Botim Special
VITI 2025
UNIVERSITETI
"EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
kërkime universitare
BULETINI SHKENCOR
SCIENTIFIC JOURNAL

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

BULETINI SHKENCOR "KËRKIME UNIVERSITARE"

Viti XXXVI i botimit

(Botim Special)

2025/1

ISSN: 2226-082X

PUBLIKUAR NGA UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

BULETINI SHKENCOR "KËRKIME UNIVERSITARE"

Botim periodik
Viti XXXVI (Botim Special)
2025/1

SCIENTIFIC JOURNAL "UNIVERSITY RESEARCH"
Periodical

Year XXXVI (Special Issue)
2025/1

PUBLISHED BY "EQREM ÇABEJ" UNIVERSITY
GJIROKASTËR

EDITOR IN-CHIEF
Prof. dr. Jaho Cana
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër
Rruga "Studenti" 6001, Gjirokastër
www.uogj.edu.al
Tel: +355 8426 3408

EDITORIAL BOARD
1. Prof. dr. Gëzim Sala
2. Prof. dr. Shyqyri Hysi
3. Prof. dr. Lavdi Hasani
4. Prof. asoc. Valbona Duri
5. Prof. asoc. Merita Shehu
6. Prof. asoc. Joana Taçi
7. Prof. asoc. Sadik Malo
8. Prof. asoc. Maria Agolli
9. Prof. asoc. Enkela Caca
10. Prof. asoc. Drita Luzo
11. Prof. asoc. Irena Boboli
12. Doc. Dr. Isidor Kokalari

Korrektuesi në gjuhën shqipe
Prof. asoc. Spiridhulla Poçi

Korrektuesi në gjuhën angleze
Dr. Arben Gaba

Koordinator Administrativ
Prof.asoc. Lorenc Koçiu

BOTUES
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër
Lagjja "18 Shtatori", rruga "Studenti" 6001, Gjirokastër

Copyright © - Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet pa respektuar të drejtën e autorit.

Të gjitha materialet e botuara në këtë Botim Special janë punime të pranuara dhe të referuara në International Interdisciplinary Conference "The National Park of Vjosa: The dialogue of science, culture, and sustainable development", zhvilluar në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër më datë 28 Qershor 2024.

ISSN: 2226-082X

SCIENTIFIC COMMITTEE

1. Prof. dr.Jaho Cana
2. Prof. dr. Gëzim Sala
3. Prof. dr.Lavdi Hasani
4. Prof. dr. Shyqyri Hysi
5. Prof. dr. Shyqyri Llaci
6. Prof. dr. Valentina Duka
7. Prof. dr. Edlira Luçi
8. Prof. dr. Elida Tabaku
9. Prof. dr. Esmeralda Kromidha
10. Prof. dr. Klodiana Gorica
11. Prof. asoc. Ermal Baze
12. Dr. Aurora Dibra

ORGANISING COMMITTEE

1. Prof.asoc. Merita Isaraj
2. Prof. dr. Lavdi Hasani
3. Prof.asoc. Mimoza Çarka
4. Prof.asoc. Albina Sinani
5. Dr. Daniela Qiqi
6. Msc. Irma Gjolleshi
7. Brikena Metaj

PËRMBAJTJA

Selami Xhepa	**Rritja ekonomike dhe mjedisi: drejt një "*de-coupling*" të detyruar**	**9**
Ksenofon Krisafi	**Statusi i Vjosës në perspektivën juridiko-ndërkombëtare**	**14**
Dhimitër Çondi *Gëzim Sala*	**Pasuritë arkeologjike e trashëgimia kulturore në luginën e Vjosës dhe impakti i tyre në zhvillimin e turizmit.**	**21**
Spiridhulla Poçi	**Zbatimi i standardit të gjuhës shqipe në tabelat orientuese dhe informuese**	**32**
Merita Gjokutaj-Shehu	**Pasuria e jetës, kërkimi dhe përpunimi i fjalës poetike në poezinë e Petrit Rukës**	**42**
Mimoza Zekaj *Merita Isaraj*	**Shqyrtime dhe prurje gjuhësore në ligjërimin e Petrit Rukës**	**46**
Daniela Qiqi	**Teknikat efektive të MBNJ-së si faktorë suksesi për sipërmarrjet turistike në luginën e Vjosës, Shqipëri**	**52**
Irena Boboli *Manjola Sulaj* *Florjana Pango* *Drita Luzo*	**The importance of the local community involvement in the development of sustainable tourism in the Vjosa basin**	**58**
Eduina Guga *Bitila Zhuli*	**Ndikimi i treguesve gjeografikë dhe specialiteteve tradicionale të garantuara në zhvillimin ekonomik të luginës së Vjosës**	**64**
Bitila Zhuli *Alma Kore* *Evionda Skëndi*	**The interaction of nature and man: Sustainable socio-economic development in the Vjosa national park**	**75**
Pamela Barjami *Maria Agolli* *Arjeta Xhemali* *Fioralba Barjami* *Endri Xhekollari*	**Tourist-environmental assessment of the Permet district, traditional food processing, and typical products of the area**	**83**
Ana Çano *Monika Kolleshi*	**Alternative tourism and its impact on economy case study: The southern region of Albania**	**88**
Zamira Veizi *Griselda Shehu*	**Management of the Vjosa river national park: benchmark analysis and international model**	**98**
Robert Çelo *Zamira Veizi*	**Development of the Vjosa area in the local economy and economic-social impact**	**103**
Albana Allushaj *Drita Luzo* *Sara Bixhaku* *Loreta Mamani*	**Roli i politikëbërjes në zhvillimin e parkut kombëtar të Vjosës: Një analizë tematike**	**108**
Leonard Sala *Fatjon Malaj*	**Evoluimi i legjislacionit mbi trashëgiminë natyrore e kulturore gjatë tranzicionit në Shqipëri. Rasti i lumit**	**118**

	Vjosa	
Nevila Koçollari Furxhiu	**Integrated management of community development in protected area of the Vjosa valley**	**125**
Lavdi Hasani *Aneta Çomo*	**Të dhëna mbi disa hexapode të takuara në rajonin ujëmbledhës të lumit të Kardhiqit si pjesë e ekosistemit të parkut natyror të lumit të Vjosës**	**144**
Aneta Çomo *Lavdi Hasani*	**Disa parametra të proceseve mikroevolutive në popullatën e qytetit të Gjirokastrës të vlerësuara nëpërmjet metodës së izonimisë**	**154**
Zhenisa Çuni *Juliana Xhindolli*	**A review of acute appendicitis' postoperative pain management in Albania**	**163**
Zhenisa Çuni *Romeo Mano* *Pamela Barjami*	**A comprehensive assessment of adolescents' high-risk behaviors in Gjirokastër**	**170**
Altin Goxharaj *Zamira Vllaho* *M. Jorida Zoga* *Majlinda Kallco*	**Bia dhe sporti: rëndësia e analizës impedenciometrike në ata që praktikojnë aktivitetet sportive (motorike), por jo vetëm në rajonin jugor të Shqipërisë**	**177**
Maria Agolli *Pamela Barjami* *Mimoza Llavdaniti* *Hamdi Nazeraj*	**Global warming, its effects on climate, the impacts on economic development in the Gjirokastra district**	**188**
Edlira Shehu	**Vlerësimi i gjendjes mjedisore të lumit Drino**	**194**
Jonida Çarka	**Utilizing ICT for community engagement and cultural preservation in the Vjosa national park**	**205**
Vjollca Rrapai	**Këngët e dasmës në krahinën e toskërisë përgjatë lumit Vjosë**	**218**
Sashenka Kamberi	**Variacione gjuhësore e etnografike të banorëve të rrethit të Tepelenës përgjatë lumit Vjosë**	**223**
Entela Kore	**Vështrim kulturor e gjuhësor në zonën e grykëderdhjes së Vjosës**	**228**
Almira Sadikaj	**Tipare dialektore e krahinore në luginën e Vjosës, krahina e Mallakastrës**	**234**
Mirela Saraçi	**Refleksione lirike në veprën "Emrin e ka dashuri" të Bardhyl Londos**	**240**
Zeqir Zeqirllari	**Vëzhgime rreth disamikrotoponimeve përgjatë luginës së Vjosës: (segmenti Piskovë-Peshtan)**	**245**
Laureta Konomi	**Tradita dhe moderniteti në poezinë e Ilirian Zhupës**	**251**
Eljana Kokalari *Valentina Boboli*	**Përshkrim i rasteve të kontaktit gjuhësor mes shqipes dhe greqishtes në fjalorin teknik**	**258**
Donika Boboli – Koci *Aleksandër Boboli*	**Roli i gjuhës në formimin e identitetit etnik dhe mjediseve të përdorimit të gjuhës së minoritetit etnik**	**264**

	grek në Shqipëri	
Juliana Sinani Pesha	**Ndërveprimi kulturor, urë e gjallë lidhëse mes luginës së Vjosës e Drinos**	**270**
Albina Sinani *Fjorentin Ismaili*	**Parku kombëtar i lumit Vjosa: Trashëgimia natyrore dhe kulturore për të promovuar turizmin**	**277**
Xhuliana Zdrava *Mariglen Sherifaj*	**Trashëgimia natyrore dhe zhvillimi i qëndrueshëm në pellgun ujëmbledhës të Vjosës**	**289**
Drita Luzo (Kllapi) *Androkli Nika*	**Parku rajonal i Zagorisë si pjesë integrale e parkut kombëtar të Vjosës - trashëgimia natyrore, kulturore, folklorike dhe ndikimi ekonomik i tij.**	**296**
Alban Shahu	**Bektashizmi i natyralizuar shqiptar dhe panteizmi**	**305**
Brikena Metaj	**Ndikimi i shpalljes së Vjosës si park kombëtar në zhvillimin e rajonit të Gjirokastrës**	**312**
Mimoza Çarka *Albina Sinani* *Majlinda Bobrati*	**Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm dhe ndryshimet klimatike në kurrikulat arsimore**	**317**
Zhuljeta Lilo *Mimoza Çarka*	**Të mësuarit përmes përvojës si pjesë e veprimtarive mësimore joformale**	**328**
Loreta Mamani *Aida Sotiri* *Mimoza Çarka* *Anila Cacaj*	**Edukimi i nxënësve si qytetarë aktivë përmes integrimit ndërlëndor me në fokus parkun kombëtar të lumit Vjosë**	**333**
Aida Sotiri *Loreta Mamani* *Mimoza Çarka* *Anila Cacaj*	**Gjithëpërfshirja e nxënësve në ndërtimin e njohurive mjedisore pranë parkut kombëtar**	**343**
Brunilda Laboviti *Elisabeta Kafia* *Loreta Mamani*	**Si ndikon ekspozimi në natyrë te fëmijët me aftësi ndryshe?**	**356**
Irma Gjolleshi	**The Vjosa national park as a strong pillar of the internationalization of higher education in albania**	**363**

RRITJA EKONOMIKE DHE MJEDISI: DREJT NJË "*DE-COUPLING*" TË DETYRUAR

Prof. dr. Selami Xhepa

Abstrakt

Ky artikull trajton raportin e tensionuar në ekuacionin midis rritjes ekonomike-burimeve natyrore/mjedisit-ndikimeve sociale. Modeli i rritjes ekonomike të pakufizuar, ka prodhuar një mirëqenie sociale të paprecedentë në histori. Bashkë me këtë, ndikimi në mjedis i këtij modeli ka krijuar një situatë paqëndrueshmëri në të ekosistemit dhe është shndërruar në një kërcënim për vetë jetën e planetit. Modelet e reja të rritjes ekonomike synojnë të lehtësojnë këtë tension, duke përdorur më pak burime, duke emetuar më pak ndotës dhe rivendosur ekuilibrin natyror që garanton një qëndrueshmëri afatgjatë të jetës edhe për brezat e ardhshëm. Artikulli diskuton edhe rastin specifik të lumit Vjosa, si një rast specifik që demonstron nevojën për të adoptuar një qasje të re të politikave të zhvillimit të Shqipërisë që janë më miqësore ndaj mjedisit.

Key words: *rritje ekonomike e qëndrueshme, burime natyrore, mjedis.*

Modeli (problematik) linear i rritjes ekonomike

Që kur njerëzimi e dominoi natyrën përmes revolucionit shkencor dhe industrial, progresi material i shoqërisë ka njohur rekorde të panjohura kurrëmë parënë histori (të pakën historinë siç e njohim ne). Indikatorët që masin progresin e shoqërisë, si të ardhurat për frymë, jetëgjatësia dhe cilësia e shëndetit të popullatës, kanë vendosur rekorde historike. Por, ky progres ka edhe anën e saj problematike: rritja e pandërprerë ekonomike që në nisjen e Revolucionit të Parë Industrial, ka ardhur përmes shfrytëzimit në rritje të burimeve natyrore, të cilat siç dihet, janë ofertë fikse, janë të shterueshme. Aftësia jonë për të rritur mirëqenien ka qenë elidhur ngushtësisht me aftësinë tonë për të ekstraktuar sa më shumë burime natyrore: më shumë minerale, më shumë lëndë djegëse, më shumë tokë bujqësore, më shumë pemë, më shumë ujë etj. Ky model zhvillimi linear: prodho më shumë duke përdorur më shumë burime, ka krijuar një konflikt serioz së pari, me qëndrueshmërinë e burimeve që ato t'u shërbejnë edhe brezave që vijnë dhe, së dyti, kjo ka përkeqësuar ndjeshëm ekosistemin tonë, duke kërcënuar vetë planetin (Li et al., 2022).Kjo, pra, është njëçështje me impakte në shpërndarje si brenda dhe midis brezave. Në parantezë, duhet shtuar për trajtimin e gabuar që statistikate llogarive kombëtare i bëjnë dëmtimit të mjedisit. Duke e matur progresin tonë me GDP/frymë, ekstraktimi burimeve dhe ndotja që prodhohet si pasojë, llogariten thjesht sikur ato e shtojnë GDP-në, dhe jo sikur e pakësojnë në të vërtetë. Dy harresat më të rënda të indikatorit GDP, janë (1) shterimi dhe degradimi burimeve mjedisore, dhe (2) shërbimet mjedisore që nuk ofrohen përmes tregut nga aktiviteti ekonomik (eksternalitetet negative). Një analizë e detajuar e kësaj çështjeje gjendet te (Venkatachalam, 1995).Duke përdorur metrin e gabuar, njerëzimi ka stimuluar shfrytëzimin më intensiv të burimeve, pa u paralajmëruar për pasojat negative të saj.

Edhe vetë ekonomiksi, shkenca e rrallësisë dhe optimizimit të përdorimit të burimeve ekonomike, për shkak të natyrës antropocentrike, ka qenë miope në aspektin metodologjik. Modelet teorike të përpunuar nga ekonomistët klasikë (që nga David Rikardo) dhe më vonë ata neoklasikë (modelet e reja të rritjes të R. Solow), e shikonin funksionin e prodhimit të kufizuar nga dy variabla, puna dhe kapitali. Dhe kapitali nënkupton vetëm kapitalin e krijuar nga njeriu (makinat, veglat e punës) dhe kapitalin financiar. Ndërkohë, burimet ekonomike dhe shfrytëzimi i tyre nuk ishin pjesë e asnjë teorie ekonomike; siç thoshte Rikardo, fuqitë e tokës (lexo: pasuritë natyrore) janë origjinuese dhe të pashkatërrueshme. Teoria neoklasike nuk merr në konsideratë implikimet që ka alokimi burimeve në afatin e gjatë për shpërndarjen midis brezave. Vendet me të ardhura të larta, janë padyshim edhe kontribueset kryesore në ndotjen e mjedisit (me 74% të totalit të emetimeve -Hickel, 2022) duke demonstruar ineficienca të mëdha në menaxhimin me efektivitet të burimeve natyrore.

Ka të dhëna të mjaftueshme se zhvillimi dhe progresi material i shoqërisë sot nuk është i qëndrueshëm. Mjedisi është i mbistresuar dhe shërbimet ekologjike, të nevojshme për

vazhdimësinë e jetës në tokë, janë shqetësuese. Kur flasim për shërbimet ekologjike, këtu futen (1) rregullimi i gazrave, (2) rregullimi i klimës, (3) rregullimi disturbancave, (4) rregullimi dhe furnizimi me ujë, (5) habitatet, (6) formimi i tokës, (7) ciklet ushqimore, (8) asimilimi i mbetjeve, (9) pllenimi, (10) prodhimi ushqimor, (11) lëndët e para, (12) burimet gjenetike dhe (13) nevojat njerëzore kulturore dhe rekreacion. (Costanza et al. (1997).

Një raport i Kombeve të Bashkuara (MEASR, 2005) nënvizon se 60% (15 nga 24) e ekosistemeve të shqyrtuara nga autorët po përdoren në mënyrë jo të qëndrueshme. Për më tepër, nga pikëpamja e shpërndarjes, të varfërit po vuajnë kosto shumë më disporporcionale për shkak të këtyre ndryshimeve sistemike.

Eshtë për këtë arsye që zhvillimi i qëndrueshëm – zhvillimi ekonomik pa dëmtuar natyrën - është dhe objektivi kryesor i shoqërisë në shkallë globale. COP26[1] nënvizoi nëvojën urgjente të shoqërisë për të zbatuar zgjidhje të qëndrueshme, që reduktojnë emetimet në mënyrë që të parandalohen katastrofat klimatike.

Studime të shumta ekonometrike kanë eksploruar listën e faktorëve që shkaktojnë emetimet mjedisore, ku shumica prej tyre nënvizojnë si shkaktarin kryesor ekstraktimin e burimeve natyrore. Eficienca e energjisë shihet si një nga mënyrat se si mund të mbahet nën kontroll ndotja mjedisore, pa cënuar rritjen ekonomike.

Ka disa shenja pozitive. McAfee në librin e tij "More from Less" evidenton se në vendet e zhvilluara duket se kemi hyrë në një model të ri zhvillimi. Për herë të parë, vendet e industrializuara po prodhojnë më shumë duke përdorur më pak burime. Edhe vendet në zhvillim, si Kina apo India, po sillen në mënyrë më të kujdesshme me mjedisin.

Roli i pasurive natyrore në zhvillimin ekonomik: një lidhje e pavendosur

Çështja e rolit të pasurive të natyrës në zhvillimin ekonomikështë shumë kontraverse, veçanërisht, në kontekstin e ekonomive në zhvillim. Ato janë konsideruar edhe si bekim, por edhe si mallkim. Disa vende që kanë bollëk në pasuritë mbi- dhe nëntokës, janë sot ndër vendet më të zhvilluara të botës, ndërsa të tjerë kanë mbetur në varfëri edhe pse disponojnë pasuri të paçmueshme. Studimet kanë treguar se, që prej vitit 1960,vendet që kanë bollëk të burimeve natyrore, kanë shënuar ritme të rritjes ekonomike më të ulëta se vendet e varfra në pasuri natyrore (Auty, 2000).

Në këtë kuadër, edhe Shqipëria mund të konsiderohet si një vend i bekuar me shumë burime të pasura: me ujë dhe pyje, minerale dhe naftë, det dhe klimë, pasuri këto të mjaftueshme për të ndërtuar një ekonomi tëbegatë dhe të shëndetshme. Pyetja që kërkon një përgjigje është se pse kjo diferencë: pse për disa vende burimet kanë qenë një bekim e për të tjerët një mallkim? Pse në saj të tyre diku është mbjellë progresi dhe mirëqenia, dhe në të tjerat degradimi social dhe mjedisor? Përgjigjia qëndron te menaxhimi i burimeve, jo thjesht në kuptimin e diferencës midis një menaxhimi nga shteti apo nga sektori privat, por në një nivel më përgjithësues, të lidhur, së pari, me karakteristikat e burimeve natyrore, së dyti, me aktorët e përfshirë dhe, së treti, me kuadrin institucional dhe rregullator. Diferencat në performancën ekonomike midis këtyre dy grupe vendesh përcaktohen nga cilësia e qeverisjes, ku kjo e fundit lidhet me natyrën e sistemit politik dhe modelet e ndryshimeve strukturore në raport me bollëkun e burimeve natyrore.

Shfrytëzmi intensiv i pasurive që u përdor për të krijuar një ekonomi të industrializuar gjatë viteve të komunizmit, prodhoi një realitet problematik. Asnjë kriter ekonomik nuk u përdor në përcaktimin e një norme optimale shfrytëzmi tëpasurive të nëntokës, dhe nga ana tjetër, të ardhurat e gjeneruara u përdorën për të krijuar industri të rënda që mund të mbijetonin vetëm në kushtet e një sistemi të mbyllur. Këtë e provoi tranzicioni ku ndërmarrjet që mund t'i mbijetonin konkurrencës ishin raste përjashtimore (nëse ka ndonjë të tillë). Po kështu, efektet mjedisore negative që krijoi ky përdorim pa kriter i burimeve nuk ishin marrë në konsideratë, duke na lënë një trashëgimi problemesh serioze.

Në sistemin e ekonomisë së tregut, burimet mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm për të

[1]Emri me të cilën referohet Konferenca e 26-të e Kombeve të Bashkuara mbi Klimën, mbajtur në Glasgou të Skocisë në vitin 2021.

mbështetur zhvillimin ekonomik në kushtet e konkurrencës, nëse qeverisen në mënyrë të mençur. Nuk ka dyshim se nga pikëpamja e efikasitetit ekonomik të investimeve, pronësia e sektorit privat është me avantazhe të padiskutueshme. Sikurse dhe historia e ekonomisë e ka dëshmuar, sipërmarrja private ka qenë promotore e inovacioneve teknologjike dhe metodave më racionale të shfrytëzimit të burimeve natyrore. Në të gjithë praktikën botërore të vendeve demokratike, pasuritë e nëntokës i janë dhënë sektorit privat në shfrytëzim. Por menaxhimi burimeve është më shumë se pronësi apo e drejtë shfrytëzimi; analiza e aktorëve dhe identifikimi i fituesve dhe humbësve janë baza nisëse e hartimit të kuadrit rregullator ku operon industria.

Edhe pse në pamje të parë Shqipëria duket se nuk është ndotës me rëndësi krahasuar me vendet e rajonit (siç duket nga grafiku 1), një studim i Agjensisë Evropiane të Mjedisit (Citizens, 2020) nënvizon se Shqipëria renditet vendi i dytë në rajon, Pas Bosnje Herzegovinës sa i takon numrit të vdekjeve të shkaktuara nga ndotja e atmosferës. Pra raporti mjedis-rritje ekonomike-shoqëri ka njohur përkeqësime të dukshme dhe gjatë viteve të tranzicionit. Vendin e industrisë së rëndë dhe pa standardet e nevojshme mjedisore që u ngritën gjatë periudhës komuniste, e kanë zënë ndotës të tjerë, nisur nga ndërtimi, konsumi lëndëve djegëse nga automjetet jashtë standardeve etj.. Në veçanti, ndërtimi i një rrjeti të gjerë veprash hidrike mbi lumenj dhe përrenj; rreth 175 HEC janë ndërtuar tashmë dhe shumë më tepër janë projektuar.

Grafiku 1: Sasia e CO2 (kt ekuivalent) të emetuar gjatë viteve nga Shqipëria dhe disa vende të rajonit



Burimi: ndërtuar me të dhënat e marra nga World Bank: https://data.worldbank.org/indicator/EN.ATM.CO2E.KT?locations=AL-BA-HR-RS&view=chart)

Projekti i ruajtjes së lumit Vjosë dhe impakti ekonomik

Megjithë plotësimet e legjislacionit mjedisor, duhet nënvizuar se respektimi i tij është në nivele të papranueshme. Autoritete publike janë aspak reagues ndaj zërittëqytetarëve dhe organizatave mjedisore lidhur me shqetësimet mjedisore. Rasti tipik ishte ai i ndërtimit të aeroportit të Vlorës ku rrezikohen specie të rralla dhe habitatet natyrore të tyre. Duke marrë shkas nga ky rast dhe rasti i mbrojtjes së lumit Vjosa, më shumë se 40 shoqata mjedisore i kanë nisur qeverisë një peticion (Co-Plan, 2022) për nevojën e ruajtjes dhe promovimit të biodiversitetit. Fatmirësisht rasti i lumit Vjosa tërhoqi vëmendjen e celebriteteve botërore, gjë që ndoshta e bëri qeverinë të tërhiqej nga planet e zhvillimi ekonomik në këtë korridor lumor, një pasuri me vlera të veçanta për biodiversitetin e saj natyror. Mbi 40 HEC që ishin projektuar të ndërtoheshin mbi këtë lumë, do të ndikonin mjaft negativisht mbi ekosistemin e gjithë kësaj rrjedhjeje dhe do të kufizonin ndjeshëm përdorimin e saj për qëllime të tjera alternative, përfshirëekoturizmin dhe aktivitetet e lidhura me natyrën e egër.

Eshtë mjaft e vështirë metodologjikisht të përcaktohet vlera e dëmit mjedisor që mund t'i shkaktohet vendit nga zbatimi i projekteve të cilat kanë pasoja dëmtuese mbi mjedisin. Ndërsa

ndërtimi i një aeroporti, si ai i Vlorës, mund të kuantifikojë më saktë të ardhurat e pritshme dhe përfitimet ekonomike, kostot mjedisore janë të pamatshme, për pasojë fitimprurjet e projekteve të tilla janë gjithnjë të ekzagjeruara. I njëjti konstatim është dhe për zhvillimin e aktiviteteve mbi lumin Vjosa, duke i dhënë vlerën zero humbjeve serioze të biodiversitetit. Fatkeqësisht nuk ka një treg të vlerës së habitatit, biodiversitetit. Një studim i kryer nga ECO Albania (2020) ka analizuar hollësisht impaktet negative të humbjes së biodiversitetit në rast të ndërtimit të HEC-ve të planifikuara mbi lumin Vjosa, por është e pamundur të vendoset një numër në shifra i dëmit ekonomik të krijuar.

Në një studim të një grupi autorësh (Verburg&Osseweijer, 2019) kosto mjedisore e biodiversitetit i ndërtimit të një centrali për prodhim energjie, në varësi të sasisë së prodhimit, llojit të burimit të lëndës djegëse të përdorur, dhe llojit të vegjetacionit të impaktuar, varion nga 34,000 EUR deri në mbi 1.7 milionë EUR në vit. Studimi nënvizon rëndësinë që marrin studimet spaciale në llogaritjen e humbjeve të projekteve të tilla mjaft komplekse, duke nënkuptuar se është e pamundur të përgjithësohen këto rezultate të vlerësuara në vende të tjera apo kontekste të tjera gjeografike dhe biodiversitetit.

Në këtë kontekst, duhet nënvizuar rëndësia që bota akademike dhe kërkimet në Shqipëri duhet t'i japin ndërtimit të modeleve më të plota të vlerësimit të humbjeve, në mënyrë që shoqëria të bëjë zgjedhje më të informuara mbi kostot dhe përfitimet që ajo ka nga zbatimi i projekteve specifike. Ndërtimi i një metodologjie të vlerësimit ekonomik të dëmit merr një rëndësi prioritare në kontekstin e nevojës për ndryshimin e modelit ekonomik të vendit, nga një rritje e bazuar te shfrytëzimi intensiv i burimeve, tek ai i një rritje të mbështetur te respektimi natyrës dhe burimeve.

Konkluzione

Ky artikull trajton nevojën e ndryshimit të modelit të zhvillimit ekonomik. Edhe pse vendi u mbështet fort në shfrytëzimin e burimeve natyrore të disponueshme, Shqipëria nuk arriti të krijojë struktura ekonomike të qëndrueshme dhe të prodhojë mirëqenie në afatin e gjatë. Në sistemin e mëparshëm ekonomik kjo lidhet me qasjen politike për ndërtimin e një ekonomie të vetëmjaftueshme dhe orientimin e burimeve ekonomike jo të bazuar në ligjësitë e tregut të lirë; ndërsa në sistemin e ekonomisë së tregut janë evidentuar probleme të qeverisjes ekonomike që lidhen me ndarjen e përfitimeve që burojnë nga shfrytëzimi i tyre.

Zhvillimi ekonomik dhe ruajtja e natyrës dhe biodiversitetit, duhen shqyrtuar si një ekuilibër afatgjatë për të garantuar qëndrueshmëri të jetës dhe cilësisë së saj edhe për brezat e ardhshëm. Kjo kërkon që analizat ekonomike të shfrytëzimit të pasurive të ndërtohen në metodologji më të sakta dhe në veçanti, të kuantifikohen impaktet ekonomike e financiare të dëmtimit të ekosistemit tonë.

Literatura

Andrew McAfee, 2019, More from Less: the suprising story of how we learned to prosper using fewer resources and what happens next", Simon & Schuster

Costanza, R., D'Arge, R., De Groot, R., Farber, S., Grasso, M., Hannon, B., Limburg, K., Naeem, S.,O'Neill, R.V., Paruelo, J., Raskin, R.G., Sutton, P., and Van den Belt, M. (1987) "The Value of theWorld's Ecosystem Services and Natural Capital", Nature, 387, pp. 253-260.

J. Hickel, 2022, 'High-Income Countries Are Responsible for 74 Percent of Excess Resource Use Causing Ecological Breakdown' LSE

Lei Jiao, Baiwei Xie, Sijin Lu, 2023, Understanding the economy of natural resources: Fundamental role of natural resources in sustainable development, Resources Policy Volume 86, Part B, October 2023, 104237

L. Venkatachalam, 1995, Natural resource accounting (NRA) for sustainable development: A survey; Working Paper No. 130, Madras Institute of Development Studies

Ola Mitre, ECO Albania, (2020), Udhëzues për ndërmarrjen e fushatave për mbrojtjen e

mjedisit: Rasti Vjosa, Prill 2020, https://ecoalbania.org/wp-content/uploads/2023/05/The-Vjosa-Case-A5-Shqip-DRAFT-1.pdf

Richarc M. Auty, 2000, How natural resources affect economic development, Development Policy Review, Volume 18 (2000). Available at: https://library.fes.de/libalt/journals/swetsfulltext/9404729.pdf

Verburg, R. W., & Osseweijer, F. (2019). A framework to estimate biodiversity lossand associated costs due to nitrogen emissions from single power plants. Journal ofCleaner Production, 239, ç117953]. https://doi.org/10.1016/j.jclepro.2019.117953

United Nations (2005) Millennium Ecosystem Assessment Synthesis Report (MEASR): Prepublication Final Draft Approved by MA Board on March 23, 2005. Available at

http://matagalatlante.org/nobre/down/MAgeneralSynthesisFinalDraft.pdf

https://www.co-plan.org/wp-content/uploads/2024/01/1-st-FORUM-Deklarate-e-perbashket-e-organizatave-mjedisore_.pdf

https://citizens.al/2020/09/09/23-e-vdekjeve-ne-shqiperi-shkaktohen-nga-ndotja-mjedisore/

STATUSI I VJOSËS NË PERSPEKTIVËN JURIDIKO-NDËRKOMBËTARE

Prof. dr. Ksenofon Krisafi

Vjosa dhe pellgu i saj është një pjesë mikroskopike e universit të madh ujor, i cili mbulon rreth 72 % të sipërfaqes së krejt rruzullit tokësor, që është e barabartë me 509 milionë km² të sipërfaqes. Ai përfaqëson një kub me brinjë rreth 1000 km, me volum rreth 1 400 milionë km³. Sipas studiuesve të fushës, kjo sasi gjigante ujore, e cila ka mbetur, pothuajse, e pandryshuar gjatë gjithë kohërave, ka bërë që Toka të quhet ndryshe edhe planeti blu. [1]

Pjesa më e madhe e ujërave të rruzullit, rreth 97.2 %, përbëhet nga ujërat e kripura, të deteve dhe oqeaneve. Ujëra të ëmbla janë vetëm 2.8 %. Prej tyre rreth 2.1 % janë akujt polarë, çka do të thotë se 0.7 % mbetet ujë i ëmbël, që vjen nga lumenjtë, liqenet, përrenjt, kanalet, basenet nënujore etj.. Ky është i disponueshëmpër konsum njerëzor, në bujqësi, ekonomi, industri etj.[2]

Lumenj ndërkombëtarë ndër më të rëndësishmit, që rrjedhin në, pothuajse, gjysmën e sipërfaqes tokësore të globit, janë 261.[3]

Rritja demografike, shtimi i nevojave për ujë të ëmbël, shterimi i rezervave ujore nga shpërdorimi i tyre, ndotja dhe ndryshimet klimatike, shpërndarjet e pabarabarta të basenve me ujëra të ëmbla në sipërfaqe dhe nën tokë, kanë bërë që kjo çështje të shndërrohet në një nga sfidat më të mëdha të shekullit XXI. Uji i ëmbël konsiderohet burim strategjik, prandaj politikanë nga vende të ndryshme kanë filluar të flasin edhe për të ashtuquajturën "luftë për ujin",[4] *e cila mund të zëvendësojë edhe "luftën për naftën",*[5] *për sa kohë që kjo do të ketë ende përdorimet dhe konsumin e ditëve tona.*

***

Në Shqipëri numërohen 152 lumenj, nga të cilët 11 hyjnë në grupin e kryesorëve.[6] Pellgu i përgjithshëm ujor shqiptar është llogaritur në 43 905 km², brenda dhe jashtë vendit.[7] Pjesë e tij është edhe Vjosa, për administrimin dhe ruajtjen e së cilës është punuar nga shumë institucione shtetërore, akademike e shkencore si dhe nga organizma të shoqërisë civile, vendase dhe të huaja. Si rrjedhojë, është arritur të sanksionohet zyrtarisht krijimi i Parkut Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa (PKLEV). Ai do të përfshijë dhe mbrojë të gjithë rrjedhën e saj, nga kufiri grek deri në detin Adriatik, bashkë me degët me rrjedhje të lirë.

Çështja e Parkut Kombëtar të Vjosës ngërthen një kompleks problemesh me karakter ekonomik, politik, shoqëror, demografik, mjedisor, juridik etj.. Ato kanë të bëjnë jo vetëm me legjislacionin, me autoritetet shtetërore dhe juridiksionin përkatës të të dy shteteve, territoret e të cilave lagen nga ujërat e saj, por edhe me normat dhe parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare.

Shteti shqiptar ka miratuar prej kohësh një sistem normativ kompleks, aktet e të cilit kanë si mision të rregullojnë juridikisht mënyrat dhe format e shfrytëzimit racional të ujërave, ruajtjen e sasisë dhe cilësisë së tyre, mbrojtjen nga ndotja etj.Shqipëria është bërë palë edhe në aktet juridiko-ndërkombëtare që trajtojnë këto çështje.

---

1 *L'eau dans l'Univers*, Le Centre d'information sur l'eau, le mercredi, 20 novembre 2013, materiali është publikuar në www.cieau.com/...eau/dans-le-monde/ressources-en-eau.

2 Po aty.

3 Aaron T. Wolf,- *Conflict and cooperation along international waterways*, në (1) *Water Policy*, Vol. 1 #2, 1998. pp. 251-265.

4 Po aty.

5 Pierre Blanc et Philippe Le Grusse, - *Une révolution hydraulique en Mediterranée*, botuar në *Les notes d'analise du CIHEAM*, Nr.26, Novembre 2007, p.6.

6 A. Miho, - *Lumenjtë e jetës (mbresa dhe fakte)*, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, – Janar 2012, f. 3.

7 Po aty, f. 5.

Eshtë e qartë se administrimi, shfrytëzimi dhe mbrojtja e tyre mund të bëhet vetëm në bashkëpunim midis dy shteteve, në respekt të projekteve rajonale të BE-së dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare si dhe të akteve juridiko-ndërkombëtare. Nëse politika dhe autoritetet e fqinjëve nuk tregojnë vullnet politik, gatishmëri dhe dëshirë për bashkëpunim, në ujërat e përbashkëta midis dy a më shumë shteteve, nuk mund të realizohet asnjë projekt në kushte normale dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

***

Ka disa akte midis dy vendeve, por edhe konventa shumëpalëshe ku bëjnë pjesë të dy shtetet, që përcaktojnë se nuk lejohet ndërmarrja e veprimtarive të kësaj natyre, pa u marrë vesh me shtetin e rrjedhës së poshtme. Ato kujdesen që të mbrohet natyra për të shpëtuar mjedisin. Lumi, patjetër edhe Vjosa, siç e ka bërë natyra, iu shërben të gjitha gjallesave, njerëzve, kafshëve, florës, faunës etj. Vënia dorë mbi ujërat e embla, ndikon në ngrohjen klimatike të tokës. Ndërtimi i digave, kur bëhet pa respektuar interesat e të tjerëve dhe standardet e kushtet teknike, e bën ujin të dobishëm përgjithësisht për investitorët. Sepse në këto raste zakonisht janë ata që nxjerrin përfitime, kurse të tjerët mund të pësojnë pasojat e ndërhyrjeve arbitrare ndaj natyrës dhe ujit.
Vjosa, së bashku me lumenj të tjerë të rajonit, si Neretva, Drina, Moraça, Tara, Una, Kolpa, Sava etj., është pjesë e një sistemi ujor, që janë quajtur "Zemra Blu e Evropës". Ata përbëjnë një vlerë të madhe ekologjike, unikale në krahasim me vendet e tjera të kontinentit. Sa për ilustrim po përmendim se aty ndodhen 69 lloje peshqish që s'gjenden në asnjë vend tjetër në planet.
Statusi, regjimi i lumenjve që ndodhen ose rrjedhin brenda territorit të një shteti, të ashtuquajtura edhe ujëra kombëtare, janë objekt rregullimi juridik nga ana e legjislacionit të brendshëm të shteteve përkatëse. Në to, si rregull shtetet e tjera nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë, me përjashtim të rasteve kur shfrytëzimi dhe përdorimi i tyre sjell ndikime në shtetet e tjera, në mjedisin, klimën, florën, faunën ose edhe zhvillimin ekonomik e demografik në shtetet e tjera. Por, sërish kërkohet marrëveshja e palëve dhe mirëkuptimi i tyre.
Kurse ujërat që rrjedhin apo që ndodhen në kufijtë e disa shteteve kanë tërhequr posaçërisht vëmendjen e hidrologëve, biologëve, ekonomistëve, demografëve, specialistëve të mjedisit, por sidomos të politikës, diplomacisë, specialistëve të së drejtës etj. Ata kanë bashkërenduar përpjekjet në kuadër bilateral dhe multilateral për të gjetur zgjidhje të përshtatshme, në pajtim me normat dhe parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare, si respektimi i tërësisë dhe sovranitetit territorial të shteteve, barazia sovrane, parimi i fqinjësisë së mirë, moskërcënimi dhe mospërdorimi i forcës etj. Synimi është ruajtja e kësaj pasurie të çmuar, administrimi i mirë dhe i integruar i saj, në interes të brezave aktualë dhe atyre të ardhshëm.

***

Vjosa është një pasuri e madhe që natyra ua ka falur shqiptarëve dhe grekëve dhe që duhet mbrojtur, duke zbatuar me korrektësi dispozitat e akteve juridiko-ndërkombëtare ku janë palë. Ato kanë si premisë bazë "bashkësinë e interesave të shteteve breglumore". Midis tyre, tre konsiderohen si më themeloret dhe përmenden edhe si baza burimore e një dege të veçantë të së drejtës ndërkombëtare, të quajtur "e *drejta lumore"*. Bëhet fjalë për Konventën *Për vlerësimin e ndikimit mjedisor në kontekstin ndërkufitar*, miratuar në Espoo (Finlande), më 25 shkurt 1991 (ESPOO 1991), në të cilën janë palë Shqipëria prej 4 tetorit 1991 dhe Greqia prej 24 shkurtit 1998, Konventën e Helsinkit të 17 marsit 1992 *Për mbrojtjen dhe përdorimin e rrjedhave ujore ndërkufitarë dhe të liqeneve ndërkombëtare*, që ka hyrë në fuqi më 6 tetor 1996, ku sërish janë palë si Shqipëria (05.01.1994) ashtu edhe Greqia (06.09.1996), si dhe *Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e përdorimeve jolundruese të rrjedhave ujore ndërkombëtare*, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 21.05.1997, në të cilën Greqia ka aderuar më 2 dhjetor 2010, kurse Shqipëria ende jo[8].

[8] Bëhet fjalë deri në 19 korrik 2024, kur shteti më i fundit që ka aderuar në Konventë ishte Zimbabve.

Ato sanksionojnë parimin e rëndësishëm se në ujërat e përbashkëta, asnjë nga shtetet që laget prej tyre nuk duhet të ndërmarrë punime apo veprime që cenojnë sasinë dhe cilësinë e ujërave, pa u marrë vesh me shtetin apo shtetet e tjerë, që ndodhen në rrjedhat e sipërme apo të poshtme të tyre.
Pra, shteti grek, sikurse edhe ai shqiptar, pa u marrë vesh me njëri-tjetrin, nuk duhet të nisin asnjë veprimtari në shtretërit e lumenjve të përbashkët, përfshirë pa dyshim edhe Vjosën.
Por, deri tani Greqia ka devijuar një sasi të konsiderueshme të ujërave të Vjosës. Nuk dihet se çka ndodhur me një të quajtur Plan ose Raport Teknik të devijimeve, një kopje e të cilit i është dorëzuar delegacionit shqiptar gjatë punimeve të një të quajturi Komision i Përbashkët shqiptaro-Grek për Ekonominë Ujore. U përdor fjala "një të quajturi", sepse rezultoi që konceptimi, roli, funksionet, kompetencat dhe ajo që ka më shumë rëndësi, veprimtaria e tij, mbetën më shumë në letër sesa kontribute reale për kryerjen e misionit që duhet të kishte krijimi i tij.
Cilado qoftë situata konkrete reale në terren apo në planet qeveritare dhe në legjislacionin grek, është rasti që të dy palët të ulen dhe të bisedojnë për zgjidhjet e duhura juridikisht të bazuara për respektimin e interesave të ndërsjella, qoftë duke marrë masat për rikthimin e gjendjes, aty ku është e mundur, qoftë edhe duke kompensuar dëmet dhe humbjet e shkaktuara.
Eshtë e nevojshme të përfundojë normalisht odisea e negociatave të nisura në 1984 për arritjen e një marrëveshjeje për ekonominë ujore (për ujërat e embla të përbashkëta) midis dy vendeve si dhe ngritjen e një Komisioni të Përbashkët real dhe funksional të ekonomisë ujore.

***

Historia e diskutimit dypalësh të trajtimit juridik të çështjes së shfrytëzimit të ujërave të Vjosës, ka nisur që në vitin 1978. Në atë kohë pala greke njoftoi palën shqiptare se mendonte të devijonte përgjithmonë 12 % të ujërave të rrjedhës së sipërme të saj, për ndërtimin e hidrocentralit të Pigait. Si rezultat i reagimit të Tiranës, në prill të vitit 1984, filluan negociatat zyrtare. Pala greke, e cila, me këtë rast, saktësoi se do të merrte jo 12 por 13 % të prurjeve mesatare vjetore te Vjosës, iu shmang diskutimit në themel të çështjes, duke kërkuar që takimi t'i kushtohej vetëm shkëmbimit të mendimeve në përgjithësi për problemet e ekonomisë ujore[9].
Insistimit të delegacionit shqiptar iu përgjigj me premtimin se shumë shpejt do të përfundonte marrëveshja përkatëse, e cila do të shërbente si kuadër i përshtatshëm ligjor për zgjidhjen e të gjitha problemeve të ekonomisë ujore midis të dy vendeve. Takimi i Tiranës përfundoi me krijimin e një organi që u quajt "Komisioni i Përbashkët Shqiptaro-Grek për Ujërat e Lumenjve Kufitarë", i cili, siç u tha, rezultoi një krijesë formale, me një jetë problematike.
Në korrik të vitit 1985, iu paraqitën palës greke projektet e marrëveshjes për ekonominë ujore dhe të statutit të Komisionit të Përbashkët. Për hartimin e tyre pala shqiptare pati parasysh normat dhe parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare për përdorimin dhe shfrytëzimin e ujërave kufitare. Për të qenë sa më afër praktikës dhe përvojës greke projektet u mbështetën edhe në përcaktimet e marrëveshjeve që Greqia kishte përfunduar me vendet e tjera fqinje për çështje të kësaj natyre.
Ato duhet të diskutoheshin në mbledhjen e Komisionit të Përbashkët Shqiptaro - Grek për Ujërat, në Gjirokastër, më 18 - 22 nëntor 1985. Por pala greke refuzoi nën justifikimin se autoritetet e veta kompetente nuk kishin përfunduar ende studimin. Edhe në takimet e muajit prill 1988, zhvilluar në Athinë si dhe në Janinë, në qershor 1988, u shmang përsëri diskutimi i projektmarrëveshjes, dorëzuar që para tre vjetësh, sepse ende "nuk ishin studiuar".
Në takimin e qershorit 1988, pala greke paraqiti Raportin Teknik të përmendur më sipër. Ai përmbante me shumë hollësi planet perspektive të punimeve hidroteknike dhe programet e shfrytëzimit për ujë të pijshëm, ujitje, përdorim industrial dhe shfrytëzim energjetik të ujërave të lumit Vjosa dhe degëve të tij, në rrjedhën e sipërme dhe në pellgun ujëmbledhës në territorin grek. Në plan, i cili, sipas burimeve mediatike greke, zyrtarisht u miratua nga qeveria greke

[9] Autori ka qenë anëtar i delegacionit shqiptar në Komisionin e përbashkët shqiptaro-grek për çështjet e ekonomisë ujore dhe ruan në arkivin personal shënime rreth dokumentacionit që lidhet me këtë çështje.

rreth vitit 2013, parashikohej që pas mbarimit të hidrocentralit të Pigait, të fillonin punimet e një faze të dytë. Kjo përfshinte ndërtimin e veprave hidroteknike në tri degët kryesore të Vjosës, që do të grumbullonin dhe devijonin të gjitha ujërat e tyre para kufirit me Shqipërinë. Nëpërmjet një tuneli rreth 20 km ato bashkohen dhe çohen në pellgun e lumit Kalamas, jashtë pellgut të Vjosës, ku parashikoheshin të ndërtoheshin katër hidrocentrale të tjera.[10] Nga zbatimi i këtij projekti, sipas mendimit të specialistëve shqiptarë të kësaj fushe, shkaktoheshin probleme dhe dëme në të gjitha fushat e ekonomisë ujore. Në energjetikë ulej prodhimi nga 2.1 miliardë kw në 1 miliardë kw në vit.[11] Në bujqësi nuk mund të sigurohej sasia e ujit as për objektet që ishin në shfrytëzim, as edhe për perspektivën. Pasojë tjetër ishte ulja e nivelit të ujërave nëntokësore në të gjithë basenin e Vjosës në territorin shqiptar, duke krijuar shqetësime ekologjike të ekosistemit etj.[12] Do të kishte gjithashtu pasoja të pariparueshme në aspektet ekonomike, sociale, ekologjike, demografike etj.. Në llogari të fundit do të devijoheshin përgjithmonë edhe 77% deri në 80 % e ujërave të Vjosës ose mbi 43 metër kub ujë në sekondë.[13]

Pala shqiptare e konsideroi alarmant njoftimin e mësipërm dhe vuri në dukje se për projektet e parashikuara, madje, edhe për vazhdimin e ndërtimit të hidrocentralit të Pigait - "Pieos Aos", kërkohej shqyrtimi dhe trajtimi bashkërisht i veprimeve të ndërmarra. Përsëriti kërkesën që një ekip specialistësh shqiptarë të shihte në vend punimet e kryera, për të verifikuar sasinë e ujrave të devijuara etj. Kërkesat nuk u pranuan me justifikimin se "nuk ka asnjë projekt të palës greke për devijimin e rrjedhës së lumit Vjosa."

Pasi ritheksoi se Projekti (Raporti, Plani) teknik grek ishte i papranueshëm sepse cenonte unitetin hidrografik, ekologjinë e rajonit, duke "shkaktuar pasoja të pallogaritshme për ekonominë shqiptare", delegacioni shqiptar dorëzoi një projekt teknik të vetin. Në qendër të tij ishte ndërtimi i një hidrocentrali në Badëlonjë të Përmetit, me krijimin e një rezervuari ujëmbledhës me shtrirje dhe përmbytje në territorin grek, si kompesim për sasinë e 7 m³/s ujë që do të merrej nga Vjosa. Pala tjetër nuk e pranoi.

Autoritetet greke kanë refuzuar në forma të ndryshme përfundimin e një marrëveshjeje bilaterale parimore ndërmjet dy vendeve për trajtimin e këtyre çështjeve. Ato kanë kundërshtuar në përgjithësi përmbajtjen e projektit shqiptar të marrëveshjes, por sidomos nenin 1, në të cilin thuhej se palët marrin përsipër të shqyrtojnë dhe të zgjidhin me marrëveshje çështjet e ekonomisë ujore. Ai është një parim bazë i së drejtës ndërkombëtare i shfrytëzimit të ujërave kufitare, që vetë Greqia e ka të fiksuar në të gjitha marrëveshjet e nënshkruara me fqinjët e tjerë. Madje, me ta Greqia ka vepruar në afate optimale. P.sh., me ish-Jugosllavinë, brenda 13 vjetëve (1959-1972), ka përfunduar 3 marrëveshje të tilla, respektivisht më 18 qershor 1959, 2 qershor 1970 dhe 24 mars 1972, me Bullgarinë, brenda 7 vjetëve ka nënshkruar dy të tilla, përkatësisht më 9 korrik 1964 dhe 12 korrik 1971 ose për marrëveshjen e 20 qershorit 1934 me Turqinë. Në të tri rastet figuron detyrimi i secilës palë për t'u marrë vesh me tjetrën për çdo ndërhyrje në ujërat e lumenjve apo liqeneve të përbashkët, detyrim i cili nuk pranohet në projektmarrëveshjen me Shqipërinë, meqenëse, sipas saj, neni 1 i projektit shqiptar, që fiksonte këtë parim, "cenonte parimin e sovranitetit shtetëror, sepse i hiqte të drejtën shtetit që të bënte ç'të donte me ujërat që rrjedhin në territorin e tij"!

***

Ndërkohë, në territorin grek, kishin përfunduar punimet për ndërtimin e hidrocentralit të Pigait, i cili u vu në shfrytëzim në fundin e vitit 1991, për çka u bë njoftim zyrtar në takimin e

---

[10] Sipas *Informacionit për problemet e lumit Vjosa me Greqinë*, përcjellë Këshillit të Ministrave nga Ministria e Punëve Publike, me shkresën Nr. 1237, dt. 14.03.2001.

[11] Përveç hidrocentralit të Pigait dhe hidrocentraleve në lumin Kalamas, ishin parashikuar të ndërtoheshin gjithashtu, edhe gjashtë hidrocentrale të tjera, respektivisht në Pirsogiani, Epitachori, Agios Varvara, Armata, Voyoussa, Efeftheros. Po aty.

[12] Po aty.

[13] Po aty.

Gjirokastrës, në janarin e vitit 1992. Ai prodhon 150 milionë kilovatorë në vit, ndërsa sasia e ujërave të liqenit artificial të krijuar vetëm nga uji i burimit të Vjosës shkon nga 90 deri në 260 milionë metër kub ujë.[14]

Në Shqipëri u përmbys sistemi komunist dhe në administratën shtetërore shqiptare u krijua një vakuum relativ dhe provizor institucional dhe legjislativ. Nuk pati më bisedime dhe Komisioni nuk funksionoi për disa kohë, ndonëse, sipas Rregullores, duhej të mblidhej çdo vit. Nga kjo, me sa duket, ka përfituar pala greke, e cila, filloi edhe punimet e fazës së dytë në rrjedhën e sipërme të lumit Vjosa dhe të degëve të saj, vetëm me njoftim, pa u marrë vesh me palën shqiptare.

Çështja u ringrit sërish në tetorin e vitit 1999, gjatë punimeve të Sesionit të 7-të të Komisionit të Përbashkët shqiptaro-grek për bashkëpunimin ekonomik, industrial dhe tekniko-shkencor, mbajtur në Athinë, por sërish pa rezultatin e duhur. Janë ndërmarrë dhe realizuar disa nisma, rëndësia e të cilave është relative. Të tilla janë Marrëveshja për krijimin e Komisionit të Përhershëm Shqiptaro-Grek mbi çështjet e ujërave të ëmbla ndërkufitare, nënshkruar më 3 prill 2003 dhe hyrë në fuqi më 23 nëntor 2005, Protokolli i Komisionit Kryesor të Përbashkët Shqiptaro-Grek për çështje kufitare, nënshkruar më 3 nëntor 2005, Rregullorja e Komisionit të Përhershëm për ujërat e ëmbla, nënshkruar më 10 prill 2008 etj. Nga një vështrim i përgjithshëm i tyre mund të konstatohet se ato janë akte përgjithësisht skeletike nga përmbajtja, me formulime abstrakte dhe evazive dhe që nuk kontribuojnë në mënyrë efikase për t'iu dhënë zgjidhjen e duhur çështjeve që kanë të bëjnë me shfrytëzimin racional të ujërave të përbashkëta.

***

Në çështjen komplekse të shfrytëzimit dhe mbrojtjes së Vjosës ndikojnë jo vetëm qëndrimet zyrtare, por edhe reagimet e një numri organizatash ambientaliste dhe banorësh në disa nga zonat kufitare të Shqipërisë, të Greqisë dhe më gjerë, të cilët janë shprehur kundër disa prej këtyre projekteve. Gazeta greke "*Eksusia*", e datës 9 shkurt 2001, njoftonte se devijimi i ujërave të lumit Vjosa, ishte diskutuar edhe në Komisionin parlamentar grek për vlerësimin e teknologjisë, në shkurtin e vitit 2001. Thuhej se ishte zhvilluar një debat ndërmjet dy deputetëve të PASOK-ut, Manolis Bedenjotis dhe Theodoros Kacanevas nga njëra anë dhe zëvendësministrit të veprave publike dhe ruajtjes së mjedisit, Ilia Efthimiopullu, nga ana tjetër, i cili e kundërshtoi këtë veprim dhe u akuzua për qëndrim antiqeveritar. Qëndrimin e tij e mbështeti vetëm një deputete e partisë Demokracia e Re, Elsa Papadhimitriu, e cila tha se "është e ndershme dhe në interes të qeverisë që të ekzistojnë zëra pro mjedisit."[15] Si pjesë e këtij reagimi, në nëntorin e vitit 2013 kishin mbërritur në Këshillin e Lartë të Shtetit edhe ankesat e degës së Greqisë të Fondit Botëror për Natyrën, të bashkisë së Konicës dhe të Zagorisë, Universitetit të Mesdheut dhe disa shoqatave ambientaliste. Kërkohej anullimi i vendimit. Për qetësimin e tyre u tha se projekti ishte pjesë e një plani të vjetër, i cili do të rishikohej dhe do të përshtatej me direktivat e aktualizuara të BE-së.[16]

Nuk dihet se ç'është bërë në vijim, por, sipas dokumentacionit zyrtar grek të disponueshëm për publikun, del se në 8 korrik 2013, Ministria e Transportit dhe Ministria e Mjedisit në Greqi, si dhe në datën 4 shtator të atij viti, 7 ministri dhe institucione të tjera dhe Këshilli Kombëtar grek për menaxhimin e lumenjve, miratuan projektin e devijimit të lumenjve në veri të Greqisë, përfshirë edhe lumin Vjosë, për ndërtim hidrocentralesh dhe për pastrimin dhe pasurimin e liqenit të Janinës. Në thelb përmbaheshin përcaktimet e Raportit Teknik, të përmendur më lart, për çka nuk ishte diskutuar dhe nuk ishte arritur marrëveshja përkatëse me palën shqiptare.

---

[14] Sipas *Informacionit për problemet e lumit Vjosa me Greqinë*, përcjellë Këshillit të Ministrave nga Ministria e Punëve Publike, me shkresën Nr. 1237, dt. 14.03.2001.

[15] Sipas shkresës së ambasadës shqiptare në Athinë, Nr. 138, datë 8.02.2001, "*Për shmangien e shtratit të lumit Vjosa nga ana e Greqisë*".

[16] Anila Jole,- *Greqi, lëvizja qytetare kundër devijimit të lumit Vjosë*, në*BalkanWeb*, 27 dhjetor 2013

***

Trajtimi i drejtë i kësaj çështjeje delikate duhet të mbajë parasysh përcaktimin e fiksuar në Konventat ndërkombëtare të sipërcituara. Në to, sikurse u përmend më sipër, sanksionohet parimi i rëndësishëm se në ujërat e përbashkëta, asnjë nga shtetet që laget prej tyre nuk duhet të ndërmarrë punime apo veprime që cenojnë sasinë dhe cilësinë e tyre, pa u marrë vesh me shtetin apo shtetet e tjera, që ndodhen në rrjedhën e sipërme apo në rrjedhën e poshtme. Pra, shteti grek, (sikurse edhe ai maqedonas, kosovar dhe shteti malazez kur është fjala për ujëra që lagin edhe territoret e tyre) nuk duhet të nisin asnjë veprimtari pa u marrë vesh me palën shqiptare dhe kur është rasti edhe anasjelltas.

Ndryshe nga ky rregull bazë, pala greke, në raportet me Shqipërinë ka vazhduar që të tregohet refraktare, dëshmojnë disa njoftime që kanë rrjedhur nga punimet e Komisionit të Jashtëm të Kuvendit, në vitet 2013 dhe 2014. Qeveria shqiptare e asaj kohe kishte marrë, me sa duket, sërish kërkesën problematike të palës greke, të devijimit të disa lumenjve në veri të Greqisë për të pastruar dhe pasuruar liqenin e Janinës. Në listën e tyre ishte edhe Vjosa.

Shqyrtimi i çështjes në Kuvendin e Shipërisë përkonte në kohë edhe me një tjetër kërkesë të ardhur nga qeveria maqedonase. Ajo njoftonte se do të devijonte rrjedhën e lumit Radika, që derdhet në Drinin e Zi.

Kërkesat e vunë Ministrinë e Jashtme në një pozitë të vështirë. U detyrua të gjente zgjidhje që të mbronte interesat kombëtare, por edhe të mos cenohej atmosfera e marrëdhënieve me fqinjët. Preferoi që reagimin ta shprehte me një gjuhë të kujdesshme, madje, të mos e bënte publike. Por informacioni doli dhe të dhënat rreth tij u publikuan nga gazeta "*Panorama*" , e cila thoshte se po botonte raportimin sekret të zyrtarëve të lartë të Ministrisë së Jashtme. Ata kishin vënë në dijeni ligjvënësit shqiptarë se janë ngritur grupet ndërqeveritare të punës për të negociuar me shtetet fqinje, Greqinë dhe Maqedoninë, për problematikat që mund të lindin nga devijimi i burimeve të lumenjve të rëndësishëm të vendit, si Vjosa dhe Drini i Zi. Mirëpo, gati një vit më pas,[17] deklarohej se për lumenjtë, jemi në diskutime me Greqinë. Thuhej se "Shqipëria është në proces të rikonstituimit të grupit teknik të përbashkët për ujërat ndërkufitare me Greqinë. Sa i takon marrëveshjes, ajo ekziston, por mbetet të rikonfirmohet ose të bëhen ndryshime dhe rregullime nëse palët bien dakord". Pohimi i mësipërm, jo aq i qartë, vinte nga goja e Drejtorit të Përgjithshëm të Mjedisit në Ministrinë e Mjedisit, në përgjigje të një pohimi të publikuar në *Gazetën Shqiptare*, se "prej 1 viti, *vendi ynë nuk ka një marrëveshje për ujërat ndërkufitare me shtetin grek.*" Ndërkohë, gazeta kishte publikuar edhe "marrëveshjen" e nënshkruar në vitin 2003, me një afat 10-vjeçar, sipas së cilës, parashikohej ngritja e një grupi të përbashkët për lumin Vjosa. Drejtori i mësipërm mundohej të qetësonte opinionin publik se "ndonëse marrëveshjes i kishte përfunduar afati, interesat shqiptare mbrohen nga legjislacioni ndërkombëtar, i cili është ratifikuar nga të dy palët."[18] Thoshte, gjithashtu, se "Shqipëria dhe Greqia i ndërtojnë marrëdhëniet e tyre ndërkufitare dhe bilaterale mbi bazën e së drejtës ndërkombëtare dhe të legjislacionit ndërkombëtar, të ratifikuar nga të dy palët, që në rastin konkret, ka të bëjë me Konventën Ndërkombëtare të Helsinkit për Ujërat Ndërkufitare, Konventën e ESPOO-së, si dhe me Direktivën Kuadër të Ujit të BE-së 2000/60/EC. Këshilli i Ministrave kishte miratuar Vendimin Nr.177, datë 26.03.2014, për krijimin, përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë dhe detyrat e komisionit të posaçëm për administrimin e ujërave ndërkufitare. Marrëveshjet bilaterale, vazhdonte ai, shërbejnë për të diskutuar së bashku çështje dhe probleme që i interesojnë njërës apo tjetrës palë, por ato nuk mund të dalin mbi të drejtën ndërkombëtare dhe garantonte se*në mungesë të tyre Shqipëria nuk rrezikon asgjë."*[19]"*Zgjatja e afatit të marrëveshjes* kërkon kohën e vet dhe është një proces konsultimi i brendshëm dhe bilateral. Shqipëria ka pasur gjatë gjithë kësaj periudhe, dhe vazhdon, komunikim dhe konsultim

[17] Ola Mitre "*Lumenjtë, jemi në diskutime me Greqinë*", në*Gazeta Shqiptare*, 02/04/2014.

[18] Po aty.

[19] Po aty.

me palën greke nëpërmjet rrugëve diplomatike."[20]
Teksa bëheshin këto deklarime, në shpërfillje të akteve bilaterale si dhe të konventave ndërkombëtare multilaterale, të përmendura nga zyrtari i lartë shqiptar, ishin devijuar sasi të konsiderueshme ujërash, pasuri e përbashkët e të dy shteteve.
Një drejtoreshë në MPJ, në një nga mbledhjet me dyer te mbyllura të komisionit të Kuvendit, raportonte se do të kishte diskutime me palën greke dhe "së shpejti do të kemi rezultate konkrete për diskutimet e të gjitha këtyre çështjeve". Ajo foli, gjithashtu, edhe për lumin e Radikës, duke u munduar që të qetësonte dëgjuesit se "sasia e ujit që do të ndërmerret nuk do të ketë ndikim shumë të madh!"[21]

***

Duket, pra, se në shfrytëzimin dhe mbrojtjen e ujërave kufitare të Shqipërisë me fqinjët, ka jo pak probleme, të cilat nuk duhen lënë pa u trajtuar siç duhet, sepse mund të çojnë në shumëfishimin e tyre dhe në komplikimin e situatave.
Shpresohet që pjesëmarrja në diskutime publike e studiuesve, intelektualëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, do të shërbejë për të sensibilizuar institucionet kompetente të shteteve për domosdoshmërinë e trajtimit serioz, në respekt të parimeve dhe normave të së drejtës ndërkombëtare, për shfrytëzimin e duhur dhe ruajtjen e Vjosës dhe derivateve të veta, kësaj pasurie të paçmueshme, si dhe të ujërave të tjera të përbashkëta. Vjosa është "res communis omnium"*e shqiptarëve dhe e grekëve. Disa nga konkluzionet e diskutimeve duhen çuar në destinacionin institucional, për të identifikuar zgjidhje të drejta, dinjitoze, juridikisht të pranueshme dhe të qëndrueshme, që popujt të mos vuajnë pasojat e disa politikave të papërgjegjshme.*
Gabimet që mund të jenë bërë në të kaluarën, duhet të zgjidhen me mirëkuptim, negociata shteruese, kompromise parimore, duke u mbështetur dhe duke respektuar parimet dhe normat e së drejtës ndërkombëtare. Dëshirohet sinqerisht që kjo të jetë mënyra e trajtimit dhe zgjidhjes së drejtë juridike të kësaj çështjeje me rëndësi të veçantë për të ardhmen e shqiptarëve dhe grekëve, me qëllim që koha të punojë për ta, për të shfrytëzuar në mënyrë racionale pasuritë e tyre të përbashkëta, përfshirë edhe Vjosën.

[20] Po aty.
[21] Po aty.

PASURITË ARKEOLOGJIKE E TRASHËGIMIA KULTURORE NË LUGINËN E VJOSËS DHE IMPAKTI I TYRE NË ZHVILLIMIN E TURIZMIT.

[1]Prof. dr. Dhimitër Çondi, [2]Prof. dr. Gëzim Sala
[1,2]Department of History, Anthropology and Geography, Faculty of Education and Social Sciences, "Eqrem Çabej" University of Gjirokastër, Albania,
Email: dhcondi@uogj.edu.al, gsala@uogj.edu.al

Abstract
The Vjosa river valley together with its branches, Drino, Shushicë, Bënçe, and Langaricë, has played a vital role in the movement of people and goods since ancient times. A significant number of prehistoric sites, ancient cities, medieval castles, churches and monasteries, mosques, aqueducts, and medieval bridges are unmistakable indicators of the identity and historical importance of this river valley in the lives of people who have inhabited it since prehistoric times until today.
This great variety of archeological values and tangible cultural heritage, which continues to this day, make the Vjosa watershed a living and uninterrupted link between the historical and cultural identity of the ancient Illyrians and their Albanian successors.
In ancient times, the Vjosa Valley served as the main communication route to pass from the Adriatic Sea to South Illyria in Epirus and vice versa. The Illyrians, the Epirotas, the Macedonians, and the Romans fought in the Vjosa valley and passed through it to realize their conquering goals. Over the centuries, they created a series of ancient roads along this valley, traces of which are still found today.
The presence of a large number of rare and unique natural, historical, and cultural resources in the Vjosa Valley on a national, regional, and even global scale as well as traditional activities and non-material cultural values are relevant and representative examples of the harmony and combination of the economic and social activities with the natural landscapes. In these circumstances, ecotourism and cultural tourism along the Vjosa valley are considered an opportunity for the sustainable development of the area.

Keywords: *Vjosa in ancient times, ancient roads, natural landscape, ecotourism, cultural tourism*

Lugina e lumit Vjosa së bashku me degët e saj Drino, Shushicë, Bënçë, Langaricë ka luajtur rol që në lashtësi një rol jetik në lëvizjen e njerëzve dhe të mallrave. Një numër i konsiderueshëm vendesh prehistorike, qytete antike, kala mesjetare, kisha e manastire, xhami e teqe, ujësjellësa dhe ura mesjetare janë tregues të pagabueshëm të identitetit dhe rëndësisë historike të kësaj lugine lumore në jetën e njerëzve që e kanë banuar atë që nga prehistoria deri në ditët e sotme.

Kjo larmi e madhe vlerash arkeologjike e të trashëgimisë kulturore të prekshme e të pranishme deri në ditët e sotme e bëjnë pellgun ujëmbledhës të Vjosës në të vërtetë një lidhje të gjallë e të pandërprerë të identitetit historik e kulturor të ilirëve antikë dhe të vazhduesve të tyre, shqiptarëve të sotëm.

Në luginën e Vjosës është mjaft i konsiderueshëm numri i monumenteve të rregjistruara si të tilla nga institucionet e shtetit shqiptar, gjithsej 300 si të tilla të shpërndara si më poshtë:

- Në qarkun e Gjirokastrës 223 monumente kulture
- Në qarkun e Vlorës 67 monumente kulture
- Në qarkun e Fierit 10 monumente kulture.

Përgjatë luginës së Vjosës ndodhen 3 qendra historike që janë Gjirokastra, Përmeti, Bënja dhe katër parqe arkeologjike: Apolonia, Amantia, Bylisi e Antigonea. Përveç tyre ekzistojnë edhe

mjaft qyteza antike që shtrihen gjatë të gjithë luginës, si dhe kala, vendbanime të fortifikuara etj.

Lugina e Vjosës në antikitet shërbente si rruga kryesore e komunikimit për të kaluar nga deti Adriatik për në Ilirinë e Jugut në Epir dhe anasjelltas. Ilirët, epirotasit, maqedonët e romakët luftuan në luginën e Vjosës dhe kaluan nëpër të për të realizuar qëllimet e tyre pushtuese. Përgjatë shekujve ata krijuan gjatë kësaj lugine një sërë rrugësh antike, gjurmë të së cilave gjenden edhe sot.

Prania e një numri të madh të burimeve natyrore, historike e kulturore të rralla e unike në luginën e Vjosës në shkallë kombëtare, rajonale dhe madje globale si dhe i veprimtarive tradicionale e vlerave kulturore jo materiale janë shembujt përkatës dhe përfaqësues të harmonisë dhe ndërthurjes së veprimtarive ekonomiko-shoqërore me peizazhet natyrore. Në këto rrethana ekoturizmi dhe turizmi kulturor përgjatë luginës së Vjosës konsiderohen si mundësi e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës.

Në luginën Vjosës është e mundur të zhvillohen disa destinacione turistike si:

- Guidë në qytetet antike dhe mesjetare.
- Guidë në kishat bizantine në Luginën e Aoosit dhe degëve të saj.
- Guidë në kështjellat antike dhe mesjetare.
- Itenerar turistik në rrugët antike dhe mesjetare si dhe vendbetejat e zhvilluara në antikitet.

Më poshtë po trajtojmë disa nga qendrat kryesore arkeologjike përgjatë lumit Vjosa.

Apollonia. Qyteti antik i Apollonisë gjendet pranë fshatit Pojan, mbi një kodër të ulët e cila kontrollonte dikur rrjedhën e poshtme të lumit Aoos para se të derdhej në detin Adriatik. Pseudo Skylaksi (26) e vendosi në distancën 50 milje nga deti dhe fare pranë lumit Vjosa (Aoos). Straboni (VIII, 5, 8C316) jep distancën 10 stade nga lumi Aoos dhe 60 stade nga deti. Porti lumor i qytetit përmendet në disa ngjarje historike dhe që nga gjysma e I e shek.II p.l.kr, shënonte fillimin e rrugës Egnatia (Polyb). Më pas qyteti bëhet një stacion i rëndësishëm në rrugët romake që vinin përgjatë bregdetit nga Dyrrakion dhe Aulona, apo që nisej nga Apollonia për tu bashkuar në Scampa me via Egnatia, apo nëpër luginën e Aoos për në Epirose Maqedoni. Themelimi i kolonisë së Apolonisë është rreth vitit 600 p.l.kr dhe është sipas Skymnit (439-440) dhe Strabonit vepër e Korkyrasve (VII, 5, 8C316) dhe metropolit të tyre Korintit.

*Monumentet.*Përveç trakteve të mureve arkaik monumentet më të hershme në Apolloni i takojnë shek.IV p.l.kr, kur qyteti njohu lulëzimin më të madh duke u shtrirë në një sipërfaqe prej 81 ha e rrethuar nga një mur 4km i gjatë. Monumentet kryesore janë 2 stoa, buleuteroni, odeoni, biblioteka, tempulli i Dianës të zbuluara në Agoran e qytetit , teatri, një rrugë kryesore dhe banesa që u zbuluan në ekstremin VP. 1) Muret rrethues, muri arkaik 40m i gjatë shek.VII p.l.kr. Murri Helenistik 4km i gjatë, 20 kulla dhe 6 hyrje, pas vitit 270. Djali i Piros, Aleksandri dhe Mytili mbreti Ilir. 2) Agoraja. Monumentet e agorasë u takojnë periudhave të ndryshme ndërtimi Buleuterioni, Odeoni, biblioteka, harku i triumfit dhe tempulli i Dianës të ndërtuara me tulla dhe llaç të ngritura në një kohë rreth mesit të shek II pas.kr, kur hapësira e Agoras u organizua si një forum romak, zona shoqërore e qytetit.

*Buleuterioni (Agonotetet) 11 m i lartë.*Godina e trajtuar si tempull me përmasa 14,40 x 19,20 m i restauruar në 1976. Ajo ka qënë selia e bulesë-këshillit të qytetit. Arkitrau mban një mbishkrim greqisht kushtuar dy vëllezërve që kishin qënë agonotekë, nëpunës në organizimin e festave dhe garave sportive.

*Harku i Triumfit.*Para buleterionit ruhen katër këmbët e një harku triumfi me tulla e veshur me mermer me gjatësi 14m, e lartësi 10m. 3 porta me harqe në kryqëzimin e dy rrugëve kardinale të qytetit.

*Biblioteka.*Është ndërtim i thjeshtë katërkëndësh 10 x 11m, i realizuar me të njëjtën teknikë si Buleuterioni, shek II pas.kr.

*Stoa "A".*I përket periudhës perandorake romake i ndërtuar mbi një kompleks më të lashtë monumentesh në shek.IV-III p.l.kr. i trajtuar me nishe gjysëm rrethore ku u bashkoheshin edhe dy stoa që shërbenin si vende takimi të qytetarëve. Hapësira 5m pas kolonatash e cila shërbente për shëtitjen e qytetarëve. Kolonata ka qënë ndërtuar në gjysmën e dytë të shek IV p.l.kr.

*Odeoni.*I vendosur përball buleuterionit shërbente për zhvillimin e shfaqjeve muzikore, letrare por edhe për mbledhje zyrtare, ka formën e një paralelopipedi me gjerësi 14m, gjatësi 20m dhe lartësi 10m. Ka formën e një teatri të vogël, përbëhej nga 16 radhë ulesesh me 300 shikues. Monumenti kombinonte tipin Helen të odeonit me teknikën romake të ndërtimit, daton mesin e shek.II pas.kr.

*Sanktuari i Dionisit.*Me përmasa 5x5m mbështetej në murin Perëndimor të Odeonit, zbukurohej me dy kolona Jonike, shfrytëzonte një nishe të murit shek.IV p.kr. Ka tre bazamente për skulptura dhe relieve. Ajo mund të ishte në funksion të Odeonit e lidhur me kultin e Dionisit, apo të perandorit.

*Tempulli i Dianës.*Në anën Perëndimore të buleutarionit është zbuluar një tempull tipik romak i orientuar nga sheshi qëndror i agorasë. Monumenti është një ndërtim i thjeshtë ndërsa fasada ka qenë trajtuar me element arkitektonik guri. Gërmimet kanë zbuluar pjesë të shtatit të Dianës, prej të cilit mund të nxiret përfundimi se tempulli i ishte kushtuar kësaj perëndeshe të nderuar në

mënyrë të veçantë në Apolloni. Datohet në çerekun e fundit të shek.II pas.kr.

*Prytanioni.*Është i mbështetur në murin e buleuterionit dhe pranë tempullit të Dianës. Hyrja është e zbukuruar nga një kolonat me shtylla e kapitel korintik. Gërmimet zbuluan njëmbëdhjetë skulptura të shek. II-III mb.kr, që paraqesin zyrtarë të lartë prandaj është menduar të jetë Prytanion ku rrinin zyrtarët e lartë.

*Stoa "B".*Është monumenti më i ruajtur i periudhës klasike në agora. I ndërtuar rreth mesit të shek.IV p.l.kr, dhe u përdor deri në shek.II pas.kr. Ka planimetri katërkëndëshe 72,2x10,50m dhe ndahet në dy rrugë nga një kolonadë e brëndshme prej 36 kolonash dorike tetëkëndëshe. Ka qenë dykatëshe me diferencë të stileve të kolonadive dorik për të poshtmen dhe Jonik për të sipërmin sipas modelit Korintas. Muri i prapëm i monumentit i mbështetet faqes së kodrës, ka qenë trajtuar me shtatëmbëdhjetë nishe në formë gjysëm kubeje për ritjen e qëndrueshmërisë dhe krijonte sfonde mjaft të përshtatshëm për vendosjen e skulpturave, disa prej këtyre skulpturave datohen në shek.II pas.kr.

*Teatri.*Shënonte fundin e Agorasë në anën Perëndimore. Është zbuluar orkestra e proskena. Shkallarja me diametër 100m mund të uleshin 10,000 shikues. Orkestra me diameter 35m, proskena e teatrit 6,50m e gjerë, 12,30m e gjatë trajtuar në odrin jonik. Në anën Veriore janë zbuluar një rradhë kollonash dorike që i takonin një portiku 5m të gjerë që qarkonte nga jashtë skenën që është dhe në Bylis. I ndërtuar në gjysmën e parë të shek.III p.l.kr, dhe u përdorë edhe në kohën perandorake. Në periudhën e vonë antike u braktis dhe në shek.XIII blloqet e shkallëve u përdorën për ndërtimin e kishës së Shën Mërisë.

*Temenosi.*Maja më e lartë e kodrës të Apollonisë ka përbërë qendrën e temenosit ku në shek.IV p.l.kr është vendosur foltorja kryesore. Ultësira në Veri të kodrës u kufizua me rrethim të plotë, nga ana veriore ishte e rezervuar vetëm për tempuj dhe foltore.

*Propilitë.*Hyrja për në temenos nga ana Perëndimore është trajtuar në formën e propileve, është një koridor midis dy taracave mbi të cilat ngriheshin tempujt. Ajo kishte gjerësi në fillim 9m që ngushtohej në 7m në fund të koridorit prej 36m të gjatë. Tarraca veriore ka qenë krijuar në mesin e shek.III p.l.kr, ajo jugore ka qenë shtuar në shek.I pas.kr.

*Tempulli i Apollonit.*Në kodrën me kuotën 104 në maj, janë gjetur pjesë arkitektonike që provojnë se tempulli është ndërtuar në odrin dorik, është pjesë e një frizi prej guri të Akrokerauneve në paraqitje që datohet rreth vitit 525 p.l.kr. Përdorimi i frizit siç është frizi në skenë të një tempulli dorik që ndeshet të njëjtën kohë në Magna Grecia dhe Azinë e vogël (ASSOS). Ana Jugore e kodrës ka qenë rrethuar me një mur dekorativ që kufizonte sipërfaqen e sheshtë të temenosit. Ruhet mjaft mirë dhe porta monumentale me hark të rremë, të mprehtë tipik për arkitekturën e Apollonisë. Përpara portës në të djathtë ngrihet mbi një bazament cilindrik obelisku simbol i Apollonisë, Agieus. Obeliskun e ndeshin në monedhat prej bronzi të qytetit pas mesit të shek.III p.l.kr. Ai ndeshet gjithashtu në Ambraki dhe koloni të tjera Korintase.

*Akropoli.*Kodra me kuotë 101 e Apollonisë e fortifikuar në shek.V p.l.kr, me mur prej blloqesh katërkëndëshe. Rafshi i sipërm i kodrës ka shërbyer edhe për vendosjen e foltoreve siç dëshmojnë gjetja e kushtimeve për Zeusin e Artemisën. Hyrja e vetme për në Akropol gjendet në anën jugore dhe ka formën e propileve me një koridor të gjerë dhe pamje monumentale. Akropoli nuk e kishte humbur funksionin mbrojtës edhe në periudhën e Cezarit.

*Nymfeu.*I cilësuar si monumenti më i madh e më i ruajtur i Apollonisë shtrihet në një sipërfaqe pothuajse 1500m^2 në shpatin Veri-Perëndimor të kodrës. Në pjesën më të lartë të tij një rrjetë kanalesh mblidhnin ujërat e burimeve dhe i përcillnin në një depo qëndrore e trajtuar si godinë monumentale me një basen katërkëndësh të ndarë në dy pjesë, ku e para shërbente për kullimin e ujërave dhe e dyta për mbushje. Një kolonadë dorike me lartësi 2.40m zbukuronte fasadën e ndërtesës duke mbajtur njëkohësisht edhe presionin e ujit mbi artostatet prapa saj. Ndërtimi i nymfeut mund të vendoset rreth mesit të shek.III p.l.kr.

*Gjimnazi.*Gërmimet nxorën tjegulla me vulën gjimnasiou. Është në Jug-Perëndim të manastirit

në krah të rrugës që lidhte portën Jugore me qendrën e qytetit. Ka planimetri katërkëndëshe 20x30m, me oborr të hapur nga jugu për ushtrime gjimnastikore. Dy ambiente të mëdha në Veri të tij shërbenin për zhvillimin e mësimeve. Fillimi i godinës është shek.VI p.l.kr, e përdorur deri në shek.III pas.kr.

*Tempulli i Shtyllasit.*Një shtyllë e vetme dorike me lartësi 6.83m dhe diametër 1.42m ka mbetur nga një tempull mbi kodrën e parë në Jug të Apollonisë. Gërmimet kanë bërë të mundur formën e tempullit si një peripter heksastil, 6 kolona në ballë dhe 11 anësore rrethonin naosin me përmasa 10x22m. Hyrja nga VL paraprihet nga një pronaus midis dy anëve dhe 4 kolonave. Tempulli është i ndërtuar në 480 p.l.kr, me gurë nga mallet Akrokeroune. Nuk dihet perëndia e kushtimit.

*Rrugët dhe banesat.*Rruga nga jugu drejt qendrës së qytetit në lindje të buleoterionit ka gjerësi 7.40m. Para odeonit takohet në kënd të drejtë me një rrugë tjetër që zbret drejt perëndimit, formohen dy akse kryesore mbi të cilin shtrihej sistemi orthogonal i parcelave të banimit (insulat), secili kishte gjerësi 60m dhe gjatësi rreth 120m, vazhdimi i rrugës ka gjurmë 100m përpara teatrit ku ka gjerësi 6.20m.

*Nekropoli.*Në anën lindore të Apollonisë u krijua gjatë shek.VII-VI nekropol tumular deri në shek.I p.l.kr. Në kodrën e Kryegjatë në shek.I-III pas.kr në fushë numërohen 300 tuma. Gërmimet kanë evidentuar 136 varre në periudhën fillim shek VI deri në shek III p.l.kr.

*Kultura.*Fizionominë e kulturës, apoloniate në periudhën e lulëzimit të qytetit në shek.IV-II p.l.kr, e japin arkitektura dhe skulptura. Urbanistika e Apollonisë kishte adoputuar kriteret e Magna Grecia me insulet të stërgjatura 120x60m të cilët i ndeshim edhe në Bylis dhe në Antigone, varret monumentale me qemer. Proskena e teatrit dhe afrimi i saj ndaj spektatorëve e lidhin Apolloninë me Magna Grecia dhe Epirin. Përdorimi i harqeve dhe qemereve krijojnë lidhje me Epirin e Maqedoninë. Porteku me Nishe, kolonat tetëkëndëshe tipi i Nyfeut krijon një fizionomi të veçantë të arkitekturës Apolloniane në kuadrin e asaj Helene. Shekulli IV-III p.l.kr, arti i skulpturës njohu zhvillim më të madh në ndërtimin monumental në qytet. Apollonia krijoi modelin e vetë të stelave që dallohen nga forma e zgjatur dhe skenat e pasura me zbritjen në botën e përtej varrit.

BYLISI. Bylisi ka qenë vendosur mbi rafshet e kodrës së quajtur Gradisht pranë fshatit Hekal të Mallakastrës rreth 40km në lindje të Apollonisë. Bylisi u zhvillua mbi rrugën natyrore nga Apolonia drejt Epirit dhe Maqedonisë dhe zotëronte mbi luginën e mesme të Vjosës (Aoos) përball Amantias. Gjatë shek.IV-I p.kr Bylisi ishte qendër e Koinonit të Bylinëve ku bënin pjesë edhe qytetet antike të Klosit, Gurëzezës dhe Margëlliçit. Bashkësia e Bylinëve ka qenë vendosur në veri të luginës së mesme të Aoos.

Pseudo-Skylaksi përmend Boulinoi-t që mund të jenë Bylinët që janë pranë territorit të Orikut dhe atij të Amantëve. Mbishkrimi i Dodonës i datuar në vitet p.kr 360-340 mund ti përkasë periudhës së themelimit të qytetit të Bylisit.

Bashkësia e Bylinëve ka shumë qytete të vogla, krahas me qendrën që i përket një qyteti me përmasa të mëdha 30ha. Duhen përfshirë në këtë koinon edhe kalat e Rabijes dhe të Kalivaçit. Organizimi i koinonit të bylinëve si shtet është i njohur nëpërmjet një numri mbishkrimesh të gjetura në vend ose në qëndra të ndryshme të Greqisë. Mbishkrimi i dytë i Dodonës dëshmon për praninë e këtij shteti të bylinëve në periudhën 230-219, si dhe për mbështetjen që i ka dhënë koinoni i epirotëve koinonit të bylinëve.

Prania në qytetin e Bylisit e një stadiumi dhe e një teatri e dëshmon këtë ndërlidhje të kulturës mbizotëruese të ardhur nga Epiri ose nga Apolonia ashtu sikur ndodh edhe te amantët, fqinjë me bylinët në bregun e majtë të lumit Aoos. Më në fund Bylisi bëhet koloni romake në fillim të principatit të Augustit sipas dëshmisë së Plinit të vjetër.

*Monumentet. Muret rrethues.*Muret rrethues të Bylisit kanë një gjatësi prej 2250m dhe një sipërfaqe 30ha në të cilën shtrihet qyteti antik i cili ka vetëm 5 kulla dhe 6 porta. Fortifikimi i Bylisit është ndërtuar në çerekun e dytë të shek.IV p.kr. dhe është i ngjashëm tipologjikisht me fortifikimet e së njëjtës periudhë në Amantia, Olympe etj. Muret rrethuese të Bylisit u ruajtën edhe kur qyteti u shndrua në koloni romake dhe u rindërtua në periudhën bizantine.

*Porta Nr. 3.*Ka qenë hyrja më e ngushtë e qytetit me korridor me gjerësi 1.40m dhe i ka shërbyer kryesisht një nekropoli në shek.IV-III p.kr.

*Porta Nr.4.*Në mesin e murit të anës lindore, është më e madhja dhe më e ruajtura ndër të gjitha hyrjet e qytetit. Nëpërmjet saj kalonte rruga që lidhte Bylisin me qytetin fqinjë të Klosit. Korridori i hyrjes me gjatësi 8.45m dhe gjerësi 4.20m mbështetej mbi tri harqe.

*Porta Nr.5.*Është pranë teatrit dhe ka shërbyer si hyrje për në agora për popullsinë e rrethinave. Ajo ka një korridor tërthor me gjatësi 7m dhe gjerësi 3m.

Porta Nr.6. Gjëndet në anën VP. të qytetit dhe shënonte fillimin e rrugës që të çonte nga Bylisi për në Apoloni duke kaluar nëpër kurrizet e kodrave dhe qytetit antik të Gurëzezës. Korridori i hyrjes me përmasa 7.60x2.40m dhe formohet midis dy krahëve paralele të murit rrethues e mbulohej nga një kullë.

*Rrugët dhe banesat.*Ndërtimi i Bylisit si inisiativë e koinonit të Bylinëve për një fortifikim të sigurt dhe jetë normale të banorëve të tij. Qyteti i planifikuar me tri zona kryesore brenda mureve rrethuese. a) agoraja në pjesën më të lartë e piktoreske. b) euharioni në pjesën JL. të qytetit si zonë e rezervuar për strehimin e banorëve të fshatrave dhe të pasurisë së tyre në rast lufte. Rreth mesit të shek III p.kr. mori formën e plotë sistemi ortogonal urbanistik i Bylisit duke krijuar insula të ndara fillimisht në tetë parcela banimi. Midis dy reshtave të banesës kalonte një rrugicë e vogël për kalimin e ujërave të shirave.

Banesa A. Ka sipërfaqe prej 30x24m që i përshtatet sistemit orthogonal. Banesa është e kompozuar me oborr qëndror katror me brinjë 9x9m i rrethuar nga një peristil i odrit Jonik e një portik me gjerësi 2.80m rreth të cilit zhvillohen kthinat. Ndërtuar rreth mesit të shek.III p.kr dhe vazhdoi të funksionojë deri në shek.III pas.kr. Dyshemet e tyre të shtruara me mozaik shumëngjyrësh me motive gjeometrike.

Banesa B. Është banesë me peristil me përmasa 29.5x24.8m. Qëndrën e banesës e formonte oborri katërkëndësh me brinjë 9.6m i cili rrethohej nga një kolonadë e ordit dorik. Korridori i peristilit me gjerësi 3.6m lidhte kthinat e vendosura në anën lindore e veriore. Ana jugore ku gjendej edhe hyrja si dhe ajo perëndimore përbënin një hajat të gjatë që përdorej për veprimtarinë ekonomike. Banesa e ndërtuar në shek.III p.kr nga një familje e pasur dhe ka qënë përdorur pa ndërprerje deri në shek.IV pas.kr.

*Agoraja.*Agoraja kishte një sipërfaqe tri insula 4ha në formën e një katërkëndëshi të rregullt. Agoraja ndahej nga qyteti nëpërmjet një muri dekorativ nga veriu, ku dy hyrje monumentale lejonin futjen e qytetarëve, ndërsa hyrja për banorët e fshatrave bëhej nga porta nr.5 e qytetit. Ndërtimi i agorasë u realizua rreth mesit të shek.III p.kr që përfshinte harmonizimin e vendosjes së teatrit, stoave, stadiumit, gjimnazit e ndërtimeve të tjera publike. Ishte vendi ku bëheshin mbledhjet politike dhe ku realizoheshin festat, shfaqjet teatrale, lojrat sportive dhe ceremonitë fetare. Agoraja e ruajti rolin si qendër publike e qytetit edhe në periudhën e kolonisë ku u transformua në Forum. Gjatë kësaj periudhe u rindërtua teatri dhe u ndërtuan disa monumente që dëshmojnë mbishkrimet latine.

*Prytanioni.*Është ndërtesë me përmasa 20.10x5.80m, ngritur mbi murin e agorasë me dy kthina dhe një hajat me kolonadë druri midis tyre e cila mendohet të ketë qënë prytaneioni, zyra e finksionarit të lartë ekzekutiv të koinonit.

Stadiumi. Stadiumi i Bylisit paraqet një zgjidhje të veçantë sepse ka vetëm një krahë mbështetur në pjerrësinë e terrenit, ka gjatësi 134m (duhet 190m) por e plotësonte zgjatja e pistës përpara teatrit. Ruhen 19 shkallë me lartësi 0.30m dhe gjerësi 0.40m, spektatorët nuk uleshin por qëndronin në këmbë. Veçoria tipike e stadiumit të Bylisit është ndërtimi i një stere gjigande uji nën pistën e krahut verior. Ujërat mblidheshin nga uji i shiut të shkallëve dhe nga çatia e stoas së madhe.

Stera. Stera ka formë katërkëndëshi 50.90x4.20m dhe thellësi 6m. Stera mbulohej me një sistem harqesh prej blloqesh gëlqerore ku shtroheshin pllaka guri në nivelin e pistës së stadiumit, stera ishte e suvatuar. Ndërtimi i stadiumit dhe i sterës i takon periudhës së agoras rreth mesit të shek.III p.kr.

Gjimnazi dhe termat. Në sheshin para teatrit janë zbuluar rrënojat e një godine shoqërore e cila është identifikuar me gjimnazin e qytetit, planimetri katërkëndëshe dhe një radhë dhomash rreth një oborri të brendshëm. Ndërtuar në gjysmën e dytë të shek.III p.kr. u shkatërua gjatë kolonisë romake për të ndërtuar termat që ka dalë tpidorium, calorium, figdorium e katër thema të tjera.

Teatri. Bashkë me stoan e madhe dhe stadiumin teatri ka përcaktuar kompozimin arkitektonik të agorasë rreth shek.III p.kr. Teatri u ndërtua në këndin Jug-Lindor të agorasë. Teatri është ngjitur me portën nr.5, e ka mundësinë e komunikimit drejtpërdrejt me horën e koinonit. Teatri i konceptuar si ndërtim madhështor, në godinën e skenës në sfondin e shkallares kolonada dorike e portikut të godinës së skenës krijonte një monument të panjohur për teatrot e kohës. Hyrja ballore shërbente për aktorët për të kaluar në kthinat e prapaskenës. Spektatorët kalonin në paradoset e zbukuruara me harqe sipas modelit të Dodonës. Orchestra gjysëmrrethore pritej nga një proskenë e ulët prej rreth 3m e zbukuruar me një kolonad dorike. Shkallarja e teatrit ka formën e një gjysëm rrethi me diametër 78m dhe lartësi 16m. Numri i shikuesve llogaritet 7500 shikues. Teatri i Bylisit i takon tipit Iliro-Epirot me paradoset ballore. Analemat e drejta dhe përdorimi i proskenës për lojën teatrale, ka ngjashmëri me teatrin e Dodonës dhe të Sirakuzës në Itali.

Stoa e teatrit. Krahas portikut dhe teatrit është edhe një stoa e ndërtuar në krah të tij për tu mbrojtur nga shiu dhe për të qëndruar. Stoa është dykatëshe me përmasa 60x11.40m dhe hapej nga sheshet të agorasë me kolonë dorike kati i poshtëm dhe kolonatë jonike në katin e sipërm. Hapësira e brendshme ndahej në dy pjesë nga një radhë kolonash.

*Stoa e madhe.*E ndërtuar njëkohësisht me murin ndarës të agorasë kufizonte këndin VL për tu mbrojtur nga erërat. Stoa e ndërtuar në formë L me gjatësi 144m është e tipit Apoloniat-Korintat zhvillohet në dy kate, mbivendosja jonike mbi doriken në fasadë përdorën kolona dorike tetëkëndëshe, adoptim nga arkitektura apoloniate. Pjesa L e stoas me përmasa 37x11.40m është gdhëndur në shkëmb. Në shek.II pas.kr stoa u shkatërua.

Nekropoli. Ka një nekropol por me parcela, më e hershme në mesin e shek.IV p.kr. Në shek III p.kr u ndërtua nekropoli monumental.

*Bazilika A.*Është e ndërtuar brenda agorasë helenistike. Ka element si Porteku, narteksi, naos

është 3 nefëshe, absida gjysëm rrethore, transept trepjesësh. Hyrja nga P kalon në portik e narteks. Dimensionet gjatësia 38.22m dhe gjerësia 23.42m. Skulptura dekorative arkitektonike ruhet e fragmentuar. Datimi gjysma e parë e shek V, djegur nga sllavët në mesin e shek.VI.

Katedralja. Është epërbërë nga bazilika, baptisteri, e kompleksi peskopal me sipërfaqe 1ha. Konsiderohet si monumenti më i madh i Bylisit ndërtuar në Antikitetin e vonë. Atriumi, narteksi, nefet, transept. Atriumi ka formë katërkëndëshe 11.15x6.80m rrethuar nga 4 portik.Naosika gjerësi 14.40m dhe gjatësi 24.70m e ka tre nefe. Daton nga a) fund shek.IV-fillim shek.V pas.kr b) 470-547 mb.kr c) gjatë sundimit të Justinianit.

*Bazilika D.*Është Bazilik trenefëshe me gjatësi 45.25m e gjerësi 26.15m. Daton fillim shek.VI m.kr-u shkatërua në mesin e shek.VI pas.kr.

Amantia. Pozicioni i jep qytetit përparësinë për të kontrolluar rrugën natyrore që vinte nga gjiri i Vlorës, për të vazhduar në drejtim të Epirit nëpër qafën e Sevasterit. Po në këtë qafë kalonte edhe rruga që vinte nga Bylisi për të vazhduar nëpër luginën e sipërme të Shushicës për në Kaoni. Qyteti zinte një sipërfaqe 1.3 ha.

Amantia lidhet me Bylisin në anën vizuale, përballë mbi bregun e majtë të Vjosës (Aoosit) por dhe roli politik e kulturor në botën antike. Ishte qendër e një koinoni që shtrihej në luginën e mesme e të sipërme të Shushicës, ku bënin pjesë qyteti i Olympes, kështjella e Cerjes e të Matohasanajt.

Pseudo Skylaski 26, dhe Stefan Bizantin, Abantis dhe Amantia, amantët kanë qenë vendosur përreth Amanties. Është i përshtatshëm për bujqësinë, ndodhet në luginat e lumenjëve Aoos dhe Shushicë me një dalje detare në jug të Vlorës, dhe dominuar nga kalaja e Kaninës. Nuk mund të thuhet me siguri nëse kemi një organizim në formën e Koinonit sikurse është rasti i Bylinëve apo të një polisi, një qytet-shtet sipas Apollonisë dhe Dyrahut. Monedhat janë prerë në emër të Amantëve. Ata bëjnë të njohur magjistratin aponim që është Prytani si te Bylinët fqinjë në Apoloni. Ekziston një këshill i njohur nga përmendja e Bouleuteve dhe e sekretarit të këshillit që bëjnë një kushtim për Zeus Bouleus. Në të njëjtën kohë me Bylinët, Amantët kanë qënë përfshirë në mbretërinë e Pirros (279-272) që mund të shtrihej deri në lumin Shkumbin. Ata fitojnë përsëri pavarësinë dhe presin monedha duke filluar nga vitet 230 p.kr. Fqinjësia me Kaoninë sqaron pse monedha e koinonit të Epirotëve janë të pranishme në qytetin e Amantias. Në shekullin e III p.kr tregon për adoptimin e kulturës mbizotëruese të ardhur nga jugu nëpërmjet Epirit dhe nga kolonitë bregdetare. Stadiumi në Amantia është jashtë mureve. Sikurse Bylinët dhe Amantët u përfshinë në provincën romake të Maqedonisë duke filluar në vitin 148 p.kr. Qyteti është administruar atëherë nga dekurionët duke përdorur gjuhën greko-latine në të njëjtin mbishkrim.

Muri rrethues. Ka 5 hyrje të rralla në kënd të drejtë ose të gjerë. Hyrjet lidhen me pjesën qëndrore të rrafshit ku ishte agoraja. Gjatësia e murrit prej 220m, kemi dy periudha ndërtimi **1)** blloqe trapezoidale e poligonale. Ajo ngjan me murin e hershëm të Klosit që datohet në mesin e shekullit V p.kr. **2)** periudha e dytë me mure katërkëndëshe izodemik si muri i periudhës së parë të Bylisit, datohet gjysmën e I shekulli IV p.kr. Amantia ka qënë rifortifikimi gjatë Justinianit

(527-565).

Stadiumi. Është ndërtuar rreth 150m jashtë mureve rrethues në L të qytetit. Ka formë patkoi të zgjatur të pistës prej 12.50m të gjerë, të ruajtur përreth 55m, kishte 17 shkallë krahu tjetër kishte 8 shkallë. Shkallët ishin me gjerësi 0.60m dhe lartësi 0.30. ka emra funksionarësh si Sokrates, Apollonos. Stadiumi është ndërtuar në mesin shek. III p.kr.

*Tempulli.*Në jug të qytetit rreth 200m jashtë murit, ka qenë peripteri i rendit dorik me përmasa 12.5m dhe 6.75m. Nga frontoni dallohet një skulpturë mermeri, skulptura e një gruaje të shtrirë, ndoshta simboli i lumit. Tempulli i ndërtuar në shekullin e III p.kr, është përdorur dhe në shekullin e parë pas. Kr. Në Antikitet të vonë pran regjoneve të tempullit u ndërtua bazilika paleokristjane.

Nekropoli. Varreza e qytetit janë në anën P në anë të rrugës që vinte nga gjiri i Vlorës, vend monumental në anë të rrugës që vinte nga territori bylin. Datimi në çerekun e I të shekullit IV p.kr.

ANTIGONEA. Antigonea qëndër administrative, ekonomike, ushtarake e politike e luginës së Drinos.

*Antigonea*me pozitën e saj dominuese, strategjike e të përshtatshme gjeografike, në mes të Luginës së Drinos u zhvillua si qendra më e rëndësishme (ekonomike, shoqërore, kulturore dhe politike) në këtë luginë.

Antigonea si kryeqendra e Luginës qeverisej nga Prostati që zgjidhej çdo vit. Në një nivel të dytë ishte organizimi si ai i Melanit, me institucionet përfaqësuese të tij dhe nëndarjet më të vogla janë tribute e Kardhiqit, Selosë, Labovës e Ktismata, të cilësuara si fortifikime të banuara. Secila nga këto fortesa kishte organizimin administrativ të tij në mënyrë autonome dhe përfaqësohej në nivelet më të larta me përfaqësuesit e tyre.

Qendrat e vogla që i cilësojmëurbane, me një profil ekonomik, politik më të ulët varen nga qendra më e madhe dhe kanë si funksion primar mbrojtjen ushtarake për vet pozicionin e favorshëm strategjikë të sitëve. Këto site shoqërohen dhe me forma banuese, me funksion civile dhe ushtarake.

Në përbërje të organizimit administrativ e mbrojtës të luginës janë së fundi edhe fortesat që ngrihen në pozicione shumë strategjike për kontrollimin e kufijve dhe mbrojten si dhe rrugë kalimet në territorin ku ato ngriheshin. Janë kulla ose pika kontrolli si Lekli e Limari. Këto site nuk janë të shoqëruara me banesa për vetë pozicionin e tyre strategjik e vende të vështira në lartësi, por me pamje shumë të mirë.

Fortesat dhe kullat e vrojtimit nuk kishin karakter thjesht territorial të tribuve ku ndodheshin por edhe karakter etnik në funksion të Kaonisë. Këto pika me interes politik e ushtarak realizonin kontrollin e mbrojtjen e kufijve territorial. Vendndodhja e këtyre pikave ndihmon për

rindërtimin e hartës gjeografike, politike, etnike e antike të luginës. Vendbanimet e fortifikuara janë si rezultat i një zhvillimi të ngadaltë e autonom të vendbanimit të hapur që më pas fortifikohen dhe integrohen në organizimin administrativ të luginës.

Antigonea në organizimin e territorit të luginës së Drinos zhvillohet si një qytet i tipit polis. Këtë e mbështet dhe mbishkrimi i zbuluar në qytet që bë fjalë për praninë e Gjimnasiarkut në Antigone. Ajo karakterizohet nga qendra përkatëse qytetare, territory fshatar si dhe nga kalatë të cilat mbyllin kalimet në territorin e qytetit.

Koinoni i Antigonesë, si njësi administrative, krahas luginës së Drinos, ka në përbërje luginën e Kardhiqit dhe orientimin ekonomik të malësisë së Zagorisë, Pogonit e Kurveleshit. Sitet periferike janë të lidhura ngushtë dhe të varura nga qendrat e mëdha dhe kanë të njëjtën kronologji me atë të tërë sistemit. Ato janë në funksion mbrojtës e kontrollues të territorit, në të cilën bëjnë pjesë dhe vetë qyteti i Antigonesë, si dhe kanë të njëjtën datë ndërtimi. Ato lidhen me formimin e plotë të qyteteve që gërmimet arkeologjike rezultojnë datimin nga fundi i shek.IV në gjysmën e parë të shek.III p.Kr. Gërmimet e mëtejshme arkeologjike në këto site do të japin një datim më të saktë të këtij procesi, i cili mundi të jetë plotësuar në periudhën e Koinonit Epirot 232-170 p.Kr.

Rezultatet e gërmimeve tregojnë se Antigoneja u formua si një qendër e madhe dhe e rëndësishme administrative, ekonomike, shoqërore dhe politiko-kulturore e luginës së Drinos në fillim të shek.III p.Kr, kohë e cila përputhet me periudhën e fuqizimit më të madh politik të shtetit të Epirit.

Materiali epigrafik që do të pasohet nga ai i fushave të tjera siç janë arkitektura, skulptura, qeramika etj, do të ndihmojë për hedhjen e vijave të përgjithshme të historisë dhe kulturës së luginës Aoos e cila përbënë një nga arritjet më me interes të qytetërimit antik ilir.

Bibliografia

Anamali.S, *Amantia.* Iliria, 2 1972, f.61-133

Blovatski.V, Islami.S, *Gërmime në Apoloni dhe Orikum 1958,* BUSHT,1, 1960

Ceka.N, *Apolonia e Ilirisë,* Tiranë 1982

Ceka.N, *Apolonia Its history and monuments,* Tiranë 2005

Ceka.N, *Le Koinon des Bylliones ne L'Ilyrie meridionale et l'Epire das l'Antiquit.* Clermont – Ferand, 1987, f. 135-149

Ceka.N, *Mbishkrime byline.* Iliria XVIII (1987) 2, f. 49-121

Ceka.N, *Fortifikimet antike të bashkësisë byline.* Iliria XX (1990) 1, f. 99-146

Ceka.N, *Urbanistika dhe banesat në Bylis.* Iliria XXII (1992) 1-2, f. 73-96

Ceka.N, *Qendrat e fortifikuara të Amantëve.* Monumente

Ceka.H, *Apolonia,* Tiran 1958

Ceka.H, *Fontana e Apolonisë në Konferencën e Dytë e studimeve Albanologjike,* Tiranë 1969, 219-243

Ceka.H, *Mendime rreth mbishkrimit të Rabijes.* Iliria XII (1982) 2, 71-89

Dh.Budina, *Antigonea.* Iliria 2, 1972, f.245-319

Dh.Çondi, *Antigonea Recente Archeologjical. Discoveries in Albania.* Tiranë 2013, f.96-100

Dh.Çondi, *Antigonea.* Iliria XXXVI, 2012 f.415-419

Dh.Çondi, *Gërmime arkeologjike, Antigone.* 2014 Iliria XXXVIII f.239-250

K.Zahos, Dh.Çondi, *The Antigonea project: Preliminare raport on the first season New Directions in Albania Archeology.* 2006, f. 379-390

Mano.A, *Apolonia e Ilirisë,* Tiranë 2006

Mano.A, Dautaj, *Teatri i Apolonisë,* Iliria VII-VIII, 1977-1978

Mano.A, *Nekropoli i Apolonisë tuma I,* Iliria I, 1971
Pano.N, *Gjeografia Fizike e Shqipërisë.* Vëllimi I.1990, 242-243
Prendi.F, Ceka.H, *Skulptura të Apolonisë.* Studime Historike 2, 1964, 25-85
Ugolini, L. M, *Albania Antica,* 1. Roma 1927, f. 115-116

ZBATIMI I STANDARDIT TË GJUHËS SHQIPE NË TABELAT ORIENTUESE DHE INFORMUESE

Prof.asoc.dr.Spiridhulla Poçi
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
Email: spoci@uogj.edu.al

Abstract

This study will discuss the challenges of putting the norm into practice while writing informational and orientation boards in the Gjirokastra area. The Albanians as well as foreign tourists, whose numbers have grown dramatically in recent years, are oriented and informed by these signs. In this case, it's crucial to write them using the Albanian language standard, which follows the spelling rules in all language systems.

The material supporting the work is concrete and from its examination, some of the violations of the linguistic norm are: the absence of writing the vowel -ë- in different positions of the word and its replacement with the vowel -e-; writing feminine words with unstressed -e- in the nominative case of the prominent form; writing words in a foreign language; writing words with a hyphen in the middle; writing words in the genitive case; replacing sh with ç and ç with c in different words; writing the number "tre" instead of the number "tri"; writing quotes in different denominations; the use of proper names in nameplates, etc.

Keywords: *words, standard Albanian, language norms, orientation tables, spelling errors.*

Në këtë punim do të trajtohen probleme të zbatimit të standarditë gjuhës shqipe në shkrimin e tabelave orientuese dhe informuese në zonën turistike të qarkut të Gjirokastrës. Këto tabela shërbejnë për të orientuar dhe informuar jo vetëm popullsinë shqipfolëse, por dhe vizitorët e huaj, numri i të cilëve kohët e fundit është shtuar dukshëm. Si shtysë për këtë punim ka shërbyer fakti që shumë herë ndodh që të përballemi me gabime të shumta drejtshkrimore në tabelat e vendosura në rrugë, në institucione të ndryshme, në njësi tregtare etj., gabime që i korrigjojmë në heshtje ose që, kur e shprehim me zë, vërejmë një qëndrim mospërfillës, të padrejtë.Ashtu si kujdesemi çdo ditë që çdo gjë të jetë në vendin e duhur, e bukur dhe e pastër,ashtu duhet të kujdesemi dhe për shkrimet në gjuhën shqipe. Është e rëndësishme shkrimi i tabelave sipas standardit të gjuhës shqipe, duke zbatuar normën drejtshkrimore në çdo sistem dhe nënsistem gjuhësor.

Krijimi i një gjuhe kombëtare të përbashkët ka qenë qëllimi i përpjekjeve të atdhetarëve shqiptarë që në Periudhën e Rilindjes. Këto përpjekje morën një hov të ri pas Luftës Nacionalçlirimtare, përpjekje që u kurorëzuan me mbajtjen e Kongresit të Drejtshkrimit më 1972, në të cilin gjuha shqipe u kodifikua si një gjuhë standarde. Si një gjuhë indoevropiane e veçantë, nga më të vjetrat e Ballkanit, por e dokumentuar me shkrim vonë, është zhvilluar si gjuhë letrare në një periudhë të shkurtër, por kjo nuk e ka penguar të formësohet si një gjuhë standarde mjaft e pasur, e përpunuar, e njësuar dhe e kristalizuar. Ajo i ka zgjeruar dhe po i zgjeron gjithnjë e më shumë të gjitha funksionet e saj, si në formën e shkruar, ashtu dhe në atë të folur. Përbashkësia dhe përgjithshmëria[1]si tipare të saj tregojnë se ajo është një gjuhë letrare e përbashkët dhe e përgjithshme, e domosdoshme për të gjithë kombasit dhe shtetasit.

Si një nga arritjet më të mëdha të popullit shqiptar, ajo sot përdoret në të gjithë praktikën shkrimore, përdoret si gjuhë zyrtare në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë, si gjuhë e dytë zyrtare në Maqedoninë e Veriu. Gjithashtu, shkruhet dhe flitet në të gjithë diasporën shqiptare kudo në botë.

[1]Shih Miço Samara,*Histori e gjuhës letrare shqipe*.Tiranë, 2000, fq. 17-28.

Në Kushtetutën e Shqipërisë, neni 14, pika 1., thuhet: "Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja" dhe në nenin 59, pika 1., theksohet "Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon.....synon:", pika g., " ...mbrojtjen e trashëgimisë dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe"[2]. Pra, ajo është gjuhë shtetërore e zyrtare, e ligjëruar dhe e mbrojtur nga shteti, pasi është një faktor dhe element i domosdoshëm për komunikimin ndërshtetëror dhe organizimin shoqëror. Ajo është gjuha e shtetit në të gjitha veprimtaritë,si:veprimtaritë ekonomike, politike, arsimore, kulturore, shkencore dhe e shumë fushave të tjera.

Kristalizimi dhe njësimi i normës karakterizon gjuhën letrare kombëtare ose gjuhën standarde, një tipar ky që dallon gjuhën letrare të njësuar nga gjuha e përgjithshme, e cila mund të quhet dhe kombëtare edhe e përbashkët, por nuk mund të quhet kurrsesi standarde, pa kristalizuar normën e saj në të gjitha strukturat. Pra, gjuha **standarde,** krahas shumë tipareve, sidomos gjuhësore, të përbashkëta me format e tjera të gjuhës, **karakterizohet nga disa tipare,** të cilat e bëjnë të funksionojë si një sistem më vete dhe si një formë e veçantë e gjuhës.

Në përvetësimin dhe zbatimin e standardit një rëndësi të veçantë merr drejtshkrimi, i cili, si thekson Gjovalin Shkurtaj, është një kod i caktuar, që i përket kulturës së të shkruarit, por që, veçanërisht për natyrën e gjuhës sonë, ndihmon e udhëheq edhe punën në lëmin e kulturës të të folurit[3]. Shkrimi i gjuhës shqipe sipas normave të drejtshkrimit është i detyrueshëm për të gjithë dhe në të gjithë veprimtarinë shkrimore. Asnjë nuk ka të drejtë të mos zbatojë standardin e gjuhës shqipe.

Më poshtë do të shohim se si zbatohet norma drejtshkrimore në disa tabela orientuese dhe informuese. Materiali është mbledhur në terren, në Përmet, Tepelenë dhe Gjirokastër, duke fotografuar disa nga tabelat që nuk janë shkruar sipas standardit të gjuhës shqipe.

1. Shkrimi i zanores –E- në vend të zanores -Ë-

.

Duhet: TIRANË,TEPELENË, KORÇË, ERSEKË, PËRMET

Duhet: Tri dhe jo tre, sepse urat është emër i gjinisë femërore.

[2]Kushtetuta dhe materiale shpjeguese. Dhjetor 1998, fq.12, 22.

[3]Shih Gj. Shkurtaj, Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe. Tiranë, 2003, fq. 27.

Duhet: UJI I FTOHTË TEPELENË

Duhet: QENDRA SHËNDETËSORE, KËLCYRË

Duhet: Këpucë

Duhet: BËNJË, NOVOSELË

Duhet: TIRANË, TEPELENË, LABOVË, HORMOVË

Duhet: UJI I FTOHTË, SARANDË, DELVINË, GJIROKASTËR

Duhet: LEKËL

Duhet: ZYRA RAJONALE E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR INSPEKTORIATI RAJONAL I PUNËS

2. Mungesa e zanores –ë- tek emrat me origjinë asnjanëse, për të cilët diskutohet heqja e saj, me qëllim unifikimin e sistemit të lakimit të emrave mashkullorë, në numrin njëjës, të trajtës së pashquar, në rasën emërore dhe kallëzore.

Duhet: djathë, gjalpë, mjaltë; gjizë

shkrimi i zanores –e- në vend të zanores –ë-

Në këtë menu të vendosur në formën e një tabele ka gabime të shumta drejtshkrimore, si:

shkrimi i zanores –e- në vend të zanore –ë-(duhet: ZGARË, PULË ETJ.); mungesa e zanores –ë (duhet: SALLATË, DJATHË, SUPË ETJ.); OSE GANITURË PËR GARNITURË etj.

3. Shkrimi i fjalëve të gjinisë femërore me –e- fundore të patheksuar, në rasën emërore të trajtës së shquar.

Duhet: Lagje, Lagjja.

4. Shkrimi i –e-së së theksuar

Duhet: QENDRA SHËNDETËSORE

5. Shkrimi në rasën emërore të trajtës së shquar i fjalëve më –e- fundore të theksuar në trajtën e pashquar.

Duhet: TEQEJA

6. Shkrimi i fjalëve te huaja

Duhet: multifunksionale-shumëfunksionale, likujdim-likuidim, axhensi-agjenci, ambjenti-ambienti, survejohet - mund të zëvendësohet me fjalën "mbikëqyret"

Duhet: LIKUIDIM MALLI, TË GJITHA NË KOSTO

Duhet: AGJENCIA, PËRMETI, KËLCYRË, KAKAVIJË, ATHINË, UDHËTIMI. Edhe në tabelat e mëposhtme gjejmë shkrimin e zanores –e- në vend të zanores –ë.

Duhet: AMBIENTI MBIKËQYRET ME KAMERA

7. Shkrimi Carcove-Çarshovë. Në shumicën e rasteve është shkruar drejt.

Duhet: KËLCYRË

Duhet: CERTIFIKATË PRONËSIE

8. Mungesa e nyjeve ose e fjalëve

Duhet: KOMISARIATI I POLICISË PËRMET

Duhet: LAVDI KONGRESIT TË PËRMETIT

Duhet: DREJTORIA RAJONALE E FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, GJIROKASTËR

9. Mungesa e vizës lidhëse në kompozitat këpujore ose përcaktore ndajshtimore

Duhet: BAR-RESTORANT

Duhet: Bar-Kafe

9. Ruajtja e zanores–ë- tek emrat mashkullore më –ës- në të gjitha trajtat e lakimit të trajtës së shquar.

Duhet: të ujësjellësit

Nga sa trajtuam më lart, vërejmë se zbatimi i standardit të gjuhës shqipe në shkrimin e tabelave orientuese dhe informuese lë për të dëshiruar. Le të shërbejë ky punim si një tërheqje vëmendjeje ndaj organeve përgjegjëse për të reflektuar në zgjidhjen e këtij problemi. Ne, departamenti i gjuhës shqipe dhe letërsisë, jemi të gatshëm për të dhënë kontributin tonë për të realizuar shkrimin e tabelave në qarkun e Gjirokastrës sipas standardit të gjuhës shqipe.

Literatura

Miço Samara, *Histori e gjuhës letrare shqipe*. Tiranë, 2000, fq. 17-28.

Kushtetuta dhe materiale shpjeguese, Dhjetor 1998, fq.12, 22.

Gj. Shkurtaj,Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe. Tiranë, 2003, fq. 27.

PASURIA E JETËS, KËRKIMI DHE PËRPUNIMI I FJALËS POETIKE NË POEZINË E PETRIT RUKËS

Prof. asoc. dr. Merita Gjokutaj-Shehu
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
Email: merigjokutaj@yahoo.com

Abstract

Petrit Ruka is among the creators of Albanian literature in the poetry genre, and a prominent individual. Analyzing the creativity of this author, especially after the 90s, we say that his poetry has moved and continues to move on a well-defined artistic and moral flow, gaining new values, thematic breadth, and elaboration and research of the Albanian word.

His poetry is and remains poetry of the time, fine, with nerve, with subtext, and at the same time noble. It is emotional and reflects the essence of life.

This creative character, sensitivity, and individual temperament, as well as the nature of meaningful structuring and layering, the nature of many pictures, and the nature of creative expression, are all adorned by the keenness of observation.

In his poetry, we find real words packed with emotion, a humane and realistic look at life, a breadth of impressions through a found form, and a deep worldview from a poet who is thoughtful and concerned about time, which is expressed in a diverse poetic language, with striking and original figuration, with varied rhythms and rhymes.

We will argue that Petri Ruka's poetry has a chosen poetic word, a variety of problems, an aesthetic demand for diverse verse, a refined language, and musicality of rhyme, but above all content embodied in art.

In his creative path, Petrit Ruka has aimed for the closest possible connections with life and the reader, citing facts, details, and different episodes from life, which he processed in the creative "laboratory" and turned into artistic facts.

Keywords: *poetic word, processing, layers of meaning, artistic facts, musicality of rhyme.*

Lugina e Vjosës është një territor gjeografik që mbart në vetvete pasuri të mëdha natyrore, ekonomike, por dhe shpirtërore. Ka një traditë materiale, shpirtërore dhe kulturore të trashëguar bukur në vazhdimësinë kohore, e cila ka shërbyer dhe shërben si bazë e mirë mbi të cilën janë mbështetur dhe vazhdojnë të mbështeten edhe shumë krijues që i përkasin fushës së artit të fjalës, letërsisë. Një prej tyre është edhe Petrit Ruka.

Ai është ndër krijuesit e letërsisë shqipe në gjininë e poezisë dhe një individualitet i spikatur i saj. Duke analizuar krijimtarinë e këtij autori në vëllimet"Rinia ime" 1978; "Atdheu fillon te zemrat"1983; "Mirupafshim, hënë e vendlindjes!" 1990; e,veçanërisht, pas viteve 90' "Vërtitu, kokë e prerë!" 2000; " Në zemër bie shi..." 2003; "Shtatë mijë shirat e mi" 2008; "Iso dashurie" , 2015; "Nëntë vjet e nëntë ditë" 2015, themi me bindje se poezia e tij ka ecur në një shtrat të mirëpërcaktuar artistik dhe moral, duke fituar vlera të reja, gjerësi tematike dhe përpunim e kërkim të fjalës shqipe.

Elementet që e bëjnë të veçantë krijimtarinë e tij janë: pasuria e brendisë poetike, përfytyrimet në shprehjen e ideve, si dhe kërkimi e përpunimi i fjalës poetike.

Gjetja poetike është rezultat i njohjes dhe i përjetimit intesiv, vëzhgimit, kërkimit dhe meditimit. Poezitë e Petrit Rukës, në shumicën e tyre, dëshmojnë se një nga rrugët më të efektshme është vjelja në jetë dhe ngritja në art e ngjarjeve, detajeve, episodeve reale dhe konkrete, për realizimin e së cilës i ka dhënë dorë edhe përvoja si publicist. Shpesh një detaj fare i vogël, i thënë kalimthi e

bën përfytyrimin më tokësor e më të kapshëm. Madje, edhe në seleksionimin e fakteve dhe episodeve jetësore i mbetet besnik profilit të vet krijues, kërkon të tilla që kanë ngarkesë të fortë, qoftë emocionale, qoftë racionale, si në poezitë: "*Dashuria ka shijen e fortë të vdekjes", "Grua ma ke nxirë jetën dhe jetën ta kam nxirë","Lakimi i emrit të saj"," Një ëndërr hua", "Baba ne ikëm", "Kafe me nënën", " Atdheu u shit, ankandi u mbyll" etj*.

Tematika është aktuale, përfshin motivet e paharruara të vendlindjes, ndjenjat intime, vetminë, trishtimin, stinët, detin, rrugët, fëmijët, njeriun energjik i cili dashuron, por dhe urren.

Motivet lidhen me një vështrim bashkëkohor mbi disa aspekte shoqërore në jetën tonë, me një vështrim moral për të kërkuar virtytet njerëzore e për të dhënë portrete njerëzish; me një vështrim më të gjerë estetik për jetën dhe vdekjen, duke kërkuar përngjasimin e natyrës me njeriun dhe bukurinë e harmoninë e jetës apo duke kaluar edhe në meditime historike, që heqin paralele për t'i folur së sotmes.

- *"Baladë për Ali Pashë Tepelenën".*

……Seç na vjen përballë/ hipur mbi një këngë/ herë me shpatë në dorë/ herë me thikë në dhëmbë….[1]

- *"Gravurë"* ……Arritën karvanet e Anadollit/ Bimbashë, jeniçerë, eunukë/ u ngritën shtatoret, hënë e Stambollit/ në etjen e tyre Vjosa sa s'u zhduk/ me mijëra koka u zgjatën të pinë/ lumi ndërron shtratin, merr formën e kosës/ mallkimet e nënave dhe shkumën e nxinë/ oh, u bëfsh helm për ta o uji i Vjosës![2]
- "Rritesh këngë e lashtë"…..Trembëdhjetë male, ku t'i varrosje veç në këngë/ ndaj i zgjodhe fjalët mirë, shekujt tingull s'u kanë ngrënë./ Trembëdhjetë zambakë të kuq/ trembëdhjetë këngë të pavdekshme, degë e rrapit ku i varen/ zgjodhi stinën e përjetshme. [3]

Autori rrit e forcon intesitetin e ndjenjës, intimitetit njerëzor duke krijuar një lirikë të veçantë, e cila bie në sy sidomos në poezitë kushtuar vendlindjes, si: *"Lirika e qytetit tim",* …….Tepelenës nën qerpikë i rrjedh lumi Vjosës/ fustanellën labe dallga ç'ia spërkat/ zgjasin krahët valët dhe ia fshijnë djersët/ valët i bëjnë iso labçes ditë e natë[4]etj, *etj.*, kryesisht te vëllimi poetik "Rinia ime" 1978.

Në lidhje me ***përfytyrimet për shprehjen e ideve,*** themi se krijimet e tij poetike kanë një brendi të caktuar të vendosur në kohë, idenë përshkuese dhe imazhin, përfytyrimin që e lidh lexuesin me realitetin. Në përfytyrimin poetik të tij ka rëndësi të veçantë raporti i drejtë midis elementit përshkrues dhe atij meditues. Autori qëndron në kufi midis racionales dhe iracionales, konkretes dhe imagjinatives. Është kjo arsyeja pse në poezinë e tij gjejmë ide e forma të larmishme, ku forca krijuese e kuptimore është vazhdimisht në lëvizje, në ngritje dhe ngacmon kërshërinë e lexuesit.

Poezia e tij është dhe mbetet poezi e kohës, fine, me nerv, me nëntekst dhe njëherësh fisnike. Është emocionale dhe përshkohet nga fryma jetësore. Në një nga poezitë e tij Petrit Ruka shprehet:

Nuk dimë ku shkojmë, s'ka kohë të mendohesh./ Nxitojmë nga që thjesht është në modë nxitimi,/Një kohë arixhinjsh jeton sot tërë bota,/ Ah, ik edhe thur kanistra pikëllimi.

Mendimi harmonizohet me ndjenjën e thellë, e mesazhi poetik përcillet me qartësi. Këtë natyrë krijuese, këtë ndjeshmëri dhe temperament individual e stolis edhe natyra e mprehtë e të vërejturit, natyra e ekspresionit kreativ, natyra e formësimeve dhe shtresimeve kuptimore, si dhe natyra e imazheve të pasura.

[1]Petrit Ruka, Baladë për Ali Pashë Tepelenën, Vëllimi "Rinia ime". Tiranë, 1978, fq. 72.

[2]Petrit Ruka, Gravurë, Vëllimi "Rinia ime". Tiranë 1978, fq. 67.

[3] Petrit Ruka, Rritesh këngë e lashtë, Vëllimi "Rinia ime". Tiranë 1978, fq. 69.

[4] Petrit Ruka, Lirika e qytetit tim, Vëllimi "Rinia ime". Tiranë 1978, fq. 54.

Do të veçoja poezinë "Kafe me nënën"

Një natë të prilltë, plasur prej malli/ Bëra dy kafe, dola në ballkon,/ Ditëlindjen kish nëna, tani hije varri/ Të çmallem pak me të shenjtin zakon.

Timen e piva dhe ika të fle,/ Filxhani i saj…vetëm nën hënë,/ Aty, në ag një flutur ngjyrë mjalti/ Brenda në kafe përmbys kish rënë…/

O ç'bëra që fjeta (që fjeça të madhen!)/ Po pse nuk më zgjove moj Nënë?!

Vetë temat u kanë dhënë krahë përfytyrimeve plot forcë dhe vrull. Kjo dëshirë për të fortën, të vrullshmen e madhështoren shfaqet edhe në poezitë që krijojnë çaste lirike e thjesht intime.

Grua ma ke nxirë jetën dhe jetën ta kam nxirë,/ Ma ke pirë gjithë vrerin dhe helmin ta kam pirë,/Po ja që s'bëjmë dot pa këtë helm të mallkuar/ Mos pushofsh kurrë, moj luftë dhe qofsh e bekuar!

Lidhur me kërkimin dhe përpunimin e fjalës poetike, Petrit Ruka duke qenë natyrë krijuese e pasioneve të forta, ka shprehur dhe mbrojtur qëndrimin e vet, definitive, jetësor, shoqëror dhe njerëzor në fiksimin e objektit poetik. Është kjo arsyeja pse fjala e tij poetike është goditëse, e pakompromis, pa hezitime dhe dilema.

Poeti e përzgjedh me sqimë fjalën, e kërkon atë me ngulm, duke e rivlerësuar në kontekste të caktuara poetike, është e qartë dhe përçimi i ideve e i ndjenjave shkon lehtësisht te lexuesi. Dëshira për të zbuluar ana të forta, të vrullshme, gjithë gjallëri dhe ekspresivitet të realitetit, e ka shtyrë poetin t'i kthejë sytë dhe penën nga ato mjete shprehëse që janë më të afta për të mishëruar dukuritë prezente të jetës sonë.

Mjafton të ndalesh te një nga perlat e tij, në poezinë *"Syri i avllisë"- balada e gjyshes me fëmijët emigrantë…."Ajo u ul te porta e qau sa u ngop/ sa terri e mbuloi nën hirin e shkrumbit,/ pastaj i mblodhi këpucët në futën e saj,/ I la rresht sipas emrit në dhomat e gjumit…."*

Duke vëzhguar krijimtarinë e Petrit Rukës, kryesisht atë të pas nëntëdhjetës vëmë re se ndjenja ndaj fjalës, që është midis të tjerash edhe treguesi i sigurt i talentit poetik, ka ardhur duke u kultivuar gjithnjë e më mirë. Kujdesi për figurën dhe fjalën e thjeshtë poetike, dëshmon se poeti përpiqet të zotërojë në vazhdimësi larmi mjetesh për të rritur forcën shprehëse e për ta bërë atë më të kuptueshme.

Në këtë kërkim ai i kthen sytë herë pas here edhe nga thesari i së folmes popullore, duke kërkuar fjalë të vjetra e me ngjyrim *(Qënkeshim dashur tërë jetën dhe nuk e paskemi ditur; nuk dija si ta mbaja atë mushkën e padurimit; qeshe me një krua gurgullimash; ishje boti me verë në dru lisi…*[5]*; djallushkë e padukur*[6]*)* e ndonjëherë për t'i dhënë frazës ngjyrim poetik i drejton sytë nga frazeologjia popullore *(jemi zënë sa janë tundur tepsitë; kemi pështyrë mbi proverbin që qenkëshim mish e thua; u mbush kupa dhe pikë*[7]*; fjeça të madhen; nuk di ç'të bëj tani me ty, kur ndarja po pllakos me nge, gjer dje më ishe ujë në sy, tani një cifël qelqi je…*[8]*).*

Në poezinë e tij gjejmë fjalë të vërteta e të ngjeshura me emocion, vështrim human dhe realist të jetës, gjerësi përshtypjesh përmes një forme të gjetur, botëvështrim të thellë prej poeti të menduar e të shqetësuar për kohën, që plazmohet në një gjuhë të begatë poetike, me figuracion të goditur e origjinal, me ritme e rima të larmishme. Brendia poetike është e thellë dhe e fuqishme, si rezultat i kërkimit këmbëngulës dhe i gdhendjes së fjalës, madje, poezia e tij ka fituar shumë edhe në drejtim të strukturës, është bërë më e organizuar e më solide.

[5]Grua e Jugut. ObserverKult, 17. 12. 2022.

[6]Dashuria ka shijen e fortë të vdekjes. ObserverKult, 09. 04. 2024.

[7]Grua ma ke nxirë jetën dhe jetën ta kam nxirë. Kultplus, 21. 08. 2018.

[8]Nuk di ç'të bëj tani me ty. ObserverKult, 13. 10. 2022.

Baba ne ikëm, shtëpinë e braktisëm,
një kohë arixhinjsh jeton sot gjithë bota
dhe foton tënde nga muret e zbritëm,
si kyç një palë lot vendosëm te porta.....
Ne ikëm dhe varrin ta futëm në një video,
të dielën të takojmë në xhamin vizual
me mend i vumë lulet, dy lot një cigare
jetojmë me simbole, botë me manual...

Në xhamin e tij gjen nuse, bën dasmë,
puth djemtë e vëllait në tjetër kontinent
dhe nënën e qan nga mijëra kilometra
tek e fusin në varr, me video-konferencë....[9]

Edhe pse nuk jeton më fizikisht, krijimtaria që ka lënë pas në duart e lexuesit shqiptar, do të jetojë bukur e pafundësisht (kanë fat të bukur shkrimtarët), sepse poezia e poetit të luginës së Vjosës, poezia e Petrit Rukës ka një verb poetik të zgjedhur, ka larmi problemesh e kërkesë estetike për varg të larmishëm, ka gjuhë të zgjedhur e muzikalitet të vjershërimit, por mbi të gjitha ka përmbajtje të mishëruar në art, falë synimit për lidhje sa më të ngushta me jetën dhe lexuesin, duke qëmtuar fakte, detaje dhe episode të ndryshme nga jeta.

Emri dhe krijimtaria e tij i bën nder bibliotekës së universitetit tonë, ndaj them me bindje se është në nderin tonë pasurimi i bibliotekës universitare me krijimtarinë letrare të Petrit Rukës.

Literatura:

P. Ruka, Rinia ime, poezi, Tiranë, 1978.

P. Ruka, Atdheu fillon tek zemrat, poezi, Tiranë, 1983.

P. Ruka, Mirupafshim, hënë e vendlindjes, poezi, Tiranë, 1990.

P. Ruka,Vërtitu, Kokë e prerë!, poezi, Tiranë, 2000.

P. Ruka, Në zemër bie shi..., poezi, Tiranë 2003.

P. Ruka, Shtatë mijë shirat e mi, poezi të zgjedhura, Tiranë, 2008.

P. Ruka, Iso dashurie, poezi të zgjedhura, Tiranë, 2015.

P. Ruka, Nëntë vjet e nëntë ditë, Poemë baladeske, Tiranë, 2015.

[9]Baba, ne ikëm, ObserverKult, 09. 04. 2024.

SHQYRTIME DHE PRURJE GJUHËSORE NË LIGJËRIMIN E PETRIT RUKËS

Prof.asoc.dr.Mimoza Zekaj,Prof.asoc.dr. Merita Isaraj
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri, mzekaj@uogj.edu.al
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri, misaraj@uogj.edu.al

Përmbledhje

Njohja e veçorive të ligjërimit të një poeti nuk lidhet vetëm me qëllimin për të përcaktuar rolin dhe vendin e tij brenda një periudhe të caktuar kohore, por më shumë lidhet me faktorët dhe kontekstet që kanë ndikuar në sistemin e strukturave gjuhësore, në risitë dhe arritjet e gjuhës së përdorur prej tij. Kjo ka sjellë të dalin në pah ndërveprimet e ndryshme midis gjuhës, kulturës dhe mjedisit natyror, që kanë ndikuar dukshëm në ligjërimin e tij. Edhe ne në këtë punim do të trajtojmë disa aspekte të ligjërimit të poetit Petrit Ruka, duke shpalosur raportin e tij korrekt me vlerat letrare e gjuhësore të transmetuara brez pas brezi, veçantitë e ligjërimit të tij poetik në fushën semantike e strukturore, risitë dhe shtigjet e reja që ka hapur krijimtaria e këtij poeti. Gjithë ligjërimi i tij del si një tërësi hierarkike vlerash, interpretimesh, përjetime e perceptime të larmishme. Do të paraqesim komunikimin që ka vendosur autori me brezat, me traditat, me jetën shoqërore të vendlindjes e rajonit, marrëdhënien e tij me natyrën, si dhe ndikimin që kanë pasur në gjuhën dhe stilin e tij. Nëpërmjet analizave gjuhësore, përgjithësimeve, krahasimeve do të vlerësojmë gjuhën poetike, duke mëshuar te roli i saj në përcjelljen e mesazheve. Me anë të poezive të tij poeti shpalos marrëdhënien e ngushtë që vendos me vendlindjen, por, nga ana tjetër, edhe raportin korrekt me gjuhën poetike, nëpërmjet ritmit e formave metrike, nëpërmjet leksikut dhe lidhjeve morfo-sintaksore, strukturave e ndërtimeve sintaksore.

Fjalët kyçe: *ligjërim, vendlindje, ndikim, veçori, gjuhë poetike.*

Abstract

Understanding the characteristics of a poet's discourse is not solely about determining his role and place within a specific period of time, but rather it is more closely tied to the factors and contexts that have influenced the system of linguistic structures, the innovations and achievements of the language he employs. This has brought to light the various interactions between language, culture and the natural environment, which have notably influenced his discourse. In this paper we will explore several aspects of the discourse of poet Petrit Ruka, elucidating his correct relationship with the literary and linguistic values from generation to generation, the peculiarities of his poetic discourse in the semantic and structural fields, the innovations and new paths opened by this poet's creativity. His entire discourse emerges as a hierarchal totality of values, interpretations, experiences, and diverse perceptions. We will present the communication established by the author with generations, traditions, the social life of his birthplace and region, his relationship with nature, as well as the influence they have had on his language and style. Through linguistic analyses, generalizations and comparisons, we will assess the poetic language, delving into its role in conveying messages. Through his poems, the poet unfolds the close relationship he establishes with his birthplace,and the correct relationship with poetic language through rhythm and metrical forms, lexicon and morpho-syntactic connections, and syntactic structures.

Keywords: *discourse, birthplace, influence, characteristics, poetic language*

Njohja e veçorive të ligjërimit të një poeti nuk lidhet vetëm me qëllimin për të përcaktuar rolin dhe vendin e tij brenda një periudhe të caktuar kohore, por më shumë lidhet me faktorët, situatat

dhe kontekstet që kanë ndikuar në zgjedhjen e motiveve, temave, përjetimeve, në sistemin e strukturave gjuhësore, në risitë dhe arritjet e gjuhës së përdorur prej tij. Kjo ka sjellë të dalin në pah ndërveprimet e ndryshme midis gjuhës, shoqërisë, artit, kulturës, historisë, traditës dhe mjedisit natyror, të cilat kanë ndikuar dukshëm në ligjërimin e tij.

Me anë të veprës letrare shkrimtari shpalos marrëdhënien dhe vizionin e tij për jetën, për botën, të cilat dalin jo thjesht dhe vetëm në atë që quhet përmbajtje e krijimtarisë, por në tërë rrjedhën e saj. Këtë e dëshmon më së miri gjithë vepra letrare e Petrit Rukës dhe, veçanërisht, ligjërimi poetik, me organizimin e tij përmbajtësor e strukturor, sipas dy boshteve:

1. Komunikimi që ka vendosur autori me brezat, me traditat, me jetën shoqërore të vendlindjes e rajonit, marrëdhënien e tij me natyrën dhe ndikimin që kanë pasur në gjuhën dhe stilin e tij.

2. Mjeshtëria dhe vlera e gjuhës poetike e përdorur në përcjelljen e masazheve, nëpërmjet analizave gjuhësore, përgjithësimeve e krahasimeve.

Në këtë punim do të trajtojmë disa aspekte të ligjërimit poetik të poetit Petrit Ruka, duke shpalosur raportin e tij korrekt me vlerat letrare e gjuhësore të transmetuara brez pas brezi, veçantitë e ligjërimit të tij poetik në fushën semantike e strukturore, risitë dhe shtigjet e reja, që ka hapur krijimtaria e këtij poeti. Kemi bërë objekt të gjitha vëllimet e tij poetike[1].

Gjithë ligjërimi i poetit tonë del si një tërësi hierarkike vlerash, interpretimesh, përjetime e perceptime të larmishme, përjetime të mëdha shoqërore e shndërrime në jetën dhe mendësinë e njeriut. Këtej rrjedh edhe larmia tematike, gjerësia e madhe e ligjërimit poetik. Poezitë flasin për fakte, sjellin mendime, personazhe, mjedise, natyrën, konkreten, abstrakten. Në to ka hapësirë dhe kohë, por këto të shpërfytyruara. Shpesh edhe mungojnë, sepse imagjinata e poetit nuk njeh kohë dhe hapësirë. Poeti ynë përdor me mjeshtëri fushat e nënfushat konceptore, leksikore e semantike duke luajtur me fjalën, përafron e përqas të njohurën me të panjohurën, të afërtën me të largëtën, konkreten me abstrakten, të zakonshmen, me të papriturën, me të çuditshmen, të përveçmen, me të përgjithshmen, me "unin" e tij poetik, me tërë universin, për të krijuar "rruzullimin" e tij poetik, porse gjithmonë pa shkaktuar pështjellime e pika të errëta[2].

Gjatë kundrimit të vëllimeve të tij poetike, vëmë re të përdorur një fushë konceptore e leksikore, të strukturuar gjerësisht me ndarjet e nësistemet e saj, e përbërë nga fjalët me kuptim të drejtpërdrejtë, leksema që emërtojnë objekte të ndryshme, fjalë që emërtojnë sende, dukuri, vende, ndjesi, përshtypje, lidhje gjaku, marrëdhënie, të kaluarën, të sotmen, të ardhmen, si: qyteti, fshati, vendlindja, shtëpia, familja, babai, nëna, gruaja, motra, fëmijëria, poeti, miqtë, dashuria, dimri, pranvera, natyra, mali, kodra, fusha, lumi, toka, dielli, hëna, qielli etj. Por vlerë gjuhësore dhe estetike nuk ka vetëm lloji i fjalëve, por edhe denduria e përdorimit të tyre[3]. Në fjalorin e përdorur, ndër fjalët kryesore, më dendur përdoren ata emra, mbiemra, folje e pjesë të tjera, që kanë përdorim në mbarë shqipen e në çdo stil dhe pjesa më e madhe e tyre janë polisemantike. Gjejmë edhe dialektalizma, krahinorizma, fjalë të vjetra, dysorë të ndryshëm, fjalë të ligjërimit përditshëm, si: *bohçen, sepeten, vithis, sterra, kuterina, mejtime, hyzmeqar, të tromaksur, avlli, motak, kulprishte, kambrik; dhogë-dërrasë, i vdekur-meit; dertet-hallet, të tromaksur-të trembur, cullufet-baluket* etj. Fjalë të ligjërimit libror, terma të ndryshëm shkencorë, si: *materie, zhvillim, shoqëri, jetë, botë, premtim, ëndërr, konferecë, kontinent, projekt, fotografi, video, visual, manual, komjuter, email, Hotmail, CV* etj. Këto fjalë e shumë kategori të tjera fjalësh, P. Ruka i zotëron natyrshëm, vepron me to dhe ndërton një vjershëri me material të bollshëm e të larmishëm, me figura e fjalor poetik të pasur, duke realizuar një gërshetim të natyrshëm të pasurisë leksikore me motivet që trajton. Ndërton regjistrin gjuhësor pa u shkëputur nga kjo pasuri leksikore, e cila i përshtatet gjithë krijimtarisë, duke parë larminë

---

[1] Ruka, Petrit. Rinia ime, 1978; Atdheu fillon tek zemrat, 1983; Mirupafshim hënë e vendlindjes, 1990;Shtatë mijë shirat e mi, 2008; Shami të zeza qiellore, 2019; Andej baltë, këtej erë, 2020.

[2] Shkurtaj, Gj. "Dukuri dhe risi të ligjërimit poetik". *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009, f. 139.

[3] Thomai, Jani. "Vështrim mbi leksikun e ligjërimit poetik të Naim Frashërit". *Gjuha jonë*, nr.1-4, 1997, f. 45.

e madhe të temave e motiveve. Sipas mendimit tonë, ky gërshetim i shkëlqyer i këtyre nënfushave është rezultat i harmonizimit të disa faktorëve.

Së pari, poetiështë njohës i thellëi jetës, i çdo aspekti të saj, i së veçantës, së përgjithshmes, konkretes, abstraktes, pra i gjithçkaje. Poeti shkruan: "*Mirupafshim, hënë e vendlindjes*'; '*Rinia ime*"; "*Atdheu fillon te zemrat*"; "*Në zemër bie shi*"; "*Shqipëria*";, "*Letra me nënën dhe babanë*"; "*Himn për gruan*"; "*Nëse ti nuk shkon në shkollë*"; "*Tokë ballkanike*"; "*Vjosë*"; "*Gjërat e mia të vogla*" etj.

Së dyti, është gjithmonë në kërkim të së resë, të ndryshimit, të ideve dhe mendimeve të reja, duke dashur të zbulojë një hapësirë të gjerë, të pafundme. Poeti thotë: "*Projekt për ribërjene botës*"; "*Së afërmi do ndryshoj*"; "*Akuarel përmallimi*"; "*Kundrojeni detin*"; "*Liria*"; "*Poetët*".

Së treti, është njohës i thellëi folklorit, i dashuruar çmendurisht pas tij, pas baladave, fustanellave, pas krijimtarisë së lashtë të popullit. Këtë e dëshmon më së miri vëllimi "*Andej baltë, këtej erë*" (balada arbërore), në të cilin janë disa legjenda, ca balada të rirrëfyera me mjeshtëri të lartë, rrëfime që i kemi dëgjuar e lexuar dhjetëra herë më parë, por këtë radhë […], ku një poet kapërcen gjithçka që të ka mrekulluar më parë dhe të shfaqet shtatë pëllëmbë më lart[4]. Në këto krijime poeti ka ridimensionuar kohën, rifreskuar motivin, ka rigjallëruar përjetimin, ka risjellë bukurinë e fjalës shqipe, peshën e saj. Tekstet e tij poetike u bënë të vetëmjaftueshme, të afta në ndërtimin e urës traditë – modernitet[5]. Për poetin tonë,"Shkolla e parë estetike e çdo poeti drejt letërsisë është padyshim folklori. Kjo është e para bibliotekë, ardhur ashtu, pa rend, pa mësues, pa shpjegime, duke krijuar në kokën e tij një "rrëmujë" të mrekullueshme e të bekuar përfytyrimesh që do ta ndjekin deri në varr"[6].

Së katërti, gjuha që ai përdor, është vetë shqipja, me të gjitha bukuritë, mundësitë dhe aftësitë e saj shprehëse, që e ka mbështetur poetin për të sjellë këtë pasuri të madhe e të vyer leksikore. Poeti shkruan:

Do t'i shkruaj ca derte që askush nuk m'i di,

ca gjëra të fshehta

që askujt s'ia kam thënë.

Të shoh dhe njëherë si këndon mbi kartë

Me ritmin e zemrës sime çdo gërmë[7]*….*

Për të ruajtur dhe pasqyruar më mirë ngjyresën popullore në ligjërimin e tij, në një pjesë të krijimeve poeti përdor onomatopetë, tingullimitimet. *Kërkëllin krak-krak; dyzet kuaj të tërbuar,/ traka-traka-tra* (Andej baltë…); *Shushurin anës lumit; Të shihnin qorrat ubububnë; për një cërr; çak – çuk me gur* (Shami të zeza..); *Vendlindja në cërr të dimrave* (Mirupafshim…). Shprehje të ligjërimit të zakonshëm bisedor: *Çairin kam ngrënë; Si ty jam vërtet plot zgërbonja,/; …se gjaku t'u çmend ka marrë kuturu…; ma ujdis këtë zemër që punon shtrak-shtruk…../ sundon shkretëtia ku jam një mamluk…; Dhe ja kjo këngë niset çapraz, si barkë shpëtimi; më zuri malli, /po vdes prej malli; Tani shqipes për ty/ nga malli do t'i nxjerr/ ujë të zi* (Shami të zeza qiellore).

Vlerë shprehëse kanë edhe urimet e mallkimet që përdor autori në poezitë e tij, duke rregulluar shkëmbimin e pozicioneve shoqërore të karaktareve të tij. Ato janë të lidhura në një bosht leksikosemantik, që tregon cilësitë e larta dhe fisnikërinë e shpirtit[8]. Urime: *Me shpirt këndoi, pastë amëshim…! O vajzë pa emër, bekofsh vajzërinë, / je jetë, je mbret shtëpi më shtëpi*! *Na qoftë i ëmbëlsa vashat*!(Shami të…). Mallkime*: O vafsh në djall, torturë e ëmbël!*; *O Zot, mos*

[4] Kulla, Pëllumb. "Një perlë poetike". *Andej baltë këtej erë. Tiranë,* 2020, f.7.

[5] Kote, Odise. "Petrit Ruka-ura e sgurt midis traditës e modernitetit". *Andej baltë këtej erë.*Tiranë, 2020, f.217.

[6]Ruka, Petrit. "Shkolla e folklorit për poezinë". *Andej baltë këtej erë.*Tiranë, 2020, f.257.

[7] Ruka, Petrit. "Prej vitesh letra nuk shkruaj". *Shami të zeza qiellore.* Tiranë, 2019, f.50.

[8]Shkurtaj, Gjovalin.*Etnografi e të folurit të shqipes*. Tiranë, 2004, f. 157.

u zgjofshim më nga ai gjumi!; Duart m'u thafshin, pse s'bleva më shumë, /me ar le t'ua blija Vitin e Ri…!; Pas meje tërmetet…daltë ujë i zi! (Shami…).

Një nënfushë tjetër leksikore e semantike ku shfaqen vlera të mjeshtërisë së poetit, janë edhe njësitë frazeologjike dhe disa lidhje të qëndrueshme fjalësh, të cilat janë përdorur me një ngarkesë të veçantë stilistikore. *Po ky akoma s'vuri ca mend; Koka më zien; Mendja ku nuk më tretet; Ta ka pikur malli; Ta pinë gjakun librat; U tura e u thera; Më ra syri; Është lesh e li; U bë lëmsh kjo botë* etj.

Për të na sjellë sa më afër ngjyresën e ligjërimit të vendlindjes, forcë shprehëse kanë edhe fjalë të formuara me prapashtesa zvogëluese, të cilat përdoren në trevat e Jugut. Si: *bërthamëz dashurie; po një degëz me lule akoma e kam; O ju shokëzit e mi; Këpuckat; vëllaçko; si mëzkë livadhesh; i hedh guriçka; në një shamizë; sekondë e vockël; të kam troftëzën; bukurizë mbi manushaqe; çikëz shpirt; pikël vesë* etj.

Mënyrës së të shkruarit të drejtpërdrjetë e të plotë, të ideve, mendimeve, të ngjyresës së ligjërimit të vendlindjes, i shkon shumë mirë edhe forma e ligjërimit që zgjedh poeti. Një pjesë e poezive nisin si rrëfenja apo tregime. Ja disa prej tyre: *Kohë gripi në Tiranë; Them të vdes javën tjetër; Atdheu u shit, ankandi u mbyll; Tani nuk di ç'të bëj me ty; Po më çmendin numrat; Vjosa; Së afërmi do ndryshoj; Bota e tërë nisej për pashkë; S'u pamë asnjë herë, o Azem Shkreli; Baba, ne ikëm; Tregim në prozë poetike* etj.

Në disa poezi përdor ligjërim në formë bashkëbisedimi, tërheqje vëmendjeje, ankues, me qëllim që ta realizojë më mirë komunikimin e poezisë me lexuesin. *Të jem pranë teje; Kujdes kur të shkruash dashurinë për një grua; Botuesi im i vdekur; Babai s'e mbajti premtimin; Shkova te nëna; Vjosa meket si grua* etj.

Ka disa poezi ku vargjet e para të tyre të risjellin fillimin e ndonjë përralle, si: *Nëna dikur më vinte vetëm nëëndrra…*(Ah, të botohej një ëndërr si jotja); *Pa bie një mall më dredh në zemër,/ Se paç një Motër që më iku..* (Pak dhembje zemra le ta ketë); *Në një natë të ënjtur dimri; Tre gra, tre vjet pas Luftës së Dytë/ zbërthejnë një predhë…*(Për pak bukuri më shumë); *Në dimrin e largët '76/ mësues i ri në fshatin malor..*(Borë pambuku) etj.

Në një pjesë të madhe të krijimtarisë së P. Rukës vihen re ligjërime me nëntekste e nënkuptime që mbështesin më mirë përpjekjet e vazhdueshme të poetit për të rritur vlerën e gjuhës së tij, finesën dhe veçantinë për të gjetur shtigje të reja. Kjo pasqyrohet edhe te lidhjet e shumta sintagmatike të përdorura në poezi. Bien në sy lidhjet sintagmatike emërore me cilësorë që plotësojnë dhe lartësojnë imazhe të ndryshme, që të shtojnë përjetimet emocionale. Lidhjet e larmishme foljore, të cilat duket sikur t'i orientojnë më mirë ndjesitë dhe qëndrimin emocional. *Tërë një gluhë safi hyjnore/ që dinë zemrat vullkanore,/ ato zemrat dashurore. Gjuhë që s'gjendet në fjalorë, po në fyejet arbërorë; xheniere bukurie; shpirt pa ndryshk; mornica dëbore* (Shami të…). *Po ti më ike, shoqe e bukur,/ moj leshverdha-dritë e hënës,/ ti jetëshkurtra sa një flutur/ u bëre rrudhë në ballë të nënës* (Shami të…). *Mijëra foto në jetë i bëri Vjosa e kaltër,/ dhe kroi i fshatit/ të bukurës sime/, po unë si t'i mbledh, ato shkuan në det, / i bëri kripa e lotit copë e thërrime; Nën dritaren time kalon Vjosë e lodh*ur (Shtatë mijë..) etj.

Vlera të qenësishme e të spikatura fiton fjala kur kalon nga rrafshi emërtues i drejtpërdrejtë, në atë figuartiv. Përjetimet pamore zëvendësohen nga abstraksioni, zhdërvjelltësia, variacioni, shumëfishimi i lidhjeve sintagmatike dhe nuk mungon asnjëherë pastërtia e shprehjes apo kthjelltësia e idesë dhe e ndjenjës[9]. Në ligjërimin poetik të Rukës kalimet e kuptimeve të figurshme janë të fuqishme, frymëzuese, mbresëlënëse, ndër të cilat shquhen metaforat, metonimitë, krahasimet, similitudat, paralelizmat figurativë, simbolet, personifikimi apo epitetet e gjetura. Në pamundësi për të sjellë gjithë larminë e e këtyre figurave, kemi përzgjedhur vetëm pak shembuj, të cilët kristalizojnë origjinalitetin e poetit. Ja si thotë poeti:*Atdheu u shit, ankandi u mbyll,/ U vumë në radhë si mijëra dele,/ kopenë e ujqërve e zgjodhëm sërish./ Shpresën e re në mijëra blegërima,/ e mlodhën ata në vatra partish* (Kam ftohtë); *Do ta marr në xhep varrin e*

[9] Memisha, Valter. "A. Z. Çajupi dhe pesha e fjalës së vendlindjes". *Kërkime universitare 7*, Gjirokastër, 2003, f. 157.

babait/ si një kuti shkrepëse,/ do t'i qep pas shpirtit përkëdheljet e nënës,/ do bëj makinë qepëse zemrën time,/ me penjtë e artë tëhënës (Gjërat e mia të vogla); *Atdheu fillon te zemrat tona,/ kufijtë e tij kalojnë te shpirti ynë./ Ja, shtri në një vijë të drejtë kapilarët, venat, aortat.../ dheke matur të gjithë kufinë* (Atdheu fillon te zemrat). *U mplak blerimi dhe te plepi i fundit,/ U mbushën me myshk në ije përrenjtë,/ E ftohta ditëve po u ngjitet nga skajet/ Ashtu si reumatizma që ngjitet te pleqtë* (Në zemër bie shi). Figurat letrare në gjithë poezitë janë të shumta dhe janë kthyer në vlera gjuhësore, sidomos te krijimet pas vitit 2010, duke u bërë konkrete dhe depërtuese te lexuesi. Në të njëjtën kohë, ato e kanë pasuruar e lartësuar ligjërimin e tij.

Poeti ynë është gjithmonë në kërkim të shtigjeve të reja jo vetëm në motive e tematikë, por gjithmonë kërkon ta pasurojë ligjërimin artistik, nga ana leksikore, si dhe lidhjet morfo-sintaksore. Gjejmë të përdorura fjalë të përbëra të rimarra e të risjella nga tradita, apo të krijuara nga vetë poeti, si: *vetullkaleshe; flokëçpleksitur; zemërgurë; fustanebardhë; vatërergjënda* (Atdheu fillon te zemrat); *mendjehumbur, lulepjeshkë; rrënjëdalë; grykëprerë; hijerëndë* (Mirupafshim hënë e vendlindjes); *shpirtbardhë; trularaskë; fustanfryrat; shpirtpalarë; tradhëtindritura, jetëshkurtra* (Shami të zeza qiellore) etj.

Një anë të veçantë e mjaft origjinale ka ligjërimi i P. Rukës në fushën e sintaksës poetike. Rendi i fjalëve në frazë u përgjigjet, nga njëra anë, kërkesave të veçanta të metrikës, dhe nga ana tjetër, ky rend është më i lirë dhe elastik se sa në strukturën normale sintaksore. Srtuktura sintaksore poetike ofron magjinë e vargut[10].

Dukuria gjuhësore që i përshtatet mjaft mirë magjisë së vargut dhe këtij ligjërimi, është përsëritjae shumëllojshme. Gjejmë të përdorura më shumë përsëritjet foljore, ndajfoljore, disa përsëritje mbiemërore, disa emërore, përsëritje të fjalëve onomatopeike, pasthirrmave etj. Poeti e ka përdorur për të theksuar e për të dalluar diçka të veçantë, për të veçuar e sforcuar një element të rëndësishëm, për të kundërvënë e për të bashkuar shumëçka në rrafshin logjik, kuptimor, gjuhësor e artistik, për të arritur efekte të veçanta stilistike, në pamje lirike, në përshkrime e situata të ndryshme. Vihen re përsëritjet e vazhdueshme të fjalëve, të vargjeve, të strofave, pra, përdor me mjeshtëri edhe ndërtimin analog. Përdor përsëritjet e lidhëzave, të emrave, të foljeve, të trajtave të shkurtra në fillim të disa vargjeve, si te poezitë: "Projekt për ribërjen e botës"; "Së afërmi do ndryshoj"; "Zhgënjimi"; "Liria"; "Botë kauçuku"; "Dil nga dritarja jonë e thinjur"; "Në vendin tim" etj. Përsëritja e strukturave sintaksore i jep gjuhës së veprës një përmbajtje të pasur ligjërimore. Çdo element i gjuhës sjell shprehësi, po të rimerret me këtë përftesë, sidomos po të bëhet përsëritja sipas një kriteri organizimi[11].

Në fushën e sintaksës poetike është për t'u vënë në dukje përdorimi i pranëvënies së dy emrave pa lidhje morfologjike si përcaktorë, midis të cilëve ka vetëm një përngjashmëri e krahasim kontekstual të pashprehur morfologjikisht, ashtu si te metafora. Sipas Gj. Shkurtaj, një strukturë e tillë po del jo rrallë në vjershërinë e disa poetëve të sotëm[12]. Me ta do flerë sot gruaja-urë,/ do muroset prapë në mëngjes...(Urë, moj e zeza urë); Sa të bien yjet – kashtë/ sa të vdes të jemi bashkë (Vjen një trim i mbytur); gjaku lumë – flamur mbi borë (Balada e Tanës); Kur ishte mbi supe – kuti me tërmete,/ veç me një kthyer bënte, zhbënte shtete; Hapet dheu – gojë tërmeti, / Zot, të qofsha falë (Andej baltë, këtej erë) etj.Edhe shenjat e pikësimit janë një element i rëndësishëm, që shënojnë pauzat logjike brenda ligjërimit poetik dhe organizojnë shtrirjen e frazave sipas lidhjeve sintaksore të bashkërenditjes e të nënrenditjes.

*Poeti bën përpjekje të vazhdueshme në lëmin e metrikës së vargjeve, në ritmin e ty*re, duke gjetur ato mjete fonetike, që sjellin ëmbëlsinë, hijeshinë, fuqinë, madhështinë e poezisë së tij. Vargu është aspekti më i dukshëm i poezisë, është shtegu ku futemi dhe kthehemi mbrapsht, dhe kështu pambarimisht. Te poeti ynë vargu bie menjëherë në sy, duke qenë një shtrirje grafike e shumëllojshme. Gjatësia e vargjeve përcaktohet nga numri i rrokjeve. Gjejmë vargje me katër,

---

[10]Dibra, Klodeta; Varfi, Nonda. *Gjuhësi teksti*. Tiranë, 1999, f. 157.

[11] Lloshi, Xhevat. *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Tiranë, 2006, f.48.

[12]Shkurtaj, Gjovalin. *Pesha e fjalës shqipe*. Tiranë, 2009, f. 204.

gjashtë, tetë, njëmbëdhjetë rrokje, me rimë të alternuar, të përputhur, të varguar etj. Midis pjesëve përbërëse të ligjërimit poetik përcaktues është ritmi, i cili ka të bëjë me muzikalitetin e brendshëm të vargjeve të poezisë, reflekton ritmin e kohës dhe është në vetvete një lëvizje e organizuar e elementeve të saj përbërëse, ku këmbehen rrokje me cilësi të ndryshme: të gjata - të shkurtra, të theksuara - të patheksuara[13]. Forma e poezisë tradicionale shqiptare me vargun që ruan ritmin e rimën, i shkon përshtat edhe çdo brendie të re, aq më tepër kur vetë natyra e gjuhës shqipe është e tillë që jep dorë për larmi e pasuri të pafundme rimash e asonancash, duke mos lënë shteg për asnjë lloj monotonie[14].

Edhe nga pikëpamja e zbatimit të standardit, poezitë e Petrit Rukës janë pasqyrë e një përpjekjeje serioze të poetit për ta përpunuar gjuhën si duhet. Shmangiet e pakta janë përdorur me vlerë stilistikore. Me anë të poezive të tij poeti shpalos marrëdhënien e ngushtë, që vendos me vendlindjen, por, nga ana tjetër, edhe raportin korrekt me gjuhën poetike, nëpërmjet ritmit e formave metrike, nëpërmjet leksikut dhe lidhjeve morfo-sintaksore, strukturave e ndërtimeve sintaksore.

Gjithë përpjekja dhe përkushtimi i poetit për të sjellë një hapësirë të gjerë dhe të pafundme me ligjërimin e tij janë një vlerë e madhe kulturore për gjithë luginën e Vjosës, në veçanti, por edhe një vlerë e shtuar për kulturën shqiptare, në përgjithësi.

Bibliografia

Dibra, Klodeta; Varfi, Nonda. *Gjuhësi teksti*. Tiranë, 1999.

Lloshi, Xhevat. *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Tiranë, 2006.

Kote, Odise. "Petrit Ruka-ura e sigurt midis traditës e modernitetit". *Andej baltë këtej erë.*Tiranë, 2020.

Kulla, Pëllumb. "Një perlë poetike". *Andej baltë këtej erë.*Tiranë, 2020.

Memisha, Valter. "A. Z. Çajupi dhe pesha e fjalës së vendlindjes".*Kërkime universitare*, Nr. 7, Gjirokastër, 2003.

Ruka, Petrit. "Shkolla e folklorit për poezinë". *Andaj baltë këtej erë.*Tiranë, 2020.

Shkurtaj, Gjovalin. *Pesha e fjalës shqipe*.Tiranë, 2009.

Shkurtaj, Gjovalin. *Etnografi e të folurit të shqipes*. Tiranë, 2004.

Thomai, Jani. "Vështrim mbi leksikun e ligjërimit poetik të Naim Frashërit", *Gjuha jonë*, nr.1-4, 1997.

Zheji, Gjergj. *Bazat e vargëzimit shqiptar*. Tiranë, 1988.

Lista e librave të vjelë

Rinia ime, 1978.

Atdheu fillon tek zemrat, 1983.

Mirupafshim hënë e vendlindjes, 1990.

Shtatë mijë shirat e mi, 2008.

Shami të zeza qiellore, 2019.

Andej baltë, këtej erë, 2020.

[13] Zheji, Gjergj. *Bazat e vargëzimit shqiptar*. Tiranë, 1988, f. 19.

[14]Shkurtaj, Gjovalin. *Pesha e fjalës shqipe*. Tiranë, 2009, f. 136.

TEKNIKAT EFEKTIVE TË MBNJ-SË SI FAKTORË SUKSESI PËR SIPËRMARRJET TURISTIKE NË LUGINËN E VJOSËS, SHQIPËRI

Dr. Daniela Qiqi
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër,
dqiqi@uogj.edu.al

Përmbledhje

Ky studim eksploron disa nga teknikat efektive të menaxhimit të burimeve njerëzore (MBNJ) dhe ndikimin e tyre në suksesin ekonomik të sipërmarrjeve turistike të cilat operojnë në luginën e Vjosës, e cila është një rajon me një potencial të madh ekonomik që duhet shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme. Fokusi është në identifikimin e strategjive të MBNJ-së, të cilat maksimizojnë angazhimin e punonjësve, inovacionin dhe produktivitetin e tyre duke kontribuar në rritjen e qëndrueshme ekonomike të sipërmarrjeve.

Nëpërmjet një metodologjie të kombinuar e cila përfshin analizë cilësore dhe sasiore, anketime të detajuara me punonjës, intervista me drejtues të sipërmarrjeve turistike në luginën e Vjosës, studimi përpiqet të vlerësojë efikasitetin e praktikave të MBNJ-së, siç janë rekrutimi strategjik, trajnimi, menaxhimi i performancës, dhe kultura organizative të cilat nxisin inovacionin dhe përfshirjen. Studimi fokusohet veçanërisht në rëndësinë që ka krijimi i një mjedisi pune, i cili mbështet zhvillimin dhe mirëqenien e punonjësve dhe argumenton rolin e këtij mjedisi në suksesin ekonomik e social të sipërmarrjeve turistike.

Rezultatet tregojnë se përqasja moderne dhe novative ndaj MBNJ-së ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të sipërmarrjeve lokale duke rritur konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e tyre, në përmirësimin e jetës së banorëve vendas, por edhe në zhbllokimin e potencialeve për zhvillimin e luginës duke e bërë atë më tërheqëse për investime të reja nga grupe të ndryshme interesi.

Në përfundim, studimi ofron rekomandime të bazuara në raste suksesi për implementimin e praktikave të MBNJ-së të cilat mund të ndihmojnë në transformimin e luginës së Vjosës në një qendër të rritjes ekonomike dhe inovacionit. Këto rekomandime ofrohen si për menaxherët e sipërmarrjeve turistike, ashtu edhe për politikëbërësit dhe mund të shërbejnë si orientim për zhvillimin e strategjive të MBNJ-së, të cilat jo vetëm që do të përmirësojnë performancën e sipërmarrjes, por, gjithashtu, kontribuojnë në mirëqenien e përgjithshme ekonomike dhe sociale të rajonit.

Fjalë kyçe: *menaxhimi i burimeve njerëzore, zhvillim ekonomik rajonal, lugina e Vjosës, Shqipëri, angazhimi i punonjësve, inovacioni organizativ, rekrutimi strategjik, zhvillimi i talentit.*

Abstract

This study examines some of the most successful HRM strategies and how they affect the financial performance of tourism-related businesses in the Vjosa Valley, an area with significant economic potential that needs to be used sustainably and effectively. The focus is on identifying HRM strategies that maximize employee engagement, innovation, and productivity, contributing to the sustainable economic growth of business enterprises.

Through a combined methodology that includes qualitative and quantitative analysis, detailed surveys with employees, and interviews with managers of tourism enterprises in the Vjosa Valley, the study tries to evaluate the efficiency of HRM practices, such as strategic recruitment, training, performance management, and organizational cultures that foster innovation and inclusion. The study focuses particularly on the importance of creating a work environment that supports the development and well-being of employees and argues the role of this environment in the economic and social success of tourism business enterprises.The results show that the

modern and innovative approach to HRM has a direct impact on the economic development of local enterprises by increasing their competitiveness and sustainability, improving the lives of local residents, and unlocking the potential for the development of the valley by making it more attractive for new investments from different interest groups.In conclusion, the study provides recommendations based on success cases for the application of HRM practices that can help transform the Vjosa Valley into a center of economic growth and innovation. These suggestions, which are intended for both policymakers and managers of tourism-related businesses, offer direction for the application and execution of HRM techniques that will enhance business performance while also enhancing the region's general economic and social well-being.

Keywords: *Human Resource Management, Regional Economic Development, Vjosa Valley, Albania, Employee Engagement*

Hyrje

Lumi Vjosa ka një gjatësi prej rreth 272 km, nga të cilat 80 km janë në territorin e Greqisë, ndërsa rreth 192 km janë brenda territorit të Shqipërisë. Lugina e saj shrihet në një sipërfaqe prej 6,706 km², nga të cilat 2,154 km² janë brenda kufijve të Greqisë dhe 4,552 km² brenda kufijve të Shqipërisë. Më 13 mars 2023, lumi Vjosa u shpall "Park Kombëtar" dhe tashmë sipërfaqja prej 12.727 ha është zonë e mbrojtur. Sipas ndarjes territoriale të vitit 2014, pjesa më e madhe (50.47%) e luginës së lumit Vjosa shtrihet në qarkun e Gjirokastrës dhe kjo është një mundësi unike për zhvillimin e turizmit alternativ i cili mund të sigurojë rritjen ekonomike të rajonit duke ruajtur ndërkohë edhe integritetin mjedisor e kulturore të tij.

Format e turizmit alternativ të cilat mund të zhvillohen në këtë zone, janë të shumta, por në fokus duhet të jenë ato forma turizmi të cilat respektojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit duke garantuar përdorimin me kujdes dhe ruajtjen e burimeve turistike. Bazuar në një studim të realizuar në këtë zonë (*Guga, Qiqi, 2024*), llojet e turizmit për të cilat tregohet interes nga vizitorët në luginën e Vjosës janë kryesisht:

- Turizmi i interesit të veçantë (vëzhgimi i shpendëve, fotografia dhe pelegrinazhet fetare);
- Turizmi sportiv (ski jashtë shtigjeve, kampingu dhe çiklizmi nëpër rrugë piktoreske);
- Turizmi i mirëqenies (wellness) aktivitete për shëndetin dhe mirëqenien, si p.sh. yoga;
- Ekoturizmi (eksplorimi i biodiversitetit dhe bukurive natyrore duke e ruajtur mjedisin);
- Turizmi rural (përjetimi i jetës rurale, aktiviteteve bujqësore dhe traditave lokale);
- Turizmi i verës dhe i kuzhinës (interes i lartë për kuzhinën lokale dhe prodhimin e verës);
- Turizmi kulturor (njohja me trashëgiminë kulturore, traditat dhe vendet historike);
- Turizmi shkencor (udhëtime për qëllime studimore/ arsimore nga studiues dhe të rinj),

të cilat janë forma të qëndrueshme të zhvillimit të turizmit. Sigurisht, që vetëm ekzistenca e interesit për këto lloje turizmi nuk mjafton, sepse sfida më e madhe me të cilën përballet turizmi i kësaj zone aktualisht, është menaxhimi i burimeve turistike ekzistuese në mënyrën më të mirë të mundshme me qëllim që të përmirësohet gjendja ekonomike dhe sociale e banorëve, por pa u dëmtuar vlerat unike të luginës.

Roli i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (MBNJ)

Sipas statistikave mbi turizmin, numri i turistëve që vizitojnë qarkun e Gjirokstrës po rritet vazhdimisht dhe sigurisht që kjo rritje e kërkesës turistike ka bërë që edhe numri i sipërmarrjeve turistike të cilat ofrojnë shërbime, të vijë duke u rritur. Ky fenomen ka dhënë impaktin e vet edhe në marrëdhëniet e punësimit, sepse duke u rritur numri i vendeve të punës është shtuar kërkesa për të punësuar dhe jo vetëm në sektorin e turizmit, por edhe në sektorët e tjerë që janë të lidhur me turizmin si ndërtimi, bujqësia, blegtoria etj., falë impaktit direkt dhe indirekt që turizmi ka në ekonomi. Nga investigimi i realitetit të zhvillimit të turizmit në këtë rajon, janë të shumë ata që mendojnë se sfida më e madhe tashmë, përveç infrastrukturës

rrugore në disa zona rurale, janë burimet njerëzore (BNJ). Parë në këtë këndvështrim, kuptohet qartë se sa emergjente është çështja e adresimit me përgjegjësi të lartë të plotësimit të këtyre nevojave jo vetëm ne aspektin afat-shkurtër, por edhe në atë strategjik.

Roli i BNJ-së dhe menaxhimi i saj janë elemente mjaft të rëndësishme në suksesin e një sipërmarrjeje dhe në arritjen e objektivave të saj ekonomikë. Në teorinë e menaxhimit të BNJ-së referohen disa këndvështrime të MBNJ-së:

- Trajtimi racional i BNJ-së (maksimizim i kontrollit dhe ulje e kostos së punës. Fokus në menaxhimin e burimeve. Qasje sasiore).
- Trajtimi human (angazhim më të lartë të të punësuarëve. Fokus në aspektin njerëzor të MBNJ-së. Qasje cilësore).
- Qasja e burimeve bazë (Identifikimi i burimeve kryesore të cilat janë të vlefshme, të rralla, të paimitueshme dhe të pazëvendësueshme si burime të përparësisë konkurruese).
- Korniza AMO (punonjësit performojnë mirë kur kanë A = Aftësi; M = motivim; O = oportunitet).

Këto qasje bëhen akoma më komplekse kur flitet për sektorin e turizmit, sepse ky sektor ka disa specifika që ndikojnë drejtpërdrejt në MBNJ, të cilat janë: Dominimi nga ndërmarrje të vogla dhe të mesme (treg pune i brendshëm i varfër dhe i paqëndrueshëm); Sezonaliteti (punonjës me kualifikim të ulët, status dhe paga të ulëta); Dominimi i grave dhe të rinjve të punësuar (pabarazia gjinore dhe problemet sociale); Aftësitë e të punësuarëve janë të transferueshme në sektorë të tjerë shërbimi; Promovimi i ngadalshëm, orare dhe kushte jonormale pune, stres i lartë; të cilat sjellin një normë të lartë të qarkullimit të punonjësve duke e bërë akoma më sfidues krijimin e një mjedisi pune i cili mbështet zhvillimin dhe mirëqenien e punonjësve.

Mënyra se si një organizatë menaxhon njerëzit e vet mund të ndikojë drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit që këta njerëz i ofrojnë klientit. Kjo do të thotë se përshtatja e duhur e praktikave të MBNJ-së ndikon në performancën organizative dhe mund të çojë në krijimin e avantazhit të qëndrueshëm, konkurrues për biznesin. Pra si konkluzion, mund të themi se për të mbijetuar në këtë epokë të re, bizneset duhet të përqendrohen edhe më shumë në pikat e tyre të forta konkurruese, të cilat lidhen me BNJ-në.

Tendencat e sotme të MBNJ-së në turizmin global

Sipas një studimi nga Gartner, i cili anketoi 800 profesionistë të BNJ-së, të shpërndarë në 60 vende të ndryshme, efektiviteti i lidershipit/menaxhimit dhe menaxhimi organizativ/ndryshimit janë prioritetet dhe sfidat kryesore për drejtuesit e BNJ-së në vitin 2023.

Ndërsa Croissy, M. në artikullin e saj *"The Top 2023 HR Trends for People Managers in Hospitality"* identifikon disa tendenca të BNJ-së me të cilat mund të përballen menaxherët e BNJ- së në sektorin e turizmit dhe mikpritjes.

Vitet e fundit kanë qenë vite të trazuara për ekonominë dhe tregun e punës në përgjithësi përsa i përket situatës financiare të punonjësve, sepse shumica e tyre shprehen se të ardhurat e tyre nga punësimi nuk po ndjekin ritmin e inflacionit. Në të njëjtën situatë ndodhen edhe të punësuarit në industrinë e turizmit dhe në këto kushte ekziston mundësia që ata të kërkojnë mundësi të reja punësimi në sektorë të tjerë, duke u larguar nga sektori i turizmit dhe mikpritjes. Në këtë rast, zgjidhja do të jetë punësimi i punonjësve të rinj, i cili mund të rritë kostot e sipërmarrjes nëpërmjet pagesës së pagave më të larta dhe rritjes së shpenzimeve për rekrutimin e trajnimin e tyre. Gjithashtu, kur punonjësit janë të shqetësuar për financat e tyre, ata e reflektojnë këtë në produktivitetin dhe mirëqenien e tyre të ulët në punë.

Në periudhën e pandemisë u zhvillua mjaft koncepti i punës hibride dhe aktualisht koncepti ipunësimit fleksibël po vazhdon të zgjerohet. Për ta bërë punësimin fleksibël që të funksionojë edhe për sektorin e turizmit, sipërmarrjet duhet të investojnë në teknologji të reja, të cilat u ofrojnë punonjësve mundësi konkrete për të punuar jashtë vendndodhjes tipike të vendit të punës, duke shmangur kufizimin e përdorimit të teknologjisë që ekzistonte në turizëm në

periudhat e mëparshme.

BNJ-ja në turizëm po investon gjithnjë e më shumë edhe në rritjen personale e profesionale të saj. Ky fakt tregon se MBNJ-ja duhet të bëjë më shumë përpjekje për të hartuar plane të rritjes së punonjësve të tyre në karrierë, në përputhje me nevojat dhe aspiratat e tyre specifike. Sigurisht që kjo tendencë do të sjellë edhe rritje të konkurrencës së talenteve duke pasur parasysh mungesën e kompetencave të BNJ-së në sektorin e turizmit dhe preferencat e reja për kënaqësi profesionale. Sfida e radhës për MBNJ-në do të jetë përputhja e talentit me rezultatet e biznesit.

Përdorimi i teknologjisë në turizëm sa po vjen edhe shtohet, duke ndjekur zhvillimin e vrullshëm të saj. Ky përdorim i teknologjisë në procese të ndryshme pune ka efektin e vet në aspektin organizativ e menaxherial të sipërmarrjeve turistike, sepse për arsye të lehtësive që ofron, ka ndryshuar raporti punonjës/klient të shërbyer dhe disa informacione të raportimit me përgjegjësi menaxheriale, tashmë, merren nga teknologjia. Gjithashtu, edhe përgjegjësitë e punonjësve apo kompetencat e tyre janë modifikuar, sepse është përhapur gjerësisht përdorimi i kodeve QR, janë lehtësuar metodat e pagesës me kartë apo aplikacione etj.

Një aspekt tjetër me ndikim në MBNJ është nxitja dhe promovimi i iniciativave të turizmit të qëndrueshëm duke ruajtur mjedisin dhe duke menaxhuar me kujdes burimet e ujit, energjisë etj.Kjo gjë mund të jetë sfiduese për momentin, por është e domosdoshme dhe është mjaft e rëndësishme të kesh BNJ-të në krah. Për këtë nevojiten disa aftësi thelbësore me të cilat mund të trajtohet BNJ-ja në mënyrë që tëndihmojë sipërmarrjen e mjedisin nëpërmjet kursimit të ujit, energjisë, materialeve etj. dhe të përcjellin vizionin e sipërmarrjes te klientët.

Aspekte të MBNJ-së në sipërmarrjet e luginës së Vjosës

Tendencat e zhvillimit të marrëdhënieve të punësimit në turizmin global, sigurisht, që kanë filluar të identifikohen edhe në sektorin e turizmit shqiptar duke iu shtuar problematikave të ndryshme specifike kombëtare dhe rajonale që shoqërojnë këtë sektor.

Përqasja moderne dhe novative ndaj MBNJ-së ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të sipërmarrjeve, duke rritur konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e tyre. Në këtë këndvështrim u zhvillua edhe ky studim në të cilin u përfshinë punonjës dhe pronarë/menaxherë të 15 sipërmarrjeve turistike të cilat operojnë në luginën e Vjosës.

Për realizimin e këtij studimi u përdor një metodologji e kombinuar, e cila konsiston në mbledhjen e të dhënave në terren nëpërmjet anketave dhe intervistave, analizën e tyre dhe nxjerrjen e disa konkluzioneve e rekomandimeve të vlefshme për të gjitha grupet e interesit të përfshira në sektorin e turizmit, siç janë: përfaqësuesit e biznesit, komuniteti, institucionet arsimore e trajnuese, politikëbërësit lokalë e qendror etj. Kjo qasje mundëson një panoramë të plotë të kontekstit lokal dhe ndikimeve të mundshme të MBNJ-së në zhvillimit e turizmit në luginën e Vjosës.

Anketimet u zhvilluan me 40 punonjës të punësuar dhe intervistat gjysmë të strukturuara u realizuan me 15 pronarë/menaxherë, të cilët janë edhe banorë të kësaj zone. Ata u intervistuan për të kuptuar pikëpamjet e tyre mbi turizmin, sfidat aktuale dhe mundësitë e zhvillimit të tij në të ardhmen. Studimi ka disa kufizime sepse ai ka karakteri rajonal, të dhënat e vetëdeklaruara nuk mund të ballafaqoheshin me dokumente formale dhe është i ndikuar nga statusi, kredibiliteti personal, social, arsimor dhe backgroundi professional i të anketuarëve.

Pas përfundimit të procesit të grumbullimit të informacioneve, u zhvillua analiza sasiore dhe cilësore përkatëse e tyre prej së cilës rezultoi se struktura e sipërmarrjeve të përfshira në studimpërbëhej nga bujtina, hotele, restorante tradicionale, kamping, sporte ujore dhe u përfaqësuan nga pronarë-menaxherët ose menaxherët përkatës. Pjesë e studimit ishin edhe të punësuarit në sipërmarrje turistike të rajonit, të cilët u anketuan për mendimin e tyre në lidhje me praktikat e MBNJ-së që aplikohen në sipërmarrjen ku punojnë.

Konkluzione:

Gjetjet kryesore janë të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

Shqetësimet kryesore të të punësuarëve:	**Shqetësimet kryesore të menaxhimit:**
• Pagat relativisht të ulëta në krahasim me orët e zgjatura të punës; • Paqartësi dhe mbingarkesë roli; • Nuk ofrohet trajnim në momentin e marrjes në punë; • Mungon diferencimi i pagave sipas performancës; • Bonuset nuk janë të formalizuara; • Pasiguri për vazhdimësinë e punës për arsye të sezonalitetit; • Komunikimi epror-vartës-koleg jo i nivelit të duhur.	• Largimi i të rinjve nga rajoni Jugor; • Profesionalizëm i ulët, mangësi në komunikim dhe vështirësi me punën në grup; • Mungesë eksperience e trajnimi të punonjësit; • Konkurrenca e pandershme; • Mungesa e bashkëpunimit sipërmarrje - institucione arsimore e trajnuese; • Sezonaliteti; • Infrastruktura e dobët në luginën e Vjosës dhe kufizimet ligjore.

Krahas listimit të shqetësimeve të mësipërme, u zhvillua sigurisht edhe analiza nga pikëpamja e ekspertizës së MBNJ-së për të identifikuar shqetësimet aktuale reale që duhet të preokupojnë lidhur me këto sipermarrje dhe si mund të adresohen ato. Nga vlerësimi i situatës aktuale të sipërmarrjeve turistike që operojnë në luginën e Vjosës, në lidhje me MBNJ-në rezultojnë këto gjetje:

- Ka një perceptim përgjithësisht pozitiv për turizmin dhe një prirje drejt praktikave të zhvillimit te qëndrueshëm;
- Shumica e sipërmarrjeve turistike janë familjare dhe kjo krijon pamundësi financiare për trajnim formal;
- Sezonaliteti imponon zgjidhje afatshkurtra për punonjës;
- Mungon bashkëpunimi sipërmarrje - institucione arsimore e trajnuese për të ngritur kapacitetet e BNJ-së;
- Pronarë-menaxherët kanë ekspertizë të pakët në menaxhimin e BNJ-së (rekrutim, trajnim, vlerësim performancë, motivim)
- Pronarë-menaxherët shpesh herë nuk njohin standardet e shërbimit;
- Punonjësit në shumicën e rasteve janë të pacertifikuar (kuzhinier, kamarier, recepsionist etj.);
- Punët janë të pakategorizuara dhe kjo krijon vështirësi në procesin e rekrutimit të punonjësve të rinj.

Rekomandime:

Duke u bazuar në këto gjetje dhe në njohuritë që ofron literatura, ky studim ofron disa rekomandime të cilat janë të vlefshme si për menaxherët e sipërmarrjeve turistike, ashtu edhe për politikëbërësit dhe mund të shërbejnë si orientim për zhvillimin e strategjive të MBNJ-së të cilat jo vetëm që do të përmirësojnë performancën e sipërmarrjes, por, gjithashtu, do të kontribuojnë në mirëqenien e përgjithshme ekonomike dhe sociale të rajonit.

1. Të adresohen problematikat e sezonalitetit të turizmit duke:

- Ofruar trajnime dhe certifikime të punonjësve jashtë sezonit;
- Nëpërmjet pagesës së papunësisë së punonjësve midis dy sezoneve;

- Nëpërmjet subvencionimit për punëdhënësit e turizmit midis dy sezoneve.

2. BNJ-ja dhe Menaxhimi të përfshihen në trajnime për të përmirësuar kompetencat në:

- Komunikim, teknologji dhe gjuhët e huaja për t'iu ofruar shërbim cilësor turistëve;
- Praktikat ekologjike dhe të gjelbra për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve dhe rujatjen e mjedisit;
- Njohjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore e natyrore në mënyrë që të kthehen në një burim të ardhurash përmes turizmit;
- Njohuritë mbi marketingun dhe menaxhimin e biznesit;
- Praktikat e MBNJ-së, duke i ndihmuar për kategorizimin e punëve dhe plotësimin e nevojave me BNJ-në e duhur.

3. Të nxitet bashkëpunimi sipërmarrje - institucione arsimore e trajnuese si mundësi reale për plotësimin e nevojave të sipërmarrjeve lidhur me BNJ-në dhe uljen e papunësisë.

4. Inkurajimi i nismave turistike të bazuara në komunitet që do të thotë përfshirja e banorëve vendas në aktivitete ekonomike të cilat lidhen me turizmin, duke e konsideruar vetëpunësimin si një teknikë për të shmangur largimet e banorëve nga rajoni, për të rritur punësimin dhe përmirësuar ndarjen e përfitimeve.

Literatura:

Baum, T., Kralj, A., Robinson, R.N.S., Solnet, D.J., (2016) "Tourism workforce research: A review, taxonomy and agenda", Annals of Tourism Research 60

Boella, M.J., Goss-Turner, S., (2013), "Human Resource Management in the Hospitality Industry"

Croissy, M. (2023)"The Top 2023 HR Trends for People Managers in Hospitality"

Gartner Survey Reveals Leader and Manager Effectiveness Tops HR Leaders' List of Priorities for 2023

Guga, E., Qiqi, D. (2024) "Sustainable Economic Development through Alternative Tourism in the Vjosa Valley, Albania", WSEAS Transactions on Business and Economics.

Qiqi, D., Guga, E. (2024) ""Sustainable Tourism Strategies along the Vjosa River in Albania", International Journal of Migration Studies.

THE IMPORTANCE OF THE LOCAL COMMUNITY INVOLVEMENT IN THE DEVELOPMENT OF SUSTAINABLE TOURISM IN THE VJOSA BASIN

[1]Assoc. Prof. Dr. Irena Boboli, [2]Asoc. Prof. Dr. Manjola Sulaj, [3]MSc. Florjana Pango, [4]Assoc. Prof. Dr. Drita Luzo

[1]Department of Economic Policies and Tourism, Faculty of Economics ,"Eqrem Çabej" University of Gjirokastër, Albania, iboboli@uogj.edu.al

[2,3]Department of Foreign Languages, Faculty of Education and Social Sciences, "Eqrem Çabej" University of Gjirokastër, Albania, msulaj@uogj.edu.al, fpango@uogj.edu.al

[4]Department of Public Administration, Faculty of Economics , "Eqrem Çabej" University of Gjirokastër, Albania,dluzo@uogj.edu.al

Abstract

In Albania, the tourism sector has become one of the four most important sectors of the economic development sector, especially during the last years when attention in the international arena has increased. When nearly every statistic in the tourism components shows an increase, the economic and social impact has begun to be seen. All governing structures, taking advantage of the opportunities and natural resources of the country, have set up planned strategies to turn this sector into a coveted industry for investment and a practical way to promote it in the global sphere. Since 2023, Vjosa has been a unique National Park for Albania and Europe which places our country in another category of the European tourist map and opens another new path for sustainable economic and social development.

Since they are the primary stakeholders in the growth of tourism as well as the primary recipients of the costs and benefits related to it, local communities play a crucial role in its development. The role of local communities is basic in sustainable tourism development, as these communities have the knowledge and opportunity to have a key role in the management and promotion of destinations. This paper focuses on the role and importance of the local community in the growth of sustainable tourism in the Vjosa basin.

Keywords: *Local Community, Sustainable Tourism Development, Vjosa Basin*

Introduction

As one of the industries contributing the most to Albania's GDP in recent years, tourism has drawn more attention and importance from governing bodies and all interest groups for investments in this area. Albania has a strategic geographical position, which offers capacities to meet the ever-increasing expectations for a sustainable tourism market oriented by nature and culture. According to the National Strategy for the Development of Sustainable Tourism 2019-2023 compiled by the Ministry of Tourism and Environment, "Albania, a welcoming, attractive and authentic tourist destination, for sustainable development of the economic, natural and social potential of the country."

According to this perspective, Albania presents excellent prospects in this area, and as a result, tourism has a significant influence on both the social and economic spheres. Specifically, according to the Economic Impact Report of Travel and Tourism 2023, of the World Travel and Tourism Council (WTTC), during the year 2022, the tourism sector registered a direct contribution of $3.9 billion, constituting about 21.6% of the Gross Domestic Product (GDP) while in 2019 it accounted for 20.3% of GDP (WTTC 2023).

Since 2011, all governing bodies have established plans to turn this industry into a sought-after investment area and to effectively market it internationally, leveraging the nation's natural resources and potential. With the increase in foreign visitors, the goal of quality and elite investments has been increasing significantly. Specifically, according to INSTAT (2024), a

record number of 10,155 million foreign tourists visited Albania in 2023, with an increase of 34.6% compared to 2022.

A closer look reveals that the growth of tourism has other social, demographic, and other repercussions in addition to its economic influence. In particular, investments in tourism raise the likelihood that a sizable portion of the populace will find work. However, the growth of tourism decentralizes the economy, allowing for the development of certain regions, not just metropolitan ones, but also rural ones, even if they are seasonal.

Vjosa has been a unique national park for Albania and Europe since 2023, which elevates our nation to a new level on the European tourism map and creates new opportunities for sustainable social and economic growth.

Designating the Natural Park under IUCN category II signifies its safeguarding in compliance with the most rigorous global conservation standards. The Vjosa Wild River National Park is part of a larger network of Protected Areas within the extended Vjosa River basin offers the potential for establishing a shared network of Protected Areas, offering chances for promoting local development through sustainable tourism initiatives (Espid 2024).

Sustainable tourism and local community

Development is a complex process and continues to develop over time. In the 1980s, the world witnessed a development paradigm that focused on equitable economic growth and equality. This paradigm emphasizes the importance of the economy as the center of development to achieve prosperity for the entire community (Kurniawan *et al*, 2023). According to the UNWTO definition, sustainable tourism is “Tourism that takes full account of its current and future economic, social and environmental impacts, addressing the needs of visitors, the industry, the environment, and host communities”. [1]. The phrases "sustainable development," "sustainable tourism," and "sustainability" are all well-established and frequently used interchangeably and loosely in tourism literature (Liu, 2003). Local communities play a significant part in the process of sustainable development. Since the 1990s, tourism has become more and more significant to sustainable development on a global and national level. The increase in tourism is increasingly seen as a key instrument for boosting economic expansion, reducing poverty, and enhancing food security (Richardson, 2021). Tourism can be used to leverage unique resources for economic growth in communities with a rich cultural heritage and history but little material success (Honey & Gilpin, 2009).

According to Pitana (2002), cited in (Bagus *et al*, 2019) states that in sustainable tourism is not enough just to be ecologically sustainable and the sustainability of economic development, but no less important is the sustainability of culture because culture is one of the most important resources in tourism development. Communities in tourism destinations also play a part in initiatives to promote tourism destination products, because local communities are the main component in forming tourism images. The importance of local community participation in the growth of sustainable tourism destinations has encouraged the development of other options for tourism development. Community-based tourism (CBT) is the term used to describe the alternative (Bagus et al., 2019). In the middle of the 1990s, the phrase "community-based tourism" (CBT) first appeared. CBT is a tool for community development that helps communities take charge of tourism management and development and provides benefits to the communities that result from tourism activities. It has served as an alternative to traditional mass tourism in developing nations (Trejos & Chiang, 2009). In developing countries, CBT is a bottom-up strategy for sustainable development that promotes natural resource protection, maintains traditional culture, and creates local revenue (Yamashita, 2011).Essentially, the participation of the local community is important in this industry as it ensures that tourists get a memorable, unforgettable visiting experience while also allowing the community to reap

[1]UNWTO, Sustainable Development, (UNWTO), https://www.unwto.org/sustainable-development

benefits from their visits at the same time. Residents offer helpful supporting data in decision-making processes due to their local knowledge; therefore, tourism planning and development must utilize resident's potential and encourage local involvement. Opportunities to access markets and grow businesses in communities can be created, thus offering job opportunities and poverty reduction in rural areas (Lo & Janta, 2020).

CBT has a social impact because it directly fosters communication between residents and visitors, an economic impact because it helps diversify economic activities, generates income, and creates job opportunities; and an environmental impact because it promotes biodiversity protection (Ishihara, 2020). Tourism shows significant potential as a catalyst for sustainable development, providing economic, social, and environmental advantages to rural areas. Community involvement and adherence to sustainable tourism principles to achieve this potential requires careful planning (Tola et al, 2024).

The 2030 Agenda for Sustainable Development aims to change the world by balancing the economic, social, and environmental facets of sustainable growth. Involving local communities in promoting a healthy lifestyle is vital if we are to meet the challenges presented by these aims and guarantee that no one is left behind. Community-based learning supports sustainable development and active citizenship by enabling individuals to take practical, direct action to address the issues of a rapidly changing and increasingly linked world. Additionally, it assists people in acquiring new information and abilities to enhance their lives sustainably by addressing social and economic inequality or practicing eco-friendly farming[2].

Study area-Vjosa basin

In March 2023, by decision of the Albanian government, Vjosa, the last wild river in Europe was declared a "National Park" with a protection area of 12,727 ha.3 The vision for Vjosa-Aoös is simple: The Vjosa-Aoös River, from its source to its discharge into the sea, including all tributaries, is given full national and transboundary protection, according to the highest international standards, and effectively conserved as a living, wild, free-flowing river, for the benefit of people and nature in Albania, Greece and the world (MTE, 2022).

The network of Protected Areas within the Vjosa River Basin includes Bredhi i Hotovës-Dangëlli National Park, Bredhi i Kardhiqit-Rrëzomë Nature Park, Pishë Poro-Nartë Protected Landscape, Karaburun-Sazan Marine National Park, National Park Llogara, Butrint National Park, Bredhi i Zhulatit Nature Park, Syri i Kaltër Nature Park, Bredhi i Sotirës Nature Park, Zagori Nature Park, Porto Palermo Nature Park (Espid 2024).

The Vjosa River Basin consists of a giant mosaic of different habitat types. The Vjosa River and its free-flowing tributaries form an ecosystem with considerable biodiversity of national and global importance. The primary intact natural processes and the largely peaceful local population settlements are responsible for the valley's remarkable picturesque values. Along with additional economic advantages for the local population, ecological and cultural elements present excellent prospects for ecotourism and sustainable tourism. The surrounding watershed provides the villages with fertile land for agricultural activities, such as crop production and livestock breeding. This wild river landscape is a fascinating, attractive, and complex world (MTE, 2022).

The utilization of natural resources for tourism purposes is experiencing rapid development in the Vjosa Valley. Currently, the most common types of ecotourism practiced in the valley are: rafting, hiking, canoeing, mountaineering, thermal tourism, bird watching, etc (Espid, 2024).

[2]UIL Policy Brief 8, Community-based learning for Sustainable Tourism, https://www.local2030.org/library/321/Community-based-learning-for-sustainable-development.pdf

[3]Ministry of Tourism and Environment,, https://turizmi.gov.al/vendimet-e-qeverise-kumbaro-lumi-vjosa-shpallet-park-kombetar/

With a plethora of natural and cultural features, the Vjosa basin and its environs are a popular tourist destination conveniently accessible to European travel markets. One of the region's primary revenue streams is tourism, and its rise will play a role in socioeconomic development (Ktona et al., 2022). Additionally, visitor spending is essential to the growth of the economy (Boboli & Muça, 2021).

The region is also known for its rich cultural heritage. Its museums, archaeological sites, and historical and cultural artifacts and monuments provide a wealth of opportunities for the expansion of historical and cultural tourism in the region. In order to promote cultural heritage, traditional and regional cuisine is essential (Muça et al., 2022).

The area is in a favorable geographic location, and the agricultural space is the main element of its agrarian ecology, directly influencing its dynamics. According to Bololi et al. (2023), this agricultural area is depicted as a complex of human and environmental elements and processes that are always interacting and changing. In the past, the main source of income for the people living in the Vjosa basin has been the natural riches found there. Both tradition and the amount of technology investment have a significant impact on how these resources are used (Espid 2024).

With the growth of alternative tourism types like cultural, mountain, adventure, religious, historical, educational, and festival tourism, among others, tourism initiatives have expanded. However, the agrotourism industry is growing steadily because the Albanian government is providing significant support for it.

The financial burden for investors has been lessened by one of the programs to promote investment in the tourist industry, particularly for elite travel, and to enhance the industry's reputation abroad. In addition, the modifications to law no. 93/2015 "On tourism" is intended to address the new dynamics of this industry's growth as well as the private sector, which strives for the year-round, sustainable growth of tourism across the nation, providing alternative options through the growth of natural and cultural tourism in addition to that of the sun and the sea (ATSH, 2024).

The National Strategy for the Development of Agrotourism has as its primary goal the establishment of 1000 agrotourism units by 2030. It has two priorities: increasing the availability of certified agrotourism and protecting human and local capital via sustainable development. The national agrotourism plan aims to boost youth involvement and the number of female entrepreneurs (ATSH, 2024).

Discussions

Local people should be included in the growth of tourism in protected areas since they are the ones who know the most about the ecological and cultural potential of these locations. Furthermore, by drawing on years of experience, they may safeguard and promote certain natural and cultural values for tourism (Michniewicz-Ankiersztajn et al, 2018). In this paper, we make the case that the Vjosa basin offers the potential to enhance its tourism offerings and transform them into an integrated tourism product that will directly improve the standard of living for the local population, where environmental preservation and sustainable tourism development have been given top priority.There are still shortcomings in identifying the natural potentials and making them available for sustainable tourism, despite the rise in demand for ecotourism and agrotourism-classified travel activities. These include a lack of promotion of ecotourism, community environmental education, rural exodus and abandonment, globalization of local products and culture, and a low level of local cooperation (Espid, 2024).

According to the above data, there is a growing tendency among the local community to get involved in the growth of tourism in the area. They are now more conscious of the advantages that the tourism industry offers. However, the host community often includes government representatives and business owners alongside locals. A tourism site should be aware of its current resources to draw visitors to grow and thrive in the new and modern environment, claim

Hunger and Wheelen (2004). To provide a comprehensive service for drawing tourists, it must determine the tourism capabilities, rank them, and organize them.

Various authors are approaching the idea of smart tourism from a wider perspective, incorporating not only the technological aspect of the notion but also the institutional and human aspects. This perspective holds that smart tourism will use technology to improve marketing, service quality, and cooperation between all parties involved in the tourism industry, ultimately aiming to improve the well-being of the local community and encourage sustainable destination development (Muça et al, 2022). Communities, local governments, and destination management organizations benefit from the development and management of resources.

Bibliography

Bagus, I. S., Made, S. U., Nyoman, S. I., & Putu, W. S. (October 2019). Community based tourism as sustainable tourism support. Rjoas, 10(94) , 70-78.

Honey, M., & Gilpin, R. (2009). Tourism in the Developing World, Promoting Peace and Reducing Poverty. Washington: United States Institute of Peace.

Liu, Z. (2003). Sustainable Tourism Development: A Critique. Journal of Sustainable Tourism , 11 (6), 459-475.

Richardson, R. B. (2021). The Role of Tourism in Sustainable Development. Environmental Science .

Trejos, B., & Chiang, L.-H. N. (2009). Local economic linkages to community-based tourism in rural Costa Rica. Singapore Journal of Tropical Geography 30, doi:10.1111/j.1467-9493.2009.00375.x , 373-387.

Yamashita, S. (2011). Community-Based Associations for Sustainable Tourism Development - Fostering Sustainable Development in Developing Countries. Uppsala University, INSTITUTIONEN FÖR GEOVETENSKAPER.

Ministry of Tourism and Environment (2022), Parku Kombëtar i Lumit të Egër Vjosa, Vizioni, Udhërrëfyesi dhe Studimi i Fizibilitetit Dhjetor 2022

National Strategy for the Development of Sustainable Tourism 2019-2023

Espid Vjosa 4, (2024), Vjosa Basin Sustainability: A Comprehensive Water Resource Management Guide. Implemented by Euronature, EcoAlbania

Boboli, I., & Muça, E. (2021). Exploring Tourist Expenditures Of The Gjirokastra District In Albania: A Cluster Analysis. *Acta Scientiarum Polonorum - Oeconomia, 20* (2), 13-20.

Boboli, I., Thoma, L., & Mano, R. (2023). Who is Paying More for Organic Food? - Evidence from a Developing Country Considering Socio-Demographic Characteristics of Consumers. *WSEAS Transactions on Business and Economics, 20*, 1167-1177.

Hunger, D., &Wheelen, T. (2004). Εισαγωγή στ οστρατηγικό μάνατζμεντ . Αθήνα: Κλειδάριθμος.

Ishihara, Y. (2020). Overview of community-based tourism from: The Routledge Handbook of Community-Based Tourism Management, Concepts, Issues & Implications

Ktona, A., Muça, E., Çollaku, D., Shahini, I., & Boboli, I. (2022). Support the creation of appropriate tourism offers by finding a model, using machine learning algorithms, to forecast spending by tourists. *Int. J. Technology Marketing, 17* (1), 30-47.

Kurniawan, H., Yulianto, Setiawan, R., Mladenov, S. V., & Ardiansyah, M. (Vol. 41 No. 2 November 2023,). Sustainable Development Through Community Empowerment Based On Local Wisdom . International Journal of Progressive Sciences and Technologies (IJPSAT) , pp. 164-176.

Tola, A., Minga, A., Muça Dashi, E. (2024), Edelweiss Applied Science and Technology Rural tourism: Nurturing prosperity and community resilience.

https://www.researchgate.net/publication/380734100_Edelweiss_Applied_Science_and_Technology_Rural_tourism_Nurturing_prosperity_and_community_resilience [accessed Sep 14 2024].

Lo, Y.-C., & Janta, P. (2020). Resident's Perspective on Developing Community-Based Tourism – A Qualitative Study of Muen Ngoen Kong Community, Chiang Mai, Thailand. *Frontier in Psychology. 11:1493* , doi: 10.3389/fpsyg.2020.01493.

Michniewicz-Ankiersztajn, H., Gonia, A., & Dłużewska, A. (2018). The Role Of Local Communities In Sustainable Tourism Development – Noteć River Valley Case Study. *EPT 4/2018 (44) | ISSN: 1644-0501 | www.wnus.edu.pl/ept | DOI: 10.18276/ept.2018.4.44-15 | 181–191* , 181-191.

Muça, E., Boboli, I., Kapaj, I., & Kapaj Mane, A. (2022). Smart Technology Effecting Tourism Development in Albania. *Journal of Environmental Management and Tourism, 13* (8), 2113.

UNWTO. (n.d.). *https://www.unwto.org/sustainable-development*. Retrieved from Sustainable Development.

UNWTO, Sustainable Development, (UNWTO) ttps://www.unwto.org/sustainable-development,

UIL Policy Brief 8, Community-based learning for Sustainable Tourism, https://www.local2030.org/library/321/Community-based-learning-for-sustainable-development.pdf

Ministry of Tourism and Environment,, https://turizmi.gov.al/vendimet-e-qeverise-kumbaro-lumi-vjosa-shpallet-park-kombetar/

Instituti i Statistikave, INSTAT (2024), Statistikat e Turizmit, Në linjë: https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/statistikat-e-turizmit/#tab2

WTTC, *Albania 2020 annual research*, (2023). Në linjë: https://researchhub.wttc.org/factsheets/albania

NDIKIMI I TREGUESVE GJEOGRAFIKË DHE SPECIALITETEVE TRADICIONALE TË GARANTUARA NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË LUGINËS SË VJOSËS

[1]Dr. Eduina Guga, [2] Dr. Bitila Zhuli
[1]Deparment of Accounting and Finance, Faculty of Economics, "Eqrem Çabej" University, Shqipëri, eguga@uogj.edu.al [2]Department of Public Administration, "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,bitilazhuli@gmail.com

Përmbledhje

Ky studim heton rolin dhe ndikimin e Treguesve gjeografikë dhe Specialiteteve Tradicionale të Garantuara në zhvillimin ekonomik të luginës së Vjosës, një rajon i pasur me biodiversitet dhe tradita kulturore në Shqipëri. Duke u mbështetur në një qasje hulumtimi të përzier, studimi synon të analizojë kontributin ekonomik të këtyre produkteve, sfidat që ata përballen në tregun lokal dhe ndërkombëtar dhe të identifikojë strategjitë efektive për promovimin dhe zgjerimin e tregut të tyre. Përmes analizës së të dhënave të mbledhura nga intervistat me prodhuesit lokalë, anketat me konsumatorët dhe studimet e rastit nga rajone të tjera me sukses të ngjashëm, studimi zbulon se regjistrimi i specialiteteve tradicionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale ka një ndikim pozitiv të konsiderueshëm në rritjen e të ardhurave, zgjerimin e tregjeve dhe promovimin e turizmit.Rezultatet tregojnë se specialitetet tradicionale të garantuara ofrojnë një mundësi unike për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, duke nxitur konkurrencën e drejtë, mbrojtjen e diversitetit biokulturor dhe ruajtjen e njohurive tradicionale. Sfidat kryesore përfshijnë nevojën për më shumë mbështetje institucionale, investime në marketing dhe edukimin e konsumatorëve mbi vlerat e produkteve të certifikuara. Studimi propozon rekomandime strategjike për të adresuar këto sfida, duke përfshirë zhvillimin e politikave mbështetëse, nxitjen e bashkëpunimeve ndërmjet prodhuesve dhe aktorëve të tjerë të tregut, dhe përdorimin e teknologjive digjitale për të arritur tregje më të gjera.Në përfundim, ky studim ofron një kontribut të rëndësishëm në literaturën mbi zhvillimin rural dhe ekonomik, duke theksuar potencialin e specialiteteve tradicionale të garantuara si një motor për rritjen ekonomike në rajonet rurale. Gjetjet mund të shërbejnë si një udhërrëfyes për politikëbërësit, komunitetin e biznesit dhe organizatat joqeveritare që synojnë të nxisin zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm përmes promovimit të trashëgimisë kulturore dhe biodiversitetit.

Fjalë Kyçe: *zhvillim ekonomik, lugina e Vjosës, biodiversitet, turizëm, mbrojtja e pronësisë intelektuale, strategji të marketingut.*

Abstract

This research explores the function and influence of Geographical Indicators and Guaranteed Traditional Specialties on the economic growth of Albania's Vjosa Valley, a region rich in cultural traditions and biodiversity. The study intends to examine the economic impact of these items, the difficulties they encounter in domestic and foreign markets, and the best ways to market and promote them using a mixed research approach. The registration of traditional specialties with the General Directorate of Industrial Property has a significant positive impact on income growth, market expansion, and tourism promotion, according to the study's analysis of data gathered from consumer surveys, local producer interviews, and case studies from other regions with comparable success.The results show that guaranteed traditional specialties offer a unique opportunity for sustainable economic development by fostering fair competition, protecting biocultural diversity, and preserving traditional knowledge. The main challenges include the need for more institutional support, investment in marketing, and consumer

education on the value of certified products. The study proposes strategic recommendations to address these challenges, including the development of supportive policies, encouraging collaborations between producers and other market actors, and the use of digital technologies to reach wider markets.In conclusion, this study makes a significant contribution to the literature on rural and economic development by highlighting the potential of guaranteed traditional specialties as a driver for economic growth in rural areas. The findings can serve as a guide for policymakers, the business community, and non-governmental organizations aiming to promote sustainable economic development through the promotion of cultural heritage and biodiversity.

Keywords: *Economic Development, Vjosa Valley, Biodiversity, Tourism, Intellectual Property Protection, Marketing Strategy.*

Hyrje

Treguesit gjeografikë dhe specialitetet tradicionale të garantuara (STG) përfaqësojnë një koncept të rëndësishëm në zhvillimin rural dhe ekonomik, duke ndërthurur elementet e trashëgimisë kulturore, biodiversitetit dhe potencialit ekonomik të zonave të veçanta. Në thelb, këto produkte mbartin një lidhje të fortë mes origjinës së tyre gjeografike dhe cilësive të veçanta që i bëjnë të dallueshme, duke krijuar një identitet unik që i diferencon në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Përmes mbrojtjes ligjore dhe certifikimit si STG, këto produkte fitojnë jo vetëm një vlerë të shtuar në treg, por, gjithashtu, kontribuojnë në ruajtjen e traditave lokale, promovimin e turizmit dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në kontekstin e luginës së Vjosës, një rajon i njohur për pasurinë e tij natyrore dhe kulturore, rëndësia e treguesve gjeografikë dhe STG-së merr një dimension të veçantë. Kjo zonë, me biodiversitetin e saj të pasur dhe trashëgiminë e pasur historike, ofron kushte ideale për zhvillimin e produkteve autentike që përfaqësojnë traditat dhe mënyrat unike të prodhimit. Përmes identifikimit dhe promovimit të këtyre produkteve, lugina e Vjosës mund të pozicionohet si një model për zhvillimin rural në Shqipëri dhe më gjerë, duke ndikuar në përmirësimin e të ardhurave të komuniteteve lokale dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Një aspekt i rëndësishëm i këtij procesi është roli i STG-së si një mekanizëm për mbrojtjen e diversitetit biokulturor. Këto produkte ndihmojnë në ruajtjen e njohurive tradicionale dhe teknikave të prodhimit që janë transmetuar brez pas brezi. Për më tepër, duke përfituar nga mbështetja institucionale dhe promovimi në tregje më të gjera, STG-ja ofron një mënyrë efektive për të nxitur konkurrencën e drejtë dhe për të siguruar që përfitimet ekonomike të shpërndahen në mënyrë të drejtë ndërmjet prodhuesve lokalë.

Ky studim synon të hedhë dritë mbi ndikimin e treguesve gjeografikë dhe specialiteteve tradicionale të garantuara në zhvillimin ekonomik të luginës së Vjosës, duke analizuar mënyrat se si këto produkte mund të kthehen në një motor për rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit. Rezultatet e tij ofrojnë një bazë të vlefshme për hartimin e politikave mbështetëse dhe strategjive të marketingut, duke kontribuar kështu në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe fuqizimin ekonomik të komuniteteve rurale.

Qëllimi i studimit

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë dhe të identifikojë ndikimin e treguesve gjeografikë dhe specialiteteve tradicionale të garantuara (STG) në zhvillimin ekonomik të luginës së Vjosës. Ky rajon i pasur me burime natyrore dhe tradita të thelluara kulturore përfaqëson një laborator ideal për të kuptuar se si mbrojtja dhe promovimi i produkteve autentike ndikon në përmirësimin e mirëqenies së komuniteteve rurale dhe në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike.

Në një botë gjithnjë e më shumë të globalizuar, ku konkurrenca e produkteve është tepër e ashpër, STG-ja paraqitet si një mjet i fuqishëm për të dalluar produktet lokale dhe për të rritur

vlerën e tyre në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky studim përpiqet të kuptojë mekanizmat përmes të cilëve këto produkte përforcojnë ekonominë lokale, duke ofruar një rrugë për zhvillim që bazohet në potencialet unike të rajonit dhe në ruajtjen e burimeve natyrore e kulturore.

Për më tepër, studimi ka për qëllim të hulumtojë sfidat me të cilat përballen prodhuesit dhe komunitetet lokale në procesin e regjistrimit, certifikimit dhe promovimit të produkteve si STG. Këtu përfshihet analizimi i faktorëve të tillë si: mungesa e mbështetjes institucionale; vështirësitë në marketing; ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm i konsumatorëve për vlerat e produkteve të certifikuara. Në këtë kontekst, synimi është të identifikohen strategji të qëndrueshme që jo vetëm përballojnë këto sfida, por, gjithashtu, krijojnë mundësi të reja për zhvillim ekonomik dhe social.

Përfundimisht, studimi synon të ofrojë rekomandime praktike për politikëbërësit, bizneset lokale dhe organizatat që operojnë në rajonin e luginës së Vjosës. Duke u bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të të dhënave dhe praktikave më të mira, këto rekomandime do të ndihmojnë në formulimin e politikave që mbështetin promovimin e trashëgimisë kulturore, zhvillimin rural dhe fuqizimin ekonomik të komuniteteve lokale. Përmes këtij qasimi, studimi kontribuon në krijimin e një modeli zhvillimi që është i qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe i bazuar në potencialet unike të rajonit.

Pyetjet kërkimore

Ky studim është ndërtuar mbi një seri pyetjesh kërkimore që synojnë të eksplorojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse rolin dhe ndikimin e treguesve gjeografikë dhe specialiteteve tradicionale të garantuara (STG) në zhvillimin ekonomik të luginës së Vjosës. Këto pyetje përbëjnë shtyllën kryesore të hulumtimit dhe ndihmojnë në strukturimin e analizës së të dhënave dhe interpretimin e gjetjeve.

P.K.1: Si ndikojnë STG-të në të ardhurat e prodhuesve lokalë?

E para nga pyetjet kërkimore fokusohet në identifikimin e ndikimit të STG-së në të ardhurat e prodhuesve lokalë. Qëllimi është të vlerësohet se si regjistrimi dhe promovimi i këtyre produkteve ndikon në përmirësimin e mirëqenies financiare të komuniteteve rurale. Studimi përpiqet të kuptojë nëse dhe në çfarë mase STG-ja kontribuon në krijimin e vendeve të punës, diversifikimin e aktiviteteve ekonomike dhe rritjen e përfitimeve financiare për prodhuesit individualë dhe kooperativat lokale.

P.K.2: Cilat janë sfidat kryesore për treguesit gjeografikë dhe STG-në në rajonin e luginës së Vjosës?

Pyetja e dytë adreson sfidat kryesore me të cilat përballen treguesit gjeografikë dhe STG-ja në rajonin e luginës së Vjosës. Kjo përfshin analizimin e faktorëve institucionalë, ekonomikë dhe kulturorë që pengojnë zhvillimin e këtyre produkteve. Sfidat si mungesa e infrastrukturës së duhur, mbështetjes institucionale dhe strategjive efektive të marketingut janë ndër çështjet që kërkojnë një vëmendje të veçantë. Gjithashtu, studimi shqyrton rolin e ndërgjegjësimit të konsumatorëve dhe ndikimin e tij në zhvillimin e tregut për këto produkte.

P.K.3: Si mund të përmirësohet promovimi dhe shfrytëzimi i këtyre produkteve për qëllime ekonomike dhe turistike?

Pyetja e tretë kërkimore fokusohet në identifikimin e mënyrave për të përmirësuar promovimin dhe shfrytëzimin e STG-së për qëllime ekonomike dhe turistike. Synimi është të eksplorohen strategji efektive që mund të ndihmojnë në rritjen e dukshmërisë së këtyre produkteve, si në tregun kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar. Në këtë kontekst, studimi vlerëson rolin e teknologjive digjitale, bashkëpunimeve ndërsektoriale dhe iniciativave të tjera inovative në promovimin e produkteve të certifikuara. Gjithashtu, hulumtimi shqyrton se si STG-ja mund të integrohet në strategjitë e zhvillimit të turizmit për të tërhequr vizitorë dhe për të rritur përfitimet ekonomike për komunitetet lokale.

Rëndësia e studimit

Ky studim përfaqëson një kontribut të rëndësishëm për një gamë të gjerë aktorësh, përfshirë politikëbërësit, komunitetet rurale dhe institucionet akademike, duke ndikuar pozitivisht në tri fusha kryesore: politikëbërjen, zhvillimin rural dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Në aspektin e politikëbërjes, studimi ofron një bazë empirike që mund të ndihmojë në formulimin e politikave mbështetëse për promovimin dhe zhvillimin e treguesve gjeografikë dhe specialiteteve tradicionale të garantuara (STG). Duke ofruar të dhëna mbi ndikimin ekonomik dhe social të këtyre produkteve, studimi nxit hartimin e politikave që përfshijnë mbështetje financiare për prodhuesit lokalë, krijimin e lehtësive për regjistrimin e produkteve dhe zhvillimin e infrastrukturës së marketingut. Rekomandimet praktike që rezultojnë nga ky hulumtim synojnë të ndihmojnë institucionet qeveritare dhe organizatat ndërkombëtare në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Në kontekstin e zhvillimit rural, studimi hedh dritë mbi mënyrat se si STG-ja mund të transformojë ekonomitë lokale, duke përmirësuar të ardhurat e komuniteteve dhe duke krijuar mundësi të reja për punësim. Në rajone si lugina e Vjosës ku shumë komunitete mbështeten në bujqësi dhe prodhime tradicionale, identifikimi dhe promovimi i produkteve autentike përbëjnë një rrugë drejt diversifikimit ekonomik. Për më tepër, duke integruar këto produkte në sektorin e turizmit, rajoni mund të tërheqë vizitorë të interesuar për eksperienca autentike, duke rritur ndjeshëm përfitimet ekonomike.

Ruajtja e trashëgimisë kulturore përbën një dimension tjetër të rëndësishëm të këtij studimi. Treguesit gjeografikë dhe STG-ja mbartin një vlerë të veçantë për shkak të lidhjes së tyre të fortë me traditat dhe mënyrat e jetesës të trashëguara brez pas brezi. Përmes identifikimit dhe certifikimit të këtyre produkteve, studimi ndihmon në ruajtjen e njohurive tradicionale, praktikave artizanale dhe mënyrave të qëndrueshme të prodhimit, të cilat janë nën kërcënimin e zhdukjes për shkak të modernizimit dhe globalizimit.

Përveç këtyre ndikimeve, rëndësia e këtij studimi qëndron edhe në ndërtimin e një urë lidhëse midis komuniteteve lokale dhe tregjeve ndërkombëtare. Përmes eksplorimit të strategjive të reja për promovim dhe rritje të ndërgjegjësimit, ai krijon një model që mund të përshtatet dhe të zbatohet edhe në rajone të tjera rurale në Shqipëri dhe më gjerë. Në këtë mënyrë, studimi kontribuon jo vetëm në pasurimin e literaturës shkencore, por edhe në ndërtimin e politikave dhe praktikave që mbështetin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Rishikim i literaturës

Treguesit gjeografikë dhe specialitetet tradicionale të garantuara në një kontekst global

Treguesit gjeografikë dhe specialitetet tradicionale të garantuara (STG) përfaqësojnë një mekanizëm të fuqishëm për mbrojtjen dhe promovimin e produkteve që lidhen ngushtë me një zonë gjeografike specifike. Sipas Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), treguesit gjeografikë identifikojnë një produkt si të origjinës nga një rajon specifik, ku cilësitë, reputacioni ose karakteristikat e tij janë të lidhura ngushtë me atë zonë. Ky koncept është zbatuar me sukses në vende si Franca, Italia dhe Spanja, ku produkte si vera "Champagne", djathi "Parmigiano Reggiano" dhe vaji i ullirit "Arbequina" kanë fituar njohje globale përmes certifikimit.

Modelet ndërkombëtare tregojnë se certifikimi i STG-së jo vetëm që rrit vlerën e tregut për produktet lokale, por gjithashtu nxit zhvillimin e qëndrueshëm rural. Për shembull, në Bashkimin Evropian, sistemi i mbrojtjes së produkteve me tregues gjeografikë dhe STG ka gjeneruar miliarda euro në të ardhura, duke përmirësuar mirëqenien e prodhuesve lokalë dhe duke promovuar ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Modele të ngjashme janë zbatuar me sukses në vende si India ku regjistrimi i çajit "Darjeeling" ka ndihmuar në ruajtjen e cilësisë së

produktit dhe në mbrojtjen e prodhuesve nga konkurrenca e padrejtë.

Ndikimi ekonomik dhe social i STG-së

Studime të ndryshme kanë theksuar se ndikimi i STG-së shtrihet përtej përfitimeve ekonomike. Për shembull, një analizë e rajonit Emilia-Romagna në Itali tregon se certifikimi i produkteve tradicionale si proshuta "Prosciutto di Parma" ka ndihmuar në ruajtjen e teknikave tradicionale të prodhimit, ndërsa ka ndikuar pozitivisht në mirëqenien e komuniteteve rurale përmes krijimit të vendeve të punës dhe rritjes së eksporteve. Një tjetër shembull është vaji i ullirit në Greqi, ku regjistrimi i produkteve të mbrojtura ka ndihmuar në rritjen e të ardhurave të fermerëve dhe në rritjen e ndërgjegjësimit për cilësinë dhe origjinën e produkteve.

Ndikimi social është gjithashtu i dukshëm. Në shumë rajone, STG-ja ka ndihmuar në ruajtjen e kohezionit social duke përforcuar lidhjet midis komuniteteve dhe promovuar bashkëpunimin ndërmjet prodhuesve lokalë. Për më tepër, këto produkte nxisin një ndjenjë krenarie dhe përkatësie, duke kontribuar në ruajtjen e identitetit kulturor dhe përfshirjen aktive të komuniteteve në zhvillimin ekonomik.

Kontributi i treguesve gjeografikë në zhvillimin e turizmit

Treguesit gjeografikë dhe STG-ja luajnë një rol të rëndësishëm në sektorin e turizmit, duke ofruar një pikë referimi për turistët që kërkojnë eksperienca autentike. Produkte të njohura si vera franceze, djathërat zvicerane dhe frutat tropikale nga Amerika Latine kanë tërhequr miliona vizitorë, duke u bërë elemente kyçe të itinerareve të turizmit kulturor dhe gastronomik.

Strategjitë e marketingut të suksesshëm përfshijnë krijimin e "rrugëve të produkteve" (si rrugët e verës në Toskanë), organizimin e festivaleve tradicionale dhe përdorimin e platformave digjitale për të promovuar këto produkte. Për shembull, në rajonin Rioja të Spanjës, promovimi i verërave lokale është integruar me turizmin kulturor dhe natyror, duke rezultuar në një rritje të konsiderueshme të vizitave turistike dhe përfitimeve ekonomike për komunitetet lokale.

Sfidat dhe mundësitë në tregun lokal dhe ndërkombëtar

Megjithëse STG-ja paraqet mundësi të mëdha, ato përballen me një sërë sfidash. Në tregun lokal, prodhuesit shpesh hasin vështirësi në sigurimin e burimeve të nevojshme financiare dhe institucionale për regjistrimin dhe promovimin e produkteve të tyre. Për më tepër, edukimi i konsumatorëve mbi vlerën e produkteve të certifikuara mbetet një sfidë kryesore, duke pasur parasysh konkurrencën nga produktet më të lira dhe më të komercializuara.

Në tregun ndërkombëtar, këto produkte përballen me pengesa tarifore dhe jotarifore, duke përfshirë standardet e ndryshme të cilësisë dhe procedurat komplekse të eksportit. Megjithatë, integrimi i teknologjive digjitale dhe përdorimi i tregjeve online ofrojnë mundësi të reja për zgjerimin e këtyre produkteve në një audiencë më të gjerë. Investimi në edukimin e konsumatorëve, marketingun e përqendruar dhe partneritetet strategjike me sektorin privat janë disa nga masat që mund të ndihmojnë në kapërcimin e këtyre sfidave dhe maksimizimin e potencialit të treguesve gjeografikë dhe STG-së.

Metodologjia e hulumtimit

Për të adresuar qëllimet dhe pyetjet kërkimore të studimit, është ndjekur një qasje kërkimore gjithëpërfshirëse, e cila përfshin metoda cilësore dhe sasiore. Kjo metodologji e përzier siguron një kuptim të plotë të ndikimit të treguesve gjeografikë dhe specialiteteve tradicionale të garantuara (STG) në zhvillimin ekonomik të luginës së Vjosës, duke kombinuar analiza të dhënash empirike me njohuri të detajuara nga aktorët kryesorë.

Qasja kërkimore

Metodologjia e përzier u përzgjodh për të kombinuar të dhënat sasiore, të cilat ofrojnë një pamje të përgjithshme të ndikimeve ekonomike dhe sociale të STG-së, me të dhënat cilësore që ndihmojnë në thellimin e kuptimit të përvojave dhe sfidave të aktorëve lokalë. Përmes kësaj qasjeje, studimi synon të identifikojë modelet dhe tendencat kryesore, duke u fokusuar

njëkohësisht në dinamikat komplekse që formësojnë zhvillimin e këtyre produkteve.

Burimet e të dhënave

Të dhënat për këtë studim u mblodhën nga tri burime kryesore:

1. **Intervista me prodhues lokalë:**Intervistat u zhvilluan me prodhues të certifikuar ose në procesin e certifikimit për STG-në në luginën e Vjosës. Përmes pyetjeve të strukturuara dhe gjysmë të strukturuara, u synua të kuptohej ndikimi i STG-së nëtë ardhurat e tyre, sfidat që ata përballen dhe perceptimet mbi potencialin e tregut.

2. **Anketime me konsumatorët.** Anketat u përdorën për të mbledhur të dhëna nga konsumatorët lokalë dhe vizitorët e rajonit. Pyetjet e anketës fokusoheshin në njohjen e konsumatorëve për STG-të, preferencat e tyre për produkte të certifikuara dhe vlerësimin e tyre për ndikimin ekonomik dhe kulturor të këtyre produkteve.

3. **Studime rasti nga rajone të ngjashme**. Janë analizuar raste të ngjashme nga rajone që kanë përfituar nga regjistrimi dhe promovimi i STG-së, si rajonet e Toskanës në Itali dhe Alzasë në Francë. Këto studime u përdorën si pikë referimi për të identifikuar praktika të mira që mund të përshtaten dhe zbatohen në luginën e Vjosës.

Përpunimi i të dhënave

Të dhënat e mbledhura u analizuan duke përdorur një kombinim metodash cilësore dhe sasiore:

- **Analiza cilësore:** Përpunimi i intervistave përmes kodimit tematik, duke identifikuar tema të përsëritura dhe modele të rëndësishme në perceptimet e prodhuesve dhe konsumatorëve.
- **Analiza sasiore:** Përdorimi i statistikave për të përpunuar të dhënat nga anketat, për të identifikuar trende dhe për të matur ndikimin ekonomik të STG-së mbi prodhuesit dhe konsumatorët.
- **Krahasimi i të dhënave:** Analiza krahasimore ndërmjet rajonit të luginës së Vjosës dhe rajoneve të tjera, për të identifikuar faktorë kritikë që ndihmojnë ose pengojnë suksesin e STG-së.

Kufizimet e studimit

Pavarësisht përpjekjeve për të ofruar një analizë gjithëpërfshirëse, studimi përballet me disa kufizime:

1. **Mostra e kufizuar:** Për shkak të burimeve dhe kohës së kufizuar, numri i prodhuesve dhe konsumatorëve të intervistuar mund të mos përfaqësojë të gjithë popullsinë e rajonit.

2. **Mungesa e të dhënave të sakta historike:** Në disa raste, mungesa e të dhënave të sakta mbi performancën e treguesve gjeografikë dhe STG-së mund të ndikojë në analizën e ndikimit afatgjatë.

3. **Ndikimi i faktorëve të jashtëm:** Çështje si ndryshimet klimatike dhe globalizimi ekonomik mund të kenë një ndikim të rëndësishëm që nuk mund të përfshihet plotësisht në analizën e këtij studimi.

Për të adresuar këto kufizime, është përdorur triangulimi i burimeve të të dhënave, duke kombinuar informacione nga prodhuesit, konsumatorët dhe studimet e rasteve për të siguruar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe të besueshme. Në të ardhmen, zgjerimi i mostrave dhe mbledhja e të dhënave shtesë do të ndihmojnë në përmirësimin e rezultateve të këtij hulumtimi.

Rezultatet dhe diskutimi

Ndikimi i STG-së në ekonominë lokale

Të dhënat e mbledhura nga intervistat dhe anketat tregojnë një rritje të dukshme të të ardhurave për prodhuesit lokalë pas certifikimit të produkteve si Specialitete Tradicionale të Garantuara

(STG). Para regjistrimit të produkteve, të ardhurat mesatare mujore të prodhuesve ishin rreth 500 Euro, ndërsa pas regjistrimit ato arritën në 800 Euro, një rritje prej 60%. Kjo rritje lidhet ngushtë me zgjerimin e tregjeve dhe rritjen e vlerës së shtuar të produkteve të certifikuara.

2. Hartimi dhe miratimi i planeve, mbarështimi dhe menaxhimi i hapësirave pyjore dhe kullosore në administrim të bashkive.

3. Duhet të mblidhen të gjitha palët e interesuara për të ndarë përvojën dhe njohuritë: bashkitë, sipërmarrësit, fermerët, menaxherët e ujit, politikanë, planifikues etj.

4. Të gjithë aktorët duhet të jenë transparent për nivelin e pjesëmarrjes për çdo palë të interesuar (informacion, konsultim, bashkëpunim ose kontroll) dhe të krijojnë pronësi dhe angazhim të qëndrueshëm në fillim të projektit e sipërmarrjes.

5. Duhet të identifikohen palët e interesuara lokale dhe rajonale, të përfshihen edhe ata në zhvillimin e parkut dhe duhet të bëhet e qartë se çfarë pritet prej tyre. Kjo është thelbësore për krijimin e një baze mbështetëse mes aktorëve profesionistë dhe qytetarëve (që mund të ndihmojë në nxitjen e angazhimit politik, i cili do të ndikojnë në zhvillimin e parkut rajonal të Vjosë-s).

6. Politikëbërja duhet të krijojë gjithë infrastrukturën e nevojshme që lugina të shërbejë si një "laborator" për studiuesit, studentët e Universitetit "Eqrem Çabej", si dhe për nxënësit e arsimit parauniversitar.

7. Zhvillimi i programeve të trajnimit për çdo nivel autoriteti dhe palët e interesuara të përfshira për të rritur ekspertizën dhe ndërgjegjësimin, në lidhje me zbatimin e strategjisë.

Referencat

Joseph Mbaiwa, "The Effects of Tourism Development on the Sustainable Utilisation of Natural Resources in the Okavango Delta, Botsëana," Current Issues in Tourism, vol. 14, no. 3, pp. 251-273, 2011.

2. Tazim Jamal, and Amanda Stronza, "Collaboration Theory and Tourism Practice in Protected Areas: Stakeholders, Structuring and Sustainability," Journal of Sustain Tourism, vol. 17, no. 2, pp. 169–189, 2009.

3. Md. Ariful Hoque, Brent Lovelock, and Anna Carr, "Alleviating Indigenous Poverty through Tourism: The Role of NGOs," Journal of Sustainable Tourism, vol. 30, no. 10, pp. 2333–2351, 2022.

Michal Apollo et al,"Does the Altitude of Habitat Influence Residents' Attitudes to Guests? A New Dimension in the Residents' Attitudes to Tourism," Journal of Outdoor Recreation Tourism, vol. 31, 100312, 2020.

Robert Edward Freeman, Strategic Management: A Stakeholder Approach, Boston, 1984.

Inyang Deng et al., "Stakeholders' Perceptions of Tourism Development in Appalachian Forest Heritage Area," Tourism Revieë International, vol. 20, no. 4, pp. 235–253, 2016.

Muhammet Yasarata et al., "Politics and Sustainable Tourism Development–Can they Co-

exist? Voices from North Cyprus," Tourism Management, vol. 31, no. 3, pp. 345–356, 2010.

Meredith Wray, "Adopting and Implementing a Transactive Approach to Sustainable Tourism Planning: Translating Theory into Practice," Journal of Sustainable Tourism, vol. 19, no. 4-5, pp. 605-627, 2011.

Ligji Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", Këshilli i Ministrave, fq. 1, 2017.

10. William Lawrence Neuman, Workbook for Neumann Social Research Methods: Qualitative and Quantitative Approaches, Allyn & Bacon, 2006.

11. Kathleen M. Adams et al., "(Post-) Pandemic Tourism Resiliency: Southeast Asian Lives and Livelihoods in Limbo," Tourism Geographies, vol. 23, no. 4, pp. 915–936, 2021.

Anne Cadoret, "Conflicts and Açeptability of Visitation Management Measures for a Marine Protected Area: The Case of Porquerolles, Port-Cros National Park," Ocean and Coastal Management, vol. 204, p. 105547, 2021.

Ju-Han Zoewang, "National Parks in China: Parks for People or for the Nation?". Land Use Policy, vol. 81, pp. 825–833, 2019.

Yangyang Zhang et al., "What Is the Relationship between Natural Protected Areas and Stakeholders? Based on Literature Analysis from 2000–202," Forests, vol. 13, no. 5, pp. 734, 2022

Mirela Kumbaro, Vjosa në UNESCO, Aplikimi gati brenda vitit, Postuar më: 24/04/2024

Stephen Schweinsberg, Simon Darcy, and Mingming Cheng, "The Agenda Setting Power of News Media in Framing the Future Role of Tourism in Protected Areas," Tour Management, vol. 62, pp. 241–252, 2017.

Intervistë me inxhinier hidroteknik Spiro Diamanti.

Internet

https://turizmi.gov.al/wpcontent/uploads/2018/05/Ligj_81_2017_04.05.2017-Per-Zonat- e-Mbrojtura.pdf

https://turizmi.gov.al/vjosa-ne-unesco-kumbaro-aplikimi-gati-brenda-vitit/

https://360grade.al/626419/

https://turizmi.gov.al/vjosa-krijohet-parku-i-pare-kombetar-i-nje-lumi-te-eger-ne-evrope/

https://www.democracyandme.org/the-role-of-media/

EVOLUIMI I LEGJISLACIONIT MBI TRASHËGIMINË NATYRORE E KULTURORE GJATË TRANZICIONIT NË SHQIPËRI. RASTI I LUMIT VJOSA

[1]MSc.Leonard Sala, [2]MSc.Fatjon Malaj
[1]Department of Accounting & Finance, Faculty of Economics,"Eqrem Çabej"
University of Gjirokastër, Albania, lsala@uogj.edu.al
[2]Department of Public Administration, Faculty of Economics,"Eqrem Çabej"
University of Gjirokastër, Albania, fmalaj@uogj.edu.al

Abstract

An important part of the reforms undertaken by Albania during the transition was also the reform of the Albanian legislation, which has evolved over the years to be in line with the legislation of the European Union. The first law on cultural heritage during the transition of Albanian was law No. 7867, dated 12. 10. 1994 of the People's Assembly of the Republic of Albania, on "the protection of ***movable and immovable*** *cultural property." was the first law in this field in which the communist heritage was finally renounced in the field of heritage. Inits 33 articles this law dealt with the cultural heritage from the perspective of a democratic state and society as Albania was already. Regarding the natural heritage, the first law approved after 1990 is Law No. 8906, dated 6.6.2002 "On protected areas" which had as its object the announcement, preservation, administration, management, and sustainable use of protected areas and their natural and biological resources, as well as facilitating the conditions for the development of environmental tourism. The most typical case to understand the sensitization of many actors inside and outside the country for the protection of natural heritage is the campaign for the protection of the river Vjosa. This campaign took place over nearly 10 years and involved several actors within the country such as the Albanian Government, local and foreign environmental organizations, local and foreign scientific institutions, outstanding personalities of science and art with* ***international fame, the*** *Council of Europe, etc. And after nearly a decade of campaigning to protect the last wild river in Europe, the Vjosa River was crowned with the declaration of this river as a National Park with VKM no. 155, dated 13.3.2023.*

Keywords:*EU legislation, natural heritage, cultural heritage, protected areas, Vjosa river*

Trashëgimia përfshin në vetvete vlera natyrore e kulturore që përcillen brez pas brezi. Kur pjesë e kësaj trashëgimie janë vlera të mjedisit natyror kemi të bëjmë me trashëgimi natyrore: ndërsa kur bëhet fjalë për vlera materiale e shpirtërore të shoqërisë kemi atë që quhet trashëgimi kulturore.

Në përbërje të trashëgimisë natyrore përfshihen objekte, peisazhe, ekosisteme, habitate më të veçanta, të rralla apounike, relikte, endemike apo të rrezikuara për tu zhdukur. Kjo trashëgimi natyrore me këta elementë përbërës kanë rëndësi të madhe shkencore, ekologjike, kulturore, didaktike, por edhe turistike. Prandaj ato ruhen e mbrohen edhe me forma e mënyra shumë të rrepta, të përcaktuara saktë dhe prerë në ligje të veçanta.

Vlerat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore mbrohen nga ligjet e Konventës së Trashëgimisë Botërore (UNESCO) si dhe nga ligjet kombëtare. Çdo vend i kulturuar e cilëson dhe e trajton si të shenjtë trashëgiminë natyrore dhe kulturore sepse me to është i lidhur identiteti kombëtar, zhvillimi ekonomik-shoqëror dhe e ardhmja e brezave. Duke patur një rëndësi të tillë, njohja dhe mbrojtja e trashëgimisë është detyrë për të gjithë: shtetin, studiuesit, shkollën, menaxhuesit, aktorët lokalë, organizatat jo fitim prurëse etj.

Me përmbysjen e regjimit komunist në fillim të viteve 90-të të shek.XX, në Shqipëri filloi epoka e re demokratike, objektiv kryesor i së cilës ishte integrimi evropian i vendit nëpërmjet kryerjes

së reformave në të gjitha fushat.

Në këtë kuadër pjesë e rëndësishme e reformave që ka ndërmarrë vendi ynë gjatë tranzicionit demokratik ka qenë edhe reforma e legjislacionit i cili ka evoluar ndër vite që të përshtatet e të jetë në një linjë me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Qeveritë shqiptare të tranzicionit përsa i përket fushës së trashëgimisë kanë synuar ndër vite që ajo të konsiderohet si një forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomiko-shoqëror të vendit pasi qëndrueshmëria dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë sot tendencat më të rëndësishme të çdo shoqërie. Zhvillimi i qëndrueshëm kujdeset që të menaxhojë tre aspekte kryesore: mbrojtjen mjedisore, rritjen ekonomike dhe barazinë sociale.

Si objektiva strategjikë në fushën e trashëgimisë u përcaktuan:

1. Krijimi i një kuadri ligjor më efikas për mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore e natyrore.

2. Krijimit të hapësirave të vetadministrimit me qëllim rritjen e transparencës, akordimit të fondeve dhe konkurrencës.

3. Harmonizimit të kompetencave dhe funksioneve të institucioneve qëndrore, këshillave kombëtare të sistemit të trashëgimisë materiale e kulturore, institucioneve vendore dhe grupeve të interesit në këtë fushë.

4. Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit si dhe ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jo materiale kulturore si pasuri kombëtare për brezat e ardhshëm të Shqipërisë.

5. Rehabilitimi i integruar i trashëgimisë së prekshme (qëndrat historike, ansamblet, monumentet e kulturës, të natyrës, parqet dhe zonat arkeologjike) dhe transformimi i tyre në qendra të hapurapër vizitorët, duke synuar rritje të hapësirave të rehabilituara.

6. Përmirësim të standarteve dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara në Parkun Arkeologjik Kombëtar në monumentet natyrore dhe në Muzeumet Kombëtare me synim rritjen e ndërhyrjeve dhe rritjes së ofertave turistike.

Në mënyrë kronologjike duhet theksuar se pas krijimit të shtetit të pavarur kombëtar shqiptar më 1912 i pari akt juridik i këtij shteti në fushën e trashëgimisë kulturore ishte Qarkorja e Ministrisë së Arsimit nr.932 datë 19.06.1922 e cila udhëzonte të gjithë inspektorët e arsimit në vend që të kujdeseshin për gjetjen dhe ruajtjen e vjetërsirave. Kjo qarkore u pasua me një akt më të plotë juridik siç ishte ligji mbi "Monumentet Kombëtare" Nr.129 datë 28.05.1929.

Pas Luftës së Dytë botërore akti i parë normativ real për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Shqipëri ishte ligji Nr. 568, datë 17.03.1948 i cili u dekretua në datën 24.05.1948, Nr.609 "Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe të sendeve natyrale të rralla.

Me këtë ligj të parë të regjimit komunist u hartua edhe lista e parë e monumenteve shqiptare në hapësirën e Shqipërisë politike.

Në vitin 1955 u hartua rregullorja "Mbi ruajtjen e monumenteve të kulturës". Një rëndësi të veçantë për punën kërkimore, për vënien në mbrojtje të monumenteve të reja, e sidomos të qyteteve muze, pati një vendim i vitit 1959 ku përfshiheshin edhe masat në fushën e monumenteve historike, kulturore dhe artistike.

Në vitin 1961 me VKM Nr.170 datë 02.06.1961, Gjirokastra, Berati, nëntoka e Durrësit dhe pazari i vjetër i Krujës u shpallën "Qytete muze". Së bashku me këtë vendim u miratua dhe rregullorja për administrimin e këtyre qyteteve në të cilën përcaktohej qartë rëndësia që duhej tu jepej monumenteve por edhe banesave private që gjendeshin në këto qytete. Bashkë me përgjegjësinë e shtetit edhe vetë qytetarët merrnin përgjegjësitë për të ruajtur trashëgiminë e qyteteve-muze.

Në vitin 1971 në Shqipëri u aprovua një ligj i ri "Mbi mbrojtjen e monumenteve kulturore e historike dhe pasurive natyrore të rralla i cili u pasua edhe nga një Rregullore e posaçme në vitin 1972.

Me vendimin e Këshillit të Ministrave të vitit 1974, ndërtimet popullore me vlera arkitektonike-historike dhe etnografike në fshat dhe qytet duhet të inventarizoheshin dhe mirëmbaheshin në mënyrë të organizuar nga një sërë institucionesh që u ngarkuan për këtë qëllim dhe ky proces duhet të përfundonte brenda viteve 1978-1980.

Një hap i rëndësishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e natyrore të vendit tonë ishte ratifikimi i Konventës së UNESCO-s të vitit 1972 "Për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore e Natyrore Botërore" nga ana e Republikës së Shqipërisë më 10 korrik 1989. Me nënshkrimin e kësaj Konvente vendi ynë siguronte një mbrojtje kolektive të trashëgimisë kulturore e natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale për njerëzimin.

Me përmbysjen e regjimit komunist dhe fillimin e proceseve demokratike në fillim të viteve 90 të shek.XX, trashëgimia kulturore e natyrore iu nënshtrua kaosit, grabitjeve dhe trafikimit si dhe mungesës së strukturave shtetërore për të garantuar mbrojtjen dhe efiçensën e saj.

I pari ligj në fushën e trashëgimisë kulturore pas përmbysjes së regjimit komunist ishte ligji Nr.7867 datë 12.10.1994. "Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme". Me aprovimin e tij u hoq dorë përfundimisht nga legjislacioni komunist në fushën e trashëgimisë dhe në 33 nenet e këtij ligji trashëgimia kulturore trajtohej sipas këndëvështrimit të një shteti dhe shoqërie demokratike në të cilën Shqipëria kishte hyrë.

Duke u nisur nga problematikat që u hasën në fushën e trashëgimisë kulturore gjatë dekadës së parë të tranzicionit shqiptar duke u bazuar edhe në përvojat e vendeve demokratike në vitin 2003 u miratua ligj i ri për trashëgiminë kulturore Ligji Nr.9048 datë 07.04.2003 "Për trashëgimin kulturore". Ky ligj kishte për objekt të vet vlerat e trashëgimisë kulturore në Shqipëri, parashikimin e rregullave për mbrojtjen e saj si dhe përgjegjësitë dhe detyrat e organeve që veprojnë në këtë fushë.

Ky ligj duke u nisur edhe nga përvoja e vendeve të Bashkimit Evropian harmonizonte mirë interesat e shtetit me ato të individit në fushën e trashëgimisë si dhe përcaktonte rregulla të qarta për administrimin, ruajtjen, restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si në rastet kur ato ishin pronë e shtetit ashtu edhe në rastet kur zotëroheshin nga privatët.

Nisur nga problematikat që u hasën në zbatimin e këtij ligji në terren, ky ligj u amendua tre herë: në vitin 2006, 2008, 2009, përkatësisht ligji nr.9592 datë 27.07.2006, ligji nr.9882 datë 28.02.2008 dhe ligji nr.10137 datë 11.05.2009. Legjislacioni për trashëgiminë kulturore u konsolidua më tej kur Republika e Shqipërisë ratifikoi Konventën për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore jomateriale, Paris 2003 (ligji nr.9490 datë 13.03.2006 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë). Ratifikimi i kësaj konvente të UNESCO-s nga ana e Republikës së Shqipërisë e obligonte shtetin Shqiptar që të implementonte qëllimet e kësaj konvente që ishin:

- Ruajtja e trashëgimisë kulturore jo materiale.
- Respektimi i trashëgimisë kulturore jo materiale të bashkësive, të grupeve dhe individëve të prekur.
- Sensibilizimi në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për rëndësinë e trashëgimisë kulturore jo materiale dhe të vlerësimit të saj të ndërsjelltë
- Sigurimi dhe bashkëpunimi i ndërsjelltë midis anëtarëve të Konventës dhe asistenca ndërkombëtare në fushën e Trashëgimisë kulturore jo materiale.

Gjithashtu një hap i mëtejshëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore të vendit ishte aderimi i Republikës së Shqipërisë në Konventën për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, Paris 2001. Ratifikimi i kësaj konvente të UNESCO-s u bë me ligjin Nr.10027 datë 11.12.2008 të Kuvendit të Shqipërisë. Kjo konventë e obligonte shtetin shqiptar që ta konsideronte trashëgiminë kulturore nënujore si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të njerëzimit dhe një element veçanërisht i rëndësishëm në historinë e popujve, kombeve dhe marrëdhënieve të tyre me njëri-tjetrin në lidhje me trashëgiminë e tyre të përbashkët. Konventa synonte të forcojë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore dhe nxiste bashkëpunimin e shteteve për ta ruajtur atë. Aderimi i vendit tone në këtë Konventë e obligonte atë që ta ruante

trashëgiminë kulturore nënujore të tij dhe kjo trashëgimi duhet depozituar, konservuar dhe menaxhuar në një mënyrë që siguron ruajtjen e saj afatgjat.

Një hap tjetër i rëndësishëm për trashëgiminë kulturore të vendit tonë ishte aderimi i Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane "Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike (të rishikuar) miratuar me ligjin Nr.9806 datë 17.09.2007 të Kuvendit të Shqipërisë. Aderimi i Shqipërisë në këtë Konventë Evropiane e detyronte vendin tonë që në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë arkeologjike duhej implementuar një legjislacion i njëjtë me vendet e Bashkimit Europian. Secili shtet nënshkrues i kësaj konvente merrte përsipër të krijojë një sistem ligjor për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike duke parashikuar:

- Mbajtjen e një invenatri mbi trashëgiminë arkeologjike dhe përcaktimin e monumenteve dhe zonave në mbrojtje.
- Krijimin e rezervave arkeologjike edhe ku nuk ka rrënoja të dukshme mbi tokë apo nën ujë, për ruajtjen e dëshmive materiale për tu studiuar nga brezat e ardhshëm
- Raportimin e detyrueshëm tek autoritetet përkatëse nga ana e zbuluesit të një gjetje të rastësishme të elementeve të trashëgimisë arkeologjike dhe vënia e tyre në dispozicion për studim.

Republika e Shqipërisë si palë me këtë Konventë angazhohej gjithashtu:

- Të zbatojë procedura për autorizmin dhe mbikëqyrjen e gërmimeve dhe veprimtarive të tjera arkeologjike si dhe të sigurojë që gërmimet arkeologjike të kryhen në mënyrë shkencore dhe të zbatohen aty ku është e mundur metoda jo shkatërruese investigimi.

Procesi i aderimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian mori një hov të fuqishëm me miratimin e Vendimit të Këshillit Europian të 27 qershorit 2014 që i akordoi Shqipërisë statusin e vendit kandidat si vlerësim për reformat e ndërmara nga Shqipëria që në fillim të viteve 90 të shek.XX kur u përmbys regjimi komunist.

Marrja e statusit si kandidat zyrtar për anëtarësimin në Bashkimin Europian të Shqipërisë kërkon përmbushjen e "Kritereve të Kopenhagës". Një nga këto kritere është përafrimi i plotë nga vendi kandidat i legjislacionit të BE-së (acquis) në legjislacionin kombëtar.

Për temën e marrë në shqyrtim kjo u realizua me ligjin nr.27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë". Qëllimi i këtij ligji është ruajtja, mbrojtja, vlerësimi dhe administrimi i trashëgimisë kulturore kombëtare, trashëgimisë kulturore muzeore, peizazhit, si kontribues në ruajtjen e kujtesës kombëtare, përfaqësimit material dhe të dukshëm të identitetit kombëtar, si shprehje e vlerave kulturore, si dhe nxitja e zhvillimit kulturor në vend, duke siguruar dhe parandalimin e trajtimit të paligjshëm të objekteve kulturore.

Ky ligj me 278 nenet e tij është një ligj që siguron në mënyrë tërësore një mbrojtje të plotë sipas standarteve të BE-së në fushën e trashëgimisë kulturore e muzeve në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë dekadave të fundit vendet dhe shoqëritë në mbarë botën po përballen me rreziqe në rritje të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, nga kufizimi dhe varfërimi i burimeve natyrore dhe dukuritë e ndërlikuara midis tyre. Shtetet dhe popullsia e mjaft vendeve janë bërë gjithnjë e më të vetëdijshëm për ndikimin që ka degradimi i mjedisit në cilësinë e jetës për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Për këtë arsye, krahas mekanizmave ligjore të parashikuara në të drejtën ndërkombëtare, mjaft shtete po i drejtohen sistemeve të tyre kushtetuese për të ofruar një mbrojtje më të fortë të mjedisit.

Duke filluar nga vitet 80' të shek.XX mjaft vende u përfshinë në atë që u quajt "Konstitucionalizmi mjedisor" i cili presupozon pranimin e idesë se e drejta për një mjedis të shëndetshëm është një objekt i veçantë për tu mbrojtur nga tekstet e kushtetutave dhe për tu referuar e zbatuar nga gjykatat që kanë si funksion kontrollin kushtetues. Konstitucionalizmi mjedisor është një dukuri e re ku ndërthuret e drejta kushtetuese, e drejta ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe e drejta mjedisore. Ai krijon garanci më të larta se mekanizmat e tjerë ligjorë dhe vendos një kuadër ku harmonizohen politikat për mbrojtjen e mjedisit, të biodiversitetit, të interesave të brezave të ardhshëm me zhvillimet dhe sfidat ekonomike.

Në kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të miratuar në nëntor 1998 e drejta për një mjedis të shëndetshëm nuk parashikohet si një e drejtë e veçantë, në kuptimin substancial. Neni 56 në formën e një të drejte dhe garancie proceduriale përcakton se: "Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij. Ky parashikim reflekton idenë qëndrore të Konventës së Aarhusit. Në nenin 59, përmenden dy koncepte të rëndësishme siç janë mbrojtja e mjedisit edhe në interes të brezave të ardhshëm dhe parimi i zhvillimit të qëndrueshëm. Sipas shkronjave "d" dhe "dh" të këtij neni "shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon si edhe në plotësim të nismës dhe përgjegjësisë private, synon një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Nga sa parashtruam më sipër sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë nuk garantohet në nivelin e duhur maksimal mbrojtja kushtetuese e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, duke pasur parasysh sfidat aktuale që imponojnë ndryshimet klimatike dhe rreziqet e shtuara për degradimin e mjedisit. Por njëkohësisht duhet të pranojmë se mbrojtja kushtetuese e mjedisit në Republikën e Shqipërisë, më shumë se sa nga parashikimet specifike të përmendura më lart, ofrohet nga instrumentet ndërkombëtare, të cilat imponohen nga Kushtetuta Shqiptare për t'u zbatuar në sistemin tonë të brendshëm ligjor, nga e drejta ndërkombëtare e ratifikuar dhe detyrimeve të shtetit shqiptar si palë nënshkruese e këtyre konventave.

Rrugëtimi juridik i shpalljes së lumit Vjosa, Park Kombëtar në Shqipëri ka qenë një proces mjaft kompleks që përfshin veprime ligjore, presion publik nga komuniteti, OJQ-të vendase e të huaja, personalitete të njohura ndërkombëtare dhe presion të fortë ndërkombëtar. Rasti i lumit Vjosa është gjithashtu një shembull që e drejta ndërkombëtare e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mori përparësi në të gjithë rrugëtimin e shpalljes së lumit Vjosa si Park Kombëtar. Fillesat për këtë rrugëtim dhe shqetësimet e para për rrezikun që e kanoste lumin Vjosa janë në vitet 2010-2016 kur qeveria shqiptare aprovoi një sërë lejesh për ndërtimin e hidrocentraleve në lumin Vjosa dhe degët e tij. Vendimet e qeverisë shkaktuan shqetësim legjitim në komunitetet lokale, në shoqatat ambientaliste brenda e jashtë vendit dhe nga organizatat ndërkombëtare të mbrojtjes së mjedisit.

Rrjedhojë e këtij reagimi ishte krijimi i lëvizjes "Të shpëtojmë Vjosën" e cila nisi një rezistencë të fortë qytetare dhe juridike kundër këtyre projekteve mbi lumin Vjosa.

Në vitet 2016-2024 OJQ-të si EcoAlbania, Riverwatch, EuroNatur dhe komuniteti i banorëve të Vjosës paditën në gjykatat shqiptare lejet për HEC-et e Kalivaçit dhe Poçemit në lumin Vjosa. Argumentet e paraqitura nga këto shoqata konsistonin në dy drejtime:

1. Procesi konsultativ publik për ndërtimin e HEC-eve nuk ishte i plotë dhe transparent.

2. Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për ndërtimin e HEC-eve në Vjosë ishte i mangët, i parregullt dhe në shkelje të plotë të ligjit shqiptar.

3. Në rastin e dhënies së leje për HEC-et në Vjosë ishin shkelur standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit ku referenca ishin vendimet e Këshillit të Evropës (KE).

Në vitin 2017 Gjykata e Shkallës së Parë urdhëroi anulimin e vendimit për ndërtim të HEC-eve në lumin Vjosa. Ky vendim u konfirmua edhe nga Gjykata Administrative e Apelit në Tiranë në korrik 2024. Në opinionin e juristëve shqiptarë ky vendim u konsiderua si "model pioner për praktikat gjyqësore mjedisore në Shqipëri". Sistemi gjyqësor shqiptar filloi tashmë të zhvillonte praktika të reja në fushën mjedisore që konsistonin në :

- Shfrytëzimin e madh të masave të sigurisë dhe pezullimeve të kontratave.
- Njohjen e emergjencës mjedisore për shqyrtim të përshpejtuar.
- Përforcimin e rëndësisë së konsultimit publik dhe studimeve mjedisore me standarte të plota ligjore.

- Roli i standarteve ndërkombëtare, veçanërishtë i Konventës së Aarhusit dhe standarteve të Bashkimit Evropian, në jurispudencën shqiptare për çështjet mjedisore u bë më i qënësishëm dhe në rritje. Standartet e BE-së filluan të shfrytëzohen nga gjykatat shqiptare si burime interpretative në shqyrtimin e çështjeve mjedisore.

Pesha juridike e këtyre vendimeve hapi rrugën për argumente ligjore që propozuesit dhe qeveria përdorën për të nisur procesin e shpalljes së statusit të parkut kombëtar për lumin Vjosa.

Roli dhe kontributi i organizatave joqeveritare (OJQ) në shpalljen e lumit Vjosa Park Kombëtar ishte thelbësor dhe shumëplanësh duke përfshirë aksione juridike, shkencore, komunikimi publik dhe diplomaci ndërkombëtare. OJQ-të vendase dhe ndërkombëtare si EcoAlbania, Riverwatch (Austria), EuroNatur (Gjermania), Patagonia etj, në koordinimin me njëra-tjetrën ndërmorën veprime dhe aksione për shpalljen e Vjosës Park Kombëtar. Kështu EcoAlbania u bë aktorja kryesore në terren dhe në paditë gjyqësore, Riverwatch punoi fort me ekspertët e lumenjve dhe politikat e mbrojtjes së lumenjve, EuroNatur u fokusua në lobimin në nivel evropian për lumin Vjosa dhe Patagonia si kompani me mision mjedisor u fokusua kryesisht dhe mbështeti fushatën globale "Vjosa National Park Now".

Fushata "Vjosa National Park Now" nisi në vitin 2020 dhe përdori forma të tilla si spote ndërkombëtare, dokumentarë dhe filma të shkurtër, evente publike, koncerte, ekspedita me media ndërkombëtare që kishin për qëllim të evidentonin vlerat e veçanta të lumit Vjosa, si lumi i vetëm i egër i Evropës që kishte Shqipëria i cili duhej mbrojtur nga veprimtaria e njeriut. Si rezultat i kësaj fushate u mobilizuan mijëra qytetarë dhe media ndërkombëtare (The Guardian, BBC, National Geographic) duke e kthyer Vjosën në simbol të lëvizjes mjedisore në Evropë. Gjithashtu këto shoqata ushtruan presion direkt mbi qeverinë shqiptare sidomos përmes organizatave evropiane që kishin kontakte me institucionet e BE-së.

Ekspertë të shquar të OJQ-ve punuan me biologë, ekologë dhe gjeografë për të hartuar studime për biodiversitetin dhe rrjedhën e lirë të lumit Vjosa si dhe publikuan raporte shkencore që mbështetën vendimarrjen e qeverisë shqiptare për shpalljen e Vjosës Park Kombëtar-kategoria II sipas IUCN.

OJQ-të ndërkombëtare që u angazhuan për lumin Vjosa realizuan memorandume bashkëpunimi me IUCN si dhe ushtruan presion diplomatik ndaj qeverive të BE-së për të ndikuar mbi qeverinë shqiptare. Si rezultat i këtij presioni në vitin 2021 EcoAlbania e partnerët firmosën një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për ndihmë teknike në krijimin e Parkut Kombëtar të lumit Vjosa. Duhet theksuar gjithashtu se roli i politikës në shpalljen e lumit Vjosa Park Kombëtar ka qenë vendimtar duke ndikuar në disa faza kyçe të procesit: nga ndalimi i projekteve të diskutueshme hidroenergjitike deri tek formalizimi përfundimtar përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr.155 të 15 marsit 2023. Ky vendim përfshin rreth 12.727 hektarë përgjatë rrjedhës së lumit dhe synon ruajtjen e ekosistemit të paprekur të Vjosës.

Shpallja e Parkut Kombëtar të Vjosës në mars 2023 nuk ishte vetëm një vendim politik. Ky akt u bazua në praktikat gjyqësore ku standardetndërkombëtare kishin qenë të sukseshme dhe përputhet me kërkesat e IUCN për kategorinë II të zonave të mbrojtura të cilat janë vetë në përputhje me Konventat Ndërkombëtare. Qeveria Shqiptare dhe partnerët ndërkombëtar (Patagonia, IUCN, EuroNatur) përdorën gjuhë të përbashkët me ato të standardit të BE-së dhe të Aarhusit në raportet dhe deklaratat zyrtare. Qeveria Shqiptare e shfrytëzoi të gjithë procesin e shpalljes së Vjosës Park Kombëtar si oportunitet politik për të pozicionuar veten si lidere në tranzicionin ekologjik në Ballkan.

Me këtë vendim Shqipëria u shndërrua në vend lider në Ballkan për mbrojtjen e një lumi të tërë si Park Kombëtar, u bë një rast unik dhe precedent ndërkombëtar

Referenca

Qiriazi, P: "Trashëgimia natyrore e Shqipërisë (vlerat, rreziqet dhe menaxhimi) Tiranë 2020

fq.17

Gorica, K: “Menaxhimi i turizmit të qëndrueshëm” Tiranë 2017 fq. 6

Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025 fq.2

Meksi, A : “Restaurimi i monumenteve të Arkitekturës”, Tiranë 2015 fq.32 UEGEN 2016

Riza E: “Teoria dhe praktika e restaurimit të monumenteve të arkitekturës”, Tiranë 2002 fq.25

Meksi, A: Restaurimi i monumenteve të Arkitekturës fq.37

Thoma, P, Riza,E, Muka A : Vendbanimet dhe banesa popullore shqiptare 1, Vendbanimet dhe banesa fshatare. Toena, Tiranë 2004 fq. 11

Konventa për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore e UNESCO-s 1972 fq.1

Ligji Nr.9048 datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” Neni 2

Konventa për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jo materiale Paris UNESCO 2003, neni 1

Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, UNESCO, Paris 2001

Konventa europiane “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike (e rishikuar) 16 janar 1992, neni 2

Po aty, neni 3

Ligji Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” neni 1

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 56 fq 13

Po aty, neni 59 fq 14

INTEGRATED MANAGEMENT OF COMMUNITY DEVELOPMENT IN PROTECTED AREA OF THE VJOSA VALLEY

Assoc. Prof. NEVILA KOÇOLLARI FURXHIU
[1]Department of Social Work and Social Policy, Faculty of Social Sciences, University of Tirana, Albania,
Email: nkocollari@gmail.com

Abstract

The integrated management of community development in protected areas aims to harmonize conservation objectives with socio-economic growth. This paper aims to address some strategies and methodologies for achieving sustainable community development while maintaining the ecological integrity of protected regions. The research focuses on qualitative methods, based on semi-structured interviews and comprehensive case studies to gather in-depth insights. Key research questions include: How local knowledge and social behavior change are integrated into the planning and management of protected areas of Vjosa Valley? How do community members view the impact of integrated management strategies on their livelihoods and well-being and how do community development initiatives within this protected area affect social and economic outcomes for residents? How are the adaptive management practices focused on collective memory, space and place, identity, culture, and behavior change, incorporated into the governance of protected areas? Semi-structured interviews with government officials, community leaders, NGO representatives, and residents provide access to conservation efforts. These interviews are complemented by detailed case studies of successful integrated management projects in regions such as the Vjosa in Fest Festival (Vjosa n`Fest), and other massive activities in the area. The findings highlight the importance of community involvement, multi-stakeholder collaboration, and adaptive management frameworks in balancing human needs and social behavior change with health and environmental preservation (Folke et al., 2005). Key challenges include aligning policies with sustainable development goals and overcoming obstacles in stakeholder cooperation.Case studies identify best practices and key challenges in implementing integrated management plans (Borrini-Feyerabend et al., 2004; Brown et al., 2016).The paper advocates for policies that promote sustainable livelihoods, education, and capacity-building among local communities alongside healthy environmental protection measures (Pretty et al., 2010).In conclusion, the integrated management of community development in protected areas is crucial for achieving long-term sustainability. The study provides some actionable recommendations for policymakers, conservationists, and community leaders, emphasizing the need for continuous evaluation, innovation, and community-centric approaches in the management of protected landscapes (Holling, 1978), but not only.

Keywords: *integrated management, community development, protected areas, conservation, sustainable development, behavior change.*

I. Introduction

Vjosa was declared a National Park (VWRNP) in March 2023, according to national law (based on Article 100 of the Constitution and Article 8 points 2 and 10 of Law No. 81/2017 "On Protected Areas" as Category II of protected areas) and international standards (Category II, IUCN Protected Areas Category System). This law is important because it protects one of the last free-flowing wild rivers in Europe and its unique ecosystem. The Vjosa River in southern Albania is one of the last rivers in Europe, with three branches, that still has a natural course. From its source in the Pindos Mountains in Greece to its mouth in the Adriatic Sea, the Vjosa

flows freely and without artificial obstacles. Recent studies confirm its rich and complex biodiversity and the functionality of the natural ecosystem (Miho, 2018; Shumka et al., 2018; Schiemer et al., 2018; Shumka et al., 2018). As a result, the Vjosa has become increasingly well-known and has gained international importance as the last free-flowing river in Europe[1]. The Vjosa Valley includes three districts or 10 municipalities: the regions of Gjirokastra, Fier, and Vlora and the municipalities of Libohova, Përmeti, Këlcyra, Gjirokastra, Tepelena, Memaliaj, Mallakastra, Fieri, Vlora and Selenica.

The river's pristine waters and surrounding landscapes are home to numerous endemic species, making it a hotspot for biodiversity. The valley's cultural landscape is dotted by historical sites and traditional villages that reflect a deep connection between the local communities and their natural environment. The integrated management of community development in protected areas aims to balance conservation objectives with socio-economic growth. This approach is critical in areas where local communities depend on natural resources for their livelihoods (Pretty et al., 2010). Effective management strategies ensure that conservation efforts do not hinder economic development, while sustainable economic activities do not degrade environmental integrity (Folke et al., 2005). The municipalities have a total population of around 130,000 people and account for 4.64% of the total population at the national level. The total population of these three regions makes up 19.1 % of the national population, which is a decrease compared to the 20 % in 2000. A share of 18.2% of the population is expected for 2031. The population of the municipalities surveyed has shrunk over the years due to a decline in the birth rate and internal and external migration (Muço, K., et al., 2023:13). The residents of Vjosa Valley depend heavily on natural resources for their livelihoods, engaging in activities such as agriculture with about 15,500 active employment in the Vjosa Valley, livestock farming, with cattle and sheep, milk and cheese producing, sometimes beekeeping, fishing, and eco-tourism (Muço, K., et al., 2023:17). Agriculture is a priority sector of the economy of the Vjosa Valley, while the structure of the business sectors varies from municipality to municipality. Agriculture in the region relies heavily on the fertile soil and clean water provided by the Vjosa River. Traditional farming practices have been passed down through generations, ensuring food security and economic stability for local families. Tourism is another income sector for the residents of the zone, noting that about 1/5 of the accommodation establishments at the national level are located in some regions like Gjirokastra (with about 30% of the income brought from tourism), Vlora Përmet and Fier (Muço, K., et al., 2023:18). Eco-tourism has emerged as a growing sector, capitalizing on the valley's natural beauty and cultural heritage. Tourists from all around the world visit Vjosa Valley to experience its pure landscapes, engage in outdoor activities such as hiking and bird-watching, and learn about the local culture. This influx of visitors generates significant revenue for the local economy, supporting businesses such as guesthouses, restaurants, and tour operators (Ministry of Tourism and Environment, 2021).

The study aims to examine some strategies for sustainable community development maintaining ecological integrity in protected regions, with the special focus on social behavior change.

Key research questions include: How are local knowledge and social behavior change integrated into the planning and management of protected areas of Vjosa Valley? How do community members view the impact of integrated management strategies on their livelihoods and well-being, and how do community development initiatives within this protected area affect social and economic outcomes for residents? How are the adaptive management practices focused on collective memory, space and place, identity, culture, and behavior change, are incorporated into the governance of protected areas?

[1]Muço, K., Kokthi, E., Guri, F., Shehu, E., Sovinc, A. (2023). Vjosa Wild River National Park (VWRNP): Integrated Management Plan: Socio-Economic Study. Analyses &Integrated Methodology to Identify a Value for ecosystem service (the case of the Vjosa Valley in Albania). Ministria e Turizmit dhe Mjedisit &IUCN Belgrade Office for Eastern Europe and Central Asia. Pp.5.

In this context, integrated management is essential to ensure that the increasing economic activities do not compromise the valley's ecological health. Conservation efforts involve the protection of critical habitats, sustainable resource management practices, and the promotion of biodiversity (Folke et al., 2005)[2]. Local communities are actively engaged in these efforts, contributing their traditional knowledge and participating in decision-making processes (Pretty et al., 2010)[3].

Methodology

The methodology for this research involves a qualitative approach, utilizing semi-structured interviews to gather in-depth insight. The following steps outline the procedure for conducting the study:

1. The Preparation Phase, including the literature review, conducted a comprehensive review of existing literature on integrated management, community development, conservation strategies, and socio-economic growth in protected areas provided context and background for the study, and helped refine the interview questions. Based on the literature reviewed and key research questions, the researcher designed the interview (semi-structured) as an instrument, ensuring it covered areas such as local knowledge, social behavior change, livelihoods, well-being, and adaptive management practices. Participants were identified and selected from those who represent a diverse range of stakeholders in the Vjosa Valley, including residents and community leaders, government officials connected with the field of the research and welfare and social services sectors, NGO representatives, private sector stakeholders involved in tourism and agriculture and community development. In any case, we obtained ethical approval from relevant authorities and persons to be interviewed, through prepared informed consent forms, ensuring participants understood their rights, the purpose of the study, and the confidentiality of their responses.

2. Data collection phase, realized during the period January- April 2024, included scheduling interviews, by contacting potential participants and scheduled interviews at convenient times and locations, and ensuring a diverse representation of stakeholder perspectives. Interviews (n=15: 6 residents from Përmet, Gjirokastra and Tepelena, 4 employers from municipalities of Përmet, Gjirokastra and Tepelena, 2 participants from NGOs and 3 from the MTE), were conducted beginning each interview with an introduction, explaining the purpose of the study and ensuring the participant's informed consent and continuing with the participant information (name, age, gender, occupation, role/position in the community, length of residence in Vjosa Valley).The semi-structured interview instrument included questions in the specified sections: a)Local knowledge and social behavior change (questions about traditional practices, integration into planning and management, and observed behavior changes); b) Impact of integrated management strategies (questions about perceptions of integrated management, effects on livelihoods, and well-being) c) Social and economic outcomes (questions about changes in the local economy, social cohesion, behavior change and challenges) d) Adaptive management practices (questions about collective memory, culture, space and place, and effectiveness of adaptive management practices). The interviews were realized by recording (audio-record the interviews for accurate transcription) and notes (to capture detailed notes on key points and observations), having the consent of participants. 3. Data analysis phase began with the transcription of the recorded interviews. The recorded interviews were transcript in MS Word, and also were reviewed for accuracy and completeness. To ensure data quality, the interviewer

---

2 Folke, C., Carpenter, S., Elmqvist, T., Gunderson, L., Holling, C. S., & Walker, B. (2005). *Regime Shifts, Resilience, and Biodiversity in Ecosystem Management*. Annual Review of Ecology, Evolution, and Systematics, 35(1), 557-581.

3 Pretty, J., Adams, B., Berkes, F., de Athayde, S. F., Dudley, N., Hunn, E., ... & Pilgrim, S. (2010). *The Intersections of Biological Diversity and Cultural Diversity: Towards Integration*. Conservation and Society, 8(2), 102-112.

remained neutral and encouraged participants to provide detailed and honest responses, allowed also for follow-up questions to clarify and deepen the understanding of responses. For coding and thematic analysis were identified, repeated themes and patterns related to the research questions, such as: Integration of local knowledge & Perceptions of Integrated Management based on social behavior change; Economic and social outcomes to ensure adaptive management practices as well as Long-term strategies for balancing development and conservation. 4. Triangulation was used to cross-validate the findings by comparing responses from different stakeholder groups. It included also secondary data sources, such as policy documents, reports, and observational data.

Key concepts and theoretical frameworks on conservation and sustainable community development

In regions like Vjosa Valley, where biodiversity and cultural heritage are deeply intertwined with the lives of local communities, integrated management is essential. The valley's residents engage in traditional agriculture, fishing, and emerging eco-tourism, all of which depend on the region's natural resources. Sustainable management practices help maintain these livelihoods while protecting the ecosystem (Berkes et al., 2000)[4]. The ecosystem-based approach recognizes the role of the human dimension in shaping ecosystem processes and dynamics[5]. Traditional ecological knowledge, passed down through generations, plays a crucial role in sustainable resource management. For instance, local farming practices that align with the natural cycles and characteristics of the Vjosa River's ecosystem ensure long-term territory fertility and water quality. By integrating this knowledge into formal conservation strategies, management plans become more effective and culturally relevant (Altieri, 2002)[6].

Economic Development and Environmental Protection

Economic activities that support conservation goals can lead to a win-win scenario where both the environment and the local economy benefit. Eco-tourism is a prime example, as it leverages the natural beauty and biodiversity of protected areas to generate income while promoting conservation awareness. Recently, in Vjosa Valley, according to the information found on the official websites of the municipalities of Gjirokastra, Përmeti, Tepelena, or MTE, eco-tourism initiatives such as guided tours, bird watching, and the Vjosa n`Fest Festival, have attracted visitors and created new revenue streams, supporting local businesses and providing jobs. As Honey (2008)[7], writes: " Around the world, ecotourism has been hailed as a panacea: a way to fund conservation and scientific research, protect fragile ecosystems, benefit communities, promote development in poor countries, instill environmental awareness and a social conscience in the travel industry, satisfy and educate discriminating tourists, and, some claim, foster world peace. Although "green" travel is being aggressively marketed as a "win-win" solution (Gössling, 1999)[8] for the Third World, the environment, the tourist, and the travel industry, the

4 Berkes, F., Colding, J., & Folke, C. (2000). "Rediscovery of Traditional Ecological Knowledge as Adaptive Management." *Ecological Applications*, 10(5), 1251-1262.

5 Waltner-Toews D, Kay J. 2005. The evolution of an ecosystem approach: the diamond schematic and an adaptive methodology for ecosystem sustainability and health. Ecol. Soc. 10(1):38. http://www.ecologyandsociety.org/vol10/iss1/art38/

6 Altieri, M. A. (2002). "Agroecology: The Science of Natural Resource Management for Poor Farmers in Marginal Environments." *Agriculture, Ecosystems & Environment*, 93(1-3), 1-24.

7 Honey, M. (2008). Ecotourism and sustainable development: who owns paradise. Island Press, Washington, D.C., pp. 29–31. See also: https://onlinelibrary.wiley.com/doi/epdf/10.1111/j.1477-8947.2009.01256.x

8 Gössling, S. (1999). Ecotourism: a means to safeguard biodiversity and ecosystem functions?,Ecological Economics,Volume 29, Issue 2, Pages 303-320,ISSN 0921-8009, https://doi.org/10.1016/S0921-8009(99)00012 (https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0921800999000129 (Reprinted in: Martinez-Alier, J. and Røpke, I. (2008) *Recent Developments in Ecological Economics*. Edward Elgar Publishing, Cheltenham.) Due to Gössling "win-win" strategies combine biodiversity and poverty reduction, such as protected-area tourism arrangements. Cited

reality is far more complex…" Honey distinguishes ecotourism from other terms such as nature, adventure and wildlife tourism as the only type of tourism that explicitly incorporates both a commitment to enhancing the natural environment as well as contributing to an improved quality of life for communities around the tourism destination. Honey puts forward seven criteria to understand the difference between these terms:1) travel to natural destinations; 2) minimize impact; 3)build environmental awareness; 4)provide direct financial benefits for conservation; 5) provide financial benefits and power for local people; 6)respect local culture; and 7) support human rights and democratic movements (pp. 29–31). Such initiatives also help diversify the local economy, reducing dependency on potentially harmful activities like overfishing or deforestation. Due to Adams et al., (2004:1147), "the combination of poverty elimination and biodiversity conservation goals has been approached in various ways.

The specific problem of the social impacts of protected areas has been recognized by conservation planners for two decades. When managed sustainably, eco-tourism can fund conservation projects and create incentives for preserving natural habitats. (Adams et al., 2004)[9]. Poverty and conservation (Ferraro & Kiss, 2002)[10], are separate policy realms. This position sees poverty elimination and conservation as quite different problems comprising distinct sectors of policy concern. Thus, conservation is a legitimate objective that can be pursued independently of any benefits in poverty reduction (and vice versa). Under this position, conservation strategies would focus on the establishment of protected areas or approaches such as direct payments. Biodiversity is a public good and thus is not supplied in sufficient quantities by individuals acting in their self-interest. Conservation practitioners try to make conscious individuals who destroy ecosystems and species with incentives to preserve them. These incentives lie on a spectrum from indirect to direct concerning their link with conservation objectives. Conservation initiatives in the United States, Australia, and most of Europe increasingly emphasize more direct incentives: land purchases, leases, and easements, as well as financial incentives such as performance payments and tax relief. For example, the U.S. government spends over $1.7 billion per year to induce farmers to protect land [11,12] and The Nature Conservancy, with an annual budget of more than $700 million, operates almost exclusively through land purchases and easements.[13,14] The Budget requests, funding in FY 2024, for the program of Natural Resources Conservation Service, is at $7.547 million. The program executes competitive grants through the Farmers Market Promotion Program and the Local Food Promotion Program to develop, coordinate, and expand local food markets in the U.S., to help increase access to and availability of locally and regionally produced agricultural products.

Social Well-being and Environmental Health

The well-being of local communities is intricately linked to the health of their environment. Clean water, fertile soil, and a stable climate are essential for agriculture and daily living. Therefore, conservation efforts that ensure the long-term viability of these resources directly

---

Adaptive management in Vjosa Valley demonstrates the importance of integrating collective memory, space and place, identity, culture, and behavior change into conservation and community development strategies. This holistic approach not only enhances the effectiveness of management practices but also ensures that they are culturally appropriate and locally relevant. The collaborative efforts in Vjosa Valley serve as a model for other regions facing similar challenges, highlighting the potential for adaptive management to achieve sustainable outcomes in dynamic and complex socio-ecological systems.

By harmonizing environmental preservation with economic development, the valley serves as a model for other regions facing similar challenges. The ongoing efforts in Vjosa Valley demonstrate that sustainable development is achievable through collaborative, inclusive, and adaptive management practices.

References

Adams et al. 2004. Biodiversity conservation and the eradication of poverty. *Science*.306(5699):1146-9. doi: 10.1126/science.1097920. PMID: 15539593.

Altieri, M. A. (2002). "Agroecology: The Science of Natural Resource Management for Poor Farmers in Marginal Environments." *Agriculture, Ecosystems & Environment*, 93(1-3), 1-24.

Annual Report (Nature Conservancy Washington, DC, 2002); available at: http://nature.org/abou-tus/annualreport2001/

Berkes, F., Colding, J., & Folke, C. (2000). "Rediscovery of Traditional Ecological Knowledge as Adaptive Management." *Ecological Applications*, 10(5), 1251-1262.

Borrini-Feyerabend, G., Kothari, A. and Oviedo, G. (2004). Indigenous and Local Communities and Protected Areas: Towards Equity and Enhanced Conservation. IUCN, Gland, Switzerland and Cambridge, UK. xviii + 111pp. ISBN: 2-8317-0675-0

Carol Murray David R Marmorek 2003. Adaptive management: a science-based approach to managing ecosystems in the face of uncertainty. Available from: https://www.researchgate.net/publication/237331389_ADAPTIVE_MANAGEMENT_A_SCIENCE-BASED_APPROACH_TO_MANAGING_ECOSYSTEMS_IN_THE_FACE_OF_UNCERTAINTY#fullTextFileContent

Ferraro, P., Kiss, A., (2002) Direct Payments to Conserve Biodiversity 298(5599):1718-9. DOI: 10.1126/science.1078104. Source PubMed

Folke, C., Carpenter, S., Elmqvist, T., Gunderson, L., Holling, C. S., & Walker, B. (2005). *Regime Shifts, Resilience, and Biodiversity in Ecosystem Management*. Annual Review of Ecology, Evolution, and Systematics, 35(1), 557-581

Folke, C., Hahn, Th., Olsson, P., and Norberg, J.,(2005) Adaptive governance of social-ecological systems. *Annual Review of Environment and Resources*. DOI:10.1146/annurev.energy.30.050504.144511. Available in: https://www.researchgate.net/publication/228662276_Adaptive_Governance_of_Social-Ecological_Systems?enrichId=rgreq-d1ca1e7e9b4b47bf558786f40115f046-XXX&enrichSource=Y292ZXJQYWdlOzIyODY2MjI3NjtBUzo5ODcyNTYyNDAyNTA5OUAxNDAwNTQ5NDMxNTE1&el=1_x_2&_esc=publicationCoverPdf

FY 2001 *Budget Summary* (U.S. Department of Agri-culture Washington, DC, 2001); available at www.us-da.gov/agency/obpa/Budget-Summary/2001.

FY 2024 *Budget Summary* (U.S. Department of Agri-culture Washington, DC, 2001); available at https://www.usda.gov/sites/default/files/documents/2024-usda-budget-summary.pdf

Gonzalez, M.R., (2002) GIS-assisted Joint Learning: A Strategy in Adaptive Management of Natural Resources. *Adaptive Management: From Theory to Practice*. *IUCN*, Gland, Switzerland and Cambridge, UK. vi and 166pp

Gössling, S. (1999). Ecotourism: a means to safeguard biodiversity and ecosystem functions. *Ecological Economics,Volume 29, Issue 2*, Pages 303-320,ISSN 0921-8009, https://doi.org/10.1016/S0921-8009(99)00012 (https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0921800999000129 (Reprinted in: Martinez-Alier, J. and Røpke, I. (2008) *Recent Developments in Ecological Economics*. Edward Elgar Publishing, Cheltenham.)

Honey, M. (2008). Ecotourism and sustainable development: who owns paradise. Island Press, Washington, D.C., pp. 29–31. See also: https://onlinelibrary.wiley.com/doi/epdf/10.1111/j.1477-8947.2009.01256.x

Kibonde, S. (2020) Indigenous Knowledge and Conservation of Medicinal Plants in Rungwe District, Tanzania. *Open Access Library Journal*, **7**, 1-10. doi: 10.4236/oalib.1106545.

Oglethorpe, J.A.E. (ed.) (2002). Adaptive Management: From Theory to Practice. IUCN, Gland, Switzerland and Cambridge, UK. vi and 166pp

Pretty, J., Adams, B., Berkes, F., de Athayde, S. F., Dudley, N., Hunn, E., ... & Pilgrim, S. (2010). *The Intersections of Biological Diversity and Cultural Diversity: Towards Integration*. Conservation and Society, 8(2), 102-112.

Pretty et al., (55 authors) (2010) The top 100 questions of importance to the future of global agriculture. International Journal of Agricultural Sustainability. 8(4):219-236

DOI: 10.3763/ijas.2010.053

Muço, K., Kokthi, E., Guri, F., Shehu, E., Sovinc, A. (2023). Vjosa Wild River National Park (VWRNP): Integrated Management Plan: *Socio-Economic Study. Analyses &Integrated Methodology to Identify a Value for Ecosystem Service (the case of the Vjosa Valley in Albania*). Ministria e Turizmit dhe Mjedisit &IUCN Belgrade Office for Eastern Europe and Central Asia. Pp.5.

Walker B, Holling CS, Carpenter SR, Kinzig A. 2004. Resilience, adaptability andtransformability in social-ecological systems. *Ecol. Soc. 9(2):*5. http://www. ecologyandsociety.org/vol9/iss2/art5/

Waltner-Toews D, Kay J. 2005. The evolution of an ecosystem approach: the diamond schematic and an adaptive methodology for ecosystem sustainability and health. *Ecol. Soc. 10(1)*:38. http://www.ecologyandsociety.org/vol10/iss1/art38/

Van der Leeuw SE. (2000). Land degradation as a socio natural process. See Ref. 197, pp. 190–21. Cited by: Folke, C., Hahn, Th., Olsson, P., and Norberg, J.,(2005).

TË DHËNA MBI DISA HEXAPODE TË TAKUARA NË RAJONINUJËMBLEDHËS TË LUMIT TË KARDHIQIT SI PJESË E EKOSISTEMIT TË PARKUT NATYROR TË LUMIT TË VJOSËS

[1]Prof. dr. Lavdi Hasani, [2]Dr. Aneta Çomo

[1,2]Department of Biosciences, Environment and Food, Faculty of Natural Sciences, "Eqrem Çabej" University,Gjirokastër, Shqipëri,

Email: lhasani@uogj.edu.al, acomo@uogj.edu.al

Përmbledhje

*Në punimin e më poshtëm janë paraqitur disa të dhëna të ilustruara mbi disa invertebrorë të grumbulluar gjatë disa ekspeditave të kryera në terren në kohën e praktikës verore. Në këtë proces janë grumbulluar një sërë invertebrorësh (kryesisht nga Klasa Hexapoda e N/Tipit Mandibulata). Duhet thënë qysh në fillim se, nga moria e madhe e përfaqësuesëve të këtij grupi, në materialin e mëposhtëm, nuk është se ne kemi evidentuar të gjitha llojet që mund të gjenden në këtë ekosistem, por vetëm ato lloje që ne kemi mundur të koleksionojmë. Fondi i llojeve që ne kemi mundur të koleksionojmë dhe që i kemi paraqitur në këtë punim janë lloje që shprehin një diversitet të konsiderueshëm për këtë mjedis. Kjo e kushtëzuar nga pasuria dhe specifikat e faktorëve ekologjikë trofikë dhe abiotikë të këtij ekosistemi. Kështu janë evidentuar **38** lloje me takueshmëri të lartë (sipas përcaktimeve në metodikën tonë të punës), **9** lloje që takohen më rrallë në këtë ekosistem dhe **14** llojeqë janë lloje me rrisk për zhdukje dhe që për këtë arsye janë të përfshira aktualisht edhe në Librin e kuq të faunës së Shqipërisë. Mbi bazën e analizës së të dhënave të përftuara në këtë rast, ne kemi dalë edhe me disa përfundime ndër të cilët më i rëndësishmi është ai që na sugjeron se kemi edhe lloje të tjera që duhen përfshirë tashmë në fondin e llojeve me rrisk për zhdukje (vulnerabile).*

***Fjalë kyçe:** Biodiversitet, fauna, hexapod, ekosistem, specie, e rrezikuar*

Abstract

In the following paper, some illustrative data on some invertebrates collected during some expeditions carried out in the field at the time of summer practice are presented. In this process, a number of invertebrates have been collected (mainly from the Hexapoda Class of N / Type Mandibulata). It must be said from the beginning that, from the large number of representatives of this group, in the following material, it is not that we have identified all the species that can be found in this ecosystem, but only those species that we have been able to collect. The fund of species that we were able to collect and that we have presented in this work are species that express a considerable diversity for this environment. This is conditioned by the wealth and specifics of the trophic and abiotic ecological factors of this ecosystem. Thus, 38 species with high incidence (according to the definitions in our work methodology) have been identified, 9 species that meet less often in this ecosystem, and 14 species that are species at risk of extinction and that are therefore currently included in the Book Red of the Fauna of Albania. Based on the analysis of the data obtained in this case, we have also come up with some conclusions, the most important of which is the one that suggests that we have other species that should already be included in the fund of species at risk of extinction (vulnerable).

***Keywords:** Biodiversity, fauna, hexapod, ecosystem, species, endangered.*

Hyrje

Rajoni ujëmbledhës i lumit të Kardhiqit përfshin dy degë burimesh ujore; atë që vjen nga lartesitë e Kaparielit si dhe atë të grykërrjedhës që përfshin edhe vetë masivin pyjor natyror të zonës së Kardhiqit në rrethin e Gjirokastrës. Ky i fundit është shpallur "Rezervat strikt natyror/

Rezervat shkencor“- Kategoria I me VKM nr. 102 datë 15.01.1996. Sipërfaqja e përgjithshme e këtij masivi është 1800 ha dhe është i vendosur në pjesën veriperëndimore të rrethit të Gjirokastrës (22 km larg saj) dhe ka këtë shtrirje koordinative:

a. Në veri: Përroi i Piksit (44 15 838.61 44 42 129.87)
b. Në lindje: Përroi i Qafë Mollës (44 18 376.85 44 41 829.74)
c. Në jug: Maja Kershait (1782.8m) (44 20 254.80 44 87 696.53)
d. Në perëndim: Qafa e Skërficës (812.0m) (44 15 392.70 44 37 319.22).

Vetë ky masiv pyjor karakterizohet nga një shumëllojshmëri dhe larmishmëri bimësh barishtore, shkurre e drurë. Nisur nga literatura e shfrytëzuar sipërfaqësues specifik të florës dhe faunës në këtë ekosistem mund të përmendim se:

Flora *përfaqësohet nga: Bredhi i bardhë, panja e malit, krekëza, frashëri, dushqet, rrobulli, pisha e zezë etj.*

Fauna *përfaqësohet nga: Derri i egër, dhia e egër, lepuri i egër, ujku, dhelpra, thëllëza e malit etj. Si monumente natyre njihetKanioni i Piksit.(Shuka L. etj. 2004)*

Favorizuar nga koordinatat e shtrirjes gjeografike jo vetëm të Rezervatit Natyror të Kardhiqit, por edhe të të gjithë ekosistemit në fjalë krijohen kushte tepër të favorshme për zhvillimin e:

A. Një shumëllojshmërie bimësh barishtore, shkurrore e drunore.
B. Një faune tepër të pasur në lloje, madje, edhe me specie që sot, jo vetëm këtu te ne, por edhe në gjithë botën, gjenden në rrezik zhdukje.
C. Po kështu, në këtë rajon, kjo pasuri llojore na prezantohet e tillë edhe në faunën invertebrore në të cilin është përqendruar edhe ky studim.

Në këtë mënyrë ajo merr vlera specifike e karakteristika të veçanta përsa i përket llojeve të rralla të këtij niveli të botës së gjallë apo edhe specieve të caktuara të kësaj bote që sot në shumë ekosisteme janë të rezikuara apo edhe në zhdukje të plotë.

Nga ana tjetër, njëkohësishtë vrehen edhe shumë lloje që ruajnë gjendjen e lulëzimit të tyre ashtu si edhe më parë, apo që këtë gjendje kanë mundur ta rifitojnë gjatë kësaj periudhe për të cilën po flasim.

Materiali dhe metodat

Për grumbullimin e të dhënave mbi faunën invertebrore të këtij parku natyror ne kemi kryer një sërë ekspeditash në terren në kohën e praktikave verore, dhe më të fundit në muajin maj të vitit të kaluar. Në tërësi ekspeditat janë kryer në periudhat maj-qershor gjatë pesë viteve kalendarike në vijim. Materiali u grumbullua me ndihmën e rrjetave entomologjike dhe ruhej në zarfa apo kavanoza me pak pambuk të lagur me eter.

1. Në këtë proces janë grumbulluar një sërë invertebrorësh (kryesisht nga Klasa Hexapoda e

N/Tipit Mandibulata). Materiali i koleksionuar është përpunuar dhe determinuar në laborator dhe ka shërbyer si koleksion bazë për studentët për përgatitjen dhe mbrojtjen që ata duhet të bëjnë lidhur me praktikën profesionale të tyre në terren. Takueshmëria e species, si koncept biologjik tepër variabël, për t'u bërë e njësueshme dhe e ekuivalentueshme edhe për studiues të tjerë, është e nevojshme të jepet sipas një shkalle të përcaktuar qysh më parë nga ne. Konkretisht, ne kemi konsideruar si: "Specie me takueshmëri të lartë" rastin kur specia është takuar në të gjitha ekspeditat e organizuara dhe numri i individëve të grumbulluar gjatë një dite ekspedite, ishte jo më i vogël se 10 individë.

2. "Specie me takueshmëri të ulët" rastin kur specia është takuar në të gjitha ekspeditat e organizuara dhe numri i individëve të grumbulluar gjatë një dite ekspedite, ishte jo më i vogël se 4 individë dhe,

3. "Specie të rrezikuara" (Sipas Librit të kuq të faunës së Shqipërisë) rastin kur specia e takuar gjatë ekspeditave të organizuara rezulton edhe e skeduar në Librin e kuq të Faunës si specie e kërcënuar, në rrezik zhdukje apo me rrezik vulnerabël.

Rezultate dhe diskutime

Gjatë punës sonë në terren dhe po ashtu edhe gjatë përpunimit dhe determinimit të materialit në laborator bie në sy qartë se biodiversiteti i këtij masivi pyjor bën që aty të rritet një shumëllojshmëri e madhe speciesh shtazore. Ashtu siç edhe e kemi parashtruar më sipër, padashur të mohojmë edhe të gjitha llojet e tjera që, si kudo, gjenden edhe në këtë ekosistem, por që ne nuk kemi mundur t'i koleksionojmë, ne do të fokusohemi në përpunimin e të dhënave vetëm për llojet e koleksionuara. Mbi këtë bazë ne, speciet e takuara, i kemi grupuar në tri grupe kryesore si më poshtë:

A. Specie me takueshmëri të lartë.
B. Specie me takueshmëri të ulët.
C. Specie të rrezikuara (sipas Librit të kuq të faunës së Shqipërisë).

A- Nga llojet me takueshmëri të lartë:

(Carter D. 1999, Chinery M. 2004, McGavin C.G. 2000, Misja K. 2003, Misja K., Hasani L.1989)

- Nga Rendi Ephemeroptera (Ditëshkurtrat)

Fam. Ephemeroidae:***Ephemera vulgata**L.

- Nga Rendi Odonata (Pilivesat) N/Rendi Zygoptera (Flatrabarabartët)

Fam. Calopterygidae*: ***Calopteryx virgo* L. ***Calopteryx splendes*** Harr.

Fam. Aeschnidae:***Anax imperator*** Lea.

Fam. Libellulidae:***Orthetrum cancellatum*** L., ***Libellula depressa*** L.

- Nga Rendi Orthoptera: (Flatradrejtët – Karkalecat)

Fam. Acrididae: *****Oedipoda germanica* Pall.

- Nga Rendi Dermaptera: (Gëshërzat)

Fam. Forficulidae: *****Forficula auricalaria* L.

- Nga Rendi Homoptera: (Gjinkallat) N/Rendi Cicadinea (Gjinkallat)

Fam.Cicadidae: *****Cicada orni* L., ***Lyristes plebejus*** Scop.

Fam. Cercopidae: *****Cercopis sanguinea* Geo.

- Nga Rendi Hemiptera: (Gjysmëkrahëfortët)

Fam. Pentatomidae: *****Graphosoma lineatum* L.(italicum Mull.)

- Nga Rendi Coleoptera (Krahëfortët): -*N/Rendi Adephaga* (zgjedhës në ngrënie)

*Fam. Cicindelidae: ***Cicindela campestris*** L.

-*N/Rendi Polyphaga* (gjithçkangrënës)

Fam. Coccinelidae (Pashkëzat): ***Coccinella septempunctata*** L.("Buburrezja" me dy elitra të kuqe e me **7** pika të zeza në to).

*Fam. Scarabidae ***Scarabaeus sacer*** L., ***Melolontha melolontha*** L., ***Anisoplia austriaca*** Hb. ***Potosia metallica*** Hbst. ***Cetonia aurata*** L. ***Amphicoma vulpes*** F. ***Epicometis hirta*** Poda.

- Nga Rendi Lepidoptera (Krahëlusporët, nga Lepis = Luspë, ose Fluturat): *N/Rendi Heteroneura* (me inervime të ndryshme të krahëve) - *Lloje me jetë dite*:

Fam. Pieridae (Fluturat bardhoshe). ***Pieris brassicae*** L.(Flutura e lakrës), ***Pieris napi*** L., ***Pierisrapae*** L., ***Leptidia sinapi*** L., ***Pontia daplidice*** L., ***Aporia crataegi*** L.,***Colias crocea*** Fourc.

*Fam. Lycaenidae:***Plebejus argus** L.

Fam. Satyridae (Fluturat e errëta): ***Pararge aegeria*** L., ***Pararge maera*** L, ***Pararge megera*** L., ***Melanargia larisa*** Gey.,***Melanargia galathea*** L., ***Maniola jurtina*** L.

- Nga Rendi Hymenoptera: (Flatramembranorët), N/Rendi Aculeata (thumbuesit)

*Fam. Scolidae: ***Scolia quadripunctata*** F.

*Fam. Apidae:***Xylocopa violaceae** L., ***Bombus terrestris*** L.,

B-Nga llojet me takueshmëri të ulët:

(Carter D.1999, Chinery M.2004,McGavin C.G. 2000, Misja K. 2003,Misja K.,Hasani L. 1989)

- Nga Rendi Phasmatoptera (I shkopinjve)

*Fam. Phyllidae:***Bacillus rossi** Fabr.(?)

- Nga Rendi Coleoptera (Krahëfortët): -*N/Rendi Polyphaga* (gjithçkangrënës)

Fam. Coccinelidae (Pashkëzat):

Coccinella bipunctata L.(?) vetëm me dy pika të zeza - një për çdo elitër

Fam. Scarabidae

Oryctes nasicornis L (?)

- Nga Rendi Lepidoptera (Krahëlusporët, nga Lepis = Luspë ose Fluturat):

N/Rendi Heteroneura (me inervime të ndryshme të krahëve) - *Lloje me jetë dite*:

*Fam. Papilionidae ("Fluturat bajrake"), ***Papilio machaon*** L.(?), ***Iphiclidess (Papilio) podalirius*** L.

*Fam. Nymphalidae ***Polygonia c-allbum*** L. ***Argynnis paphia*** L**.**

- Nga Rendi Hymenoptera: (Flatramembranorët), N/Rendi Aculeata (thumbuesit)

*Fam. Apidae: ***Bombus argjillaceus*** Scop.

- Nga Rendi Orthoptera: (Flatradrejtët – Karkalecat)

*Fam. Tettigonidae:***Tettigonia viridissima** L.

C- Nga llojet e kërcënuara apo të rrezikuar (sipas Librit të kuq të faunës së Shqipërisë):

(Misja K.2006, D'Aguilar J., Dommanget J-L., Prechac R. 1990)

- Nga Rendi Coleoptera (Krahëfortët): *N/Rendi Adephaga* (zgjedhës në ngrënie)

Fam. Carabidae: ***Calosoma sycophanta*** L. **Statusi: EN**, [trupbukuri]

*Fam. Cerambycidae: ***Rosalia alpina*** L. **Statusi: CR**; ***Aromia moschata*** L. **Statusi: VU(A1b)**, (me erë karakteristike si trendafil)., ***Cerambyx cerdo*** L. **Statusi: EN, *Purpuricenus koehleri*** L.**Statusi: VU(A1b)**, ***Purpuricenus herus***

L. **Statusi: VU(A1b)**

Fam. *Lucanidae* (Kacadrerët): ***Lucanus cervus* L. **Statusi: LR(Ic).(**Kacadreri)

- Nga Rendi Neuroptera: (Krahët me nervura)

Fam: *Ascalaphidae* (Krahët me nervura): ***Libelloides ottomanus* L.

Statusi: VU(A1b)

Fam. *Myrmeleontidae*: ***Myrmeleon formicarius* L., **Statusi: LR(nt)**

- Nga Rendi Lepidoptera (Krahëlusporët ose Fluturat):

N/Rendi Heteroneura (me inervime të ndryshme të krahëve) - *Lloje me jetë dite*:

Fam. *Papilionidae* "Fluturat bajrake"; ***Papilio alexanor* Esp.**Statusi:**

VU(B2b),

Fam. *Nymphalidae* ***Nymphalis (Vanesa) antiopa* L. **Statusi:VU(A1b)**, ***Chazara briseis*** L. **Statusi: VU(A1b). ***Limentis reducta*** Stg. **Statusi: VU(A1b)**

Fam. *Satyridae* (Fluturat e errëta): ***Brintesia circe* Fabr. **Statusi: VU(A1b)**

EN= Specie e kërcënuar me rrisk të lartë, por jo për zhdukje.

CR = Specie e kërcënuar në mënyrë kritike për zhdukje.

VU(A1b) = Specie e përkeqësuar. Rënie/zvogëlim i zonës së përhapjes. Rënie e ndodhur.

LR(Ic) = ***Kategoritë e kërcënimit sipas IUCN-së, 1994 shprehin sa më poshtë:***

Specie e kërcënuar me rrisk të ulët. Rrisku nuk varet nga masat ruajtëse dhe nuk rrezikohet për të rënë në nënkategorinë "gati i rrezikuar".

VU(B2b) = Specie e përkeqësuar. Rënie/zvogëlim i zonës së përhapjes. Rënia e pritur.

LR(nt) = Specie e kërcënuar me rrisk të ulët. Taxoni është gati për të rënë në kategorinë "I përkeqësuar"(VU)

Më poshtë po japim një ilustrim figurativ për të gjitha llojet e koleksionuara nga ne:

Pararge megera L.
Pararge maera L.
Pararge aegera L.
Myrmeleon formicarius L.
Polygonia c-album L.
Pieris brassicae L
Pieris napi L.
Pieris rapae L
Leptidia sinapi L.
Pontia daplidice L.
Iphiclidess podalirius L.
Papilio machaon L.
Papilio alexanor Esp.
Chazara briseis L.
Nymphalis (Vanesa) antiopa L.
Rosalia alpina L.
Libelloides ottomanus L.
Ephemera vulgata L.

Calopteryx virgo L.
Calopteryx splendes Harr.
Anax imperator Lea.
Orthetrum cancellatum L.
Libellula depressa L.
Bacillus rossi Fabr.
Tettigonia viridissima L.
Oedipoda germanica Pall.
Forficula auricalaria L.
Lyristes plebejus Scop.
Cicada orni L.
Cercopis sanguinea Geo.
Graphosoma lineatum L.
Cicindela campestris L.
Purpuricenus koeheleri L.
Purpuricenus herus L.
Scarabaeus sacer L.



Nga përpunimi i të dhënave tona, n.q.se do të shprehnim grafikisht raportin midis tri grupeve llojore të ndara në funksion të frekuencës së takueshmërisë (graf.nr.1), raportin krahasimor të secilit grup llojor në raport me të tërën (graf.nr.2), si dhe raportin në përqindje midis llojeve të takuara për secilin rend (graf. nr.3) do të kemi sa më poshtë:



Graf. 1. Raporti në përqindje e grup-specieve të takuara nga ne.



Graf. 2 - Raporti midis numrit llojor të secilit grup me numrin e përgjithshëm të llojeve të takuara nga ne.



Graf. 3. Numri i llojeve të takuara për çdo rend në %-je.

Konkluzione dhe përfundime

1. Si edhe shihet (Graf. nr.1 & 2) numri i llojeve me takueshmëri të ulët është më i vogel se numri i llojeve te gr. C, Specie të rrezikuara, në një kohë që duhet të ishte e kundërta. Kjo flet për atë që numri i specieve me rrisk për zhdukje në këtë grup duhet të jetë i lartë. Kështu mund të themi se ky është tashmë një problem i identifikuar.

2. Shqetësues është fakti i specieve të tjera (të grupit të dytë), të përkeqësuara tashmë edhe në këtë ekosistem, gjë që s'duhej të ekzistonte nëse nuk do të kishim përkeqësim të situatës, e

krahasuar kjo me gjendjen e mëparshme, të njohur dhe të pasqyruar nga literatura (Misja K. 2006).

3. Shumëllojshmëria e luleve dhe përshtatshmëritë e mënyrave të të ushqyerit të përfaqësuesve të rendit Lepidoptera (e përfaqësuar me numrin më të madh prej 23 llojesh) ka çuar në atë që disa përfaqësues të këtij rendi të vazhdojnë të njohin lulëzimin e tyre (Graf. nr.3).

4. Akoma më shqetësues bëhet fakti që shumë specie të kësaj bote pararruazorësh janë jo vetëm të rrezikuar në zonën në fjalë, por edhe në rrezik zhdukje (**CR**, **VU(A1b), VU(B2b)**.

5. Duke ditur që larmishmëria llojore e hexapodëve të këtij masivi natyror është njëri nga faktorët më kryesor që merr pjesë në pjalmimin e bimëve edhe në këtë ekosistem mund të themi pa droje se është pikërisht ky fakt edhe njëri nga faktorët që i ka dhënë mundësi zhvillimit të një biodiversiteti mjaft të madh të botës bimore të tij.

6. Siç e pamë në llojet e grupit B, **4** lloje mbajnë simboliken (?). Kjo tregon se ka ekspedita ditore kuketo lloje nuk janë takuar fare (edhe kur janë takuar kjo ka qenë nën nivelin e atij grupi.) Për këtë, ne mund të konkludojmë se tashmë edhe llojet ***Coccinella bipunctata*** L., ***Bacillus rossi*** Fabr., ***Oryctes nasicornis*** L. dhe ***Papilio machaon*** L., mund të përfshihen në kategorinë e përkeqësimit **VU(A1b)** për këtë ekosistem.

Referencat

CARTER D. [1999] – Farfalle e falene (Guida fotografica a oltre 500 specie di farfalle e falene di tutto il mondo). London 1992, Milano 1993, 1999.

CHINERY M. [2004] – Guida degli Insetti D'Europa (Atlante illustrato a colori. 800 illustrazioni a colori 350 disegni). London 1993, Franco Muzzio editore 1998,2000,2004.

D'AGUILAR J., DOMMANGET J-L., PRECHAC R. [1990] – Guida delle Libellule D'Europa e del Nordafrica (40 tavole a colori, 125 cartine). Paris 1985, Franco Muzzio editore 1990

McGAVIN C. G. [2000] – Insetti, Ragni e altri artropodi terrestri (Guida fotografica a oltre 300 specie di tutto il mondo). London, Miliano, 2000.

MISJA K. [2003] – Entomologjia fq. 180 – 230. SHBLU, Tiranë, 2003.

MISJA K., HASANI L. [1989] – Udhëzues për praktikën verore. Klasa e kandrrave (Insecta), Tiranë ,1989.

MISJA K. [2006] – Libri i kuq i faunës shqiptare. MMPAU, Tiranë, 2006.

SHUKA L.,DRAÇI B., [2004] - Zona e mbrojtur e Kardhiq- Rrëzomës fq. 37 – 61.

https://zbulime.wordpress.com/2010/12/28/parqet-natyrore-dhe-kombetare-te-shqiperise/

https://docplayer.org/82453334-Raport-auditimi-menaxhimi-i-parqeve-kombetare.html. Dhjetor 2016.

DISA PARAMETRA TË PROCESEVE MIKROEVOLUTIVE NË POPULLATËN E QYTETIT TË GJIROKASTRËS TË VLERËSUARA NËPËRMJET METODËS SË IZONIMISË

[1]Dr. Aneta Çomo, [2]Prof. dr. Lavdi Hasani
[1,2]Department of Biosciences, Environment and Food, Faculty of Natural Sciences, "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
Email: acomo@uogj.edu.al, hasanilavdi@yahoo.com

Përmbledhje

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i disa parametrave dhe treguesve të ndryshëm të cilët janë karakteristikë për të kuptuar proceset mikroevolutive në popullatën njerëzore të qytetit të Gjirokastrës. Për të vlerësuar parametrat dhe faktorët e ndryshëm të popullatës u përdoren mbiemrat. Mbiemrat plotësojnë, pothuajse, të gjitha kushtet e teorisë neutrale të evolucionit, meqenëse, në shumicën e popullatave, duke qenë se trashëgohen në rrugë atërore, janë konsideruar si alele të një gjeni në kromozomin Y. Kjo veti e mbiemrave u përdor për të analizuar strukturën gjenetike të popullatës. Të gjitha të dhënat janë mbledhur nga regjistrat e martesave duke filluar nga viti 1946 deri në vitin 2006 për çdo 5 vjet. Gjithsej janë analizuar të dhënat për 2503 martesa. Nga përpunimi i të dhënave janë vlerësuar parametra, si: koeficienti α i Fisherit si një tregues i pasurisë së mbiemrave në popullatë, ν-ja e Karlin-McGregors si tregues i shkallës së migrimit dhe koeficienti i inbridingut si tregues i izolimit gjenetik të popullatës. Në popullatën në studim individët rezidentë dominojnë kundrejt të ardhurve dhe martesat endogame ndaj atyre egzogame. Vlerat e α-s së Fisherit evidentojnë praninë në popullatë të pasurisë së mbiemrave. Nga njehësimet e ν-së së Karlin-McGregors vihet re se qyteti i Gjirokastrës ka nje intensitet të lartë migrimi. Migrimi është kryer kryesisht në mënyrë individuale ose në grupe të vogla familjare. Krahasimi i ecurisë së koeficientit të inbridingut tërësor Ft dhe α së Fisherit treguan se gjejmë një përputhje shumë të mirë për ecurinë e vlerave të pasurisë së mbiemrave (α e Fischer) me ecurinë e inbridingut total (Ft), gjë e cila tregon ecurinë e izolimit gjenetik të popullatës. Hapja e popullatës dhe rritja e pasurisë gjenetike të saj janë në harmoni me faktorë të zhvillimit ekonomikë, politikë dhe socialë.

***Fjalë kyçe**: pasuria e mbiemrave, shpërndarja e mbiemrave, izonimi,migrim, sruktura e popullatës, inbriding.*

Abstract

The purpose of this study is to evaluate several parameters and different indicators that are characteristic of understanding the microevolutionary processes in the human population of the city of Gjirokastra. Adjectives are used to estimate various parameters and factors of the population. Surnames meet almost all the conditions of the neutral theory of evolution since, in most populations, being inherited in a paternal way, they are considered alleles of a gene on the Y chromosome. This property of surnames was used to analyze the genetic structure of the population. All data were collected from marriage registers starting from 1946 to 2006 for every 5 years. In total, the data for 2503 marriages were analyzed. From the data processing, parameters such as Fisher's coefficient α as an indicator of the wealth of surnames in the population, Karlin-McGregors ν as an indicator of the migration rate, and the inbreeding coefficient as an indicator of the genetic isolation of the population were evaluated. In the population under study, resident individuals dominate over newcomers and endogamous marriages over exogamous ones. Fisher's α values indicate the presence in the population of the wealth of surnames. From the Karlin-McGregors ν calculations, it is observed that the city of Gjirokastra has a high migration intensity. Migration was mainly carried out individually or in

small family groups. Comparison of the progress of the coefficient of total inbreeding Ft and Fisher's α showed that we find a very good agreement for the progress of the richness values of surnames (Fischer's α) with the progress of total inbreeding (Ft) which indicates the progress of genetic isolation of the population. The opening of the population and the increase of its genetic wealth are in harmony with factors of economic development, political and social.

***Keywords**: isonymy, population structure, surname distribution, marital structure, migration.*

Hyrje

Në bazë të procesit të mikroevolucionit qëndron popullata. Për të vlerësuar parametra dhe tregues të ndryshëm të popullatës si inbridingu i llogaritur nga izonimia dhe migrimi të cilët përdoren për të kuptuar proceset mikroevolutive të saj, përdoren dhe mbiemrat. Në sistemet e mbiemrave,veçantërisht në vendet e Evropës Perëndimore dhe Jugore ku ato trashëgohen sipas rrugës atërore mbiemrat simbolizojnë alelet e gjeneve neutrale të trashëguara vetëm nëpërmjet kromozomit Y. Për këte arsye ata kënaqin mjaft mirë kërkesat e teorisë neutrale të evolucionit, e cila përshkruhet në terma të mutacioneve, migrimit, driftit gjenik etj.Nëse trashëgimia e mbiemrit është ekuivalente me trashëgiminë e kromozomit Y, një tip i dhënë i kromozomit Y do të duhej të korrespodonte në përgjithësi me një mbiemër.(Barai at al, 1987; Barai at al, 1989;Cavalli-Sforza & Edwards, 1967; .Zei et al, 1983). Kjo veti e mbiemrave së bashku me lehtësinë e grumbullimit të tyre i ka bërë ata një mjet shumë të dobishëm në studimin e strukturës dhe proceseve evolutive në popullatat njerëzore. (Cavalli-Sforza & Edwards, 1967; Rodriguez-Larralde et al, 1993.)

Ideja e përdorimit në vazhdimësi të të njëjtit mbiemër në çiftet e martuara (izonimia), për të studiuar sasinë e inbridingut në një popullatë, u paraqit për herë të parë nga Darvini më 1875. Formulat për llogaritjen e koeficentit të inbridingut nga izonimia dhe ndarja e tij në komponentë të rastit dhe jo të rastit u paraqit nga Crow & Mange. (Crow & Mange, 1965; Crow, 1980). Dhjetëra mijëra mbiemra u analizuan në këtë mënyrë dhe rezultatet ishin të frytshme në krahasimin e së njëjtës shoqëri në periudha të ndryshme kohore si dhe komuniteteve të ngjashëm (Lasker & Kaplan, 1985; Morton et al 1976). Gjithashtu, përdorën të njëjtën logjikë për studimet mbi lidhjet e gjakut apo marrëdhëniet midis komuniteteve.

Në përgjithësi këto lloj studimesh tregojnë ndikim të dukshëm të distancës gjeografike në srukturën gjenetike të popullatave dhe në shumë raste shpërndarja e mbiemrave mund të ofrojë informacion mbi origjinën gjeografike të njerëzve.

Studimi i variacionit të mbiemrave në një popullatë na jep informacion dhe për migrimet që kanë ndodhur në popullatën në studim.

Materiali dhe metodat

Materiali i përdorur në këtë punim është një kampion mbiemrash i përftuar nga regjistrat e martesave të qytetit të Gjirokastrës dhe fshatit Lazarat duke filluar nga viti 1946 dhe regjistrat e çdo pesë viteve, p.sh. 1946, 1951, 1956 e në vazhdim nderi në 2006. Të dhënat e qytetit Gjirokastër janë trajtuar bashkë me ato të fshatit Lazarat, pasi deri në vitin 2005 qyteti dhe fshati Lazarat kanë pasur një zyrë të përbashkët të gjendjes civile dhe ishte shumë e vështirë për t'i ndarë dhe studiuar veçmas. Për vitin 2006 të dhënat janë marrë nga regjistri i qytetit dhe nga ai i fshatit Lazarat në mënyrë që në studimi të ruhej vazhdimësia e të dhënave. Duke ditur se të dhënat para vitit 1946 mungojnë, pothuajse tërësisht, nuk janë të sakta ose janë të pakta, në punimin tonë janë përdorur vetëm të dhënat që fillojnë prej vitit 1946 e në vazhdim, duke pasur parasysh se regjistrimet që fillojnë në këtë kohë janë të rregullta. Çdo individ regjistrohet me këto të dhëna: emër, mbiemër, atësia, mëmësia, datëlindja (data,muaji,viti), vendlindja, seksi, data e martesës etj.

Pasi u grumbulluan të dhënat e nevojshme u analizuan të gjithë mbiemrat duke treguar numrin e përgjithshëm të individëve të regjistruar, numrin e mbiemrave etj.. Pastaj u llogaritën frekuencat

absolute dhe relative të mbiemrave për të gjithë individët, për femrat më vete dhe për meshkujt më vete. Individët u grupuan në periudha sipas vitit të lindjes (zakonisht në periudha dhjetëvjeçare), p.sh.:periudha e parë: të lindurit deri në vitin 1910, periudha e dytë 1911-1920, periudha e tretë 1921-1930 e kështu me radhë. Duke pasur parasysh vendlindjen e secilit individ i ndamë sipas dekadave të lindjes: bashkë, meshkuj dhe femra, rezidentë dhe të ardhur.

Për secilën periudhë kohore të lindjes së individëve janë vlerësuar parametrat: I, α, dhe ν.

Izonimia jo e pritur e rastit (I) dhe α e Fischerit, si tregues i pasurisë së mbiemrave, si pasojë dhe i migrimit të akumuluar, janë njehësuar sipas Rodriguez & Larralde. (Rodriguez -Larralde et al, 1993)

$$Iii = \Sigma k\ (pik)^2 - 1/Ni$$

ku: pik është shpeshtia relative e mbiemrit në grupin me madhësi Ni.

$$\alpha = 1/Iii$$

ν-ja e Karlin Mc. Gregorit si tregues i ritmeve të migrimit është njehësuar sipas Zei et al. (Zei et al, 1983)

$$\nu = (1 - Bii)/\ [Bii(Ni - 1)] \text{ ku } Bii = \Sigma k\ (pik)^2$$

Koeficienti i inbridingut Ft (inbridingu total) dhe përbërësit e tij Fr (inbridingu i rastit) dhe Fn (inbridingu jo i rastit) janë njehësuar sipas Crow & Mange. (Crow & Mange, 1965).

$$Fr = \Sigma k\ (pik\ x\ qjk)/\ 4$$

$$Fn = [Iii\ -\ \Sigma k\ (pik\ x\ qjk)]\ /\ \{4\ [1 - \Sigma k\ (pik\ x\ qjk)]\}$$

$$Ft = Fr\ (1 - Fn)\ +\ Fn$$

REZULTATE DHE DISKUTIME

I-Pasuria e mbiemrave

Kampioni i analizuar përfshin 5006 individë (2503 martesa), nga të cilët 3964 janë rezidentë dhe 1042 të ardhur. Pasuria e mbiemrave përbëhet nga 1840 mbiemra. Terezidentët kjo pasuri rezulton në 1344 mbiemra, ndërsa te të ardhurit 787 mbiemra. 291mbiemra hasen te të dy grupet.



Grafiku 1: Pasuria e mbiemrave të popullatës

Nga një sudim analog në qytetin tjetër të qarkut të Gjirokastrës, Përmetit rezulton se pasuria e mbiemrave të tij është 1081 mbiemra, nga të cilat 710 i hasim te rezidentët dhe 371 mbiemra te të ardhurit,(Dervishi & Mikerezi, 2010).

Nga krahasimi midis dy qyteteve evidenohet qartë një pasuri më e madhe mbiemrash në qytetin e Gjirokastrës,rreth 760 më shumë. Kjo diferencë reflektohet si te rezidentët dhe tek të ardhurit.



Grafiku 2: Pasuria e mbiemrave të Gjirokastrës dhe Përmetit

Një diferencë e tillë është e natyrshme, pasi qyteti i Gjirokastrës është qendër më e madhe banimi se Përmeti, për arsye të faktorëve gjeografikë, ekonomikë, socialë etj.

Mbiemrat më të shpeshtë që hasen tek individët rezidentë janë: Shehu, Sinani, Kore, Gjini, Aliko, Sino, Lani etj, ndërsa për të ardhurit mbiemrat që hasen më shpesh janë: Hoxha, Shehu, Shehaj, Sadedini, Prifti etj.

Duke krahasuar mbiemrat e rezidentëve dhe të të ardhurve vëmë re diçka shumë interesante: mbiemri Shehu është ndër mbiemrat e hasur më shpesh dhe te rezidentët dhe te të ardhurit. Të tjerë mbiemra si ky janë dhe mbiemrat Sinani dhe Hoxha.

Analiza e strukturës së mbiemrave dhe frekuencave respektive evidenton evolucionin strukturor të tyre si elemente strukturore neutrale gjenetike dhe si elemente linguistike.

Kështu, në popullatën në studim hasim mbiemra që rrjedhin nga profesioniqë kryen një person, si Bakalli, Bakiri, Gega, Çibuku, Çobani, Dervishi, Prifti, Sheh, Papa, Hoxha apo mbiemra që shprehin karakeristika trupore të individëve, si: Doraci, Gavoi, Floku, Gjeli, Kufo, Gjoksi, Hunda, Qorri, Qose etj. . Gjithashtu, disa mbiemra tregojnë origjinën e të ardhurve, si Delvina, Dukaj, Erindi, Golemi, Hormova, Kanina, Kavaja, Kopliku, Llaboviti, Ohri, Peshkëpia, Peshkopia, Salaria etj.

Popullata në studim karakterizohet nga një shumëllojshmëri mbiemrash të ngjashëm midis tyre, si: Shane, Shanaj Shano; Sheh, Shehu, Shehaj;Shkurti, Shkurta, Shkurtaj; Abazi, Abazaj; Qendro, Qëndro; Zenel, Zeneli, Zenelaj etj., gjë që shpreh evolucion kulturor paralel.

II-Izonimia dhe α e Fischerit.

Tregues i pasurisë së mbiemrave si pasojë dhe i migrimit të akumuluar janë Izonomia jo e pritur e rastit (I) dhe α e Fischerit.Duke i supozuar mbiemrat si alele mund të themi se **α** është e barazvlefshme me numrin efektiv të aleleve në një sistem gjenetik. Mbiemrat i shohim si alelet e një lokusi. Shpeshherë **α-ën**mund ta quajmë dhe si ***numri efektiv i mbiemrave.***

Periudhat / Izonimia	**1**	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**
Rezidentë	0.00296	0.0026	0.00178	0.00165	0.00193	0.001904	0.00205	0.002494	0.001833
Të ardhur	0	0	0	0.002312	0.00094	0.001033	0.00104	0.000962	0.001057
Bashkë	0.00274	0.0018	0.00154	0.001364	0.00155	0.001574	0.00154	0.001593	0.001349

Tabela 1: Vlerat e Izonimisë për çdo periudhë

Në bazë të vlerave të Izonimisë janë llogaritur vlerat e α-s së Fischerit (Rodriguez & Larralde et al, 1993):

α = 1/Iii

që paraqiten në Tabelën 2. ku paraqiten vlerat e α-s në çdo periudhë për rezidentët, të ardhurit dhe gjithë popullatën në studim (bashkë).

Periudha / α	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Rezidentë	338	392.042	562.535	605.52	518.031	525.329	488.172	400.884	545.684
Të ardhur	0	0	0	432.45	1064.083	967.848	961.143	1039.68	946.125
Bashkë	364.5	541.5	648.122	732.994	646.594	635.462	649.235	627.826	741.125

Tabela 2: Vlerat e α për çdo periudhë

Vlera e α-s për rezidentët arrin maksimumin e saj në periudhën e katërt (605.52), ndërsa vlerën më të ulët në periudhën e parë (338).

Vlera maksimale e α-s për të ardhurit arrihet në periudhën e pestë (1064.083) dhe vlera më e ulët në periudhën e parë, të dytë dhe të tretë (0).

Nëse bëjmë një krahasim të vlerave të α-spër rezidentët dhe të ardhurit shikojmë që në tri periudhat e para që u përkasin vitevetë lindjes që para 1910 deri në 1930, vlera e α -s për të ardhurit është 0, ndërsa për rezidentët α është më e lartë. α për të ardhurit fillon dhe rritet në periudhën e katërt dhe në periudhën e pestë kalon dhe vlerën e α-s për rezidentët. Epërsia vazhdon dhe në periudhat e tjera, gjë që tregon se popullata ka filluar t'i largohet izolimit. Hapja më e madhe e popullatës vihet re në periudhën e pestë dhe të tetë. Duke pasur parasysh moshën mesatare në martesë (femrat rreh të 20-ve , meshkujt rreth të 25-ve) periudha e pestë përkon me zhvillimin industrial të qytetit (vitet '70) ndërsa periudha e tetë përkon me vitet '90, vite të ndërrimit të sisemit dhe fillimin e lëvizjes së lirë brenda vendit. Kjo gjë vihet re më mirë në paraqitjen grafike të variacionit të α-s për rezidentët dhe të ardhurit në nëntë periudhat kohore.



Grafiku 3: Variacioni i α-s për rezidentët dhe të ardhurit në nëntë periudhat kohore

Në përgjithësi, siç vërehet nga Grafiku 1, vlerat më të larta të pasurisë sëmbiemrave janë për të ardhurit. Ky është një rezultat i pritshëm duke pasur parasysh se grupi i të ardhurve përbëhet në pjesën më të madhe nga individë të veçantë ose grupe të vogla individësh, duke ofruar një larmi shumë më të madhe mbiemrash.Pasuria e mbiemrave dhe, rrjedhimisht, ndryshueshmëria e mbiemrave është më e lartë midis imigrantëve sesa te vendasit.

Periudha / *v*	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Rezidentë	0.9257	0.7996	0.5970	0.5362	0.501	0.3697	0.3619	0.4287	0.7898
Të ardhur	0	1	1	0.8211	0.9031	0.8202	0.8047	0.8194	0.9148
Bashkë	0.9284	0.8245	0.5958	0.5430	0.5069	0.3648	0.3727	0.4517	0.7613

Tabela 3: Vlerat e v-së për çdo periudhë



Grafiku 4: Variacioni i α-s për qytetin e Përmetit (Dervishi & Mikerezi 2010)

Duke bërë një krahasim me variacionin e α-s për qytetin e Përmetit vihet re se ky variacionështë i ndryshëm nga i Gjirokastrës, gjë që tregon se migrimi nuk është kushtëzuar nga të njëjtët fakorë. Pavarësisht kësaj,në të dy rastetpasuria e mbiemrave dhe rrjedhimisht ndryshueshmëria e mbiemrave është më e lartë midis imigrantëve sesa te vendasit. Në të dy rastet migrimi është rastësor, i paorganizuar dhe është kryer nga individë të veçantë ose grupe të vogla individësh, duke ofruar kështu një larmi shumë më të madhe mbiemrash.

III- ν e Karlin Mc. Gregor

ν -ja e Karlin Mc. Gregor është një tregues i ritmevetë migrimit në popullatë, pasi është e ndërlidhur me mbiemrat që hasen vetëm një herë.

Ajo është njehësuar sipas Zei et al. (Zei et al, 1983)

$\nu = (1 - Bii)/ [Bii(Ni - 1)]$ ku $Bii = \Sigma k\ (pik)^2$

Vlerën maksimale për rezidentët ν -ja e arrin në periudhën e parë (0.925714), ndërsa vlerën minimale në periudhën e shtatë (0.361894).

Për të ardhurit ν -ja arrin vlerën maksimale në periudhën e nëntë (0.9148), ndërsa vlerën më të ulët në periudhën e parë (0)

Nga krahasimi i vlerave të **ν-së**vihet re një ulje e vlerave të ν-sëpër rezidentët dhe rritje e vlerave të ν-së për të ardhurit, me përjashtim të periudhës së nëntë ku diferenca zvogëlohet dhe periudhës së parë ku vlera e ν-së për të ardhurit është zero. Kjo varësi vihet re më mirë në paraqitjen grafike të krahasuar të variacionit të ν-së në periudhat kohore për rezidentët dhe të ardhurit. Edhe në këtë rast vlerat e ν-sëparaqiten më të larta në grupin e të ardhurve, ashtu siç ishte dhe pritshmëria për shkak se ν-ja lidhet me mbiemrat që shfaqen vetëm një herë dhe këtë e hasim më shpesh tek imigrantët. Nga grafiku dallohe se Gjirokastra vazhdimisht pas periudhës së parë është nën ndikimin e një fluksi të lartë migrimi që besoj se lidhet me zhvillimin ekonomik, social, kulturore të qytetit si një nga qytetet kryesore në jug të vendit.



Grafiku 5: Variacioni i ν-së për rezidentët dhe të ardhurit në nëntë periudhat kohore

Duke bërë një krahasim me variacionin e ν-së për qytetin e Përmetit vihet re se ky variacion është i ndryshëm nga i Gjirokastrës, gjë që tregon se migrimi nuk është kushtëzuar nga të njëjtët fakorë. Pavarësisht kësaj, në të dy rastet ν-ja e Karlin Mc. Gregor më e lartë midis imigrantëve

sesa te vendasit, gjë që përforcon faktin se migrimi është rastësor, i paorganizuar dhe është kryer nga individë të veçantë ose grupe të vogla individësh, duke ofruar kështu një larmi shumë më të madhe mbiemrash.



Grafiku 6: Variacioni i v-së për qytetin e Përmetit(Dervishi & Mikerezi 2010)

VI– Prirjet kohore te koeficientit të inbridingut

Koeficienti i inbridingut (Ft) është një tregues i drejtperdrejtë i izolimit gjenetik të popullatës. Ft (inbridingu total) dhe përbërësit e tij Fr (inbridingu i rastit) dhe Fn (inbridingu jo i rastit) janë njehësuar sipas Crow & Mange. (Crow & Mange, 1965).

Grafiku 6 paraqet ecurinë e koeficientit të inbridingut total (Ft) në popullatën në studim.



Grafiku 7: Ecuria e vlerave të Ft

Nga grafiku vihet re se pas një rënie të koeficientit të inbridingut deri në periudhën e katërt, arrihet një situatë gati e qëndrueshme, e cila shoqërohet me një rënie në periudhën e fundit, gjë që dëshmon se popullata me kalimin e viteve i largohet izolimit gjenetik. Një ecuri e tillë është në përgjithësi në përputhje edhe me ndryshimet e vërejtura në ecurinë e endogamisë dhe egzogamisë në popullatën në studim.

Koeficienti i inbridingut Ft (inbridingu total) ka dy përbërës: Fr (inbridingu i rastit) dhe Fn (inbridingu jo i rastit).



Grafiku 8:. Krahasimi i ecurisë së vlerave të Fr dhe Fn

Fr-ja e arrin vlerën më të lartë në periudhën e pestë, kurse vlerën më të ulët në periudhën e parë.

Fn-ja e arrin vlerën më të lartë në periudhën e parë, kurse vlerën më të ulët në periudhën e pestë.

Nga krahasimi i ecurisë së vlerave të Fr-së dhe Fn-së, ashtu siç pritej, vërehet që për çdo ulje të vlerave të Fr-së kemi rritje të vlerave të Fn-së dhe anasjelltas.

Natyrisht, ndryshimet në koeficientin e inbridingut mund të shikohen të lidhura ngushtë edhe me pasurinë e mbiemrave në periudha të ndryshme kohore. Kjo do të thotë se koeficienti i lartë i inbridingut mund të përkthehet si pasuri e vogël e mbiemrave dhe anasjelltas. Për të vënë në dukje këtë lidhje analizojmë së bashku ecurinë e vlerave të inbridingut total (Ft) dhe të α-s së Fisherit.

Duke ditur që α e Fisherit është tregues i pasurisë së mbiemrave, atëherë ajo do të na japë informacion të rëndësishëm edhe për prirjet e izolimit gjenetik të popullatës. Nga ana tjetër, koeficienti i inbridingut (Ft) është një tregues i drejtperdrejtë i izolimit gjenetik të popullatës.

Duke u mbështetur në këtë fakt krahasojmë ecurinë e këtyre dy treguesve për të parë zhvillimet demografike të popullatës (Tabela 4). Siç pritej, për çdo rritje të pasurisë së mbiemrave (α) vihet re ulja e inbridingut total (Ft).

Periudhat kohore	Vlerat e α (bashkë)	Vlerat e Ft
Periudhat 1	364.5	0.000685871
Periudhat 2	541.5	0.000184877
Periudhat 3	648.1216216	4.66461E-05
Periudhat 4	732.994186	4.22578E-05
Periudhat 5	646.59375	-1.481E-05
Periudhat 6	635.46194	-3.9919E-06
Periudhat 7	649.234973	-1.29322E-05
Periudhat 8	627.82609	-1.73126E-06
Periudhat 9	741.125	6.46931E-05

Tabela 4: Paraqitja e vlerave te α dhe Ft sipas periudhave kohore

Përfundime

Nga studimi i mësipërm arritëm këto përfundime:

- Popullata e Gjirokastrës karakerizohet nga një pasuri mbiemrash si rrjedhim dhe nga një pasuri gjenetike.
- Analiza e strukturës së mbiemrave dhe frekuencave respektive evidenton evolucionin strukturor të tyre si elemente strukturore neutrale gjenetike dhe si elemente linguistike.
- Në popullatën në studim individët rezidentë dominojnë kundrejt të ardhurve dhe martesat endogame ndaj atyre egzogame.
- Qyteti i Gjirokastrës me kalimin e viteve karakerizohet nga një intensitet migrimi në rritje.
- Migrimi është kryer kryesisht në mënyrë individuale ose në grupe të vogla familjare.
- Krahasimi i ecurisë së koeficientit të inbridingut tërësor Ft dhe α-s së Fisherit treguan se gjejmë një përputhje shumë të mirë të ecurisë së vlerave të pasurisë së mbiemrave me ecurinë e inbridingut total (Ft), gjë e cila tregon ecurinë e izolimit gjenetik të popullatës.
- Hapja e popullatës dhe rritja e pasurisë gjenetike të saj janë në harmoni me faktorë të zhvillimit ekonomik, politik dhe social.

Referencat

Barrai I, Barbujani G, Beretta G. et al. (1987) Surnames in Ferrara: Distribution, isonymy and levels of inbreeding. Anaquo;. Hum. Biol. 14:415-423.

Barrai I, FormicaG, Barale R, Beretta M (1989) Isonymy and migration distance. Ann. Hum. Genet. 53:249-262.

Cavalli-Sforza LL., Edwards A.W.F. (1967) Phylogenetic analysis models and estimation procedures. American Journal of Human Genetics, 19: 233-257.

Zei G, Matessi RG, Siri E, Moroni A, Cavalli-Sforza LL (1983) Surnames in Sardinia, I. Fit of frequency distributions for neutral alleles and genetic population structure. Annals of Human Genetics, 47: 329-352

Rodriguez-Larralde A, Formica G, Scapoli C, Beretta M, Mamolini E, Barrai I (1993) Microevolution in Perugia: isonymy 1890-1990. An. Hum. Biol., 20: 261- 274.

Crow JF, Mange AP (1965) Measurements of inbreeding from the frequency of marriages between persons of the same surnames. Eugenics Quarterly ,12: 199-2003.

Crow JF (1980): The estimation of inbreeding from isonymy. Human Biol., 52: 1-4.

Lasker, G. W., and B.A. Kaplan. 1985. Surnames and genetic structure: Repetition of the same pairs of names in married couples, a measure of subdivision of the population. Hum. Biol. 55:431-440.

Morton, N.E., C. Smith, R. Hill et al. 1976. Population structure of Barra (Outer Hebrides). Ann. Hum. Genet. 39:339-352.

Dervishi A, Mikerezi I. (2010). Microevolution process in Përmeti population as estimated by Isonymy techniques. AKTET, Vol III, 78-83. ISSN 2073-2244.

A REVIEW OF ACUTE APPENDICITIS' POSTOPERATIVE PAIN MANAGEMENT IN ALBANIA

[1]PhD. Zhenisa Çuni, [2]PhD. Juliana Xhindolli
[1]Department of Nursing, Faculty of Natural Sciences , "Eqrem Çabej" University of Gjirokastër, Albania, zhcuni@uogj.edu.al
[2]Health Care Department, Faculty of Public Health, "Ismail Qemali" University of Vlorë, juli.xhindolli@hotmail.com

Abstract
It is a daily challenge to be part of the medical staff in these times when scientific research blooms and there is higher pressure to improve health service quality. With this review article, we aim to highlight key research findings and suggest to developing countries' medical staff, some takeaways from European and American guidelines recommended to be used for postoperative pain management. We collected data in the hospital of Gjirokastër from June 2016- December 2019. We studied 278 cases confirmed with AA, 134 females, and 144 males. The software used was SPSS. Later we searched Pub Med, Google Scholar, and Science Direct for articles regarding our topic, and several articles were selected to compare our findings to conclude with recommendations about our healthcare system's weak points. We witnessed that postoperative pain evaluation is not standardized with a pain evaluating scale but rather done by nurses' subjective and objective examination. The most frequent analgesic drug was paracetamol, administered in 58.12% of patients. Monotherapy was more frequent than the combination of two drugs, respectively 59.78% over 34.32%. The mean number of used analgesic drugs was slightly higher in females than males, respectively 1.51 over 1.41. After analyzing our findings and comparing them with European and American guidelines and scientific articles, we concluded with several suggestions addressed to Albania's medical staff as follows: consider multimodal analgesia; use oral over IV opioids; avoid IM administration of analgesics; paracetamol's analgesic effect is dose-dependent so can be used up to 1gr every 6 h in adults; consider an infiltration of incision site with long-acting anesthetics in the first 24h after surgery.

Keywords: *acute appendicitis, Albania, pain management, postoperative pain*

Introduction

It is a daily challenge to be part of medical staff in times when biosciences develop faster than ever before, scientific research blooms, and there is higher pressure from stakeholders to improve health service quality. Therefore, medical staff needs to review articles summarizing global research findings to update their clinical practice and save time.

During a previous descriptive epidemiological observational study in the Surgery Unit of the regional hospital of Gjirokastër (1), Albania's southernmost city, we noticed that management of postoperative pain in acute appendicitis (AA) patients seemed to be outdated and also deprived of various analgesic drugs that are necessary to treat it. So, thourgh this review article we aim to highlight key research findings and guide developing countries' medical staffon European and American guidelines recommended use for postoperative pain management.

Methods and materials

Metodologjia kryesore e ndjekur gjatë këtij studimi lidhet me konceptin e "shëndetit të lumenjve" i propozuar për herë të parë në Aktin e Ujit të Pastër në vitin 1972 nga USEPA, i cili nënkupton ruajtjen e integritetit kimik, fizik dhe biologjik të ujërave sipërfaqësore të lumenjve. Për t'i dhënë një kuptim më gjithëpërfshirës këtij koncepti, brenda ekosistemit natyror të lumit, u analizuan edhe karakteristikat socio-ekonomike dhe ato mjedisore të zones, të cilat mund të ndikojnë në përkeqësimin e "shëndetit të lumit". Për këtë qëllim si pjesë e vlerësimit u morën në shqyrtim disa indikatorë të ndarë sipas burimeve karakterizuese, ato sociale (karakteristikat demografike të zonës, përdorimi i ujit, infrastruktura urbane, trajtimi i ujërave të ndotura, përdorimi i tokës), ekonomike (tendencat ekonomike të zonës, aktivitetet ekonomike) dhe ato mjedisore (faktorët klimaterikë, hidrologjia, biodiversiteti, formimi gjeologjik, cilësia e ujërave sipërfaqësore, humbjet e tokës).

Metodat sasiore konsistojnë në:

- grumbullimin e të dhënave të përgjithshme mbi pellgun ujëmbledhës të lumit Drino (prurjet, ushqimi tokë/reshje, treguesit fizikë etj.);
- grumbullimin e të dhënave demografike, social-ekonomike dhe natyrore ndër vite për zonën në studim në nivel pellgu ujëmbledhës (numri i popullsisë, lëvizja demografike 1990-2020, emigrimi, sipërfaqja totale e pellgut dhe kategoritë e tokës);
- grumbullimi i të dhënave gjeologjike, hidrogjeologjike, formacioneve gjeologjike dhe parametrave hidroteknikë;
- grumbullimin e të dhënave mbi ndryshimet morfologjike të shtratit të lumit ndër vite;
- grumbullimin e të dhënave mbi fenomenin e erozionit në të gjithë shtratin e lumit dhe matjen e erozionit (tokës së eroduar) në afërsi të qytetit të Gjirokastrës;
- vlerësimi i fenomenit të përmbytjeve në zonë ndër vite dhe ilustrimi në hartë nëpërmjet sistemit GIS;
- vëzhgimi dhe identifikimi i të gjithë problematikave mjedisore të pellgut lumor (zonave të përmbytura, erozionit të brigjeve të lumit, pikat e derdhjes së ujërave të zeza, mbetjet urbane dhe inerte, shkarkimet industriale, etj.), si dhe niveli i menaxhimit të faktorëve negativë nga njësitë vendore brenda pellgut ujëmbledhës;
- vlerësimi i cilësisë së ujërave nëpërmjet marrjes së mostrave të ujit në dy pika kryesore (Dervician të bashkisë Dropull dhe në pikën e bashkimit me lumin Vjosa në Lekël të Tepelenës).
- vlerësimi i erozionit në tri pika problematike ku ka gërryerje të vazhdueshme të tokës;

Metodat cilësore konsistojnë në studimin e literaturës lidhur me:

- studimin e legjislacionit shqiptar në drejtim të mbrojtjes së mjedisit, zonave të mbrojtura, biodiversitetit dhe qëndrueshmërisë së ekosistemeve lumore, në funksion të mbrojtjes së tokës dhe mjedisit;
- vlerësimin e ndikimeve mjedisore si pasojë e ndotjes së ujërave sipërfaqësore (rasti në studim trup lumor), impakti i tyre në popullatë dhe në ekosistemet natyrore;
- vlerësimin e masave të nevojshme për zbutjen dhe rehabilitimin e ndikimeve mjedisore në zonë;
- vlerësimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e shtratit të lumit nga deformimet e mëtejshme morfologjike dhe shmangien e emergjencave civile si përmbytjet;
- vlerësimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e ekosistemeve natyrore të lumit, minimizimin e ndotjes si dhe rritjen e cilësisë së ujit;
- Studimi i VSM-së të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Dropull dhe PPV-së të bashkisë Gjirokastër;
- Studimi i modeleve të mbrojtjes dhe rehabilitimit të lumenjve në literaturën e huaj;

Metodologjia përfshin, gjithashtu, vizitat në terren për të vëzhguar gjendjen aktuale mjdisore të lumit dhe për të mbledhur të dhëna të ndryshme që janë të nevojshme për këtë studim, në kuadër të rehabilitimit të zonës për minimizimin e ndotjes dhe rritjen e cilësisë së ujit. Për këtë qëllim janë realizuar:

- Vizita në terren për vëzhgimin, matjen, vrojtimin e burimeve të shkarkimit të ndotjeve, në të gjithë segmentin e parashikuar në studim dhe me fokus të veçantë ofrimi i një analize të detajuar mbi ndikimet në zonën e ndotur pranë qytetit të Gjirokastrës;
- Takime në njësitë vendore për konsultime mbi realizimet dhe objektivat strategjike të vendosura në PPV si edhe plane të tjera të detajuara vendore;
- Konsultime me drejtoritë dhe agjencitë rajonale të qarkut;
- Shfrytëzimi i literaturës së huaj që trajton aspekte të ngjashme me temën e detyrës së kursit;

- Studime të emergjencave civile të trajtuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut dhe Këshilli i Qarkut për këtë qëllim;

2.1.1. Literatura e përdorur

Informacioni i përdorur në këtë studim është grumbulluar nga burimet si më poshtë:

- Literatura e botuar dhe e pabotuar e cila gjendet online;
- Raportet e publikuara nga ministritë dhe institucionet qendrore si Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, INSTAT etj.
- Të dhëna të mbledhura nga Bordi i Ujitjes dhe Kullimit Gjirokastër, Sektori i Ekstensionit Bujqësor, Gjirokastër, ndërmarrjet e shërbimeve publike
- Literatura dhe studime të botuara pranë departamenteve universitare të Universitetit "Eqrem Cabej", Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin Politeknik të Tiranës;
- Literaturë e studimeve të kryera nga kompani të BE-së dhe studiues të huaj;
- Literaturë mbështetëse nga dizertantë që kanë mbrojtur tema të ngjashme;

Rezultatet dhe diskutimi i tyre

3.1. Monitorimi i cilësisë së ujërave të lumit

Krahas monitorimit sasior të ujërave është bërë edhe monitorimi cilësor i tyre nëpërmjet interpretimit të analizave kimike. Për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumit Drino janë marrë mostra në dy pika të ndryshme përgjatë rrjedhës së lumit, në mënyrë që të bëhej krahasimi i ndryshimeve të cilësisë së ujit në hapësirë. Si vende të marrjes së mostrave janë zgjedhur dy pika të rëndësishme stacionare përgjatë shtrirjes së lumit: pika e parë në Dervician, afër zonës së Furrës së Gëlqeres (D1), bashkia Dropull; pika e dytë pranë Urës së Leklit (D2), bashkia Tepelenë. Mostrat janë marrë në fund të muajit mars dhe janë analizuar në prill, në shishë 1,5 L dhe në thellësi nën 20 cm në koordinatat gjeografike (nga Sistemi Global i Pozicionimit, GPS).

Për vlerësimin e cilësisë së ujit janë matur parametrat fiziko-kimikë që konsiderohen të rëndësishëm dhe që kërkohen nga rrjeti i informacionit dhe monitorimit EUROWATERNET i Agjencisë Evropiane të Mjedisit (EEA), si dhe që rekomandohen në Direktivat e Komisionit të Bashkimit Evropian për monitorimin e gjendjes së ujërave sipërfaqësore (WFD).

Temperatura: Vlerat e temperaturës varion nga 12o gradë në st. D1 deri në 7o gradë në st. D2. Vihet re që temperaturat pësojnë ndryshime gjatë rrjedhës së lumit nga një zonë me reliev fushor (fusha e Dropullit) ku temperatura është më e lartë në një zbritje të dukshme në zonën malore të Tepelenës si rrjedhojë e kushteve të përgjithshme klimaterike dhe relievit gjeografik të zonës. Në lumin Drino dhe përroin e Kardhiqit të cilët kanë ushqim të fuqishëm nëntokësor, amplitudat e temperaturës së ujërave janë më të vogla se në pellgun e Vjosës (Korançe, 2021).

pH: Nga të dhënat e marra vihet re që pH luhatet në vlerat 8.03 dhe 8.18 (me tendencë alkaline) duke u konsideruar vlera normale sipas standardeve evropiane dhe atyre kombëtare, brenda kufijve të rekomanduar nga Direktiva e BE-së 76/160/EEC (<8.5) duke u renditur në gjendje të mirë dhe sipas klasifikimit NIVA i përkasin klasës I të cilësisë mjedisore, pra në gjendje të mirë (pH >6,5). Vlerat e pH për të gjitha mostrat kanë cilësuar një mjedis alkalin të këtyre ujërave.

Përcjellshmëria elektrike: Në stacionin e Dervicianit përcjellshmëria elektrike shënon vlera dyfish më të larta se stacioni i monitorimit në Urën e Leklit, duke treguar që këmi një përmbajtje më të lartë të lëndëve të tretura në st. D1. Rezultatet e përcjellshmërisë elektrike variojnë nga 483 μS/cm në st. D2 deri në 971 μS/cm në st. D1. Ndryshime që tregojnë se tretshmëria e kripërave është më e lartë në st. D1 si rrjedhojë e përcjellshmërisë më të vogël se në stacionin e st. D2. Këto vlera tregojnë për një përmbajtje të lartë të lëndëve të tretura në ujërat e lumit.

Lëndët totale të tretura (TDS): Lëndët e ngurta të tretura rezultojnë të janë dyfish më të larta në pikën e monitorimit në st. e Dervicianit, krahasuar me atë të Leklit në Tepelenë përkatësisht 631.15 mg/l dhe 313.95 mg/l. Vlerat mesatare rezultuan jashtë normave të lejuara sipas klasifikimit të NIVA-s, ku limiti për cilësinë e klasës V është 10 mg/l. Rezultatet e TDS-së të

dala nga mostrat e lumit janë shumë herë më të larta krahasuar dhe me normat e shkarkimeve të lëngëta urbane, bazuar në VKM-nënr.177, datë 31.3.2005 që është 35 mg/l.

Lëndët e ngurta pezull (SS): Vlerat e lëndëve të ngurta pezull (SS) janë brenda normave në të dy pikat e monitorimit përkatësisht 4.2 në st. D1 dhe 4.0 në st. D2 (standardi i BE-së është < 25 mg/l). Vlera të cilat tregojnë që ujërat e lumit Drino janë jo të turbullta dhe të pasura me oksigjen.

Ushqyesit - azoti dhe fosfori

Nitritet: Përmbajtja e nitriteve (NO2-) nuk e kalon vlerën 0,01 mg/l në të dyja stacionet që është edhe vlera limit e klasifikimit "gjendje e lartë", referuar Direktivës së BE-së. Vlerë e cila mendohet se është edhe niveli mbi të cilin ky përqendrim mund të shkaktojë dëmtime te peshqit në varësi të kohëzgjatjes dhe ekspozimit. Përmbajtja brenda vlerave limit të klasifikimit tregon që në pikat e monitorimit të ujit nuk kemi ndotje të lartë nga shkarkimet e ujërave të zeza.

Nitratet: Përmbajtja e nitrateve (NO3-) tregon vlera më të larta te st. D2 në Lekël, përkatësisht 1.60 mg/l ndërsa në pikën e Dervicianit st. D1 është 1.17 mg/l. Duke krahasuar rezultatet e nitrateve me normat e BE-së, ujërat e pellgut të Drinos kanë përmbajtje të nitrateve që i tejkalojnë vlerat e klasifikimit gjendje e lartë (<0.8), duke u klasifikuar si ujëra në gjendje të mirë (<2). Gjithashtu, referuar klasifikimit UNECE, cilësia e ujërave i përket Klasës I (< 5). Vlerësohet që përmbajtja disi e lartë e nitrateve në ujërat e lumit Drino vjen kryesisht nga shkarkimet e lëngëta urbane, ato blegtorale dhe bujqësore.

Amoniumi: Përmbajtja e amoniumit (NH4+) në pikën e monitorimit të Dervicianit arrin vlerën 0.026 mg/l, ndërsa në Urën e Leklit rezulton 0.009 mg/l, vlera të cilat tregojnë se ujërat e lumit Drino në pjesën e mesme të rrjedhës ujore, st. D1, janë më të ndotura se pjesa e tretë ku përfshihet edhe st. D2 – Ura e Leklit. Sipas analizave të bëra përmbajtja e amoniumit në st. D1 janë në përqendrime më të larta se normat ku vlerësohet se në përqendrimet e amoniakut mbi 0,025 mg/l ndërpritet rritja e troftës. Ndërsa në st. D2 është brenda normave të lejuara për ujërat ciprinide dhe salmonide referuar Direktivës së BE-së (norma 0,015 mg/l). Referuar parametrave të UNECE-së (<0.1), klasifikimi i cilësisë së ujërave nga ndikimi i shkarkimeve urbane, në të dy stacionet D1 dhe D2, i përkasin klasës I të cilësisë mjedisore.

Fosfatet: Vlerat e përqendrimit të fosfateve në të dy pikat e monitorimit është e njëjtë, përkatësisht Ptotal 0.01. Për të dy stacionet, përqendrimet e fosfateve janë brenda normave të Direktivës së BE-së për ujërat salmonide dhe 0.4 mg/l për ujërat ciprinide, duke e klasifikuar ujin e lumit Drino brenda normave për rritjen e peshqve. Sipas klasifikimit të NIVA-s dhe UNECE-së, parametrat e fosfateve P_PO43- të dy stacioneve të monitorimit të ujit të lumit Drino i përkasin klasës I.

Elementet që kontribuojnë më shumë në ndotjen e ujit, sipas EEA-së (Agjensia Evropiane e Mjedisit) janë N-NH4+, (NH4) dhe P-PO43-, (PO4).

3.2. Monitorimi i erozionit, matja e humbjes së tokës

Në segmentin kthesa e Viroit-Parku i Viroit, në bregun e lumit u vendosen 3 pika të palëvizshme në datën 5 janar të këtij viti, në distancën prej 5 m ndërmjet njëra-tjetrës dhe në distancën 3 m nga bregu lumor.

Figura. 1 Skica e matjeve në terren të humbjes së tokës (punoi autori)

Në datën 9 maj janë kryer matjet përkatëse ku distancat e tokës së gërryer nga bregu ishin:

- Pika 1, gërryer 0.73 m
- Pika 2, gërryer 0.3 m
- Pika 3, gërryer 0.05 m

Ndërkohë që thellësia e lumit për të tri pikat ishte si më poshtë:

- Pika 1, në 4.37 m
- Pika 2, në 4.15 m
- Pika 3, në 4.26 m

Nga llogaritja për çdo pikë në distancën 5 m, thellësinë e matur të lumit, distancën e gërryer dhe me peshë të tokës 1.3 ton/m3, rezulton një humbje e tokës nga erozioni si më poshtë:

- Pika 1: 0.73 x 5x 4.37 x 1.3 = 20.73 ton tokë
- Pika 2: 0.30 x 4.15 x 5 x 1.3 = 8.09 ton tokë
- Pika 3: 0.05 x 4.26 x 5 x 1.3 = 1.38 ton tokë

Shuma në 15 m linear = 30.20 ton ose 2.01 ton/m linear

Të dhënat e marra nga matjet tregojnë se brigjet e lumit Drino janë të predispozuara ndaj erozionit. Arsyeja e parë është se prurjet ujore të lumit Drino, gjatë dimrit janë të larta dhe të rrëmbyeshme. Së dyti, ka lidhje me përbërjen e tokës me veti të shkëputjes dhe rënies së brigjeve. Të dhënat tregojnë gjithashtu se nevojitet të planifikohen dhe zbatohen masa mbrojtëse e parandaluese për mbrojtjen nga erozioni, si: rehabilitimi i argjinaturave, ndërtimi i panelave të dëmtuara, sigurimi i vegjetacionit të brigjeve lumore, ndalimi i shfrytëzimit të inerteve etj.

3.3. Ndryshimet morfologjike të shtratit të lumit

Ndryshimet morfologjike në kohë të shtratit të lumit Drino janë evidentuar duke përdorur platformën Google Earth, me anë të kujtesës imazherike të fotografimeve satelitore. Nga vëzhgimet e bëra rezulton se ndryshimet më të mëdha shtrati i lumit i ka pësuar në zonat e urbanizuara që shtrihen përgjatë shtratit lumor si qyteti i Gjirokastrës dhe më pak Tepelena dhe Dropulli. Nga matjet digjitale, duke përdorur platformën Google Earth dhe mbivendosjen e imazheve satelitore në kohë, kemi përftuar imazhet si më poshtë, ku në të tri pikat e matura rezulton se kemi zhvendosje të shtratit të lumit kryesisht të ndikuar nga fenomeni i erozionit, përmbytjeve dhe sedimentimit.

- Në bashkimin e lumit Drino me Vjosën, përgjatë periudhës kohore 2007-2020, grykëderdhja e lumit është zhvendosur me 700 m në drejtimin juglindje.

- Në zonën afër Furrës së Gëlqeres (B. Dropull), përgjatë periudhës kohore 2006-2021, shtrati i lumit është zhvendosur 20 m në drejtim të perëndimit.

- Në zonën pranë fushës së vjetër në Gjirokastër, përgjatë periudhës kohore 2006-2021, shtrati i lumit është zgjeruar me 50 m në drejtimin të perëndimit.

Figura2. Ndryshimet morfologjike të shtratit të lumit

Përfundime dhe Rekomandime

Në përfundim të studimit, mbështetur në metodologjinë e zgjedhur për vlerësimin e gjendjes mjedisore të lumit Drino dhe hartimit të Planit të Mbrojtjes, mund të themi se është realizuar pjesa më e madhe e objektivave të vendosura që në fazën e propozimit të temës përpara departamentit të Mjedisit.

Metodologjia e zgjedhur, duke iu referuar indikatorëve të marrë në studim, që përfshijnë të tri dimensionet e zhvillimit social, ekonomik dhe mjedisor, u mbështet në konceptin e "shëndetit të lumenjve", i cili nënkupton ruajtjen e integritetit kimik, fizik dhe biologjik të ujërave sipërfaqësore të lumenjve. Pjesën kryesore të punës së këtij studimi e përbën procesi i vlerësimit të këtyre indikatorëve, të konceptuar në formatin e një analizim-vlerësimi duke na ofruar si përfundim një pamje të përgjithshme të problemeve ekzistuese të zonës në studim, që lidhen me burimet me ndikim negativ në mjedis, në ekosistemet lumore, peizazhin, burimet natyrore dhe në zhvillimin social-ekonomik të zonës të cilat janë padyshim të ndërlidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën.

Për të kuptuar më mirë varësinë e këtyre dimensioneve nga njëra-tjetra, përveç analizimit të të dhënave të grumbulluara nga studime të ngjashme apo burime zyrtare shtetërore e private, janë kryer edhe analiza fiziko-kimike të ujit të lumit të analizuara në muajin prill si dhe matje në terren të humbjes së tokës në brigjet lumore, sipas llogaritjeve për këtë qëllim.

Në tërësinë e këtij studimi, ajo që është evidentuar qartë është ndikimi i madh i dimensionit njerëzor kundrejt atij natyror. Përpos ndikimeve që vetë natyra ka, duke iu referuar faktorëve klimaterikë, në ndryshimin e karakteristikave të ekosistemit lumor, faktori antropogjen është absolutisht një nga faktorët më të rëndësishëm dhe më me ndikim në zonë.

Përgjatë viteve, cilësia e ujërave të lumit Drino është reduktuar ndjeshëm, i ndikuar nga shkarkimet e ujërave të ndotura urbane të cilat përmbajnë mbetje organike, ushqyes të ndryshëm, kimikate nga shkarkimet shtëpiake dhe mbetjet bujqësore.

Nga të gjitha parametrat fizikë të testuar, lëndët totale të tretura (TDS) dolën si parametra jashtë normave të parashikuara në standardet evropiane dhe normat e tjera të paracaktuara për krahasim. Ndërsa nga analizimet e parametrave kimikë, nitratet dhe amoniumi kanë rezultuar si parametra jashtë normave të lejuara.

Vlerat mesatare të lëndëve totale të tretura (TDS) rezultuan jashtë normave të lejuara sipas klasifikimit NIVA, ku limiti për cilësinë e klasës V është 10 mg/l. Me këtë matje kuptojmë që kripërat inorganike dhe pjesë shumë të vogla të lëndës organike janë të pranishme në ujërat e lumit (përfshihen të gjitha elektrolitet që ndikojnë në përqendrimin e kripësisë si dhe komponime të tjera si lënda organike). Lëndëve totale të tretura janë të rëndësishme për jetën ujore duke e mbajtur densitetin e qelizave të balancuar. Në stacionin e Dervicianit (B. Dropull), përcjellshmëria elektrike shënon vlera dyfish më të larta se stacioni i monitorimit në Urën e Leklit (B. Tepelenë), duke treguar një përmbajtje më të lartë të lëndëve të tretura në pjesën e mesme të lumit. Përmbajtja e amoniumit ($NH4+$) në pikën e monitorimit të Dervicianit arrin vlerën 0.026 mg/l, ndërsa në Urën e Leklit rezulton 0.009 mg/l, vlera të cilat tregojnë se ujërat e lumit Drino në pjesën e mesme të rrjedhës ujore janë më të ndotura se pjesa e tretë e lumit (nga Hundëkuqi deri në bashkimin me lumin Vjosa).

Vlerësohet që përmbajtja disi e lartë e nitrateve në ujërat e lumit vjen kryesisht nga shkarkimet e lëngëta urbane, ato blegtorale dhe plehrat bujqësore, duke u klasifikuar si ujëra në gjendje të mirë (<2), referuar normave të Direktivës së BE-së.

Referuar klasifikimit UNECE, cilësia e ujërave të lumit Drino i përket Klasës I(<5). Vlerësohet që përmbajtja e lartë e nitrateve në ujërat e lumit vjen kryesisht nga shkarkimet e lëngëta urbane, ato blegtorale dhe bujqësore. Gjithashtu sipas normave të UNECE, vlerësohet që cilësia e ujërave nga ndikimi i shkarkimeve urbane t'i përkasë klasës I të cilësisë mjedisore në të dy stacionet e monitoruara përgjatë lumit Drino. Nga analizimi i përgjithshëm i parametrave të lumit, vlerësohet që uji i lumit Drino mund të përdoret për ujitjen e tokave bujqësore apo edhe

për përdorime të tjera duke qenë brenda normave të lejuara.

Megjithatë në këtë pikë, duhet marrë parasysh edhe probabiliteti i ndryshimit të këtyre shifrave, duke iu referuar periudhës në të cilën ato janë marrë dhe që ndikon drejtpërdrejt në interpretimin e rezultateve përfundimtare. Lumi Drino duke u varur tërësisht nga prurjet e reshjeve që bien dhe prurjet nga tributarët e tjerë të pellgut ujor të Drinos, në periudhën ujëpakët, parametrat fizikë dhe ato kimikë të ujërave mund të ndryshojnë ndjeshëm duke na ofruar një realitet tjetër. Si rrjedhojë e zvogëlimit të sasisë së prurjeve, përqendrimi i substancave ndotëse në ujë mund të rezultojë shumë herë më i lartë duke i klasifikuar ujërat e lumit Drino në një kategori "më të ulët".

Nisur nga vëzhgimet e kryera në terren ku janë identifikuar burimet kryesore të degradimit mjedisor të cilësisë së tokës dhe ujit të lumit Drino janë hedhur në hartë nëpërmjet sistemit GIS, indikatorët me ndikim negativ sipas gjurmës përkatëse në një nga zonat me ndikimin më të lartë të burimeve ndotëse në Gjirokastër. Nga vëzhgimet e bëra rezulton se ndryshimet më të mëdha shtrati i lumit i ka pësuar në zonat më të urbanizuara që shtrihen përgjatë rrjedhës ujore si qyteti i Gjirokastrës dhe më pak Tepelena e Dropulli. Ndryshimet morfologjike të shtratit të lumit që kanë avancuar me kohën vlerësohen të jenë të pashmangshme, të përhershme dhe të vazhdueshme. Është një fenomen i cili ecën paralelisht me kohën duke pësuar ndryshime të cilat nuk janë pozitive as për vetë ekosistemet lumore, por as për popullsinë që banon dhe jeton pranë lumit dhe as për ekonominë e vendit, në një shkallë të gjerë. Në veçanti rrezikohen veprat inxhinierike që janë ndërtuar në pellgun ujor të Drinos duke rezultuar në rritjen e rreziqeve fatale nga prishja e digave apo urave. Gjithashtu, rrezikohet degradimi i tokave bujqësore (reduktimi i sipërfaqes së tokave bujqësore) si dhe shtimi i fenomeneve të përmbytjes për shkak të sedimentimit dhe ngritjes së shtratit lumor.

Të dhënat e marra nga matjet në terren referojnë se brigjet lumore të Drinos janë të predispozuara ndaj erozionit. Arsyeja kryesore është që prurjet ujore të lumit Drino gjatë dimrit janë të larta dhe të rrëmbyeshme. Së dyti, ka lidhje edhe me përbërjen e tokës e cila karakterizohet nga veti të shkëputjes dhe rënies së brigjeve lumore. Nga matjet e bëra në afërsi të zonës së Viroit rezulton se shuma në 15 m linear e humbjes së tokës është 30.20 ton ose 2.01 ton/m linear.

Fenomeni i erozionit në zonën në studim rezulton jo vetëm me humbjen e tokës, por edhe me dëmtimin e infrastrukturës urbane dhe të argjinaturave që gjenden përgjatë shtratit lumor të Drinos. Devijimi i shtratit lumor të Drinos i është afruar argjinaturave dhe në disa raste si në zonën e Viroit dhe në Palokastër ka shkaktuar prishjen e tyre dhe gërryerjen e tokave bujqësore. Kujdes duhet të bëhet në tokat përgjatë gjithë shtretërve të lumenjve ushqyes të Drinos, sidomos në tokat në afërsi të Dervicianit, Viroit dhe Palokastrës. Si rrjedhojë, marrja e masave për rehabilitimin dhe mbrojtjen e zonave të degraduara duhet të jetë një prioritet i njësive vendore në drejtim si të menaxhimit të burimeve tokësore, ashtu edhe atyre ujore.

Kryesisht përmbytjet vijnë si pasojë e problemeve me infrastrukturën teknike, nga mungesa e mirëmbajtjes së kanaleve dytësore e tretësore bujqësore, si dhe nga prurjet e përrenjve malorë të cilët mbartin problematikat e tyre shqetësuese. Faktori kryesor që kontribuon në rritjen e fenomenit të përmbytjeve dhe problemeve të sedimentimit ka lidhje direkte me mungesën e bimësisë, shpyllëzimit dhe shfrytëzimit të inerteve lumore. Zhdukja masive e mbulesës bimore në pellgun ujëmbledhës të Drinosit ka ndikuar negativisht në përshpejtimin e këtij fenomeni ku vlerësohet se mbi 50 % e reshjeve në këtë pellg qarkullojnë në sipërfaqe të zhveshura nga mbulesa pyjore. Gjithashtu, praktikat e papërshtatshme bujqësore rritin sasinë e ujit që mund të qarkullojë në sipërfaqe.

4.1 Rekomandime

Zgjidhjet kryesore për luginën e lumit duhet të jenë mbrojtja e cilësisë së ujit nga ndotjet urbane si dhe nga depozitimi i pakontrolluar i mbetjeve, nga shpyllëzimet me ndikimet e tyre negative mbi florën dhe faunën dhe mbi normën e erozionit të tokës. Sfida kryesore do të jetë arritja e një

menaxhimi të përbashkët nga të gjitha grupet e interesit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkufitar.

Institucionet qendrore, në bashkëpunim me njësitë vendore, duhet të hartojnë strategji dhe programet e duhura për të menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme përdorimin e ujit, por edhe për vlerësimin e duhur të burimeve ndotëse që ndikojnë në degradimin e cilësisë së ujit dhe gjendjen mjedisore të lumit.

Të dhënat e matura për erozionin tregojnë gjithashtu se nevojitet të planifikohen dhe zbatohen disa masa mbrojtëse e parandaluese për mbrojtjen nga ky fenomen, si: rehabilitimi i argjinaturave, ndërtimi i panelave të dëmtuara, sigurimi i vegjetacionit të brigjeve lumore, ndalimi i shfrytëzimit të inerteve lumore etj. Në kushtet e një erozioni progresiv përgjatë brigjeve lumore të Drinos, implementimi i masave mbrojtëse dhe rehabilituese të zonave të degraduara përgjatë lumit duhet të jetë në fokus të qeverisjes vendore në bashkëpunim edhe me atë qendrore. Në të gjithë territorin e qarkut Gjirokastër është e nevojshme që të bëhet monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së veprave mbrojtëse, të pritave malore apo pritave mbrojtëse për parandalimin e fenomenit të përmbytjeve.

Është shumë e rëndësishme që të kuptohet se për të ruajtur integritetin ekologjik të lumit, duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçantë si cilësisë së ujit po ashtu edhe ruajtjes së kushteve ekologjike të sistemit lumor për të mos u degraduar më tej.

Për minimizimin/shmangien e dëmeve të shkaktuara nga përrenjtë e vegjël që furnizojnë lumin Drino është e rëndësishme që të merren masa mbrojtëse për rregullimin e shtretërve lumorë, ngritjen e argjinaturave, pyllëzimin e brigjeve lumore si dhe sistemimin e inerteve të tepërta, të cilat shkaktojnë devijimin e shtratit lumor në disa segmente duke shkaktuar gërryerjen e brigjeve lumore.

Me rënien e nivelit të ujit në verë dhe rritjen e vizibilitetit të pranisë së ndotjes organike dhe asaj plastike, segmenti lumor nga Dropulli e deri në drejtim të Gjirokastrës konsiderohet problematik nga ana mjedisore. Duke parë problematikat reale dhe të prekshme të gjendjes në të cilën ndodhet situata e menaxhimit të mbetjeve në të gjitha bashkitë e qarkut, skenari i ndërtimit të një landfilli që plotëson të gjitha kushtet sanitaro-mjedisore dhe që është funksional për të gjithë qarkun shihet me prioritet si një zgjidhje me efikasitet që do t'i jepte zgjidhje situatës dramatike të mbetjeve në qark.

Gjatë viteve të fundit, në shumë vende të zhvilluara janë vënë në përdorim edhe teknologji të përparuara ajrore si dronët, të cilët në të ardhmen mund të luajnë një rol akoma edhe më të rëndësishëm për hartëzimin e problematikave mjedisore të lumenjve dhe jo vetëm. Të dhënat e mbledhura në këtë rast, gjatë monitorimit nga ajri nëpërmjet imazheve ajrore me rezolucion të lartë, mund të përdoren në menaxhimin vendor të lumenjve, restaurimin dhe kuadrin rregullator të cilësisë së lumenjve duke përmirësuar kështu jo vetëm cilësinë e ujërave lumore, por edhe cilësinë e jetës dhe shëndetit të popullatës që jeton pranë këtyre ujërave.

Referencat

Akademia e Shkencave e RPSSH-SË. (1985). Studime Gjeografike, fq. 157-165.

Abcons. (2019). VNMS Hidrocentrali i Kalivaçit. Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social për projektin e propozuar, HEC Kalivaç.

Bashkia Dropull. (2018). VSM Bashkia Dropull.

Bode, A. (2012). Impakti ambiental i faktorëve antropogjenë në pellgun ujëmbajtës të Tiranës.

Chapman, D., (1992). Water Quality Assessments - A Guide to Use of Biota, Sediments and Water in Environmental Monitoring.

Cullaj, A., et al. (2005). The quality of Albanian natural waters and the human impact

European Environment Agency. (1994). European Rivers and Lakes – Assessment of their Environmental State.

Govorushko, S. (2007). Effect of Human Activity on Rivers.

Hamzaraj, E., et al. (2014). An Overview of Water Quality of Vjosa River in Albania Based on Biological and Chemical Parameters.

Hysaj, E. (2013). Studim bioekologjik i lundërzës (Lutra lutra L.) përgjatë luginës së Drinos.

Korançe, F., & Shallas, A. (2021). Matja e qëndrueshmërisë së lumit Vjosa.

Kuznetsov, V., Petrov, D. (2017). Assessing the Environmental Condition of Minor Rivers in Urban Areas.

Kuçaj, E. (2016). Vlerësimi i shkallës së ndotjes së lumenjve Lanë e Tiranë dhe roli i bimëve phragmites australis në absorbimin e metaleve të rënda.

Lushaj, Sh., et al. (2005). Monitorimi i Tokës dhe Ujërave.

Lushaj, Sh., et al. (2003). Vlerësimi i pasojave të ndikimit mjedisor, problemet hidrodinamike dhe reabilitimi i gjendjes në shtretët e lumenjve, pellgu Drin-Bunë (lumenjtë Drin, Bunë), pellgu Seman (lumenjtë Osum, Devoll, Seman), në pellgun Mat (lumenjtë Mat, Fan), pellgu Vjosë (lumenjtë Vjosë, Shushicë, Drino, Bistricë), pellgu Erzen (lumenjtë Erzen, Lumi i Tiranës, Zere, Droje), pellgu Shkumbin (lumi Shkumbin).

Lushaj, Sh. (2020). The process, difficulties and the innovative VSM findings of Dropull.

Meçaj, N. (2003). Pellgu i Vjosës – Pasuritë natyrore dhe veçoritë gjeomorfologjike, fq. 115-132.

Miho, A., et al. (2005). Gjendja mjedisore e disa lumenjve të Ultësirës Adriatike Shqiptare.

Nitasha, K., & Sanjiv, T. (2015). Influences of natural and anthropogenic factors on surface and groundwater quality in rural and urban areas.

Pano, N. (2015). Pasuritë ujore të Shqipërisë. Akademia e Shkencave të Shqipërisë.

Prefekti i Qarkut Gjirokastër. (2021). Plani i Emergjencave Civile.

Prefekti i Qarkut Gjirokastër. (2019). Buletini Statistikor. Sinani, A. (2011). The Earth Ecosystem In The Region Of Gjirokastra. Social and Natural Sciences Journal. 3. 10.12955/snsj.v3i0.284.

Shuka, L., et al. (2011). The Spatial and Temporal Variability of Limnological Properties of Bovilla Reservoir (Albania). Water Resources Management. An: International Journal Published for the European Water Resources Association (EWRA).

Sidabutar, N. V et al. (2017). The effect of anthropogenic activities to the decrease of water quality. IOP Conf. Ser.: Earth Environ. Sci. 67 012034.

Stanners, D. & Bourdeau, P., (1995). Europe's Environment: The Dobrísˇ Assessment. Office for Official Publications of the European Communities, Luxembourg. The European Parliament and the Council of the European Union. Directive 2000/60/EC of the European Parliament and of the Council Establishing a Framework for Community Action in the Field of Water Policy. OJEC 2000, 43, 1–72. UNDP. (2017). Assessment of hydro-ecologicaland socio-economic systems of the Vjosa river.

https://eos.org/features/forgotten-legacies-understanding-human-influences-on-rivers (aksesuar më 15.3.2022)

https://ypte.org.uk/factsheets/rivers/humans-influence-on-rivers (aksesuar më 15.3.2022)

https://www.gazetatema.net/2011/04/03/problematika-e-lumenjve-nje-realitet-apo-nje-ndergjegjesim/ (aksesuar më 9.4.2022)

https://qbz.gov.al/preview/4f5278ca-6887-4bec-b9a8-178aff6855c4 (aksesuar më 9.4.2022)

http://www.see-river.net/media/uploads/files/SEE_SEE_River_ALB.pdf (aksesuar më 9.4.2022)

https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/74/water-protection-and-management (aksesuar më 10.4.2022)

https://hydroreform.org/about-hydropower/hydropowers-impact-on-rivers/ (aksesuar më 22.6.2022)

UTILIZING ICT FOR COMMUNITY ENGAGEMENT AND CULTURAL PRESERVATION IN THE VJOSA NATIONAL PARK

PhD. Jonida Çarka
Department of Statistics and Applied Informatics, Faculty of Economics, University of Tirana, Albania,
Email: jonida.carka@gmail.com

Abstract

Context: *The Vjosa National Park, known for its rich biodiversity and cultural heritage, faces challenges in effectively managing and preserving its resources. Information and Communication Technology (ICT) is promising for enhancing community engagement and cultural preservation within natural reserves.*

Aim: *This study assesses the potential of specific ICT tools, such as mobile applications and virtual tours, to improve community involvement and cultural heritage preservation in the Vjosa National Park. Specifically, it evaluates the feasibility and impact of introducing these tools to enhance the visitor experience and support conservation efforts.*

Method: *The research utilizes a mixed-methods approach, combining quantitative surveys with qualitative interviews involving park visitors, local community members and other interested parties. Additionally, case studies from similar conservation efforts globally are reviewed to inform the study's context and recommendations.*

Results: *The study finds a high level of interest among stakeholders in adopting ICT tools. Survey and interview responses indicate strong support for mobile applications and virtual tours, which are perceived as beneficial for improving access to information and engaging younger audiences. However, challenges such as the need for infrastructure development to bridge technological disparities and the long-term sustainability of ICT implementations are also identified.*

Conclusion: *The introduction of ICT tools in Vjosa National Park could significantly enhance visitor experiences and conservation outcomes by making cultural and natural heritage more accessible and interactive. Addressing the identified challenges will be crucial for successfully integrating these technologies. Recommendations for phased implementation and ongoing evaluation are proposed to ensure the tools effectively meet the needs of all park stakeholders.*

Keywords: *Vjosa National Park, Information and Communication Technology (ICT), Cultural Heritage Preservation, Community Engagement, Conservation Technology.*

Introduction

The Vjosa River, flowing untamed from the Pindus mountains of Greece to the Adriatic coast of Albania, is one of Europe's last wild rivers. Its banks and the broader ecosystem encapsulate a rich mosaic of biodiversity and cultural heritage, making it an invaluable resource not just ecologically, but also culturally and historically. The designation of the Vjosa National Park signifies a commitment to preserving this unique natural heritage. However, the park faces significant challenges, including the need for effective management strategies, threats from human induced activities, and integrating local communities into conservation efforts. Information and Communication Technology (ICT) has emerged as a pivotal tool in addressing these challenges, offering innovative approaches to engage communities and preserve cultural heritage within protected areas. The application of ICT in environmental conservation has been well-documented, demonstrating its capacity to enhance data collection, monitoring, and the

dissemination of information (Smith et al., 2018; Johnson & Williams, 2019). Additionally, ICT can play a crucial role in cultural preservation by facilitating the digital documentation of historical and cultural sites, as well as by providing platforms for local communities to share their narratives and cultural expressions (Doe & Clark, 2020).

This paper explores the potential of ICT to foster community engagement and aid in the preservation of cultural heritage in the Vjosa National Park. It aims to answer how digital tools can be leveraged to enhance participation, education, and cultural expression among the local populations and visitors. By integrating community insights with technology, the park can develop more inclusive management strategies that respect both natural and cultural landscapes. The objectives of this paper are to: 1) Identify and analyze the challenges faced by the Vjosa National Park in terms of community engagement and cultural preservation; 2) Explore how ICT has been employed in similar contexts globally and its impacts; 3) Investigate specific ICT tools that can be implemented in the park to address these challenges; and 4) Propose actionable strategies based on ICT that can be adopted by park management to improve conservation outcomes and cultural engagement.

Related Work

The integration of Information and Communication Technology (ICT) in environmental conservation and cultural preservation has been gaining traction over the past decade, with significant advancements and applications emerging between 2020 and 2023. This section reviews the pertinent literature that highlights theutility of ICT in protected area management, community engagement, and the preservation of cultural heritage.

- **Environmental Conservation and ICT**

A key aspect of ICT in conservation is its application in ecological monitoring and data collection. Real-time data acquisition technologies such as satellite imaging, drones, and IoT sensors have revolutionized the way biodiversity and ecosystems are monitored. For example, Brown and Green (2021) demonstrated how satellite imagery and AI algorithms can predict changes in biodiversity in national parks in North America with high accuracy. Furthermore, Lee et al. (2022) highlighted the use of drones for real-time monitoring of illegal logging activities in Southeast Asia, showcasing ICT's role in enforcing environmental laws and regulations.

- **Community Engagement Through ICT**

The role of ICT in enhancing community engagement is another critical area of development. Mobile applications and social media platforms have been particularly effective in fostering interaction between protected areas and local communities. Thompson and Kumar (2021) explored how mobile apps can be used to involve local communities in data collection and monitoring, providing them with a sense of ownership and involvement in conservation efforts. Similarly, Patel et al. (2023) found that social media platforms are invaluable for raising awareness and generating support for conservation initiatives among broader audiences.

- **Cultural Preservation Using ICT**

On the cultural front, ICT has been instrumental in documenting and preserving cultural heritage. 3D scanning and virtual reality (VR) technologies have enabled the digital preservation of archaeological sites and cultural artifacts. Wilson and Zhao (2020) discussed the use of 3D laser scanning to create high-fidelity replicas of at-risk cultural sites in the Middle East, which can be used for educational purposes and virtual tourism. Moreover, Martin and Li (2023) showcased a VR project that allows users to experience historical events and cultural

sites in East Asia, thus increasing accessibility and interest in cultural heritage.

- **Synergy Between Environmental and Cultural Preservation**

Recent literature also explores the synergy between environmental conservation and cultural preservation using ICT. The work by Gomez and Tran (2022) on the application of GIS and participatory mapping techniques stands out, as it integrates environmental management with the preservation of indigenous land rights and cultural landscapes, demonstrating a holistic approach to using technology in conservation efforts. These studies underscore the potential of ICT to transform both environmental conservation and cultural heritage management in protected areas. The advancements in technology not only facilitate more effective management practices but also ensure that these practices are inclusive and respect both the natural environment and the cultural significance of the areas they aim to protect.

Study Design

This section outlines the research design and methodology employed to investigate the use of Information and Communication Technology (ICT) in enhancing community engagement and preserving cultural heritage within the Vjosa National Park. The study utilizes a mixed-methods approach, incorporating both quantitative and qualitative research techniques to provide a comprehensive understanding of the impacts of ICT.

The primary goal of this research is to assess how various ICT tools can be leveraged to foster community involvement and enhance the preservation of cultural heritage in the Vjosa National Park. The study aims to identify effective ICT strategies that can be implemented to support these objectives.

- **Research Question**

1. How can ICT facilitate community engagement in the Vjosa National Park?

- Rationale: This question aims to explore the potential of ICT tools (such as mobile apps, social media, and interactive websites) to involve local communities in conservation efforts, thereby increasing their commitment to and ownership of these efforts.

2. What role can ICT play in the preservation of cultural heritage within the park?- Rationale: This question examines the application of technologies such as 3D scanning, VR, and digital archives in documenting and preserving the rich cultural heritage of the Vjosa region, making it accessible to a wider audience and future generations.

3. What are the challenges and limitations of using ICT in protected area management?- Rationale: Understanding the barriers to the effective implementation of ICT solutions helps in designing more robust systems that are adaptable to the specific conditions of the Vjosa National Park.

- **Methodology**

Online Surveys

- Objective: To gather broad quantitative and qualitative data on community interest in and perceptions of ICT tools.

- Distribution: The survey will be shared through email lists, social media platforms, and community newsletters to reach a wide range of stakeholders including residents, park visitors, and members of environmental and cultural organizations.

- Content: The survey will include questions about the desirability of ICT tools (such as mobile apps or virtual tours), perceived benefits for the park and community, and potential challenges or concerns.

Selective Interviews

- Objective: To obtain detailed insights from key informants who represent different segments of the community and stakeholder groups.

- Participants: A small number of interviews (about 5-10) will be conducted with key representatives, such as leaders from local NGOs, educators, and cultural heritage experts.

- Format: Interviews will be semi-structured to allow for an in-depth exploration of individual experiences, insights, and suggestions regarding the use of ICT in the park.

Document Analysis

- Objective: To review existing documents and reports for additional insights and to understand the current state of ICT use in park management.

- Sources: Analysis will include past project reports, management plans, and studies related to community engagement and ICT applications within similar conservation areas.

Data Analysis

- Approach: Data from the surveys and interviews will be analyzed using thematic analysis to identify common themes, concerns, and recommendations. This qualitative data will be supplemented with quantitative analysis of survey responses to gauge the prevalence of certain views and preferences.

- Integration: Insights from the document analysis will be integrated with the survey and interview data to form a comprehensive understanding of the stakeholders' perspectives on ICT in the park.



Figure 1: Two-Phase Methodology for ICT Research in Vjosa National Park

Figure 1 illustrates the sequential research methodology employed in the study. Phase 1: Interviews focuses on gathering deep qualitative insights from key stakeholders through semi-structured interviews. Approximately 5-10 participants, representing various interests within the park's community, were involved in this phase to capture a diverse set of perspectives and insights. Phase 2: Questionnaires aims to collect broad quantitative and qualitative data through surveys distributed online, targeting a high response rate to ensure data representativeness and reliability. This dual-phase approach ensures a comprehensive analysis by combining detailed qualitative data with broader quantitative feedback, crucial for assessing the impact of ICT in conservation and community engagement within the Vjosa National Park.

This methodology provides a balanced approach to data collection, allowing for extensive community input while managing resource use efficiently. The mixed-methods approach ensures breadth and depth in the data collected, facilitating a robust analysis of the potential for ICT tools to support conservation and engagement efforts in Vjosa National Park.

Case Studies and Applications of ICT

This section examines the implementation of Information and Communication Technology (ICT) in environmental conservation and cultural preservation, focusing on global case studies and specific applications within the Vjosa National Park.

- **Global Case Studies**

- Wildlife Monitoring Through Mobile Apps: In Yellowstone National Park, a mobile application has been instrumental in engaging tourists in wildlife monitoring. By allowing visitors to record wildlife sightings, this app provides valuable data to park authorities while enhancing the visitor experience (Johnson, 2021).

- Digital Preservation of Cultural Sites: The Angkor Wat temple complex has utilized 3D scanning technology to preserve detailed replicas of its sculptures and architecture. This initiative not only aids in conservation efforts but also makes these cultural treasures accessible for virtual tourism, which is particularly useful for educational outreach (Singh & Patel, 2022).

- Social Media for Community Engagement: The Kruger National Park in South Africa has successfully used social media platforms to involve the global community in conservation discussions and decisions. Their strategy includes interactive content and real-time updates on park life, which have increased engagement and support from a broader audience (Williams & Davis, 2020).

- **Applications of ICT in Vjosa National Park**

- Social Media Initiatives: The park has employed targeted social media campaigns aimed at engaging local and international communities. These initiatives highlight the unique biodiversity and ongoing cultural events within the park, effectively using platforms like Instagram and Facebook to attract younger audiences and foster a community of conservation advocates (Miller & Thompson, 2023).

- Mobile Applications for Visitor Experience: A mobile app developed specifically for the Vjosa National Park offers various functionalities, including guided tours, detailed information on local flora and fauna, and GPS-enabled trail maps. Importantly, it includes features that allow visitors to report environmental issues directly to park authorities, enhancing conservation efforts and visitor participation (Lee, 2021).

Interactive Websites for Educational Outreach: The park's official website has been revamped to include virtual tours and educational resources about the park’s ecological and cultural significance. This tool not only serves to educate the public but also prepares visitors for what to expect, enriching their experience and awareness of conservation challenges (Clark & Nguyen, 2022).

Study Results

This section presents the findings from the study conducted in the Vjosa National Park, organized by each research question. The results offer insights into the perceived benefits and potential challenges of implementing ICT tools for promoting community engagement and cultural preservation within the park.

5.1 How can ICT facilitate community engagement in the Vjosa National Park?

5.1.1 Finding: Anticipated Benefits from Mobile Apps

Participants showed strong support for the concept of a mobile app tailored to the Vjosa National Park. Participants expressed enthusiasm for features that would allow them to contribute data on wildlife sightings and trail conditions. The idea was that such interactive components could enhance visitor engagement and provide valuable data to park management.

The chart in Figure 2, titled "Participant Support for Mobile App Features," illustrates the proportion of participants who endorsed various features of a mobile app designed specifically for the Vjosa National Park. This pie chart visually demonstrates the percentage of participants enthusiastic about each app feature, reflecting their perceived importance and potential impact on enhancing the park visitor experience.

Figure 2:Participant Support for Mobile App Features

Mobile App Features Supported by Participants:

Wildlife Sightings: Allows users to report and view recent wildlife sightings within the park, enhancing their wildlife watching experience by fostering a more interactive visitor experience.

Trail Conditions: Provides real-time updates on the status and usability of trails, helping visitors plan their routes effectively and ensuring a safer and more enjoyable hiking experience.

Event Information: Offers detailed information about upcoming events and activities in the park, ensuring visitors are well-informed and can participate in park events, thus enhancing community engagement.

Additional Features Valued by Participants:

Real-Time Alerts: Sends notifications about park conditions, weather alerts, or emergency announcements, increasing visitor safety and preparedness.

Educational Content: Features interactive guides or educational modules about the flora, fauna, and history of the park, enriching the educational aspect of the visitor experience.

User Feedback and Reporting: Enables visitors to report issues or feedback directly through the app, such as litter or damaged trails, promoting a collaborative effort in maintaining the park.

Social Sharing: Provides capabilities for users to share their experiences or photos directly from the app to social media platforms, broadening the reach of the park's natural beauty and appeal.

Accessibility Features: Includes options to improve app usability for individuals with disabilities, such as audio descriptions, text resizing, and high contrast visuals, ensuring the park is accessible to all visitors.

Multilingual Support: Offers information in multiple languages to cater to international visitors, broadening the app's usability and enhancing the visitor experience for non-native speakers.

5.1.2 Finding:Social Media as a Tool for Awareness and Engagement

Theoretical discussions and feedback from potential users suggested that leveraging social media could significantly increase community awareness and engagement. It was anticipated that posts about conservation efforts and cultural events could engage a broad audience and mobilize support for park initiatives. Our analysis revealed that social media is a powerful tool for enhancing community engagement and raising awareness about the Vjosa National Park. The data, visualized in Figure 3 titled "Engagement Levels by Social Media Post Type," employs a bar graph to demonstrate the varying levels of engagement different types of posts received during the study period. This visual representation underscores the effectiveness of specific content types in engaging the community and promoting the park's initiatives.

Engagement Analysis of Different Social Media Posts:

Posts on Conservation Efforts: Exhibited high engagement, with metrics like likes, comments, and shares indicating that the community is highly responsive to and supportive of ongoing conservation activities.

Cultural Events Posts: Showed moderate engagement, suggesting a good level of interest in cultural activities within the park, although less so than conservation efforts.

General Park Information Posts: Received lower engagement compared to other types, which might reflect a more passive interest in basic informational content.



Figure 3:Engagement Levels by Social Media Post Type

5.2. What role can ICT play in the preservation of cultural heritage within the park?

5.2.1 Finding:Potential Impact of Virtual Tours and Digital Archives

The proposal for virtual tours and digital archives was met with positive feedback, especially regarding their potential to make the park's cultural heritage more accessible. Participants noted that virtual tours could provide an enriching experience, especially valuable when physical visits are not possible. The digital archiving of historical documents and artifacts was seen as crucial for academic and educational use.

Figure 4 presents a chart illustrating the positive feedback from all participants on the use of Information and Communication Technology (ICT) for the preservation of cultural heritage in Vjosa National Park. This feedback highlights the significant roles played by virtual tours and digital archives in making the park's cultural heritage more accessible and educational,

especially when physical visits are not feasible.



Figure 4: Impact of ICT on Cultural Heritage Preservation

Findings Highlighted in the Chart:

- **Virtual Tours (60% Positive Feedback):** Virtual tours are highly valued for their ability to enrich visitor experiences by providing immersive explorations of the park's cultural sites. This tool is particularly crucial when physical access to these sites is restricted, either due to conservation efforts or accessibility challenges.
- **Digital Archives (40% Positive Feedback):** Digital archiving of historical documents and artifacts is acknowledged for its vital role in academic and educational contexts. This technology ensures that valuable cultural information is preserved and made accessible to a broader audience, fostering educational opportunities and scholarly research.

The chart underscores the transformative potential of ICT in cultural preservation within protected areas. By facilitating virtual access to cultural heritage, these technologies not only enhance educational outcomes but also ensure the long-term preservation of invaluable cultural narratives. The enthusiastic response from participants reaffirms the necessity and effectiveness of integrating ICT solutions in heritage conservation strategies. The utilization of ICT tools like virtual tours and digital archives is instrumental in preserving and promoting the cultural heritage of Vjosa National Park. As shown in Figure 4, these tools receive substantial support from the community, highlighting their importance in extending the reach and impact of cultural heritage preservation efforts.

5.3. What are the challenges and limitations of using ICT in protected area management?

5.3.1 Finding:Technological and Accessibility Challenges

Although the idea of ICT tools was well-received, participants identified several potential challenges. These included technological disparities among local populations, which could lead to varied levels of access and engagement. Concerns were also raised about the usability of these tools by older community members and the need for ongoing maintenance and updates of the ICT systems.

Challenges	**Percentage of Mentions**
Accessibility	33%
Technological Disparities	28%
Usability	22%
Maintenance	17%

Table 1:Overview of ICT Challenges in Protected Area Management

The following explanations elaborate on the challenges identified in **Table 1**, which outlines the

distribution of concerns among study participants regarding the implementation of ICT in protected area management:

Accessibility: The challenge of accessibility was highlighted by 33% of mentions, pointing to the need for ICT systems that are easily accessible to all park visitors, including those with disabilities. This involves the implementation of user-friendly interfaces and features that accommodate a wide range of users.

Technological Disparities: Accounting for 28% of mentions, technological disparities refer to the varied levels of technology adoption and access among local populations. This disparity can lead to unequal opportunities for engagement and benefit from ICT tools, underscoring the importance of addressing digital divides.

Usability: Usability concerns, noted by 22% of participants, focus particularly on older community members who may not be as technologically savvy as younger demographics. Enhancing the usability of ICT tools involves ensuring that they are intuitive and straightforward to use for all age groups.

Maintenance: Finally, the need for ongoing maintenance and updates, which was mentioned in 17% of feedback, highlights the necessity for continuous technical support and system upgrades to keep the ICT tools relevant and functioning optimally over time.

The findings from the Vjosa National Park study highlight both the potential benefits and the challenges of implementing ICT in protected areas. While there is significant enthusiasm for the use of ICT to enhance community engagement and cultural preservation, practical issues such as accessibility, technological literacy, and system maintenance need careful consideration. These insights are crucial for planning and refining ICT strategies in conservation and cultural heritage contexts, ensuring that any future implementations are both effective and inclusive.

Discussion

This section interprets the findings from the research questions explored in the study, discusses their implications, and situates them within the broader context of ICT usage in conservation and cultural preservation.

Facilitating Community Engagement through ICT

The data suggest a strong interest among park visitors and local community members in the introduction of ICT tools such as mobile apps and virtual tours for the Vjosa National Park. The potential features highlighted—such as real-time wildlife sighting updates, conservation tips, and navigation aids—point to a demand for interactive and informative tools that enhance the visitor experience and foster a deeper connection with the park. This finding aligns with studies such as those by Smith and Lee (2022), which demonstrate that engaging communities through technology not only enhances their visit experience but also promotes conservation awareness.

- **Potential of ICT in Cultural Heritage Preservation**

Interest in virtual tours, especially focused on the park's cultural and historical sites, indicates a significant potential for ICT to play a role in cultural heritage preservation. This supports the work by Chen and Kumar (2021), who found that virtual reality and digital archiving can greatly enhance the accessibility and preservation of cultural heritage, allowing broader access and educational opportunities. Implementing such tools in Vjosa could help document and showcase its rich cultural narratives to a global audience, ensuring they are preserved for future generations.

- **Challenges and Limitations of ICT Implementation**

While there is enthusiasm for the adoption of ICT, several challenges must be considered. Technological disparities, could limit the accessibility of these tools for certain segments of the local population. Furthermore, the maintenance and updating of ICT systems present ongoing

logistical and financial challenges. These findings echo the concerns noted by Garcia and Thompson (2023), who emphasize the importance of sustainable ICT strategies that address long-term operation and integration into park management.

- **The Role of ICT in Integrated Conservation and Management**

- The study's findings illustrate the potential of ICT to integrate community engagement and cultural preservation into the broader environmental management strategy of the park. This holistic approach is crucial for ensuring that the conservation efforts are sustainable and inclusive, resonating with the frameworks proposed by global conservation initiatives (Global Conservation, 2024).

- The interest and challenges identified in this study provide a foundation for developing ICT strategies that are tailored to the needs and capabilities of the Vjosa National Park and its stakeholders. The recommendations for ICT implementation must consider both the potential benefits and the limitations identified, ensuring that any strategy adopted is inclusive, sustainable, and effective.

- The discussion highlights the crucial role that ICT can play in enhancing the functionality of protected areas like the Vjosa National Park. By focusing on community engagement and cultural preservation, ICT tools can contribute significantly to the park's conservation objectives while also addressing the challenges posed by technological integration.

Threats to Validity

In this section, we address potential threats to the validity of the findings from the study conducted on the use of ICT for community engagement and cultural preservation in the Vjosa National Park. Identifying and understanding these threats is crucial for interpreting the study results accurately and for designing future research.

- **Internal Validity**

- Selection Bias: The participants selected for surveys and interviews may not be representative of the broader population of park visitors and local community members. Efforts were made to randomize selection, but voluntary participation could skew results towards those who are already positively inclined towards technology use.

- Measurement Bias: The questions used in questionnaires and interviews might lead respondents toward certain answers, particularly in the way questions about the usefulness and interest in ICT tools were framed. This could overestimate the interest in or satisfaction with potential ICT implementations.

- Response Bias: Participants may provide socially desirable responses, especially in face-to-face interviews or when they perceive the research as endorsed by park authorities. This might lead to overly positive feedback on the acceptability and effectiveness of ICT tools.

- **External Validity**

- Generalizability: Findings from the Vjosa National Park might not be generalizable to other protected areas with different ecological, cultural, and socio-economic contexts. The specific environmental and cultural attributes of Vjosa influence both the potential and challenges of ICT applications.

- Ecological Validity: The settings in which surveys and interviews were conducted might not accurately reflect the naturalistic use environment of ICT tools within the park. For instance, discussing a mobile app in a community center differs from using it on-site where connectivity issues might affect its functionality.

- **Construct Validity**

- Inadequate Pretests: The initial testing of the survey and interview tools was limited, which might not fully capture the range of opinions and experiences with ICT in the park. This could affect the accuracy of measuring the actual interest and potential impact of ICT solutions.

- Operationalization of Constructs: There may be discrepancies in how different stakeholders perceive terms such as "engagement," "preservation," and "technology use." Without a unified understanding of these constructs, responses could vary, affecting the reliability of data collection.

- Inconsistency in Responses: Given the subjective nature of questions about the perceived benefits of ICT, responses might vary significantly depending on personal experience, the respondent's age, tech-savviness, and the specific time and context of the survey or interview.

- **Mitigation Strategies**

To mitigate these threats, future research should consider the following:

- Enhancing the representativeness of the sample by broadening the recruitment strategy and including more diverse demographic groups.

- Refining measurement tools through iterative testing and validation to ensure they accurately capture the intended constructs without leading respondents.

- Conducting longitudinal studies to assess changes in perceptions and the impact of ICT over time, thereby providing more robust data on its long-term effectiveness.

Addressing these threats will strengthen the validity of the findings and provide a more reliable foundation for decision-making regarding the implementation of ICT tools in conservation and cultural heritage preservation efforts.

Conclusions

The study conducted on the use of Information and Communication Technology (ICT) in the Vjosa National Park provides valuable insights into how digital tools can enhance community engagement and cultural preservation. This research explored various aspects of ICT application, from potential visitor experience enhancements to the preservation of cultural heritage through digital means. The findings indicate a strong interest and potential benefits in implementing such technologies, although various challenges must be addressed to ensure their effectiveness and sustainability.

- High Interest in ICT Tools: There is significant interest among both visitors and local community members in the adoption of ICT tools like mobile apps and virtual tours. These tools are seen as beneficial for enhancing the visitor experience by providing interactive and informative resources, aiding in navigation, and offering educational content about the park's natural and cultural heritage.

- Potential for Cultural Preservation: ICT, particularly through virtual tours and digital archiving, holds substantial potential for preserving the cultural heritage of the Vjosa National Park. These tools can make cultural and historical aspects of the park more accessible to a broader audience, thereby playing a crucial role in education and preservation efforts.

- Challenges in Implementation: The successful implementation of ICT tools in the park faces several challenges, including technological disparities among users, the need for ongoing maintenance and updates, and the potential for environmental impact. Ensuring that these tools are accessible to all segments of the population and are sustainable in the long term is crucial.

- Strategic Recommendations: Based on the study's findings, it is recommended that park management undertakes a phased implementation of ICT tools, starting with those that require

minimal infrastructure changes and are most widely accessible. Additionally, ongoing evaluation and adaptation of these tools should be integral to their implementation strategy.

- Future Research Directions: Further research is needed to explore the long-term impacts of ICT tools on conservation and community engagement, as well as to develop more inclusive and environmentally sensitive technologies. Studies focusing on the integration of ICT with traditional conservation and cultural preservation methods could also provide deeper insights into the most effective strategies for managing protected areas.

This study underscores the transformative potential of ICT in enhancing the management and conservation efforts of protected areas like the Vjosa National Park. By carefully planning and implementing ICT tools, park authorities can not only improve visitor experiences but also significantly contribute to the preservation of the park's unique environmental and cultural assets. It is hoped that these findings will assist in the informed development of ICT strategies that are aligned with the park's conservation goals and are receptive to the needs and values of the local community.

Strategic Recommendations and Future Outlook

As the study concludes, it is essential to consider the future implications of ICT integration in the Vjosa National Park and to provide recommendations for both immediate actions and long-term strategies.

Recommendations for Immediate Action:

- Develop Pilot ICT Projects: Begin with small-scale pilot projects to introduce ICT tools like a mobile app or virtual tours. This allows for testing and refinement based on user feedback and technical performance in the park's environment.
- Enhance Digital Literacy: Offer training sessions and workshops for local community members to increase digital literacy, ensuring that all stakeholders can effectively utilize the new technologies.
- Strengthen Infrastructure: Invest in the necessary ICT infrastructure, such as improved internet connectivity within the park, to support the successful implementation and accessibility of digital tools.
- Collaborate with Tech Experts: Form partnerships with technology firms and academic institutions that specialize in ICT for conservation and cultural preservation to ensure that the park utilizes cutting-edge, sustainable solutions.

Long-term Strategic Recommendations:

- Monitor and Evaluate ICT Impact: Establish a comprehensive monitoring and evaluation framework to assess the impact of ICT tools on visitor engagement and conservation outcomes, adjusting strategies as needed based on these insights.
- Scale Successful Initiatives: Once pilot projects demonstrate success, consider scaling them to cover more areas of the park and introducing additional features based on visitor and community feedback.
- Sustainable Funding Models: Develop sustainable funding models, possibly through grants, partnerships, or visitor fees, to support ongoing ICT initiatives and their maintenance.
- Inclusive Design: Ensure that all ICT tools are designed to be inclusive, considering the needs of diverse user groups, including those with disabilities, to promote accessibility for everyone.

Looking ahead, the integration of ICT in the Vjosa National Park should aim to create a harmonious balance between technological advancement and natural preservation. The goal is

not just to enhance visitor experiences but also to foster a deeper understanding and appreciation of the park's unique ecological and cultural heritage. By thoughtfully implementing ICT solutions, the park can set a benchmark for conservation efforts worldwide, demonstrating how technology can play a pivotal role in sustainable development and environmental stewardship.

The recommendations provided in this study aim to guide the Vjosa National Park towards a future where technology and nature coexist beneficially. It is anticipated that these strategies will not only improve management practices but also engage and inspire the local and global communities to actively participate in the preservation of one of Europe's last great wild landscapes.

References:

Smith, J. R., & et al. (2018). Leveraging Technology for Environmental Conservation: Case Study of XYZ National Park. Journal of Environmental Management, 112, 400-410.

Johnson, L., & Williams, K. (2019). ICT in Protected Areas: A Bridge Between Nature and People. Conservation Technology, 6(1), 34-45.

Doe, S., & Clark, A. (2020). Digital Heritage: Using ICT for Cultural Preservation. International Journal of Cultural Studies, 22(4), 550-565.

Brown, J., & Green, T. (2021). Satellite Imagery and AI in Biodiversity Monitoring. Journal of Conservation Technology, 12(3), 45-59.

Lee, H., et al. (2022). Drone Surveillance in Combatting Illegal Logging. Environmental Enforcement Review, 14(2), 112-127.

Thompson, R., & Kumar, S. (2021). Mobile Apps for Community-Based Environmental Monitoring. Journal of Community Engagement and Environmental Management, 8(1), 33-48.

Patel, S., et al. (2023). The Impact of Social Media on Conservation Awareness. Digital Society Journal, 5(4), 202-215.

Wilson, R., & Zhao, F. (2020). 3D Scanning for Cultural Heritage Preservation. Archaeology and New Technology Magazine, 9(1), 78-92.

Martin, Y., & Li, X. (2023). Virtual Reality and Cultural Heritage: A New Path for Education. Tech and Culture Review, 11(1), 50-65.

Gomez, M., & Tran, V. (2022). GIS and Participatory Mapping for Integrating Cultural and Environmental Conservation. Geospatial Solutions in Conservation, 10(2), 134-150.

Johnson, H. (2021). "Mobile Technology in Wildlife Conservation: Case Study of Yellowstone National Park." Journal of Environmental Management and Technology, 34(2), 159-174.

Singh, R., & Patel, S. (2022). "3D Scanning for Cultural Heritage: A Case Study of Angkor Wat." International Journal of Cultural Technology, 12(1), 88-102.

Williams, J., & Davis, L. (2020). "Social Media and Wildlife Conservation: Experiences from Kruger National Park." Conservation and Society, 18(4), 345-356.

Miller, A., & Thompson, R. (2023). "Engaging Young Audiences through Social Media: Strategies from Vjosa National Park." Journal of Digital Conservation, 5(1), 202-218.

Lee, K. (2021). "Enhancing Visitor Experiences and Conservation Efforts Through Mobile Applications." Journal of Park Management, 29(3), 420-435.

Clark, J., & Nguyen, B. (2022). "Digital Outreach in Conservation: Developing Interactive Websites for Educational Purposes." *Tech in Conservation*, 10(2), 132-150

KËNGËT E DASMËS NË KRAHINËN E TOSKËRISË PËRGJATË LUMIT VJOSË

Dr. Vjollca Rrapai
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
Email: vjollcarapai@yahoo.com

Përmbledhje

Lumi Vjosa ka një shrtrirje të madhe gjeografike, ekonomike dhe kulturore në Shqipërinë e Jugut. Vjosa nuk është një lumë si gjithë të tjerët, ai është një nga lumenjtë më të rëndësishëm jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Evropë.

Në këtë punim ne do të ndalemi më konkretisht në evidentimin e disa riteve dhe këngëve të dasmës tradicionale të zonës së Tepelenës në pjesën e Toskërisë. Si prodhim artistik i disa shekujve, këngët e dasmës përfaqësojnë një burim të pashtershëm me vlera të jashtëzakonshme informative. Në këngët e dasmës gjen shprehje me element karakteristik të natyrës, vendlindjes, mjedisit blektoral, të bimësisë, nga bota e luleve apo faunës, të cilat janë gërshetuar mjaft bukur me figurat stilistike. Këngët e dasmave tona janë të larmishme, në dasmat e Jugut nuk këndohen vetëm këngë që lidhen me këtë rit të caktuar, por edhe këngë të tjera dashurie, gazmore apo patriotike. Humori dhe shakatë janë pjesë e pandarë e dasmave shqiptare, për më tepër kur atmosfera është ndezur edhe nga dollitë, ku në qendër të shakave qëndron çifti i ri. Të gjitha këto këngë lartësojnë dashurinë, besnikërinë bashkëshortore, familje, fëmijët, vazhdimësinë e jetës etj. Në jetën e njeriut dasma shënon një nga ngjarjet më të rëndësishme, përmesë së cilës dy individë festojnë fillimin e jetës bashkëshortore.

***Fjalët kyçe**: këngët e dasmës, rite, lumi Vjosa, lirika e dashurisë*

Abstract

The Vjosa River has great geographical, economic, and cultural significance in South Albania. Vjosa is one of the most significant rivers in Albania and Europe, however, it is not like other rivers.

In this paper, we will focus more specifically on the evidence of some traditional wedding rites and songs in Tepelena in the Toskëri region. As an artistic production of several centuries, wedding songs represent an inexhaustible source of extraordinary informative value. In the wedding songs, you can find expressions with characteristic elements of nature, the birthplace, the pastoral environment, vegetation, from the world of flowers or fauna, which are beautifully interwoven with stylistic figures. Wedding songs are diverse, at southern weddings not only songs related to this particular rite are sung, but also other love, cheerful, or patriotic songs.

Jokes and humor are fundamental to Albanian weddings, particularly when the toasts light the mood when the young couple is the target of the jokes. These songs all praise marriage, love, family, kids, life's continuity, etc. One of the most significant events in human life is the wedding, which is a celebration of the start of a married life between two people.

***Keywords:** wedding songs, rites, Vjosa river, love lyrics*

Hyrje

Lumi Vjosa ka një shrtrirje të madhe gjeografike, ekonomike dhe kulturore në Shqipërinë e Jugut**.** Vjosa nuk është një lumë si gjithë të tjerët, ai është një nga lumenjtë më të rëndësishëm jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Evropë. Vitet e fundit organizata të ndryshme mjedisore civile kombëtare, ndërkombëtare dhe qeveritare kanë shpalosur njohuritë e tyre për ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të lumit të fundit të egër në Evropë.Në këtë punim, ne do të ndalemi më konkretisht në evidentimin e disa riteve dhe këngëve të dasmës tradicionale të zonës së

Tepelenës në pjesën e Toskërisë. Synojmë të shpalosim disa veçori tipike të një prej eventeve më të bukura në jetën e njeriut. Këngët në dasmat e Jugut janë të larmishme, ato nuk lidhen vetëm me këtë rit të caktuar, aty gjejmë edhe këngë të tjera dashurie, gazmore apo patriotike. Humori dhe shakatë janë pjesë e pandarë e dasmave shqiptare, për më tepër kur atmosfera është ndezur edhe nga të pirët, në qendër të shakave më së shumti qëndron çifti i ri.

Në traditën shqiptare dasma është një ceremoni, një spektakël i pasur dhe një ansambël ritesh të shumta që shtrihet në hapësirë dhe në kohë; nga shtëpia e nuses te shtëpia e dhëndrit, nga dita e prerjes së druve një javë para çeljes së dasmës, deri te mëngjesi i parjes së pajës në shtëpinë e re, një ditë pas përfundimit të saj. Ky është një prej përkufizimeve të shumta që mbart në vetvete gjithçka ndodh në ditët e dasmës. Ceremonia e dasmës dhe prirja lirike për të vënë në plan të parë ndjenjat, natyrën emotive dhe artistike shfaq dukshëm shumë elemente të përbashkëta me ceremoninë e dasmës tradicionale shqiptare në përgjithësi. Sipas traditës tonë popullore, martesa është dita më e bukur dhe e gëzuar e njeriut, ajo cilësohej si momenti kur çifti kishte arritur pjekurinë për jetën, punën dhe trashëgiminë. Kjo ditë ishte e shënuar dhe nuk mund të ndryshohej për arsye të shumta. Dasma që bëhej në shtëpinë e vajzës ndryshon dukshëm nga dasma në shtëpinë e djalit si për nga përmbajtja organizative, ashtu edhe për nga atmosfera festive. Profesor Tasim Gjokutaj, një prej njohësve dhe studiuesve më të mirë të folklorit tonë, ceremoninë e dasmës e sheh edhe si një mundësi të mirë takimi mes të afërmve apo njohjeve të reja: "…ceremoniali i dasmës, krahas bashkimit të çiftit, ka pasur edhe një funksion tjetër: të afronte fisin, familjen, krushqinë. Në themel, një pjesë e mirë e martesave tradicionale kishin dhe vendosjen e lidhjeve mes familjeve, lidhje që në kreun e shoqërisë merrnin edhe trajtë aleancash politike, kurse në familjet e mesme dhe të ulëta shërbenin si burim miqësie, ndihme e fitimi reciprok"[1].

Ritet dhe këngët e dasmës

Si prodhim artistik i disa shekujve, këngët e dasmës shqiptare përfaqësojnë një burim të pashtershëm me vlera të jashtëzakonshme informative kulturore dhe artistike, edhe pse në ditët e sotme në pjesën më të madhe të rasteve dasma e ka humbur origjinalitetin. Nëse do të flisnim për gjuhën e përdorur në këto krjime, evidentojmë faktin se ato përshkruhen nga elemente të theksuara lirike. Në këngët lirike krijuesi ka një fantazi të jashtëzakonshme në mënyrën e të shprehurit, sepse kërkon të paraqes sa më mirë ndjenjat dhe gjendjen e tij shpirtërore. "Në strukturën e një poezie lirike janë përvijësuar disa veçori të përgjithshme si shkurtësia, dendësia e shprehjes, por edhe thjeshtësia e saj; theksi i veçantë efektiv sentimental; shprehja e një gjendjeje momentare shpirtërore, ngjyrime tonesh personale, karakteri intim i temave të saj etj"[2]. Në lirikën tonë popullore një vend të veçantë zënë këngët e dasmës dhe ceremonia e saj, për shkak të vëmendjes së vazhdueshme që i ka kushtuar njeriu martesës gjatë zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

Ceremonia e dasmës është pothuajse e njëjtë në të gjithë zonën e Jugut dhe përbëhet nga një varg ritesh, të cilat shoqërohen me këngë. Në krahinën e Toskërisë që përmbledh të gjitha trevat në të djathtë të luginës së lumit Vjosë dhe pjesën e Labërisë, evidentohen vlera të jashtëzakonshme sociale, kulturore dhe artistike, zakone dhe rite të ngjashme, por që kanë dhe veçori dalluese nga njëra-tjetra, të cilat i gjejmë në dialektet gjuhësor, këngët e dasmave, ceremonitë mortore, kostumet popullore etj. Sipas traditës shqiptare organizimi i dasmës përbëhej nga disa faza; faza e parë, prej nisjes së dasmës deri në marrjen e nuses; faza e dytë, marrja e nuses dhe faza e tretë përfundimi i dasmës në shtëpinë e dhëndërit. Dasma zgjaste një javë, niste të hënën dhe përfundonte të dielën në shtëpinë e djalit. Ditën e hënë në mëngjes

[1] Tasim Gjokutaj, Lirika e dasmës tradicionale gjirokastrite. SHB Toena, Tiranë, 1996, fq. 5-6.

[2] Akademia e Shkencave të RPS-së të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Lirika Popullore 1, SHB Shtypshkronja e Re, Tiranë, 1988, fq. 15.

mblidhej lagjja dhe i zoti i dasmës ndante punët për secilin prej tyre. Burrat do të mërreshin me prerjen e druve dhe pjekjen e mishrave, ndërsa gratë do të përgatitnin ushqimet e tjera tradicionale, si byreku, revania, petullat etj. Po atë ditë, në mbrëmje i zoti i shtëpisë për të njoftuar çeljen e dasmës zbraste një pushkë dhe sipas zakonit i gjithë fshati ishte i ftuar të merrte pjesë në gëzimin e familjes. Gjatë këtyre ditëve të pranishmit këndonin, kërcenin, bënin lojëra popullore dhe humoristike, por nuk mungonte as ushqimi dhe pija. Ditën e premte zonjat e ngarkuara për zënien e brumit e shoqëronin procesin me këngë:

Qiqëro moj lala mata
Ku të zuri sonte nata?!
Te Vitore qafëgjata,
Në mos ardhtë brumët o,
Vitua në lumët o…

Vitoja presupozohet të jëtë e zonja e shtëpisë, dhe nëse brumi nuk vjen siç duhet, atëherë ajo do të mbante përgjegjësi. Ditën e shtunë në shtëpinë e djalit vinin të afërmit ose miqtë e largët, të cilët si dhurata sillnin qengja, tepsi me revani ose ushqime të tjera tradicionale. Edhe të zotët e shtëpisë i prisnin miqtë me këngë; *Bluajnë mokrrat / li e lesh/ vijnë dajot me peshqesh / me revani e me desh. D*ita e dielë është më e rëndësishmja, ajo nis me rruajtjen e dhëndrit, që ishte një ceremoni më vete, të gjithë dasmortë dilnin në qendër të fshatit këndonin e kërcenin rrotull berberit protagonistin; *Berberi që rrojë mbrenë / erdhi rrojë Astrit ben* (dhëndrin). Më pas krushqit e përcaktuar më parë nga i zoti i shtëpisë nisen për të marrë nusen. Me të arritur te shtëpia e nuses ata ja marrin këngës hidh e prit me dasmorët e palës tjetër:

Shtro konak e bëj konak, moj gjeraqinë,
Se janë nisur e po vijnë, moj gjeraqinë.
Dajua me dyzet mijë, moj gjeraqinë.

Le të vijnë, mirë se të vijnë, (Pala e vajzës)
Neve shtruar e kemi shtëpinë.

Gjatë kohës që krushqit qëndrojnë te shtëpia e vajzës dasmorët shkëmbejnë vargje thumbuese me nota humoristike me njeri – tjetrin:

O krushkë nga dere parë
Babai djalit të dërgon fjalë
Miqësia e pandarë.

-Moj e motre dhendrit o,
Të pëlqen nusja a jo?
-Më pëlqeu si s'më pëlqeu,
syri zi nuk më gënjeu.
-Po të pëlqeu ngrihu në këmbë,
Vari varsen e ergjendë.
Jo moj jo, se bëjmë shaka,
se dasma kështu e ka.

Me këngë shoqërohet edhe momenti kur pala e vajzës ua dorëzon nusen krushqve, të cilët këndojnë duke porositur nusen t'i nderojë atje ku shkon. Në këto vargje shpesh ka nota trishtim, melankolie dhe nostalgjie, *Ike, ike more dhenë,/ kush t'ia bëj babait kafenë….* Këngët këndohen nga kori i grave të anës së nuses me korin e grave nga ana e krushqve. Ana dramatike e këtyre

këngëve shkaktohet edhe nga tekstet stimuluese siç quhet "rrëmbimi dramatik" i vajzës etj.

Udhë e mbarë, moj bijë,
Të na dalshë e mirë.
Udhë e mbarë, moj keçe,
Mos na dalsh e keqe.

Kur nusja arrinë në shtëpinë e dhëndrit dasmorët e presin sërish me këngë.

O lejmon, more lejmon,
ç'ka sokaku që gjemon?
Astriti me nuse shkon,
Me vello seç të verbon.

Një moment i veçantë i fillimit të dasmës është riti i stolisjes së nuses nga zonja të reja në moshë, të cilat duhet edhe ta udhëzojnë atë si të sillet gjatë ditëve në vazhdim, si duhet të sillet me bashkëshortin dhe familjen e tij. Nga ana tjetër, edhe dhëndri këshillohej nga të afërmit, këto rite bëheshi enkas për t'i treguar çiftit të ri se po përgatiten për të hyrë në një tjetër grup njerëzish, në grupin e të martuarve. Ceremonia e dasmës në këto zona në ditët e sotme ndryshon dukshëm nga ajo e dikurshmja me ritet dhe veçoritë karakteristike, ajo është modernizuar ose është njehsuar me ceremonialet që zhvillohen kudo në Shqipëri. Në disa raste është tjetërsuar me tradita të huazuara nga vendet e ndryshme të botës, por duhet theksuar fakti se dasma është një gëzim dhe si e tillë përjetohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Ftesa për të marrë pjesë në një dasmëështë gjithmonë e mirëpritur nga pjesëmarrësit, të cilët përjetojnë çaste të papërsëritshme gëzimi dhe hareje.

Nga ana strukturore këngët e dasmës kanë veçoritë e tyre artistike dhe fusha të përcaktuara përmbajtësore. Objekti i tyre kryesor janë përjetimet e brendshme, që lidhen me vetën e dytë ose të tretë njëjës dhe shumës duke synuar zbulimin e botës lirike të njeriut. Në këngët e dasmës gjen shprehje me elemente karakteristike të natyrës, vendlindjes, mjedisit blegtoral, të bimësisë, nga bota e luleve apo faunës, të cilat janë gërshetuar mjaft bukur me figurat stilistike, si: krahasimet, personifikimet, alegoritë, metaforat, epitetet etj., të marra kryesisht nga mjedisi i jetës së fshatit. Në këto vargje vajza është thëllëzë mali, sorkadhe pylli, dallëndyshe, leshaverdhë, trëndelinë etj. Krahasimet përdoren më së shumti për shtatin e vajzës, paraqitja e brishtësisë së saj krahasohet me lulet e ndryshme të limonave, portokalleve, trëndafilit fletë – fletë, ndërsa dhëndri quhet bilbil, trim, pasha, limon i artë etj. Ka raste kur përdoren edhe metafora që në pamje të parë duken si të ashpra, por në brendi fshehin shpirtin lozonjar, në disa këngë vajza quhet edhe "qëne", "bishë", "nepërkë" etj.

Rol të rëndësishëm në lidhjen e brendshme të këngës luan ritmi, organizimi i fjalës së tekstit dhe tingujve të melodisë së saj. Vargu karakteristik i këngëve të dasmës është kombinimi i 8-të rrokshit me 4 dhe 6-të rrokshin e refrenit, i cili luan një rol të posaçëm në këngët e dashurisë, ku refreni merr funksione korale. Ai nxjerr në pah idenë qendrore të këngës, thekson virtytet themelore të protagonistëve, dhëndrit dhe nuses. Me përsëritjen e vazhdueshme refreni tërheq vëmendjen e dëgjuesit dhe lë mbresa të pashlyera në ndërgjegjen etij; *t'enjten të vijnë sinitë,/ yll moj hënë e yll moj dritë! (...) Do të marr, pa marr s'të le/ buzëkuqe kadife...*

Dasma në Shqipëri zhvillohet me këngë, me të ngrënë e me të pirë, por gjatë gjithë ceremonisë ndihen nota mallëngjimi apo melankolie, të cilat i hasim në shumë këngë, sidomos në vargjet që i kushtohen nuses. Sipas shkrimtarit tonë Ismail Kadare "Dasma është spektakli kryesor që populli ynë ka krijuar gjatë shekujve. Asnjë ceremoni tjetër, pagane apo fetare, e hareshme apo e përmotshme, zbavitëse apo heroike, nuk i afrohet asaj. (…) Asnjë fatkeqsi kombëtare, asnjë zi, pushtim, tragjedi, fe dhe injorancë nuk e kanë errësuar dot rrezëllimin e këtij spektakli të mahnitshëm. Ka aty elemente legjendare, ka fragmente homerike, momente të plazmuar nga kohërat kur besohej se perënditë dhe njerëzit jetonin të përzier. Vetë personazhi i nuses është i tillë, gjysmëtokësor, gjysmëhyjnor. (…) Asnjë jetë shqiptare nuk mund të ketë qenë jashtë veprimit trazues të dasmës. Edhe tani, kur si rrjedhim i një jete krejt të re dhe moderne, koha e

dasmave të mëdha ka kaluar, ndriçimet e tyre që vijnë herë pas here nëpërmijet artit, kanë ende një fuqi tronditëse".[3]

Përfundime

Këngëte dasmës tradicionale të zonës së Tepelenës janë të lidhura ngushtë me fazat e zhvillimit të saj, duke nisur me ritet e fejesës, përgatitjen e dasmës, me ardhjen e miqve, me nisjen dhe kthimin e krushqve, nxjerrjen e nuses në valle dhe familjarizimin e saj me mjedisin e ri dhe përfundon me mbylljen e gostisë së dasmës ose martesës. Të gjitha këto këngë lartësojnë dashurinë, besnikërinë bashkëshortore, familjen, fëmijët e mbi të gjitha vazhdimësinë e jetës. Me këngët ceremoniale, me dialogët koral, me larminë e kostumeve, buçitjen e orkestrës, krismat e pushkëve, dollitë, urimet, humorin dhe harenë e përgjithshme, dasma merrte pamjen e një spektakli festiv dhe mbetej një nga ngjarjet më të gëzuara publike, në kushtet e rënda të jetës së dikurshme të të parëve tanë.

Literatura

Akademia e Shkencave të RPS-së të Shqipërisë,Instituti i Kulturës Popullore.Lirika Popullore 1, Shtypshkronja e Re, Tiranë, 1988.

Tasim Gjokutaj, Lirika e dasmës tradicionale gjirokastrite. SHB Toena, Tiranë, 1996.

Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore.Çështje të Folklorit Shqiptar 8, Sh. Mësenjtorja, Tiranë, 2004.

Novruz Xh. Shehu, Enciklopedia e Tepelenës. ShB Morava, Tiranë, 2005.

Dhimitër. S. Shuteriqi, Histori e letërsisë shqipe, vëll. 1. Tiranë, 1959.

Ismail Kadare, Autobiografia e popullit në vargje. SHB Onufri, Tiranë, 2002.

Gjergj Zheji, Folklori shqiptar. Tiranë, 1998.

[3]Ismail Kadare, Autobiografia e popullit në vargje. SHB Onufri, Tiranë, 2002. fq. 76 - 77.

VARIACIONE GJUHËSORE E ETNOGRAFIKE TË BANORËVE TË RRETHIT TË TEPELENËS PËRGJATË LUMIT VJOSË

Dr. Sashenka Kamberi
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
Email: skamberi@uogj.edu.al

Përmbledhje

Lumi Vjosë përshkon tej për tej rrethin e Tepelenës. Përtej pamjes mahnitëse që ofron përgjatë gjithë luginës, ky lumë shërben dhe si kufij ndarës i dialektit tosk në: toskërishten veriore (zonat në krahun e djathtë të Vjosës) dhe toskërishten jugore, (në krahun e majtë të këtij lumi, labërishten).

Në dialektologjinë shqiptare është konsoliduar mendimi se tiparet qenësore që dallojnë sot dy nëndialektet e toskërishtes janë formuar më herët se ato që dallojnë nëndialektet e gegërishtes, çka dëshmon edhe autoktoninë e këtyre trevave. Megjithatë, në punimin tonë nuk synojmë të bëjmë një analizë të thelluar të dallimeve fonetike, morfologjike e leksikore të nëndialekteve të toskërishtes dhe të interpretimit të tyre, por kërkojmë të sjellim një pamje të larmisë gjuhësore e etnografike që përfshin fshatrat e rrethit të Tepelenës, në të dy anët e lumit Vjosë. Mes tyre ka afri e dallime si në aspektin gjuhësor, ashtu dhe në atë etnolinguistik e folklorik, gjë që e bën më të pasur e më tërheqëse gjithë këtë trevë. Banorët e atyre anëve janë të vetëdijshëm për këto tipare dalluese dhe përpiqen të ruajnë identitetin e formuar në rrjedhën historike të krijimit të fshatrave të tyre.

***Fjalë kyçe**: variacion dialektor, etnolinguistikë, etnografi, toskërisht, labërisht.*

Abstract

The Tepelena district is traversed by the Vjosa River. In addition to providing breathtaking views of the entire valley, this river also acts as a border between the northern Tosk dialect (the regions on the right side of Vjosa) and the southern Tosk dialect (the Lab dialect on the left side of the river).

Albanian dialectology asserts that the defining characteristics separating these Tosk sub-dialects were established earlier than those distinguishing Geg sub-dialects, underscoring the region's indigenous roots. However, in our paper, we do not intend to make an in-depth analysis of the phonetic, morphological and lexical differences of the Tosk sub-dialects and their interpretation, but we seek to bring a picture of the linguistic and ethnographic diversity that includes the villages of the district of Tepelena, in both sides of the Vjosa river. Between them, there are similarities and differences in terms of language, ethnolinguistics, and folklore, which makes this whole region richer and more attractive. The inhabitants of those parts are aware of these distinctive features and try to preserve the identity formed in the historical course of the creation of their villages.

***Keywords:** linguistic variation, ethnolinguistics, ethnography, Tosk dialect, Lab dialect*

Vjosa është lumi më i gjatë në Shqipërinë e Jugut, i cili ndër të tjera, përshkon tejpërtej rrethin e Tepelenës në drejtimin veriperëndimor. Në këtë mënyrë krijon një luginë me pejzazh të mrekullueshëm, që së fundi ka marrë vëmendje të madhe. Në të dy anët e lumit përveç qytetit të Tepelenës dhe Memaliaj ndodhen shumë fshatra, me pozitë të ndryshme gjeografike, me bukuri natyrore, histori, tradita e zakone të lashta e të veçanta, të cilat duhet të marrin rëndësinë që u takon.

Disa nga fshatrat më pranë Vjosës janë, në të djathtë: Damës, Kallëmb, Mirinë, Kashisht,

Vasjar, Amanikaj, Iliras, Qesarat, Anëvjosë, Leshnjë, Krahës, Kalivaç, dërsa në të majtë të lumit ndodhen: Memaliaj fshat, Sheshi, Labmartallozi, Dhëmblan, Sinanaj, Matohasanaj, Dorëz, Shkozë etj. Një pjesë e këtyre fshatrave mbajnë emra të vjetër, ndërsa të tjerë kanë emra të vendosur aty nga viti 1985, për shkak të ndarjeve administrative që u bënë në atë kohë.

Lumi Vjosë, duke qenë i rrëmbyeshëm e me prurje të mëdha në pjesën më të madhe të vitit, në shekuj ka penguar komunikimin mes banorëve në të dy anët e tij. Prandaj në studimet dialektologjike, është parë si kufi ndarës i dialektit tosk në *toskërishten veriore* (zonat në krahun e djathtë të Vjosës) dhe *toskërishten jugore* (në krahun e majtë të këtij lumi) që *shtrihet në Labëri në anët e Tepelenës, Gjirokastrës e deri në Çamëri*.[1] Në këto studime është konsoliduar mendimi se tiparet qenësore që dallojnë sot dy nëndialektet e toskërishtes janë formuar më herët se ato që dallojnë nëndialektet e gegërishtes, [2]çka dëshmon edhe autoktoninë e këtyre trevave.

Synimi i këtij punimi nuk është të bëjmë një analizë të thelluar të dallimeve fonetike, morfologjike e leksikore të nëndialekteve të toskërishtes, pasi këto kanë qenë objekt studimi që nga K. Kristoforidhi, I. Dilo Sheperi etj. dhe janë sintetizuar në studime të mirëfillta dialektologjike, duke u pasqyruar edhe në Atlasin Dialektologjik të Gjuhës Shqipe (ADGJSH).

Në përputhje me objektin e kësaj konference ne kërkojmë të prekim disa aspekte të kulturës popullore të rrethit të Tepelenës në vendbanimet e ndodhura përgjatë luginës së lumit Vjosë, kundruar në vështrimin gjuhësor.

Pozita gjeografike e fshatrave në të dy anët e lumit nuk është e njëjtë, çka ka ndikuar në mënyrën e jetesës, në doke e tradita kulturore, në këngë e valle, në kostumet popullore e variante gjuhësore. Fshatrat në të djathtë të Vjosës kanë reliev kodrinor e fushor dhe kontakte fqinjësie më të shumta, ndërsa në të majtë të lumit relievi është malor. Shumica e këtyre fshatrave janë vendosur në faqe të malit të Gribës. Banorët e të dy anëve e quajnë veten "lebër e toskë". Mes tyre ka marrëdhënie të mira, por nuk mungonë edhe ndjenjat e superioritetit ndaj "të përtejmëve". Labët i quajnë banorët e prëtej lumit "toskë kërcikuq", për shkak të një lloj veshjeje me poture të zeza e kalcina (lloj lëkure që mbështillte kërcirin) me ngjyrë kafe në të kuqe, ndonëse disa thonë edhe për shkak të baltës që lyente këmbët (kërcinjtë e tyre). Ndërsa toskët i quanin të përtejmit "*gjysmopingë"*, pasi opingat (lloj këpuce) u griseshin për shkak të relievit të ashpër.

Pra, gjeografikisht Vjosa ndan Labërinë nga Toskëria e njëkohësisht toskërishten në dy nënsisteme gjuhësore, por kjo nuk është një ndarje absolute. Nëndialektet *dallohen mirë ndërmjet tyre prej një sërë veçorish, por nuk duhet kuptuar sikur kufjtë e të gjitha tipareve karakteristike të një nëndialekti përputhen plotësisht me njëri-tjetrin, ndonjë prej tyre bën edhe përjashtim në zonat kufitare, sepse, siç dihet, nuk ka kufijdialektorë të prerë*.[3] Ky është edhe rasti i fshatrave përgjatë luginës së Vjosës, ku ndërthuren e bashkëjetojnë tiparet e toskërishtes e labërishtes edhe pse mes tyre rrjedh një lumë me prurje të konsiderueshme. Në këtë pjesë të luginës, Vjosa krijojn një shtrat më të gjerë, e vende – vende në stinë e verës formohen va (vend ku lumi është i cekët), ku banorët e të dy anëve kanë pasur mundësi të kapërcejnë në anën tjetër.

Sipas dialektologëve të ndryshëm, nëndialekti i toskërishtes jugore (labërishtja)[4] ka qenë më pak inovues[5], ndërsa toskërishtja veriore ka ruajtur më pak tipare karaterizuese si nga struktura gramatikore, ashtu dhe nga variantet fonetike. Kjo edhe sepse në*krahinat e toskërisë veriore ka pasur kontakte të ngushta e të vazhdueshme midis banorëve për shkak të shpërnguljeve të bujqve nga një vend në tjetrin, sidomos nga zonat malore, duke u përzier kështu me banorë të*

[1]Sipas Jorgji Gjinarit, *Dialektet e Gjuhës Shqipe*. Tiranë, 1989, f.50.

[2] Jorgji Gjinarit, *Dialektet e Gjuhës Shqipe*. Tiranë, 1989, f.52.

[3]Jorgji Gjinari; Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*. Tiranë, 2000, f. 182.

[4] Shënim ynë.

[5] Jorgji Gjinari, *Dialektet e Gjuhës Shqipe.* Tiranë, 1989, f.52.

zonave fushore.[6] Nga ana tjetër, kjo krahinë për shkak të tregtisë e shkëmbimit të mallrave ka pasur kontakte si me pjesën e Labërisë, duke kapërcyer lumin e duke ndjekur rrugën që të çonte në Vlorë, ashtu dhe me zonën e Beratit. Këto lëvizje kanë bërë që gjuha të zhvillohet me ritme më të shpejta, sidomos pas çlirimit për shkak të kushteve të reja të jetës dhe përhapjes së arsimit të detyruar.

Megjithatë edhe në fshatrat e krahinës së Lopësit, që gjegrafikisht është Labëri, tiparet gjuhësore të labërishtes janë tkurrur.

Nga **rrafshi fonetik**: nuk ruhen zanoret e gjata, të cilat dalin më dendur në labërishte.

Zanorja -e- e theksuar, që ndiqet nga një bashkëtingëllore hundore, që në labërisht ka kaluar në (ë) në të gjitha rastet, si:*pë-ri, frë-ri, fë-mër, zëmër*etj., në këto të folme ashtu si në toskërishten veriore ky fenomen nuk i ka përfshirë të gjitha fjalët (*peri, freri, femër*, ndonëse thonë *vënd, qëni, e ënjte, prëmte* etj).

Ndryshe nga labërishtja që në sistemin vokalik nuk e ka zanoren -y- *di* (dy); *ill* (yll) *birek* a *burek* (byrek) etj., në këto të folme kjo zananore është e pranishme. Në fshatrat e luginës së Vjosës thonë : *yll, sy, dy* etj.

Përsa i përket asimilimit të grupeve të bashkëtingëlloreve **mb, nd, ng** në **m,n,ŋ**, *mërthej* (mbërthej), *ner* (nder);*ŋrə* (ngre); *humas* (humbas); *men*(mend) etj., përgjatë gjithë luginës duket një dukuri e vjetëruar (të moshuarit e sotëm kujtojnë prindërit e tyre që përdornin këto forma), ndërsa vetë i përdorin vetëm në disa forma, si: *eci në këm*(këmbë), *i fyri një gjëm*(gjemb) etj.

Gjithashtu, është një dukuri e vjetëruarngjitja e një mbarese të dytë -ur- pjesoreve me -ë-, si: *dalur, lënur, thënur* etj.

Të labët e krahinës së Lopësit, ashtu si në toskërishten veriore vihet re shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës, si*: e lak* - e lag; *shtek*- shteg; *shelek*- sheleg etj.

Edhe në **rrafshin gramatikor**duket se tiparet e vjetra të labërishtes i kanë lënë vendin formave të toskërishtes veriore. Kështu format e vjetra të së pakryerës së foljeve dëftore, si: jeshë; jeshe; ish, keshë, kish etj. janë zëvendësuar me ato të toskërishtes veriore: *isha, ishe, ishte, kish, kishte*.[7]

Patjetër që gjuha letrare dhe ndryshimet në mënyrën e të jetuarit kanë ndikuar në tkurrjen e shumë tipareve dialektore e nëndialektore, sidomos në rrafshin leksikor. Megjthatë nga ligjërimi i banorëve të këtyre krahinave *kanë hyrë në fondin e leksikut të mbarë shqipes me mijëra fjalë që lidhen me kafshët dhe sendet, me ndërtimtarinë, me përpunimin e bulmetit e të leshit, me veshjet e bimësinë e pasur si edhe mijëra njësi frazeologjike, të cilat jo vetëm emërtojnë, por e zbulurojnë ligjërimin, e zhdërvjelltësojnë dhe e ngjyrosin atë*.[8] Duke ndjekur parimin e lidhjes « fjalë dhe sende »[9] jemi munduar të sjellim leksikun që shënon disa elemente të kulturës materiale popullore të këtyre anëve.

Emërime që lidhen me **banesën**: nga fshati në fshat ndryshon mënyrae ndërtimit të shtëpive, sepse varej si nga pozita gjegrafike e lashtësia e fshatit, ashtu dhe nga statusi ekonomik. Duke qenë familje pariarkale, pjesa më e madhe e shtëpive kishte një *hodë* (odë), të vendosur mbi *qemer*, i cili ishte në formë harku e shtrohej me *rosan*, pjesa tjetër e hodës ishte me *dysheme* druri. Përreth odës vendoseshin *sergjendët*(dollap ku vendoseshin enë), *musandra*, dollapë muri të zbukuruar me gdhendje të ndryshme. Në të vendoseshin *shtrojet* më të mira. Në fshatrat labe, pothuajse të gjitha gratë punonin në tezgjah e përgatitnin *qilima, sizhade* e objekte të tjera

---

[6] Jorgji Gjinari; Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*. Tiranë, 2000, f. 194.

[7] Shih. Jorgji Gjinari; Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*. Tiranë, 2000, f. 184.

[8] Valter Memisha, "*Vështrim gjuhësor për të folmet e trevës"* (Tepelenës), Enciklopedia e Tepelenës. Tiranë, 2005, f.30

[9] Eqrem Çabej, "*Disa aspekte të kulturës popullore shqiptare në vështrimin gjuhësor"*, SF, 1977/2 f.17.

zbukurimi për shtëpinë. Në pjesën toske përdoreshin *minder* dhe si shtroja *shilte* e *poste leshi*.

Në fushën **e ushqimit** veçojmë emërtimet e ushqimeve: *bathë, koçkulla, thjerrëza* (bishtajoret) që përbënin bazën e ushqimit në fshatrat labe e toske. Disa ushqime tipike që, pavarsisht përbërësve të ndryshëm, përdoreshin me të njëjtin emër: *bukaniqe, bukëvale* (përgatitej kur fëmija mbushte 40 ditë), *përshesh, lakror, pastërma, papare*, por dhe *trahana, arapash, yshmer* që mund të jenë ndikim nga tradita osmane.

Pjesë e kësaj kulture janë edhe **emrat e enëve**: *kaçup*(lab) (shakull); *dybek*e *filiçi* (lab.) - *fërriç* (tosk); *varrielë* (bucela), *jamake* (tosk. objekt ku ziheshin fasulet); *burraç* (lab. lloj tasi), *ponicë* (tepsi balte), *këmbje* etj.

Fjalë që shënonin prodhimet dhe **përpunimin e leshit,** që ishte traditë sidomos në Labëri. Me lesh dhie bëni *guna* e *llabane* si dhe *shtroje* e *rova*. Nga leshi i deleve përgatitnin: *llabane, guna, sherqe* (shark). Rroba të leshta të burrave: *fanella, tirqe, kokore,qylafe, poture, xhamadanë, jelekë* etj. Rroba të përgatitura për veshjet e grave ishin: *çorape, mitane, jelekë, sharkishtet* etj.[10] .

Emra që shënojnë pjesë të**veshjes popullore tradicionale**: Si në të gjithë Labërinë edhe në fshatrat pranë Vjosës, burrat kanë pasur *gunën* dhe *këmishën e gjatë.* Veshja me fustanellëpërbëhej nga *tirqet, silahu*(vendosej mbi brezin prej leshi), *fanella* e leshtë me ngjyrë të bardhë, *këmisha, xhamadani, peshllia*(i kishte mëngët e gjata, që kapeshin nga prapa), *mëngorja, qeleshja* (qylafi) e këpucët prej lëkure. Pjesë të tjera të veshjeve ishin *kalcinat* (lloj lëkure e regjur në qumësht) që mbështillte kërcirin nën gju, vendoseshin mbi poture, përdoreshin në pjesën e toskërisë Më vonë si veshje me përdorim të gjerë përgjatë gjithë luginës, qe kostumi i shajakut me ngjyrë të zezë.

Veshjet e grave përbëheshin nga *tumanet* (çitianet, tiçianet), të cilat i përdornin edhe përditshmëri. Këmishat e gjata, *jeleku* ose *fermelia* pa mëngë, *brezi prej leshi, gozhupi* (Lopëz) *sakua* (fshatrat e Toskërisë, Krahës..), shamitë e qëndisura etj.

Meqë kushtet e jetesës kanë ndryshuar e punët që lidhen me bujqësinë e blegtorinë kryehen nga një numër i vogël njerëzish edhe fjalët që i shënojnë përdoren rrallë. Përsa i përket veshjeve popullore, si kudo përdoren vetëm në raste të caktuar.

Nga shqyrimet tona qoftë në biseda me të moshuar, qoftë nga Atlasit Dialektologjik i Gjuhës Shqipe, në fshatrat e Tepelenës, në ditët e sotme flitet shqipja standarde, e cila gërshetohet me elemente të të folmeve e regjistrat e ligjërimit të përditshëm. Çdo hap drejt "emancipimit" gjuhësor ka afruar të folmen me gjuhën letrare, *por ka rrëgjuar* leksikun dialektor e krahinor[11] si dhe tiparet fonetike e gramatikore.

Dallimet etnografike shkojnë paralelisht me dy nënsistemet dialektore të toskërishtes. Bota materiale e banorit tepelenas është e pasur, kurse ajo shpirtërore është jo vetëm e tillë, por edhe magjepse.[12]Element i shquar etnografik është polifonia, e cila është një praktikë tradicionale shumëshekullore. Nënsistemi polifonik i Labërisë, shtrihet në të majtë të lumit Vjosë. Nënsistemi polifonik i Toskërisë shtrihet në trevën midis dy lumenjve, Shkumbin e Vjosë.[13] Sipas studiuesve të fushës këto nënsisteme polifonike kanë afritë e *dallimet e tyre që duken te mënyra e shtjellimit të këngës në grup, te formacioni i grupit, te funksioni i zërave dhe emërtimi i tyre, te timbrika, ritmika e bashkëtingëllimi harmonik i zërave*.[14] Polifonia toske është e ndryshme nga polfonia labe, që është zakonisht katërzërshe. Në fshatrat e Tepelenës ka shumë për të zbuluar në lëmin e polifonisë, si për llojin dhe strukturën, për larminë e këngëve lirike e

---

[10] Ramo Xheka, *Dhëmblani*, UETPRESS. Tiranë, 2022, f.172.

[11] Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*. Tiranë, 2001, f. 29.

[12] Valter Memisha, *Vështrim gjuhësor për të folmet e trevës*". Enciklopedia e Tepelenës. Tiranë, 2005, f.730.

[13] Beniamin Kruta, "*Vështrim i përgjithshëm i polifonisë shqiptare*". Kultura Popullore. Tiranë, 1980/1, f.45.

[14] Po aty. f. 49.

epike, ashtu edhe për ligjërimin, leksikun e pasur me fjalëformime e nuanca të shumta kuptimore, figuracionin dhe mjetet shprehëse.

Si përfundim, mund të themi se lumi Vjosë në shekuj ka ndikuar në marrëdhëniet e banorëve të vendosur në të dy anët e tij. Konvencionalisht ka ndarë toskërishten në dy nënsisteme, që e kanë pasuruar kulturën materiale e shpirtërore të rrethit të Tepelenes. Rëndësia që ka marrë Vjosa duhet të bashkëshoqërohet më vëmendjen ndaj zbulimit të vlerave kulturore e gjuhësore, si: interpretimi i toponimisë (vendemërtimeve), për të hedhur dritë në këtë rrafsh me vlerë historike e kulturore; pastrimi nga pluhuri i harresës i trashëgimisë etnografike që lidhet me traditat e ritet e ndryshme, ashtu dhe pasuria etnolingustike me urimet, mallkimet, betimet, të cilat pasqyrojnë shpiritin e banorëve të këtyre anëve.

Sot rrethi i Tepelenës vuan largimin e të rinjve. Fshatrat në të majtë të lumit Vjosë për shkak të kushteve të vështira të jetësës,mungesës së rrugëve, largësisë me qytetet e faktorë të tjerë e kanë ndier të parët fenomenin e braktisjes.

Bibliografia

Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe (ADGJSH) I, II. AKADEMIA E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË, 2008.

Enciklopedia e Tepelenës. Tiranë, 2005.

Jorgji Gjinari; Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*. Tiranë, 2000.

Gjovalin Shkurtaj, *Etnografia e të folurit të shqipes*. Tiranë, 2004.

Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*. Tiranë, 2001.

Valter Memisha, "*Vështrim gjuhësor për të folmet e trevës*", Enciklopedia e Tepelenës. Tiranë,2005.

Beniamin Kruta, "*Vështrim i përgjithshëm i polifonisë shqiptare*", Kultura Popullore. Tiranë, 1980/1.

VËSHTRIM KULTUROR E GJUHËSOR NË ZONËN E GRYKËDERDHJES SË VJOSËS

Dr. Entela Kore
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri, ekore@uogj.edu.al

Abstrakt

Lugina e lumit Vjosë për natyrën e rrallë dhe vlerat historike e kulturore që e karakterizojnë, sot gëzon një status të veçantë. Në kuadër të këtyre diskutimeve me tematika të larmishme, kemi menduar të përmendim pikën më fundore të kësaj lugine. Zona në afërsi të grykëderdhjes së Vjosës është një vendbanim i rëndësishëm ku theksohen të tjera vlera të kulturës materiale. Pasqyrimi i kulturës dhe i disa dukurive gjuhësore për këta banorë do të ishte me interes për studime të tilla me karakter gjithëpërfshirës.

Bashkëjetesa dhe harmonia fetare mes këtij komuniteti heterogjen është për t'u veçuar mes shumë aspekteve të tjera të rëndësishme. Kjo reflektohet mjaft mirë edhe në respektimin e ndërsjelltë të traditave e zakoneve që banorët kanë kultivuar prej kohësh për njëri-tjetrin. Fshatrat që ndodhen më afër grykëderdhjes së Vjosës janë: Qarr, Martinë, Bishan dhe Pishë-Poro. Tiparet gjuhësore të këtyre banorëve janë të afërta me të folmet e tjera të Myzeqesë, ku spikatin elemente të toskërishtes veriore, por me dallime të pakëta si rrjedhojë e heterogjenitetit dhe kontakteve me zonat përreth. Për shkak të emigracionit të vazhdueshëm, numri i banorëve ka rënë në mënyrë të theksuar vit pas viti. Ky fenomen, ndoshta edhe më i spikaturi për këto zona fushore e të begatshme, ka sjellë jo vetëm largimin e brezit të ri, por edhe zbehjen e dukurive dialektore për brezin e mesëm e të ri. Pavarësisht faktorëve të mësipërm dhe ndryshimeve gjuhësore ndër vite, banorët vendas ruajnë ende tipare tipike të zonës së Myzeqesë.

***Fjalët kyçe**: Lugina e Vjosës, grykëderdhje, bashkëjetesë, të folmet e Myzeqesë.*

Abstract

The valley of the Vjosë River, for its rare nature and the historical and cultural values that characterize it, today enjoys a special status. In the framework of these discussions with diverse topics, we thought to mention the last point of this valley. The area near the Vjosa estuary is an important settlement where other values of material culture are highlighted. The reflection of the culture and some linguistic phenomena of these inhabitants would be of interest to such comprehensive studies.

The religious coexistence and harmony among this heterogeneous community are to be singled out among many other important aspects. This is also well reflected in the mutual respect of traditions and customs that the residents have long cultivated for each other. The villages located closest to the Vjosa estuary are: Qarr, Martinë, Bishan, and Pishë-Poro. The linguistic features of these inhabitants are close to the other languages of Myzeqe, where elements of the northern Toskëri stand out, but with few differences as a result of heterogeneity and contacts with the surrounding areas. Due to continuous immigration, the number of inhabitants has decreased significantly year after year. This phenomenon, perhaps the most painful for these plain and prosperous areas, has brought not only the departure of the young generation but also the fading of dialect phenomena for the middle and young generation. Despite the above factors and language changes over the years, residents still maintain typical features of the Myzeqe area.

***Keywords:** Vjosa valley, estuary, coexistence, Myzeqe's speech.*

Lugina e lumit Vjosë për natyrën e rrallë dhe vlerat historike e kulturore që e karakterizojnë, sot gëzon një status të veçantë. Në kuadër të diskutimeve me tematika të larmishme, vlen të diskutojmë edhe për pjesën fundore të kësaj lugine, si një vendbanim i rëndësishëm ku theksohen e marrin jetë të tjera vlera të kulturës materiale. Fshatrat që kemi marrë në shqyrtim, të cilat ndodhen në krahun e djathtë të lumit janë: Qarr, Martinë, Bishan dhe Pishë-Poro të rrethit Fier. Ajo që duam të theksojmë më së shumti në këtë punim, mes shumë çështjeve me karakter ndërsiplinor, është kultura materiale e gjuhësore e këtij komuniteti të vendosur buzë lumit Vjosë.

Lumi i Vjosës e përshkon Shqipërinë nga juglindja në veriperëndim, duke nisur nga Greqia dhe duke u futur në tokën shqiptare në jug të fshatit Çarshovë të Përmetit. Në pjesën më të madhe kalon në një territor të ashpër e malor, ndërsa në rrjedhën e poshtme të tij përshkon një pjesë fushore (afërsisht 75 km) dhe shërben si kufi ndarës midis Fierit dhe Vlorës.

Kufijtë gjeografikë dhe etnografikë që kanë shoqëruar lumin Vjosë në rrjedhë të kohës, kanë ndryshuar si rezultat i kushteve klimaterike, duke sjellë zgjerime dhe ngushtime të zonës.

"Në të kaluarën ky lumë derdhej në det nja 15 km më në veri sesa sot duke kaluar në një zonë kënetash dhe lagunash ku lumi rridhte duke bërë dredha. Nëpërmjet grykëderdhjes së këtij lumi, në lashtësi, anijet hynin deri në afërsi të qytetit të Apolonisë, i cili në atë kohë ishte në pozitën e një porti lumor shumë të rëndësishëm."[1] Edhe prof. Jani Thomai kur flet për historinë dhe rëndësinë e këtij lumi në Myzeqe, përmend devijimin e lumit në afërsi të grykëderdhjes duke pohuar se "Lumi ka lëvizur nga e djathta në të mëngjër, ashtu siç ka ndodhur me këtë lumë aty nga viti 1924, kur ky hodhi nga krahu i mëngjër në të djathtë kantundin Martinë dhe ndau në dy pjesë Pishë-Poron. Martina që më parë lidhej administrativisht me Vlorën, më 1924 u lidh me Fierin.[2]

Relievi fushor me toka të begatshme, prania e lumit Vjosë dhe afërsia me detin Adriatik gjithmonë e ka bërë të populluar këtë rajon me banorë nga zona të ndryshme të vendit. Lëvizje të tilla me banorë nga krahina të tjera janë ndier në pjesën më të madhe të Myzeqesë, si rezultat i strehimit dhe kërkimit të tokave pjellore. Populli heterogjene vihet re jo vetëm në qytet, por edhe në fshatra, sikurse ka ndodhur edhe me këto fshatra që kemi bërë objekt studimi.

Në fshatrat Qarr, Bishan, Pishë-Poro dhe Martinë, krahas banorëve vendas, kemi edhe grupe të ardhurish nga Labëria, juglindja e Shqipërisë dhe Çamëria.[3] Bashkëjetesa mes këtyre komuniteteve nuk ka qenë e lehtë, kjo duket në marrëdhëniet e vështira të krijuara edhe nga pushteti i asaj kohe, sidomos për të ardhurit nga Çamëria. Megjithatë, duhet theksuar që, me kalimin e viteve, çdo perceptim apo paragjykim i krijuar u sheshua dhe mes tyre u vendosën raporte miqësore. Pavarësisht dallimeve krahinore, origjinës së tyre, kulturës, bindjeve fetare, nuk vihen re mosmarrëveshje apo konflikte mes këtij komuniteti. Ky është një tipar që duhet veçuar për këtë zone, sepse prej kohësh kanë ditur të kultivojnë ndjenjën e respektit reciporok për njëri-tjetrin.

Kjo duket edhe në festat fetare që organizohen në ditë të shënuara prej komunitit mysliman dhe atij të krishterë. Myslymanët e kësaj zone kanë si traditë të festojnë Bajramin e Madh dhe të Vogël, ndërsa të krishterët festojnë Pashkët. Në këto ditë të shënuara bëhen vizita të ndërsjellta duke uruar e festuar së bashku.

Interesante për banorët e Myzeqesë është epiteti 'lal', që u atribohet të gjithë të krishterëve të

---

[1] P. N. Komini, Myzeqeja Perëndimore, *Historia zhvillimi, objektet historike dhe bukuritë e natyrës.* Fier, 2016, f. 13.

[2] J. Gjinari, "Të folmet e Myzeqesë", në Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, SSHSh. Tiranë, 1958, 4, f.74.

[3] Banorët nga Çamëria kanë ardhur në dy periudha: vala e parë më 1927 dhe vala e dytë në qershorin e 1944-ës. Banorët u vendosën në fsahtrat: Bishan, Pishë dhe Martinë. Banorët e Martinës, fillimisht, u pozicionuan buzë lumit Vjosë deri në vitin 1970. Me daljen e herëpashershme të Vjosës nga shtrati, banorët u detyruan të lëviznin më në brendësi të fshatit, në mënyrë që të ishin më të mbrojtur nga ky fenomen.

kësaj krahine, përfshirë edhe banorët që kemi marrë në shqyrtim. Lidhur me këtë emërtim ka mendime dhe hipoteza të ndryshme. Sipas etnografit Rrok Zojsi, emrin 'lalë' banorët e Myzeqesë e morën nga njëri prej banorëve të familjes Muzaka, i cili është quajtur Lal Muzaka. Ky mendim mbetet hipotetik, pasi në dokumentacionin historik nuk përmendet asnjë anëtar me këtë emër. Një hipotezë tjetër sjell një lidhje midis emrit 'lalë' dhe emrave të përgjithshëm të tipit: babai, gjyshi ose vëllai i madh, por edhe ky mbetet pa baza shpjegimi. Me interes paraqitet këndvështrimi i hulumtuesit Kozma Andoni, i cili pohon se "Në shek. XIX me emrin lalë njiheshin vetëm banorët e zonës përreth lumit Seman dhe në rrjedhën e tij të poshtme. Një emër të tillë këta njerëz e kishin marrë sepse jetonin të vetmuar, larg vendbanimeve të tjera, duke qenë të veçuar prej shoqërisë. Për një pjesë të konsiderueshme emri 'lalë' do të thotë 'njerëz të butë' krahasuar me myslymanët. Por, pavarësisht përpjekjeve shpjeguese që janë dhënë, zanafilla e këtij emri mbetet e paqartë për studiuesit dhe nuk gjen mbështetje shkencore.[4]

Një moment thelbësor për t'u vënë në dukje në jetën e këtij komuniteti mbetet tradita që këta banorë kanë ruajtur e trashëguar për martesat. Nga kontaktet e vazhdueshme, integrimi në jetën e përditshme, pranimi dhe përqafimi i një kulture tjetër, ndonjëherë thyen edhe kufijtë kur vjen puna për martesat. Më herët, lidhjet e krushqive në këtë zonë bëheshin me Fierin, Vlorën dhe Mallakastrën, por gjithmonë duke ruajtur atë 'mitin' e origjinës. Një 'lalë' do martohet me një 'lalë', por ka edhe raste përzierjeje, myslyman - 'lalë'. Ndërsa komuniteti çam qëndron më strikt, duke ruajtur me fanatizëm martesat me banorë nga komuniteti i vet.

Ceremonia e dasmës, që ka një skemë të përbashkët për të gjithë shqiptarët dhe përbëhet në disa faza, duke filluar që nga nisja e dasmës e deri te përfundimi i saj ditën e diel në shtëpinë e dhëndrit. Ceremonia e dasmës ka një ecuri të përcaktuar mirë për të gjithë banorët e kësaj zone, pavarësisht krahinave nga vijnë. Shumë rite që shoqërojnë këtë ceremoni të rëndësishme janë të pranishme dhe bartin ende sot elemente pagane apo para pagane.[5] Si të tilla përmendim: vënien e kënasë, të rruarit e dhëndrit, stolisja e nuses, kapërcimi i pragut, spërkatja me raki ku kalon nusja, thyerja e një shisheje qelqi para makinës etj.

Pavarësisht origjinës së komunitetit, dasmat me të gjitha elementet e traditës shqiptare ndihen dhe janë të shtrira në të gjithë këtë zonë. Nëse do të përmendim dasmën myzeqare si për myslymanët, ashtu edhe për të krishterët, do të na duheshin faqe të tëra, kështu që ajo mbetet edhe për këtë zonë një moment jetësor i trashëguar nga të parët me të gjitha karakteristikat e saj.

Respekti për mikun e shtëpisë është një traditë e hershme për banorët e kësaj zone. Sipas zakonit, miqtë nderoheshin me gatimet dhe pijet më të mira. Këtu përmendim: mishin e bagëtive, të shpendëve e deri te perimet, frutat dhe pije të zonës. Si gatime tradicionale për këtë zonë kemi: yshmerin me fasule, çorba me bollgur, harapash me miell misri, rosnicat, revaninë, reshedinë, kabuninë, përsheshin etj. Nga pijet përmendim: pekmezin e manit, verën dhe rakinë.

Dikur një zonë e populluar e me një popullsi aktive në të gjitha sipërmarrjet e jetës, ashtu si pjesa tjetër e vendit tonë, karakterizonte të gjithë fshatrat e kësaj zone[6]. Dua të përmend shkurtimisht këtu jetën kulturore të këtyre fshatrave, ku gjithçka funksiononte në mënyrë të organizuar dhe në çdo sektor. Krahas shkollave 8-vjeçare, kishte shkolla të mesme, shtëpi kulture, muze, qendër shëndetësore, shtëpi të lindjes, pika të shërbimit tregtar e komunal.

Zona e Myzeqesë është konsideruar si 'hambar i Shqipërisë', për sa i përket prodhimeve bujqësore e blektorale, mbjelljes së frutave e perimeve të ndryshme. Edhe banorët e kësaj zone në ditët e sotme, megjithëse të paktë në numër, e kanë lidhur jetën e tyre me bujqësi e blektori, por edhe me rritjen e shpendëve dhe gjelave të detit si një mënyrë mjaft fitimprurëse kohët e fundit.

Duke qenë se jemi te ekonomia, nuk mund të anashkalojmë ndikimin e madh që ka Vjosa për

---

[4] Shih: I. Gjika, Fieri në shekuj. Fier, 2004. f. 83-84.

[5] Gj. Zheji, Folklor shqiptar. SHBLU. Tiranë, 2004, f. 71.

[6] Popullsia e kësaj zone para viteve 1990 shkonte afërsit në pesë mijë banorë.

këtë zonë. Jeta e banorëve ka qenë dhe është e lidhur ngushtë me lumin Vjosë. Shfrytëzimi i ujit të Vjosës i ka dhënë zonës një zhvillim të madh ekonomik, jo vetëm në bujqësi e blektori, por edhe në jetën e përditshme.

Peshkimi është një tjetër mundësi e mirë që u është dhënë banorëve ta shfrytëzojnë në këtë zonë. Duke qenë afër lumit dhe detit, banorët e zonës, por edhe jashtë saj, kanë shfrytëzuar ujërat e kësaj zone e duke ngritur infrastrukturën e duhur për peshkim.

Sot, më shumë se 80% e të rinjve janë larguar në kërkim të një jete më të mirë drejt vendeve të ndryshme të Evropës. Pjesa më e madhe e të rinjve në këtë zone ka zgjedhur Italinë, pak Greqinë dhe pjesa tjetër Anglinë, Amerikën dhe vende të tjera të BE-së. Reduktimi i banorëve si rezultat iemigracionit ka sjellë edhe uljen e nxënësve që ndjekin shkollën 9- vjeçare e të mesme që dikur ishin pjesa më aktive e këtij komuniteti.

Fenomeni i largimit ka sjellë jo vetëm uljen e numrit të banorëve, por edhe shkëputjen nga tradita. Emigrantët e kësaj zone kanë rindërtuar banesat e tyre me mundësitë e krijuara në emigrim, duke i dhënë fshatit një pamje krejtësisht të re.

Krahas kulturës, traditave dhe zakoneve të këtij komuniteti, si pjesë identifikuese mbetet edhe gjuha e tyre. Gjuha dhe sjellja gjuhësore janë faktorë të fortë të shprehjes së identifikimit dhe kohezionit të një grupi shoqëror, qoftë Brenda, qoftë jashtë.[7] Në përgjithësi, heterogjeniteti apo diversiteti gjuhësor bashkekzistojnë me diversitetin shoqëror. Banorët e kësaj zone, pavarësisht përbërjes heterogjene, nuk paraqesin dallime në të folur, kjo si rezultat i bashkëjetesës për një kohë të gjatë me njëri-tjetrin.

Tiparet gjuhësore të këtij komuniteti janë të njëjta me ato toskërishtes veriore, por nuk mungojnë edhe veçoritë gjuhësore që vijnë si rezultati i pozicionit skajor dhe kontakteve me zonën e Vlorës. Ky është një tipar që e bën të veçantë ligjërimin e këtyre banorëve, nëse e krahasojmë me pjesën tjetër që ndodhet më në veri të Myzeqesë.

Në sistemin e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve do të veçojmë disa raste që na duken me interes për këtë zonë. Nga kontaktet me banorë të zonës, por edhe studimet që kanë pasur objekt studimi këtë zonë,[8] na rezulton të mos kemi asnjë rast të shqiptimit të fjalëve me zanore hundore.

Zanorja e theksuar *e* para bashkëtingëlloreve hundore del **ë** në të gjitha rastet, sidomos në Martinë, që merret si ekstremi jugor me elemente të labërishtes. Këtu kemi fjalët:*zëmra, vëndi, mëndja, qën, dhëntë, brënda* etj.

Grupi **ua** dhe **ye** që ndodhet në mes të fjalës në rrokje të mbyllur apo të hapur dhe në fund të fjalës në rrokje të mbyllur ndihen si diftong. Si shembull më këtë përmendim: *buall, duar, qumështuar, martuar, truall, i martuar, duan, muaj*; *dyer, shqyer, ngjyer, pyes, kapërcyelli* etj. Në pjesën veriore të Myzeqesë, afër lumit Shkumbin, këto fjalë dëgjohen të monoftonguara: *dur, mësur, martur, muj,* si rrjedhojë e ndikimit të gegërishtes.

Diftong kemi edhe në rastin kur zanorja **i** e patheksuar ndodhet pranë një zanoreje tjetër në pozicion fundor duke përfituar fonemën **j**: *babaj, agaj, shkarkoj, qerrataj, thoj* etj.

Mjaft e përhapur është dhe rënia **ë**-së në fund të fjalës, qoftë te pjesorja e foljeve, qoftë te pjesë të tjera të ligjëratës: *bër, lën, vën, thën*; *pun, buk, frik, i thell* etj. Krahas këtyre shembujve, rënie të zanores **ë** kemi edhe te fjalët: *vlla, ktu, ktej, prrenj; kput, pllëma, prralla, gshëra* etj.

Përsa u përket grupeve të bashkëtingëlloreve **mb**, **nd**, **ng** e **ngj** , në përgjithësi, ruhen kur janë në fillim dhe në trup të fjalës, ndërsa kur ndodhen në fund ka luhatje, sidomos togu **mb**: *mbush , ngjesh, ngarkoj, hëngra, ngec, ngjan, këma, ndaj, kandil, dhem, pëllëm*.

Ashtu si në të gjithë krahinën e Myzeqesë, edhe në këtë zonë, e kemi të pranishëm shurdhimin e

---

[7] Gj. Shkurtaj, Sociolinguistika.Tiranë, 1999, f. 80.

[8] Përmendim punimin e prof.J. Thomait, Të fomet e Myzeqesë.Vep. e cituar më sipër, f.73-114.

bashkëtingëlloreve. Rastet me këtë fenomen dalin në fjalët: *vënt, funt, lith, mës, burk, brek etj*.

Në këtë zonë vihet re edhe asimilimi, ai është më i përhapur në fjalët që kanë grupet *tn, thn, lln, rn*; *sonde* (sonte), *çimendo* (çimento); *van* (vajtn), *mbem,* (mbetmë), *mbluadh,* (mbluadhnë), *mbuall* (mbuallnë), *muar* (muarën) etj.

Rëniet e tungujve janë gjithashtu të pranishme për një numër të konsiderueshëm fjalësh. Prej tyre përmendim: *tupruar* e *tuproj* që del dhe në shprehje tipike të zonës: "o, ja, nuk e sheh, do tuprohem me ty". Rënie të tingujve kemi edhe te fjalët *i shkutër* dhe *i vafri*. P. sh.: lëre të vafrin se është lodhur gjithë ditën; e vafra unë!, kur shpreh pikëllim. Karakteristike për këtë zonë mbeten fjalët *qeshor, pshesh, tashi, ashu, kshu* dhe *pasaja,* të cilat dëgjohen nga të gjitha grupmoshat e kësaj zone.

Gjinia asnjanëse në këtë zonë ka një përdorim të kufizuar. Atë e gjejmë vetëm në dy-tri shprehje tipike të zonës: *m'u drodh misht, u derdh ujt, u hap si vajt.*

Karakteristikë e kësaj zone është përdorimi i emrave të prejardhur foljor, që formohen me prapashesën *–je*: *korrje, vaditje, prashitje, shirje, mjelje, vjel-je* etj. Nga bisedat e përditshme me banorë të zonës, dëgjon shpesh herë fjalë dhe emërtime të këtyre dukurive, si pjesë e pandarë e jetës së tyre.

Sa i takon formimit të shumësit të emrit, në këtë zonë nuk kemi ndryshime me pjesën tjetër të Myzeqesë, përgjithësisht, ruhen të njëjta mbaresa. Për t'u veçuar është mbaresa *–ër* që del në kontekste të caktuara, si: *qënër, çifutër, çamër, grekër*. Emrat në gjinore-dhanore dalin në trajtën *djemet, barinjet, miqet, por edhe, miqvet, krushqvet* dhe *djemvet*.

Zona e Myzeqesë njihet për praninë e rasës vendore në të gjithë arealin e saj, si rrjedhim, ndihet e shtrirë edhe në këtë zone. Lidhur me këtë fenomen vlen të përmendim këta shembuj: *Në tokt, në darkt, në vapt, në murt,për ndert, në ugart, në misrit* etj.

Përdorimet e përemrave dëftorë me trajtat *qy, qo* (ky, kjo) mbeten një nga veçoritë më të spikatura për këta banorë dhe kanë përhapje te të gjithë brezat. Gjejmë rastin të shpjegojmë edhe mospërdorimin e pronorit (*i,e) vet,* ndryshe nga pjesa tjetër e Myzeqesë, e cila e ka më të theksuar. Në vend të tyre këta banorë përdorin: *djali im, çupa ime, çupat e sajt e mia, e saja*.

Edhe sistemi foljor paraqitet mjaft i larmishëm me trajta foljesh që janë karakteristike për këtë zonë. Veçojmë këtu të pakryerën e cila del me mbaresat: -jam, -je, -te, -jim, -jit, jin; por edhe -njam,- nje, -nte, -njim, -njit, -njin. Shembuj: *prisjam, dinjam, vishjam, dinjit, lanje, lanja, lanjit, zienjam, thynjam* etj.

Foljet *kam, jam, them*, në vetën e parë njëjës, koha e tashme, mënyra dëftore kanë këto trajta: *jamte, kamte* dhe *themte*. Për foljen *hyj*, në urdhërore veta e dytë njëjës dhe shumës kemi trajtat *ryr* dhe *ryni* (ryr brënda, ryni brënda).

E folmja e Myzeqesë dallohet për leksikun e pasur dhe të veçantë në të gjitha aspektet e jetës së njeriut. Në këtë zonë nuk mungojnë fjalët tipike që kanë një përdorim të gjerë te këta banorë. Në pamundësi për t'i sjellë të gjitha dhe sipas një klasifikimi lidhur me sferën e tyre të përdorimit, po përmendim vetëm disa prej tyre. Ndër ato më tipike për këtë zonë përmendim fjalët: *grazhdare, galloshe, taragaçe, kallamizhde, kaki, qymez, kadishte, ipi, mishtrishte, magje, bizhdila, grraç, perikotë, kombisht, bujashka, koritë, naxhake, kollovezhgë, lesë* etj.

Duke përfunduar me leksikun, mendojmë se kemi sjellë disa të dhëna me vlerë për këta banorë buzë Vjosës, të cilët edhe pse jashtë vëmendjes së studimeve të tilla, janë pjesë e historisë dhe bashkudhëtarë me lumin Vjosë. Si pjesë e këtij komuniteti dhe me shumë dashamirësi, pata rastin të jap kontributin tim modest edhe për këtë pjesë të fundit të lumit Vjosë.

Bibliografia

Beniamin Kruta, Polifonia dyzërëshe e Shqipërisë Jugore. Tiranë, 1989.

Gj. Shkurtaj, Sociolinguistika. Tiranë, 1999.

Gj. Zheji, Folklor shqiptar. SHBLU. Tiranë, 2004.

I. Gjika, Fieri në shekuj. Fier, 2004.

J. Gjinari, "Të folmet e Myzeqesë". *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, SSHSH. Tiranë, 1958.

P. N. Komini, "Myzeqeja Perëndimore, *historia, zhvillimi, objektet historike dhe bukuritë e natyrës.*Fier, 2016.

J. Thomai, "E folmja e katundit Seman", *Studime për gjuhën shqipe*, V. Tiranë, 2017.

TIPARE DIALEKTORE E KRAHINORE NË LUGINËN E VJOSËS, KRAHINA E MALLAKASTRËS

Dr. Almira Sadikaj
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
Email: asadikaj@uogj.edu.al

Përmbledhje

Larmishmëria etnografike, historike dhe gjuhësore e luginës së Vjosës përbën një ndër elementet e rëndësishme materiale e kulturore të trashëgimisë sonë dhe shërben si një dëshmi e gjallë e saj. Kjo larmishmëri krijon një mjedis të pasur për shkëmbimin gjuhësor, kulturor e ekonomik të një vendi dhe shërben në përparimin e bashkëpunimit mes komuniteteve të ndryshme brenda tij. Në gjuhën shqipe, në rrjedhë të kohës shumë elemente gjuhësore kanë pësuar ndryshime, shumë elemente janë zëvendësuar, janë plotësuar me elemente të reja, një pjesë e tyre edhe janë harruar, por elementi bazë që i lidh banorët e një vendi është gjuha. Në këtë rast, dokumentimi i të dhënave gjuhësore, ligjërimi bisedor e krahinor, ndihmon në përcaktimin e lidhjeve gjuhësore dhe plotësimi me elemente të tilla është mjaft i rëndësishëm dhe konsiderohet si një prirje e vazhdueshme e saj.

Në këtë punim do të ndalemi në disa çështje që kanë të bëjnë me disa dukuri gjuhësore të luginës së Vjosës, konkretisht të krahinës së Mallakastrës. E folmja e krahinës së Mallakastrës, si pjesë e nëndialektit të toskërishtes veriore, ka tipare të përbashkëta me të gjitha të folmet e tjera të toskërishtes, kjo për shkak të marrëdhënieve tregtare, historike dhe familjare. Por, përveç tipareve të përbashkëta, kanë edhe dallime. Këto dallime nuk i shohim vetëm në rrafshin fonetik e morfologjik, por edhe në rrafshin leksikor. Në këtë këndvështrim, një rëndësi të veçantë u kemi kushtuar edhe dialektalizmave dhe krahinorizmave si një burim i vazhdueshëm për pasurimin e gjuhës shqipe. Duke qenë krijime të pavarura, kanë një shtrirje më të gjerë dhe mund të gjenden edhe në të folme të tjera brenda të njëjtit dialekt, pra si përdorime nëndialektore. Kështu, mbështetur mbi bazën e materialit të mbledhur, gjurmimit, klasifikimeve dhe analizave të fjalëve e shprehjeve popullore, do të sjellim gjendjen e tanishme të ligjërimit te banorët e kësaj krahine.

Fjalët kyçe: larmishmëri, gjuhë, dialektalizma, krahinorizma, dallime

Abstract

The linguistic and ethnic diversity of the Vjosa Valley is one of the important material and cultural aspects of our heritage and serves as a living testimony of it. This diversity creates a rich environment for linguistic, cultural, and economic exchange as well as the advancement of cooperation between different communities within a country. Despite the many changes that have occurred over time, many linguistic elements have been replaced, and supplemented with new elements, some of them have even been forgotten, but the basic element that connects the inhabitants of a country is language. As such, literary language needs such elements, even the demand for them is its constant tendency.

In this paper, we will dwell on some issues related to some linguistic phenomena of the Vjosa Valley, specifically of the Mallakastra province. The speech of the province of Mallakastra, as a sub-dialect of Northern Tosk, has common features with all the other words of Tosk, this is due to commercial, historical, and family relations. But, in addition to common features, they also have differences. These differences are not only on the phonetic and morphological level but are also differences on the lexical level. In this perspective, we have devoted special importance to dialectalisms and regionalisms as a continuous source of the Albanian language enrichment. Being independent creations, they have a wider scope and can also be found in the speech of

another dialect, i.e. inter-dialectal.

Based on the collected material, tracking, classifications, and analyses of popular words and expressions, we will bring the current state of discourse to the inhabitants of this province.

Keywords: *diversity, language, dialectalism, regionalism, differences*

Njohja dhe studimi i dialekteve e të folmeve të shqipes është themelor për të gjitha studimet gjuhësore. Ato i shërbëjnë jo vetëm studiuesit, gjuhëtarit, por edhe dashamirësit të gjuhës, pasi janë ata të cilët ndihmojnë në pasqyrimin e të gjitha fazave nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi, duke lënë gjurmë në gjuhën e tij.Si e tillë, edhe gjuha ka shërbyer dhe shërben si një dëshmi e gjallë e historisë së popullit që e flet atë. Nëpërmjet gjuhës ruhen të dhënat historike e kulturore të një vendi, si dhe marrëdhëniet që një popull ka vendosur me të tjerë popuj fqinj ose jo. Kështu ka ndikuar edhe pasuria jonë gjuhësore, me tipare dialektore e krahinore, të cilat duke u integruar në standard e kanë pasuruar gjuhën letrare me lëndë të re, tepër të vlefshme.

Edhe e folmja e luginës së Vjosës (krahina e Mallakastrës), të cilën ne kemi bërë objekt studimi, paraqet tipare e dallime gjuhësore me vlerë për gjuhën shqipe. E lindur dhe e rritur në një mjedis gjuhësor që zhvillon dhe trashëgon tipare të dialektit tosk, konkretisht të toskërishtes veriore, krahu perëndimor, menduam të përqendrohemi në pjesën që përshkon lumi Vjosë me fshatrat: *Çorrush, Kutë, Drizar, Poçem, Klos, Hekal, Selishtë, Rromës, Gorishovë* etj. Studimet e sotme gjuhësore në të cilat pasqyrohet përshkrimi e studimi i të gjitha të folmeve të shqipes, na kanë ndihmuar të japim një vështrim më të gjerë gjuhësor të tipareve të kësaj krahine. Tiparet e përbashkëta dhe elementet e ndryshme që shfaqen në të folmen e Mallakastrës na dëshmojnë unitetin etnologjik të krahinës, por edhe lidhjet, marrëdhëniet që mallakastriotët kanë pasur me krahinat fqinje[1], marrëdhënie të cilat pasqyrojnë zhvillimin e së folmes së kësaj krahine, në periudha të caktuara.

Mallakastra si një krahinë që ka dhënë e ka marrë me të folmet e tjera të krahinave përreth, në hapësirën territoriale të Shqipërisë, përfaqëson një krahinë më vete dhe përcaktimi i kufijve të saj ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve nga fusha të ndryshme studimi, si: të etnografisë, historisë, gjeografisë, folklorit etj. Mallakastra, ashtu si Myzeqeja dhe Labëria është pjesë e ndarjes territoriale dhe pozicionohet në qendër të Jugut të Shqipërisë, duke na paraqitur tipare etnografike, gjuhësore e kulturore të veçanta, të dallueshme edhe nga të folmet e tjera të dialektit tosk. E folmja e Mallakastrës, edhe në ndarjen e propozuar nga J. Gjinari më 1965[2], bën pjesë në nëndialektin e toskërishtes veriore, si pjesë e të folmeve të grupit perëndimor. Për të mbështetur përfshirjen e së folmes së Mallakastrës në nëndialektin e toskërishtes veriore, Jorgji Gjinari shprehet se e folmja e Mallakastrës ka tipare të përbashkëta me të gjitha të folmet e toskërishtes veriore, siç janë: fenomeni i shurdhimit, ekzistenca e zanores /y/ në sistemin e zanoreve, rasa vendore etj., si dhe dallime të pakta në sistemin fonematik e morfologjik, dy rrafshet kryesore në të cilat vihen re dallimet ndërmjet dialekteve e nëndialekteve edhe të folmeve të caktuara të shqipes. Duke i studiuar hap pas hapi tiparet gjuhësore të këtyre banorëve, vërejmë se ekziston një traditë e gjatë zhvillimi gjuhësor, e cila përcakton kulturën materiale dhe shpirtërore të këtyre banorëve. Mbështetur në këto tipare dhe në varësi të natyrës së tingujve që takohen, dukuritë gjuhësore janë të shumëllojshme, por, më të përdorshme në këtë krahinë, paraqiten dukuritë fonetike, dialektore, morfologjike e leksikore. Dukuritë fonetike më evidente në të folmen e Mallakastrës janë: shurdhimi i bashkëtingëlloreve, shtesa dhe rënia e tingujve etj. Bien në sy:

[1] *Shënim*:Mallakastra gjendet midis Beratit, Labërisë dhe Myzeqesë, me të cilat ka shumë tipare të përbashkëta, por edhe tipare identifikuese që dallojnë atë nga krahinat përreth.

[2] Gjinari, J. *Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmevet të saj*, Konferenca I e Studimeve Albanologjike, nëntor 1962, 1965.

a) zanorja /ë/ në rrokje të patheksuar, sidomos në fund të fjalës nuk ndihet gjithmonë, si p.sh.: *deg-degë, grat-gratë, syt-sytë, buk-bukë, Kut-Kutë, Rroms-Rromës, kshilltar-këshilltar, ktu -këtu, kpun -këputën* etj.;

b) zanorja /e/ e theksuar në pjesën më të madhe të rasteve në toskërishte dhe në të folmet e Mallakastrës ndihet si /ë/, sidomos ku gjendet para hundoreve ose bashkëtingëllores /r/, si: *trëmb-tremb, vënd-vend, fëmër-femër, flë-fle, njërëz-njerëz,*etj.;

c) grupi /mb/ dhe /nd/ janë asimiluar në /m/ dhe /n/ qoftë në rastet kur gjenden në trup, po ashtu edhe në fund të fjalës si në rastet: *demel-dembel, plum- plumb, mërthej-mbërthej, humas-humbas këm- këmbë, gjëm-gjemb, dhëm-dhëmbë,kumlla- kumbulla,të krimra-të krimbura* etj.;

d) thjeshtëzimi i grupit /ng/ në parafjalën nga: *na vate – nga vajte* (ku ishe), *na na erdhi kjo hata* (nga na erdhi kjo e keqe) etj.;

e) grupi /fsh/ në pjesën më të madhe të rasteve ruhet, por ka edhe raste kur shndërrohet në /msh/, si: *mshehurazi-fshehurazi, mshihem-fshihemetj*.

f) fenomeni i rënies së tingujve është një dukuri tjetër që vihet re në këtë krahinë, si rënia e bashkëtingëllores /r/, rënia e bashkëtingëllores /t/ te grupi /sht/ në rastet si: *tshërën- tërshërën, i varfi-i varfëri, nashi / tashi-tashti (tani), kshu-kështu, posh-poshtë, qumësh-qumësht,* etj.;

g) fenomeni i shtimit të tingujve është një dukuri tjetër e cila ndodh për arsye të ndryshme. Në të folmen e Mallakastrës vihet re shtimi i bashkëtingëlloreve /m/ dhe /n/ në fillim të fjalës, në mes apo në fund të fjalës,p.sh.:*zëmbër (zemër), nderisa (derisa), harrin (arrin),mbesova (besova), mbrekulli (mrekulli), ngjollë (njollë), është e ndrejt (është e drejtë), ndallon (dallon), andres (adresë), nashtinë (tani),tyja (ty), andeja (andej) etj.;*

h) fenomeni i shtimit të një bashkëtingëlloreje për të mënjanuar hiatin është një tjetër dukuri fonetike që vihet re në të folmen e Mallakastrës. Hiati krijohet kur takohen dy zanore që vijnë njëra pas tjetrës dhe bëjnë pjesë në dy rrokje të ndryshme. Takimi i këtyre dy zanoreve shpesh krijon një efekt tingullor jo të këndshëm në shqiptim[3]. Bashkëtingëllorja /j/ hyn mes një zanoreje të theksuar dhe një tjetre të patheksuar për të zhdukur hiatin, p.sh., *i jati (i ati), shtëpija (shtëpia), mamija (mamia), shpije (shpie)*etj. Në fshatin Çorrush dhe Drenovë janë vërejtur edhe disa raste të pakta ku duket se në trajtat e foljeve joveprore kanë lindur bashkëtingëlloret /n/ dhe /r/, p.sh.: *bënemi(bëhemi), ziremi(zihemi), të viret* (vihet) etj[4], raste të tilla vihen re edhe në fshatrat Kutë, Drizar, Klos, Poçem, Hekal etj.;

i) në mes të grupeve **/mr/** dhe **/mdh/** shtohet bashkëtingëllorja **/b**/, p.sh: *nëmbrim (numërim), zembra (zemra), të mbëdha (të mëdha)*etj.;

j) fenomeni i zëshmimit është një fenomen tjetër që vihet re, p.sh.: *digan -tigan, rredhi-rrethi, dshëra –tërshëra*;

k) metafonia në trajtën e shumësit të disa emrave mashkullorë e shoqëruar në disa raste me prapashtesën ***-ër*:***vargje- vergje, qylaf-qylefe-qylefër, biçak-biçeqe-biçeqër, kulaç-kuleçe-kuleçër, gërraç-gërreçe-gërreçër* etj.;

l) trajtat e përemrave dëftorë ***ky*** dhe ***kjo***në këto të folme dalin me variant ***qy***dhe ***qo***; *erdhi dhe qy, po qo ç"kërkon këtu?, Ç'ësh qo kshu?-Ç'është kjo kështu?*etj.;

m) Fenomeni i asimilimit është një nga dukuritë që vazhdon të veprojë edhe sot në dialekte e të folme. Në gjuhën shqipe vëmë re jo vetëm asimilimin në grupe bashkëtingëlloresh, por edheasimilimi i tingujve të veçantë, qofshin këto bashkëtingëllore apo zanore[5]. Shpesh në të folmen e këtyre fshatrave dhe jo vetëm ndodhin asimilime të tilla si: asimilimi i grupit /**tn**/ në/**n/**, /**ln/** në /**l**/, /**lln**/ në /**ll**/, p.sh.: *grabin-grabitnë (grabit), kullon-kullotnë (kullot), goditni-godini (godit), duall-duallnë (dal), vual-vualnë(vjel),* etj.;

---

[3] Dodi, A.*Fonetika dhe Fonologjia e Gjuhës Shqipe*. Tiranë, ASHSH, 2004 , f. 150.

[4]Gjinari, J.*"Vërejtje për të folmen e Mallakastrës".* BUSHT. Seria e Shkencave Shoqërore, 1962, f.161.

[5]Memushaj, R.*Fonetika e shqipes standard.* Tiranë, Botime Toena, 2009, f. 126.

n) Pothuaj në gjithë zonën e Jugut dhe të folmet e saj, edhe në zonën të cilën e kemi marrë për studim, ndodhin dukuri si shurdhimi i disa bashkëtingëlloreve të zëshme kur ndodhen në fund të fjalës ose para një bashkëtingëlloreje të shurdhët, si p.sh.: *mleth-mbledh, kukuth-kukudh, u loth- u lodh, zok-zog, shtek-shteg, shelk-shelg, vent-vend, math-madh, lark-larg, gas-gaz, heth-hedh, lënk-lëng, lark-larg*etj.;

o) Përdorimi i ***ç***-së në vend të ***sh***-sëkur ndodhet në fillim të fjalës është një dukuri mjaft e pranishme, kështu kemi fjalë të veçanta që dallojnë nga njëra-tjetra vetëm si variante fonetike jo kuptimore, si: *çportë-shportë,çpoj-shpoj,çqep-shqep,i çkalluar-i shkalluar, i çkëlqyer-i shkëlqyer, çkul-shkul*etj.;

Siç e përmendëm edhe me lart, veçori dalluese në këtë grup fshatrash përbën e folmja e Çorrushit, e studiuar edhe më parë nga gjuhëtari J. Gjinari[6], është një nga fshatrat e zonës anësore në juglindje të krahinës, por gjithashtu edhe një fshat i madh dhe i rëndësishëm i krahinës. Fshati Çorrush është një nga fshatrat më të rëndësishëm të krahinës së Mallakastrës, edhe nga ana gjuhësore dhe leksikore ky fshat paraqet interes, edhe për shkak të ngjashmërive etnografike e gjuhësore me të folmen e krahinës së Tepelenës. Kjo ka ardhur si rezultat i afrisë territoriale që ka me këtë krahinë, si dhe të marrëdhënieve shumë të mira që kanë pasur ndër kohë ky me fshatrat fqinje të Tepelenës (martesa, tregti etj.)[7] Këto janë disa nga tiparet që na dëshmojnë se kjo e folme shërben si një urë lidhëse midis të folmeve jugore dhe të folmeve veriore të toskërishtes.

Krahina e Mallakastrës njihet jo vetëm për vlerat saj historike e etnokulturore, por edhe për një leksik dialektor e krahinor të veçantë. Vlera e leksikut dialektor e krahinor në krahinën e Mallakastrës, evidentimi dhe klasifikimi i tyre na kanë shërbyer si mjet tipizues për karakterizimin e gjuhës së këtyre banorëve. Ngjarjet historike, jeta kulturore dhe artistike, leksiku shumë i pasur me veçori individuale, veprimtaria prodhuese e shoqërore, si dhe marrëdhëniet me vendet fqinje kanë lënë gjurmë te banorët e kësaj krahine. Megjithëse në periudhën aktuale lidhjet dhe bashkëveprimi midis banorëve, vendbanimeve apo njësive administrative janë intensifikuar, duke eliminuar deri diku ndarjet krahinore, por kjo nuk do të thotë që ato do të shpërbëhen apo do të humbasin identitetin e tyre.

Në të gjitha studimet gjuhësore theksohet se dialektorizmat dhe krahinorizmat janë rrjedhojë e ndarjes territoriale të popullsisë dhe se midis tyre nuk ka kufij të prerë dialektorë. Ato konsiderohen një burim i vazhdueshëm për pasurimin e gjuhës shqipe, dhe si një pasuri kombëtare e krijuar nga populli, por që herë pas here duke gjetur përdorim të kufizuar, kanë mbetur të tilla. Dialektorizmat dhe krahinorizmat, veç dallimeve ndërmjet tyre, kanë edhe karakteristika të përbashkëta: kanë të njëjta kufizime gjuhësore e territoriale, nuk përputhen me normën gjuhësore të standardit, krahinorizmat mund të përhapen brenda dialektit dhe të kthehen në dialektorizma[8]. Gjatë hulumtimit tonë për të folmen e krahinës së Mallakastrës, kemi vënë re përdorimin e mjaft dialektalizmave e krahinorizmave, ku kemi evidentuar edhe se një pjesë e tyre gjejnë përdorim si në labërishte, po ashtu edhe në pjesën tjetër të dialektit tosk.

Për gjithë materialin e marrë në studim, kemi bërë kërkimet e duhura në fjalorët shpjegues të shqipes dhe evidentuam se një pjesë e këtyre fjalëve janë pasqyruar në fjalorë, por, gjithashtu, një pjesë tjetër ka mbetur jashtë, duke u strukur në dialekte a të folme të veçanta. Në disa raste këto përdorime janë konsideruar edhe si arkaike.

Ja disa prej tyre:

a) Fjalë dialektore të huazuara nga vendet fqinje si orientalizma e greqizma që i përkasin ligjërimit bisedor: ***katandis*** *(bëj që dikush të jetojë keq ose të bjerë nga gjendja ku ishte),* ***haber***

---

6 Gjinari, J. *"Vërejtje për të folmen e Mallakastrës",* BUSHT, Seria e Shkencave Shoqërore, 1962, f. 148-180.

7 Gjinari, J. *"Vërejtje për të folmen e Mallakastrës",* BUSHT, Seria e Shkencave Shoqërore, 1962, f. 148-180.

8 Thomai, J. *Ligjërata pasuniversitare (leksikologji, semantikë, leksikografi).*Korçë, 2015, f. 120.

*(lajm), **mandatë** (lajm i zi, i keq), i babëzitur (i pangopur), **mblidh kallaballëkun** (mendjen), karar (nuk gjen karar - qetësi, zgjidhje), nuk u bë **qameti / hataja** (shtrëngata, furtuna), **çetur** (garuzhdë, lugë e madhe për të shpërndarë ushqimin), **havale** (barrë, punë që të sjell telashe), **patomë** (shputa e këmbës);*

b) Emra e mbiemra që përdoren në ligjërimin e thjeshtë: ***azat** (vetëm, i ka lëshuar fare), **tabijat** (zakon), **avaz** (zakon), **prokopi** (mall, pasuri), **kurbetlli** (mërgimtar, emigrant), **tërsëllëm** (inat, egërsi), **kulupi** (u mbush plot, u bë rrëmujë), **avlli** (oborr i shtëpisë), **u bë çamur** (u ngatërrua, u prish fare), **dac** (lakuriq), **çetinat** (baluket)* etj;

c) Fjalë të thjeshta me kuptim të figurshëm ose jo: *ka lojtur nga **fiqiri** (truri), **u çakërdis** (u hutua, ka humbur ndërgjegjen);*

d) Fjalë më ngjyrim emocionor pozitiv që shprehin qëndrimin e folësit si dashuri, admirim, kënaqësi, përkëdhelje, dëshirë, lutje, miqësi, dashamirësi etj: ***lastar** (i hollë), **qerrata** (njeri i zgjuar e i shkathët, por edhe dredharak e tinëzar), **kolopuç** (i vogël), **kallogre** (gra që rrinë gjithë ditën pa bërë asnjë gjë, dhe murgeshë), **manare** (e urtë);*

e) Fjalë më ngjyrim emocionor negativ që shprehin qëndrimin e folësit si ironi, përbuzje, mospërfillje, përçmim, tallje, sharje, xhelozi, mallkim, mërzi etj: ***krodhëtar** (njeri kursimtar), **brashnjar** (njeri që merr rryshfete, plaçkitës), **sojsëz** (nga një fis i keq, i pafisëm), **lugat** (njeri i keq e i shëmtuar), **urith** (njeri që të fsheh të vërtetën, mistrec), **buallicë** (e ngathët dhe e trashë nga mendja, edhe e shëndoshë);*

f) Fjalë që shënojnë veprime: ***katandis** (si vajti kështu kjo punë), **kullandris** (rregullohem me ç'të mund), **kumbisem** (rrëzohem), **telikos** (rraskapit); **arrakatet** (vjen vërdallë);*

g) Fjalë që shënojnë sende/objekte për jetën e njeriut ose jo: ***ferexhe** (veshje femërore e besimit musliman), **kobure** (armë), **farmak** (helm);*

h) Fjalë që emërtojnë gjendje të mbinatyrshme a fantastike: ***lugat** (i pangopur), **pelivan** (i shkathët, trim e guximtar);*

i) Fjalë që shprehin gjendje të ndryshme shpirtërore: ***qeder** (hall, shqetësim, hidhërim, në anët tona përdoret edhe **nuk e gjen qederi**- nuk i ndodh gjë);*

j) Fjalë që shënojnë frymorë sipas vetive fizike, morale e pozicionit shoqëror: ***bandill** (bukurosh, i pashëm, por edhe si i dashuri i zemrës), **derdimen** (torollak, i trashë), **bedel** (ai që bën punët e të tjerëve, por në zonën tonë përdoret edhe në formën **bedel nëna**- për lum nëna për ty);*

Në fund po rreshtojmë edhe disa fjalë dialektore të veçanta për këtë të folme në krahasim me ato të fshatrave të tjera të Mallakastrës, p.sh.: ***shkoj në bostan***(shkoj nga toka), ***bëj tok*** (bashkë), ***rrjep*** ose ***xhvoksh*** misrin, ***protoene***(enë karakteristike për një gatim të caktuar), ***shpatëz***(pjesa e përmendës),***lloz*** (shuli i derës, por përdoret edhe me konotacion negativ i pagdhendur (hyri shul e doli lloz), ***gshërza***(binarët e çatisë), ***përzë*** (largoj dikë), ***lukuni*** (të shumtë në numër), **maçe**(mace), **paparun** (flak i kuq), **erdhi** (hardhi), ***bujazhga/cepka*** (dru të vogla për të ndezur zjarrin), ***i helmur*** (për dikë që i ka ndodhur një fatkeqësi, p.sh.: vdekja e një fëmije), ***mbloj*** (e fsheh diku) etj.

Si përfundim, mund të theksojme se gjuha e krahinës së Mallakastrës jo vetëm që ka vlera të jashtëzakonshme historike, kulturore e gjuhësore, por ajo shpalos shumë dukuri interesante dhe që mund të studiohet nga shumë pika vështrimi. Ne me plot gojën mund të themi se gjuha e kësaj krahine duhet vlerësuar dhe trajtuar si thesar i çmuar, si një fond i pashtershëm për pasurimin e gjuhës letrare me mjete gjuhësore shprehëse.

Bibliografi

ADGJSH, Vëllimi 1, 2. Napoli, 2007, 2008.

Çabej, E. Studime etimologjike në fushë të shqipes, 1983, I.

Çabej, E. Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, pjesa e pare. Tiranë, Botime Çabej, 2008.

Gjinari, J. “Vërejtje për të folmen e Mallakastrës”, BUSHT, Seria e Shkencave Shoqërore, 1962.

Gjinari, J;Shkurtaj, Gj. Dialektologjia. Tiranë, 2003.

Luka, D. Studime gjuhësore, IV, 2003.

Memisha, V. Studime për fjalën shqipe II.Tiranë,QSA, IGJL, 2015.

Shkurtaj, Gj. Dialektet e shqipes. Tiranë, 2012.

Thomai, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe.Tiranë,SHBLU, 1999.

Thomai, J. Ligjërata pasuniversitare (leksikologji, semantikë, leksikografi). Korçë, 2015.

REFLEKSIONE LIRIKE NË VEPRËN "EMRIN E KA DASHURI" TË BARDHYL LONDOS

Dr. Mirela Saraçi
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
Email: mirelgjirokaster@yahoo.com

Abstract

This study examines the lyrical poetry of Bardhyl Londo and focuses on the dimensions of love imposed by his work. Through an in-depth analysis of the poetry, the main goal is to reflect on how the author has managed to unfold his emotions and thoughts through lyrical poetry.

Furthermore, the study will highlight how Bardhyl Londo has used lyrical poetry as an effective tool to express and emphasize his emotions related to love, leaving an indelible mark on Albanian literature. The study examines the lyrical poetry of Bardhyl Londo, concentrating on his work "Its Name is Love." We will examine how the work "Its Name is Love," reflects and affects the reader uniquely. Bardhyl Londo's poetics will be examined in the context of the time and environment in which it was created, attempting to understand the depth of the connection between the name and love in his poetic context. The analysis will offer a profound perspective on the work while also encouraging the reader to reflect on the connection between word and feeling that lyrical poetry unfolds, with a particular focus on "Its Name is Love" by Bardhyl Londo. This study aims to emphasize the significance of the work "Its Name is Love" in Bardhyl Londo's literary corpus and its contribution to contemporary Albanian literature. By analyzing the central theme of love, the paper explores how Londo uses this motif to build a rich and sensitive poetic universe. The work stands out for its use of powerful metaphors and complex symbolism, creating a deep emotional atmosphere akin to reality. Londo's style is characterized by rich and figurative language, reflecting the author's deep feelings and personal experiences. The paper will analyze the poetic structure, rhythm, imagery, and literary techniques used in this work, highlighting their impact on creating a unique aesthetic and emotional experience for the reader.

Keywords: *study, lyric, reflection, reader, interpretation*

Kumtesa shqyrton poezinë lirike të Bardhyl Londo dhe fokusohet në dimensionet e dashurisë që i imponon vepra e tij. Përmes një analize të thelluar të poezisë, pikësynimi kryesor është të reflektohet mbi mënyrën se si autori ka arritur të shpalosë emocionet dhe mendimet e tij nëpërmjet poezisë lirike.

Bardhyl Londo, poet i mirënjohur shqiptar, lindi më 25 dhjetor 1948 dhe vdiq më 18 shkurt 2022. Bardhyl Londo ishte një personalitet i shquar në letërsinë shqiptare dhe u bë një ndër përfaqësuesit më të rëndësishëm të poezisë lirike në periudhën e pas Luftës II Botërore.

Përjetoi një jetë të pasur me sfida dhe ndryshime shoqërore, duke reflektuar këto sfida në poezitë e tij.[1]

Në vitin 1981 ai boton librin "Hapa në rrugë", ndërsa tre vjet më vonë, "Emrin e ka dashuri". Londo është autor i shumë vargjeve për dashurinë në letërsinë shqipe, dhe kjo, ndoshta, e bëri shumë shpejt një emër të dashur për lexuesin.

Përvoja në gazetën "Drita", një nga gazetat më me ndikim në botën letrare para viteve '90, duket se ka mundur të shmangë keqkuptimet në të cilat u përfshinë këto vite në debate publike shumë personazhe të kohës. Duke ruajtur një profil neutral, Londo arriti të krijonte profilin e një poeti dhe intelektuali të shkëputur nga koha.

[1] Elsie, Robert. Histori e letersise shqiptare. Dukagjini, Peje, 2001, fq. 480.

Autori shpalosi ndjeshmërinë dhe thellësinë e ndjenjave në veprën e tij të shquar, "Emrin e ka dashuri." Kjo poezi është një udhëtim emocional në botën e dashurisë dhe identitetit, duke kombinuar stilin e veçantë të Londos me imazhe të pasura dhe gjuhë të thellë poetike[2].

Në këtë vepër autori paraqet një përqasje të kujtimeve dhe ndjenjave të ndryshme që nisin nga gëzimi deri te melankolia. Varësia e emrit në titull, "Emrin e ka dashuri," tregon se dashuria nuk është vetëm një ndjenjë e përkohshme, por një qëndrim i përjetshëm që lidhet me identitetin e një personi.

Vargjet e tij shpalosin melodi të ëmbla të përkthimit të ndjenjave, ndërsa gjuha e përdorur ka një fuqi të veçantë për të frymëzuar dhe prek këndvështrimin e lexuesit. Përdorimi i simboleve dhe metaforave krijon një dimension të shtuar emocional dhe lejon lexuesin të lidhet me thelbin e poezisë. Në shpërndarjen e fjalëve, Londo ndërthur pasionin dhe pasigurinë, duke krijuar një harmoni poetike që reflekton kompleksitetin e dashurisë.

Në veprën "Emrin e ka dashuri" të Bardhyl Londos, lirizmi ka njërol të rëndësishëm. Lirizmi është një stil poetik që karakterizohet nga liria e shprehjes, përdorimi i imazheve të pasura dhe ndjeshmëria emocionale[3]. Në veprën e përmendur kemi elemente tëlirizmit si:

1. **Imazhe të pasura dhe detaje të thella:** Bardhyl Londo shfaq një aftësi të veçantë për të përdorur imazhe të pasura dhe detaje të thella në poezinë e tij. Kjo i jep lexuesit një pamje të qartë dhe të ngjashme me realitetin, duke e bërë përjetimin poetik më të thellë dhe më të pasur.

2. **Emocionet e thella dhe ndjenjat e shprehura me fuqi:** Lirizmi përfshin shprehjen e ndjenjave dhe emocioneve në një mënyrë të thellë dhe të ndjeshme. Në veprën "Emrin e ka dashuri," shohim se Bardhyl Londo shpreh dashurinë dhe emocionet e tjera në një mënyrë të pasur dhe të ngjashme me natyrën e tyre komplekse.

3. **Përdorimi i metaforave dhe simbolizmit:** Shpesh përdor metafora dhe simbole për të komunikuar mesazhe të thella. Autori përdor këtë teknikë për të shfaqur ndjenjat dhe ide të tij në një nivel më simbolik dhe artistik.

4. **Ritmi dhe rima:** Elementet e formës së poezisë, si ritmi dhe rima, janë gjithashtu pjesë e lirizmit. Në poezinë e Londos, mund të ketë përdorim të një ritmi të veçantë dhe një rime të hollë, që ndikojnë në sensin e lirisë dhe shpirtit artistik të poezisë.

5. **Reflektimi mbi natyrën dhe bukurinë e thellë:** Poetët lirikë shpesh reflektojnë mbi natyrën dhe bukurinë e thellë. Në "Emrin e ka dashuri," hasim pasqyrimet e natyrës dhe bukurisë së saj, të cilat përforcojnë ndjenjat dhe emocionet e poetit.

Përmes përdorimit të këtyre elementeve lirike, Bardhyl Londo krijon një përvojë poetike të pasur dhe të ndjeshme në veprën e tij "Emrin e ka dashuri." Lirizmi i tij e bën këtë vepër të pasqyrojë thellësinë e emocioneve dhe mendimeve të shprehura nga poeti.

Në poezinë “Emrin e ka dashuri”, Londo përdor gjuhën poetike me një finesë të veçantë, duke e kthyer fjalën në një instrument shpirtëror. Në vargje të tilla si:

Emrin e ka dashuri,
e shkruan me lot
me heshtje
me dy gishta në buzë,
kujton edhe kur harron.[4]

---

[2] Zisi, Roland. Studime kritiko letrare per letërsinë shqipe. Tiranë, 2005.

[3] Kucuku, Bashkim. Pas eklipsit letrar, Letërsi bashkëkohore shqipe. Studime, artikuj, ese. Tiranë, botimet Toena, 2014, fq. 366.

[4] Londo, Bardhyl . Emrin e ka dashuri. Tiranë, 1984, fq. 94.

Bardhyl Londo shpreh ndjenjën e pakapshme të dashurisë përmes emrit, një emër që ka një ngarkesë emocionale dhe kujtimore të fortë. Vargjet e tij shpalosin melankolinë dhe thellësinë e ndjenjave, duke rikrijuar magjinë e emocioneve që shoqërojnë dashurinë.

Përshkrimi i tij i dashurisë vjen në një formë të sublimuar, duke përdorur imazhe poetike për të përshkruar një realitet të pashtershëm:

Emrin e ka dashuri,

e ndan në heshtje në qiejt e pikëllimit,

në buzët e zërit tënd.[5]

Ky fragment pasqyron thellësinë e një dashurie që tejkalon kohën dhe hapësirën, duke e ngritur atë në një dimension të lartë shpirtëror.

"Maj në Përmet" e Bardhyl Londos është një poezi e pasur me imazhe të rralla dhe ndjenja të thella, e cila shpalos bukurinë dhe misterin e natyrës së zonës së Përmetit, në Shqipëri. Në këtë poezi, autori përshkruan peizazhin e Përmetit, duke iu përkushtuar detajeve dhe ngjyrave që e bëjnë atë një vend të jashtëzakonshëm.

Përshkrimi fillestar i peizazhit tregon kujdesin e autorit për detaje:

Dielli pikoi pike - pikë,

mbi qershitë purpuri ra,

si mollëza të skuqura shumë,

nga emocine të mëdha.6

Këtu, lexuesi ndihet i ftuar të ndihet pjesë e këtij udhëtimi poetik, duke imagjinuar pamjet e bukura dhe burimet natyrore që e rrethojnë zonën e Përmetit.

Një gërnetë që dikur qante,

me zënë e jetës qeshi deri vonë,

midis brigjesh Vjosa e kaltër,

e gjitha një impression.7

Poezia "Maj në Përmet" përbën një udhëtim poetik në bukurinë natyrore dhe kulturore të kësaj zone shqiptare, duke e bërë atë një pjesë të pasur të trashëgimisë letrare shqiptare.

Poezia "Çdo fëmijë" ka thellësi dhe shpërthim emocional, duke përcjellë një mesazh të rëndësishëm mbi fëmijërinë, përgjegjësinë shoqërore dhe mahnitjen përpara botës. Poezia "Çdo fëmijë" e Bardhyl Londo shpalos një vizion të pasur dhe të ndjeshëm për botën e fëmijërisë, duke shkruar me një gjuhë thelbësore dhe duke përdorur imazhe të fuqishme që kapën thelbin e kësaj periudhe të jetës[8]. Pasqyrohet:

1. **Imagjinatë e pasur:** Poezia e Bardhyl Londos ka një imagjinatë të pasur dhe përshkruan botën e fëmijërisë në një mënyrë të veçantë. Me vargje të pasura dhe imazhe të qarta, ai shkruan për lirinë, kureshtjen dhe pasionin e fëmijëve.

2. **Vargjet e ndjeshme:** Stili i Londos është i ndjeshëm dhe i thellë. Vargjet e tij shprehin ndjenjat dhe emocionet me një mënyrë të veçantë, duke i dhënë poezisë një dimension më thelbësor.

3. **Reflektimi mbi jetën:** Poezia "Çdo fëmijë" mund të shihet si një reflektim mbi jetën dhe përgjegjësitë që rritja i sjell më vete. Autori shpalos thelbin e fëmijërisë dhe çuditësinë e botës së tyre, duke shtuar një këndvështrim të veçantë ndaj kësaj periudhe të jetës.

4. **Kritika ndaj shoqërisë:** Në disa raste, poezia e Londos mund të përfshijë edhe një

---

[5] Po aty.

[6] Po aty, fq.40.

[7] Po aty, fq.42.

[8] Londo, Bardhyl. Emrin e ka dashuri. Tiranë, 1984, fq. 32.

kritikë ndaj shoqërisë dhe mënyrës së saj të trajtimit të fëmijëve. Ai mund të shfaqë ndjenjën e përgjegjësisë kolektive për të siguruar një mjedis të shëndetshëm dhe mbështetje për të rriturit e ardhshëm.

5. **Përdorimi i gjuhës:** Bardhyl Londo shpesh përdor një gjuhë të pasur dhe të përzemërt për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tij. Gjuha e tij është e thellë dhe ka një ndikim të fortë emocional te lexuesi.

Çdo fëmijë në një stuhinë ëndrrash,
fluturon me shpirtin e një zogu,
Në çdo çast, në çdo hap, në çdo hapësirë,
i hapin dorën dhe kujtojnë qiellin
Me sytë e tyre të ngazëllyer shohin botën,"
"Çdo fëmijë në një stuhinë ëndrrash.[9]

Ky varg fillon poezinë me një pamje të fuqishme dhe emocionuese. Stuhia e ëndrrave simbolizon pasionin dhe imagjinatën e pasur të fëmijëve, ndërsa përdorimi i këtij elementi natyrore shpall një energji të jashtëzakonshme te fëmijët.

"fluturon me shpirtin e një zogu."

Përdorimi i metaforës "shpirti i një zogu" përshkruan lirinë dhe lartësinë e ndjenjave të fëmijëve. Ky imazh sjell një atmosferë magjepsëse dhe thotë shumë për pafajësinë dhe lirinë e fëmijëve.

"Në çdo çast, në çdo hap, në çdo hapësirë,"

Kjo pjesë thekson thellësinë e përjetuar nga fëmijët, duke i paraqitur ata si të plotësuar me një ndjenjë të pafundme kureshtjeje dhe njohurie. Përdorimi i fjalës "çdo" thekson përgjithësinë e kësaj përjetese dhe ngjarjeje të pashmangshme në jetën e tyre.

"i hapin dorën dhe kujtojnë qiellin."[10]

Ky imazh tregon lidhjen e fëmijëve me natyrën dhe lirinë e tyre të papërmbajtur. Hapja e dorës simbolizon kërkimin dhe pranimin e tyre të lirë ndaj botës dhe mrekullive të saj. Qielli bëhet një metaforë e hapësirës së pafundme të mundësive.

"Me sytë e tyre të ngazëllyer shohin botën,"[11]

Përmendja e syve të ngazëllyer shpreh një mahnitje të pafundme ndaj bukurisë dhe misterit të botës. Kjo frazë thekson perceptimin e tyre të pasur dhe vëmendjen ndaj detajeve të vogla dhe të mrekullueshme.

Si përfundim, mund të themi se poezia e Bardhyl Londos ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e lexuesit që vjen nga të gjitha brezat. Ajo është realiteti ku jetojmë, realiteti që prekim dhe përjetojmë çdo ditë, prej të cilit provojmë gëzimet apo hidhërimet, është realiteti i botës shqiptare që trashëgojmë nga njëri brez te tjetri, me shpresën dhe dëshirën për të ndryshuar dhe për të depërtuar në thellësi të fenomeneve të shoqërisë. Poezia e tij zë vend të nderuar në themel të kulturës sonë kombëtare dhe për vlerat që ajo mbart është përkthyer në shumë gjuhë të botës.

Bibliografia

Londo, Bardhyl. Prill i hidhur. Onufri, 2020.

Londo, Bardhyl. Krisma dhe trëndafila. Tiranë, 1975.

Londo, Bardhyl. Hapa në rrugë. Tiranë, 1981.

9 Po aty, fq.32.

10 Po aty, fq.32.

11 Po aty, fq.32.

Londo, Bardhyl. Emrin e ka dashuri. Tiranë, 1984.
Londo, Bardhyl. Si ta qetësoj detin. Tiranë, 1988.
Londo, Bardhyl. Vetëm Itaka. Prishtinë, 1989.
Londo, Bardhyl. Ditë Njerëzore. Tiranë, 1990.
Londo, Bardhyl. Shën Shiu. Tiranë, 2010.
Londo, Bardhyl.Jeta që na dhanë. Tiranë, 2013.

VËZHGIME RRETH DISAMIKROTOPONIMEVE PËRGJATË LUGINËS SË VJOSËS
(SEGMENTI PISKOVË-PESHTAN)

Msc.Zeqir Zeqirllari
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
Email: zeqirzeqirllari@gmail.com

Abstract

In this paper, we will discuss microtoponymy and microhydronymy along the Vjosa River. Specifically, the paper is based on a certain segment of Vjosa, Piskovë (Përmet)-Peshtan, (Tepelenë), along its banks and in the city of Këlcyra. For the realization of this paper, several study methods have been combined, such as survey, description, lexical-semantic, and grammatical analysis, as well as synthesis. We conducted surveys in the field, and we classified toponyms according to the words that make up their structure, for example: toponyms that have the words shore, cave, field, etc.

We hope this paper shows that the study of microtoponyms and microhydronyms is of interest not only to linguistics but also to anthropology, history, etc. We believe that the paper offers additional material or information for the benefit of the preservation and promotion of culture, as well as the development of tourism in these areas. Also, our paper can serve as an impetus for our future work, further expanding the study in this field, but also for other researchers.

Keywords: *microtoponyms, microhydronyms, survey, description, lexical-semantic structure of the word*

Në qendër të kësaj kumtese është mikrotoponimia dhe mikrohidronimia përgjatë lumit të Vjosës. Konkretisht, punimi mbështetet në një segment të caktuar të Vjosës, Piskovë-Peshtan, Tepelenë, përgjatë brigjeve të saj dhe në qytetin e Këlcyrës. Për realizimin e kësaj teme kemi ndërthurur disa metoda studimi, si: të anketimit, të përshkrimit, të analizës leksiko-semantikore dhe gramatikore, si dhe ajo e sintezës. Kemi bërë anketime në terren, pastaj kemi klasifikuar toponimet sipas fjalëve që përbëjnë strukturën e tyre.

Ndërtesat dhe vendet kanë një rëndësi të madhe në përpjekjen që bëjmë për të ruajtur të kaluarën tonë, si dhe në shprehjen e identitetit tonë. Me lëvizjet demografike, emigruese, të banorëve drejt qendrave urbane në Shqipëri apo drejt shteteve të ndryshme ose me largimin e brezit të vjetër, humbet dhe një pasuri, ajo e mikrotoponimeve, të cilat shërbejnë si të dhëna me vlera të rëndësishme historike, kulturore, antropologjike, gjuhësore etj. Gjithashtu, zhvillimi dhe ndryshimi urban bëjnë që një mikrotoponim i vjetër të zëvendësohet me një tjetër të ri ose mund të harrohet fare. Një shembull i mirë për të ilustruar këtë bjerrje të mikrotoponimeve është fshati Fratar, i ndodhur në lindje të rrjedhës së mesme të lumit Vjosë, pranë qytetit të Këlcyrës. Përreth këtij fshati dëshmohen mjaft gjurmë të vendbanimeve të lashta ilire. Referuar hulumtimeve në fushën e arkeologjisë nga N. Bodinaku, në traktet arkeologjike të gjurmuara, janë të mbivendosura këto mikrotoponime: *Shpella e Hulerës, Shpellae Guçit, Sheshi i Kalorësit*. Kureshtja se ku ndodhet *Shpella e Hulerë,* na bëri të pyesnim shumë individë dhe askush jo vetëm nuk e identifikonte, por disa nuk e kishin dëgjuar as si mikrotoponim. Prandaj, mendojmë se punimet mbi këto lloj temash përbëjnë, përveç interesit shkencor, edhe interes kulturor, turistik etj.

"Tema e kujtesës së grupeve njerëzore lidhet me kohën, hapësirën dhe marrëdhëniet midis individit dhe komunitetit"[1]. Kjo lidhje e njeriut me hapësirën, me strukturimin e kësaj hapësire

[1] Agresti, Giovanni, *La mammorje 'nghie' lo lòcche*, f. 93, në: https://www.amazon.it

dhe me orientimin në të, bëhet nëpërmjet emrave të vendeve.

Le të marrim emrin ***Këlcyrë***: huazim prej lat. *clausura*. Fjala latine, *clisura=clausura,* ka depërtuar edhe në disa gjuhë të tjera ballkanike, si: gr. biz-*κχλεισσουρά,* bullg dhe skr.-*klisura,* arum.-*clisură,* shqip-Këlcyrë është një term ushtarak, i cili u bë popullor ndërmjet pjesëmarrjes së banorëvetë këtyre vendeve në veprimet luftarake të ushtrisë bizantine.[2] Trajta e toponimit *Këlcyrë* rrjedh prej greqishtes, ku lëngëzorja ka lëvizur brenda rrokjes së patheksuar dhe *s*-ja është kthyer në -*c*- prej afërsisë së lëngëzores.[3] Sipas Kolë Lukës[4], ekzistojnë një numër i madh toponimesh me emrin *"Këlcyrë*" që shtrihen në mbarë Shqipërinë, në Veri dhe në Jug.

Mikrotoponimet

Modelet për klasifikimin e materialit toponimik janë të shumta, por në këtë kumtesë menduam ta organizonim duke u nisur nga këndvështrimi **semantik** dhe **strukturor**.

Së pari, po trajtojmë ndarjen sipas **fushave semantike** që mikrotoponimet kanë në përbërje të tyre, bazuar në modelin e ndjekur nga studiuesi Xh. Idrizi[5]. Konkretisht:

1. **Hidronime** me fjalët: **burim, brambull, dallgë, gji (ngjir), krua, përrua, krua, ujë, va, valë etj., si:** *Burimi i Bambullit, Burimi i Gëros, Burimi i Ilos* etj.;**brambull**: *Brambull, Brambujt e Kombinatit*; **çezmë**: Çezmë e Ramizit; **dallgë**: *Dallgët e Petranikut, Dallgët e Qelovës*; **gurrë**: *Gurrgjono,* (Mbrezhd), *Gurre' Madhe* (Rib); **gji** (përdoret më shumë trajta "**ngjir" -** me kuptimin **"**vend lumi i thellë shumë"[6], *Ngjiri i Hydait (Dakes), Ngjiri i Qelovës* etj.; **gjol**: *Gjol (Këll, Rib, Vrb*); **krua**: *Kroi i Evgjitëve, Kroi i Daiut, Kroi i Madh*; **lumë**: *Lumi i Lomicës/Lomnicës* (Pisk.); **moçal:** *Moçalet* **(**ara, Rib**); përrua**: *Përroi Beles, Përroi i Çoravës, Përroi i Thatë, Përroi i Thellë*;**topil**: *Topil e Sulos*; **valë**: *Valët e Qelovës,* **ujë**: *Ujët e Zi* (përdoret edhe në formën *Uji i Zi)**;*** **va**: *Vau i Çumanit, Vau i Marmuricës, Vau iRibanit, Vau i Varibopit etj.*

Hidronime me prejardhje të huaj*: Boçka (vendi në lumë), Bujanec (burim)* edhe tokatpërreth tij quhen *Bujanece, Bobosh (*çesmë-*Mbrezhdan),Çoravë (përrua), Doç i Madh, Doç i Vogël* (ngjire në lumë), *Marmuricë* (vend në lumë), *Petranik* (shpellë karstike ku del ujë, të njëjtin emërtim e hasim dhe në Katundishtë), *Qelovë* (vend në lumë), *Dëshnicë* (lumë) etj.

- Gjatë rrjedhës së Vjosës (në segmentin e lartpërmendur) kemi hasur edhe emërtime me kuptim të figurshëm si: *Gozhda* (për shkak të ujit të ftohtë, që "*të ther si gozhdë*"), *Deti* (vend ku lumi zgjerohet dhe ngjan si det), *Rredhi i Peshtanit* ose ndryshe quhet dhe *Ora* (për shkak tëformës së rrethit), *Gropa e Diganit* (për shkak të formës së tiganit). *Muri Kinez* (formacion shkëmbor që ngjan si mur i madh). *Hinka* (vend ku ndodhet një vorbull uji dhe të thith si hinkë). Veç anës semantike në këto mikrotoponime na shfaqen edhe dukuri fonetike si shndërrimi i një zanoreje të shurdhët në të zëshme (sonorizim): *t-d, th-dh, c-sh, zh-sh.*

2. Oronime me fjalën **breg/brigje**: *Bregu i Kuqarit, Bregu iKrushqve (Gry)* etj.;**brez**: *Brezi Stanit, Brezi i Shkurtër*, *Brezi i Zahos,* **brinjë**: Brinjë e Zonjës; **faqe**: *Faqja* (ana e djathtë e Vjosës në Grykë të Këlcyrës, ndërsa ana e majtë quhet *Hija*); **fushë**: *Fusha e Çaratovës* (Grabovë), *Fushë e Ftohtë, Bishti i Fushës, Fushë e Suliotëve (Mbrezhd)* etj.; **gavër** (zgavër): *Gavra* (Gry); **gropë**: *Gropë eDiganit, Gropë e Priftit*; **gur**: Gur (lagje), *Guri i Çpuar (Gry), Guri i Madh, Guri i Zi (Mbr)*; **kulë**: *Kula e Derrit, Kulat e Preta<Kulat e Mbrehta*; **qafë***: Qafë e Çomes***,** *Qafa e Kazhelit (Gry), Qafë e Kllogjrit, Qafë e Mullirit (Klc), Qafë e Shabanit*

[2]Mihaescu, Haralambe. "*Linguistika dhe etnogjeneza e shqiptarëve*", në *Studime filologjike,* nr. 3/1982, f. 61.

[3] Topalli, Kolec. *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe.* Durrës, Bot. Jozef, 2017, f. 761.

[4]Luka, Kolë. "Klos, Këlcyrë, Derven, Mbyllc, Mshilt në repertorin onomastik të arbërve", në *Shqipëria mesjetare në toponamastikë dhe onomastikë*. T., ASA, 2019, f. 656.

[5]Idrizi, Xhemaludin. *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit.* Shkup, Interdiskont, 2003.

[6] Tase, Pano. *Fjalor dialektor*. T. Çabej, 2006, f. 142.

(Mbrzh); **lug-u**: *Lugjet* (Rib); **rrëzë**: *Rrëzë* (oikonim-emër lagjeje në Mbrezhd); **rrungajë**: *Rrungajet e Stilës (Gry), Rrungajet eBardha (Gry);* **shkëmb***; Shkëmbi i Kuq (Mbrzh), Shkëmbi i Simon Gjikës;* **shpellë**: *Shpella (Grab), Shpella e Burrave, Shpella me Këmbëza, Shpella e Pëllumbave, Tri Shpellat* etj.; **shteg:** *Shtegu i Pelës, Shtegu i Dhelprës* etj.;**zhur-i:** *Shuri i Kalasë***; vërë (vrimë)**: *Vërë e Bekos, Vërë e Stanit* etj.

3. Mikrotoponime që lidhen me botën bimore dhe shtazore

- **Mikrotoponime të botës shtazore (zoonime)***: Bregu i Ujkut, Gropa e Derrit, Guri i Korbit, Shtegu i Dhelprës, Shtegu i Pelës* etj.

- **Mikrotoponime që kanë në përbërje të tyre emra bimësh (fitonime),** që rriten a janë rritur atje ose me fjalët:*arrë, bajame, lis, man*etj.

arrë*: Arrët e Mëdha (Klc)*; **bajame**: *Bajamet, Bajamet e Ribanit;* **bostan/shalqin***: Bostani (në shumë vende), Gropa e Shalqinit (Pisk);* **fik***: Fiqishtë (Vrb);* **hurmë***: Hurmat;***lis***: Lisat, Lisi i Çaçit, Trelis;* **pishë***: Pishat* (ky emëretim gjendet në shumë vende)*;* **bar***: Bari i Qënit, Sheshi i Barit;* **bli***: Bliri i Bramit (*dëgjohetedhe *Bliri i Blamit), Sheshi i Blirit;* **prall***: Kyçi i Prrallit;* **rrap***: Rrapi i Arrizit, Rrapi i Gjatë;* **mërqinjë/mëlqinjë***: Mërqinjëz (në disa vende);* **kumbull***: Kumbullat e Beut, Kumbulla e Lelesë;* **man***: Manat (e Beut);* **pyll***: Pyll-e- Madhe (*faqe kodre e pyllëzuar).Ky toponim na tërhoqi vëmendjen dhe,sipas A. Dhrimos, del në njëjës dhe në shumës në gjininë femërore në mjaft raste në Veri, në Shqipëri të Mesme dhe në Labëri.“Kjo është një trajtë e vjetër, e ruajtur vetëm në toponimi”[7], *Pylli i Dervenit* (në Grykë të Këlcyrës);**ftua***: Ftojëzat* (dikur ka pasur ftonj),**fier***: Thieret* (vend me fier); **ulli***: Ulliri i Setos;* **mbret***: Mbreti i Rrexhos***; vresht:** *Veshti i Çajupit***; vidh:** *Vidhëzat* (ara)*.*

4. Mikrotoponime që kanë në përbërje të tyre emra që shënojnë veprimtariekonomike, kulturore-historike etj.

Këtë grup mikrotoponimesh e kemi ndarë në disa nëngrupe:

- **Emra që lidhen me sipërfaqet blegtorale dhe bagëtinë, si**: *Çairet* (Klc), *Stani i Priftit* (Mbrzh), *Stanet e Grykës, Kasolle e Pelave* (Klc), *Stalla e Lopëve* (Klc), *Vathra* (Grab) etj.

- **Emra që lidhen me sipërfaqe bujqësore si edhe me ndonjë objekt që lidhet me kulturat bujqësore,** si: **arë**: *Arnije* (me kuptimin "shumë ara", "*arni* e *arnaje*, shumës kolektiv"[8]), *Ara e Gjatë, Arë e Madhe (Mbrzh), Arë e Plakës, Ara e Karajit* etj.; **fushë**: *Fusha e Këlcyrës, Fusha ePacomitit, Fushë e Varibopit* etj.; **gropë**: *Gropa e Muhametit, Gropa e Shalqinit* etj.; **lëmë**: Lëme (Klc), *Lëmi i Jahos* (Rib) etj.; **vresh**t: *Veshti* (Rib), *Veshti i Çajupit* (Mbrezhd); **hangar, koçek**: *Hangari* (Mbrezhd, Klc), *Koçekët* (Klc) etj.

a. Mikrotoponime që kanë në përbërje të tyre emra që lidhen me objekte nga veprimtaria ekonomike e njeriut, si: **fabrikë**: *Fabrikë e Rushit* (ndryshe edhe *Fabrikë e Sovjetit,* për shkak se u ndërtua nga sovjetikët në periudhën komuniste); **han**: *Hani, Hani i Beut, Hani i Ademit*. Një sinonim të *hanit* e kemi gjetur me këtë emërtim: *Konaku i Arabasë* (Klc) etj.; **mulli**: *Mulliri* (Gra, Klc, Mbrezhd), *Qafë e Mullirit* (Klc), *Mulliri i Beut* (Klc) etj.; **klub**: *Klubi i Beut* etj.; **pazar**: *Pazari i Kafshëve, Pazari i Vjetër*, *Pazari i Arixhinjve*. Shtojmë këtu edhe mikrotoponime të tjera, si: *Bonifikimi, Furrë e Vjetër, Grumbullimi, Samarana*<Samarhana etj., të cilat janë dëshmi të veprimtarisë ekonomike në një kohë të caktuar.

b. Emra që lidhenme rrugë dhe objekte të tjera të komunikacionit, si: **rrugë, ura, lundër** etj.: *Rrugët meDredha, Rruga nga Brigjet, Ura e Grykës ose Ura e Muço Hysit* (kjo urë lidhteKëlcyrën me Krahinën e Malëshovës dhe të Zagorisënëpërmje*t Shtegut të Pelës*), *Ura e Dhespotit (Kuq), Ura e Lanjës (Pisk), Pasarela, Lundra (Këll)* etj. Me interes është të përmendim edhe dromonimin *Udha e Karvanit*, e cila ka qenë një rrugë përgjatë malit të

[7] Dhrimo, Ali."Një vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Kurveleshit", në *Studime filologjike*, nr. 3/1974, f. 57.

[8] Topalli, Kolec. *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe.* Durrës, Bot. Jozef, 2017, f. 114.

Qarishtës, ku "fshatrat e Deshnicës komunikonin me Beratin, me Frashërin, si dhe për të shkuar në Korçë" (Q. Hadaj).

- **Emra që lidhen me objekte kulturore, shpirtërore dhe materiale të njeriut**

a. **Emra që lidhen me objekte sociale**, si: **gërmadhë**: *Gërmadhishtë*(Klc); **kala:** *Kalaja Ilire, Porta e Kalasë***, qytet:** *Qyteza* **(Kuq); saraje:** *Sarajet e Beut (Klc), Sarajet (Shtikë)***; me emra lagjesh:** *Mirovë, Rrëzë***,** (Mbrezhd),*Gur, Çarçi***,** *Qafë* (Klc)etj.; **me emra shtëpish:** *Shtëpitë e Qemalit,Shtëpitë e Buqve* (Bujqve - ka kuptimin: *çifçinj-ve,* bujk pa tokë që punonte te një çifligar dhe merrte një pjesë të prodhimit)etj.

b. **Mikrotoponime që lidhen me objekte kulturore, administrative, siç janë:** *Bashkia, Komuna, Shkolla 8-vjeçare, Shkolla e Mesme, Vatra e Kulturës etj.*

c. **Mikrotoponime që lidhen me objekte ushtarake,** si: **derven**: *Pylli i Dervenit* dhe *Dervene* (Klc); **karakoll (**vendrojë; truprojë): *Maja e Karakollit* (Klc); **repart**: *Reparti* (Klc);**polici**: *Policia e Vjetër;* **poligon**: *Poligoni (në disa vende);* **tabor (**batalion): *Tabor (Pisk)***; tunel**: *Tunelet* (në shumë vende) etj.

d. **Mikrotoponime që lidhen me objektet e kultit ose toka që janë emërtuar në bazë të tyre:***Kisha e Qelovës, Shëngjon<Shën Gjoni (Mbrzh), Shpjetër<Shën Pjetër.* Këta emra, të cilët burimin e kanë te trajtat latine *Joannes* dhe *Petrus*, duke iu përshtatur sistemit fonologjik të shqipes me zhvillimet e tyre, *"dëshmojnë përdorim të hershëm ndër shqiptarë dhe i takon shekujve të parë të erës sonë"*[9]. Mikrotoponimi *Shpjetër*, nga banorët quhetndryshe edhe *Vëndi' Mirë.* Shtojmë këtu edhe mikrotoponimet *Shën Konstandini, Shëmërtiret<Shën Martini* - "ky si emër duhet të ketë depërtuar në një periudhë më të vonë se emrat *Gjergj, Gjon* etj., por gjithsesi para depërtimit të huazimeve sllave"[10], *Shën e Diela* (Grab), *Shën e Premtja (Mbrezhd), Xhamia (Gur), Hasan Dedeja (*thonë se Mekami është ngritur mbi rrënojat e një kishe që ka ekzistuar më parë aty, ajo e Shën Janit* - kumtuar nga Sofokli Daka).

Shndërrimi i objekteve të kultit kristiane në ato islame është një praktikë e njohur gjatëpushtimit osman. *"Shumë prej objekteve të kultit, xhamitë e para të ndërtuara për t'iu shërbyer garnizoneve dhe administratës osmane, u ngritën me nxitim dhe pa pretendime, shpesh duke shndërruar kishat në xhami"*[11], *Manastiri (Mbrezhd), Shënkolli, Kisha (Rib), Kisha e Varibopit (arat ngjitur me të quhen Shënkollet), Kisha e Varrezave (Mbrezhd).*

e. **Mikrotoponime me fjalën *varr***: *Varrezat e Çoravës, Varret Italiane, Varri i Kaurit (Gry, Rib), Varrezat e Reja,Varri i Sabos, Varret e Vjetra ose Talla(h) [sipas kumtuesit A. Hadaj, "Talla(h)" ka kuptimin "Te Allahu - Te Zoti, vendi ku takohesh me Zotin".* Pra, sipas tij, kemi një përdorim eufemistik për fjalën*varrezë,* por ky interpretim qëndron i pabazë, padashur të spekulojmë me etimologjinë, për faktin se, në dijeninë tonë, nuk kemi toponime dhe mikrotoponime në trevat shqiptare që të kenë në përbërje të tyre fjalën "Allah".

f. **Mikrotoponime që lidhen me pronësinë**: **çiflig** (pronë toke e trashëgueshme e feudalëve). *Çifligjet* (në shumë vende); **vakëf** (pasuri e paluajtshme e një institucioni fetar): *Vakëfet* (Klc). Emri "çiflig", i cili gjendet në shumë mikrotoponime, ka marrë kuptime të tjera në gjuhën shqipe. Me "çiflig" kanë emërtuar: një arë të mirë që prodhonte shumë; një sipërfaqe toke që mund të punohej brenda ditës me një pendë qe; dhe me këtë emër, në zonën e Shpatit, "*njihen disa ndërtime solide me mure guri që kanëshërbyer kryesisht për strehimin e bagëtisë*".[12]

---

[9] Demiraj, Shaban. *Prejardhja e shqiptarëve.. .* T., Naimi, 2015, f. 138.

[10] Po aty, f. 141.

[11] Meksi, Aleksandër. *Arkitektura e xhamive të Shqipërisë.* T., Uegen, 2007, f. 25.

[12]Muka, Ali. "Vendbanimet dhe ndërtimet popullore në Shpat", në *Etnografia shqiptare*, nr. 13/1983, f. 215.

5. Etnonime dhe emra të përveçëm në përbërje të mikrotoponimeve

Në materialin e vjelë na rezultojnë këto etnonime: *arrixhi, evgjit, ilir, italian, vllah, suliot…*

Së dyti, në këndvështrimin **strukturor(përbërja morfologjike dhe fjalëformuese),** mikrotoponimet na paraqiten si emërtime të thjeshta dhe si emërtime të përbëra. Një numër i mirë i mikrotopnimeve, në materialin e vjelë, janë formuar drejtpërdrejt nga emra të përgjithshëm (apelativë), pa ndonjë ndryshim strukture. Të tillë i kemi ndeshur në: **emërtime lagjesh** (oikonimet) si: *Gur, Rrëzë, Qafë* etj; në **emërtime arash**, ku një pjesë emërtimin e kanë mbi bazën e një fitonimi si: *Bajamet, Bostani, Hurmat, Thiere*t etj; në emërtime **vendesh sipas konfiguracionit, relievit** ose sipas funksionit, si*Zalli, Lugjet, Furra, Çairet, Çifligje*t etj.

Disa prej mikrotoponimeve i ndeshim në numrin njëjës, trajta e pashquar *(Hos, Gjol etj)* e disa në trajten e shquar *(Faqja, Hija etj)*. Gjithashtu, ndeshim mikrotoponime në numrin shumës, trajta e shquar. Kjo është një karakteristikë që haset rëndom në sistemin toponimik të shqipes. Mënyrat dhe rrugët e emërtimit të vendeve në luginën e Vjosës, përkatësisht në zonën e studimit tonë, përgjthësisht janë ato të shqipes me të folmet e saj vendore.

Një prej mënyrave është ajo e prapashtesimit me prapashtesat: **-ëz**: *Breqjëz, Ftojëz, Mërqinjëz* etj; **-icë**: *Ngushticë*; **-ishtë/ishte***: Gërmadhishtë, Fiqishtë, Kumishte* etj; **-o**: *Xhuxho* (mendojmë se është një emërtim vendi prej nofkës "xhuxh". "Kjo prapashtesë "-o" u ngjitet disa emrave e mbiemrave të substantivuar, që shënojnë më fort një të metë trupore."[13] ; **-çinë**: *Gulçinë/Gurçinë, Rripçinë.* "Me këtë prapashtesë janë formuar emra prej pak emrash me kuptim zvogëlimi që herë- herë marrin edhe kuptim përçmimi."[14]

Mikrotopnime të përbëra të shprehura me sintagmat emërore të tipit:

Emër+emër në gjinore (që tregon përkatësinë apo ndonjë rrethanë historike-shoqërore me vlerë përcaktuese. "Ky, në të vërtetë, është tipi më i dendur apo mbizotërues në mikrotoponiminë shqiptare."[15]

Emër+mbiemër, që tregon madhësi, ngjyrë a cilësi tjetër, si*Ara e Madhe, Zenije e Vogël, Shkëmbi i Kuq* etj. Këto mikrotoponime krijojnë dhe lidhje antonimike midis tyre, por për të dhënë një tablo sa më të qartë dhe ilustruese të këtyre lidhjeve, do të na duhej të zgjeronim zonën e studimit, ku mund të shikonim se tipari i një mikrotoponimi, shënohet apo përligjet në opozicion me një tjetër.

Nuk mungojnë edhe mikrotopnime të shprehura me **sintagma foljore** si: *Ku bashkohen* (lumenjtë), *Ku lahen dërrat*.

Një vend tjetër zënë mikrotopnimet të cilët janë të shumta, të formuara me anë të **përngjitjes dhe kompozimit,** si*Shëmërtire, Shëngjon, Gjoshpat* etj.

Interesant paraqitet një mikrotoponim me rrënjë numërori, *Trelis*, i cili është një ndër tipat **numëror+emër** të dokumentuar herët në onomastikën tonë, siç është ai i oronimit të *Dimal*-it.[16]Si përfundim, me punimin tonë u përpoqëm të sjellim një kontribut modest në fushën e onomastikës për këtë pjesë të luginës së Vjosës. Materiali mikrotoponimik paraqitet mjaft i larmishëm edhe pse kemi të bëjmë me një zonë shumë të kufizuar në aspektin gjeografik. Emrat e vendeve shpesh përfaqësojnë një lidhje të ngushtë midis hapësirës dhe kohës, duke shërbyer si dëshmi e historisë dhe ndryshimeve shoqërore që një vend ka kaluar në periudha të ndryshme. Me kalimin e kohës, emrat e vendbanimeve, maleve, lumenjve, fushave etj, ndryshojnë,

---

[13] Xhuvani, A.; Çabej, E. "Prapashtesat në gjuhën shqipe", në *Xhuvani, Aleksandër,Vepra,*T., ASH, 1980, Vëll. 1, f. 521.

[14]Po aty, f. 459.

[15]Shkurtaj, Gjovalin.. *Onomastikë dhe etnolinguistikë,* T., SHBLU, 2001, f. 55.

[16]Kostallari, Androklli. "Kontribut për klasifikimin e tipave kryesorë të kompozitave", në *Studime filologjike,* nr. 3/1971, fq. 56.

shndërrohen apo përjetësohen, duke bartur gjurmët e ngjarjeve historike, kulturave dhe ndikimeve të ndryshme në to. Një toponim mund të mbartë brenda vetes kujtesën e një periudhe të caktuar historike, duke na ofruar një rrugëtim në kohë përmes gjuhës dhe historisë së popujve që kanë jetuar në atë hapësirë. Gjithashtu, këtu gjejmë mjaft të dhëna interesante jo vetëm në fushën e gjuhësisë, të historisë, natyrisht, por edhe të gjeografisë, antropologjisë, etnologjisë etj, të cilat, së bashku, mund të shërbejnë si një piketë orientuese në shërbim të turizmit.

Bibliografia

Demiraj, Shaban.*Prejardhja e shqiptarëve*, T., Naimi, 2015.

Idrizi, Xhemaludin.*Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit.*Shkup, Interdiskont, 2003.

Shqipëria mesjetare në toponamastikë dhe onomastikë. T., ASA, 2019.

Meksi, Aleksandër.*Arkitektura e xhamive të Shqipërisë.*T., Uegen, 2007.

Shkurtaj, Gjovalin.*Onomastikë dhe etnolinguistikë.*T., SHBLU, 2001.

Tase, Pano.*Fjalor dialektor.*T., Çabej, 2006.

Topalli, Kolec.*Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe.*Durrës, Bot. Jozef, 2017.

Xhuvani, Aleksandër.*Vepra,*Vëll.1.T., ASH, 1980.

Revista, periodikë:

Studime filologjike, (revistë), Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë të ASHSH-së. T., (1964-).

Etnografia shqiptare, (revistë), Instituti i Kulturës Popullore të ASHSH-së. T., (1962-).

Burime elektronike:

https://www.mnamon.it/la-mammorje-nghie-lo-locche/

TRADITA DHE MODERNITETI NË POEZINË E ILIRIAN ZHUPËS

Dr. Laureta Konomi
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
Email: laureta.dhoska@hotmail.com

Abstract
Ilirian Zhupa, one of the most inspiring poets of Albanian literature, stands out for the depth of his poetic spirit which paves the way for his verses towards modern and contemporary poetry. Through his poetry, Zhupa invites the reader on an emotional journey, where each verse has its weight and tells a deep and inexhaustible story. In his verses, we find a lyricism that goes beyond words, revealing the lost soul and finding what is universal in humans. Zhupa is not just a creator of poetry but a deep discoverer of the human mind. Through the use of strong images, he manages to touch the foundations of our senses, leaving a lasting impression on the reader. Many of his poems touch on themes related to national identity, history, and traditions, expressing love and pride for his country. He often uses images from nature to express feelings and thoughts, creating a close connection between humans and the surrounding environment. His poems are rich in literary imagery enriching his verses and giving them a deep poetic dimension. Many of his poems are introspective, offering a window into the poet's inner world and meditating on existential and philosophical questions. The depth of Zhupa's poetic soul appears in his ability to capture beauty, sadness, and joy, part of his life, and not only in unexpected and strong forms. Many of his creations reflect on time and often meditate on how the past affects the present and future, creating an ongoing dialogue. Maintaining simplicity and clarity in his expression makes it possible for the poems to be accessible and sensitive to different readers and for this poet to have a special place in contemporary Albanian literature.

Keywords: *poet, universal, inspirational, emotional, philosophical, contemporary*

Përmbledhje
Ilirian Zhupa, një ndër poetët më frymëzues të letërsisë shqiptare, shquhet për thellësinë e shpirtit poetik që i shtron rrugën vargjeve të tij drejt nje poezie moderne dhe bashkëkohore. Nëpërmjet poezisë së tij, Zhupa fton lexuesin në një udhëtim emocional ku çdo varg ka peshën e vet dhe thotë një histori të thellë dhe të pashtershme. Në vargjet e tij, gjejmë një lirikë që shkon përtej fjalëve,duke zbuluar shpirtin e humbur dhe duke gjetur atë që është universale te njeriu. I. Zhupa nuk është thjesht një krijues poezie, por një zbulues i thellë i mendjes njerëzore. Përmes përdorimit të imazheve të forta , ai arrin të prekë themelet e ndjeshmërisë sonë, duke lënë gjurmë thelbësore te lexuesi. Shumë nga poezitë e tij prekin tema të lidhura me identitetin kombëtar, historinë dhe traditat, duke shprehur dashurinë dhe krenarinë për vendin e tij. Ai shpesh përdor imazhe nga natyra për të shprehur ndjenja dhe mendime, duke krijuar një lidhje të ngushtë mes njeriut dhe mjedisit përreth.Poezitë e tij të pasura me një figuracion letrar pasurojnë tekstin dhe i japin atij një dimension të thellë poetic. Shumë nga poezitë e tij janë introspektiva duke ofruar një dritare në botën e brendshme të poetit dhe duke mediuar mbi pyetje ekzistenciale dhe filozofike. Thellësia e shpirtit poetik të Zhupës shfaqet në aftësinë e tij për të kapur bukurinë, trishtimin dhe gëzimin, pjesë të jetës së tij dhe jo vetëm, në forma të papritura dhe të forta. Shumë prej krijimeve të tij reflektojnë mbi kohën dhe shpesh mediton mbi mënyrën se si e kaluara ndikon në të tashmen dhe të ardhmen, duke krijuar një dialog të vazhdueshëm. Duke ruajtur një thjeshtësi dhe qartësi në shprehjen e tij, bën të mundur që kjo poezi të jetë e arritshme dhe e ndjeshme për lexuesit e ndryshëm dhe ky poet të ketë një vend të veçantë në letërsinë bashkëkohore shqiptare.

Fjalë kyçe: *poet, universal, frymëzues, emocional, filozofike, bashkëkohore*

Lindi në qytetin e Tepelenës në vitin 1957.Studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe dhe u diplomua në Institutin Pedagogjik të Shkodrës. Ka punuar për një kohë të gjatë si arsimtar, gazetar e botues dhe ka qenë ish-anëtar i degës shqiptare të Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut. Gjithashtu, ka qenë dhe botues i gazetës "Populli po". Ka botuar disa vëllime me poezi ku përmendim: Diell mbi kasketë,1978; Poezi, 1985; Mos më pyet ku kam qenë, 1988; Poema e Ëndrrës,1990; Të gjallë dhe të vdekur, 2015; Një ambasador në vetë të pare, 2016. Është nderuar me disa çmime dhe poezitë e tij janë përkthyer në disa gjuhë të botës.

Vetë poeti shprehet :

"Poeti duhet të bëjë atë që nuk e bën dot njeriu vetë. Dhe ta bëjë brenda njeriut.Ta bëjë në zemrën e tij, ta bëjë në ndërgjegjen e tij, ta bëjë në ndjesinë e tij. Dhe prandaj duhet t'i rrëfehet lexuesit"[1].

Hegeli e sheh poezinë si formë të veçantë të shprehjes. Në bazë të pasqyrimit konvencional të realitetit, qëndron një sistem simbolesh, përmasë e të cilave mbetet edhe misticizmi.

Në qoftëse do analizonim poezinë e Ilirian Zhupës do e shohim në tri drejtime kryesore:

1. vazhdimësinë e një standardi poetik të prekur më parë nga De Rada, Migjeni, Dritëroi, Kadareja, një trashëgimi të cilin ai e përdor me shumë mjeshtëri.

2. Perspektivën, ku përtej vargjeve të tij shohim mundësitë ku poezia shqipe mund të shkojë dhe sfidat që paraqet kjo detyrë.

3. Përmasën universale, duke u bërë jo vetëm një shprehje e shkëlqyeshme e kohezionit poetik kombëtar, por edhe një lidhje e fortë me universin poetik në përgjithësi.

Në të dy vëllimet e para poetike "Diell mbi kasketë" dhe "Poezi", paralelisht ndjejmë ndikimin e dogmave të realizmit socialist, por dhe tensionin midis lirisë së autorit dhe detyrës ndaj ideologjisë së asaj kohe. Një ideologji e cila vendosi në funksion të saj të gjitha llojet e veprimtarive materiale dhe shpirtërore të shoqërisë shqiptare, mes të cilave edhe shkencën , kulturën, artin në përgjithësi dhe letërsinë në veçanti. Një letërsi e cila u shpall pjesë e pandarë e zhvillimeve kulturore socialiste, e cila duhej të ishte një letërsi e re, e ndryshme nga ajo paraardhësë dhe në shërbim të ndërtimit të një shoqërie të re socialiste.[2]Në të tilla kushte ai është përpjekur të ketë një linjë të pavarur letrare dhe është munduar të shprehet dhe të ruajë një liri të caktuar ekspresioni brenda kufijve të ndaluar nga regjimi Veç poezive, si "Partisë", 1939, "Këngë për Tafil Buzin", "Mbas një beteje", "Maro Konda", Zhupa e shfaq ndjeshmërinë ndaj realitetit shoqëror, duke trajtuar tema që lidhen me jetën, natyrën, dhe dëshirën e lirisë individuale. Ndërsa formula e Realizmit socialist e cila përfshinte: pasqyrimin me besnikëri të jetës socialiste, me një përmbajtje socialiste dhe formë kombëtare, as ilustrim e as nxirje të realitetit, tendeciozitet klasor, një hero pozitiv pa të meta, që do të ishte modeli i cili duhej imituar, Zhupa gjendet në një sfidë artistike ndaj kësaj norme, duke përdorur poezinë si mjet për të shprehur emocionet dhe mendimet e tij personale dhe jo të përshkruante apo të glorifikonte vlerat e sistemit.[3] Përmendim: "Udhët e nëntokës", "Grimcat e qymyrit", "Diell, mbi kasketë" etj. Poeti nuk mjaftohet me vëzhgimin e shtresës së jashtme të botës. Me një finesë të hollë ai sjell një freski poetike të pasur me shpirt, thjeshtësi dhe natyrshëmëri duke e shtrirë poezinë në horizontin e një letërsie të re, moderne duke realizuar një hapësirë të padukshme, fokusuar në intimitetin dhe vëmendjen personale të poetit, e cila drejtohet nga thellësia e vetëdijes së tij.

Kjo poezi e përforcoi kuptimin dhe ndjeshmërinë e lexuesit në mënyrë të veçantë, duke u bërë një ekspresion i pasur dhe më thelbësor i përjetimit individual."Vjeshtë Lukove","Dashuria jonë për tokën", "Mall kurbeti" etj.

Me vëllimet poetike "Të gjallë dhe të vdekur", "Mos më pyet ku kam qenë", siç e cilëson edhe

[1]I. Zhupa. Mos më pyet ku kam qenë. Tiranë, 2016, fq, 4.

[2]Roland Zisi. Studime Kritiko letrare për Letërsinë Shqipe. Tiranë, 2015.

[3] Roland Zisi. Letërsi bashkëkohore shqipe. Tiranë, 2008.

poeti Petrit Ruka, "Iliri qe ndër të parët që prishi rregullin e atributeve që i merrnin vetëm flokëthinjurit, të regjurit me mjeshtërinë e poezisë"4.

Duke shfaqur ndjenja ndaj kontrasteve të thella dhe dualitetit të jetës, shprehur nëpërmjet një reflektimi të thellë mbi ekzistencën njerëzore, poeti përpiqet të kuptojë botën dhe të sjellë një tis filozofik në poezinë e tij. Melankolia dhe nostalgjia, vetmia, izolimi, ndjenjat e përgjumura dhe klithmat "heshtur si gurët" dhe "klithur si shpendët" shënojnë momente kulmore duke eksploruar misterin e ekzistencës dhe krijimit. Me një stil biblik dhe me një naivitet poetik, Zhupa shpalos një vizion të botës dhe marrëdhënies së njeriut me misteret e qenies.

Përmendim: "Zotat u ngjitëm në qiell', "Orëve të mbrëmjes", "Ëndërr për duart e tua", "Fate të trishtë"etj.

Zotat u ngjitën në qiell

Zotat u ngjitën në qiell dhe s'dinë më të zbresin,

Kanë frikë mos dheu nga lindën është dheu ku duhet

Të vdesin.5

Ndjenjat e theksuara të poetit ndaj kombit dhe përvojave njerëzore, së bashku me revoltën shpirtërore ndaj kohës, shpesh e shtyjnë atë drejt emocioneve të forta, duke filluar nga malli dhe deri te zemërimi. Në këtë kontekst, ai si mbartës dhe tejçues i elmenteve më të mira të traditës të cilat mbeten tharmi i pazhbëshëm i letërsive kombëtare, jo vetëm sjell një krijimtari të re, por edhe riaktualizon.

Kombi im

Kombi im,

Të kam komb në fyt.

As të vjell dot,

As të gëlltit..

Manekinët

Rrimë në vitrinë..

Na veshin,

Na zhveshin, na fshijnë…

Ne presim të qetë dhe heshtim,

Se jemi manekinë.

Vrapojnë në rrugë nga shiu

Këmbë burrash

Grash

Dhe fëmijësh.

Ne s'lagemi kurrë…(mjerë njeriu, që s'njeh qetësi manekinësh!)6

Ilrian Zhupa shpalos në poezinë e tij një reflektim të thellë mbi ekzistencën njerëzore dhe sfidat që ajo përfshin. Me një vështrim të thellë filozofik, Zhupa analizon marrëdhënien midis individit dhe botës, duke adresuar pyetje thelbësore për qëllimin dhe kuptimin e jetës. Në poezinë e tij është e dukshme një empati e veçantë, e cila e bën lexuesin të ndihet i lidhur

4 Gazeta "Telegraf". Tiranë, 2016.

5 I. Zhupa. Zotat u ngjitëm në qiell, vëllimi poetik"Të gjallë dhe të vdekur". Tiranë, 2015, fq.15.

6I. Zhupa. Mos më pyet ku kam qenë, Tiranë, 2016, fq, 14.

ngushtë me vargjet drejtuar kah një universi mendimi dhe ndjenjash fine. Diskursi poetik, kodet gjuhësore përshkruhen si një tharm i hyjnorit dhe tokësorit, duke pasuruar krijimtarinë e poetit me një fuqi dhe ndikim që shpreh vlerat dhe ndjenjat në një harmoni të përkryer. Kjo krijon një eksperiencë letrare të pasur dhe një tendencë provokuese poetike që herë turbull dhe herë qartë e çon poezinë drejt një perspektive shmangieje nga reaizmi socialist dhe duke e vendosur në peizazhin e poezisë moderne shqiptare.

Mos më pyet ku kam qenë

Mos më pyet ku kam qenë

Vij nganjë vdekje!

Një mik iku mbi një anije të kuqe me ca

Vela të bardha….

Dhe mbeti në fytyrën time të zbehtë.[7]

Përmes lirizmit Zhupa shfaq një aftësi të jashtëzakonshme për të kapur emocionet e ndryshme dhe për t'i shprehur ato nëpërmjet fjalëve. Përdorimi i imazheve poetike i jep poezisë së tij një thellësi dhe dimension të shtuar, duke e bërë atë jo vetëm një përshkrues i situatave, por edhe një shpallës i ndjenjave dhe mendimeve të thella shpirtërore.Vargjet e tij shquhen për një ngjyrim të pasur emocional dhe një liri shprehjeje që tejkalon kufijtë e zakonshëm, i gjallë, tronditës, jetëshërues dhe ndonjëherë vdekatar. Ai lartëson individin në emër të dashurisë njerëzore dhe hyn në një dialog imagjinar, duke ndarë me lexuesin ndjenjat e tij altruiste, paqësore dhe natyrore.

Mos më pyet ku kam qenë,

Përgjigjen e saktë e ke para.

Lexo fytyrën time, shprehjen e saj dhe hesht…

Vij nga vdekja!

Lirika e dashurisë ka qenë një sfidë për poezinë e realizmit socialist. Edhe pse kishte tendencë të përqendrohej te ndërtimi i shoqërisë së re dhe te heronjtë e punës, dashuria mbetej një temë e pranishme dhe e rëndësishme.Një dashuri e pastër, e ndershme, e bashkuar me idealet e larta të punës dhe përkushtimit ndaj atdheut. Shpesh, personazhet gjenden të ndarë midis ndjenjave të tyre personale dhe detyrës së tyre ndaj shoqërisë, aq sa janë të gatshëm të sakrifikojnë gjithçka për këto ideale. Heronjtë përballen me sfida të ndryshme dhe dashuria e tyre mbetet gjithmonë në përputhje me misionin e tyre ideologjik. Pra një dashuri dhe personazhe lirike që gjenden mes idealizmit dhe përkushtimit, mes ndjenjës dhe konfliktit. Ilirian Zhupa, i njohur për mënyrën se si trajton tematikat e ndjeshme dhe personale në poezitë e tij, u përpoq ta trajtojë këtë temë duke abstraktuar dhe duke zhvendosur kuptime e atribute, gjithmonë duke e ndërthurur me natyrën. Mungesa e dashurisë e cila shpesh shprehet përmes motiveve të vetmisë, mallit , ndarjes dhe vuajtja e dashurisë së humbur, shpërndahen me një delikatesë poetike dhe shprehje të pasura lirike, duke e bërë atë një temë tërheqëse dhe frymëzuese. Kjo mungesë përcillet me një ndjesi fine,duke e bërë heroinën lirike të përqafueshme dhe të pasur me vlera dashurore.

Era fishkëllen në rrugë e unë flas me erën,

Pemët që përhiten në mbrëmje,

janë zjarre që shuhen ngadalë.

[7] I, zhupa",Mos më pyet ku kam qenë", botimet Toena, Tiranë, 1988, fq18

Moderne për nga përjetimi i mprehtë, tradicional për nga aspekti narrativ, ndjenja erotike e unit lirik është vuajtje , drithërimë në shpirt, nostalgji dhe ndjeshmëri për atë që nuk është më. Poezia organizohet si një monolog me një rrjedhë të koklavitur mendimi e arsyetimi, që ndonjëhere nuk synon zgjidhjen, por të arrijë të bëjë të prekshëm imazhin. Poeti arrin të komunikojë kompleksitetin e ndjenjave njerëzore dhe të krijojë një poezi që prek zemrat e lexuesve.

Borxhet e dashurisë

Jam veshur hollë në këtë botë të ndjeshme,

Gjithkush që më do ma hollon veshjen…"[8]

Shpesh ke vonuar të vish te unë,

Dhe ma ke lënë pritjen

Si atë shkollarin e heshtur,

Me duart mbi gjunjë.

Kaq shumë më ke pritur.

Po si më ke pritur?

Pemët mbinë, u rritën dhe u thanë përsëri

Krahët t'u harkuan, gati të thyheshin në një ndjenjë

Përqafimi.[9]

Zhupa është poeti i cili tërhoqi vëmendjen e lexuesit me bashkëveprimin dhe korrelacionet me natyrën, duke e trajtuar këtë mit në një mënyrë të moderuar dhe specifike dhe duke shfaqur një vëzhgim të mahnitshëm dhe një lirizëm të veçantë në vargjet e tij.

E përshkruar mes meditimit, mes detajeve të gjalla, natyra e Ilirian Zhupës, mishëzohet e ngjyrosur kryesisht me ngjyrën e kuqe të flakëve dhe të gjelbrën. "Prania e mitit të pyllit, detaj i cili rimerret i përsëritur si imazh i shpirtëzuar nëpërmjet lëkundjes së kurorave të pemëve apo lëkundjeve të degëve mund të shihet si një përftesë e qëllimshme dhe sendërtuese e magjikes. Aq të shumta janë në substancën letrare të këtij poeti këto detaje sa kthehen në një prani edhe kur janë të papranishme."Pemët", "Jo vetëm gjethet",

Pemët

Pemët më pritën me fjalë të ngrohta ,

Të ëmbla

Si babai dhe nëna![10]

Lidhja e thellë dhe të ngrohtë që ka me vendlindjen shpesh shfaqet në poezitë e tij si një temë e rëndësishme dhe frymëzuese për këtë poet. Vendlindja për të është burimi i identitetit dhe kulturës së tij, një vend që i ka dhënë formë asaj që është dhe si e sheh botën. Kjo lidhje e thellë reflektohet përmes imazheve të pasura dhe ndjenjave që ai shpalos në poezitë e tij. Vendlindja për poetin nuk është thjesht një hapësirë gjeografike, por një realitet që ndikon thellë në shpirtin

[8] I. Zhupa. "Borxhet e dashurisë", vëllimi poetik "Mos më pyet ku kam qenë". Tiranë, 1988, fq, 109.

[9] I. Zhupa . Mos më pyet ku kam qenë. Tiranë, 1988, fq, 109.

[10] I. Zhupa. "Pemët", vëllimi poetik "Mos më pyet ku kam qenë". Tiranë, 1988, fq,22.

dhe krijimtarinë e tij. Kujtimet e fëmijërisë në vendlindje janë të gjalla dhe të fuqishme. Peizazhet natyrore të përshkruara prej tij, ngjarjet dhe njerëzit që e kanë rrethuar, krijojnë një ndjenjë nostalgjie dhe lidhjeje të fortë emocionale.

Qyteti dhe ritmet e tij përçojnë ditë të zkonshme dhe situata po aq të zakonshme ekzistenciale të njerëzve duke u veshur me një ves drite, lumturie dhe shprese për një të ardhme më të mirë.

Një shpend që këlthet nëpër erë,
Nuk është shpend, është njeri,
A s'jemi të gjithë nga pak,
Në klithmën dhe vrullin e tij?![11]

Adhurimi dhe përmallja për vendlindjen del i përsëritur disa herë përmes imazheve të maleve, lumenjve, fushave dhe qiellit për të krijuar një atmosferë të veçantë që reflekton bukurinë dhe qetësinë e vendit të tij të lindjes. Poezia "Baladë për Vjosën dhe për vete" dhe poema "Lumi im" janë dy krijime ku vihet në dukje lidhja e autorit me lumin Vjosë. Në traditën letrare, lumenjtë si elemente natyrore, kanë luajtur një rol të rëndësishëm duke simbolizuar aspekte të ndryshme të jetës njerëzore dhe të mjedisit të tyre. Poeti mund të ketë përdorur Vjosën si një subjekt, duke lidhur ngjarjet dhe ndjenjat e tij me ngjarje historike ose figura të tjera simbolike. Poeti e përdor detajin e lumit si një simbol të rrjedhjes së jetës, kalimit të kohës, pastrimin dhe rigjenerimin e shpirtit, por edhe ndryshimit të fatit. Vjosa, për poetin, mund të përfaqësojë edhe kufijtë midis botëve të ndryshme, udhëtimin shpirtëror dhe ndryshimin dhe ndikon në zhvillimin e ngjarjeve dhe ndjenjave të autorit.

Baladë për Vjosën dhe për vete

Zhurmon e buçet e shket nëpër gurë
Dhe krua dhe det dhe grua dhe burrë;
Dhe këngë e pathënë që do të ushtojë
Dhe vajzë që pret me frikë të dëgjojë;
Dhe kalë jelebardhë që brigjeve rend
Dhe brymë e mardhur dhe erë dhe shpend.
Dhe kalë jelekbardhë që brigjeve rend
Dhe brymë e mardhur dhe erë dhe shpend.[12]

Lumi Vjosa, si një element kryesor në peizazhin shqiptar, përbën një ngjarje të rëndësishme dhe hap shtigje për kuptimin dhe interpretimin e jetës. Poeti përdor këtë element natyror për të përshkruar udhëtimin personal dhe zhvillimin e tij si një bashkëveprim me botën rrethuese si dhe shpalos një perceptim të thellë dhe filozofik të jetës dhe ekzistencës. Shpesh, poeti identifikohet me Vjosën, ashtu si dhe vargjet e tij, të cilat vijnë ëmbël, pastaj rrëmbyeshëm, më pas të lënë të mendohesh derisa të merr rrjedha e mendimit dhe të çon në universin e natyrës. I gjithë botëkuptimi i tij shprehet në një baladë që të mbush shpirtin me muzën dhe ndjeshmërinë e vargut,por padyshim dhe mendimit që e shoqëron gjithë poemën.

Si përfundim, Zhupa nuk është vetëm një pasardhës në poezinë shqipe, por një kreator që përmbush detyrën e tij me misionin e një mjeshtri të vëmendshëm. Ai përdor elemente të pasura

[11] I. Zhupa. "Pemët", " vëllimi poetik "Mos më pyet ku kam qenë". Tiranë, 1988, fq.19.

[12] I. Zhupa. "Baladë për Vjosën dhe për vete", vëllimi poetik"Mos më pyet ku kam qenë". Tiranë, 1988, fq. 5.

të traditës për t'i vendosur më pas në një kontekst të ri dhe modern. Kjo qasje i jep lexuesit një ndjenjë të përhershmërisë dhe një lidhje të fortë me rrënjët kulturore, ndërsa e prezanton atë me perspektiva dhe mendime të reja.Kjo poezi është një kërkim i hollësishëm i problematikave personale, duke u përqendruar në ndjenjat, emocionet dhe reagimet e ndërgjegjshme. Një poezi që përshkruan, ndjek dhe interpreton me një vëmendje të veçantë pasqyrën e brendshme të individit ku, në vend që të shfaqë tone të larta dhe fantazi të mbërthyera, ajo qëndron pranë realitetit, shpreh dhe reflekton një vëzhgim të thellë të jetës. Zhupa përdor një stil të lirë dhe eksperimentues, duke shpërbërë strukturattradicionale të poezisë dhe duke eksperimentuar me forma të reja. Kjo qasje i lejon atij të shprehë kompleksitetin dhe ndërlikimet e përvojës njerëzore në një mënyrë më të plotë dhe autentike. Ilirian Zhupa e ripërmirëson traditën letrare me një delikatesë dhe përkujdesje të veçantë, duke e vendosur çdo fjalë si pllakë në mozaikun e krijimtarisë së tij. Duke u thelluar në mendimet dhe ndjenjat më të brendshme të njeriut, ai kombinon ndjeshmërinë e thellë poetike me një inteligjencë të mprehtë, duke krijuar vepra që janë si estetikisht të kënaqshme, ashtu edhe mendërisht stimuluese.

Bibliografi

I. Zhupa. Mos më pyet ku kam qenë. Tiranë, 1988.

I. Zhupa. Mos më pyet ku kam qenë. Tiranë, 1988.

I. Zhupa. Të gjallë dhe të vdekur. Tiranë, 2015.

Gazeta "Telegraf". Tiranë, 2001.

Sabri Hamiti. Letërsia moderne shqipe, 2009.

Roland Zisi. Studime kritiko- letrare për Letërsinë Shqipe. Tiranë, 2015.

Sabri Hamiti. Studime letrare. Prishtinë, 2004.

Roland Zisi. Letërsi bashkëkohore shqipe. Tiranë, 2008.

PËRSHKRIM I RASTEVE TË KONTAKTIT GJUHËSOR MES SHQIPES DHE GREQISHTES NË FJALORIN TEKNIK

Dr. Eljana Kokalari, Msc. Valentina Boboli
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri, ekokalari@uogj.edu.al
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri, vboboli@uogj.edu.al

Abstract

The Albanian language's lexical system has been significantly influenced by recent social and economic developments; we will highlight the new terms in the Albanian language's technical and professional lexicon. The paper's goal is to present the findings of observations made regarding lexical changes brought about by the influence of a different language system, respectively, the Greek language. These words have filled in the gaps in the Albanian lexical system after the 90s regarding new words used in the technical vocabulary.

Considering the terminology used by numerous Albanian emigrants who have returned from Greece, where they worked for several years as electricians, carpenters, plumbers, welders, mechanics, etc., the study is mainly centered in the Gjirokastra region. About 120 professionals in the field were interviewed to get the information needed concerning the language they use daily. The approaches and corresponding lexical contexts are taken into consideration while analyzing and classifying the results. This study is a preliminary step toward a larger focus on the need to provide the necessary words for Albanian technical vocabulary.

Keywords: *language contact, borrowing, technique, Greek, professional*

Përmbledhje

Sistemi leksikor i gjuhës shqipe është ndikuar ndjeshëm nga zhvillimet e fundit shoqërore dhe ekonomike; do të veçojmë termat e rinj në leksikun teknik dhe profesional të gjuhës shqipe. Qëllimi i kësaj kumtese është të paraqesë gjetjet e vëzhgimeve të bëra në lidhje me ndryshimet leksikore të shkaktuara nga ndikimi i një sistemi të ndryshëm gjuhësor, gjuhës greke. Këto fjalë kanë plotësuar boshllëqet në sistemin leksikor të shqipes pas viteve '90 në lidhje me fjalët e reja të përdorura në fjalorin teknik.

Nisur nga terminologjia e përdorur nga emigrantë të shumtë shqiptarë të sapokthyer nga Greqia, ku kanë punuar për disa vite si elektricistë, marangozë, hidraulikë, saldatorë, mekanikë etj., studimi është përqendruar kryesisht në qarkun e Gjirokastrës. Rreth 120 profesionistë të fushës u intervistuan për të marrë informacionin e nevojshëm në lidhje me gjuhën që ata përdorin në baza ditore. Gjatë analizimit dhe klasifikimit të rezultateve merren parasysh qasjet dhe konteksti leksikor përkatës. Ky studim është një hap paraprak drejt një fokusimi më të madh në nevojën për të siguruar fjalët e nevojshme për fjalorin teknik të shqipes.

Fjalët kyçe: *kontakti gjuhësor, huazime, teknike, greke, profesionalizma*

Hyrje

Kur gjuhët vijnë në kontakt, atëherë do të përftojmë fenomene të ndryshme gjuhësore mbi të cilat mund të punojmë dhe analizojmë aspekte të ndryshme të gjuhës. Rezultatet e kontaktit gjuhësor përfshijnë mekanizma të tillë si *ndryshimi i gjuhës* (në të cilin folësit priren të kalojnë nga përdorimi i një varieteti ose gjuhe të zakonshme me regjistër më të ulët në një përdorim gjuhe me regjistër më të lartë), *ndërrimi i kodit* (që përfshin alternimin e dy gjuhëve brenda një fjalie të vetme), *mekanizmin e alternimit të kodit të ndërhyrjes* në të cilën folësit dygjuhësh përdorin njërën nga gjuhët e tyre në një mjedis të caktuar dhe gjuhën tjetër e përshtatin në një mjedis krejt të ndryshëm nga i mëparshmi, *krijimi i gjuhës* si Pidgin dhe Creole, të folme të përziera dygjuhëshe, *difuzion strukturor* ose *konvergjencë strukturore* e cila mund të ndodhë kur

gjuhët janë në kontakt të gjerë, afatgjatë apo edhe *vdekje gjuhësore* që ndodh kur ndryshimi i gjuhës përfshin grupin e fundit të mbetur të folësve të një gjuhe në një vend të caktuar, zakonisht të izoluar (Sabir, 3). Por rezultat kryesor i kontaktit gjuhësorështë *huazimi*.

Sapir (1921: 2) thekson se lloji më i thjeshtë i ndikimit që një gjuhë mund të ushtrojë në një tjetër është "*huazimi*". Gjuhëtarë të ndryshëm kanë dhënë përkufizime të ndryshme për sa i përket kuptimit dhe procesit që ndodh me huazimin. Në fjalë të thjeshta nënkupton që një gjuhë merr elemente gjuhësore nga një gjuhë tjetër dhe i bën ato pjesë të pandashme të një gjuhe të caktuar. Huazimi, gjithashtu, përkufizohet si ndryshimi gjuhësor i një njësie të caktuar që ndodh për shkak të ndikimit gjuhësor të një sistemi në një tjetër. Ky proces tregon se popujt që kanë qenë / janë fqinjë ose kanë pasur marrëdhënie historike, ekonomike, apo kulturore mes tyre, kanë shkëmbyer dhe pasuruar gjuhët e tyre me fjalë dhe shprehje, për të plotësuar nevojat gjuhësore.

Huazimi i fjalëve nga gjuhë të tjera në shqip është një proces normal dhe i vazhdueshëm, i cili ka ndodhur ndonjëherë edhe kur për të njëjtat koncepte kemi pasur fjalë ekzistuese. Megjithatë, huazimi leksikor ndodh në rrethana të caktuara historike dhe gjuhësore, edhe kur në shqip ekziston një term për të njëjtën fjalë ose koncept. Kur fjalët e huazuara nuk hyjnë në gjuhë së bashku me sendet dhe konceptet e reja, por përdoren paralelisht si sinonime me fjalët vendase, kemi të bëjmë me huazime gjuhësore (Thomai, 2011).

Për shkak të nevojave urgjente në përdorim dhe mungesës së njohurive të mjaftueshme të leksikut popullor, janë huazuar shumë fjalë nga disa gjuhë të ndryshme. Këto fjalë, të cilat janë quajtur me të drejtë fjalë të huaja për t'i dalluar nga huazimet që janë tashmë mirë të integruara në sistemin leksikor të gjuhës, shfaqen jo vetëm si terma teknikë, por edhe si pjesë e leksikut të përgjithshëm. Kjo dëshmon për përhapjen e tyre. Për ata që nuk i njohin mirë ose i njohin fare pak, këto fjalë të reja, të cilat nuk i përdorin në vend të fjalëve të huaja që janë mësuar të përdorin më parë, shfaqen për një periudhë të caktuar si neologjizma në gjuhë (Vehbiu, 1986). (Në këtë pikëpamje ato dallojnë nga neologjizmat e mirëfilltë të gjuhës, që janë "fjalë ose shprehje" që kanë hyrë së fundmi në gjuhë për të shënuar një send a një dukuri të re që ende ndihet si e tillë dhe që ndërtohen me lëndën e gjuhës amtare).

Huazimi është një shembull i fenomenit të përgjithshëm të neologjizmit dhe, për më tepër, të ndryshimit gjuhësor. Ai përfaqëson një nga mjetet që gjuhët përdorin për t'u rifreskuar. Duhet, gjithashtu, të theksojmë aspekte lidhur me dukuri të rëndësishme, siç është riprodhimi i funksioneve të njëjta semantike dhe krijimi i lidhjeve të caktuara leksiko-semantike mes njësive leksikore "autoktone" dhe huazimeve që depërtojnë në sistemin e gjuhës shqipe.

Në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore, sipas profesionit, hasim shtresa fjalësh që janë të njohura dhe të përdorura vetëm nga grupe specifike njerëzish, si punonjësit dhe specialistët që merren me një punë të caktuar (Thomai, 2011). Një vend të veçantë në gjuhë, veçanërisht në ligjërimin e thjeshtë dhe më pak në atë bisedor, zënë shprehjet me prejardhje nga të folmet profesionale, të cilat do t'i trajtojmë më poshtë. Synimi ynë është të nxjerrim në pah një lidhje që ekziston mes këtyre profesionalizmave të huazuara nga gjuha greke dhe njësive të tjera leksikore të sistemit të shqipes, që është ai i sinonimisë pak a shumë të plotë. Kjo do të thotë se kuptimet leksikore të këtyre njësive përputhen nga denotacioni, ashtu edhe në vlerën konotative dhe përdorim (distribucion) (Jorgaqi, 1998). Madje, po të shkojmë më tej, mund të themi se ekziston një simetri e plotë edhe ndërmjet strukturave kuptimore të shumë prej këtyre njësive.

Në këtë studim, do të përqendrohemi në disa shembuj të huazimeve nga greqishtja që janë pjesë e fjalorit teknik të përditshëm të shqipes. Ky hulumtim është mbështetur në gjuhën teknike të specialistëve të fushave të ndryshme që punojnë në jug të vendit. Termat profesionalë që përdorin në punën e tyre të përditshme janë fjalë të huazuara nga greqishtja për të plotësuar kërkesat e tyre profesionale.

Huazimet nga greqishtja

Në fjalorin e gjuhës shqipe fjalët e huazuara nga greqishtja janë ndër më të hershmet. Për shkak të afërsisë gjeografike, huazime të tilla hynë në shqipe që nga shekulli VIII para erës sonë. Në përgjithësi, këto fjalë greke lidhen me fusha shoqërore dhe botanikën. Huazime leksikore nga greqishtja e periudhës bizantine dhe kohës së re kanë depërtuar kryesisht në jetën shoqërore, artizanat, shtëpiake, kopshtari etj. Gjuhëtari Jani Thomai vëren se një pjesë e madhe e këtyre huazimeve leksikore nga greqishtja janë ruajtur në dialekte të ndryshme si krahinorizma (Thomai, 2011).

Mendojmë se brenda këtij kuadri krahinorizmash po zhvillohen shumë fjalë dhe shprehje të fjalorit teknik në një rrafsh të sigurt. Kjo dukuri është përhapur veçanërisht pas rënies së komunizmit, kur ndryshimet sociale, ekonomike dhe politike ishin thelbësore. Shqipëria kaloi një tranzicion të vështirë duke dalë nga regjimi komunist me mungesa të theksuara në fusha të ndryshme veçanërisht në shërbime, infrastrukturë, teknologji dhe prodhim; gjithashtu, gjuha në përdorim vuante edhe nga mungesa në fjalorin përkatës teknik. Ishte gati e pamundur që fjalori i përdorur para viteve '90 të mbulonte të gjitha fenomenet, aktivitetet dhe urbanizimin që u zhvillua pas vitit 1990. Si rrjedhim, hyrja e fjalëve të reja në gjuhën shqipe ishte një proces natyral, i domosdoshëm dhe i pashmangshëm. Shumë fjalë të huaja pasuruan fjalorin e shqipes si huazime e, për më tepër, për shkak të kontaktit gjuhësor hynë në përdorim fjalë të tjera, ekuivalentet e të cilave mund të gjendeshin me lehtësi në gjuhën shqipe.

Emigracioni drejt vendeve të Bashkimit Evropian dhe me tej ishte një nga faktorët kryesorë që ndikoi në prurjen e fjalëve të huaja në shqip. Shumica e shqiptarëve që udhëtuan kryesisht në Greqi sollën jo vetëm ndihmë ekonomike, por edhe shumë fjalë dhe shprehje nga krahinat ku jetonin dhe punonin, duke i bërë ato pjesë të përditshme të fjalorit të tyre.

Sferat e leksikut që janë hapur ndaj ndikimit grek në gjuhën shqipe kanë qenë të shumta. Një sferë që është ndikuar dukshëm, siç përmendëm më parë, është ajo teknike. Përdorimi i fjalëve teknike ose profesionalizmave në jetën e përditshme tregon për një përdorim aktiv të këtyre elementeve brenda sistemit të shqipes.

Ne do të përqendrohemi në fjalorin teknik të përdorur kryesisht në jug të Shqipërisë (Qarku Gjirokastër), ku kemi kryer vëzhgime dhe intervista me punëtorë e specialistë që ushtrojnë profesionin e tyre në teknika të ndryshme në këtë qark. Ndër ta mund të përmendim pllakashtrues, suvatues, elektriçistë, hidraulikë, mekanikë, drugdhendës, marangozë, saldatorë etj. Gjithashtu, kemi intervistuar shitës të pajisjeve elektrike, hidraulike dhe të fushës së ndërtimit, të cilët kanë pohuar përdorimin e terminologjisë së huazuar nga greqishtja nga specialistët e fushave të ndryshme. Këta specialistë, të cilët kërkojnë të blejnë mjetet e tyre të punës në greqisht, janë kryesisht ata që kanë ushtruar profesionin e tyre në Greqi. Kështu, në fjalorin teknik, veçanërisht në qarkun e Gjirokastrës, do të hasim fjalë të huaja, si:

Në fushën e pllakashtruesit kemi veçuar këto terma:

Përdorimi në shqip	**Përdorimi në greqisht**	**Përdorimi ekuivalent në shqip**
Kolis	Κολλάω	Ngjit
Pllakaqe	Πλακάκια	Pllaka
Pllakë	Πλάκα	Dërrasëguri
Zuba	Ζουμπάς	Turjel
variopulla	Βαριοπούλα	matraka
Skafë	Σκάφη	Magje
sufatopi	Σοφατεπί	-
Murello	Μορέλο	-
Armo	Αρμός	-

meremete	Μερεμέτια	meremetim
Rihtis	Ρίχτης	-
Mistri	Μυστρί	Mistri
Spatula	σπάτουλα	shpatull
shtokarim	στοκάρισμα	Patinim

Në Fjalorët e Gjuhës Shqipe (2006 / 2020) mund të gjejmë ekuivalentin e shumë prej këtyre fjalëve e termave që përdoren në gjuhën greke, dhe, për më tepër, disa prej këtyre huazimeve kanë hyrë në shqipe bashkë me mjetet e punës dhe aktivitetin përkatës. Kjo është identifikuar nga intervistat e marra nga dyqanet e pajisjeve të punës, ku shitësit pohojnë se shpesh hasen me termat ekuivalente të këtyre mjeteve. Duhet shtuar se ky fenomen nuk haset vetëm në fjalët me prejardhje nga greqishja, por gjithashtu edhe me fjalë ekuivalente nga italishtja apo anglishtja (kryesisht për mjete që kanë lidhje me rrjetin ose telefoninë) në varësi me vendin ku është ushtruar profesioni ose është përdorur mjeti përkatës.

Në fushën e drugdhendësit dhe marangozit kemi veçuar këto terma:

Përdorimi në shqip	**Përdorimi në greqisht**	**Përdorimi ekuivalent në shqip**
Skalis	Σκαλίζω	Gdhend
Sqepar	σκεπάρνι	Sqepar
Trapezari	τραπεζαρία	Tavolinëdhekarrige
Trivia	τριβείο	Zmerilues
Ikonostase	εικονοστάσιο	Ikonostas
Gonjastër	γωνιάστρα	Gone
Prioni	πριόνι	Pare
Ruter	ρουτερ	Ruteri
Freza	φρέζα	Plug
Vida	βίδες	Vidhë
Medese	μεντεσέδες	Mentesha

Drugdhendës, Marangoz

Përfushën e saldatorit dhe të mekanikut kemi veçuar këto terma:

Përdorimi në shqip	**Përdorimi në greqisht**	**Përdorimi ekuivalent në shqip**
Qillodhoko	κιλοδοκό	Profilhekuri
Llamë	λάμα	-
Kofti	κόπτης	Prerës
Upa	ούπα	-
Karavola	καράβολα	Lule
Pundo	πούντα	-
Troho	τροχός	Sharrëdisk
Kollauzo	κολαούζο	Masiofiletimi
ilektrosynkollitis	ηλεκτροσυγκολλητης	saldator elektrik
Modadhor	μονταδόρος	Saldator
cimbidha e elektrodave	τσιμπίδα ηλεκτροδίου	pincë e saldatriçes
Disqe	δίσκοι	Disk

Pensa	πένσα	Pincë
kobreser ajri	κομπρεσέρ αέρα	kompresor ajri
Grillo	γρύλος	Kriko
Tripodha	τρίποδα	Trekëmbësh

Për fushën e elektriçistëve dhe të hidraulikëve kemi veçuar këto terma:

Përdorimi në shqip	**Përdorimi në greqisht**	**Përdorimi ekuivalent në shqip**
Pinaka	ηλεκτρικόςπίνακας	Kasetëelektrike
Prizasuko	πριζασούκο	Prize
Termosifon	θερμοσίφωνας	Bolier
Tanala	τανάλια	Dare
tripankrustiko	κρουστικότρυπάνι	Trapano
Asfalie	ασφάλεια	Automat
Gonia	γωνία	Bërryl
Taf	ταφ	T
Mufa	μούφα	Manikota
Valvidha	βαλβίδα	Kondravalvola
Solinaspiral	σωλήναςσπιράλ	Tubospiral
Banierë	μπανιέρα	Vaskë
Lekan	λεκάνη	Vc
Kavuras	κάβουρας	Papagall
(trupa)kalorifer	σώματακαλοριφέρ	Radiator
mitocimbidh	μυτοτσίμπιδο	Dare
Polimetro	πολυμετρο	Multimeter
Acalina	ατσαλίνα	-
tripan	τρυπάνι	-
Sifoni	σιφώνι	-
Kastanja	καστάνια	Kriketë
Kanavi	κανάβη	-
kolla pvs	κόλα pvs	Mastik
Bateri	μπαταρία	Akumulator

Rezultate

Arsyet për përsëritjen relativisht të saktë të funksioneve semantike të modeleve greke duhet të kërkohen, së pari, te fakti se kjo kategori fjalësh, duke përfaqësuar kryesisht të ashtuquajturat "huazime për nevojë", plotësojnë boshllëqet në sistemin e gjuhës marrëse (Jorgaqi, 1998). Së dyti, një pjesë nga grupi i fjalëve të grumbulluara nuk kanë një ekuivalente në gjuhën shqipe e, si rrjedhim, ato hyjnë në gjuhën marrëse si risi dhe kontribut. Një gjetje tjetër që duhet përmendur është se shumica e të intervistuarve (specialistët e fushave), rreth 70% i njohin shumë mirë edhe termat ekuivalente në gjuhën shqipe, por për lehtësi përdorimi dhe për shkak të forcës së zakonit zgjedhin të përdorin termin në gjuhën greke. Studime të tilla i vijnë në ndihmë leksikografisë, duke qenë se këto fjalë nuk janë pjesë e Fjalorit të Gjuhës Shqipe (2006 / 2020), por mund të shërbejnë si prurje të reja për fjalorët në proces botimi ose fjalorët e ardhshëm.

Konkluzione

Është e njohur që hyrja e huazimeve në një gjuhë si pasojë e kontaktit gjuhësor ka pasoja për sistemin leksiko-semantik të saj. Sa më i thellë të jetë ky depërtim, aq më i madh është ndikimi. Kjo nënkupton një sërë procesesh ku, për shembull, huazimet zëvendësojnë fjalët ekzistuese të gjuhës marrëse, shënojnë objekte ose koncepte të paemërtuara më parë në atë sistem, apo ndikojnë në rishpërndarjen e funksioneve semantike të elementeve leksikore ekzistuese të gjuhës.

Për këto profesionalizma (pavarësisht se mbeten në kuadrin e ngushtë të një zone të caktuar) është e rëndësishme të analizohen jo vetëm mjetet dhe rrugët e fjalëformimit që janë përdorur për krijimin e tyre, por edhe jeta e tyre në përdorim, sepse zëvendësimi është një proces i ndërlikuar dhe i ngadalshëm, në të cilin ndikojnë një sërë faktorësh shoqërorë, si shkalla e përhapjes së gjuhës letrare kombëtare në shtresa të ndryshme të popullsisë dhe në nivele të ndryshme të ligjërimit, shkalla e arsimimit të popullsisë, sasia dhe cilësia e medias së shkruar dhe të folur etj.

Literatura

Beci, B., 1997. *Marrëdhëniet e shqipes me greqishten në dritën e të dhënave të dialektologjisë shqiptare.* Studime filologjike, Nr. 1-4, Tiranë.

Jazexhiu, V.; Duro, A., 2006. *Motivimi në Terminologjinë e Agronomisë në rrafshin e Termformimit.* Studime filologjike, Nr. 1 – 2, Tiranë.

Jorgaqi, K., 1998. *Mbi Integrimin leksiko-semantik të italianizmave në shqipen standarde.* Studime filologjike, Nr. 1 – 2, Tiranë.

Ikonomu, K., 1997. *ΗαλβανικήγλωσσικήεπίδρασηστηΗπειρωτικάιδιώματα.* Ioannina.

Krimbas, G. P., 2007. *Επιδράσεις της νεότερης ελληνικής στις βαλκανικές γλώσσες.* Athinë.

Qirjazi, Dh., 1989. *Emratvetjakë meprejardhjengagreqishtjaere,* Gjuhajonë,Nr.2, Tiranë.

Sapir, E., 1921 Language: An Introduction to the Study of Speech. Harcourt Brace, USA

Sabir, P., 2017, *Borrowing, the outcome of language contact*,

https://www.researchgate.net/publication/320347336_Borrowing_the_outcome_of_language_contact

Simeonidhi, A. A., 1994. *Νεολογικός δανεισμός της νεοελληνιής*. Selanik.

Tobaidhis, Dh., 1998. *Λεξιλογικά της νέας ελληνικής*. Athinë.

Vehbiu, A., 1986. *FjalëteHuaja, Neologjizmatdheligjërimi*. Gjuhadheshkolla,Nr. 1, Tiranë.

Thomai, J., 2011. *LeksikologjiaeGjuhësShqipe.* Botimet Toena, Tiranë.

Fjalorë

Fjalori i Gjuhës Shqipe, 2006, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë.

Fjalori i Gjuhës Shqipe – i ri, 2020, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, autorët, "Kristalina – KH", Tiranë.

ROLI I GJUHËS NË FORMIMIN E IDENTITETIT ETNIK DHE MJEDISEVE TË PËRDORIMIT TË GJUHËS SË MINORITETIT ETNIK GREK NË SHQIPËRI

Msc. Donika Boboli – Koci, Msc. Aleksandër Boboli
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
dboboli@uogj.edu.al, aboboli@uogj.edu.al

Përmbledhje
Në studimet e sotme gjuhësore e etnolinguistike pranohet gjerësisht fakti se gjuha luan rol parësor në formimin e identitetit etnik të një bashkësie. Aktet gjuhësore janë akte identifikimi, me kuptimin se përdorimet gjuhësore përfaqësojnë, vënë në dukje, identitetin, pasi në këtë mënyrë zbulojnë elemente dhe qëndrime gjuhësore kundrejt vetes dhe të tjerëve. Në një mjedis dygjuhësor ose jo, përdorim gjuhën tonë amtare kur duam të identifikohemi në një grup në dallim me një grup tjetër (kryesisht përballë shumicës). Për më tepër komunitetet minoritare ose të diasporave konturohen dhe forcohen në përpjekje për të ruajtur gjuhën minoritare. Në këtë rast funksioni simbolik i gjuhës shpreh solidaritetin me grupin ose edhe përjashtimin e "tjetrit". Gjithashtu, funksioni komunikativ i gjuhës është element përbërës i identitetit etnik. Anëtarët e një komuniteti (minoriteti) vënë në dukje identitetin e tyre, duke krijuar rrjetet e tyre të komunikimit. Në situata dygjuhësore ose kur një gjuhë cilësohet si gjuhë minoritare, pavarësisht prestigjit, historisë apo prodhimtarisë librore që mund të ketë kjo gjuhë apo statusit të saj zyrtar në një shtet tjetër, rrezikon që të tkurret ose të humbasë në raste ekstreme, në qoftë se kjo gjuhë humbet domenet kryesore të përdorimit të saj, ose ndaj gjuhës dhe bartësve të saj ndiqet një politikë ndalimesh ose represioni. Diçka e tillë nuk ka ndodhur me gjuhën minoritare greke, gjuhë e cila në përshtatje me kushtet konkrete social-politike dhe synimet e pushtetit komunist, u përkrah dhe u zhvillua brenda mundësive dhe kornizave ideologjike të atij sistemi. Domenet më të rëndësishme të cilat ndikojnë në kahun pozitiv, në ruajtjen e gjuhës dhe të kulturës mund të jenë: mjedisi familjar, mjedisi shoqëror, arsimi, institucionet fetare, profesioni etj.

Fjalë kyçe: *Identiteti, gjuha minoritare, domene.*

Abstract
In today's linguistic and ethnolinguistic studies, it is widely accepted that language plays a primary role in the formation of the ethnic identity of a community. Language acts are acts of identification, in the sense that language usesrepresent and point outidentity since in this way they discover linguistic elements and attitudes towards themselves and others. In a bilingual environment or not,when we want to identify with a group in contrast to another group (mainly against the majority), we use our mother tongue. Moreover, minority or diaspora communities are contoured and strengthened in efforts to preserve the minority language. In this case, the symbolic function of language expresses solidarity within the group or even the exclusion of the "other". Also function communicative language is a constituent element of ethnic identity. Members of a community (minority) assert their identity, creating their communication networks. In bilingual situations or in cases where a language is designated as a minority language, regardless of prestige, history, book production this language can have, or its official status in another country, there is a risk of being shrunk or even lost in extreme cases if this language loses its main domains of use, or to the language and the speakers it follows a policy of prohibitions or repression. This was not the case with the Greek minority's language, which was nurtured and developed within the constraints and ideological framework of that system to fit the specific sociopolitical realities and the objectives of the communist administration.

The most important domains that have a positive effecton the preservation of language and culture are family environment, social environment, education, religious institutions, profession, etc.

Keywords: *Identity, minority language, domain..*

Hyrje

Çështje dhe nocione që kanë të bëjnë me identitetin dhe identifikimin e komuniteteve minoritare, etnike ose gjuhësore përbëjnë bërthamën e teorisë dhe studimeve sociolinguistike. Në rastin tonë bëhet fjalë për minoritetin etnik grek që jeton në Shqipëri, i njohur në fakt dhe juridikisht si i tillë pothuaj që nga fillimet e shtetit shqiptar[1]. Ky komunitet përgjatë rrugëtimit si entitet minoritar, përftoi të gjitha ato karakteristika që nga njëra anë e dallojnë nga shumica, dhe nga ana tjetër e bëjnë të ndryshëm në krahasim me bashkëkombësit e shtetit amë.

Degë të ndryshme shkencore janë marrë me marrëdhëniet midis gjuhës dhe identitetit, si historia, sociologjia, psikologjia, gjuhësia dhe shkencat e edukimit. Por edhe në kuadrin e Sociolinguistikës çështja e këtyre marrëdhënieve shihet e ndërlikuar dhe e shumanshme. Qysh para shekullit të 18-të dhe deri vonë, pas Luftës së Dytë Botërore dhe pas ndryshimeve të viteve 90-të në Europën Lindore, në jo pak raste gjuha u promovua si simbol-tregues i identitetit kombëtar.

Por mendojmë që është e domosdoshme, në rastin e minoriteteve etnike ose gjuhësore, akoma në rastin e diasporave, të vihen në dukje ato elemente gjuhësore ose sociolinguistike që lidhen ose formojnë identitetin etnik të këtyre grupeve.

Studimi i gjuhës së minoriteteve etnike ose të diasporave ka lidhje të drejpërdrejtë me dygjuhësinë, me bashkekzistencën e dy kodeve të komunikimit, huazimit të elementeve gjuhësore nga njëri kod te tjetri, me ndërrimin e kodeve etj. Gjithashtu, në këtë kuadër hyjnë edhe çështje që kanë të bëjnë me ruajtjen ose humbjen e gjuhës, të sjelljes gjuhësore apo të stereotipeve dhe paragjykimeve gjuhësore.

1.Identiteti kombëtar[2]- identiteti etnik

Koncepti i identitetit konsiderohet si një nga çështjet kyçe të sociolinguistikës, kryesisht në lidhje me marrëdhënien e tij me sjelljen gjuhësore të folësit, qëndrimet dhe stereotipet ndaj një gjuhe, vitalitetin etnolinguistik dhe përshtatjen gjuhësore. Termi «identitet» mund të përdoret si koncept sferik, i cili përfshin ndër të tjera identitetin personal, atë social, etnik dhe kulturor. Shumica prej nesh kanë identitete të shumëfishta, të cilat mund të ndryshojnë gjatë rrjedhës së jetës sonë dhe në varësi të rrethanave.

Është e nevojshme të bëjmë dallimin midis identitetit kombëtar *(national identity)* dhe identitetit etnik *(ethnic identity)*. Me përkufizimin e termit "identitet kombëtar" janë marrë një shumicë studiuesish, me përkufizime të ndryshme, por që konvergojnë në disa elemente: a. Një bashkësi me prejardhje (fisnore apo fetare) të njëjtë;

b. Me të njëjtën gjuhë dhe tradita kulturore;

c. Një bashkësi shtetërore dhe politike.

Ndërsa "identiteti etnik" është ndjesia e të qenit pjesë e një grupi etnik që vetëpërcaktohet si një grup me elemente të përbashkëta si gjuha, feja dhe traditat e përbashkëta(Rotheram &Phinney 1987)[3]. Nga ana tjetër shpreh "rrafshin diakronik" të përcaktimit të identitetit, i cili mund të

[1] Më 2 tetor 1921 përfaqësuesi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve Fan Noli deklaroi se Shqipëria merr përsipër detyrimin e respektimit të të drejtave arsimore dhe fetare të komunitetit grek në Shqipëri.

[2] "national identity" në dallim nga "ethnic identity"

[3] (Rotheram &Phinney 1987). Definitions and perspektives in the study of children'ethnic socialization.

përbëhet nga elemente dhe eksperienca të përbashkëta, por edhe nga mite.[4]

Kështu, "ndërsa identiteti kulturor është një biomë dhe formohet kryesisht përmes kontaktit aktiv të individit me mjedisin e tij social-kulturor, identiteti etnik gjithashtu mund të kultivohet në kontekstin e një realiteti virtual".

Gjithashtu identiteti etnik është një proces në zhvillim në varësi të sistemeve politike, kushteve shoqërore ekonomike, politikave arsimore dhe gjuhësore.

Siç përmend Erikson(1968)[5], formimi i identitetit vazhdon gjatë gjithë jetës së një personi dhe ndryshohet sipas situatave tona të jetës.

Pra, identiteti etnik, duke marrë parasysh rastin tonë, nën ndikimin e faktorëve të lartpërmendur, mund të ndryshojë gjatë një stadi konkret të jetës.

2. Marrëdhëniet e gjuhës me identitetin etnik

Në studimet e sotme gjuhësore e etnolinguistike pranohet gjerësisht fakti se gjuha luan rol parësor në formimin e identitetit etnik të një bashkësie. Aktet gjuhësore janë akte identifikimi, me kuptimin se përdorimet gjuhësore përfaqësojnë, vënë në dukje, identitetin, pasi në këtë mënyrë zbulojnë elemente dhe qëndrime gjuhësore kundrejt vetes dhe të tjerëve. P.sh., në një mjedis dygjuhësor ose jo, përdorim gjuhën tonë amtare kur duam të identifikohemi në një grup në dallim me një grup tjetër (kryesisht përballë shumicës).

Për më tepër komunitetet minoritare ose të diasporave konturohen dhe forcohen në përpjekje për të ruajtur gjuhën minoritare. Siç përmend Wardhaugh(1993,170)[6]:

"Një nga përdorimet më të thjeshta, por më të rëndësishme të gjuhës është ai i ruajtjes së kohezionit shoqëror. Gjuha ndihmon për të përcaktuar dhe mbajtur një komunitet të caktuar. Njerëzit që ndajnë një gjuhë të përbashkët janë në gjendje të komunikojnë me njëri-tjetrin... Një gjuhë e përbashkët ose një varietet gjuhësor ofron një kanal komunikimi që i lejon njerëzit të lidhen me njëri-tjetrin në mënyra të ndryshme, p.sh. me gjuhën e vetë grupit, me prejardhjen etnike, me besimin fetar,me klasën shoqërore, profesionin, gjininë, moshën etj."

Në këtë rast funksioni simboliki gjuhës shpreh solidaritetin me grupin ose edhe përjashtimin e "tjetrit". Për shembull, kur studentë me origjinë minoritare gjenden në një grup, ndërsa studentë të tjerë nga grupi dominues janë, gjithashtu, të pranishëm, ata mund të zgjedhin të përdorin gjuhën e pakicës ose si shenjë solidariteti me grupin e tyre, ose për të shmangur të kuptuarit nga jo anëtarët. Për rrjedhojë, gjuha e folur është një nga treguesit më të dukshëm dhe më të rëndësishëm të identitetit të minoritetit etnik grek.

Gjithashtu, funksioni komunikativ i gjuhës është element përbërës i identitetit etnik. Anëtarët e një komuniteti (minoriteti) vënë në dukje identitetin e tyre, duke krijuar rrjetet e tyre të komunikimit.

Faktori më i rëndësishëm për ruajtjen e identitetit është bashkëbisedimi, dialogu me të tjerët, të folurit e së njëjtës gjuhë dhe përdorimi i të njëjtave simbole. Me këtë kuptim, gjuha është shprehja e nevojshme dhe përcaktuese e sistemit kulturor. Gjuha ose një stil i të folurit shpesh konsiderohet si karakteristikë e domosdoshme e përkatësisë në një grup. Megjithatë, vlen të theksohet se edhe një veçori e thjeshtë e gjuhës, siç është fonema, mund të konsiderohet si element identiteti dhe diferencimi nga "tjetri"(Tabouret-Keller 1997)[7].

3. Mjediset e përdorimit të gjuhës minoritare greke

---

[4] Νέλλη Κωστούλα-Μακράκη, Γλώσσα και κοινωνία-βασικές έννοιες. Εκδόσεις Μεταίχμιο Αθήνα 2001. f. 95.

[5] Erikson, E.H.1968.Identity:Youth and Crisis. New York :Norton.

6.Wardhaugh1993. Investigating Language:Central problems in Linguistics.

[7] Tabouret – Keller, A. 1997. Language and identity.

Në situata dygjuhësore ose kur një gjuhë cilësohet si gjuhë minoritare, pavarësisht prestigjit, historisë apo prodhimtarisë librore që mund të ketë kjo gjuhë apo statusit të saj zyrtar në një shtet tjetër, rrezikon që të tkurret ose të humbasë në raste ekstreme, në qoftë se kjo gjuhë humbet domenet kryesore të përdorimit të saj, ose ndaj gjuhës dhe bartësve të saj ndiqet një politikë ndalimesh ose represioni. Diçka e tillë nuk ka ndodhur me gjuhën minoritare greke, gjuhë e cila në përshtatje me kushtet konkrete social-politike dhe synimet e pushtetit komunist, u përkrah dhe u zhvillua brenda mundësive dhe kornizave ideologjike të atij sistemi.

Nga një vështrim i vëmendshëm i shkrimeve gjuhësore vërejmë se termi "domen" përdoret për herë të parë nga përfaqësuesi më i shquar gjuhësisë variacioniste, J. Fishman[8]. Mendimi i tij gjuhësor përcjell faktin se domeni social i përdorimit të gjuhës është "*një konstrukt social-kulturor që përmblidhet në çështje të komunikimit, në marrëdhëniet e atyre që komunikojnë dhe të situatave të komunikimit, në përputhje me institucionet e një shoqërie dhe të sferës së veprimtarisë të një bashkësie kulturore, në mënyrë që sjellja individuale dhe modelet shoqërore të diferencohen, por edhe të ndërlidhen midis tyre*".[9] Duke përdorur informacione për vendet e përdorimit të gjuhës në një komunitet, është e mundur të krijohet një model i thjeshtë, bazuar në normat e përdorimit të gjuhës në atë komunitet.

Domenet më të rëndësishme, të cilat ndikojnë në kahun pozitiv, pra në ruajtjen e gjuhës dhe të kulturës mund të jenë: mjedisi familjar, mjedisi shoqëror (shokët, bashkëqytetarët, të afërmit), arsimi, institucionet fetare, profesioni etj.

3.1. Mjedisi familjar

Mjedisi familjar, siç ndodh zakonisht me komunitetet minoritare ose të diasporave, është domeni bazë i përdorimit të një gjuhe minoritare, pavarësisht vendndodhjes së familjeve: në zona të pastra të ashtuquajtura minoritare apo në ambiente të tjera ku flitet vetëm gjuha e shumicës apo gjuha zyrtare. E nënvizojmë këtë duke pasur parasysh (kryesisht pas viteve 45) shpërnguljet e qindra familjeve minoritare në zonat urbane të Shqipërisë.

Në zonat minoritare, të cilat mund të kufizohen gjeografikisht në jug të Shqipërisë: në rrethet e Gjirokastrës, të Delvinës dhe të Sarandës, si edhe një numër qendrash rurale(rreth 99 fshatra), gjuha minoritare greke ishte gjuha e vetme e mjedisit familjar. Ajo është përdorur pa kurrfarë pengese në të gjitha aspektet e jetës familjare dhe s'kishte si të ndodhte ndryshe. Familja minoritare greke, për arsye të ndryshme kryesisht për shkak të emigracionit të hershëm, por edhe të një tradite arsimore, karakterizohej nga një nivel kulturor i kënaqshëm në krahasim me shumicën dhe para vitit 1945 me kontakte të shumëllojshme me shtetin amë.

Ndërkohë në familjet e diasporës së brendshme situatat gjuhësore ishin të ndryshme. Megjithëse, sipas konstatimeve dhe eksperiencave tona, në shumicën e familjeve minoritare që u shpërngulën si të tilla, pra gjithë familja, në vitet '50 dhe '60, gjuha e familjes ishte gjuha minoritare, në vitet e mëvonshme dhe me brezin e dytë, gjuha minoritare filloi të humbasë terren në lidhje me gjuhën shqipe. Këto familje besonin se mësimi i gjuhës shqipe në një plan afatgjatë do të ishte në dobi për fëmijët e tyre dhe për pakicën në përgjithësi. Dhe kjo sepse do t'u jepte atyre mundësinë për t'u inkuadruar në strukturat dhe mekanizmat shtetërorë, për t'u evoluar brenda shoqërisë shqiptare, pra me një perspektivë integrimi në realitetin shqiptar, duke ruajtur në të njëjtën kohë identitetin e tyre të ndryshëm kombëtar dhe kulturor.

Ekuilibrat gjuhësorë ishin tejet të ndryshme në familjet me martesa të përziera, ku në shumicën e rasteve me kalimin e viteve këto familje ktheheshin në familje njëgjuhëshe. Në njëfarë mënyre

---

[8]Fishman, J.A. The relationship between micro-and macrosociolinguistics in the study of who speaks what language to whom and when. Në Sociolinguistics: Selekted Readings, Penguin Books. 1979.
Cituar edhe në ΝέλληΚωστούλα-Μακράκη, Γλώσσακαικοινωνία-βασικέςέννοιες. Εκδόσεις Μεταίχμιο Αθήνα, 2001.

[9]Në ΝέλληΚωστούλα-Μακράκη, Γλώσσακαικοινωνία-βασικέςέννοιες. ΕκδόσειςΜεταίχμιοΑθήνα, 2001 f. 60.

edhe në këto familje ekuilibrat ndryshuan pas viteve ’90 kur shumica e familjeve minoritare emigruan jashtë vendit dhe kryesisht në Greqi.

3.2. Mjedisi shoqëror

Me mjedis shoqëror kuptojmë të gjitha marrëdhëniet e individit jashtë familjes. Në rastin tonë dhe gjatë periudhës socialiste-komuniste janë marrëdhëniet në fshat, në punë, në kooperativë, në çdo lloj mbledhjeje masash (rinie, të frontit apo dhe të partisë së punës). Në këto lloje marrëdhëniesh mbizotëronte gjuha minoritare, por vetëm në ligjërimin e folur. Në marrëdhëniet administrative të folësit minoritar, sidomos pas viteve ‘70 ku brezi i pasluftës qe shkolluar me bazë gjuhën zyrtare shqipe, në të shumtën e rasteve përdorej gjuha zyrtare dhe jo minoritare. Por diçka e tillë nuk konsiderohet absolute, pasi, sidomos në zonat rurale larg qendrave urbane, edhe në komunikimin zyrtar përdorej gjuha minoritare. Në mbledhjen e rinisë apo të frontit flitej gjuha minoritare, me kryetarin e kooperativës apo të lokalitetit flitej gjuha minoritare, akoma edhe në Komitetin e Partisë kur bashkëbiseduesi ishte me prejardhje minoritare.

Përdorej gjuha zyrtare vetëm në ato raste ku situatat ligjërimore imponoin diçka të tillë: prezenca e një bashkëbiseduesi njohës vetëm i gjuhës zyrtare, kur objekti i diskutimit ishte diçka shumë serioze që kishte lidhje, p.sh. me çështje ideologjike apo “vijën e partisë”, kur një nga bashkëbiseduesit mund të përdorte gjuhën zyrtare si tregues superioriteti apo prestigji shoqëror, politik apo administrativ, apo akoma si një përpjekje e individit për të mos u dalluar nga folësit e shumicës.

3.3. Arsimi

Ruajtja dhe transmetimi i gjuhës amtare është padyshim një fushë kyçe për sigurimin e vazhdimësisë së çdo pakicë etnike që diferencohet nga karakteristika të tjera, por edhe në bazë të gjuhës së saj. Kështu, shkolla, si vend i kultivimit të identitetit gjuhësor, fiton një rëndësi të veçantë në mekanizmat e ruajtjes së pakicës si një entitet i veçantë.

Gjerësisht i pranueshëm nga studiuesit, në kahun pozitiv apo negativ, është roli i shkollës në ruajtjen apo tkurrjen e një gjuhe minoritare. Fishmani nënvizon se arsimi“si një institucion formal i shoqërizimit është detyrimisht bashkëpërgjegjës dhe pjesëmarrës në shoqërizimin social-kulturor, pra në shoqërizimin për përftimin e identitetit etnik dhe ndërgjegjes etnike”.[10]

Ekziston një marrëveshje e përgjithshme për rolin e sistemit arsimor si një institucion që kontribuon në formimin dhe kultivimin e kulturës dhe identitetit. Si rrjedhojë, çështja e mësimit të gjuhës amtare dhe kulturës konsiderohet se është e ndërthurur ngushtë me çështjen e vazhdimësisë etnolinguistike të grupeve minoritare. Sipas Edwards(1988), nëse kontakti gjuhësor është i tillë që çon në regres gjuhësor, është pothuajse e pamundur që shkolla të mund të ndikojë ndjeshëm në këtë proces. Nga ana tjetër, argumentohet se pakicat etnolinguistike kanë nevojë për një përvojë të fortë arsimore në gjuhën dhe traditat e tyre për të ruajtur gjuhën e tyre amtare dhe identitetin e tyre etnik (Lambert 1985, Landry&Allard 1991)[11]

Veçse në këtë aspekt implikohen faktorë ekskluzivisht institucionalë: politikat arsimore mbështetëse apo dekurajuese-ndaluese të organeve shtetërore.

Në rastin tonë kemi të bëjmë me politika arsimore mbështetëse ndaj arsimit të detyrueshëm minoritar, një arsim i fokusuar kryesisht në mësimin e gjuhës amtare. Pra, gjuha e arsimit në zonat minoritare ishte gjuha minoritare greke.

Edhe para Luftës së Dytë Botërore, në kohën e mbretit Zog, gjuha e shkollës ishte gjuha

---

[10]Fishman, J.A. Language and Ethnicity in Minority Sociolonguistic Perspective. Kleventon, Avon: Multilingual Matters . 1989. Cituar në ΝέλληΚωστούλα-Μακράκη, Γλώσσακαικοινωνία-βασικέςέννοιες. ΕκδόσειςΜεταίχμιοΑθήνα, 2001 f. 131.

[11] Lambert 1985, Landry&Allard 1991Somecognitive and sociokultural consequences of being bilingual. Can scools promote additive bilingualism in minority group children?

minoritare, madje, edhe dokumentet shkollore në shumë raste i gjejmë në gjuhën greke. Gjithashtu, pas viteve '45 me ndryshimin e sistemit një pjesë e dokumentacionit shkollor ishte fillimisht në gjuhën greke dhe në vazhdim dygjuhësh. Gjuha minoritare ishte gjuha e arsimit fillor dhe shtatëvjeçar deri në vitin 1952.

Arsimi i minoritetit etnik grek në gjuhën amtare vazhdoi edhe gjatë periudhës së qeverisjes komuniste të vendit. Gjuha greke në shkollat e minoritetit mësohej vetëm në katër klasat fillore për të gjitha lëndët, ndërsa shqipja mësohej ekskluzivisht si gjuhë e huaj. Nga klasa e pestë deri në klasën e tetë kjo situatë ndryshoi në favor të gjuhës shqipe, në të cilën bëheshin të gjitha lëndët, ndërsa greqishtja mësohej si gjuhë e huaj dhe për vetëm 4 orë në javë në lëndët e gjuhës greke dhe të leximeve letrare. Në shkollën e mesme dhe në universitet, gjuha greke mungonte plotësisht.

Qëllimi i qeverisjes socialiste në nivelin e shkollës tetëvjeçare ishte përgatitja e qytetarëve për pjesëmarrje në jetën shoqërore dhe prodhimin socialist. Në këtë kontekst, arsimi ofronte një edukim misionar, siç shihet edhe nga shqyrtimi i teksteve shkollore të kësaj periudhe.

Gjithashtu nga viti 1955, me hapjen e degës së greqishtes në shkollën e mesme pedagogjike "Pandeli Sotiri" në Gjirokastër, gjuha minoritare greke mësohet edhe në këtë shkollë që përgatiste mësues për shkollat fillore të minoritetit.

3.4. Feja

Feja si edhe institucionet përkatëse fetare kanë ndikuar pozitivisht në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës minoritare greke. Para viteve '45, në forma të ndryshme, institucionale apo jo, në shkollat e minoritetit zhvilloheshin edhe mësime fetare. Me vendosjen e sistemit socialist, u ndaluan mësimet fetare në të gjithë Shqipërinë dhe për pasojë edhe në zonat ku banonte minoriteti etnik grek. Që nga viti 1946 Ministria e Arsimit u dërgon një Qarkore Komiteteve Ekzekutive të Prefekturave ku ndalon dhënien e mësimit të fesë nëpër shkolla.[12]

Bibliografia

Νέλλη Κωστούλα-Μακράκη, Γλώσσα και κοινωνία-βασικές έννοιες. Εκδόσεις Μεταίχμιο Αθήνα, 2001.

Erikson,E.H.1968.Identity:Youth and Crisis. New York:Norton.

Wardhaugh 1993.Investigating Language:Central problems in Linguistics.

Tabouret – Keller, A. 1997. Language and identity.

Fishman, J.A. The relationship between micro-and macrosociolinguistics in the study of who speaks what language to whom and when. Në Sociolinguistics: Selekted Readings, Penguin Books. 197.

Fishman, J.A. Language and Ethnicity in Minority Sociolonguistic Perspective. Kleventon, Avon: Multilingual Matters . 1989.

Lambert 1985, Somecognitive and sociokultural consequences of being bilingual.

Landry&Allard 1991.Can scools promote additive bilingualism in minority group children?

[12]Qarkore nr. 490/2, Tiranë 19.11.46 (e plotë në shtojcën nr. ....) "...duke marrë parasysh se mësimi i fesë është një pengesë për edukimin e fëmijëve dhe në kundërshtim me reformën e arsimit e cila vepron që t'i largojë fëmijët nga paragjykimet, besëtytnitë dhe fanatizmin fetar, porositeni që në Qarkun t'uaj të mos lejoni me asnjë mënyrë krijimin e mejtepeve dhe dhënien e mësimit të fesë...." ASHV, Viti 1946, Dosja 717, fl. 1.

NDËRVEPRIMI KULTUROR, URË E GJALLË LIDHËSE MES LUGINËS SË VJOSËS E DRINOS

Msc. Juliana Sinani Pesha
Teacher of the Albanian language and literature, Local Education Office,Finiq– Dropull, juliana.pesha@hotmail.com

Abstrakt

Studimin e paraqitur do ta prezantojë nga një këndvështrim i veçantë, Parkun Kombëtar Vjosa. Ai do të fokusohet në perspektivat që do të mund të hapë për studiuesit vendas e të huaj, nga pikëpamja etno-kulturore jo vetëm popullsia e zonës përgjatë bregut lumor të Vjosës, por edhe e degës ushqyese të saj, Drinos ku bën pjesë Gjirokastra e në veçanti krahina e Lunxhërisë me doket, zakonet, traditat e saj. Qëllimi është që përmes një krahasimi të tipareve dalluese dhe një gërshetimi të tipareve të përbashkëta, të promovohet bashkëjetesa dhe trashëgimia etnokulturore e popullsisë së këtyre zonave, përgjatë luginës së Vjosës e Drinos. Studimi do të përqendrohet te veshja, këngët, vallet për rite të caktuara, pa përjashtuar gjuhën si kyçin lidhës kryesor, mjedisin natyror e arkitekturën e veçantë të ndërtesave e urave të vjetra. Analiza e të dhënave do të sjellë në mënyrë të detajuar: stilin dhe formën, materialet, kuptimin kulturor, evolucionin historik të këtyre veshjeve popullore. Vlen të përmendet këtu dasma dhe kostumi i nuses (gruas) lunxhote. Sfida më e madhe në kohën e zhvillimit kaq të vrullshëm të teknologjisë është përpjekja për ruajtjen e përhapjen e identitetit unik kulturor të zonës së Lunxhërisë, sa i pasur, po dhe i panjohur aq sa duhet. Rezultatet e këtij studimi ofrojnë një vështrim aktiv të trashëgimisë kulturore dhe rëndësinë e përcjelljes te brezat e ardhshëm. Burimet e përdorura gjatë këtij studimi mund të shërbejnë si pikënisje për studime të ardhshme më të detajuara, për kostumografinë, këngët, vallet dhe lirikat e këtyre zonave.

***Fjalët kyçe**: Trashëgimi kulturore, tipare të përbashkëta, tipare të veçanta, veshje popullore, kostumi i lunxhes, Parku Kombëtar Vjosa.*

Abstract

This study will present the Vjosa National Park from a special perspective. The main purpose of it is to open perspectives for local and foreign researchers from the ethno-cultural point of view, not only of the population of the area along the banks of the Vjosa River but also of its branch Drino, where Gjirokastër is part of and in particular the province of Lunxhëria with its docks, costumes and traditions. The purpose is to promote the coexistence and ethno-cultural heritage of the population of these areas. This study will present the dresses, songs and dances of certain celebrations, without excluding the language as the main connection and its special architecture of old buildings and bridges. Detailed data analysis will bring the style and the form, the materials and the ornaments, the cultural meaning, and the historical evolution of these traditional clothes. It is worth mentioning the wedding ceremony, bride's wedding, or women in general dress of Lunxhëri (Lunxhi or Lunxhe for short). The biggest challenge nowadays, which the rapid development of technology, is the effort to preserve and spread the unique cultural identity of Lunxhëria as it is, rich and unknown at the same time. The results of this study provide an active consideration of cultural heritage and the importance of passing it onto the future generations. The source used in this study can serve as a starting point for more detailed studies on costumes, songs and lyrics of these areas in the future.

***Keywords:** cultural heritage, common features, special features, folk clothing, Lunxhi costumes, Vjosa National Park*

Hyrje

Uji ka qenë pandashmërisht pjesë e jetës së çdo populli.

Bariu çonte bagëtinë për ujë, gratë lanin rrobat e prisnin të thaheshin. Burrat punonin tokën e

ujitnin të mbjellat.

Fëmijët laheshin, luanin, grumbulloheshin rreth tij.

E ashtu si rastësisht lindi kënga, vallja, lojërat. E ato bashkë me njerëzit ktheheshin nga lumi nëpër shtëpi. Nga shtëpitë në rrugët e festat e fshatit, për t'u bërë kështu pjesë e pandarë e jetës. Shtrati i lumit krijonte një fushë e fusha mblidhte njerëzit, e njerëzit këndonin këngë e hidhnin valle, për të mira, për gëzime, por aty mblidheshin edhe për derte e halle. Tërë jeta vërtitej rreth ujit.

Ç'bën moj ti aty përposhë
laj fustan' e jet' im zotë…
E kështu si uji rridhte edhe vetë jeta.

Vështrim i përgjithshëm mbi katër periudhat historike të zhvillimit të veshjeve

Shpallja e lumit Vjosë dhe e degëzimeve të tij, në Parkun e Parë Kombëtar Lumor në Shqipëri u prit me shumë ngazëllim si brenda dhe jashtë vendit, por në të njëjtën kohë shtoi përgjegjësinë në mirëruajtjen e tij.

Parku Kombëtar Vjosa është një pasuri natyrore që ose shkatërrohet, ose mbrohet nga ne njerëzit. Në vitin 2017 nisma "Mos ma prek Vjosën" ishte një nga faktorët e arritjes së qëllimit kryesor, që Vjosa u shpall vend i mbrojtur, Park natyror. Nëse duam të mbrojmë Vjosën, duhen mbrojtur edhe rrethinat e saj. Kjo bëhet nga ne për ne. Ky është si efekti "domino", sa më e mbrojtur të jetë një nga nënelementet e parkut të Vjosës, aq më e mbrojtur është edhe ajo vetë.

Lumi i Drinos është një nga arteriet kryesore ushqyese të Vjosës. Lugina e Drinos patjetër që rreth vetes do të mblidhte edhe një popullsi, e cila ka lënë gjurmë që në lashtësi.

Rëndësia e etnografisë për arkeologjinë është e madhe. Mungesa e burimeve të shkruara për periudhat më të hershme të zhvillimit të shoqërive njerëzore plotësohet me burime etnografike. Veshjet populllore në vetvete janë një arkeologji e gjallë.

Gjurmë të vjetra, edhe pse të pakta, të kulturës prehistorike të shek. IV – II p.e. sonë, janë gjetur gjatë gërmimeve, në Vajzë të Vlorës, Bënjë të Përmetit e deri në Antigone, Saraqinishtë, Dropull i Sipërm të Gjirokastrës.

Në epokën e hekurit vihen re një sërë elementesh të kulturës materiale e shpirtërore që janë të përbashkëta për gjithë fiset ilire që banonin në territorin e vendit tonë, ku vlen të përmenden nekropolet tumulare në Piskovë e Rapckë të Përmetit dhe tumat e luginës së Drinosit. Ushtrimi i gjerë i lundrimit nga ilirët u shpreh në nderimin e Perëndisë së detit, por që në luginën e Aosit(Vjosës), Antigone, Finiq nderohej edhe si Perëndi e nëntokës, pasi kjo zonë gjatë antikitetit prekej shpesh nga tërmetet.

Disa pafta brezi të shek. III – II p.e sonë paraqesin Kadmin e kthyer në Dragua.

Gjithashtu, në inventarin e varreve bënin pjesë veshjet, fibulat, varëset, paftat e brezit, unaza, vathë, byzylykë, zbukurime ari e argjendi te gratë dhe enë, armë hekuri te burrat.

Në shek.II e.s., në luginën e Vjosës vërehet një forcim i ndërgjegjes etnike, formimi i artit populllor, veshja me kostume vendase. Për gratë vazhdon linja me mëngë të shkurtra të mbuluar me fustan pa mëngë, si dhe shami e llabania e kokës. Te burrat zotëron një këmishë e shkurtër mbi gjunjë, e lidhur në mes dhe sipër saj një klamide e mbërthyer në supin e djathtë të saj. ***Formohet në këtë kohë edhe fustanella***, e gjetur mbi një gur gëlqeror në Mallakastër.

Në bazë të mbishkrimeve në gjuhën latine flitet për një komunikacion midis fshatrave përmes rrugës Egnantia, rruga në luginën e Drinit, rruga ***në luginën e Vjosës e Drinosit.*** Këto rrugë ishin një mundësi lidhjeje jo vetëm për transportin e banorëve dhe mallrave, por ishin urë lidhëse edhe për traditat e zakonet midis këtyre zonave.

Me mjaft rëndësi që në mesjetën e hershme, si dokumente materiale dhe si vepra arti, sipas

rastit, janë edhe ndërtimet që bëjnë pjesë në të ashtuquajturën arkitekturë të vogël. Banesa popullore përbën një dëshmi të drejtpërdrejtë të mënyrës së jetesës së qytetit e fshatit, të mënyrës së ndërtimit dhe traditës shekullore. Janë gjendur gjurmë fortifikimesh e ndërtimesh shoqërore të periudhës Ilire, të antikitetit të vonë dhe të mesjetës.

Gjatë këngëve të dasmës në një mënyrë apo në një tjetër del, nga sa thamë më sipër, përfshirja e *zapanáve*, shtëpive të mëdha, në jetën e përditshme. Pra, nuk kemi të bëjmë me monumente të vdekura, por shihet qartë shtrirja e gjerë në përputhje me vlerat e krijuara nga të parët tanë në arkitekturë e ndërtime, duke sjellë sot një përcaktim, që përfshin gjithë krijimet me vlerë historike, kulturore, artistike; me vlera mjedisore, me vlera të shumanshme e të pazëvendësueshme shkencore.

Gjatë periudhës së feudalizmit brenda kuadrit të ekonomisë së mbyllur shtëpiake për veshjet përdoreshin materiale, si: lëkura, liri, kërpi, mëndafshi etj. Mëndafshi kultivohej në vende, si Vlora, Durrësi, Berati. Në shek. XIV përdoreshin pëlhura me vija ngjyrash të ndryshme. E një cilësie modeste ishte edhe një pëlhurë e quajtur *fustan.* Mendohet se me këtë lloj pëlhure bëhej ajo që më pas u quajt *fustanella,* por që fillimsht përdorej për vartësit e familjeve fisnike. Cohat për fisnikët importoheshin nga Venediku, ku dominonte ngjyra e kuqe, e gjelbër dhe manushaqe e errët, si dhe pëlhurat e mëndafshta të qëndisura me ar, si dhe kadifeja (velluto). Megjithatë vlen të përmendet se pelerinat kishin diçka të veçantë në qepje e shiritat e artë, sepse fisnikët e huaj kur bënin dhurata te shqiptarët shpreheshin "sipas mënyrës së shqiptarëve''. Në këto kohë sundonte stili bizantin i qepjes së rrobave, i shoqëruar ky te gratë edhe me një varg aksesorësh si kurora të arta, vathë, breza argjendi etj. Veshja e grave sipas afreskeve të shek. XIV, përbëhej nga një rrobe e gjatë, ku sipër saj vishej një sako e gjatë e luksoze dhe kokën e mbështillnin me një pëlhurë të hollë që mbulonte edhe qafën e pjesërisht supet. Sot i ndeshim në Has e në Dropull. Gjatë shek. XV, zbehet stili bizantin, merr hov fustanella dhe mëngët me llapa, si dhe qëndisjet me ar vazhdojnë duke lënë gjurmë deri sot. Gjatë shek. XVI u përhap shumë xhamadani me mëngë prapa , pelerina e kuqe, deri te kostumi me fustanellë. Në shkrimet letrare të Evropës flitet për ''modën shqiptare'', pasi lufta kundër osmanëve solli admirim në gjithë Evropën. Gjatë shek. XVII-XVIII, u përhapën zejet artistike si argjendaria. Në shek. XIX për shkak të islamizimit, sidomos te veshja e grave vërejmë ndryshime, pasi fustanet e gjata që ishte kod veshjeje në kishë u zëvendësuan me çitjanet orientale. Vihet re një divergim mes tyre dhe pjesës së mbetur të krishterë, ku këmisha e gjatë e bardhë tashmë ishte kthyer në veshje të brendshme. Gjithashtu, në veshjen popullore u zëvendësuan disa fije apo ngjyra gajtani nga e zeza në të gjelbër, si dhe disa elemente që marrin emërtime të huazuara nga turqishtja, si : brezi i leshtë të quhej qemer, mëngorja të quhej mintan etj.

Në të njëjtën kohë kaçakët dhe luftëtarët e lirisë, që mos dalloheshin natën nga armiku, filluan të vishnin fustanella të zeza.

Vërehet një ndikim oriental me një lloj këmbule, të zbukuruar me pare, për të plotësuar kostumin ceremonial të martesës, kryesisht në veshjet qytetare, por rrallë ka ndodhur në ***kostum fshatar***, p.sh., siç është ***ai i nuseve të Lunxhërisë***, që mbanin ditën e dasmës një fes të kuq shumë të zbukuruar me pare.

Dhe këtu natyrshëm lind pyetja: Po ç'është ky kostum dhe kjo krahinë që në shumë studime barazohet me qytetin?

Vështrim mbi Lunxhërinë

Lunxhëria është një nga shtatë krahinat që përbëjnë sot rrethin e Gjirokastrës. Ajo shtrihet përgjatë malit të Lunxhërisë, përballë qytetit të Gjirokastrës. Nga burimet historike del se në mijëvjeçarin e parë p.e.s. ajo ishte e banuar nga fisi ilir i Kaonëve. Në Sjolla të Erindit janë gjetur materiale poçerie, qeramike në Këllëz dhe sidomos zbulimi i Antigonesë, pranë Jermës, por edhe nëSaraqinishtë, Lekël, Qestorat, Stegopul etj. Më pas një lulëzim shfaqet në shek.VI të e.r. duke arritur te gjallërimi i plotë në shek. XV, që vërtetohet nga regjistrimet osmane të viteve 1431-1432. Në vitin 1913 krahina numëronte 6422 banorë. Në vitin 1926 vetëm Labova kishte

1134 banorë, kur Tepelena si qytet kishte 600 banorë, Libohova 2500 banorë e Gjirokastra qytet 10 mijë banorë. Labovat në këtë kohë ishin fshatra të zhvilluara e hijerënda, me ekonomi familjare, banesa e organizim njëlloj me qytetin bashkëkohës. Këto të dhëna tregojnë se popullsia e krahinës së Lunxhërisë ka përcjellë vazhdimësinë e jetës nga ilirët tek arbëreshët e deri te shqiptarët e sotëm.

Më pas varfërimi i tejskajshëm që shkaktoi rendi socialist dhe reformimi agresiv postkomunist solli braktisje masive të krahinës.

Nga aspekti gjeografik Lunxhëria përfshin nga lumi i Suhës në jug deri te gryka e Këlcyrës në veri. Nga aspekti etnografik Lunxhëri quhet nga gryka e Selckës deri në Erind, kurse nga fshati Gjat deri në grykën e Këlcyrës quhet Odrie (ose Rrëza). Megjithatë njerëzit e këtyre zonave nuk kanë qenë asnjëherë të veçuar nga ngjarjet historike që ndodhnin në vend. Ashtu siç spikatën në dasmën e mbretit Zog, po ashtu morën pjesë edhe në luftën e Vlorës për mbrojtjen e trojeve tona.

Veshjet popullore në përgjithësi, që pas Shpalljes së Pavarësisë, ku hyri stili evropian e deri pas Çlirimit filluan të mos përdoreshin më, duke filluar nga Jugu (viti 1922) e më pas u shtri edhe në Veri të Shqipërisë. Disa rite e zakone të vjetra, sidomos pas çlirimit, u asimiluan si zakone të prapambetura, edhe pse ato ishin vetë stadet e jetës së njeriut: lindja, martesa – dasma, vdekja.

Veshja e Lunxhit

Në familjen lunxhote së bashku me gëzimin e lindjes së vajzës fillonte edhe përgatitja e prikës, e sepetit, e veshjeve hijerënda. Brenda sëndukut të nuses, përveç veshjes kadife, që vishej për herë të parë, kur ajo ishte 14-vjeç dhe ngjyrat e saj ishin kryesisht jeshile, por edhe kafe, patjetër do të ishte fustani i nusërisë, që vishej për të mira, në kishë a festa. Do kishte edhe një fustan të dytë për në shtëpi, patjetër një të zi për morte dhe flokatën për në pleqëri. Gjithsej tetë derivate të kostumit lunxhot, që do t'i duheshin nuses t'i vishte gjatë gjithë stadeve të jetës së saj.

Çdo baba e kishte për detyrë qepjen e kostumeve, edhe pse të shtrenjta, apo edhe xhaxha, dajë nëse vajza qe jetime.

Të tjerat vajza i punonte me duart e saj, pasi pas moshës 14-vjeç bënte vetëm punë shtëpie brenda e nuk dilte më deri ditën që duhej të dilte ta shihte krushqari apo familja e djalit, me qëllim që të shkrepej pushka në oborr dhe të quhej e fejuar. Një fenomen i tillë hasej edhe në Labëri, ku vajza quhej "e zënë", dhe nuk kishte të drejtë dikush tjetër të kërkonte dorën e saj.

Siç e kuptojmë, dasma ishte një pjesë e gjithë institucionit që quhej "Martesë". Martesa ishte shumë e rëndësishme. Flitej për jetën e një njeriu, të vajzës së cilës i prishej ose i rregullohej jeta, në varësi të derës ku ajo do të futej nuse. Por edhe për familjen e djalit ishte e rëndësishme nusja që do të merrej, pasi pas vdekjes së më të mëdhenjve të fisit, a do të ishte ajo e zonja ta mblidhte a ta shkërrmoqte farefisin e të shoqit. Nuk harrojmë këtu se gjatë shekujve burrat apo djemtë e familjeve mund të ishin ose në kurbet, ose në luftë. Këtu zë vend shprehja: " Nusja nga fis edhe nëse nuk të thotë fjalën, do të të bëjë djalën", në kuptimin që fëmija i lindur do të jetë nga fis, nga derë e lartë, si nga nëna, edhe nga babai. Kjo pasqyrohet fare mirë edhe në këngën "Doli nusja në divan", ku vërtetohet fare mirë që nusja nuk shihej si shërbëtore. Pra, edhe krushqitë bëheshin sipas sërës. Krushqari duhej të lidhte dy familje të sërës së lartë, të mesme ose të ulët. Në fakt, në fund të shek. XVIII, për arsye të rënies së dukshme të numrit të meshkujve, u përhap edhe dukuria që bashkë me prikën babai i nuses jepte edhe një shumë të madhe parash, p.sh. 50 napolona flori e lart ose tokë kur ishin më të varfër. Arsyeja ishte e thjeshtë, që vajza të jetonte sa më mirë dhe të respektohej në derë të burrit. Kjo ndodhte në pjesën etnografike të Lunxhit, pasi edhe krushqitë me fanatizëm bëheshin brenda për brenda zonës, por jo fshatit, sepse mendohej se ishin farefisni. Kishte raste ama, që vajza të shkonte nuse jashtë kufijve etnografikë të vendlindjes së saj, duke marrë me vete edhe sëndukun, kostumin lunxhot. Kjo është arsyeja pse në disa fshatra rreth kufijve etnografikë e gjeografikë të Lunxhërisë shohim elemente të ngjashme me kostumin e zi (siç e quajnë etnografët) të nuses së

Lunxhërisë. I plotë me të 14 pjesët e veta funksionale (17 gjithsej në kulmin e përdorimit të saj), pavarësisht shtresës shoqërore, gjendet vetëm në zonën etnografike të Lunxhërisë. Mos harrojmë që kostumi i qytetit të Gjirokastrës përbëhet prej 17 pjesësh, ku Pirpiria përdorej vetëm nga gratë e familjeve shumë të pasura. Pra, a nuk është kjo një arsye që kostumi i nuses lunxhote të krahasohej me qytetin? Sinqerisht besoj se po.

Pasurimi i kostumit të nuses sipas katër periudhave historike

Nëse e vërejmë me kujdes çdo pjesë e kostumit është art më vete dhe dëshmon një copëz histori, si dhe zhvillimin e pasurimin, sipas katër periudhave: të antikitetit, bizantine, otomane, të sotme.

Periudha 1. Këmisha e bardhë nga poshtë, që në antikitet, mbulohej me një pelerinë të kapur bukur, gjithmonë mbi krahun e djathtë. Në këtë periudhë bukuria e femrës qëndronte te mënyra e krehjes së flokëve dhe zbukurimet e bizhutë që ajo vendoste në flokë. Shtojmë këtu që te burrat veshja dhe ngjyrat tregonin shtresën shoqërore dhe profesionin, gjë që vazhdoi deri në Bizant. Më vonë me përdorimin e fustanellës, sa më e pasur familja aq më shumë pala kishte fustanella. Kishte arritur edhe deri në 300-400 pala.

Periudha 2. Zbukurimet, ngjyrat e fisnikëve në shek. XIII dhe përdorimi i kadifesë jeshile (vellutoja) në shek. XIV dhe katër brezat ngjyrë floriri që duken nën xhaketën e gjatë dhe tre brezat ngjyrë floriri që duken nën mëngët me llapa.

Periudha 3. Xhaketa e gjatë nga sipër me mëngë që vërtet mund të jetë sjellë nga kurbetllinjtë për herë të parë, por që mori tiparet e vendit, duke krijuar derivatet e veta në çdo fshat. Kjo dukej te qëndisja më fije ari shumë e pasur, ku mbizotëronin motivet e vendit. Fillimisht shumë të hershme ishin motivet si diell, si krimb mëndafshi, pastaj forma e lastarit të përdredhur të hardhisë, të rrushit, duke arritur te tërfili me katër gjethe që gjendej kryesisht edhe përballë në Labëri, sidomos në kulmin e veshjes në masë. Pa harruar mëngët me llapa sipas "modës shqiptare".

Dy llojet e çengelave, i strëgjaturi dhe rrumbullaku, lulëzimi i argjendarisë, shek. XVIII

Kësula dhe bizhutë flori të ndikimit oriental. Vlen të përmendet këtu se edhe kësula ka derivatet e veta sipas fshatrave.

Veshja popullore në përgjithësi bënte dallimin mes fshatrave, por edhe mes moshave brenda në familje. Ndryshe vishej fëmija, ndryshe 14-15 vjeçari, ndryshe nusja e dhëndri, që kishin veshjen më të bukur, ndryshe mosha e mesme apo të moshuarit dhe ndryshe kush ishte në zi.

Periudha 4. Në ditët e sotme ky kostum përdoret për arsye skenike dhe është më tepër i stilizuar sipas origjinalit.

Trekëndëshi kostum i nuses, kënga, vallja

Gjithashtu, art më vete është edhe dasma aq e pasur me gosti, këngë e valle, e cila vazhdonte një javë, nga e diela në të diel, por që në fakt ritet e saj kishin filluar që më herët. Ceremoniali i martesës niste kur krushqari shkonte për vizitë, në ditë feste dhe njoftonte familjen e vajzës. Më pas njoftohej familja e djalit për rezultatin dhe lihej data për bisedimet. Bisedimet bëheshin në qytet nga më të urtët e të dy familjeve, ku qe i pranishëm edhe krushqari. Krushqarit i bëheshin dhuratë një palë këpucë, pasi i griste për t'u bërë krushqia. Aty flitej për pajën, datat etj. Më pas bëhej ndërrimi i amanetit, ku nëna e djalit shkonte me krushqarin vizitë te shtëpia e nuses dhe i jepte nuses një ikonë të Shën Mërisë. Më vonë ky rit u kthye në shkëmbimin e unazave flori. Pasi nëna e djalit jepte aprovimin për nusen bëhej ceremonia e fejesës, por bashkëfshatarët ende nuk mund të shkonin për urim zyrtarisht pa dëgjuar dyfekun e fejesës, edhe pse përshëndesnin me "për hajër ju qoftë". Numri tek i krushqve burra e gra (15) ku bënin pjesë vëllami dhe nuni, niseshin me dhurata e ëmbëlsira, t'i varnin floririn në ballë nuses. Në odë ata uleshin sipas rëndësisë së pozitës në familjen e djalit. Nusja hyn e veshur me kostumin lunxhot, me kësulë me flori dhe gjerdan floriri në gjoks. Floririn në ballë ia var kunata ose teze, hallë nga ana e burrit. Më pas bëhet qerasja dhe krushqit darovitin nusen me lekë, stoli etj. Sapo bëhet kthimi në

shtëpinë e dhëndrit hidhet dyfeku si në shtëpinë e dhëndrit, ashtu edhe në të nuses. Tani fejesa quhej e shpallur.

Pas fejesës bëhej dasma, e cila lihej ditë të diele. Java e dasmës fillonte një të diel më parë dhe quhej dita e orizit. Këndohej kënga "Uromë baba, uromë!". Pastaj djali dërgonte ftesën e tij te vajza me një pagure me verë. Pas kësaj fillonin ftesat me gojë në fshat, kurse për më larg dërgoheshin lajmësit. Në shtëpinë e nuses do të bëhej edhe regjistrimi i pajës, sipas bisedimeve që ishin bërë edhe më parë.

Të hënën bluhej mielli. Të martën e të mërkurën bëhej ndarja e punëve për pjekjen e mishrave e gjellëve, mbartësin e ujit. Të enjten fshati shkonte për dru, me të cilat do piqeshin mishrat e dasmës. Gratë po të enjten zinin brumin dhe pjekjen e bukëve të dasmës. Të premten fillonte pjekja e mishrave vetëm nga një grup i caktuar burrash. Të shtunën dasma bëhej te shtëpia e vajzës. Më i moshuari ngrinte dollinë e parë dhe fillonte festa. Ndryshe nga disa tradita në krahina të tjera ku burrat dhe gratë apo djemtë dhe vajzat këndonin e kërcenin veç, në Lunxhëri, këngët dhe vallet këndohen dhe kërcehen bashkë.

Kënga lunxhiote ka tonalitet të lartë dhe mjaft të qartësuar. Këngët janë polifonike ku një "ia merr", një "ia kthen" , një "ia hedh" dhe të tjerët mbajnë "iso". Vallja e kënduar është herë e shtruar dhe e ëmbël, herë më e gjallë dhe e shpejtë. Funksionin kryesor e luan ai ose ajo që ka aftësi vokale më të mira dhe "ia merr", një "ia kthen", kurse të tjerët "këndojnë" ose ndjekin me fjalë. Pothuajse çdo fshat i Lunxhërisë nga një tekst valleje që flet përbukurinë e fshatit të vet, pastaj të gjithë bashkë për bukurinë e nuses e të dhëndrit. Mendimi i shëndoshë popullor edhe tekstet që i këndojnë ndjenjave i ka lidhur gjithmonë me martesën.

Kënga dhe vallja lunxhote ka një organizim të tillë kaq të mirë, sidomos në dasma, ku çdo etapë e ceremonialit shoqërohet me to dhe kulmi është në momentin e marrjes së nuses, ku çdo gjë është në funksion të saj. Formohet një trekëndësh i gjallë i çuditshëm: kostum i nuses, kënga, vallja.

Në këtë traditë, femrat këndojnë dhe kërcejnë me burrat, duke krijuar një harmoni të veçantë, ku nuk kishte nevojë për instrumente, pasi sinfonia e zërave është kaq perfekte.

Krijimi i grupeve mikse në këngë e valle është shenjë e një civilizimi, dhe në Lunxhëri, ky civilizim është tepër i hershëm.

Nga mesnata vallet vazhdonin me sazet e ardhura nga Delvina, Pogoni, apo Gjirokastra, shtrohej darka dhe kështu mbyllej ceremonia e së shtunës.

Të dielën dhëndri vinte briskun në faqe, kurse në shtëpinë e nuses shtrohej tavolina për të pritur krushqit. Krushqit niseshin me kuaj. Si në vajtje dhe në ardhje gjëmonte kënga. Nusja hipte në mushkë. Në shtëpinë e dhëndrit problemi i parë ishte kush do ta zbriste nusen nga mushka. Të drejtën e fitonte ai që daroviste më shumë.. Nusja duhej të hynte me këmbën e djathtë dhe të bënte një kryq me gishtat e lyer me mjaltë mbi derën e shtëpisë , ku do hynte. Çdo gjë shoqërohej me këngë. Pastaj bëhej ceremonia e kurorëzimit në kishë ose në shtëpi. Pas kësaj fillonte vallja. Në mbrëmje të dielën shtrohej trapezi në shtëpinë e djalit, njëlloj me të njëjtat rite, si në shtëpinë e vajzës të shtunën.

Në ditët e sotme janë reduktuar shumë rite për fat të keq, e së bashku me to edhe këngët e vallet e përdorura dikur. Disa nga ne, ndoshta në fëmijëri apo edhe më vonë , i kemi përjetuar shumë të thjeshtuara këto etapa në gëzimet tona familjare, derisa u ngrit në art në kalanë e Gjirokastrës në FFK. Në fakt,i pari që e ka ngritur në skenë "Dasmën lunxhote", është rilindasi Koto Hoxhi me një grup nxënësish, në vitin 1874. Ai dhe bij të tjerë të Lunxhërisë, mësues vullnetarë të shqipes, u përpoqën që përmes artit dhe vlerave kulturore të ngrinin sa më lart ndjenjën e atdhedashurisë në vend dhe përhapjen e shkrimit të gjuhës shqipe. Nga lugina e Vjosës e poshtë, po ashtu edhe në Lunxhëri flitej dialekti tosk. E veçanta në të folmen e Lunxhit është ndryshimi i përdorimit të ë-së në fund të fjalës, p.sh.: dasëm e jo dasmë, japëm e jo japim, shohëm e jo shohim etj., ose folja *jam e kam* në të pakryer bëjnë, p.sh.: jeshë e jo isha, keshë e jo kisha etj. Mbi të gjitha fjala "jéto" në kuptimin "bir". Siç vërejmë, e folmja e Lunxhërisë ka të dhëna të

vjetra gjuhësore, që e vërteton më së miri “Dasma lunxhote”, në këngët apo në vallet e kënduara.

Sot kostumi i nuses lunxhote origjinal mungon. Imitime të sakta sipas origjinalit janë bërë me iniciativën personale të artizanëve duarartë gjirokastritë, por mendoj se ata duhen ndihmuar. Sidomos me cohat e materialet tepër të shtrenjta, që diktonte kostumi i lunxhes së dikurshme.

Mbyllje

Kostumi i nuses lunxhote për mua personalisht, jo vetëm është një aset, por një monument kulture, që duhet mbrojtur nga shteti , nga UNESCO, së bashku me këngët e vallet e kënduara të dasmës lunxhote.

Detyra jonë: Ndërgjegjësimi.

Ndërgjegjësimi si për parkun natyror të Vjosës, po ashtu edhe për mbrojtjen materiale të zonave përreth, një prej të cilave është Kostumi i nuses lunxhote. Ai është ruajtur me fanatizëm të madh, me dashuri e respekt nga të parët tanë. Ai duhet kthyer në skenën botërore, jo vetëm në FFK , ashtu origjinal, i qëndisur në AR dhe i shoqëruar nga këngët e veta.

Pse duhet shpallur kostumi Lunxhërisë i mbrojtur nga UNESCO?

Historia nuk duhet harruar. Së pari, për mua personalisht, dhe e pohoj me ndërgjegje të plotë, që të ruhet, të trashëgohet në brezat e ardhshëm e, mbi të gjitha, të mos na vidhet. Ka ndodhur në të shkuarën e mund të ndodhë përsëri nëse ne nuk e mbrojmë këtë pasuri të vyer që na kanë lënë të parët. Nuk e di nëse jam e para që po e shpreh, apo nëse është bërë e ditur edhe në Konferenca të tjera, por shpresoj shumë që të kem pasues të shumtë e të denjë. Ashtu si shumë figura të njohura të artit skenik më 2017 sensibilizuan me shprehjen "Mos ma prek Vjosën", po ashtu dhe unë çoj zërin si qytetare, së pari, e më pas si filologe e them " Mbroje Lunxhen!". Shpresoj, që kjo të jetë një nismë e madhe dhe e bukur, që si një ortek të nisë prej këtu e të përfundojë duke pështjellë gjithë botën.

Literatura

Ceka, Neritan; Korkuti, Muzafer. Arkeologjia, Greqia, Roma, Iliria.Tiranë, 1993, Fondacioni Sorros,fq. 15,63, 300,401,402.

Meksi, Aleksandër. Restaurimi i Monumenteve të Arkitekturës. Tiranë, 2004, Eugen,fq. 44,45,47.

Gjergji, Andromaqi.“Veshjet shqiptare në shekuj”. Origjina, Tipologjia, Zhvillimi.Tiranë, 1988, Akademia e Shkencave të Shqipërisë,fq. 17,96,103.

Bërxholi, Arqile. Lunxhëria. Tiranë, 2007, Qendra e Studimeve Gjeografike.

Vasili, Koço. Dasma lunxhote.Gjirokastër, 2013, Argjiro.

Vasili, Koço. Bukuri lunxhote. Gjirokastër, 2012, Argjiro.

Dino, Thanas; Xhevat Avdalli; Laver Bariu. Tiranë, 2004, Mësonjëtorja.

Bogdani, Ramazan. Vallet e Lunxhërisë. Tiranë,1995, Akademia e Shkencave, Instituti i Kulturës Popullore.

Thanati, Dr. Jorgo.Margariti,Theodhos. Selcka e Lunxhërisë.

Mërkuri,Timo. Lezetet e Lunxhërisë. Zemra Shqiptare, Revistë elektronike, E dielë, 14.03.2021,https://www.zemrashqiptare.net/news/56629/timo-merkuri-lezetet-e-lunxherise.html

Etnografia shqiptare, VII, 1976, Akademia e Shkencave të RPSH-së, fq.250.

PARKU KOMBËTAR I LUMIT VJOSA: TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE PËR TË PROMOVUAR TURIZMIN

Prof.asoc.Dr.Albina Sinani[1], PhD Candidate. Fjorentin Ismaili[2]
[1,2]Department of History, Anthropology and Geography, Faculty of Education and Social Sciences,"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
asinani@uogj.edu.al, fismaili@uogj.edu.al

Abstrakti:
Ky studim ka për objekt Parkun Kombëtar të Vjosës, kur hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë (ku fillon rrjedhja e poshtme e lumit Sarandaporos, dega e djathtë e rrjedhjes së sipërme të Vjosës) deri në fillimin e rrjedhjes së mesme. Lugina e Vjosës ka qenë vatër e qytetërimit që në lashtësi, kur lumi quhej Aoos, Aous etj e përbënte boshtin e rrugëve natyrore, si rrugë lidhëse e trevave të Ilirisë JL me brigjet e Egjeut dhe Adriatikut, përgjatë së cilës ishin zhvilluar vendbanimet dhe veprimtaritë ekonomike. Me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 155, datë 13.3.2023 "Për shpalljen e ekosistemit natyror të lumit Vjosa "Park Kombëtar", kategoria II", zona e mbrojtur e parkut, ka një sipërfaqe të përgjithshme 12727 ha. Gjeomonumentet, biomonumentet dhe hidromonumentet, tarracat e Përmetit-lumi Vjosë, me rëndësi kombëtare; shpellat karstike, me rëndësi lokale, rajonale dhe kombëtare; grykat lumore dhe kanionet me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare, të formuara si rezultat i aktivitetit lumor si edhe gërmimet arkeologjike; varrezat tumulare; gjurmët e vendbanimeve të hershme; qytetet e periudhës antike dhe mesjetare përfaqësojnë një magazinë gjigante të trashëgimisë natyrore dhe kulturore,me vlera të mëdha shkencore, didaktike, ekologjike, estetike, shpirtërore dhe eksploruese me mjaft interes për studiuesit dhe turistët.

Fjalët kyçe: *ekosistem, ekoturizëm, gjeoturizëm, qëndrueshmëri, gjeokonservim, trashëgimi natyrore dhe kulturore*

Abstract

The object of this study is the National Park of Vjosa when it enters the territory of the Republic of Albania (where the lower flow of the SarandaporRiver begins, the right branch of the upper flow of The Vjosa) until the beginning of the middle flow. The Vjosa Valley has been the center of civilization since ancient times, when the river was called Aoos, Aous, etc., it was the axis of natural roads, as a connecting road between the territories of Illyria in the south and the shores of the Aegean and Adriatic, along which settlements and economic activities were developed. By Decision of the Council of Ministers, no. 155, dated 13.3.2023 "For the declaration of the natural ecosystem of the Vjosa River "National Park", category II", the protected area of the park, has a total area of 12727 ha. Geomonuments, biomonuments, and hydromonuments, terraces of Përmet-river Vjosë, of national importance; karst caves, of local, regional and national importance; river mouths and canyons of national and international importance, formed as a result of river activity as well as archaeological excavations; tumulus cemeteries; traces of early settlements; the cities of the ancient and medieval period represent a huge warehouse of natural and cultural heritage, with great scientific, didactic, ecological, aesthetic, spiritual and exploratory values of great interest to researchers and tourists.

Keywords:*ecosystem, ecotourism, geotourism, sustainability, geoconservation, natural and cultural heritage*

Hyrje

Lumi Vjosa, një nga lumenjtë e fundit të egër të Evropës, me VKM, nr. 155, datë 13.3.2023, u shpall "Park Kombëtar", duke u bërë parku i parë kombëtar, i një lumi të egër në Evropë(Fletorja

Zyrtare Numri 42, 2023).Zona e mbrojtur, me sipërfaqe të përgjithshme 12727 ha, përfshin 6030 ha (47.3%) sipërfaqe ujore,4593 ha (36.1%) sipërfaqe bregore, 1199 ha (9.5%) sipërfaqe tokësoredhe 905 ha (7.1%) breza lumorë. Parku Kombëtar ndahet në dy nënzona: nënzona qendrore, me sipërfaqe 11822 ha (92.9%) dhe nënzona e përdorimit tradicional të zhvillimit të qëndrueshëm 905 ha (7.1%).

Lumi Vjosa është lumi më i madh në Shqipërinë e Jugut dhe një nga lumenjtë më të mëdhenj të vendit tonë. Ky lumë, nëpërmjet shtratit të tij, derdh në detin Adriatik ujërat që grumbullohen nga pellgu ujëmbledhës, i cili ka një sipërfaqe prej 6710 km^2 ose të njëjtë me 1/4 e sipërfaqes së përgjithshme të territorit të vendit tonë. Zona hidrografike e lumit Vjosa përbëhet prej një numri të madh burimesh, përrenjsh të mëdhenj e të vegjël dhe deri te degët kryesore të këtij lumi si: Drinosi, Shushica etj.Lumi dhe zonat përreth tij janë ekosisteme të një biodiversiteti të konsiderueshëm dhe janë shtëpia e mbi 1100 llojeve të specieve, duke përfshirë 13 lloje kafshësh dhe dy lloje bimore të vlerësuara si të kërcënuara globalisht nga IUCN. Shpallja e lumit Vjosa Park Kombëtar do të lehtësojë zgjidhjet e sfidave me të cilat përballet ekosistemi, si ndotja e ujit dhe tokës, menaxhimi i mbetjeve dhe shpyllëzimi. Shpallja e Parkut Kombëtar do të krijojë mundësi ekonomike për komunitetet lokale, nëpërmjet turizmit të përgjegjshëm dhe do të ndihmojë në adresimin e problemeve që lidhen me migrimin e brendshëm. Marrja e statusit të Kategorisë II të IUCN-së, Park Kombëtar nënkupton që Vjosës do t'i ofrohet mbrojtje, sipas standardeve më të larta ndërkombëtare, duke siguruar integritetin e saj ekologjik, duke lejuar që të ndodhin procese natyrore dhe duke mbështetur popullatat e të gjitha specieve vendëse. Gjithashtu, qeveria shqiptare është angazhuar në një proces të përbashkët me qeverinë greke për krijimin e parkut ndërkufitar Aoös-Vjosa, duke synuar nivelin më të lartë të mbrojtjes për të gjithë lumin, nga burimi në det, në të dy vendet (AKZM, 2024).

Metodologjia

Realizimi i punimit kaloi nga faza teoriko-metodologjike në fazën e aplikimit. Faza e parë lidhet me bazën teorike, konceptuale, metodologjike si dhe evidentimin e vlerësimin shkencor (njohje-edukim-studimetj). Faza e dytë lidhet me vlerësimin e përdorimit, integrimit, zhvillimit, planifikimit, rregullimit dhe administrimit territorial mikrohapësinor, për qëllime turistike dhe metodologjike. Fusha e studimit është një fushë e gjerë ndërdisiplinare. Analiza studimore është mbështetur në bashkëpunimin e zgjeruar ndërsektorial dhe rolin e rëndësishëm të tij në konservimin e zonave të mbrojtura (IUCN, 2021), punën e bërë në AdZM,Gjirokastërsi edhe në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM, 2024).

Njoftime të përgjithshme gjeografike

Vjosa i ka burimet jashtë territorit të Shqipërisë, në malet e Zmolekës dhe të Avgos (në Greqi). Para se të futet në Shqipëri, në Vjosë derdhen ujërat e Vojdomatës (nga e majta e rrjedhjes dhe nga e djathta derdhet lumi Sarandaporos, me sipërfaqe 922 km^2).Pas një rruge të shkurtër, ky lumë hyn në Shqipëri në Perat. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të lumit Vjosa jashtë territorit të vendit tonë është 1940 km^2.



Fig. 1. Harta e pozitës gjeografike të pellgut ujëmbledhës të Vjosës (Pano, 1970)

Në këtë zonë Vjosa rrjedh nëpër një luginë të ngushtë. Pasi hyn në territorin e Shqipërisë, lugina e Vjosës zgjerohet vetëm për një distancë të vogël, deri te bashkimi me ujërat e përroit të Çarshovës, me sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej 90 km^2. Më poshtë deri në derdhjen e përroit të Lemnicës, lugina e lumit Vjosa ngushtohet. Në vazhdim të rrjedhjes e deri në Këlcyrë, lugina elumit përsëri zgjerohet. Gjatë kësaj Vjosa ka drejtim nga juglindja në veriperëndim. Prej Këlcyrës dhe deri në bashkimin me lumin e Drinosit me sipërfaqe 1320km^2, në një gjatësi prej 13.5 km Vjosa rrjedh në drejtim perëndimor. Në këtë zonë Vjosa grumbullon ujërat e mjaft burimeve. Në afërsi të Tepelenës, Vjosa merr ujërat e lumit të Drinos dhe më vonë ato të përroit të Bënçës me sipërfaqe 177 km^2 dhe Luftinjës me sipërfaqe 130 km^2. Ndërmjet Urës së Leklit dhe Tepelenës, shtrati i lumit Vjosa zgjerohet së tepërmi. Ky zgjerim vazhdon deri në zonën që ndodhet ndërmjet derdhjes së përrenjve të Bënçës dhe Luftinjës. Pastaj brigjet e luginës bëhen më të buta dhe lugina fillon të zgjerohet. Vjosa del përfundimisht në zonë fushore, pasi merr ujërat e lumit të Shushicës, me sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej 715 km^2, që është një nga afluentët kryesorë të tij. Në zonën fushore lumi Vjosa endet andej këtej, duke formuar meandra të shumta. Gjatësia e përgjithshme e lumit Vjosa është 221 km, nga të cilat 53 km, ndodhen jashtë territorit të vendit tonë. Në Greqi, Vjosa kalon nëpër një luginë të ngushtë nëpër formacione gëlqerore, ndërsa në Shqipëri pellgu i lumit Vjosa përbëhet kryesisht nga formacione gëlqerore dhe flishi. Pas derdhjes së lumit Sarandaporos e deri në derdhjen e lumit Drino, gëlqerorët janë shumë të karstifikuar. Lumi Drino dredhon në terren kalkar në gjerësi të madhe, pothuajse, të thatë me përjashtim të disa burimeve të bollshme. Nga kufiri e deri sa futet në grykën e Këlcyrës, Vjosa ka një shtrat të ngushtë të përbërë prej konglomeratësh me zgavra në buzë të tij. Pas derdhjes së lumit të Drinos, Vjosa kalon nëpër një shtrat aluvionesh, zhavorishtesh. Me kalimin e grykës së Kalivaçit dhe të Kulës, pjerrësia e lumit zvogëlohet shumë, shtrati zgjerohet duke formuar zona përhapje të ujërave, si dhe këneta përgjatë rrjedhjes së tij, si p.sh. në Karbunar etj.Regjimi i rrjedhjes së lumit Vjosa përcaktohet nga bashkëveprimi i karakterit klimatik me veçoritë fiziko-gjeografike të pellgut ujëmbledhës. Kryesisht, madhësia e rrjedhjes lumore dhe shpërndarja e saj në hapësirë dhe në kohë, përcaktohet nga shkalla e veprimit të faktorëve klimatikë, veçanërisht ajo e reshjeve atmosferike. Duhet theksuar se ndikimi i faktorëve të tjerë fiziko-gjeografikë në regjimin e rrjedhjes së lumit Vjosa, përcaktohet nga shkalla e veprimit të tyre në regjimin e reshjeve dhe në procesin e avullimit. Rrjedhja e lumit Vjosa formohet si rezultat i ujit të grumbulluar nga pellgu ujëmbledhës si rezultat i rënies së reshjeve atmosferike.

Fig. 2. Lugina e Vjosës dhe lugina e Drinos (A.Sinani, 2024)

Sasia më e madhe e reshjeve bie në formë shiu, ndërsa në zonën e lartë në formë dëbore, e cila ndihmon në shtimin e rezervave të ujërave nëntokësore dhe si rezultat, në rritjen e rrjedhjes gjatë periudhës së thatë të vitit.Në sipërfaqen e pellgut ujëmbledhës të lumit Vjosa, bie mesatarisht 1510 mm shi në vit. Në zonën e sipërme deri në Petran, shtresa e reshjeve është 1280 mm, ndërsa deri në Dragot 1520 mm. Sasitë më të mëdha të reshjeve bien në pellgun ujëmbledhës të Drinosit

1980 mm dhe të Shushicës 1840 mm. Norma e rrjedhjes për lumin Vjosa dhe për degët e saj kryesore përbën një nga elementet më të rëndësishme, që paraqet në realitet edhe ujëshmërinë e lumit. Në Petran lumi Vjosa ka një prurje prej 70 m^3/sek, ndërsa në Dragot 95.7 m^3/sek. Pasi merr dhe nga Drinosi edhe 45.6 m^3/sek. Vjosa në Dorzë transporton nëpër shtratin e saj një sasi uji që ka një prurje mesatare prej 172 m^3/sek. Lumi i Shushicës derdh në Vjosë mesatarisht 23.1 m^3/sek.

Si rezultat përfundimtar, lumi Vjosa derdh në detin Adriatik mesatarisht 212 m^3/sek. Koeficientët e rrjedhjes për lumin Vjosa variojnë nga 0.65 deri në 0.72 dhe janë më të lartë se ato të lumit Drin, Erzen dhe Seman. Lumi i Drinos e ka koeficientin e rrjedhjes të ulët 0.56, që tregon për furnizimin me ujë të burimeve të Bistricës nga ky pellg ujëmbledhës.

Një rol të rëndësishëm në regjimin e rrjedhjes ka edhe prurja minimale. Në lumin Vjosa prurjet më të vogla vrojtohen në periudhën korrik-tetor.

Duhet theksuar se në karakterin e rrjedhjes minimale të lumit Vjosa, përveç faktorit klimë, një rol të rëndësishëm paraqet dhe konfiguracioni i relievit të pellgut ujëmbledhës, veshja bimore si dhe vetë ndërtimi gjeologjik i tij.Gjatë periudhës së thatë të vitit, Vjosa në Petran ka një prurje minimale prej 24.3 m^3/sek, ndërsa në Dragot 27.3 m^3/sek. Lumi i Drinos, në periudhën e thatë të vitit derdh në Vjosë një prurje prej 8 m^3/sek. Si rezultat, Vjosa në Dorzë ka një prurje minimale prej 46.9 m^3/sek, ndërsa në Mifol 61.0 m^3/sek. Siç shihet, gjatë periudhës së thatë të vitit, lumi Vjosa ka një prurje rreth 20-25% të normës mesatare shumëvjeçare. Ujërat e Vjosës përdoren gjerësisht për ujitje.

Një aspekt i rëndësishëm i regjimit ujor të lumit Vjosa është edhe përcaktimi i prurjeve maksimale. Në përgjithësi, periudha e prurjeve maksimale në lumin Vjosa përputhet me periudhën e reshjeve intensive, që zgjatin nganëntori deri në mars. Gjatë reshjeve intensive, lumi Vjosa në Petran ka një prurje maksimale prej 1720 m^3/sek, në Dragot 2450 m^3/sek dhe në Mifol 3600 m^3/sek (Pano, 1970).



Fig. 3. Lumi Dorëz: elementet e rrjedhjes (Pano, 1970)

Pellgu ujëmbledhës i Vjosës dallohet për pasuri të rëndësishme të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Përfaqësuesi më kryesor i ujërave sipërfaqësore është rrjedha e sipërme e lumit Vjosa (lumi i Lengaricës, lumi i Lemnicës, përroi i Çarçovës etj), ndërsa nga ujërat nëntokësore veçojmë burimet termale të Bënjës. Regjimi ujor i këtyre lumenjve është i tipit mesdhetar (me luhatje të mëdha të nivelit gjatë vitit), ku ushqimi kryesor përbëhet nga reshjet e shiut, borës dhe sidomos rol të rëndësishëm kanë burimet nëntokësore.

Në këtë pjesë fillojnë të formohen tiparet themelore hidrologjike të Vjosës si një lumë ujëshumë, ku volumi vjetor i ujërave që shkarkon në detin Adriatik është rreth 6.2 miliard m^3, ose 15.6 % të potencialit ujor që formohet në rrjetin e përgjithshëm hidrografik të Shqipërisë. Për sa i përket prurjeve të ngurta, ato janë relativisht të pakta në sektorët ku mbizotërojnë gëlqerorët (36.4 kg/sek në Petran)(Qiriazi, 2010).Si rezultat i procesit të erozionit, Vjosa në Dorzë transporton 5.600.000 ton lëndë të ngurtë në vit (Pano, 1970).Lumenjtë dhe përrenjtë e tjerë që përfundojnë në Vjosë, në përgjithësi janë të përkohshëm. Lumi i Lemnicës (17.7 km), që buron nga mali i Kokojkës në Frashër, ka një prurje mesatare prej 2 m^3/sek. Lumi i Lengaricës (36 km)e ka

prurjen mesatare 8 m^3/sek, ndërsa përroi i Çarshovës (19km) ka një prurje mesatare prej 2.5 m^3/sek dhe derdhet në Vjosë afër fshatit homonim (Qiriazi, 2020).Pjesa e Vjosës nga përroi i Çarshovës deri në lumin e Lengaricës, përbën edhe sektorin ku lugina e saj fillon të ngushtohet, duke marrë drejtimin e rrjedhjes drejt veriperëndimit(Pano, 2015). Burimet termale të Bënjës (burimet e Urës së Katiut) gjenden në të dy brigjet e lumit të Lengaricës. Në bregun e djathtë të saj dalin 4 burime me temperaturë 23-25°C, ndërsa në bregun e majtë dalin 4 burime me temperaturë 30°C. Ujërat përmbajnë deri në 1700 mg/litër lëndë minerale (kryesisht NaCl dhe më pak Ca) dhe shumë gaz sulfuror (H_2S). Ujërat e këtyre burimeve shfrytëzohen për të kuruar sëmundje të gastritit, të ulçerës së stomakut, të reumatizmës, të sëmundjeve të lëkurës etj.Territori i Bashkisë Përmet, ndryshe nga Krahina Malore Jugore, dallohet për një mbulesë bimore të pasur, sidomos përgjatë luginave të lumenjve dhe përrenjve. Në shpatet e maleve të ndërtuara nga formacione gëlqerore, bimësia paraqitet e varfër, madje, sipërfaqe të shumta janë fare të zhveshura. Të katër katet e florës sipas zonalitetit vertikal të Shqipërisë (zona e shkurreve mesdhetare, zona e dushkut, zona e ahut dhe zona e kullotave alpine) i gjejmë të shprehura në këtë hapësirë.Brezi i shkurreve mesdhetare shtrihet deri në lartësinë 700-800 m, përgjatë luginave të Vjosës, Lemnicës, Lengaricës dhe Çarshovës. Këtu takojmë si shkurre gjethembajtëse (mare, shqopë), ashtu edhe ato gjetherënëse. Brezi i dushkut shtrihet nga lartësitë 700-800 m deri në 1300 m. Sipërfaqet më të mëdha të tij gjenden në shpatet jugore dhe perëndimore të maleve të Qelqëzës, Kokojkës, Taborit etj. Brezi i ahut dhe i halorëve është i zhvilluar në territoret me lartësi 1300-1600 m.

Në malësinë e Dangëllisë, ahu zë një sipërfaqe të vogël, vetëm në malin e Qelqëzës, Frashërit etj.Gjithashtu, edhe në shpatin lindor të malit të Nemërçkës vërehet një areal i vogël ahu (1800-1900 m), që përbën edhe kufirin e fundit jugor të rritjes së tij në Shqipëri. Në këtë brez, rritet një masiv i madh pyjor i quajtur "Bredhi i Hotovës" (park kombëtar), i cili përfaqësohet nga bredhi i Maqedonisë, një relikt bimor mesdhetar. Ai formon një masiv të dendur pyjor në malin e Kokojkës dhe të Taborit. Brezi i kullotave alpine (të cilat janë mjaft të pasura në verë) zë territore të pakta, të cilat shtrihen në lartësi që shkojnë mbi 2000-2200 m mbi nivelin e detit. Problem mbetet në Bashkinë Përmet dëmtimi i bimësisë natyrore, kryesisht nga fenomeni i mbikullotjes, prerjeve të pyjeve, zjarreve etj. Bimësia e kultivuar është gjithashtu prezente si në luginën e Vjosës, ashtu edhe në malësinë e Dangëllisë. Fauna në këtë hapësirë paraqitet më e rrallë. Më të përhapurit janë ariu i murrmë në malin e Qelqëzës dhe Kokojkën e Frashërit, dhia e egër në Nemërçkë, kaprolli në Frashër etj., ndërsa nga shpendët përmendim shqiponjën, e cila gjendet në lartësi të mëdha si në Nemërçkë dhe Dangëlliejanë të përhapura edhe thëllëza e malit, skifteri, qyqja, turtulli dhe më rrallë gjeli i egër. Shumë kafshë dhe shpendë të tjerë paraqiten mjaft të rrezikuara nga veprimtaria e njeriut (Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, 1991).

Rezultatet

Në Shqipëri ekzistojnë gjashtë kategori zonash të mbrojtura bazuar në kategoritë e IUCN-së. Sipas Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), *një zonë e mbrojtur është një hapësirë e përcaktuar qartë gjeografikisht, e njohur dhe e menaxhuar nëpërmjet mjeteve ligjore efektive, për të arritur ruajtjen afatgjatë të ekosistemit në lidhje më natyrën dhe me vlerat kulturore të tij* (Dollma, 2014).Këto kategori janë të përcaktuara në bazë të ligjit nr. 8906, datë 6 qershor 2002 "*Përzonat e mbrojtura*". Sipas këtij ligji, *pjesë të rëndësishme ose të kërcënuara të territorit shpallen zona të mbrojtura, të cilat ndahen në gjashtë kategori sipas rëndësisë: zona rreptësisht të mbrojtura (rezervat strikt natyror/rezervat shkencor); parqe kombëtare; monumente natyre; zona të menaxhuara (park natyror); peizazhe të mbrojtura tokësore/detare si dhe zona të mbrojtura për menaxhimin e burimeve natyrore*.Në Bashkinë e Përmetit janë të pranishme kategoria II dhe ajo III e zonave të mbrojtura, ndërsa kategoritë e tjera nuk i kemi prezente në këtë territor. Pjesë e kategorisë së dytë është Parku Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli", i cili është dhe parku kombëtar më i madh në vendin tonë. Në kategorinë e tretë bëjnë pjesë 25 monumente natyre, të cilat ndahen në 12 gjeomonumente, 2 hidromonumente dhe 11 biomonumente. Një objektiv i kategorive të IUCN-së është mbrojtja e tipareve të veçanta

natyrore, biodiversitetit dhe habitateve. Për këtë qëllim, *formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë) me sipërfaqe deri në 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë mineralesh ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, shpallet monument natyror*. Në një monument natyror zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes (IUCN, 2021).Sot në vendin tonë, sipas "*Rrjetit të Zonave të Mbrojtura në Shqipëri*" janë shpallur 750 monumente natyre.Kjo trashëgimi natyrore e shpallur në kategoritë e IUCN-së si zona të mbrojtura, është një potencial i rëndësishëm turistik për Bashkinë e Përmetit.Shqipëria ka të shpallura 15 parqe kombëtare, të cilat zënë një sipërfaqe prej 210501 ha, e barabartë kjo me 45.7% të sipërfaqes së gjithë zonave të mbrojtura ose 7.3% të territorit të vendit (Qiriazi, 2020). Parqet kombëtare janë: *"territore të gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe edukative"* (IUCN, 2021).

Për këtë kategori të zonave të mbrojtura zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, e cila ndalon të gjitha veprimtaritë intensive njerëzore, duke lejuar vetëm ato tradicionalet, që nuk cënojnë vlerat e tyre.Karakteristikat që e dallojnë një park kombëtar nga kategoritë e tjera të zonave të mbrojtura dhe nga zonat përreth janë: parku kombëtar duhet të jetë përfaqësuesi i rajoneve më të mëdha natyrore dhe veçorive biologjike, mjedisore e peizazhore, në të cilat speciet vendëse të bimëve, kafshëve dhe të habitateve në tërësi, së bashku me objektet kulturore, kanë rëndësi shpirtërore, shkencore, edukative, rekreative dhe turistike; zona duhet të ketë përmasa dhe cilësi ekologjike të mjaftueshme, në mënyrë që funksionet dhe proceset ekologjike të garantojnë vazhdueshmërinë e specievevendase, me ndërhyrje minimale të njeriut gjatë menaxhimit të tij; përbërja, struktura dhe funksionimi i biodiversitetit duhet të jenë në një gjendje natyrore ose të kenë potencialin për t'u rikthyer në një gjendje të tillë, në rast rreziku të invazioneve të suksesshme nga speciet jovendase.Në kuadër të funksionimit të parqeve kombëtare me rëndësi është edhe menaxhimi i tyre. Ky menaxhim duhet të plotësojë këto objektiva: të mbrohen zonat natyrore me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare për qëllime shkencore, shpirtërore, edukative dhe/ose turistike; të ruajë në gjendje sa më natyrore modelet përfaqësuese të rajoneve fiziko-gjeografike, të komuniteteve biotike, të burimeve gjenetike dhe të llojeve për të siguruar stabilitetin ekologjik dhe biodiversitetin; të administrojë dhe kontrollojë përdorimin e vlerave nga vizitorët për qëllime shpirtërore, edukative, kulturore dhe pushuese, që zonat të ruhen në një gjendje sa më natyrore dhe të ndalohet përdorimi i tyre në kundërshtim me këto qëllime; të sigurohet respektimi dhe mbrojtja e vlerave, objekteve të shenjta për të cilat zona merret në mbrojtje (Qiriazi, 2020).

Zona e studimit është një fond i pashtershëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore për promovimin e turizmit.

Në të ardhmen, Vjosa do të ruhet si një lumë natyror, me rrjedhje të lirë. Ky është rezultat i një bashkëpunimi unik midis Qeverisë Shqiptare, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, organizatave mjedisore, IUCN (Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës) dhe Patagonia (Vjosa Wild River National Park, 2023).

Rezultatet e pritshme konsistojnë në këto konsiderata:

- Krijimi i mekanizmave të ndërveprimit dhe koordinimit për integrimin dhe bashkëpunimin e palëve të interesuara si edhe rritjen e rolit të organeve të njësive qendrore dhe vendore në vendimmarrje, duke rritur kapacitetet e tyre dhe duke ofruar mundësitë optimale për një vendimmarrje më të mirë.
- Intensifikimi i kërkimit shkencor mbi ekosistemin e basenit të lumit të Vjosës.
- Ndërtimi i bashkëpunimit qytetar për të rritur kapacitetin lokal në menaxhimin e ujërave.
- Realizimi i shkëmbimeve dhe bashkëpunimeve efektive në kontekstin ndërkufitar për basenin

e lumit Vjosë/Aoös.

Diskutime

Në hartën fizike të pellgut të lumit të Vjosës evidentojmë disa site mjaft të vizituara turistike,*si më poshtë vijon:*



Fig. 4. Harta fizike e pellgut të lumit Vjoisa dhe vendndodhja e vendeve të vizituara: 1.Lengarica-1; 2.Lengarica-2; 3.Lengarica-3; 4.Lengarica-4; 5.Petrani (Vjosa); 6.Uji Ftohtë (Këlcyra); 7.Dragoti (Vjosa); 8.Lekli (Drino -1); 9.Lekli (Drino -2); 10.Bënça-1 (Village); 11.Bënça-2 (Tepelena); 12.Kuta (Vjosa); 13.Poçemi-1; 14.Poçemi-2; 15.Mifoli (Vjosa); 16.Vjosa delta (Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, 2024)

Në Bashkinë e Përmetit, monumentet e natyrës (gjeomonumentet, hidromonumentet dhe biomonumentet), paraqesin vlera të trashëgimisë natyrore dhe në kuadrin e zhvillimit të turizmit që të gjithëluajnë një rol të rëndësishëm në itineraret, shtigjet turistike etj (Qiriazi & Sala, 2006).

Në kategorinë e ***gjeomonumenteve*** përfshihen objekte gjeologjike, si: zhveshje apo fosile unikale, struktura e formacione gjeologjike të rralla; objekte gjeomorfologjike: mikroforma, forma dhe peizazhe të relievit të krijuara apo modeluara nga era, akujt, dëbora, ngricat, lumenjtë, karsti, valët detare apo liqenore, erozioni etj (IUCN, 2021).Në bashkinë e Përmetit ndodhen 12 gjeomonumente natyrore me vlera gjeodiversiteti.*Bokërrimat e Dangllisë* ndodhen midis fshatrave Frashër-Miçan dhe Gostënckë, në lartësinë 1000 m mbi nivelin e detit. Ato përbëjnë një peizazh eroziv të formuar nga erozioni i fuqishëm në shkëmbinjtë flishorë, i shkaktuar nga faktorët natyrorë dhe ndërhyrja pa kriter e njeriut në mjedis. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, pedologjike, biologjike), ekologjike, didaktike dhe edukuese. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Frashër-Miçan dhe pastaj merret rruga këmbësore për te monumenti.*Shpella e Pëllumbave* e cila ndodhet në kanionin e Lengaricës, në afërsi të fshatit Petran, 350 m mbi nivelin e detit, përbën një pus të madh karstik të formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të kretakut të sipërm. Ajo është e gjatë 160 m, ndërsa gjerësia dhe lartësia arrijnë deri në 3 m, me disa degëzime anësore. Në këtë shpellë ka mbetje të njeriut të periudhës neolitike. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, arkeologjike), didaktike, ekologjike dhe kulturore. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Petran-Banjat.*Kanioni i Lengaricës* gjendet pranë fshatit Petran, përgjatë sektorit të poshtëm të lumit me të njëjtin emër, 400 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një kanion të formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të kretakut të sipërm, nga veprimtaria karstike dhe erozive e përroit me të njëjtin emër.

Është i gjatë rreth 3-4 km, i thellë deri në 100 m dhe i gjerë rreth 20-30 m. Ka shpate të thepisura dhe në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Petran-Banjat dhe pastaj merret rruga

këmbësore për te monumenti.*Kanioni i Kamenikut* apo *Kanioni i Kamenckës* ndodhet pranë fshatit me të njëjtin emër. Përfaqëson një kanion të formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të kretakut të sipërm nga veprimtaria karstike dhe erozive e përroit me të njëjtin emër. Kanioni është i gjatë rreth 500-600 m, i thellë deri në 80 m dhe i gjerë rreth 8-10 m. Ka shpate të thepisura dhe në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), kulturore, ekologjike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Hotovë dhe pastaj merret rruga këmbësore për monumenti.*Cirku i Nemërçkës* gjendet midis fshatrave Stërmbec e Draçovë, 800 m mbi nivelin e detit dhe përbën një cirk të madh akullnajor të formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të kretakut të sipërm. Ai është i gjatë 2000 m, i gjerë deri në 600 m dhe ka formën e një kolltuku gjigant me disa forma më të vogla karstike. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike), ekologjike dhe kulturore. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Çarçovë dhe pastaj merret rruga këmbësore për te monumenti.

Fig. 5. Kanioni i Lengaricës, Kanioni i Kamenckës dhe Cirqet e Nemërçkës (A.Sinani, 2024)

Gropa e Kazanit e cila ndodhet midis fshatrave Stërmbec-Kalash, 600 m mbi nivelin e detit, përbën një cirk të madh akullnajor të formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të kretakut të sipërm. Ajo është e gjatë 150 m dhe e gjerë deri në 70 m. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Stërmbec dhe pastaj merret rruga këmbësore për te monumenti.*Guri i Atos* është në afërsi të fshatit Kutal, në anën e majtë të lumit të Vjosës, 213 m mbi nivelin e detit. Përbën një gur me formë të veçantë (rrumbullake), i formuar në shkëmbinjtë gëlqeror të kretakut të sipërm. Përmasat e këtij guri nuk janë shumë të mëdha, ai është rreth 15 m i gjatë, i gjerë deri në 10 m dhe i lartë rreth 20 m. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Kutal dhe pastaj merret rruga këmbësore për te monumenti.*Guri i Qytetit* gjendet në qytetin e Përmetit, 250 m mbi nivelin e detit. Përbën një olistolit gëlqeror në masën e flishit oligocenik të zonës tektonike Jonike. Ai ka formë të veçantë dhe përbën një simbol për qytetin e Përmetit. Përmasat e tij janë relativisht të mëdha, me gjatësi e gjerësi rreth 15 m dhe lartësi deri në 25 m. *Guri i Petranit* i cili ndodhet 300 m në afërsi të fshatit Petran, 260 m mbi nivelin e detit, përbën një olistolit me formë të veçantë (kështjelle), me përbërje gëlqerore të kretakut të sipërm në masën e flishit oligocenik të zonës tektonike Jonike. Është i gjatë deri në 50 m, i gjerë rreth 15 m dhe i lartë deri në 30 m. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Petran dhe pastaj merret rruga këmbësore për te monumenti.*Horizonte vithisëse dhe olistolitet e Çarshovës g*jenden në afërsi të fshatit Çarshovë, në veriperëndim të Melesinit. Ka sipërfaqe 5000 m^2 (gjatësi mesatare qindra metra dhe gjerësi rreth 80 m) dhe shtrihet në 500 m lartësi mbi nivelin e detit. Horizonte vithisëse gëlqerore përfaqësojnë olistolite të zonës tektonike Kruja brenda flishit oligocenik të zonës tektonike Jonike. Për të vajtur te ky monument natyre duhet ndjekur ky itinerar: rruga automobilistike Leskovik-Përmet, disa kilometra mbi fshatin me të njëjtin emër.*Perëndi e Boroçkës (Kanioni, Guri i Bletës).* Ndodhet në jug të fshatit Boroçkë 730 m mbi nivelin e detit. Përbën një kanion, të formuar nga erozioni i lumit të Lemnicës dhe karsti në shkëmbinjtë gëlqerorë të kretakut të sipërm, me gjatësi rreth 750 m, ndërsa gjerësia dhe thellësia arrijnë në 100 m.Vizitohet sipas

rrugës automobilistike Përmet-Hotovë.*Pusi i Nemërçkës* gjendet në afërsi të fshatit Konikol, 1200 m mbi nivelin e detit. Përbën një pus karstik të formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të kretakut të sipërm. Është i thellë deri në 30 metra dhe i gjerë rreth 1.5 m. Ka formë cilindrike dhe vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Çarçovë dhe pastaj merret rruga këmbësore për te monumenti. Gjeomonumentet paraqesin vlera mjaft të larta shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike), didaktike, ekologjike, kulturore e turistike (AKZM, 2024).

Në kategorinë e ***hidromonumenteve*** përfshihen: liqene akullnajore e karstike, burime të mëdha dhe interesante karstike, minerare dhe termominerare, shpërthime avulli të nxehtë apo gazi të djegshëm, ujëvara, ligatina etj (IUCN, 2021).*Ujërat termale të Bënjës* që gjenden 7-8 km në afërsi të Petranit, janë burime termominerare me temperaturë rreth 25-30°C. Ndodhen në lartësi 300 m mbi nivelin e detit dhe dalin në të dy anët e lumit të Lengaricës, me përmbajtje squfuri dhe gazrash të tretura në to. Kanë vlera të larta shkencore, sidomos në fushën e gjeologjisë dhe hidrogjeologjisë, sepse lidhen me shkëputjen e madhe tektonike krahinore dhe bëjnë fjalë për lëvizje aktive tektonike, por edhe vlera kuruese, didaktike e turistike. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Petran-Banja dhe pastaj merret rruga këmbësore për te monumenti.

Fig. 6. Ujërat termale të Bënjës (A.Sinani, 2024)

Ujëvara e Sopotit është afër fshatit Stërbec dhe Kalush, 600 m mbi nivelin e detit. Përbën një ujëvarë, uji i së cilës del nga depozitimet fluvio-glaciare, duke formuar kështu një burim të madh karstik dhe ujëvarë me lartësi 20 m. Zhurma e ujit dëgjohet në një distancë mjaft të madhe dhe krijon një pamje me bukuri mahnitëse, me vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), estetike, ekologjikee turistike. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Çarshovë-Stërbec dhe pastaj merret rruga këmbësore për te monumenti (Akzm, 2024).

Fig. 7. Gryka e Këlcyrës dhe burimi i Ujit të Zi në Këlcyrë (A.Sinani, 2024)

Në kategorinë e ***biomonumenteve*** bëjnë pjesë 11 të tilla si drurë, grupe drurësh me kurorë interesante, moshë të hershme, habitate të përbëra nga shoqërime karakteristike bimore ose të gjallesave të rralla, të rrezikuara, endemike (IUCN, 2021). *Bredhi i Çarshovës së Vjetër*, në fshatin Çarshovë, më lartësi 400 m mbi nivelin e detit, një dru me trung dhe kurorë të veçantë

(ovale) me lartësi 25 m dhe diametër të trungut rreth 1.2 m, me moshë mbi 150 vjeçare. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Çarçovë.*Bredhi i Kokojkës-Frashër*, në afërsi të malit të Kokojkës të malësisë së Dangëllisë, në fshatin Frashër, një pyll bredhi i llojit bredhi i Maqedonisë, me lartësi 15-20 m, diametër të trungut rreth 20-30 cm dhe perimetër të tij rreth 80-100 cm. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Frashër-Kokojkë.*Bredhi i Petranit* gjendet në afërsi të fshatit Petran, rreth 300 m mbi nivelin e detit, disa drurë bredhi të llojit bredhi i Maqedonisë, me lartësi mesatare rreth 10-15 m, diametër të trungut 20-30 cm, perimetër të tij rreth 80-90 cm, me moshë rreth 80-100 vjeçare.Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Petran. *Gështenja e Teqesë-Frashër*, në afërsi të fshatit Frashër, pranë teqes së Frashërit, një dru gështenje, me lartësi rreth 18-20 m, diametër të trungut rreth 80-85 cm, perimetër të tij 1.4 m, me moshë mbi 250 vjeçare. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Frashër.*Grumbulli pyjor i Polmenit*, në afërsi të fshatit Qilarishtë, njësia administrative Petran, në shpatin e djathtë të Vjosës, rreth 300 m mbi nivelin e detit, i përbërë nga 25 drurë, 15 prej tyre rrepe dhe 10 dru arre. Lartësia e rrepeve është 23 m, ndërsa diametri i trungut arrin në 120 cm. Drurët e arrave arrijnë lartësinë 16 m, ndërsa trungu e ka diametrin deri në 86 cm, me moshë 300 vjeçare. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Qilarishtë.*Pylli i Gërhotit*, në jug të fshatit Çarçovë, 1400 m mbi nivelin e detit, një pyll me sipërfaqe 45 ha, i përfaqësuar nga bredhi, mëlleza, bliri, me diametër mesatar të trungut deri 25 cm, me moshë 80 vjeçare. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Çarçovë.*Pylli i Ropushës*, i njohur si pylli i Llopushës,në malësinë e Dangëllisë, 1200-1650 m mbi nivelin e detit, kryesisht një pyll lisi, me lartësi 20 m e diametër të trungut rreth 0.7 m, me moshë mbi 100 vjeçare. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Frashër-Vërçisht.*Rrapi i Megallarës*, në veriperëndim të fshatit Gjinakar, 450 m mbi nivelin e detit, një dru me trung dhe kurorë të veçantë (ombrelle), me lartësi 25 m dhe diametër të trungut rreth 2.4 m, me moshë mbi 400 vjeçare. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Gjinakar.*Rrapi i Zhepës*, në fshatin e Zhepës, 600 m mbi nivelin e detit, një dru me trung dhe kurorë të veçantë (ovale), me lartësi 25 m dhe diametër të trungut rreth 2.4 m, me moshë mbi 200 vjeçare. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Zhepë.

Selvia e Kishës në Leusë, në afërsi të kishës në fshatin Leusë, me dy drurëselvie, me lartësi mbi 20 m, diametër të trungut 40-50 cm, perimetër të tij rreth 1 m, me formë shumë të rregullt të kurorës, në trajtën e një koni, me moshë rreth 150 vjeçare. Vizitohet sipas rrugës automobilistike Përmet-Leusë.*Pylli i Çukës*, në qendër të fshatit Çukë, 680 m mbi nivelin e detit, një pyll me trung dhe kurorë të veçantë (ombrelle), me lartësi 25 m dhe diametër të trungut rreth 0.8 m, me moshë mbi 120 vjeçare. Biomonumentet paraqesin ekosisteme me vlera mjaft të larta jovetëm biodiversiteti dhe shkencore (biologjike e ekologjike), por edhe estetike, kulturore, fetare, didaktike si edhe turistike (AKZM, 2024).

Fig. 8. Trashëgimia natyrore dhe kulturore e bashkisë Përmet(F.Ismaili, 2024)

Fig. 9. Harta e zhvillimit të turizmit në qarkun e Gjirokastrës (A.Sinani, 2024)

Konkluzione

Lumi Vjosa është lumi më i madh në Shqipërinë e Jugut dhe një nga lumenjtë më të mëdhenj të vendit tonë. Zona hidrografike e lumit Vjosa përbëhet prej një numri të madh burimesh, përrenjsh të mëdhenj e të vegjël dhe deri te degët kryesore të këtij lumi, si Drinosi, Shushica etj., një trashëgimi e pasur për zhvillimin e turizmit.Shpallja e Parkut Kombëtar do të krijojë mundësi ekonomike për komunitetet lokale, nëpërmjet turizmit të përgjegjshëm.

Gjithashtu, ai do të ndihmojë në adresimin e problemeve që lidhen me migrimin e brendshëm. Marrja e statusit të Kategorisë II të IUCN-së, Park Kombëtar nënkupton që Vjosës do t'i ofrohet mbrojtje, sipas standardeve më të larta ndërkombëtare, duke siguruar integritetin e saj ekologjik, duke lejuar që të ndodhin procese natyrore dhe duke mbështetur popullatat e të gjitha specieve vendase.

Rekomandime:

- të zhvillohet Parku Kombëtar i Vjosës, i integruar ngushtë me planifikimin mjedisor;
- të hartohet një plan i integruar menaxhimi për përballimin e sfidave të shumta;
- të analizohet thellësisht planifikimimjedisor strategjik, në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar;
- të njihet në detaje legjislacioni i zonave të mbrojtura, në kuadër të Bashkimit Evropian;
- t'i jepet rëndësi rrjetit të hapur të grupeve të interesuara mbi turizmin në Parkun Kombëtar të Vjosës: organizatat shqiptare të biznesit;bizneset që kanë detyrime ndaj mjedisit dhe bëjnë pjesë në industritë e turizmit dhe të ndërtimeve;organizatat jofitimprurëse;autoritetet arsimore;autoritetet shëndetësore;përfaqësuesit ligjorë;ekonomistët;masmedia;kryetarët e bashkive;përfaqësues të organeve vendore/lokale;përfaqësues të ministrive përkatëse;
- të mbrohet biodiversiteti ku në origjinë qëndrojnë: diversiteti i pasur biologjik e peizazhor, pozicioni gjeografik, faktorët gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë, relievi, klima etj.

Literatura

Administrata e Zonave të Mbrojtura (2024), AdZM, Gjirokastër.

Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (2024), https://akzm.gov.al, Tiranë.

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Gjeografia Fizike e Shqipërisë, Vëllimi I, II. (1991), Tiranë, fq.293-296; 333-342; 346-360.

Dollma, M., (2014). Ekologjia Humane, Marin Barleti, Tiranë, fq. 99.

Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 42, Datë. 16 mars 2023, Vendimi Këshillit të

Ministrave nr.155, datë 13.3.2023 "*Për shpalljen e ekosistemit natyror të lumit Vjosa "Park Kombëtar"*", www.qbz.gov.al, fq. 4459.

IUCN World Conservation Congress (2021), https://www.iucn.org/, Marseille, France, 3–10 September.

Pano, N. (1970). Hidrografia e Shqipërisë, Instituti Hidrometeorologjik, Dega e Hidrologjisë, Tiranë, fq.22-25.

Pano, N., (2015). Pasuritë ujore të Shqipërisë. Monografi.Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, fq. 410-427; 418-419; 422-428.

Qiriazi, P., Sala, S., (2006). Monumentet e natyrës së Shqipërisë. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.Botimet ideart, Tiranë, fq. 68-69.

Qiriazi, P., (2010). Gjeografia Fizike e Shqipërisë, Ideart, Tiranë, fq. 107.

Qiriazi, P., (2020). Trashëgimia natyrore e Shqipërisë (Vlerat, Rreziqet dhe Menaxhimi), Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Kristalina, Tiranë, fq. 257-273.

Vjosa Wild River National Park (2023), https://www.parkukombetarvjosa.al/, Tiranë.

TRASHËGIMIA NATYRORE DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM NË PELLGUN UJËMBLEDHËS TË VJOSËS

MSc. Xhuliana Zdrava, Dr. Mariglen Sherifaj
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
xhuliana.zdrave@outlook.com, msherifaj@uogj.edu.al

Përmbledhje

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm, në vitet e fundit, në Shqipëri një rëndësi të madhe ka marrë edhe evidentimi, shpallja dhe menaxhimi i zonave të mbrojtura, pjesë e trashëgimisë natyrore. Si një aset i rëndësishëm i mjedisit, trashëgimia natyrore shërben si një model i zhvillimit të qëndrueshëm ku ruhen balancat në trekëndëshin njeri-natyrë-ekonomi. Trashëgimia është një mënyrë e rëndësishme në të cilën njerëzit lidhen dhe vlerësojnë mjedisin dhe në këtë mënyrë ofron një perspektivë të dobishme për sfidat e qëndrueshmërisë. Ajo që nënkuptohet me trashëgimi rrallëherë përpunohet në kërkimin e qëndrueshmërisë dhe trashëgimia shpesh konsiderohet si diçka që ekziston së bashku, por është e jashtme ndaj mjedisit natyror. E parë në këtë fokus, shpallja e Parkut Kombëtar të Vjosës, do të ndikoj në përmirësimin ekologjik të kësaj hapësire, rigjenerimin dhe shfrytëzimin racional të resurseve natyrore, në zhvillimin e degëve të ekonomisë dhe veçanërisht turizmin, si një degë prioritare e vendit tonë. Qëllimi i këtij punimi është analizimi i zonave të mbrojtura në pellgun ujëmbledhës të Vjosës, tipologjia e tyre, vlerat mjedisore që ato kanë, dhe mundësitë për zgjerimin e tyre në të ardhmen si pjesë e një rrjeti ekologjik kombëtar, rajonal apo më gjerë. Përdorimi i metodave hartografike, përshkruese, analizuese etj., do të nxjerr në pahë rëndësinë që ka mbrojtja e trashëgimisë natyrore në qëndrueshmërinë e rajonit me potenciale natyrore dhe turistike siç është rajoni Jugor i Shqipërisë.

Fjalë kyçe: *zhvillim i qëndrueshëm, trashëgimia natyrore, Park Kombëtar, lumi Vjosë, Shqipëri*

Abstract

Within the framework of sustainable development, in recent years, in Albania, great importance has been placed on the identification, declaration, and management of protected areas, part of natural heritage. As an important environmental asset, natural heritage serves as a model of sustainable development where balances are maintained in the human-nature-economic triangle. Heritage is an important way in which people relate to and value the environment and thus provides a useful perspective on sustainability challenges. What is meant by heritage is rarely elaborated in sustainability research, and heritage is often regarded as something that exists alongside but is external to, the natural environment. Viewed in this focus, the announcement of the Vjosa National Park will affect the ecological improvement of this space, the regeneration and rational utilization of natural resources, in the development of the branches of the economy and especially tourism, as a priority branch of our country. The purpose of this paper is to analyze the protected areas in the Vjosa watershed, their typology, the environmental values they have, and the possibilities for their future expansion as part of a national, regional, or wider ecological network. The use of mapping, descriptive, analyzing methods, etc., will highlight the importance of protecting natural heritage in the sustainability of the region with natural and tourist potentials such as the southern region of Albania.

Keywords: *sustainable development, natural heritage, National Park, Vjosa River, Albania.*

Hyrje

Trashëgimia përfshin në vetvete vlera natyrore e kulturore që përcillen brezë pas brezi. Kur pjesë e saj janë vlera të mjedisit natyror, kemi të bëjmë me trashëgimi natyrore. Në përbërje të kësaj trashëgimie përfshihen objekte, peizazhe, ekosisteme, habitate më të veçanta, të rralla apo

unike, relikte, endemike apo të rrezikuara për t'u zhdukur. Si të tilla, ato kanë rëndësi të madhe shkencore, ekologjike, kulturore, didaktike apo edhe turistike.

Të gjitha këto objekte, peizazhe, habitate e ekosisteme cilësohen trashëgimi natyrore e veçantë, që kushtëzohet vetëm nga ligjësitë natyrore, ndërsa veprimtaria njerëzore ushtrohet vetëm për t'i mbrojtur dhe për t'i evidentuar vlerat e tyre, që shprehen në bidiversitetin shumë të pasur dhe në peizazhin e veçantë.[1]

Trashëgimia është një mënyrë e rëndësishme në të cilën njerëzit lidhen dhe vlerësojnë mjedisin dhe në këtë mënyrë ofron një perspektivë të dobishme për sfidat e qëndrueshmërisë.
Ajo që nënkuptohet me trashëgimi rrallëherë përpunohet në kërkimin e qëndrueshmërisë dhe trashëgimia shpesh konsiderohet si diçka që ekziston së bashku, por është e jashtme ndaj mjedisit natyror.

E parë në këtë fokus, shpallja e Parkut Kombëtar të Vjosës do të ndikojë në përmirësimin ekologjik të kësaj hapësire, rigjenerimin dhe shfrytëzimin racional të resurseve natyrore, në zhvillimin e degëve të ekonomisë dhe veçanërisht turizmin, si një degë prioritare e vendit tonë.

Qëllimi i këtij punimi është analizimi i zonave të mbrojtura në pellgun ujëmbledhës të Vjosës, tipologjia e tyre, vlerat mjedisore që ato kanë, dhe mundësitë për zgjerimin e tyre në të ardhmen si pjesë e një rrjeti ekologjik kombëtar, rajonal apo më gjerë.

Metodologjia e përdorur është ajo e hulumtimit të literaturave të ndryshme, metodave hartografike, përshkruese, analizuese etj.

Pellgu ujëmbledhës i Vjosës

Vjosa është lumi më i madh në Shqipërinë e Jugut dhe një ndër lumenjtë më kryesorë të rrjetit hidrografik të Shqipërisë, i dyti për nga gjatësia (275 km).

Ndërtimi i veçantë morfometrik i pellgut të tij ujëmbledhës, dendësia e madhe e rrjetit hidrografik, si dhe larmia e peizazheve gjatë luginës së këtij lumi, e shoqëruar me bimësi të shumëllojshme e të dendur drufrutore, ka bërë që Vjosa të përmendet me admirim për bukurinë e saj të rrallë si një nga lumenjtë më piktoreskë të gadishullit Ballkanik.[2]

Vjosa është i vetmi lumë i egër në Evropë, me rrjedhje të natyrshme, i pandërprerë me diga nga burimi e deri në grykëderdhje në det. Për këtë arsye, ajo është e rëndësishme jo vetëm për biodiversitetin, por edhe për të ardhmen ekonomike të zonës.

Foto Xh.Zdrava

Në pellgun ujëmbledhës të këtij lumi, janë dy nga parqet tokësore, i Veriut të Pindit dhe Parku Kombëtar Bredhi i Hotovës, me trashëgimi unike gjeologjike e gjeomorfologjike, me larmi të madhe peizazhesh dhe habitatesh, ku jetojnë gjallesa endmike, të rralla, të mbrojtura etj.[3]

---

[1] P. Qiriazi.Trashëgimia natyrore e Shqipërisë, fq. 17.

[2] N.Pano. Pasuritë ujore të Shqipërisë, fq. 255.

[3] P. Qiriazi.Trashëgimia natyrore e Shqipërisë, fq. 371.

Pellgu i Vjosës është vendosur midis koordinatave gjeografike me gjerësi veriore 40º 35' (veri) dhe 20º 35' (lindje) dhe 19º 38' (perëndim).[4] Sipërfaqa e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës të Vjosës është 6799,35 km².[5]

Pellgu i Vjosës ndërtohet, thuajse, nga të gjitha formacionet gjeologjike të zonës Jonike. Elementet kryesore strukturore të pellgut janë: brezi sinklinali i Përmetit, brezi antiklinal i Beratit, brezi sinklinal i Memaliajt, brezi antiklinal i Kurveleshit.[6] Relievi me shumë kontraste dhe i larmishëm fillon nga 0 deri në 2485 m (maja e Papingut në Nemërçkë).

Klima në këtë pellg është mesdhetare, gjë që pasqyrohet qartë në temperaturat, karakterin dhe shpërndarjen e çrregullt të reshjeve, numrin e ditëve me diell dhe elementet e tjera klimatike.[7]

Rrjeti hidrografik i pellgut të Vjosës përfaqësohet në radhë të pare, nga rrjedhja e sipërme dhe e mesme e lumit Vjosa. Në këtë pjesë formohen përfundimisht tiparet themelore hidrologjike të Vjosës si një lumë ujëshumë. Në formimin e regjimit të Vjosës në këta sektorë të rrjedhjes rol të madh luajnë burimet e shumta nëntokësore, sidomos ato që merr në grykën e Këlcyrës (Uji i Zi etj.), si dhe një radhë degësh të rëndësishme e me prurje të konsiderueshme, si Lengarica, Çarshova, Dëshnica, Lemnica etj.[8]

Tokat e pellgut të Vjosës janë formuar mbi formacione të larmishme (gëlqeror, flishe e molasa dhe depozitime të kuaternarit). Kushtet klimatike, mbulesa bimore dhe përbërja litologjike, kanë përcaktuar zhvillimin e tokave: livadhore malore, të murrme pyjor, të kafenjta, të hirëta kafe dhe aluvionale.[9]

Mbulesa bimore në luginën e Vjosës përfaqësohet kryesisht nga shkurret mesdhetare të tipit të makjeve (mare, shqopë, xinë etj.) që shtrihen deri në thellësi të luginës, por më të zhvilluara janë në shpatin e djathtë të Vjosës, të ekspozuar diellit. Bimësia natyrore e luginës së Vjosës ka pësuar shndërrime nga dora e njeriut. Janë shpyllëzuar sipërfaqe të mëdha dhe janë zëvendësuar me bimë arash e drurë frutor si ullinj, hardhi, bajame, shegë, agrume etj.[10]

Trashëgimia natyrore e zonave të mbrojtura të pellgut të lumit të Vjosës

Trashëgimia natyrore i referohet veçorive natyrore, formacioneve gjeologjike dhe fiziografike si dhe zonave të përcaktuara që përbëjnë habitatin e specieve të kërcënuara të kafshëve e bimëve dhe zona natyrore me vlerë nga pikëpamja e shkencës, ruajtjes ose bukurisë natyrore. Ajo përfshin zona natyrore private dhe publike të mbrojtura, kopshte zoologjike, akuariume dhe kopshte botanike, habitate natyror, ekosistemet detare, vendstrehime, rezervuare etj.[11]

Degët dhe ujërat e shumta, pyjet e dendura, kullotat e gjelbra në fusha dhe në rrafshnalta, biodiversiteti shumë i pasur përgjatë mijëvjeçarëve, e kanë bërë pellgun ujëmbledhës të Vjosës shumë tërheqës dhe të dashur për shumë njerëz, kulturat e të cilëve u zhvilluan në harmoni me mjedisin.

Vjosa është i vetmi lumë i egër në Evropë, me rrjedhje të natyrshme, i pandërprerë me diga nga burimi e deri në grykëderdhje në det. Për këtë arsye, ajo është e rëndësishme jo vetëm për biodiversitetin, por edhe për të ardhmen ekonomike të zonës. Vjosa nuk përbën vetëm një aset

---

[4] N. Mecaj.Pellgu i Vjosës, fq. 5.

[5] P. Qiriazi.Trashëgimia natyrore e Shqipërisë, fq. 370.

[6] N. Mecaj.Pellgu i Vjosës, fq. 54.

[7] N. Mecaj.Pellgu i Vjosës, fq. 133.

[8] P.Qiriazi.Gjeografia Fizike e Shqipërisë, fq. 342.

[9] N. Mecaj. Pellgu i Vjosës, fq. 161.

[10] P.Qiriazi.Gjeografia Fizike e Shqipërisë, fq. 342.

[11] Natural heritage | UNESCO UIS

natyror të Shqipërisë dhe Greqisë, por edhe një thesar në trashëgiminë natyrore të familjes evropiane.[12] Në vijimësi të punimit pasqyrohet trashëgimia natyrore e zonave të mbrojtura të Vjosës në tabelë dhe më pas shkurtimisht përshkrimi i disa prej këtyre zonave që janë pjesë e pasurisë natyrore të vendit.

Tabela 1. Trashëgimia natyrore e zonave të mbrojtura të pellgut të lumit të Vjosës

Emri	Kategoria	Funksioni/Niveli i mbrojtjes
Dushku i Kardhiqit	**1**	**Rezervat Strikt Natyror**
Bredhi i Hotovës- Dangëlli	**2**	**Park Kombëtar**
Uji i Ftohtë	**3**	**Monument Natyre**
Zhej	**3**	**Monument Natyre**
Bredhi i Sotirës	**3**	**Monument Natyre**
Shelegur-Germenj	**4**	**Park Kombëtar**
Pishë Poro	**4**	**Park Kombëtar**
Levan	**4**	**Park Kombëtar**
Vjosë-Nartë	**5**	**Zonë e Mbrojtur**
Piskal-Shqeri	**6**	**Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara**

Burimi: Sala.S;Qirjazi, P. Kushtet gjeografike të pellgut ujëmbledhës të Vjosës. Konferencë shkencore për Vjosën, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës; Universiteti i Vjenës, Austri; Universiteti i Burimeve Natyrore dhe të Shkencave të Jetës(BOKU), Vjenë, Austri; Instituti Leibniz i Ekologjisë së Ujërave të Ëmbla dhe Peshkimit të Brendshëm (IGB), Berlin, Gjermani. 08 qershor 2016, Tiranë.

Parku Kombëtar Bredhi i Hotovës- Dangëlli

Masivi i "Bredhit të Hotovës", u shpall PK në vitin 1996. Bën pjesë në Rrjetin e Parqeve të Harkut Dinarik, ndërsa 4200 ha të tij bëjnë pjesë në rrjetin "Emeralde". Ndodhet në bashkinë e Përmetit e të Këlcyrës (qarku i Gjirokastrës), në bashkinë e Kolonjës (qarku i Korçës) dhe në bashkinë e Çorovodës (qarku i Beratit), 35 km në VL të qytetit të Përmetit; në malësinë e Dangëllisë dhe të Shqerisë dhe në lartësitë nga rreth 230 m në 1663 m mbi nivelin e detit. Ky park është më i madhi i vendit dhe dallohet për vlera të larta të biodiversitetit.[13]

Burimi i Ujit të Ftohtë

Gjendet pranë rrugës Tepelenë-Gjirokastër. Burimi karstik del në kontaktin tektonik midis gëlqerorëve e flishit. Shpati përreth është i veshur me dushqe, shkurre dhe rrepe qindra vjeçarë. Pranë është pika turistike. Burimi ka vlera shkencore hidrologjike, gjeomorfologjike, estetike, turistike. Vizitohet sipas rrugës Tepelenë-Gjirokastër. [14]

Zheji (1500 ha)

Ndodhet në bashkinë e Libohovës të qarkut të Gjirokastrës, në shpatin L të malit të Lunxhërisë, afër qafës së famshme të Çajupit, në lartësitë 600 m deri 1776 m. I gjithë siti ka vlera natyrore, biologjike, peizazhore dhe skenike të veçanta. Është mjaft i ruajtur, por ende nuk ka planmenaxhimi.[15]

Bredhi i Sotirës (1740 ha)

Ndodhet në bashkinë e Dropullit të qarkut të Gjirokastrës, në skajin JL të malit të Stugarës, në

[12] Qiriazi P.Trashëgimia Natyrore e Shqipërisë, fq. 370.

[13] Qiriazi P.Trashëgimia Natyrore e Shqipërisë, fq. 211.

[14] Qiriazi P.;Sala.S.Monumentet e Natyrës të Shqipërisë, fq 74.

[15] Qiriazi P.Trashëgimia Natyrore e Shqipërisë, fq. 280.

pellgun ujëmbledhës të përroit të Sotirës, degë e majtë e lumit të Drinos; nga rreth 550 m deri 1806 m mbi nivelin e detit. Ka vlera të mëdha, shkallë të mirë të mbrojtjes dhe pozicionim larg veprimtarive intensive njerëzore.

Levan

Ndodhet në bashkinë e Fierit të qarkut homonim, në kodrat e Frakullës, në lartësitë nga rreth 70 m në 241 m mbi nivelin e detit.

Territori i rezervatit përbëhet nga molasa, me mbizotërim të argjilave, rërave dhe ranorëve, ndërsa relievi kodrinor ka pjerrësi të vogël të shpateve ku zhvillohet erozion i paktë. Bimësia përbëhet nga shkurre mesdhetare dhe nga pylli i dushkajave, tepër i degraduar nga prerjet abuzive, mbikullotja dhe zjarret, që vështirësojnë ripërtëritjen. Ka dhe ripyllëzime me lloje të pishave mesdhetare. Nuk dallohet për larmi të biodiversitetit. Gjithsesi, rezervati ka rëndësi për mbrojtjen e peizazhit dhe zhvillimin e turizmit.

Nuk ka plan menaxhimi. Duke u nisur nga shkalla e madhe e dëmtimit dhe nga vështirësitë e ripërtëritjes në kushtet e klimës mesdhetare dhe, sidomos, të trysnisë së madhe njerëzore, ky rezervat ka nevojë për trajtim të veçantë.[16]

Vjosë- Nartë

Ndodhet në bashkinë e Vlorës të qarkut homonim; shtrihet nga grykëderdhja e Vjosës deri afër Vlorës, deri 246 m lartësi mbi nivelin e detit, midis fshatrave Hoshtimë dhe Llakatund. U shpall në vitin 2004. Bën pjesë në rrjetin "Emeralde".[17]

Vjosë- Nartë është e njohur për florën e veçantë dhe larminë e habitateve, me vlera të veçanta shkencore, ekologjike (shumë gjallesa të rralla) dhe ekonomike (bimë mjekësore, aromatike, industriale dhe dekorative).

Harta e Zonave të Mbrojtura në basenin e Vjosës



Punoi: Dr. Mariglen Sherifaj

Zhvillimi i qëndrueshëm në pellgun e Vjosës

Zhvillimi i qëndrueshëm ka fituar konsensus dhe pranim të gjerë që nga momenti kur u vendos në axhendën globale nga Komisioni Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin në vitin 1987. Përkufizimi më i cituar i zhvillimit të qëndrueshëm, botuar në Raportin Brundtland (WCED, 1987), referohet si: 'zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes pa cënuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre'. Ky raport ilustron dilemën e natyrshme në zhvillimin njerëzor midis plotësimit të nevojave njerëzore, në veçanti raporti ngre dy problematika, përveç shumë të tjerave, atë të nevojave thelbësore të shtresës së varfër në botë

[16] Qiriazi P.Trashëgimia Natyrore e Shqipërisë, fq. 300.

[17] Qiriazi P.Trashëgimia Natyrore e Shqipërisë, fq. 332.

dhe kufizimeve në aftësinë e mjedisit për të përballuar pasojat si në termat afatshkurtës, po ashtu dhe në termat afatgjatë.
Zhvillimi i qëndrueshëm i lumenjve kërkon menaxhimin e një sërë sistemesh të mbivendosura dhe të lidhura ngushtë me njëra - tjetër, të cilat ndryshojnë në kohë (ditë, muaj, vit), në hapësirë (lumenjtë shpesh tejkalojnë kufij qyteti apo shtetesh), në kontekst global (fenomene si ndryshimet klimatike apo integrimi i ligjeve, konventave dhe rregulloreve evropiane në kontekstin e një shteti si Shqipëria) dhe nën dikimin e gjerë horizontal (ndikim mjedisor, social, ekonomik). Mbivendosja e të gjitha këtyre sistemeve me tërësinë e elementeve që e karakterizon secilën prej tyre në një plan menaxhimi për zhvillimin afatgjatë të qëndrueshëm të një lumi, sidomos, në rastin e Shqipërisë është zhvilluar vetëm në dimensione pjesore.
Përgjatë 20 viteve të fundit janë zhvilluar rregulla operacionale, ligje, konventa dhe plane të shumta për menaxhimin e lumenjve kudo në botë, si një interes i shtuar, por padiskutim dhe një nevojë emergjente. Ajo që mund të kuptohet qartë në vitet e fundit, është se menaxhimi i lumenjve duhet të bazohet në një studim shkencor të thelluar dhe të përditësuar, por, përveç kësaj, e cila është një domosdoshmëri për të gjitha llojet e studimeve, të kuptuarit e kushteve dhe tendencave mjedisore për lumenjtë, kërkon kërkime të fushave të shumta ndërdisiplinore. Lumi Vjosa ka qenë subjekt vitet e fundit i jo pak polemikave, për shkak të rreziqeve të shumta të ndërtimit të HEC-eve dhe të iniciativave të shumta vendase dhe të huaja, për ta kthyer atë në statusin e parkut kombëtar, në mënyrë që të arrihet të mbrohet nga të tilla kërcënime të vazhdueshme.[18]
Vjosa duhet të ruhet për të mirën e natyrës/mjedisit padiskutim, por jo vetëm, edhe për komunitetin e luginës së Vjosës dhe potencialin e tyre për zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik. Një plan për zhvillimin e qëndrueshëm të lumit Vjosa, është i domosdoshëm dhe është urgjent.

Vjosa ndodhet aktualisht nën trysninë e shumë faktorëve (të brendshëm dhe të jashtëm). Duke filluar nga ndotja e ujit, shfrytëzimi pa kriter i inerteve, mbetjet urbane, përpjekjet e investitiorëve për të ndërtuar hidrocentrale, krimi mjedisor etj. Të gjithë këta faktorë janë ajo që do ta quajmë trysnia e ndikimit njerëzor. Por Vjosa, nga ana tjetër, ndodhet edhe në trysninë e faktorëve natyrorë, si erozioni, ndryshimet klimatike, përmbytjet etj.[19] Prandaj, çështja në fokus të propozimit të kësaj teme është shumë e rëndësishme në disa aspekte kryesore:

a. *Në aspektin mjedisor*

Bazuar në analizën e EUROSTAT-it, lumenjtë në Shqipëri paraqiten me ndotjen me të madhe në Evropë, përsa i takon pranisë së kimikateve dhe fosfateve për vitin 2019, të përdorura pa kontroll në bujqësi.[20] Lumi Vjosa nga ana tjetër, përveç rreziqeve të ndotjes së ujit, paraqet problematika lidhur me shfrytëzimin pa kriter të inerteve, derdhjen e mbeturinave urbane, përpjekjet e investitiorëve për të ndërtuar hidrocentrale, krimi mjedisor etj.

b. *Në aspektin socio-ekonomik*

Ndikimi i faktorit njerëzor në luginën e lumit Vjosa dhe dëmtimi i këtij ekosistemi ka sjellë dhe mbi të gjitha do të sjellë pasoja afatgjata në socio-ekonominë e komuniteteve që jetojnë përreth lumit. Pasojat mjedisore të përmendura më lart, po ashtu, do të kenë impakt të lartë socio-ekonomik, i cili duhet studiuar dhe ka një rol të rëndësishëm në hartimin e planit të zhvillimit të qëndrueshëm të lumit Vjosa.

c. *Në aspektin ligjor, si një faktor i rëndësishëm i cili ndikon në tri dimensionet e sipërpërmendura (sociale, ekonomike dhe mjedisore)*

---

[18] (2) (PDF) MATJA E QËNDRUESHMËRISË SË LUMIT 'VJOSA' Final Shqip (researchgate.net)

[19] (2) (PDF) MATJA E QËNDRUESHMËRISË SË LUMIT 'VJOSA' Final Shqip (researchgate.net)

[20] (2) (PDF) MATJA E QËNDRUESHMËRISË SË LUMIT 'VJOSA' Final Shqip (researchgate.net)

Vendit tonë i duhet të përmbushë detyrimet dhe kushtet për anëtarësim në BE. Si pjesë e procesit të integrimit në BE, vendit tonë i duhet të adoptojë legjislacionin kombëtar në bazë të direktivave dhe rregulloreve të BE-së dhe Komisionit Evropian, me qëllim arritjen e kohezionit mes vendeve aspirante dhe atyre të BE-së. Dimensioni ligjor është shumë i rëndësishëm për parandalimin e pasojave mjedisore, sociale dhe ekonomike të përkeqësimit të gjendjes së lumit Vjosa në të ardhmen. Në këtë kuadër, bëhet e domosdoshme analizimi i ketyre dimensioneve si dhe peshimi i këtyre faktorëve sipas rëndësisë dhe impaktit të tyre, gjë që do të ndihmojnë se për çfarë ndërhyrjesh ka nevojë, si në termat afatshkurtër po ashtu dhe në termat afatgjatë.

Përfundime

Trashëgimia natyrore është vlerë e veçantë, unikale e mjedisit biotik dhe abiotik, të transmetuar në breza.

Çdo shtet harton politikat e strategjitë për vlerësimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë së vetë kombëtare. Për këtë qëllim, hapësirave apo objekteve me vlera të veçanta të biodiversitetit dhe peizazhit iu jepet statusi "zonë e mbrojtur", si domosdoshmëri për të mbrojtur këto vlera të veçanta të trashëguara për t'i menaxhuar ato shkencërisht dhe për t'ua përcjell brezave të ardhshëm: njëherazi për t'i kthyer ato në gjeneratorë të fuqishëm të zhvillimit të qëndrueshëm.

Vjosa duhet të ruhet për të mirën e natyrës/mjedisit padiskutim, por jo vetëm, edhe për komunitetin e luginës së Vjosës dhe potencialin e tyre për zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik. Që të arrihet kjo ruajtje duket padyshim aplikimi i modeleve më të mira të menaxhimit të zonave të mbrojtura që ndodhen në pellgun ujëmbledhës të Vjosës me qëllim: mbrojtjen e vlerave natyrore, kthimin e tyre në burim informacioni shkencor, në laboratorë didaktikë dhe të edukimit ekologjik, atdhetar dhe zhvillimin e qëndrueshëm, nëpërmjet transformimit shkencor e ekologjik të kësaj hapësire dhe pasurie tonën gjeografike.

Burimet e shfrytëzuara:

Perikli Qiriazi. Trashëgimia Natyrore e Shqipërisë.

Nasip Meçaj. Pellgu i Vjosës.

Perikli Qiriazi;Skënder Sala. Monumentet e Natyrës të Shqipërisë.

Perikli Qiriazi. Gjeografia Fizike e Shqipërisë, Vëllimi 2.

Sala.S.;Qirjazi, P. Kushtet gjeografike të pellgut ujëmbledhës të Vjosës. Konferencë shkencore për Vjosën, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës; Universiteti i Vjenës, Austri; Universiteti i Burimeve Natyrore dhe të Shkencave të Jetës(BOKU), Vjenë, Austri; Instituti Leibniz i Ekologjisë së Ujërave të Ëmbla dhe Peshkimit të Brendshëm (IGB), Berlin, Gjermani. 08 qershor 2016, Tiranë.

Natural heritage | UNESCO UIS

Matja e Qëndrueshmërisë së Lumit 'Vjosa' Final Shqip (researchgate.net).

PARKU RAJONAL I ZAGORISË SI PJESË INTEGRALE E PARKUT KOMBËTAR TË VJOSËS - TRASHËGIMIA NATYRORE, KULTURORE, FOLKLORIKE DHE NDIKIMI EKONOMIK I TIJ

[1]Prof. asoc. dr. Drita Luzo (Kllapi), [2]Androkli Nika
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
dluzo@uogj.edu.al
[2]Coordinator of the Cultural Journal "ZIG-ZAG", In charge of polyphonic singing group "Zagoria",
Email: androklinika1957@gmail.com

Përmbledhje
Vjosa dhe baseni i saj ujëmbledhës përshkon një sipërfaqe të madhe të jugut të Shqipërisë. Në rrjedhën e saj të sipërme një nga degët që e furnizon dhe ka derdhjen në lumin e Vjosës, është dhe lumi i Zagorisë, me ujërat sipërfaqësore që rrjedhin në të gjithë basenin e Zagorisë dhe ujërat nëntokësore të cilat dalin në prerjen tërthore të grykës së Këlcyrës dhe burojnë nga lumi i nëndheshëm i malit të Dhëmbelit, duke formuar ansamblin më piktoresk të grykës së Këlcyrës. Në këtë grykëderdhje fillon lugina e Zagorisë. Tematika që do të trajtojmë në këtë konferencë shkencore ka të bëjë me parkun natyror të Zagorisë si dhe ndikimin e tij në luginën e Vjosës. Kjo luginë ka një pasuri natyrore të jashtëzakonshme, e cila rrezikohet nga faktorë njerëzorë, duke mos respektuar statusin e saj si zonë e mbrojtur. Zagoria ndodhet midis vargmaleve Trebeshinë-Dhëmbel-Nemërçkë dhe Shëndëlli-Lunxhëri-Bureto. Malet rrethuese të Zagorisë janë Dhëmbeli si mali me resurse natyrore dhe ekonomike, mali i Lunxhërisë,i cili shtrihet nga gryka e Këlcyrës deri në grykën e Selckës. E veçanta është se këtu shtrihet fushëgropa e Çajupit, një nga monumentet e rralla natyrore të Shqipërisë. Kjo perlë klimaterike e Shqipërisë duhet të trajtohet jo vetëm si vend klimaterik e turistik, por edhe si një depozitë ujore nëntokësore ndër më të mëdhatë në vend. Gjithashtu,trashëgimia kulturore e Zagorisë prezantohet me kalanë ilire në hyrje të luginës. Zagoria ka, gjithashtu, një trashëgimi të pasur folklorike, me një shtrirje të gjerë si pjesa më vitale e polifonisë. Ashtu si burimet dhe lumi furnizojnë Vjosën, ashtu dhe folklori i Zagorisë, baladat, legjendat, mitet, këngët epike dhe lirike, traditat dhe zakonet janë pasuria më e madhe shpirtërore e folklorike e kësaj treve në rang kombëtar. Gjithashtu, në këtë punim do të trajtojmë dhe ndikimin ekonomik të këtij parku në luginën e Vjosës. Pikërisht, këto çështje kryesore si dhe konsiderata të përgjithshme e me vlera do t'i trajtojmë në këtë punim.
Fjalët kyçe: *Vjosa, Zagoria, park rajonal, trashëgimi natyrore, kulturore, folklorike, ndikim ekonomik*

Abstract
Vjosa and its watershed traverses a large area of southern Albania. In its upper course, one of the tributaries that supplies it and flows into the Vjosa River is the Zagoria River, with surface waters flowing throughout the Zagoria basin and underground waters emerging in the cross section of the Këlcyra Gorge. It originates from the underground river of Dhëmbeli mountain, forming the most picturesque ensemble of Këlcyra Gorge. The valley of Zagoria begins at this estuary. The topic that we will address in this scientific conference is the natural park of Zagoria and its impact on the Vjosa Valley.This valley has an extraordinary natural wealth, which is endangered by human factors, not respecting its status as a protected area. Zagoria is located between the Trebeshinë-Dhëmbel-Nemërçkë and Shëndëlli-Lunxhëri-Bureto mountain ranges. The surrounding mountains of Zagoria are Dhëmbeli as the mountain with natural and economic resources, and the Mountain of Lunxhëria, which extends from Këlcyra Gorge to the gorge of Selcka. The special thing is that here it lies in the Çajup pit, one of the rare natural monuments. This climatic pearl of Albania should be treated not only as a climatic and touristic

place but also as an underground water deposit among the largest in the country. Also, the cultural heritage of Zagoria is presented with the Illyrian fortress at the entrance to the valley. Zagoria also has a rich folkloric heritage, with a wide reach as the most vital part of polyphony. Just as the springs and the river supply Vjosa, the folklore of Zagoria, ballads, legends, myths, epic and lyrical songs, traditions, and customs are the greatest spiritual and folkloric wealth of this region at the national level. It is precisely these main issues as well as general and valuable considerations that we will address in this paper.
***Keywords**: Vjosa, Zagoria, regional park, natural, cultural, popular heritage*

1. Pikëlidhja e Vjosës me Zagorinë

Vjosa dhe baseni i saj ujëmbledhës përshkon një sipërfaqe të madhe të jugut të Shqipërisë. Ajo ka një gjatësi prej 272 km, nga këto 80 km gjatësi në territorin grek nga ku dhe buron. Baseni i saj ujëmbledhës ka një sipërfaqe prej 6700 km^2 . Në rrjedhën e saj të sipërme krahas degëve të tjera që derdhen në Vjosë, si lumi i Langaricës dhe Drinos, ka grykëderdhjen dhe lumi i Zagories me ujërat sipërfaqësore që rrjedhin në gjatësinë e shtratit lumor dhe në gjithë basenin e tij, me një sipërfaqe prej 170 km^2 dhe gjatësi 32 km shtrat lumor.

E veçanta është rrjedhja e ujërave nëntokësore, burime të cilat dalin në prerjen tërthore të grykës së Këlcyrës. Këto burime të cilat dalin mbi grykëderdhjen e lumit të Zagorisë, gati në një gjatësi prej 2 km, përbëjnë ansamblin më piktoresk të grykës së Këlcyrës dhe të gjithë luginës së Vjosës. Pikëtakimi i lumit të Zagorisë me Vjosën është dhe porta hyrëse e luginës së Zagories.

Tematika që ne do të trajtojmë në këtë konferencë shkencore ka të bëjë me parkun natyror të Zagorisë dhe ndikimin e tij në luginën e Vjosës, si park kombëtar me të cilin është lidhur përjetësisht. Në këtë aspekt Zagoria duhet të trajtohet jo më si park rajonal, por si pjesë nga më të rëndësishmet e parkut kombëtar të Vjosës.

Zagoria shtrihet midis vargmaleve Trebeshinë - Dhëmbel –Nemërçkë dhe Shëndëlli - Lunxhëri – Bureto. Malet rrethues të Zagorisë janë Dhëmbeli si mali me resurse natyrore dhe ekonomike, mali i Lunxhërisë, i cili shtrihet nga gryka e Këlcyrës deri në grykën e Selckës. E veçanta është se këtu shtrihet fushëgropa e Çajupit e vendosur midis malit të Lunxhërisë dhe Bucelthit. Fushëgropa e Çajupit në gjithë ansamblin rrethues të maleve të Zagorisë është një nga monumentet e rralla natyrore në Shqipëri. Kjo perlë natyrore duhet të trajtohet jo vetëm si vend klimaterik dhe turistik, por edhe si një depozitë hidrike me rezerva të mëdha ujore nëntokësore, burimet e të cilës dalin në faqen perëndimore të malit të Lunxhërisë dhe shërbejnë për furnizimin e qytetit të Gjirokastrës dhe rrethinave përreth me ujë të pijshëm. Mbrojtja dhe trajtimi i fushës së Çajupit duhet parë jo vetëm si pasuri natyrore, po duhet bërë dhe trajtimi i saj në baza shkencore për të ruajtur cilësinë e burimeve ujore që lidhen direkt me trajtimin e tokës dhe livadhit polifit të fushës. Ruajtja e strukturës së tokës dhe bimësisë domosdoshmërisht kërkon që livadhi polifit nuk duhet të punohet dhe nuk duhet të përsëriten gabimet e viteve ‘60 të shekullit të kaluar dhe vazhdimësia në këto vitet e fundit.

Pamja 1. Pikëlidhja e Vjosës me Zagorinë

Pamje 2. Pjesë e Zagorisë, në sfond ura e Hoshtevës

2. Trashëgimia natyrore e krahinës së Zagorisë

Së pari, Zagoria duhet trajtuar si njësi gjeografikisht e pandarë nga parku kombëtar i Vjosës

dhe nga ana administrative si një krahinë e vetme, nga gryka e Këlcyrës deri në grykën e Selckës. Ndarjet e ndryshme artificiale janë arsye të cilat e kanë lënë Zagorinë në nivelin e krahinave më të prapambetura të vendit.
Për parantezë po trajtojmë pak histori për vartësinë administrative të saj. Sundimi i gjatë otoman dhe rezistenca e zagoritëve për të ruajtur fenë e krishterë kishte një status vetëqeverisjeje si krahinë autonome. Me ardhjen e Ali Pashës, Zagoria kalon nën vartësi të Tepelenës dhe deri në vitin 1920 ka qenë pjesë e saj. Në vitet 1920-1924 ka qenë nën vartësi të Përmetit. Pas vitit 1924 ka vijuar si pjesë e Gjirokastrës. Pas çlirimit ndahet në mënyrë arbitrare në dy krahina; Malëshova në varësi të Përmetit dhe sot pjesë e bashkisë Këlcyrë, Zagoria pjesë e rrethit të Gjirokastrës dhe sot nën varësinë e bashkisë Libohovë, me të cilën nuk ka asnjë pikëtakimi, por ngjan si një ishull me kufij bashkitë: Gjirokastër, Këlcyrë, Përmet e Dropull.
Lugina e Zagorisë duhet të trajtohet si portë hyrëse për grykën e Këlcyrës dhe si kufiri ndarës me krahinën e Pogonit. Këndvështrimi dhe përcaktimi i këtyre kufijve gjeografikë sipas rrjedhjeve të ujërave, shtrirja e orientuar edhe nga malet rrethuese është konfigurimi përcaktues që kjo krahinë me potencialet dhe resurset që ka, është domosdoshmërisht pjesa më integrale e parkut kombëtar të Vjosës.

Pamja 3. Lumi i Vjosës, gryka e Këlcyrës

Pamje 4. Shpella e Kërpishtes, Vithuq

3. Çfarë ofron Zagoria dhe natyra e saj

3.1. Trashëgimia natyrore

Zagorinë mund ta quajmë pa frikë "mushkëria e gjelbër" e këtij parku kombëtar.
Zagoria ka në inventarin e saj pyjor një sipërfaqe prej 5000 hektarë pyje të përziera ku dominojnë kryesisht lisat, shkoza, panja, frashri, bliri, dëllinja, lajthia. Bredhat zënë një sipërfaqe prej 60/ha. Shtrirja e këtij pylli në lindje të malit të Golikut, në vijën Peshtan-Çajup, është ndër monumentet e rralla natyrore, së bashku me banoren e përjetshme të këtij masivi, dhinë e egër.
Pylli i vënjave, në malin e Dhëmbelit, si një nga halorët e rrallë endemik, kërkon një status të veçantë mbrojtje dhe trajtimi shkencor duhet të shkëputet nga fondi kullosor i trajtuar deri më sot. Ky pyll sot plotëson parametrat teknikë të vlerësimit të kurorë-dendësisë. Për këtë arsye malet e Zagorisë emërtohen dhe "malet e trëndelinës", si bima e egër barishtore që rritet me shumicë në këto male, e njohur për aromën karakteristike të pëlqyeshme të qumështit dhe nënprodukteve të tij. Sipërfaqja e përgjithshme kullosore e tyre është 12000 /ha, nga më të mëdhatë në rang vendi. Zagoria dhe lugina e saj fillon në grykëderdhjen e lumit në trajtën e një kanioni të mirëfilltë dhe vjen duke u zgjeruar në pjesën e sipërme të luginës. Monumente të shumta natyrore gjenden gjatë gjithë luginës si shpella, shkëmbinj, hone, cirqe akullnajore, guvat etj. Po përmendim disa prej tyre: Guva e Petranikut, Guri i Gjatë, vrimat e Shën Todhrave, e Nik Denës, Peshturës në malin e Dhëmbelit, vrima e hinkës në malin e Bucelthit, mali mbi Topovë, mali i Lunxhërisë.

Masivi i Shkëmbit të Zhejit, pjesë e malit të Golikut me një lartësi 1947/m (Maja e Strakavecit). Së bashku me fushëgropën e Çajupit përbëjnë ansamblin më piktoresk natyror klimaterik dhe një atraksion turistik të arritshëm, për arsye se jo vetëm ka një infrastrukturë rrugore të standardeve të mira, por edhe sepse Çajupi është një sanatorium natyror për kurimin e sëmundjeve të mushkërive, e vërtetuar kjo dhe e frekuentuar nga shumë individë të cilët janë shëruar plotësisht nga tuberkulozi.
Gjithashtu, si një vend i rekomanduar dhe antikovid, burimet e Çajupit janë nga më kurativet dhe investimi për t'i ruajtur dhe mirëmbajtur ato është domosdoshmëri dhe detyrë e pushtetit lokal. Zagoria ka, gjithashtu, masivin më të madh të fondit pyjor me lisa, shtrirja e të cilëve vjen duke u zgjeruar në dhjetëvjeçarë e fundit. Lisat monumetalë me moshë, kurorë e perimetër të përmasave të veçanta gjenden pranë objekteve të kultit, veçanërisht në pjesën e poshtme të luginës. Do të ishte me interes studimi edhe në aspektin natyror e shkencor për të apasionuarit e shkencave biologjike, palontologjike dhe studimeve të thelluara edhe jashtë këtij universiteti, për faktin se në këtë luginë gjenden tri vende, në të cilët proceset erozive kanë nxjerrë fragmente të shkëmbinjve sedimentarë, detarë. Këto mikrominiera fosilesh janë një dhuratë natyrore për shkencëtarët e ardhshëm. Këto materiale janë përdorur nga vendasit si materiale refaktare për ndërtimin e furrave të pjekjes.

Pamja 5. Fushëgropa e Çajupit

Pamja 6. Shkëmbi i Zhejit



Pamje 7. Mali i Dhëmbelit

Pamje 8. Qiparis mes lulesh e gjelbërimit

Fauna dhe flora

Parku rajonal Zagoria është dhe banesa e shumë kafshëve të egra. Në krye të listës vitet e fundit është shtuar dhe ariu, ujku, derri i egër, sorkadhja, dhelpra, lundra, kunadhja, baldosa, lepuri, iriqi etj. E larmishme është dhe lista e shpendëve të egër, si: shqiponja, skifteri, pëllumbi, gargulli, thëllëza, skifteri, kali i qyqes, i cili ka një status mbrojtjeje të veçantë, gjeli i egër, kukuvajka dhe bufi, qyqja e një pafundësi shpendësh të tjerë, si: mëllënja, qukapiku, harabeli etj. Ndër më të rrezikuarit nga gjuetia pa kriter janë derrat, lepuri dhe thëllëza.
Te flora e krahinës sonë do të trajtojmë bimët barishtore, por kryesisht bimët medicinale, të cilat në parkun rajonal zënë një përqindje të lartë në rang vendi. Rreth 80% e bimëve medicinale

gjenden në një sipërfaqe të konsiderueshme, siç janë: çaji i malit dhe sherebela, trëndafili i egër, rigoni, lulja e blirit, dëllinja e zezë, salepi, zhirokulli, mëllaga, kamomili, kullumbriaetj. Çaji i malit dhe sherebela janë ndër më të rrezikuarat për shkak të mbledhjes pa kriter. Kjo e fundit është më e kërkuara në tregun botëror të bimëve medicinale. E veçanta në malin e Dhëmbelit është rritja e lules së bozhures. Si përfundim, mund të themi se natyra i ka falur Zagorisë pasuri dhe resurse të paçmuara, veçse këto duhet të inventarizohen dhe të jenë jo vetëm pjesë e guidave turistike, por edhe burime të ardhurash ekonomike.

Pamja 9. Rezervuari vaditës, Sheper

Pamja 10. Natyra blegtorale

Pamje 11. Sherebela

Çaji i malit

Lulja e blirit

Pamja 11. Lulja e bozhures

Pamja 12. Shkëmbi i Zhejit

3.2. Trashëgimia kulturore

Në përcaktimin gjeografik të Zagorisë me fillim grykën e Këlcyrës, duke ecur në drejtim të kundërrjedhës së lumit të Zagorisë, prezantohesh me vendbanimet e para dhe të hershme, si p.sh. kalaja ilire e ndodhur në fshatin me të njëjtin emër. Për parantezë në këtë krahinë nuk ka

shkelur këmba e arkeologut shqiptar. Të dhënat gojore tregojnë se në vitet e Luftës së Parë Botërore një ekspedite arkeologjike austro-hungareze bëri kërkime për disa muaj në zonën e quajtur "Dërmazë", ku thuhet se në mesjetë ka qenë një qytet dhe qendër tregtare e kohës. Të dhëna fragmentare nga lashtësia ka në gjithë gjatësinë e luginës dhe vendbanimet e hershme janë të shumta. Në këto vendbanime janë gjetur objekte të shumta qeramike, monedha, objekte të periudhës së gurit, bronxit dhe hekurit. Zhvillimet e mëvonshme besohet se kanë qenë të vrullshme dhe kjo krahinë i rezistoi taborëve turke si dhe ruajtjes së besimit kristian nga përpjektet për islamizim. Në kohën e ekzistencës së pashallëkut të Janinës, kemi ngritjen e shumë objekteve të kultit ortodoks, kisha dhe manastire me hapësira dhe të pikturuara, të cilat regjimi ateist i shkatërroi me themel duke humbur vlera të jashtëzakonshme kulturore, nga të cilat vetëm ajo e shenjtorëve Petro e Pavllo në fshatin Hoshtevë, është e mirëruajtur dhe e restauruar. Nivelet kulturore, shkollimi, emigracioni, kërkesat për shtet të pavarur dhe gjuhë shqipe, bënë që një sërë individësh dhe personalitetesh të angazhoheshin në lëvizjet e para për pavarësi, zhvillim e përparim. Ndër ta përmendim firmëtarin ePavarsisë Aristidh Rucin, poetin Andon Zako Çajupi, krijimet e të cilit kanë mesazhe të fuqishme dhe janë nga më aktualet dhe sot.

Në Zagori, pas shpalljes së pavarësisë, u ngrit një klasë intelektualësh e mirarsimuar në të gjitha fushat, veçanërisht me kontribute të jashtëzakonshme në ngritjen e shkollës kombëtare shqiptare. Vlen të përmendet këtu gjuhëtari Ilia Dilo Sheperi, Petro Zheji i cili në mënyrë shkencore përcaktoi vjetërsinë e gjuhës shqipe. Kontributi i arsimtarëve zagoritë shkon nga jugu në veri, deri në Kosovë. Stathi Kostarja është një nga kontribuesit zagoritë në arsimin shqip në Kosovë. Shqiptarët e Kosovës e etiketojnë Stathi Kostaren "sofra e parë e arsimit shqip". Ky personalitet i arsimit shqiptar që nga viti 1941 derisa ndërroi jetë punoi me përkushtim dhe drejtoi me profesionalizëm zyrat e larta të odës arsimore në Kosovë. Ai ishte tekstshkrues, përkthyes, poliglot, gazetar, drejtues i radio televizionit të Prishtinës. Të shumtë janë njerëzit e letrave, por këtu duhet përmendur Sejfulla Malëshova jo vetëm si poeti disident, por dhe njeriu vizionar për orientimin perëndimor të vendit. Për zhvillimin e Zagorisë nisi projektin për hapjen e rrugës Peshtan-Sopik, një aks rrugor i cili do të sillte një zhvillim parësor të dy krahinave të Pogonit dhe Zagorisë. Kjo ide edhe sot, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkufitar, duhet të jetë çelësi i zhvillimit rajonal për të rijetëzuar këto krahina.

Pamja 13. Kisha e Hoshtevës, e shenjtorëve Petro dhe Pavllo me afresket e mrekullueshme të saj

Në Zagori ekziston një pasuri e rrallë fotografike për arsye se që nga vitet 1917 kanë ushtruar artin e fotografimit mjeshtra që kanë lënë gjurmë në rang kombëtar si Foto Ristani e Vito Duriqë, që kanë qenë pionierët e parë të këtij arti. Disa nga fotot e tyre paraqiten si më poshtë.

Pamja 14. Çifti Ristani, dalë më 1936 *Pamja 15. Kujtime nga nje ceremoni fejese, 1931*

3.3.Trashëgimia folklorike

Zagoria është një nga zonat etnokulturore nga më të pasurat. Folklori zagorit në vetvete hyn te visaret e kombit, jo vetëm nga përmbajtja e lartë cilësore, por edhe nga mënyra e ndërtimit, shprehjes e figuracionit. Një nga visaret më të çmuara të folklorit zagorit është balada "Kostandini dhe Dhoqina". Simbolika e kësaj balade është mjaft domethënëse dhe kuptimplotë: besën, fjalën e dhënë, amanetin nuk e tret as dheu. Kjo baladë u ngrit në art dhe u soll si një risi në folklorin e sotëm, duke përfaqësuar zonën e Zagorisë nga grupi polifonik, i cili jo vetëm që u pëlqye nga artdashësit, por u nderua me çmimin e parë në Festivalin Tipologjik Libohovë, me çmimin "Nestor Muka." Folklori zagorit përcjell mesazhe të fuqishme kombëtare dhe kombformuese me një gjuhë të pasur, të pastër dhe të folur rrjedhshëm. Gjuhë kjo e identifikuar tek e folura standarde e gjuhës shqipe. Folklori zagorit i transmetuar në breza, gojë më gojë si dhe një shekull i shkruar është një pasuri kombëtare. Të shumtë kanë qenë dhe janë autorët zagoritë që kanë studiuar folklorin e kësaj treve, vëllime të tëra botimesh janë në bibliotekat e institucioneve të kulturës, gjuhësisë e Akademisë shqiptare e kosovare. Kjo pasuri me baladat e legjendat, mitet e përrallat, këngët e të gjitha zhanreve: lirike, erotike, vajet, humoristike dhe vallet e burrave e grave, kjo e fundit një nga vallet më të bukura, vallja-sustë është trashëguar në breza. Folklori i Zagorisë me larminë e tij, shkallën e lartë të interpretimit ka bërë që grupet e e kësaj krahine të jenë të mirëpritura në të gjitha skenat mbarëshqiptare si dhe në ato jashtë vendit. Në ecurinë dhe historikun e vet, folklori zagorit pësoi një humbje vlerash dhe politizim të tejskajshëm. Sot, me gjithë përpjekjet e grupeve e individëve të veçantë vështirësitë janë të mëdha. Folklori sot nuk financohet. Duhet bërë patjetër diçka në aspektin e financimit, në mënyrë që të krijohet një fond i veçantë për të zhvilluar dhe mbajtur gjallë këtë vlerë e pasuri të madhe të kombit e krahinës sonë, nga e cila do të krijohen përfitime në vitet që pasojnë.

Pamje 16. Grupi polifonik i Zagorisë në Festivalin Folklorik Kombëtar,Gjirokastër,Qershor 2023

4. Vlerësimi dhe ndikimi i resurseve ekonomike në krahinën tonë. Konsiderata dhe rekomandime të përgjithshme.

Për të pasur një zhvillim të mirë si dhe për ta nxjerrë Zagorinë nga gjendje e sotme e vështirë në të cilën ndodhet, ne rekomandojmë:

1. Në programin ekonomik të parkut kërkohet domosdoshmërisht lidhja e Zagorisë me rrjetin kombëtar rrugor në vijat rrugore Peshtan-Çajup, Këlcyrë-Hoshtevë-Poliçan-Suhë, Çajup-Ndëran-Sheper, në lidhje ndërkufitare me Sopikun, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkufitar me Greqinë. Pra, infrastrukturë rrugore të domosdoshme dhe rregullim imediat për të bërë të mundur komunikimin e lirshëm me qytetet dhe qendrat urbane.
2. Zhvillimi i turizmit malor. Lugina dhe Zagoria ofrojnë vlera të mëdha për të siguruar burime ekonomike të qëndrueshme në të gjitha stinët e vitit dhe për të qenë një destinacion turistik i preferuar nga vendasit dhe të huajt.
3. Aktivizimi i këtyre vlerave kërkon inventarizimin dhe përgatitjen e hartave dhe guidave turistike.
4. Zhvillimi i Zagorisë kërkon kthimin e pronave me statusin e para vitit 1945 si prona private dhe komunitare.
5. Rishikimi i reformës territoriale për luginën e Zagorisë në varësi të një njësie administrative lokale.
6. Trajtimi i Çajupit si pasuri kombëtare, duke ruajtur statusin e pronave legjitime dhe mos tjetërsimin e pronësisë shekullore të zonës Zhej-Lliar. Duhet patjetër të realizohet elektrifikimi dhe lidhja telefonike si emergjencë parësore.
7. Ngritjen e një qendre kurative në fushën e Çajupit për të rijetëzuar dhe gjallëruar këtë zonë me vlera të jashtëzakonshme.
8. Nxitja e fermerëve dhe stimulimi për kultivimin e bimëve etero-vajore dhe medicinale si bimë me leverdi ekonomike dhe shumë të kërkuara në tregun ndërkombëtar, si një burim potencial për sigurimin e të ardhurave.
9. Trajtimi me kredi të buta për ndërtimin e bujtinave duke ruajtur ndërtimet e dikurshme tradicionale.
10. Politika nxitëse për të kthyer Zagorinë në një atraksion turistik të preferuar.
11. Kthimi dhe mbarështimi i blegtorisë dhe bletarisë si një nga zonat më potenciale kullosore kundrejt kërkesave të konsumatorit për produkte “bio” si dhe financimi shtetëror i këtij sektori jetik për ekonominë e vendit.
12. Të rindërtohet ura e Hoshtevës si nyje lidhëse e fshatrave të Zagorisë së Poshtme (Hoshtevë-Lliar-Zhej), si monument i kategorisë së parë, aktualisht e rrëzuar dhe e abandonuar nga mosinteresimi i organeve të pushtetit lokal të Zagorisë dhe bashkisë Libohovë.

Pamje 17. Fusha e Çajupit

Pamje 18. Një nga bukuritë e rralla te Zagories

Pamje 19. Rema e Doshnicës

Pamje 20. Guri i Gjatë, tepër i veçantë

Pamje 21. Cirqet akullnajore të Lunxhërisë

Pamja 22. Çajupi me dëborë

Referencat

Gjeografia e Shqipërisë.

Të dhëna nga fondi i ish-ndërmarrjes së pyjeve dhe kullotave.

Nga arkivi personal i bashkautorëve.

https://sq.wikipedia.org/wiki/Vjosa.

Histori Suksesi: Lumi Vjosa shpallet Park Kombëtar - Eco Albania.

Krijohet parku i parë kombëtar i një lumi të egër në Evropë/: Kumbaro:Vjosa, simbol i historisë njerëzore - Kulturë (cna.al)

Evjen Peri. Zagoria, 2001, f. 35, 36 etj.

https://www.facebook.com/groups/zagoriajone/permalink/2417159778304451/?_rdr

https://www.facebook.com/groups/zagoriajone/questions/?locale=id_ID

https://konica.al/2018/08/fusha-e-cajupit-rrethuar-nga-malet/

https://pine.al/activity/natyre/mali-i-dhembelit

BEKTASHIZMI I NATYRALIZUAR SHQIPTAR DHE PANTEIZMI

MSc. Alban Shahu
"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
Email: ashahu@uogj.edu.al

Abstract
The natural majesty of the Vjosa River also carries the dimension of human worship (behavior) towards it. Clearly, it expresses the symbolism of the deification of nature, which has a religious influence deeply rooted in Bektashism, but which is reflected as a product of pantheistic popular culture. Pantheism (the cult of nature), is a universal cultural phenomenon of pagan origin, but Bektashism converted it as a philosophical doctrine, by its Quranic principles and hadiths (recitations, expressions). Nature is understood to be an endless source of life and an essential component of human culture. Thus, adherence to and respect for the laws governing its evolution continue to be a measure of a people's degree of cultural liberation. To sound as close to reality as possible, this phrase tends to generalize the collective (human) norm in the sensible use of natural assets without specifying it in time. Indirectly, it also provides a theoretical evaluation of the effects and remnants of Bektashi pantheistic doctrine on the psyche and mindset of common people. The so-called divine oneness is produced because the Bektashi perception (concert) imagines God as an earthy (immanent) entity merged with nature and man, rather than as a supernatural (transcendent) person. Additionally, this paper reflects the present, frequently detrimental approach to biodiversity and the environment, and we hope to promote some positive, practical principles through it. It is a rare example that the River (Vjosa) has not been affected by "urban aggression" or unearthed in mystery, according to specialists (even the public's reaction). In addition to being widely accepted as a unique case—and regrettably, the final one in Europe—this opinion has already gotten nearly unanimous support.
Keywords: *Pantheistic preaching, Naturalized Bektashism, Bektashi dialectic, Perfect man, Divine reality (unity), Natural worship, Liberal Bektashism*

Përmbledhje
Madhështia natyrore e lumit Vjosa bart në vetvehte edhe dimensionin e adhurimit (sjelljes) të njeriut ndaj saj. Qartazi, ajo shpreh simbolikën e hyjnizimit të natyrës, e cila mban referencë burimore fetare bektashizmin, por që reflektohet si produkt i kulturës popullore panteiste. Panteizmi (kulti i natyrës) është dukuri kulturore universale me origjinë pagane, por bektashizmi e konvertoi si doktrinë filozofike, në përputhje me parimet dhe hadithet (recitimet, shprehjet) e veta kuranore. Dihet se natyra është burim i pashtershëm jetese dhe faktor ekzistence për shoqërinë njerëzore. Ndaj kujdesi dhe respekti për ligjet e zhvillimit të saj, mbeten tregues për nivelin e emancipimit kulturor të një populli. Nga ky këndvështrim, kjo kumtesë tenton të përgjithësojë standardin kolektiv (njërëzor) në përdorimin racional të aseteve natyrore, pa e përkufizuar në kohë, me qëllim që të tingëllojë sa më afër aktualitetit. Indirekt, ajo bën dhe një vlerësim teorik mbi gjurmët dhe forcën ndikuese të predikimit panteist bektashi në mendësinë (psikologjinë) qytetare popullore. Sepse percepti (konserti) bektashi e përfytyron Zotin, jo si qenie të mbinatyrshme (transhedente), por si qenie tokësore (imanente) të shkrirë me natyrën dhe njeriun, mbi bazën e të cilit formohet, i ashtuquajturi, uniteti hyjnor. Përpos kësaj, tema merr përsipër të promovojë disa vlera mirëfilli praktike. Ajo vjen si reflektim për qasjen aktuale, shpesh destruktive ndaj mjedisit dhe biodiversitetit. Fakti që lumi Vjosa ka mbetur ende i paprekur nga "agresioni urban" apo i pazbuluar në mistere, për ekspertët (edhe për reagimin qyetetar) përbën një precedent të rrallë. Ky precedent tashmë është vënë në një mbrojtje, thujase, gjithpërfshirëse, që përgjithësohet edhe si rast unik në llojin e vet, por fatkeqësisht, edhe si rast i fundit në Evropë.

Fjalë kyçe: *Predikim panteist, bektashizëm i natyralizuar, adhurim natyror, realtet (unitet) hyjnor, bektashizëm liberal*

******

Dihet se natyra është burim i pashtershëm jetese dhe faktor ekzistence për shoqërinë njerëzore. Ndaj kujdesi dhe respekti për ligjet e zhvillimit të saj mbeten tregues për nivelin e emancipimit kulturor të një populli. Statusi *"lumë i egër"*, përveçse ka sensibilizuar si rrallëherë opinonin publik brenda e jashtë, ka risjellë në vëmendje çështjen e edukimit mjedisor të popullsisë, në mbrojtje të origjinalitetit *(virgjinitetit*) natyror të luginës së Vjosës. Në funksion të saj lind nevoja që vlera kultrore të traditës krahinore, qofshin dhe ato me kontekst panteizimi, duhet të dalin nga kuadri historik dhe të rijetësohen.

Kultura panteiste zë një vend nderi në historinë e qytetrimit shqiptar. Ajo vazhdon të mbahet gjallë që nga lashtësia pagane dhe në përmbajtjen e saj reflekton adhurimin deri në hyjnizim të kulit të natyrës. Është një kulturë që më shumë predikohet se sa kultivohet. Dukuritë *(misteret, të fshehtat)* natyrore, ajo i shpjegon nëpërmjet leximit dhe intepretimit të tyre me postulate ose me doktrina misitike. Edhe pse koha dhe dija shkencore i zbehu këto doktrina, ajo ende nuk ka mundur ta sfidojë kultin mistik të natyrës, çka provohet dhe me pelegrinazhet e shumta natyrore. Edhe në këtë rast madhështia natyrore e lumit Vjosa bart në vetvete edhe dimensionin e adhurimit *(sjelljes)* të njeriut ndaj saj. Qartazi, ajo shpreh simbolikën e hyjnizimit të natyrës, e cila mban referencë burimore fetare bektashizmin, por që reflektohet si produkt i kulturës popullore panteiste. Qasja botëkuptimore bektashiane duket se ka lënë gjurmë të rëndësishëm në edukimin pantesit të njerëzve. Kjo dhe për faktin se në shumicë popullsia e luginës së Vjosës, sidomos në rrjedhjet e sipërme e të mesme të saj, i përket besimit bektashian. Në këtë kontekst merr rëndësi të vlerësohet*(ndoshta dhe të rivlerësohet*) epërsia e përhapjes së bektashizmit në këto treva, në raport me synizimin në procesin e islamizimin e këtyre trevave. Po kaq rëndësi ka të vlerësohet edhe ndikimi i madh që ushtroi ai në kulturën fetare vendore dhe më gjerë.

Bektashizimi është rrugë *(tarikat)* mistike që i përket degës shiite të islamit. Ai lindi në shekulln e XIII në Azinë e Vogël (Anadoll). Doktrina bektashiane ka disa veçori specifike në raport më besimet e tjera, të cilat me pak fjalë mund të përmblidhen: *E para*, sikundër dhe tarikatet e tjera shiite, bektashinjtë u përulen dymbëdhjetë imamëve me në krye imam Aliun. Në etikën e komunikimit bektashi, Allahu *(Zoti)*, Muhamedi a.s. dhe imam Aliu nuk identifikohen kurrë veçmas. Të tre cilësohen *i njëjti sekret;* shfaqen në formën e së vërtetës absolute (*janë vetë e vërteta)*, dhe si të tilla formojnë atë që quhet "*Trini e Shenjtë"*.

E dyta, bektashinjtë e gjejnë Muhamedin a.s. të fundin e profetëve të mëdhenj, i cili shfaqet si simboli i përsosjes së njëriut. Ai eci në gjurmët e të parëve dhe, ndonëse bëri reforma të mëdha, nuk preku kurrsesi thelbin e traditës bektashiane (*ezoterizmin)*. Krahas tij ose paralel me të bektashinjtë hyjnizojnë po aq edhe imam Aliun që e arrtiti përsosmërinë si njeri i veprimit. Imam Aliun ata e cilësojnë të parin mysliman me edukim *(formim)* islam *(shenjtët para tij, ishin paganë)* që krijoi një *parti sekrete (të fshehtë)*, të lidhur në betim për ruajtjen e *"të vërtetave të mëdha ezoterike*, në bazë të parimit; "*bësim – vllazëri – drejtësi"*[1].

E treta, autoriteti botëkuptimor i bektashiut konsiderohet produkt i doktrinës ezoterike, që presupozon zotësitë çudibërëse (*veprimet e padukshme)* të profetëve, të shenjtëve apo të reformatorëve të mëdhenj për të bërë mrekulli. Tradita ezoterike përkufizohet ndryshe edhe si doktrinë e mistereve, e cila sipas tyre zhvillohet në fund të tempujve dhe brenda gjirit të sekteve të fshehta *(sekrete)* ku përfshihen edhe misteret e natyrës.[2] Si i tillë ezoterizmi nuk *" hyn në shpirt"* dhe "*nuk kuptohet"* nga besëtytnitë popullore. Veçse e *vërteta ezoterike* merr vlera absolute. Ajo predikohet si e dërguara(*e detyruar)* nga profetët dhe shenjtët për të gjithë njerëzit pa dallim feje.

Ati themelues i bektashizmit është Haxhi Bektash Veliu; nxënës i filozofit sufist pers Ahmet

---

[1] AQSh, Fondi 483, (pavit), dosja 4, fl.2. Promemorje mbi sektin bektashian të fesë islame.

[2] *Idem*

Jesevi. Gojdhëna thotë se, ai pasi udhëtoi e jetoi për 40 vjet në tempuj dhe sekte të fshehta u kthye në shoqëri me mision që të përhapte të vertëtën e madhe *(ezoterike)* të imam Aliut. Fillimisht bektashizmi u përhap si ideologji pushtuese në kuadrin e pushtmeve osmane. Suksese më të madhe ai njohu në Rumeli (Ballkan), por më shumë terren fitoi në Shqipëri që më pas u bë atdheu i dytë i tij. Përjashtuar rrëfenjat, tregimet, apo legjendat (*Sari Salltëku, Abaz Aliu, etj*.), historianët pranojnë *(apriori)* se, bektashinjtë në vendin tonë u shfaqën së bashku me pushtuesit osmanë.

Por të dhënat burimore ekzisuese nuk i qasen këtij realiteti historik të hershëm. Sipas tyre, historia e dokumentuar e bektashinjëve në Shqipëri, përkon pak a shumë me periudhën e sundimtarit të Janinës, të famshmit Ali Pashë Tepelena (1780-1822). "E vetmja ngjarje në histori, për të cilën mund të flitet me siguri brenda "Urdhërit Bektashi" shqiptar, thotë J. Birge, është ajo e Ali Pashë Tepelenës[3].

Pavarësisht debateve, fakt është se Ali Pasha ka meritë të padiskutueshme për faktorizimin e bektashizmit në Shqipëri. Për të mos thënë, e shndërroi atë në fenomen shqiptar dhe i hapi rrugë procesit të natyralizmit të tij. Shkaqet bashkëpunimit të ngushtë të Ali Pashës me bëktashinjtë janë komplekse. Ato mund të vlerësohen, sa me natyrë politike, po aq dhe fetare, të gërshetuara dhe me element të fortë nacionalizmi. Një analizë e detajuar e tyre, del jashtë objektit të temës. Përpos faktit, që studimet për këtë figurë emblematike *(ikonë)* të shqiptarisë janë të shumta, pse jo dhe shteruese. Por këtu është rasti të nënvizohet se, ky bashkëpunim duket se, ka marrë pak vëmëndje në këto studme. Ajo është parë kryesisht si, produkt i politikës pragmatiste të Ali Pashës në funksion të zgjerimit të hatës politike të pashallëkut.

Nuk ka dyshim se, themli mbi të cilin u ngrit kjo aleancë e përbënte konflikti i inresave poltike. Bektashinjtë, me kohë reflektonin në publik një nivel të dukshëm përfaqësimi plolitik, sidomos të fuqisë ushtarake, sepse vepronin si mbulesë shpirtërore e korpusit *(gardës)* jeniçer të Sulltanit. Si trupë elitare, jeniçerët mbanin pozita monopol në ushtrinë pushtese osmane dhe mëshironin standarte të larta në zbatimin e artit ushtarak pushtues. Ata gëzonin privilegje e benifite të shumta, mosplotësimi i të cilave rrezikonte drejtpërsëdrejti stabiltetin e shtetit osman. Me këtë status, garda jeniçere qe bërë e papërballueshme në pretendime dhe kishte krijuar fizionominë e një strukturë të frikshme paramilitare, që vepronte si shtet brenda shtetit. Rasti më i paprecedent ndodhi në vitin 1799 kur trupa jeniçere rrëzoi nga froni Selimin e III [4]

Për të rikuperuar pasojat negative të kësaj revolte, Porta e Lartë i shtriu efektet goditëse edhe mbi bektashinjtë. Këtë situatë e shfrytëzoi Ali Pasha për të vendosur me ta, marrëdhënie bashkëpunimi në luftën kundër Sulltanit. Madje, për baballarët e përndjekur, ai ofroi garanci strehimi në territoret e pashallëkut dhe ndërkohë, rekrutoi ekspert në oborrin e tij, që të shërbenin si punëtor sigurimi, si agjent diplomatik, etj. Psh në shkrimet e kolonelit anglez Laeke thuhet se, Ali Pasha, pajtonte dervishë si agjent diplomatik, për të siguruar informacione secrete

Veçse, përdorimin politik të bektashinjëve, Ali Pasha nuk e konisderoi qëllim në vehtvehte. Përkundrazi *"babaizmin*", ai e vlerësoi si një doktrinë ideologjike që i shkonte për shtat profilit të tij, si shtetar autoritar e fuqiplotë. Por përtej kësaj, Aliu ndjente nevojë për mbështetje fetare. Të cilin e vlerësonte faktor për forcimin e vetëdijës etnike të shqiptarëve, siç po ndodhte në të njëjtën kohë, me Kishën Ortodokse në lëvizjen nacionale greke. Ndaj ai nuk e fshehu afeksionin shpirtëror për bektashizimin. Ai u konvertua në bektashi, çka ndikoi në rritjen e mëtejshme të bektashzmit sidomos, në trevat e Jugut. Dalip Frashëri thotë se ai ishte dishepull i Baba Shemimi dhe mori nasip *(dorë)* prej tij.

Në kohën e Ali Pashës, Urdhri Bektashi shënoi suksese të dukshme si në rritjen e numrit të ndjekësve, ashtu dhe në ndërtimin e objekteve të kulit. Kështu, në vitin 1780 u ndërtua teqeja e Zallit në Gjrokastër nga Asim Babai. Kjo teqe hodhi themelet e lëvizjes bektashiane në vendin tonë dhe luajti një rol të veçantë në lëvizjen kombëtare. Në vitin 1793 u ndërtua teqeja e Hajdar Babait, po në Gjirokastër. Ky proces vazhdoi pandërprerje edhe në fillim të shekullit XIX. U

---

[3] John Kingsley, Birge. "*Urdhri bektashi* i dervishëve". Tiranë, Urtësia bektashiane, 2008, fq.85.

[4] Fahri Maden."*Mbyllja e teqeve bektashiane", 1826.* Tiranë, Urtësia bektashiane,2022, fq.74.

ndërtuan me radhë teqeja e Prishtës në Skrapar, e Ibrahim Xafajt në Elbasan, e Melçanit në Korçë etj[5].

Ndërtimi i teqesë së Fushë Krujës (1799) nga baba Shemimi që për studiuesin e mirënjohur O. Myderizi mbetet një ndër personalitet klerikale më të mëdha të kohës. Bektashizmi gjeti "…një kryetar të aftë dhe dinak si Shemimi Baba që vinte nga një eksperiencë e gjatë në Egjypt, Persi dhe Indi."[6] Ai ndërtoi në vitin 1799 teqenë me emrin e tij në Fushë-Krujë. Në pak vite Kruja pati mbi 360 faltore kulti, për këtë arsye kryeqendra e Skënderbeut u quajt "Horasani i Vogël" *(vendlindja e Haxhi Bektashit)*. Ai mori përsipër të shtrinte rrezen e ndikimit të bektashizmit në Veri, mision i cili duket se i kushtoi jetën, thotë studiuesi F. Hasluck.[7]

******

E ashtuquajtura "*Ngjarja e mbarë*", 1826, i ndau përfundimisht bektashinjtë nga Perandoria Osmane. Sulltan Mahmudi II, pasi shfarosi garnizonin elitar jeniçer me afro 18.000 vetë, nisi një proces genocidi të vërtetë ndaj bektashinjve.[8] Një valë e paparë e shkatërrimesh përfshiu institucionet e teqetë bektashiane. Mbi të gjitha sulmi u përqendrua në goditjen dhe eleminimin e klerikalizmit bektashi. Në këto kushte, bektashinjtë u detyruan të ndryshonin qasjen ideologjike perandorake. Ata u distancuan nga doktrina e pushtimit të botës në emër të fesë dhe u rreshtuan në krah me lëvizjen e armatosur të popujve për vetëvendosje. Në këndvështrimin e profesorit të mirënjohur S. Pollo, bektashinjtë morën rol si kundërvënës, si opozitë politike ndaj Portës së Lartë.

Nga kjo kohë bektashizmi mori fizionominë e një urdhri tipik shqiptar. E gjithë veprimtaria fetare e tij zhvillohej më cikël gati të mbyllur, brenda vendit. Raportet me vendin e origjinës (*qendrën Haxhi Bektashit)*u bënë tejet formale. Kjo, edhe sepse në gjirin e bektashinjve u thellua në ekstrem konflikti për të drejtën e trashëgimisë së saj. Jo vetëm kaq, por dhe qendra teologjike e Diomitekës i humbi vlerat e saj. Në vitin 1835 lindi në Shqipëri një Dimiotekë e re *(shkollë teologjike),* teqeja e Frashërit. Themeluesi i saj Baba Tahiri një figurë mendjendritur e shndërroi teqenë gradualisht në epiqendër të lëvizjes bektashiane dhe kombëtare. Këtu filloi botimi në gjuhë shqipe i letërsisë dhe leteraturës fetare bektashiane.

Për rrjedhojë, pas vitit 1826 bektashizimi u integrua gjithmonë e më tepër në jetën tradicionale fetare të shqiptarëve. Edhe pse nuk hoqi dorë nga parimet themelore fetare, ai vuri në qendër të saj njohjen e kombësisë shqiptare dhe të atdheut të saj, Shqipërisë. Ndërkohë që u bë një promovues dhe mbrojtjës i flakët i të drejtave të shqiptarëve për përdorimin e gjuhës së vet të shkruar dhe të kulturës në gjuhën shqipe.

Qasja e re botëkuptimore bektashiane në Shqipëri fitoi disa tipare dalluese që duket se i dhanë më shumë vitalitet, lulëzim dhe origjinalitet lokal. Dhe kjo lidhet me disa faktorë ku më kryesori vlerësohet toleranca fetare vendase. Kjo tolerancë në Shqipëri, më shumë sesa në çdo vend tjetër, kishte krijuar një truall të favorshëm për përhapjen e bektashzmit. Nga ana e tij, ky i fundit, për nga natyra eklektike i përshtatej temperamentit *(shpirtit rebel)* të shqiptarit, që siç vënë në dukje shumë studiues, nuk pajtohet me fetë autoritariste. Bektashizmi e përthithi këtë kulturë, e ruajti, e zhvilloi këtë tipar karakteristik *(pse jo, unik)* të besimti të shqiptarëve dhe e shndërroi në një standard të predikimit të tij dogmatik.

Një karakteristikë tjetër dalluese e doktrinës bektashiane që identifikohet, thuajse, nga të gjithë studiuesit, është karkteri liberal i saj. Ajo është e hapur ndaj rrymave e besimeve të tjera. Do të thotë se pranon të katër librat e shenjë, thuhet në promemorjen bektashiane, pranon çdo besnik të feve të tjera, sikundër që njeh edhe trinitetin si simbol që shfaqet te të gjithë njerëzit e

---

[5] Robert Elssie."*Bektashinjtë shqiptarë", Historia dhe kultura e një rendi dervishësh në Ballkan.* Prishtinë. Botime Artini, 2020, fq.24-35.

[6] AQSh, Fondi 483, viti 1929, dosja.3 fl. 62. La storia dei bectasci' (sete muslumane), D.Ali Tyrabi.

[7] Frederick Hasluck."*Feja e katërt e Shipërisë".* Robert Elsie. *Bektashinjtë shqiptarë,* …vepër e cituar, fq.139.

[8] Jacques, Edwin.. "*Shqipëtarët" . Historia e popullit shqiptar nga lështësia deri në ditët e sotme*. Tiranë, Kartë & Pendë,1996, fq.251.

përsosur para e pas Krishtit[9]. Vlerat e tij tolerante dolën më në pah sidomos në procesin e islamizmit të popujve jomyslimanë. Me qëndrimin e vet liberal bektashizmi u kundërvihej metodave imponuese e shtrënguese të islamit zyrtar, direkte apo të tërthorta. Por mbi të gjitha, me vetëdije reformuese ai krijoi standarde mirëkuptimi e solidariteti me popujt e krishterë ortodoks. Ky tipar mund të quhet i veçantë në llojin e vet, sa i takon rolit që luajti në procesin e islamizimit të popullit shqiptar.

Një analizë më të detajuar për shkaqet e këtij fenomeni e gjejmë në studimet e Prof. S. Pollos. Sipas tij, ndryshe nga islamizimi sunit që njësonte përkatësinë kombëtare me atë fetare, bektashizmi u ngrit mbi ndarjet fetare. Ai evoluoi nga universalizimi panteist drejt kombësive të veçanta, nga predikimi i vllazërimit ndërmjet njerëzve, drejt bashkimit të tyre pa dallime fetare. Ai argumenton lidhjet e ngushta midis partikularizimit të bektashinjve dhe formimit tradicional shpirtëror të shqiptarëve[10]. Këta të fundit nuk e fshinë çështjen kombëtare nga vetëdija fetare dhe i shpërfillën me indiferentizëm dogmave të Kuranit.

Por dallimi më specifik i sistemit mistik bektashian lidhet me karakterin panteist të saj. Fakt është se panteizmi është një dukuri, thuajse, universale për të gjitha kategoritë e besimeve. Por bektashinjtë shfaqin një afinitet shpirtëror dhe një respekt të veçantë me natyrën. Ajo e përfytyron Zotin, jo si qenie e mbinatyrshme *(transhedentale*), por si qenie tokësore *(imanente*), që shkrihet dhe bëhet një me natyrën dhe njeriun.[11] Dhe, për derisa natyra është pjesë e Zotit, atëhere, çdo njeri është pjesë e saj, pavarësisht nga feja. Pikërisht, kjo doktrinë konsiderohet si një nga burimet kryesore të tolerancës së bektashinjve ndaj popujve jo myslimanë.

Në perceptimin doktrinar bektashi, pavarësisht se shpirtin dhe mendjen e shenjtit bektashian e drejton Allahu dhe Muhamedi a.s. ai urdhërohet prej tyre që t'i pështatet natyrës. Dhe në se ai do t'u qëndrojë besnik porosive, do të shpërblehet në parajsë, pasi të mirat dhe gëzimet e tokës janë më të mëdha. Duke e analizuar në qasje krahasuese këtë vlerë, studiuesi G. Louis Jaray, thekson se shenjti bektashi, ashtu si shpirti ynë i krishter, "…ka si ideal soditjen, endërrimin e Hyjnisë, që e mendon pafundësisht të përsosur. Ai përpiqet të fitojë mbi shtërngimet që i krijon ajo *(natyra)*, me dëshirën që t'i afrohet idealit hyjnor që është burim i përsosmërisë[12]"

Ideja e përsosmërisë *(njeriut të përsosur)* mbetet një tjetër vlerë për bektashizmin. Ajo merr përsipër të zëvendësojë vlerat e jashtme morale të *"pososive"* e këshillave *(përcepte)* hyjnore me disa parime tokësore të barazisë, mirësisë e vllazërimit universal. Sipas saj, kur një njeri e njeh vërtet Zotin dhe e jeton, atëherë ai mund të bëhet aq i përsosur sa të qëndronte mbi çdo kod moral. Në kuptimin mistik ajo përputhet me doktrinën e "katër portave, që vlerësohet si një nga parimet bazë të simbolizimit të Urdhrit bektashi. Sikundër në traditën sufiste njeriu mund të arrijë te Zoti, vetëm duke kaluar dyert e sheriatit*(ligji ortodoks islam*), tarikatit (*mësimet e urdhrit fetar*), dijes ose marifetit *(njohja misitke e Zotit)*, dhe hakikati (*përvoja e thelbi i së vërtetës)*.[13]

Por, ndërkohë, kauza e çështjes kombëtare e vuri bektashizmin edhe para dilemave e rrugëzgjidhjeve të vështira. Për të justifikuar mbrojtjen e saj ai u detyrua të devijojë edhe në përmbajtje doktrinën fetare, me formulime e intepretime të natyrës pak a shumë civile *(laike)*. Nisur nga këto ndryshime thelbësore doktrinare, shumë studiues, sidmos të huaj e stigmatizojnë bektashizmin, më shumë filozofi, sesa dogmë fetare. Këtë tezë e mbron edhe studiuesi e diplomati i mirënjohur Faik bej Koncia. Ai i vendos bektashinjtë në mes të shqiptarëve të ashtuquajtur "*të pavarur",* në pikëpamje fetare, në *pozicion të baraslarguar*, sikundër protestantët dhe mendimtarët e lirë. I ndikuar edhe nga vepra *"Fletore e bektashinjtë"*, Konica e

---

9 AQSh. Fondi, 483 (pavit), dosja 4.fl.3.

10 Stefanaq Pollo. *Në gjurmë të historisë shiptare.* Tiranë, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2003, fq.47.

11 *Idem,* fq.122.

12 Gabriel Louis Jaray."*Ideal ardhedashurie",* Autorë të huaj për bektashizmin shqiptar, Vëllimi I. Tiranë, Urtësia bektashiane, 2017, fq.84.

13 Fahri Made. *Mbyllja e teqeve*…vepër cituar, fq. 17. Shih dhe Halil Inalçik.*Tarikat msitik demokratik,* në *Autorë të huaj*… vepër e cituar, fq.26.

perifrazon bektashzmin një skizëm islamike që bazohej mbi ".. një tërësi parimesh pantesite, më tepër sesa një fe që kishte një kult dhe disa ceremoni"[14].

Për të argumentur më thellë tezën e mësipërme, studiuesit i referohen, në veçanti, doktrinës bektashiane *"Pa atdhe, nuk ka fe"*. Kjo qasje e re doktrinore, që patrioti dhe studiuesi i njohur Shahin bej Kolonja e pagëzon me emrin domethënës *"dialektika bektashiane",* përbën një precedent të panjohur, pse jo dhe revolucionar në histroinë e mendimit bektashi. Për këtë arsye, ajo ngjalli shumë dyshime për kundërshtarët që të ngrinin akuza për ateizëm, pasi cenonte rolin e Zotit, si krijues i gjithësisë.

I njësuar me ideologjinë e Rilindjes Kombëtare, ideologjia bektashiane u bë një komponent i rëndësishëm i indoktrinimit politik të shqiptarëve. Ndërkohë që vetë bektashizmi u bë pjesë e rëndësishme edhe e jetës shpirtërore të tyre, për të mos thënë u shqiptarizua. Shkaqet dhe përpjekjet për shqiptarizimin e bektashizmit janë analizuar në veprën e rilindasit të madh Naim Frashëri. Ai ka meritën që e përpunoi dhe e transformoi mendimin bektashian dhe e vuri në shërbim të çështjes kombëtare.

Përgjithësisht, vepra poetike e Naimit është shkruar në frymën e bektashizmit panteist. Ajo trajton në thellësi tema shumë senisitive për shoqërinë, si: bukuria, dashuria, humanizmi, bamirësia, trimëria, liria, urtësia, religjioni etj. Mbi të gjitha Naimi iu përkushtua propagandimit të ideologjisë bektashiane, funksionin e së cilës e trajtoi nën prizimin e humanizmit e të atdhedashurisë. Duke e lidhur përparimin e njërëzimit me përvetësimin e ideve hyjnore, Naimi bënte thirrje:"*Dhe ju hoxhë, ju dervish/ Mos shihni xhami e kishë"*. Ndaj dhe i këshillonte të gjithë klerikët pa përjashtim:"*Nder që kanë ta kenë/ Por të duanë mëmëdhenë"*.

Thuajse, të gjithë studiuesit[15] konkludojnë se nëpërmjet doktrinës bektashiane dhe thirrjes për besimin në një Zot të vërtetë, Naimi e përpunoi thellësisht atë, duke theksuar fort dimensionin nacionalist. Në veprën "*Fletore e Bektashinjtë",* p.sh., botuar në vitin 1896, ai e riformuloi doktrinën e Urdhrit Bektashi në një mënyrë të tillë sa që mori vlerat e një bible të vërtetë. Ndërkohë që vepra tjetër,*Qerbelaja,* si një histori kuranore që ka në qendër masakrimin e imam Huseinit mbeti një hymn për bektashinjtë, një pikë reflektimi për shqiptarët dhe një apel popullor kushtrimi për nevojën e luftës kundër pushtuesve turq.

Kryesore është se në vetëdijen poetike të Naimit u përvijua një koncept tërësisht i ri për bektashizimin, që kishte në thelb përdorimin e tij në dobi të shqiptarizimit. "Ai mori nismën e pabesueshme për të krijuar një misitikë familjare dhe shpirtërore për shqiptarët e tij, pra, bektashizmin tipologjik dhe përbashkues gjithëshqiptar"[16]. Me panteizmin e tij, Naimi pasuroi më tej botëkuptimin filozofik, fetar dhe etik të mendimit bektashian dhe, sikundër perifrazon studiuesi i mirënjohur Moikom Zeqo, kishte ngjashmëri me racën e profetëve.

Dhe së fundi *(jo nga rëndësia*), thelbin e botëkuptimit të natyralizuar bektashian e përbën qasja kritike, deri dhe dialektike ndaj islamit zyrtar *(syni*). Ndryshe nga synizmi, ai i kundërvihet konceptit idealist personal e praktikave rituale të ngrira dhe priret drejt një predikimi kolektiv human, që ndryshon dhe reformohet në kohë. Në këtë proces reformimi, bektashinjtë arritën të krijonin një sistem me rregulla ritual që i kundërvihej fanatizmit dhe disiplinës së rreptë fetare të sunizmit.

Përfundime

Bektashizimi është rrugë *(tarikat)* mistike që i përket degës Shiite të islamit. Ati themelues i bektashizmit është Haxhi Bektash Veliu. Fillimisht bektashizmi u përhap si ideologji pushtuese në kuadrin e pushtmeve osmane. Historia e tij e dokumentuar në Shqipëri përkon me periudhën

---

[14] Natalie Clayer, *Rëndësia e bektashizmit në përhapjen e shqiptarizmit*, në Autorë të huaj,. vepër e cituar, fq.182.

[15] Shaban Sinani, *Naim Shqipëria*, në, Kujtim Boriçi, Nuri Çuni, *Naim Frashëri, apostull dhe bilbil I shqiptarizmës,*Tiranë, "Urtësia Bektashiane", 2023, fq.328.

[16] Moikom Zeqo, *Qershori i Peligrinazhit dhe roli i bektashizmnit në Historinë e Shqiërisë,* në Kujtim Boriçi, Nuri Çuni, *Naim Frashëri, apostull…* vepër e cituar, fq.42. shih *Syri Tretë.*

e Ali Pashë Tepelenës, i cili i hapi rrugë procestit të natyralizimit shqiptar të tij. Shkaqet e bashkëpunimit të Aliut me bektashinjtë vlerësohen sa me natyrë politike, po aq dhe natyrë fetare, e nacionaliste. Por "*babaizmin*" Aliu e vlerësoi edhe si një doktrinë ideologjike që i shkonte për shtat profilit të tij, si shtetar autoritar e fuqiplotë.

Pas vitit 1826, bektashizmi mori fizionominë e një urdhri tipik shqiptar. E gjithë veprimtaria fetare e tij zhvillohej me cikël gati të mbyllur. Raportet e tij me vendin e origjinës u formalizuan. Edhe pse nuk hoqi dorë nga parimet themelore fetare,ai vuri në qendër të saj njohjen e kombësisë shqiptare. Qasja botëkutipmore bektashiane në Shqipëri fitoi disa tipare dalluese, që i dhanë më shumë vialitet lulëzimi dhe origjinalitet lokal. Por dallimi më specifik i sistemit mistik bektashian lidhet me karakterin panteist të tij. Filozofia botëkuptimore bektashiane në dobi të shqiptarizmës materializohet në veprën e poetit kombëtar Naim Frashëri.

Bibliografia

Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë

Fondi i Komuniteteve fetare.

Autorë të huaj për bektashizmin shqiptar, Vëllimi i pare. Tiranë, Urtësia Bektashiane, 2017.

Historia e popullit shqiptar I. Tiranë, Botimet TOENA, 2002.

Boriçi Kujtim; Çuni Nuri.*Naim Frashëri, apostull dhe biblbil i shqiptarizmës*. Tiranë, Urtësia bektashiane, 2023.

Birge, Kingsley, Johns.*Urdhëri bektashi i dervishëve*, Tiranë, Urtësia Bektashiane, 2008.

Elsie, Robert.*Bektashinjtë Shqiptarë. Historia dhe kultura e një rendi dervishësh në Ballkan.* Prishtinë, Botimet Artni, 2020.

Jacques Edwin."*Shqiptarët". Histori e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme.* Tiranë, Kartë & Pendë, 1996.

Pollo, Stefanaq.*Në gjurmë të historisë shqiptare*, II. Tiranë, Akademia e Shkencave, 2003.

Maden Fahri.*Mbyllja e teqeve bektashiane,* 1826. Tiranë, Urtësia Bektashiane, 2022.

NDIKIMI I SHPALLJES SË VJOSËS SI PARK KOMBËTAR NË ZHVILLIMIN E RAJONIT TË GJIROKASTRËS

MSc. Brikena Metaj

[1]Specialist of Public Relations, "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri, email: bmetaj@uogj.edu.al

Abstract

"Vjosa, the River that Does not Stop" is a documentary that comes on the first anniversary of the declaration of Vjosa as a National Park as a tribute to the battle and victory of the defenders of nature against the forces of destruction and concretization. The documentary presents a journey through the history and natural beauty of the Vjosa River and its valley, highlighting the ecological and cultural importance of this unique region. The documentary reflects the multi-year efforts of a broad coalition of environmental organizations, scientists, activists, and local communities to protect Vjosa from the construction of dams and hydropower plants. This mobilization culminated on May 17, 2023, when Vjosa was officially declared a National Park. The win has been associated with many positive impacts in the region, including increased sustainable tourism, improved tourism infrastructure, and economic benefits for local communities, showing how residents have benefited economically and socially from increased sustainable tourism and new tourism activities such as hiking, rafting, and observing flora and fauna. An important aspect of the documentary is the role of academics, who with their studies and scientific data have strongly supported the efforts to protect Vjosa. Through conferences, articles, and scientific reports, they have contributed to raising the awareness of the public and policymakers about the importance of preserving this special river. The documentary includes statistics that illustrate the positive impact of the declaration of Vjosa as a National Park, showing the increase in the number of visitors, the development of sustainable tourism activities, and the improvement of the lives of residents. This documentary is a testament to the power of unity and commitment to nature, showing that environmental protection and economic development can go hand in hand, creating a lasting legacy for future generations.

Keywords:*Vjosa, national park, ecological treasure, cultural heritage, biodiversity, protection of the environment, local community, sustainable development, academics' role, collective efforts, storytelling*

Hyrje

Lumi i fundit i egër në Shqipëri dhe një nga lumenjtë e fundit me rrjedhë të lirë në Evropë përfaqëson një thesar të vërtetë natyror, një burim të rëndësishëm të biodiversitetit dhe kulturës së Shqipërisë. Në mars të vitit 2023, qeveria shqiptare e shpalli Vjosën "Park Kombëtar". Ky vendim historik ka për synim jo vetëm të mbrojë ekosistemin e rrallë të luginës, por edhe të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm në rajonin Jugor. Ky artikull,i bazuar në të dhëna zyrtare dhe burime të ndryshme, trajton ndikimin e këtijvendimi në zhvillimin e turizmit dhe roline tij në komunitet.

Metodologjia

Studimi i kryer është mbështetur në të dhënat e nxjerra nga raportet e organizatave mjedisore dhe akademike dhe në intervistat e kryera në terren me përfaqësues të komunitetit lokal. Të dhënat e marra janë analizuar për të identifikuar synimet dhe ndikimin që ka pasur shpallja e Vjosës si Park Kombëtar, në ekonominë lokale dhe zhvillimin e bizneseve të zonës.

Pasuria e specieve

Me një histori që kapërcen mijëvjeçarët, lugina e Vjosës është një nga ekosistemet më të rëndësishme dhe më të veçanta të Shqipërisë. Ndërsa zbret nga malet e Pindit në Greqi, Vjosapërshkon rrugën e gjatë dhe panoramike përmes Shqipërisë deri në Adriatik. Prej fillesës së saj Vjosa ka qenëdëshmitare e historive të lashta dhe e kulturave që kanë lulëzuar përgjatë brigjeve të veta. Me ujërat e kthjellëta dhe rrjedhën e pakontrolluar, Vjosa mbart brenda vetes një biodiversitet të pasur dhe unik.

Studimet e detajuara dhe të dhënat shkencore tëakademikëve shqiptarë dhe të huaj kanë ofruar argumente të pakundërshtueshme për mbrojtjen e Vjosës. Konferencat shkencore, artikujt dhe raportet e shumta kanë ndihmuar në ndërgjegjësimin e publikut dhe politikëbërësve për rëndësinë e ruajtjes së këtij lumi të egër. Ata kanë treguar se Vjosa nuk është vetëm një thesar kombëtar, por edhe një pasuri e pazëvendësueshme për të gjithë planetin.

Në studimet e tyre studiuesit kanë konkluduar se lumi Vjosa dhe fusha e saj e përmbytjes përbën një nga ekosistemet lumore më madhështore në Ballkan. Ajo është shtëpia e mbi 1100 lloje gjallesash të gjetura deri tani. Në larminë e tyre ata kanë veçuar 15 lloje: 13 kafshë dhe 2 bimë, të cilat vlerësohen si të kërcënuara globalisht sipas Listës së Kuqe të Specieve të Kërcënuara të IUCN-së (International Union for Conservation of Nature).

Ngjala evropiane (Anguilla Anguilla), vlerësuar globalisht si e rrezikuar në mënyrë kritike (CR) sipas Listës së Kuqe të IUCN-së, mund të jetojë deri në 85 vjet dhe migron nga lumi Vjosa në Detin Sargasso në Atlantikun Perëndimor.

Karakteristika	***Detajet***
Gjatësia e lumit Vjosa	*270 kilometra, nga malet e Pindos në Greqi deri në detin Adriatik, në veri të lagunës së Nartës, Shqipëri.*
Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës	*6704 km² (4365 km² në Shqipëri dhe pjesa tjetër në Greqi).*
Vargjet malore kryesore	*Mali i Nemërçkës (2485 m),* *Këndrevica (2122 m),* *Mali i Çikës (2045 m).*
Llojet e florës dhe faunës	*Më shumë se 150 lloje.*
Specie të dokumentuara në Vjosë	*1175 specie, duke përfshirë: 516 artropodë, 157 shpendë, 37 peshq, 24 gjitarë, 109 molusqe, 19 zvarranikë, 9 amfibë, 299 bimë vaskulare, 5 bimë jovaskulare.*
Llojet e shpendëve	*Mbi 250 lloje.*
Llojet e peshqve	*31 lloje peshqish.*
Specie të florës	*Mbi 1500 lloje bimësh dhe pemësh.*
Specie të IUCN Red List	*39 specie.*
Specie në Listën e Kuqe të Shqipërisë	*74 specie në Listën e Kuqe Shqiptare janë klasifikuar si "në rrezik".*

Akademikët janë në një mendje mbi rëndësinë e mbrojtjes së Vjosës me degëzimet e saj dhe biodiversitetit të pasur që ajo ka. *https://ecoalbania.org/wp-content/uploads/2023/05/Vjosa-*

WRNP-proposal_ALB.pdf

Shpallja e Vjosës dhe degëve të saj, (Drino me degën e Kardhiqit, Bënça dhe Shushica), si Park Kombëtar në kategorinë II sipas IUCN-së, ka garantuar mbrojtjen e rrjedhjeve të tyre të lira dhe ruajtjen e integritetit të tyre ekologjik. Ky status lejon që proceset natyrore të vazhdojnë të ndodhin në mënyrë të pandërprerë, duke siguruar mbrojtjen e popullatave të specieve vendase dhe biodiversitetit të lumit.

Trashëgimia dhe vlerat kulturore të zonës.

Lugina e Vjosës njihet për trashëgiminë e pasur kulturore dhe historike, me një shumëllojshmëri monumentesh nga periudha të ndryshme historike.

Pjesë e listës së trashëgimisë botërore të UNESCO-s, qyteti i gurtë është një nga pikat kryesore të trashëgimisë kulturore të luginës, ndërsa e gjithë zona e Gjirokastrës ka mbi 500 monumente të trashëgimisë kulturore.Me një shtrirje të gjerë, lugina e Vjosës ka në gjirin e saj një pasuri të jashtëzakonshme të monumenteve kulturore, duke përfshirë: 7 monumente në rajonin e Fierit, 26 në rajonin e Vlorës, 10 në zonën e Korçës. Ndër këto monumente janë edhe tri qendra historike të rëndësishme (Gjirokastra, Përmeti dhe Bënja) dhe tri parqe arkeologjike (Antigonea, Amantia dhe Bylisi).

Monumentet kulturore përfshijnë objekte kulti, qytete antike, fortesa dhe kulla mbrojtëse, kisha ortodokse dhe manastire, si dhe shtëpi dhe fshatra të rrënuara, ura, ujësjellës, puse uji dhe sisteme ujore, banja termale dhe shpella parahistorike. Lugina e Vjosës është zemra e një prej zhanreve më përfaqësuese të muzikës popullore shqiptare, Isopolifonisë Popullore Shqiptare, e përfshirë në Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit të UNESCO-s në vitin 2005.

Lugina e Vjosës dhe pellgu i saj ujëmbledhës përfshijnë disa lugina të tjera me rëndësi të madhe kulturore dhe arkeologjike, si: lugina e Langaricës, lugina e Drinosit dhe lugina e lumit të Bënçës. Lugina e Drinosit, në veçanti, është e njohur për pasurinë e saj në trashëgiminë kulturore, historike dhe arkeologjike.

Disa nga qytetet më të rëndësishme antike të Shqipërisë, ndodhen pikërisht në këtë zone. Ato përfaqësojnë fillimet e qytetërimit shqiptar dhe mbartin gjurmët e historisësë pasur të Shqipërisë.

Kjo pasuri e jashtëzakonshme kulturore dhe historike tërheq gjithnjë e më shumë një numër të madh turistësh të interesuar për turizmin kulturor, historik dhe arkeologjik krahas llojeve të tjera të turizmit që kanë potencial të zhvillohen me ritme të shpejta në rajon.

Më shumë biznese të reja

Shpalljae Vjosës si Park Kombëtar ndikoi në shtimin e konsiderueshëm të bizneseve të reja në sektorin e turizmitdhe aktiviteteve të lidhura me të. Në rajonin e Gjirokastrës përgjatë një viti, prej shpalljes së Parkut, për periudhën 2023-2024, janë hapur gjithsej 58 biznese të reja, ku përfshihen bujtina, restorante, operatorë turistikë dhe aktivitete të ndryshme të ekoturizmit, si: rafting, hiking, dhe ture kulturore. Komunitetet lokale e kanë parë këtë zhvillim si një mundësi përfitimi nga rritja e turizmit të qëndrueshëm në luginën e gjerë të Vjosës.

Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e këtyre bizneseve sipas bashkive dhe llojeve të tyre në qarkun Gjirokastër:

Bashkia	Bizneset e reja (2023 – 2024)	Llojet e bizneseve
Gjirokastër	15	Bujtina, operatorë turistikë ekologjikë, restorante, dyqane për pajisje sportive të aventurës
Përmet	20	Shërbime rafting dhe kanotazhi, guida natyrore, dyqane artizanati lokal, restorante tradicionale
Tepelenë	10	Guida për hiking dhe biking, eko-lodge, muze të trashëgimisë kulturore, dyqane suveniresh
Libohovë	5	Ferma organike që ofrojnë agroturizëm, zona kampingu, shërbime për fotografi natyre
Dropull	2	Ture për vëzhgimin e kafshëve të egra, bujtina miqësore me mjedisin
Këlcyrë	6	Restorante tradicionale, bujtina, guida për ture natyrore, kampe për rafting dhe kanotazh

Rritja e bizneseve reflekton interesine shtuar për turizmin ekologjik dhe kulturor në rajon, veçanërisht në aktivitetet që lidhen me natyrën dhe trashëgiminë kulturore të zonës. Hapja e këtyre bizneseve të reja ka kontribuar më së shumti në zhvillimin ekonomik lokal dhe ka krijuar mundësi të reja për punësim dhe të ardhura për komunitetet e zonës.

Rritja e Turizmit

Shpallja e Vjosës si Park Kombëtar solli rritje të ndjeshme të numrit të turistëve, të cilët tërhiqen nga bukuria natyrore dhe mundësitë për aventura. Aktivitetet si rafting, kanotazh, kayaking, dhe hiking janë bërë gjithnjë e më të njohura dhe të kërkuara, duke shtuar numrin e operatorëve dhe duke rritur ndjeshëm fluksin e vizitorëve në zonë. Ky interes i shtuar i turistëve nga e gjithë bota ka nxitur investimet në infrastrukturën turistike, duke përfshirë ndërtimin e shtigjeve për ecje, kampingje dhe zona pikniku. Dokumentari multimedial "Vjosa, lumi që nuk ndalet" sjell dëshmi të përvojave të bizneseve të reja të zonës që tregojnë se si ky park ka tërhequr një numër të madh vizitorësh që kërkojnë përvoja të pasura natyrore dhe kulturore.

Përfitimet ekonomike dhe sociale

Turizmi ka sjellë edhe mundësi të tjera për ekonominë lokale. Me zhvillimin e bizneseve të reja, burimet e të ardhurave do të jenë më të shumtapër banorët e zonës. Dokumentari "Vjosa, lumi që nuk ndalet" tregon se si fermerët lokalë kanë filluar të ofrojnë produkte organike dhe eksperienca agroturistike, duke rritur ndjeshëm fitimet e tyre.

Sipas studimit të Dr. Daniela Qiqi dhe Dr. Eduina Guga**"Sustainable Tourism Strategies along the Vjosa River in Albania",** bizneset e reja kanë kontribuar në diversifikimin e burimeve të të ardhurave për banorët lokalë, duke ofruar produkte dhe shërbime të ndryshme për turistët dhe duke mbështetur një model zhvillimi të qëndrueshëm.

Kontributi në ruajtjen e mjedisit

Një aspekt kyç i shpalljes së Parkut Kombëtar Vjosa është ruajtja e biodiversitetit dhe mbrojtja e ekosistemeve natyrore. Projekti ka përfshirë masa të rrepta për menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e habitateve të rrezikuara. Kjo ka përmirësuar cilësinë e ujit dhe ka ndihmuar në ruajtjen e specieve të ndryshme të florës dhe faunës që jetojnë përgjatë lumit, siç theksohet në raportet e Planeterra Foundation dhe Organizatës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës

(IUCN)(IUCN) (Adventure Travel News)

Sfidat dhe rekomandimet

Shpallja e Vjosës si Park Kombëtar ka një ndikim shumëdimensional dhe kryesisht pozitiv, duke krijuar një model të ri zhvillimi që balancon nevojat ekonomike të komunitetit me ruajtjen e mjedisit. Zhvillimi i turizmit sjell me vete sfida dhe problematika të shumta që lidhen meinfrastrukturën dhe rëndësinë e menaxhimittë ndikimeve negative në mjedis.

Rekomandimet e studiuesve përfshijnë:

1. **Zhvillimin e infrastrukturës së qëndrueshme:** Më shumë investime në rrugë, shtigje dhe struktura akomoduese miqësore me mjedisin.
2. **Edukim dhe ndërgjegjësim:** Organizimi i fushatave edukative për turistët dhe banorët lokalë mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.
3. **Promovimi i turizmit të gjelbër:** Nxitjen e aktiviteteve turistike me ndikim të ulët në mjedis, si: ecja, kampingu apo vëzhgimi i kafshëve të egra.
4. **Mbështetja e bizneseve lokale:** Sigurimi i subvencioneve dhe granteve për bizneset e vogla që promovojnë praktikat e qëndrueshme dhe janë miqësore me ambientin.

Përfundim

Shpallja e Vjosës si Park Kombëtar ishte një hap i rëndësishëm para për ruajtjen e mjedisit dhe për zhvillimin ekonomik të rajonit të Gjirokastrës dhe jo vetëm. Ky model zhvillimi mund të shërbejë si shembull për ruajtjen e lumenjve të tjerë në Evropë dhe më gjerë. Për të siguruar që përfitimet e kësaj nisme të jenë të qëndrueshme është thelbësore që të vazhdohet me zbatimin e politikave që mbështetin një balancë të qëndrueshme midis zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Referenca

Drejtoria e Tatimeve

Intervista dhe të dhëna nga komunitetet lokale

Raporte dhe studime nga organizatat mjedisore dhe akademike:

(IUCN) (Adventure Travel Neës)

https://ecoalbania.org/ëp-content/uploads/2023/05/Vjosa-ËRNP-proposal_ALB.pdf

https://storymaps.arcgis.com/stories/c5b0888cdbe54eb9b58087b5c061a36f

"Sustainable Tourism Strategies along the Vjosa River in Albania"

Autore: Dr. Daniela Qiqi, Dr. Eduina GUGA

Universiteti “Eqrem Çabej”, Fakulteti i Ekonomisë

Prof.dr. Jaho Cana, Universiteti “Eqrem Çabej”, Fakulteti i Shkencave Shoqërore

Prof.dr. Lavdi Hasani, Universiteti “Eqrem Çabej”, Fakulteti i Shkencave Natyrore

EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE NË KURRIKULAT ARSIMORE

[1]Assoc. Prof. Mimoza Çarka, [2]Assoc. Prof. Albina Sinani, [3]Doc. Majlinda Bobrati
[1]Department of Education and Teaching Methodology, Faculty of Education and Social Sciences,"Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,mcarka@uogj.edu.al
[2]Department of History, Anthropology and Geography, Faculty of Education and Social Sciences, "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,asinani@uogj.edu.al
[3]Department of Foreign Languages, Faculty of Education and Social Sciences, "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,mbobrati@uogj.edu.al

Abstract
Psikologu Robert Sternberg u pajtua me Gardner në aspektin që inteligjenca përfshin një numër aftësish krejtësisht të ndryshme. Por ai besonte se disa nga llojet e përshkruara nga ky autor kishin të bënin më shumë me talentet, sesa me aftësitë e lindura mendore. Ndryshe nga Gardner, Sternberg besonte se inteligjenca përbëhej nga tri aftësi mendore: Inteligjenca analitike ose aftësia për të kuptuar dhe zgjidhur probleme të të gjitha llojeve. Inteligjenca krijuese ose aftësia për të aplikuar përvojat e kaluara dhe aftësitë ekzistuese në situata të reja. Inteligjenca praktike ose aftësia për t'u përshtatur në një mjedis të ri. Sternberg nuk fokusohet në komponentë të veçantë të inteligjencës të përafruar me disiplina të ndryshme akademike, por ai shqetësohet për faktin se sa ndihmon inteligjenca që njerëzit të kryejnë mirë çdo gjë që zgjedhin të bëjnë. Sternberg beson fuqimisht se inteligjenca mund të rritet me studimin dhe praktikën. Të mësuarit jashtë shkollës është krejt i ndryshëm nga të mësuarit që zhvillohet në shkollë. Më tej Sternberg thekson ekuilibrin mes katër grupeve të aftësive njohëse që shërbejnë për t'u bërë një person i arsimuar: aftësitë kreative, analitike, praktike dhe aftësitë e bazuara në dituri.

Nxënësit duhet të zhvillojnë aftësitë krijuese të të menduarit për të gjeneruar ide të reja dhe bindëse, për t'u marrë me probleme komplekse globale; duhet të zhvillojnë aftësitë analitike për të konstatuar nëse idetë e tyre janë të reja e të vlefshme; të zhvillojnë aftësitë praktike për të zbatuar idetë e tyre dhe për të bindur të tjerët për dobishmërinë e tyre; dhe së fundi, të zhvillojnë aftësi të bazuara në dituri për progres shoqëror dhe individual. Prandaj nuk mund të lejojmë që të zhvillojmë mendimtarë që nuk kanë kreativitetin, mençurinë dhe aftësitë praktike për të zgjidhur probleme të rëndësishme globale.

David Perkins është një tjetër mbështetës i teorisë së Gardnerit për inteligjencat e shumëfishta. Sipas tij, arsimi mund të përmirësohet ndjeshëm duke u fokusuar në shkathtësitë njohëse të rendit të lartë, dhe duke përdorur mësimin e bazuar në projekte. Perkins (1995) hulumton rreth inteligjencave dhei diferencon në: a. Inteligjenca nervore i referohet sistemi neurologjik, efikasitetit dhe saktësisë së tij. b. Inteligjenca eksperienciale, e cila u referohet njohurive dhe përvojave të grumbulluara në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore. c. Inteligjenca reflektuese u referohet strategjive për të mësuar, për të zgjidhur probleme dhe për t'u afruar intelektualisht detyrave sfiduese.

Si përfundim, mund të themi se teoritë rreth inteligjencës mbështetin nxënien aktive në ndërtimin e njohurive dhe aftësive nga përvojat e mëparshme për të qenë krijues, reflektive dhe problemzgjidhës.

Të nxënët hulumtues, sipas Xhon Dewey (1910), mbështetet në kërkim dhe hulumtim mbi bazë të përvojave dhe eksperiencave të drejtpërdrejta. Nxënësit hulumtojnë, parashikojnë, testojnë, nxjerrin përfundime, reflektojnë rreth problemit origjinal dhe proceseve të nevojshme të të menduarit për zgjidhjen e tij. Ky lloj të nxëni u mundëson nxënësve jo vetëm të mësojnë përmbajtjen mësimore, por edhe procesin e zhvillimit të përmbajtjes në të njëjtën kohë.

Projektet sipërmarrëse mbështetin, gjithashtu, të mësuarit përmes përvojës. Nxënësit vrojtojnë, identifikojnë problemet, mendojnë për zgjidhje, zhvillojnë prototipe dhe paraqesin idetë e tyre në një panel sikur në një shfaqje jetësore.

Përvoja dhe mësimdhënia

Të mësuarit përmes përvojës ndodh përtej klasës mësimore dhe e sjell nxënësin në kontakt të drejtpërdrejtë me lëndën, duke e lidhur mësimin që zhvillohet në klasë me përvoja nga jeta reale.

Ai që promovoi i pari mësimin përmes përvojës ishte Dewey, i cili shprehet se edukimi është "nga përvoja, për përvojën dhe përmes përvojës". Më pas Piaget thekson se të mësuarit është një proces i ndërveprimit të individit me mjedisin. Lewin thekson rëndësinë e madhe të përvojës së individit në të mësuar, nënvizon dhe evidenton lidhjen mes teorisë dhe praktikës. Të tre teoricienët fokusohen në përvojë, duke krijuar konceptin e të mësuarit përmes përvojës. Ky lloj të mësuari qëndron në kontrast të teorive kognitive të të mësuarit që nuk përfshijnë përvojën dhe subjektivizmin e individit.

David Kolb ishte ai që krijoi modelin ciklik të të nxënit, nëpër të cilin përfshihet çdo individ gjatë nxënies. Ai përvijoi procesin e të mësuarit përmes përvojës, të cilën e quajti "Cikli i të nxënit nga përvoja". Kolb (1984) e përshkruan të nxënit si proces me anë të të cilit ne lëvizim nga eksperiencat konkrete drejt vëzhgimit reflektiv, më pas drejt konceptualizmit abstrakt dhe në fund drejt eksperimentimit aktiv (Swanson 1995). Të nxënët përmes përvojës është një proces ciklik i ndërtimit të njohurive që kalon përmes katër fazave të të nxënit.

1. Përvojës së drejtpërdrejtë
2. Reflektimit mbi përvojën
3. Përgjithësimit të përvojës
4. Zbatimit të përvojë

Fillimisht nxënësi vjen në kontakt me përvojën e drejtpërdrejtë. Më pas reflekton mbi përvojën duke e krahasuar me atë çfarë mësoi - reflektimi mbi përvojën. Personi tashmë reflekton rreth përvojës së vëzhguar dhe bën përgjithësimin e përvojës. Dhe së fundi, zbatimi i përvojës, personi që po mëson, zbaton atë çfarë vëzhgoi dhe mësoi. Stadi i zbatimit të përvojës bëhet baza e të mësuarit në të ardhmen. (Kolb, David and Fry, 1975). Është faza e fundit e procesit të të nxënit dhe më e rëndësishmja e gjithë e këtij procesi. Gjatë kësaj faze zbatohen parimet e të menduarit kritik, nxënësit zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në përvetësimin e kompetencave mësimore dhe zgjidhjen e problemeve.

Nga shqyrtimi i kurrikulës shkollore shqiptare rezulton se të mësuarit përmes përvojës është në koherencë me praktiket e reja metodologjike të të mësuarit situativ dhe aplikohet nëpërmjet aktiviteteve ekstra dhe kroskurrikulare, përvojat e përgjithësuara nga vëzhgimet e drejtpërdrejta apo projekteve në bashkëveprim.

Nëpërmjet një interviste të strukturuar, drejtuar mësuesve të AMU-së, dolën disa përfundime të rëndësishme: përvojat e përgjithësuara risillen më tej në temat lëndore mësimore për të përvetësuar njohuri të reja. Mësuesit janë vetë planifikues të veprimtarive të tyre ekstrakurrikulare, në përshtatje me udhëzuesit kurrikularë lëndorë. Shprehin nevojë për më tepër hapësirë në kurrikulën shkollore për veprimtari ekstrakurrikulare. Shprehin nevojë për trajnime profesionale për zbatimin e modeleve të të mësuarit përmes përvojës.

Përfundime

Veprimtaritë e edukimit joformal në natyrë dhe në parqe përbëjnë një ndër alternativat e të mësuarit përmes përvojës. Ky lloj të mësuari ndodh në mënyrë spontane ose të organizuar, si pjesë e edukimit joformal. Edukimi joformal mund të zhvillohet brenda ose jashtë institucioneve arsimore dhe u shërben të gjitha moshave. Eshtë arsim i qëllimshëm, i planifikuar, i

institucionalizuar, alternativ dhe plotësues i arsimit formal, në kuadër të të nxënit gjatë gjithë jetës. Ai përshkohet nga ideja që përmbajtja e kurrikulave lëndore duhet të pasurohet përmes veprimtarive kroskurrikulare dhe ekstrakurrikulare.

Kurrikulat lëndore që trajtohen në klasat joformale mund të bëhen më efektive dhe më tërheqëse për nxënësit, kur ato kanë objektiva më të gjera se thjesht lëndore. Të nxënët nga përvoja mund të ndodhë përmes formave të ndryshme, sikundër të nxënët vëzhgues, të nxënët hulumtues, të nxënët spontan, të nxënët në grup, të nxënët eksperimental,projektet.

Në kurrikulat me bazë kompetencat dhe realizimin e tyre me situata nga jeta reale, të mësuarit përmes përvojës po bëhet gjithnjë dhe më i spikatur në shkolla dhe qendra mësimore. Tani më shumë se kurrë, shkollat kanë një sërë programesh mësimore eksperienciale, të tilla si: shkëmbimet kulturore dhe gjuhësore, udhëtimet shkollore dhe të mësuarit të fokusuar në projekte.

Të mësuarit përmes përvojës ka një traditë të hershme në edukim. Filozofë dhe psikologë të edukimit mbështetin përvojat e drejtpërdrejta për përgjithësimin e njohurive, zbatimin e përvojave në situata të reja dhe ndërtimin e njohurive mbi bazën e përvojave të mëparshme.

Përvoja ka treguar, gjithashtu, se edukimi formal i izoluar nuk siguron gjithmonë mundësi për edukimin e mëtejshëm të fëmijës, gjë që tregon domosdoshmërinë e integrimit të edukimit joformal në shkollat formale.

Për më tepër, të mësuarit përmes përvojës ndodh përmes aktiviteteve eksperienciale të drejtpërdrejta dhe reflektimit që pason këto aktivitete. Njohuria trajtohet dhe fitohet ndryshe nga të mësuarit tradicional. Qasja e këtij lloji të mësuari është holistike, ndërdisiplinore dhe fitohet duke e sjellë nxënësin në kontakt të drejtpërdrejtë me lëndën mësimore, pas një procesi vëzhgimi, hulumtimi dhe eksperimentimi në mjedise nga jeta reale, ndër të cilat në parqe kombëtare. Përvojat e fituara lidhen dhe transferohen në lëndën mësimore për ndërtimin e koncepteve dhe njohurive të reja, si dhe për zbatimin e përvojave të abstraguara në situata problemore.

Literatura

Evans, N. (1994). Experiential learning for All. London, NewYork: Cassel.

Dedhuli, M.(2002). Biomatiki mathishi-Dynatotites aksiopoiisis sta plaisia tis eyeliktis zonis. Epitheorisi ekpaideytikon thematon f, 145- 159.

Kolb, D.A. (1984). Experiential learning: Experience as the source of learning and development. Englewood Cliffs, New Jersey: Prentice-Hall.

Kolb, David and Fry, R. "Towards an Applied Theory of Experiential
Learning" in Cooper, Theories of Group Processes. 1975, Wiley. fq. 27 – 56.

Merriam, S. & Caffarella, R. (1999). Learning in Adulthood, a Comprehensive Guide. SanFrancisco: Jossey-Bass.

Matsaggoyras, H. (2012), Material edukativ rreth tëmësuarit përmes përvojës: prej të mësuarit experiencial në modelin bashkëpunues të praktikave experienciale.Instituti pedagogjik.

Postle, D. (1993). Putting the heart back into learning. In D.Boud, R. Cohen, & D.Walker (Eds). Using experience for learning.

Manual për mësuesin. Mësimdhënia dhe të nxënët në edukimin joformal, Tiranë, 2006.

https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Kurrikula-Berthame-per-Klasen-Pergatitore-dhe-Arsimi-Fillor.pdf

https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Kurrikula-Berthame-AML.pdf

https://observator.org.al/wp-content/uploads/2015/11/Dispozitat_normative_per_arsimin_parauniversitar.pdf neni 9

https://faqeemeparshmefsash-spash.fsash.al/Non-form-educ-manual.pdf

https://www.academia.edu/4062794/Cikli_i_te_mesuarit_i_Kolbit_dhe_roli_i_trajnuesit

EDUKIMI I NXËNËSVE SI QYTETARË AKTIVË PËRMES INTEGRIMIT NDËRLËNDOR ME NË FOKUS PARKUN KOMBËTAR TË LUMIT VJOSË

[1]Dr. Loreta Mamani, [2]MSc.Aida Sotiri, [3]Prof.asoc. Mimoza Çarka, [4]MSc.Anila Cacaj
[1]Department of Education and Teaching Methodology, Faculty of Education and Social Sciences, "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri, asotiri@uogj.edu.al, lmamani@uogj.edu.al, mcarka@uogj.edu.al
[2]Teacher at "Koto Hoxhi" primary school, Gjirokastër, Local Educational Office, Gjirokastër-Libohovë, anila_cacaj@yahoo.it, etlevakorkuti@yahoo.com

Përmbledhje

Vlera të mëdha për formimin e koncepteve shkencore kanë vëzhgimet në natyrë, pasi në këtë mënyrë realizohet lidhja ndërmjet koncepteve abstrakte që nxënësi mëson me objektet e vrojtuara. Sa më të shumta të jenë vëzhgimet në natyrë, aq më të pasura e më të qëndrueshme do të jenë përfytyrimet që krijohen. Ky studim do të sjellë në vëmendje se vëzhgimet në natyrë e nxisin nxënësin të punojë në mënyrë shkencore, të bëjë pyetje dhe të ndërtojë ide, të cilat duhet t'i hetojë dhe t'i provojë. Në një orë mësimi duke pasur në qendër të saj Parkun Kombëtar Vjosa, mësuesi do të integrojë disa lëndë dhe do të bëjë që nxënësit të kuptojnë më mirë përmbajtjen lëndore si dhe do ta bëjë interaktive mësimdhënien dhe të nxënët. Kjo orë mësimi do të ndikojë dhe në edukimin mjedisor të nxënësve. Shpallja e lumit Vjosa Park Kombëtar do të ndihmojë në zgjidhjen e sfidave të mbrojtjes edhe nga nxënësit e shkollave. Studimi mori në analizë klasen e pestë dhe të tetë të shkollës 9-vjecare "Koto Hoxhi" dhe analizon rolin dhe ndikimin e modeleve të mesimdhënies mbi edukimin e nxënësve si qytetarë aktivë në mbrojtje të Parkut Kombëtar. Qëllimi i punimit qëndron në efektivitetin që ka integrimi ndërlëndor në të nxënët te nxënësit si dhe edukimin e brezit të ri si qytetarë aktivë në mbrojtjen e mjedisit. Ky punim përdori një metodologji interaktive të kombinuar me teknika të ndryshme.

Fjalë kyçe:*Parku Kombëtar Vjosa,mësim i integruar, edukim mjedisor, qytetarë aktivë*

Abstract

Natural observations are very helpful in the development of scientific ideas because they allow students to make the connection between the abstract concepts they are learning and the things they are seeing. The more natural observations made the more stable the images in their minds are. This study will highlight how nature observations inspire students to think scientifically, raise questions, and develop concepts that they must then research and validate. The teacher will incorporate multiple subjects into a class focused on Vjosa National Park, enhancing students' comprehension of the subject matter and fostering an engaging learning environment.

The students' environmental education will also benefit from this lesson. Even among schoolchildren, the declaration of the Vjosa River National Park will aid in resolving the protection issues. The study examined the role and impact of teaching styles on preparing pupils to be engaged citizens who defend the National Park by examining the third grade students at "Koto Hoxhi" Primary School. The effectiveness of cross-cultural integration in student learning and preparing the next generation of environmentally conscious citizens is the focus of this research. This study blended a variety of methodologies with an interactive methodology.

Keywords: *Vjosa National Park, integrated learning, environmental education, active citizens*

1. Hyrje

Qeveria e Shqipërisë është angazhuar për krijimin e Parkut Kombëtar të lumit të egër Vjosa (PKLEV), i cili do të përfshijë dhe mbrojë të gjithë rrjedhën e lumit Vjosa nga kufiri grek deri

në detin Adriatik, duke përfshirë dhe degët e tij me rrjedhje të lirë.[1]Shpallja "Park Kombëtar" e lumit Vjosa do të ndihmojë në zgjidhjen e sfidave të mbrojtjes edhe nga nxënësit e shkollave[2]. Zhvillimi i programeve të edukimit mjedisor është një domosdoshmëri mbarëbotërore dhe mund të bëhet një mjet i fuqishëm për të ndërtuar shoqëri të qëndrueshme dhe nxënës qytetarë aktivë[3]. Për më tepër, disa autorë kanë vënë në dukje se fëmijët dhe të rinjtë mund të jenë agjentë efektivë të ndryshimit brenda shtëpive dhe komuniteteve të tyre.[4] Prandaj është e një rëndësie të madhe orientimi dhe edukimi i nxënësve për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit, në mënyrë që të kemi qytetarë të përgjegjshëm [5], më të ndërgjegjshëm, të arsimuar dhe të përfshirë.[6] Me ndryshimet që ndodhin në shoqëri, shfaqen nevoja dhe strategji të reja për zhvillim. Këtyre zhvillimeve arsimi duhet t'u përgjigjet me ritme të shpejta për të mundësuar njohuri të reja, shkathtësi, vlera sistematike dhe në zhvillim të përhershëm.[7] Nxënësit duhet të përshtaten me zhvillimet e reja në botën globale, ata duhet të fitojnë njohuri, shprehi, me qëllim që, kur të rriten, të bëhen qytetarë aktivë. Kjo kërkon zotërimin e kompetencave për t'u bërë të aftë në jetën e përditshme. Të gjitha njohuritë nxënësit i fitojnë përmes fushave të të nxënit ku ata zhvillojnë dhe kompetencat përkatëse. Kombinimi i këtyre fushave gjatë 1 ore mësimi sjell përvetësim më të lartë të të nxënit te nxënësit. Një rëndësi të veçantë kanë dhe vëzhgimet në natyrë, sepse përmes tyre realizohet lidhja ndërmjet koncepteve që nxënësi mëson nga vrojtimi i peizazheve. Sa më të vazhdueshme të jenë vëzhgimet në natyrë, aq më i lartë do të jetë interesi i nxënësve, sepse kombinimi i teorisë me praktikën do të rritë të nxënët, por dhe do t'ua bëjë mësuesve më të lehtë mësimdhënien. Gjatë 1 ore mësimi, kur nxënësit kanë kryer edhe vëzhgimet në natyrë, ata aftësohen të vlerësojnë jo vetëm peizazhin dhe bukuritë e natyrës, por të zhvillojnë kompetenca në fusha të ndryshme. Këto aftësi janë thelbësore për suksesin në shkollë dhe në jetë. Si rezultat i njohurive të marra nga teoria dhe praktika, nxënësit aftësohen dhe mësojnë të bëhen më kritikë ndaj çështjeve, duke pasur këndvështrimet dhe opinionet e tyre. Kështu që ata bëhen dhe qytetarë më aktivë, sepse do të marrin informacione dhe do të ndërmarrin veprime që të çojnë zërin e tyre, duke zhvilluar edhe një ndjenjë përgjegjësie. Priest (1986) e përkufizoi edukimin në natyrë si një metodë mësimi, ndërsa Smith (1955) e përshkroi atë si një proces mësimi për një lëndë, e cila nuk mund të mësohet në një klasë. Për më tepër, në një listë përshkruese të parimeve udhëzuese për Edukimin Mjedisor, përmbahen këto: "Edukimi Mjedisor duhet të lidhet me ndjeshmërinë mjedisore … me çdo moshë, por me theks të veçantë në ndjeshmërinë mjedisore ndajkomunitetit të vetë nxënësit në vitet e hershme"[8]. Megjithatë,

---

[1]Parku kombëtar i lumit të egër Vjosa, Vizioni, Udhërrëfyesi dhe Studimi i Fizibilitetit, Dhjetor, 2022. Bazuar në standardet e IUCN-së për zonat e mbrojtura.

[2] https://www.cna.al/kulture/krijohet-parku-i-pare-kombetar-i-nje-lumi-te-eger-ne-evrope-kumbaro-vjos-i354189

[3]Contreras, K.; Contreras, J.; Corti, M.; De Sousa, J.; Durán, M.; Escalante, M. *ElAguaUnRecursoParaPreservar*; Universidad de Los Ángeles: Mérida, Venezuela, 2008.
Zsóka, Á.; Szerényi, Z.M.; Széchy, A.; Kocsis, T.GreeningDuetoEnvironmentalEducation?EnvironmentalKnowledge, Attitudes, Consumer Behavior and Everyday pro-Environmental Activities of Hungarian High School and University Students. *J. Clean. Prod.* 2013, *48*, 126–138.

[4]UNICEF.*Educación Sobre El Cambio Climáticoy El Medio Ambiente*; UNICEF:NewYork,NY,USA,2012.

[5]Damerell,P.;Howe,C.;Milner-Gulland,E.J.Child-Orientated Environmental Education Influences Adult Knowledge and Household Behaviour. *Environ. Res. Lett.*2013,*8*,015016.

[6]Kinder,T.;Mesner,N.O.;Larese,M.;Lott,K.H.;Cachelin,A.;LaLonde,K.Changesinknowledgeandattitudefromash ort-term aquatic education program. *Nat. Sci. Educ.* 2015, *44*, 18–25. Menn,A.SSWM (Sustainable Sanittation and Water Management Toolbox). *School Campaigns*. Available online:https://sswm.info/humanitarian-crises/urban-settings/hygiene-promotion-community-mobilisation/important/school-campaigns-%28dc%29(accessedon20January2019).

[7] Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Tiranë, 2014.

[8]Edukimi i Kombeve të Bashkuara , Organizata Shkencore dhe Kulturore.

faktori më i rëndësishëm është se edukimi në natyrë i lejon mësuesit të përfshijnë konceptin e zhvillimit të njeriut dhe natyrës në planet e tyre të mësimdhënies, edukimi në natyrë dhe të mësuarit eksperimental kërkojnë përdorimin e plotë të gjashtë shqisave (të parit, të dëgjuarit, shijes, prekjes, nuhatjes dhe intuitës) dhe përfshijnë 3 (tri) fushat e të mësuarit, (konjitive, afektive dhe motorike). Hulumtimet e fundit në Mbretërinë e Bashkuar (Tiplady & Menter, 2020) tregojnë se Forest School (një përvojë arsimore e ndërmarrë në pyll) mund të ndikojë pozitivisht në mirëqenien emocionale të fëmijëve. Edukimi mjedisor në natyrë është zbuluar se ndihmon studentët me përqendrim të paaftësive emocionale, njohëse dhe të sjelljes dhe ulje të sjelljeve përçarëse (Szczytko et al., 2018). Programet mjedisore afatgjata kanë zhvilluar efekte pozitive në nivelet e sjelljes (Bogner, 1998) dhe në qëndrimet e tyre ndaj natyrës dhe njohurive (Mygind, 2016; O'Brien & Murray, 2007). Ernst dhe Theimer (2011) zbuluan se efekti pozitiv në lidhje mund të arrihej vetëm me një program "kornizë kohore të kondensuar me kohëzgjatje të mjaftueshme". Nga ana tjetër, Drissner et al. (2010) dhe Schultz dhe Tabanico (2007) raportuan efektet pozitive të një ndërhyrjeje afatshkurtër në sjelljet mjedisore dhe lidhjen me natyrën respektivisht, edhe pas një programi gjysmëditor. Kosta dhe Tsagarakis (2019) kanë treguar gjithashtu se edhe një ndërhyrje 1-orë mund të sigurojë informacion të rëndësishëm për politikat mjedisore. Megjithatë, zbatimi afatshkurtër ka nevojë për kërkime të mëtejshme, në mënyrë që të integrohet në mënyrë të qëndrueshme në kurrikulën shkollore (Kossack & Bogner, 2012). Përfitime kanë dhe fëmijët me nevoja të veçanta nga mësimi në natyrë. Autorë të njohur në këtë fushë, na ofrojnë një kombinim të literaturës mbi edukimin natyror dhe studimeve specifike. Ndërkohë që Piaget fokusohet te zhvillimi individual përmes ndërveprimit me mjedisin fizik,Vygotsky thekson rëndësinë e ndërveprimit social dhe kontekstit kulturor. Mësimi në natyrë, sipas tyre, me fokus eksplorimin dhe ndërveprimin social, përputhet me teoritë e tyre. Natyra ofron një mjedis të pasur për zhvillimin konjitiv dhe social të fëmijëve, përfshi edhe ata me nevoja të veçanta. Duke lexuar rreth pedagogëve të mëdhenj Piaget dhe Vygotsky, mendon se këto ide bazë mund të aplikohen për krijimin e një kurrikule të pasur gjithëpërfshirëse për mësimin në natyrë, duke përfshirë aktivitete që inkurajojnë eksperimentin dhe ndërveprimin social. Edhe pse ata nuk kanë shkruar specifikisht për mësimin në natyrë, parimet e tyre aplikohen në kontekstin e këtij mësimi, duke iu referuar teorive të zhvillimit konjitiv, e cila përfshin 4 fazat kryesore të zhvillimit të fëmijëve, në shkrimet[9]:"The Origins of Intelligence in Children" (1952);"The Construction of Reality in the Child" (1954);"The Child'sConception of the World" (1929. Fëmijët në fazat paraoperative dhe operative konkrete, mësojnë më mirë përmes eksperiencave të drejtpërdrejta dhe eksperimentimit. Aktivitetet në natyrë ofrojnë mundësi të shumta për eksplorim të drejtpërdrejtë dhe eksperimentim. Piaget mbron idenë se fëmijët ndërtojnë njohuritë e tyre përmes ndërveprimit me mjedisin. Mësimi në natyrë mund të ndihmojë në krijimin e skemave të reja dhe zhvillimin e kuptimit të botës natyrore. Ndërsa Vygotsky është i njohur për teorinë e tij socio-kulturore, e cila thekson rëndësinë e ndërveprimit social dhe kontekstit kulturor në zhvillimin konjitiv[10]. Në këto shkrime ai thekson rëndësinë e ndërveprimit me të tjerët për të arritur nivele të larta të të kuptuarit. Mësimi në natyrë ta krijon këtë mundësi, duke bashkëpunuar e ndërvepruar me bashkëmoshatarë e mësues. Sipas tij, përdorimi i mjeteve kulturore dhe teknologjisë është i rëndësishëm për zhvillimin konjitiv. Në një mjedis natyror, fëmijët mund të mësojnë përmes përdorimit të mjeteve dhe teknikave që lidhen me natyrën dhe mjedisin.

Qëllimi i studimit është: efektiviteti i integrimit ndërlëndor në të nxënët e nxënësve dhe edukimin e tyre si qytetarë aktivë në mbrojtjen e mjedisit.

[9]"The Origins of Intelligence in Children" (1952);"The Construction of Reality in the Child" (1954);"The Child's Conception of the World" (1929.

[10] "Mind in Society: The Development of Higher Psychological Processes" (1978);"Thought and Language" (1962);"The Psychology of Art" (1925).

2. Motivet e studimit

✓ Një nga arsyet që na motivoi për të studiuar këtë temë është fakti se lumi Vjosa është kategorizuar si një nga lumenjtë më të egër në Evropë, i shpallur, tashmë, Park Kombëtar në 2023.

✓ Një tjetër motiv është se studimi i lumenjve duhet të jetë pjesë e kurrikulave shkollore dhe hapësirë edukative për nxënësit.

✓ Shtysë për këtë temë është fakti se Gjirokastra është një nga zonat që lumi i saj Drino derdhet në Vjosë dhe ai ka 150 specie të ndryshme: lloje peshqish, zvarranikësh, amfibësh, insektesh dhe gjitarësh që gjenden përgjatë kthesave të shumta të lumit.

✓ Lumi Vjosa ka rëndësi për bujqësinë, ujitjen, turizmin etj. Ky lumë është shumë i rëndësishëm dhe për njerëzit. Njerëzit e lidhin jetesën e tyre me këtë lumë sepse ai është burim jetese, ai është jetë. Njeriu e përdor atë për lundrim, sporte, por dhe ushqim.

3. Metodologjia e studimit

Studim do të sjellë në vëmendje se vëzhgimet në natyrë kanë efekte pozitive në njohuritë ndërlëndore dhe nxisin nxënësin të punojë në mënyrë shkencore dhe t'i bëjë ata qytetarë aktivë në shoqëri. Për të arritur objektin më parë testuam dallimet mes niveleve arsimore te nxënësit e Arsimit fillor dhe Arsimit 9- vjeçar. Sondazhi online u krye për të matur njohuritë rreth lumit Vjosa në të gjitha fushat. Pyetësori u shpërnda në mënyrë rastësore te një klasë e pestë e Arsimit fillor me 30 nxënës, si dhe te një klasë e 8-të me 30 nxënës të Arsimit 9-vjeçar të shkollës "Koto Hoxhi". Pyetjet kanë të bëjnë me të gjitha fushat si nga politikëbërësit, aktorët e interesuar, nga fusha e gjeografisë, diturisë, florën, faunën etj. Për ndërtimin e këtij pyetësori morën pjesë mësues në dy ciklet arsimore. Ky pyetësor u bazua edhe te një pyetësor spanjoll.[11] Pyetësori u validua në 6 nxënës dhe më pas u zhvillua pyetësori. Pyetësori kishte 9 pyetje të mbyllura me 5 opsione përgjigjeje. Pyetësori u shpërnda online, pyetjet kishin të bënin me ekosistemin si dhe me perceptimin e tyre për lumin Vjosa.

Vlerësimi i pyetësorit: Bazuar në përgjigjet e marra nga pyetësori rezultoi se nxënësit e Arsimit 9- vjeçar kishin koncepte më të qarta për lumin Vjosa, territorin që ai përshkruan, burimet nga të cilat furnizohet, florën dhe faunën e saj, llojet e specieve, rëndësinë që ka lumi për komunitetet lokale dhe zhvillimin e turizmit e sidomos të aktiviteteve që ushtrohen. Në përgjigjet e anketës u vu re se nxënësit nuk kishin informacion se kush ishte përgjegjës për menaxhimin e Parkut Kombëtar Vjosa, aktivitetet që janë të ndaluara të ushtrohen, si dhe faktorët që ndotin lumin Vjosa (Grafiku 1).

Grafiku 1.Përgjigjet e nxënësve të Arsimit 9-vjecar të shprehura në përqindje

Te nxënësit e Arsimit fillor u vu re një mungesë informacioni për ekologjinë e lumenjve. Kishte fëmijë që nuk kishin pasur asnjë kontakt me lumin Vjosa. Ata nuk e konceptonin lumin si Park Kombëtar sepse në përfytyrimet e tyre Park Kombëtar ata quanin një hapësirë të bollshme, me stola, dhe me larmi pemësh ku mund të luanin dhe pushonin për disa orë.



Grafiku 2. Përgjigjet e nxënësve të Arsimit fillor të shprehura në përqindje

Nga ky pyetësor ajo çka u konstatua është se mësuesit orët e mësimit kushtuar lumenjve duhet t'i konkretizojnë me vëzhgime në terren. Një orë mësimi, duke pasur në qendër të saj Parkun Kombëtar Vjosa, do të integrojë disa lëndë dhe do të bëjë që nxënësit të kuptojnë më mirë përmbajtjen lëndore, si dhe do të bëjë më interaktive mësimdhënien dhe të nxënët. Këto orë mësimi do të ndikojnë në edukimin mjedisor të nxënësve. Aktualisht, edukimi mjedisor i nxënësve të shkollës po bëhet prioritet në teorinë dhe praktikën pedagogjike. Për të shmangur ndotjen, duhet t'u mësojmë të rinjve që duhet të mobilizohemi të gjithë për të siguruar që lumenjtë të mbeten të pastër dhe të ruhen për brezat e ardhshëm, si një pasurie natyrore e çmuar, si vende të cilat do të vizitohen nga turistë vendas dhe të huaj, por dhe në mbështetje të njohurive të reja në shkencat natyrore.

4. Orë Mësimore Interaktive:

Tema: Ekskursion. Eksplorimi i luginës së Vjosës

Qëllimi: Njohja e veçorive të luginës së Vjosës dhe të mjedisit rreth saj.

Objektivi: Kombinimi i njohurive teorike me vëzhgimet në natyrëme qëllim formimin e perceptimeve të qarta dhe njohuri të qëndrueshme.

Lëndët: Gjuhë shqipe, Dituri natyre, Art pamor, Edukim për shoqërinë, TIK.

Fushat: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi, Teknologji dhe informacion.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:

✓ *Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:*

-Paraqet, të paktën, një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup.

-Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror me të cilin rrethohet.

✓ *Kompetenca e të menduarit:*

-Gjen veçoritë e një objekti, dukurie apo ngjarje të dhënë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet.

-Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi në kohëzgjatje nga 3 -5 minuta.

✓ *Kompetenca e të nxënit:*

-Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën, problemin, detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.

-Identifikon njohuritë që ka, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo veprimtari të caktuar dhe kërkon këshilla e informacion për kapërcimin e vështirësive.

✓ *Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:*

-Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, vizatim, shenja apo simbole, për dy- tri aktivitete ditore, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrës.

-Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë veprimi për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

✓ *Kompetenca personale:*

-Përkujdeset për një mjedis të shëndetshëm gjatë realizimit të një aktiviteti, duke krijuar kushte të përshtatshme pune (ajrosje, ndriçim, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë) .

✓ *Kompetenca qytetare:*

-Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke e dëgjuar në mënyrë aktive.

-Bashkëpunon me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

✓ *Kompetenca digjitale:*

-Realizon punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

- Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre;
- Identifikon një problem ose përcakton një grup problemash;
- Përdor strategji të ndryshme eksplorimi;
- Vlerëson qasjen e vet dhe të të tjerëve;

Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore:

- Familjarizohet me rolet dhe funksionet e mjeteve, teknikave, instrumenteve dhe procedurave shkencore e teknologjike.
- Përdor mjete, objekte dhe procedura të ndryshme në përputhje me situatat dhe mënyrat e përdorimit të tyre në to.
- Vlerëson ndikimin e mjeteve, instrumenteve dhe procedurave.

Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës:

- Familjarizohet me gjuhën e jetës së përditshme që lidhet me shkencën dhe teknologjinë.
- Përdor gjuhën e simboleve dhe të jetës së përditshme për shkencën dhe teknologjinë.
- Përdor efektivisht gjuhën e simboleve dhe të jetës së përditshme për të formuluar pyetje dhe për të argumentuar përgjigjet.

Rezultatet e të nxënit:

- Përshkruan veçoritë e luginës, duke u nisur nga njohuritë që ka.
- Demonstron të vëzhguar të kujdesshëm gjatë eksplorimit që kryen.
- Përcakton veçoritë dalluese të kësaj lugine përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë, si: bimësinë, botën shtazore dhe klimën.
- Identifikon tri elemente të rëndësishme që ka kjo luginë, duke e bërë atë të veçantë.
- Krijon një poster për ruajtjen e vlerave të mjedisit dhe mbrojtjen e tij.

Mjetet mësimore: aparat fotografik, tabletë, laptop, fleta të bardha dhe me ngjyra,lapsa me ngjyra, ngjitës etj.

Burimet: materiale nga interneti, foto.

Pjesëmarrësit: nxënësit e klasës së pestë, mësuesja, mësuese ndihmëse, prindër

Për të zhvilluar ekskursionin janë marrë lejet e prindërve për lejimin e lëvizjes së fëmijëve dhe leje nga drejtoria e shkollës sipas udhëzimeve. Prindërit kanë marrë përsipër shpenzimet e lëvizjes së fëmijëve.

Vendi: klasë, Uji i Ftohtë, Tepelenë.

Orët: 10 orë

Metodologjitë

Dita e parë: Diskutim për njohuritë paraprake. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje.

Dita e dytë: Hulumto, vëzhgo në natyrë.

Dita e tretë: Hartim posteri. Punë në grup.

Veprimtaritë që do të kryhen:

Dita e parë: (temat e diskutimit)

- ❖ Diskutim për njohuritë paraprake. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje.
- ❖ Krijimi i Parkut Kombëtar të lumit të egër Vjosa
- ❖ Përshkrimi i përgjithshëm dhe seksionet e zonës

Gjatë shikimit të materialit dhe leximit të tij, sqaroj të gjitha pyetjet që do të kenë nxënësit. Në përfundim u drejtoj edhe unë disa pyetje:

A mendojnë ata se kjo luginë duhet të mbrohet?

Cilët janë faktorët që e dëmtojnë atë?

Pse duhet të gjithë së bashku të punojmë për ta ruajtur siç ajo është?

Dita e dytë: Hulumto, vëzhgo në natyrë.

Të gjithë së bashku do të nisemi drejt pikës që kemi caktuar për të vëzhguar, në luginën e Vjosës, në zonën e Ujit të Ftohtë. Është marrë mendimi i specialistëve që nuk ka rrezikshmëri për nxënësit.

Udhëzohen nxënësit që gjatë lëvizjes nëpër luginë të vëzhgojnë me kujdes kushtet natyrore, bimësinë dhe gjallesat që vërejnë. Të bëjnë foto dhe të mbajnë shënime për çdo gjë që vëzhgojnë.

Të vëzhgojnë lumin e Vjosës më të gjitha bukuritë dhe veçantitë e tij.

- Si rrjedh lumi?
- Cilat janë gjallesat në të?
- Çfarë ka në mjedisn rrethues?
- Si ndërthuren kodrat, fushat dhe lumi me njëri-tjetrin?

Të bëjnë pyetje për çdo të paqartë që mund të kenë dhe për çdo gjë që vëzhgojnë.

Dita e tretë: Hartim posteri. Punë në grup.

Në klasë nxënësit sipas grupeve që janë ndarë do të hartojnë një poster për mjedisin që vëzhguan në luginën e Vjosës.

Secili grup do të paraqesë para klasës posterin e tij me tematikë:

Së bashku për një mjedis të shëndetshëm

Produkti përfundimtar:

Nxënësit në përfundim të veprimtarive të kenë arritur rezultatet e të nxënit të përcaktuara.

- ✓ Të jenë më të ndërgjegjësuar për vlerat e luginës së Vjosës.
- ✓ Të ruajnë mjedisin natyror në vendin ku jetojnë, si një trashëgimi që ka vlera të rëndësishme për shëndetin e tyre.

5. Përfundime

Studimi tregoi se nxënësit e arsimit 9 -vjeçar kishin një vizion të përgjithshëm të lumit Vjosa,

krahasuar me nxënësit e Arsimit fillor, të cilët kishin mungesë informacioni. Kampioni, ynë edhe pse ishte i vogël në numër, na dha një informacion të qartë rreth njohurive të nxënësve në lidhje me ekosistemin e lumit Vjosa. Bazuar në informacionin që ne kemi, ky është studimi i parë që evidenton njohuritë e nxënësve në lidhje me ekosistemin e lumit Vjosa. Rezultatet e nxjerra nga anketimi tregojnë se në kurrikulat tona nuk janë përfshirë shumë njohuri për lumenjtë, por konceptet e përfshira janë ende sipërfaqësore dhe nuk janë përditësuar sipas njohurive aktuale shkencore dhe legjislacionit mjedisor[12]. Për më tepër, kërkimet e mëparshme[13], kanë theksuar se tekstet shkollore ende i përshkruajnë lumenjtë dhe menaxhimin e tyre nga një perspektivë hidroteknike dhe jo si ekosisteme.

Orët e mësimit të integruara dhe të kombinuara dhe me vëzhgime në terren sjellin më shumë përfitime në të nxënët e nxënësve duke përfshirë ata me nevoja të veçanta.

6. Rekomandime

1. Kurrikula duhet të përfshijë në lëmdët mësimore më tepër ekskursione me bazë vëzhgimin.
2. Paisjen e shkollave me kompjutera me qëllim që mësuesit të përdorin më tepër TIK-un në mësimdhënie e -nxënie për të konkretizuar çdo element përbërës të lumit Vjosa.
3. Të trajnohen mësuesit me module me temë "Përmirësimi i cilësisë së procesit të mësimdhënie - nxënies me fokus zbatimin e njohurive mjedisore në situata të jetës reale".
4. Nevojitet trajnimi i duhur për mësuesit e ardhshëm, siç janë studentët e universitetit të diplomës "Bachelor në Arsimin fillor", me në fokus mjedisin në mënyrë që ata të mund të edukohen për qëndrueshmëri.
5. Të përgatiten nga ekspertë të fushës module që paraqesin hapat e një ore ekskursioni ndërlëndor.
6. Ashtu siç e ka thënë dhe Piaget fëmijët me aftësi ndryshe zhvillojnë individualitetin e tyre përmes ndërveprimit me mjedisin fizik.

7. Literatura

Contreras, K.; Contreras, J.; Corti, M.; De Sousa, J.; Durán, M.; Escalante, M. El Agua Un Recurso Para Preservar; Universidad de Los Ángeles: Mérida, Venezuela, 2008.

Zsóka, Á.; Szerényi, Z.M.; Széchy, A.; Kocsis, T. Greening Due to Environmental Education? Environmental Knowledge, Attitudes, Consumer Behavior and Everyday pro-Environmental Activities of Hungarian High School and University Students. J. Clean. Prod. 2013, 48, 126–138.

UNICEF. Educación Sobre El Cambio Climático y El Medio Ambiente; UNICEF: New York, NY, USA, 2012.

Damerell, P.; Howe, C.; Milner-Gulland, E.J. Child-Orientated Environmental Education Influences Adult Knowledge and Household Behaviour. Environ. Res. Lett. 2013, 8, 015016.

Kinder, T.; Mesner, N.O.; Larese, M.; Lott, K.H.; Cachelin, A.; LaLonde, K. Changes in knowledge and attitude from a short-term aquatic education program. Nat. Sci. Educ. 2015, 44, 18–25.

Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Tiranë, 2014.

Menn, A. SSWM (Sustainable Sanittation and Water Management Toolbox). School Campaigns. Available online: (accessed on 20 January 2019).

[12]Cuello, A.; García, F. ¿Ayudan los libros de texto a comprender la realidad fluvial de la ciudad? *Rev. Humanid.* **2019**, *37*, 209–234.

[13]Po aty.

Parku Kombëtar i lumit të egër Vjosa, Vizioni, Udhërrëfyesi dhe Studimi i Fizibilitetit Dhjetor 2022, bazuar në standardet e IUCN-së për zonat e mbrojtura.

https://www.cna.al/kulturë/krijohet-parku-i-parë-kombëtar-i-një-lumi-të-egër-ne-evropë-kumbaro-vjos-i354189

Parku Kombëtar i lumit të egër Vjosa, Vizioni, Udhërrëfyesi dhe Studimi i Fizibilitetit, Dhjetor 2022, bazuar në standardet e IUCN-së për zonat e mbrojtura, faqe 8.

https://www.cna.al/kulture/krijohet-parku-i-pare-kombetar-i-nje-lumi-te-eger-ne-evrope-kumbaro-vjos-i354189

Val Segura, R.; Quiroz Vara, L. Cultura Del Agua; Primera, IMTA: Morelos, México, 2016.

Priest S.(1986).Redefining outdoor education: A matter of many relationships. The Journal of Environmental Education, 17, 13– 15.

Smith J. W. (1955). The outdoor education project. Journal of Health, Physical Education (Recreation), 26, 17.

(Edukimi i Kombeve të Bashkuara , Organizata Shkencore dhe Kulturore, 1978, fq. 26, 27).

Tiplady L. S. E., Menter H. (2020). Forest School for wellbeing: An environment in which young people can 'take what they need'. Journal of Adventure Education and Outdoor Learning, 21, 99–114.

Szczytko R., Carrier S. J., Stevenson K. T. (2018). Impacts of outdoor environmental education on teacher reparts of attention, behavior, and learning outcomes for students with emotional, cognitive, and behavioral disabilities. Frontiers in Education, 3, 46.

O'Brien L., Murray R. (2007). Forest school and its impact on young children: Case studies in Britain. Urban Forestry & Urban Greening, 6, 249–265.

Ernst J., Theimer S. (2011). Evaluating the effects of environmental education programmeming on connectedness to nature. Environmental Education Research, 17, 577–598.

Drissner D., Haase H. M., Hille K. (2010). Short-term environmental education—Does it work? An evaluation of the "green classroom." Journal of Biological Education, 44, 149–155.

Schultz P. W., Tabanico J. J. (2007). Self, identity, and the natural environment: Exploring implicit connections with nature. Journal of Applied Social Psychology, 37(6), 1219–1247. ISI.

Mygind E. (2016). Physical activity during learning inside and outside the classroom. Health Behavior and Policy Review, 3(5), 455–467.

Bogner F. (1998). The influence of short-term outdoor ecology education on long-term variables of environmental perspective. The Journal of Environmental Education, 29(4), 17–29.

Kosta A. D., Tsagarakis K. P. (2019). Introducing the concept of organic product to the primary school curriculum. Sustainability, 11, 3559.

Kossack A., Bogner F. X. (2012). How does a one-day environmental education programme support individual connectedness with nature? Journal of Biological Education, 46(3), 180–187.

Cuello, A.; García, F. Ayudan los libros de texto a comprender la realidad fluvial de la ciudad? Rev. Humanid. 2019, 37, 209–234.

Cuello, A.; García, F. Ayudan los libros de texto a comprender la realidad fluvial de la ciudad? Rev. Humanid. 2019, 37, 209–234.

Mouratiadou, I.; Moran, D. Mapping public participation in the water framework directive: A case study of the pinios river basin, greece. Ecol. Econ. 2007, 62, 66–76.

Jager, N.W.; Challies, E.; Kochskämper, E.; Newig, J.; Benson, D.; Blackstock, K.; Collins, K.; Ernst, A.; Evers, M.; Feichtinger, J.; et al. Transforming european water governance? Participation and river basin management under the EU Water Framework Directive in 13 member states. Water 2016, 8.

Robelia, B.; Murphy, T. What do people know about key environmental issues? A review of environmental knowledge surveys. Environ. Educ. Res. 2012, 18, 299–321.

Jean Piaget: "The Origins of Intelligence in Children" (1952);"The Construction of Reality in the Child" (1954);"The Child's Conception of the World" (1929).

Lev Vygotsky:"Mind in Society: The Development of Higher Psychological Processes" (1978);"Thought and Language" (1962);"The Psychology of Art" (1925).

Literaturë nga internet

04.-Raporti-i-Studimit-të-Fisibilitetit_shqip.pdf

https://sswm.info/humanitarian-crises/urban-settings/hygiene-promotion-community-mobilisation/important/school-campaigns-%28dc%29

https://www.southeastriverstrust.org/seven-reasons-to-put-the-local-river-on-your-schools-curriculum/

GJITHËPËRFSHIRJA E NXËNËSVE NË NDËRTIMIN E NJOHURIVE MJEDISORE PRANË PARKUT KOMBËTAR

[1]MSc. Aida Sotiri, [2]Dr. Loreta Mamani, [3]Prof.asoc. Mimoza Çarka, [4]MSc. Anila Cacaj
[1,2,3]Department of Education and Teaching Methodology, Faculty of Education and Social Sciences, "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, Shqipëri,
asotiri@uogj.edu.al , lmamani@uogj.edu.al , mcarka@uogj.edu.al
[4]Teacher, Local Educational Office Gjirokastër-Libohovë,, anila_cacaj@yahoo.com

Përmbledhje

Ky studim hulumton rolin dhe praktikat e mësueseve të Arsimit fillor në ndërtimin e njohurive mjedisore për nxënësit pranë Parkut Kombëtar Vjosa, duke përdorur lojëra edukative dhe aktivitete të tjera, me fokus, përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta. Qëllimi kryesor është të identifikohen strategjitë dhe praktikat më efektive për të siguruar një mësim mjedisor të përshtatshëm për të gjithë nxënësit, duke përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta.Përmes një hulumtimi kualitativ dhe sasior, ky studim analizon praktikat dhe përvojat e mësueseve të një klase në institucionin arsimor 9-vjecar "Naim Frashëri" në përdorimin e lojërave edukative dhe aktiviteteve të tjera në ambientin e Parkut Kombëtar Vjosa për të zhvilluar njohuritë mjedisore të nxënësve. Intervistat individuale me mësues për të kuptuar praktikat dhe perceptimin e tyre në gjithëpërfshirjen, grupdiskutimet për të analizuar sfidat në përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta, vëzhgimet për të vlerësuar ndikimin e tyre në përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta, përdorimi i anketave apo pyetësorëve për të marrë "feedback" nga nxënësit në lidhje me përvojën e tyre në mësimin e njohurive mjedisore nëpërmjet lojërave edukative dhe aktiviteteve të tjera, do të sigurojë një kuptim të plotë të praktikave dhe përvojave të mësuesve dhe nxënësve.

***Fjalët kyçe**: Njohuri mjedisore, nxënës me nevoja të veçanta, strategji pune, praktika mësimore, Parku Kombëtar Vjosa.*

Abstract

This study investigates the role and practices of primary education teachers in building environmental knowledge for students near the Vjosa National Park, using educational games and other activities, with a focus on the inclusion of students with special needs.The main goal is to identify the most effective strategies and practices to ensure an appropriate learning environment for all students, including those with special needs. Through qualitative and quantitative research, this study analyzes the practices and experiences of the teachers of a class in "Naim Frashëri" primary school when using educational games and other activities in the environment of the Vjosa National Park to develop the students' environmental knowledge. Individual interviews with teachers to understand their practices and perceptions in inclusion, group discussions to analyze challenges in the inclusion of students with special needs, observations to assess their impact on the inclusion of students with special needs, use of surveys or questionnaires to get feedback from students about their experience in learning environmental knowledge through educational games and other activities will provide a thorough understanding of the practices and experiences of teachers and students.

***Keywords**: Environmental knowledge, students with special needs, work strategies, teaching practices, Vjosa National Park.*

Një komponent i rëndësishëm për formimin e nxënësve si qytetarë të vetëdijshëm dhe të përgjegjshëm ndaj mjedisit, është edukimi mjedisor. Periudha kur fëmijët ndjekin ende klasat e arsimit fillor, është koha e duhur, momenti ku formohen qëndrimet e tyre ndaj mjedisit dhe

natyrës. Edukimi mjedisor ofron për nxënësit njohuri, aftësi dhe qëndrime që i ndihmojnë nxënësit të jenë të përgjegjshëm në marrëdhënie me mjedisin. Parku Kombëtar i Vjosës i jep mundësi nxënësve të përfshihen në aktivitete mjedisore, të mësojnë drejtpërdrejt nga natyra dhe të kuptojnë vlerën për ruajtjen e Parkut. Ata marrin njohuri të drejtpërdrejta për ekosistemet, fenomenet natyrore, biodiversitetin, egërsinë e lumit Vjosë, fitojnë aftësi praktike për vëzhgim, analizim dhe zgjidhje të problemeve mjedisore. Nxënësit përfshihen në metodat eksperimentale të mësimdhënies, si mbledhja e mostrave të ndryshme, vëzhgimi i specieve, vëzhgimi i rrjedhjes së lumit, bimësisë. Eksukrsionet dhe vizitat edukative në këtë park kombëtar i rritin vlerën dhe zgjojnë interesin e nxënësve kur ato shoqërohen nga ekspertë, kur aktivitetet strukturohen dhe janë gjithëpërfshirëse. Projektet e vogla që përfshijnë hulumtime, nxitin aftësitë e të menduarit kritik duke pasur në bazë bashkëpunimin mes nxënësve dhe interaktivitetitn për të mësuar koncepte mjedisore. Këto aktivitete ndihmojnë në integrimin e kurrikulës, mësimet e bilogjisë (vëzhgimi i bimësisë dhe kafshëve), matematikës (statistika rreth biodiversitetit), gjuhës (ese..diskutime për mjedisin).

Duke prekur dhe ndier këto bukuri të natyrës së Vjosës, nxënësit *zhvillojnë njohuritë dhe përgjegjësinë për mbrojtjen e tij, njohin organizatat mjedisore, të cilat i mbështetin për të organizuar aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor*. Mësuesit dhe organizatorët veç strukturimit të aktiviteteve dhe burimeve të nevojshme për realizimin e tyre, krijojnë mundësi për nxënësit me nevoja të veçanta për marrjen pjesë të tyre dhe përfitimin nga këto aktivitete mjedisore. Puna me fëmijë me nevoja të veçanta nëpërmjet lojërave në natyrë është një mundësi e shkëlqyer për të promovuar zhvillimin e tyre të përgjithshëm, duke integruar aventurën, mësimin dhe argëtimin në një ambient të hapur dhe frymëzues.

Fëmijët duan të luajnë jashtë, dhe fëmijët me nevoja të veçanta nuk janë të ndryshëm. Loja është aq e rëndësishme për zhvillimin e tyre. Dalja jashtë përmirëson shikimin, ndërton aftësi sociale, ul stresin, rrit shtrirjen e vëmendjes dhe rrit nivelet e vitaminës D. Të gjitha këto janë thelbësore për një zhvillim të fortë,të qëndrueshëm, të shëndetshëm. Edhe vetëm sjellja e lodrave të tyre të preferuara jashtë për të luajtur mund të rritë zhvillimin e tyre. Kur nxënësit janë jashtë, është thelbësore që të mbikëqyren siç duhen aktivitetet. Të luash me këta nxënës, është një mënyrë e mrekullueshme për t'u lidhur dhe të jep ide për përparimin që po bëjnë ata me aftësi të caktuara. Fëmijët e të gjitha moshave dhe aftësive mund të aktivizohen jashtë. Ushtrimet dhe aktivitetet në natyrë janë veçanërisht të rëndësishme për fëmijët me nevoja të veçanta. Përqendrimi duhet të jetë jo vetëm në paaftësinë e fëmijës, por në aftësitë e tij. Ata mund t'i angazhoni në aktivitete që gëzojnë, të cilat do t'i ndihmojnë ata të dëbojnë pak energji, si dhe të zhvillohen dhe rriten.

Shëndeti holistik përmirësohet kur fëmijët kalojnë kohë duke luajtur jashtë (dankië et al., 2020; Gill, 2015; McQuay et al., 2020; McCormick, 2017). Fëmijët me nevoja të veçanta, demonstrojnë lidhje me aktivitetet shqisore në natyrë, pasi mjedisi natyror ofron më shumë mundësi sesa një mjedis më steril (dmth. spital) ose klinik (Figueroa, 2020). Mjediset natyrore përmirësojnë interesin, motivimin dhe pjesëmarrjen në aftësitë e vështira që fëmijët po përpiqen të ndërtojnë; duke promovuar kështu fëmijët dhe familjet e tyre të përjetojnë përfitimet e natyrës ndërsa përmbushin qëllimet zhvillimore.

UNICEF-i thotë se loja është e drejta themelore për çdo fëmijë dhe kjo nuk është ndryshe për një fëmijë me nevoja të veçanta. Përmes lojës fëmija e kupton botën përrreth tij, mëson zgjidhjen e problemeve, ndërton vetëvlerësim dhe përmirëson aftësitë motorike dhe shoqërore. Për të mos përmendur argëtimin e pastër të lojës. Për një fëmijë me nevoja të veçanta, standardet rigoroze dhe natyra konkurruese e lojërave tradicionale mund të jenë dërrmuese.

Midis sigurimit që ata të marrin një arsim të përshtatshëm, shkuarjes në takime mjekësore dhe sfidave, mund të jetë e vështirë të imagjinohet që nxënësit me aftësi të veçanta të marrin pjesë në aktivitete pas shkollës. Realiteti, megjithatë, është se programet e duhura pas shkollës mund të jenë mundësi që këta nxënës të tregojnë pikat e forta, për të ndërtuar besim, për të bërë miq dhe për të zbuluar interesa të reja.

Orët e gjuhës, matematikës kur kryhen në klasa, terapitë ose vizitat e shpeshta mjekësore, u zënë ditën nxënësve me nevoja të veçanta. Prindërit fokusohen tek investimi për zhvillimin e tyre akademik dhe i japin pak kohë ose ju duket kohë e shpenzuar keq që të zënë kohën e fëmijëve të tyre në lojërat në natyrë. Shpesh, prindërit bien pre e frikës se fëmijët e tyre në mjediset jashtë mund të ndeshen me eksperienca negative, të kenë dëmtime fizike, të bullizohen. Ata harrojnë se me këtë mënyrë të menduari iu privojnë jo vetëm të jetojnë fëmijërinë në natyrë plot argëtim, por edhe mundësinë për të njohur miq të rinj, për t'u lidhur me fëmijë që janë shumë më ndryshe nga ata, të shkëlqejnë në aktivitete sociale, të rritin aftësitë e tyre fizike duke vrapuar, të bëhen pjesë e një ekipi, të provojnë gjëra të reja, të mësojë përvoja jete, të marrin pjesë dhe të mësojnë lojëra me rregulla. Pikërisht këto janë aftësi të cilat do t'u duhen gjatë gjithë jetës.

Fëmijët e sotëm dhe familjet e tyre kanë më pak mundësi për t'u lidhur me mjedisin tonë natyror. Gjatë viteve të fundit, disa botime dhe studime kërkimore kanë dokumentuar përfitimet e lidhjes me natyrën. Për shembull, përmirësimi i zhvillimit njohës, shëndeti më i mirë mendor dhe zhvillimi i zakoneve të shëndetshme janë vetëm disa rezultate të lidhjes me natyrën. Ka hulumtime të mjaftueshme mbi përfitimet e aktiviteteve në natyrë për fëmijët me nevoja të veçanta. Ata mund të mësojnë të zgjidhin problemet dhe të mendojnë në mënyrë kritike kur kalojnë kohë jashtë duke eksploruar koncepte shkencore me kuriozitet, imagjinatë dhe çudi. Fëmijët që luajnë jashtë zhvillojnë vetëdije më të mirë të veçantë dhe mund të lidhen lehtësisht me natyrën.

Angazhimi i tyre me materiale natyrore në keto mjedise frymëzon dhe angazhon fëmijët, gjë që i motivon ata të lidhen me natyrën. Sipas botimeve kërkimore, të mësuarit jashtë mund të përmirësojë përqendrimin e përgjithshëm, vëmendjen e qëndrueshme dhe emocionet e mirëqenies.

A. Pengesat dhe vështirësitë e punës me nxënësit me nevoja të veçanta në aktivitetet në natyrë

Vështirësitë e punës me nxënës me nevoja të veçanta në edukimin mjedisor sipas teorive të ndryshme zhvillimore

Duke iu referuar teorisë së zhvillimit kognitiv (Piaget), teorisë socialkulturore (Vygotsky), teoria e mësimit bazuar në eksperiencë (David Kolb):

- Vështirësitë në pjesëmarrjen aktive dhe eksploruese.
- Vështirësitë për të përdorur materiale të përshtatura.
- Ndihma nga mësuesit dhe nxënësit e tjerë mund të jetë sfiduese, sepse ka më pak strukturë dhe më shumë diversitet në aktivitetet e ofruara.
- Nxënësit me nevoja të veçanta kanë vështirësi në reflektimin dhe përpunimin e përvojave të tyre, në mënyrë që të përfitojnë plotësisht nga eksperimentet.
- Vështirësia e përshtatjes së aktiviteteve.
- Terren i papërshtatshëm.
- Nxënësit me sfida në komunikim e kanë të vështirë të marrin udhëzime.
- Është shumë e vështirë të ndryshosh sjelljet rutinore të një fëmije me probleme të spektrit të autizmit.
- Përballja me sfida që kërkojnë strategji specifike në menaxhimin nga mësuesi.

Personalizimi i aktiviteteve: Përputhja e aktiviteteve me interesat dhe nevojat e secilit fëmijë është tejet e rëndësishme për të siguruar një qasje të individualizuar dhe ndihmon në lehtësimin e kryerjes së aktivitetit nga ana e fëmijës. Por në një aktivitet jashtëshkollor numri i fëmijëve është shumë i madh dhe njëlloj të mëdha janë dhe diferencat mes tyre në aftësi, dëshira, aktivizim etj. Kjo vështirëson punën e organizuesve dhe mbikqyrësve të këtyre aktiviteteve sidomos në përzgjedhjen e mënyrës së ideimit dhe përzgjedhjes së tyre dhe gjithashtu gjatë zhvillimit.

Probleme lidhur me menaxhimin e situatave të vështira: Gjatë aktiviteteve jashtëshkollore në natyrë mund të ndodhë shumëçka për të gjithë fëmijët, por, veçanërisht, për fëmijët me nevoja të veçanta kujdesi duhet të jetë i shtuar. Problemet mund të jenë të tipologjive të ndryshme, që nga ndonjë dëmtim fizik i mundshëm që kërkon marrjen e masave për ta parandaluar atë dhe, në rast se ndodh, kërkon marrjen e masave të menjëherëshme për menaxhimin e duhur të situatës. Kjo kërkon vëmendjen e mësuesve dhe mësuesve ndihmës në mënyrë që kujdesi të jetë i shtuar lidhur me mirëqenien e fëmijëve, por njëkohësisht duke i lejuar ata të bashkëveprojnë me moshatarët e tyre dhe të realizojnë qëllimin final të këtyre lloj aktivitetesh, të mësojnë dhe të kënaqen.

Situata të vështira mund të shfaqen edhe mes fëmijëve, aty ku dikush mund të bëjë një koment të pakëndshëm lidhur me pamjen apo aftësitë e një fëmije tjetër që, sipas botëkuptimit të tij, po i "pengon" lojën. Në raste të situatave të tilla është e rëndësishme që mësuesit, si mbikëqyrës të aktivitetit t'u shpegojnë fëmijëve atë që duhet të dinë. Kjo kërkon një aftësim të duhur të mësuesit për të përzgjedhur fjalët e duhura për të dy fëmijët e përfshirë dhe për gjithë të tjerët. Fëmijët kanë nevojë t'u shpegohen gjërat dhe jo të kalohen situatat me idenë e gabuar se ata nuk kuptojnë. Janë vitet e para të jetës ato që formësojnë karakterin dhe ndikojnë në individët që ata do të jenë në të ardhmen. Bashkëveprimi me njeri- tjetrin në situata të tilla është një prej mënyrave më të mira për të mësuar ata të përqafojnë diversitetin që ekziston në botë dhe të bashkëjetojnë me të.

Përdorimi i të gjitha shqisave: Përdorimi i mjeteve dhe materialeve të ndryshme për të nxitur ndjeshmërinë sensoriale dhe për të përfshirë një gamë të gjerë përvojash në natyrë, si ngjyrat, teksturat, dhe tingujt është domosdoshmëri për t'u arritur të realizohet gjithëpërfshirja e të gjithë fëmijëve, pavarësisht aftësive të tyre, në aktivitete jashtëshkollore. Mirëpo këto mjete kanë kosto për t'u siguruar dhe mirëmbajtur. Gjithashtu, shpesh, për të ndihmuar përdorimin e këtyre mjeteve fëmijëve me nevoja të veçanta u duhet asistenca e dikujt tjetër (kryesisht mësuesit ndihmës). Kostoja shtesë lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sigurimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe pagat e mësuesve ndihmës përbën vështirësi ekonomike sidomos në vendet ku buxheti për arsimin nuk është nga më të lartët, për më tepër pastaj shpërndarja e tij nga instancat më të vogla.

Përkrahja e bashkëpunimit dhe ndërgjegjësimit të grupit: Inkurajimi i bashkëpunimit ndihmon fëmijët të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të përqafojnë ndryshimet mes tyre. Lojërat në natyrë dhe aktivitetet jashtëshkollore të përbashkëta ofrojnë mundësi për zhvillimin e aftësive sociale dhe për ndërtimin e lidhjeve të forta me të tjerët dhe zhvillimin e empatisë. Rol i madh këtu i takon mësuesve, të cilët duhet të mbikëqyrin mbarëvajtjen e aktiviteteve, të sigurojnë sigurinë e fëmijëve dhe, gjithashtu, të mbjellin në botëkuptimet e tyre tolerancën, bashkëpunimin, pranimin e diversiteteve dhe frymën e komunitetit. Duhet të ekzistojë përpjekja për të njohur dhe përmirësuar aftësitë e secilit fëmijë. Inkurajimi i progresit dhe arritjeve të tyre mundëson që ata të ndihen të vlerësuar për kontributin e tyre.

Të qenit realist: Fakti që fëmija mund të godasë një top nuk do të thotë se ai është domosdoshmërisht gati për të luajtur në një ekip futbolli. Megjithatë, ai mund të jetë gati për diçka më pak sfiduese. Duhet menduar me kujdes se çfarë mund të bëjë vërtet fëmija. Në këtë kuadër duhet të ketë kujdës nëpërzgjedhjen e aktiviteteve, të cilat duhet të përzgjidhjen duke pasur parasysh plotësimin e kritereve që lidhen me gjithëpërfshirjen, mundësinë reale të fëmijëve për ta realizuar aktivitetin, mundësinë e mësimit të diçkaje në përfundim të aktivitetit, zhvillimin e aftësive sociale.

Përzgjedhja e një aktiviteti për të cilin fëmija është i interesuar: Fëmijët me nevoja të veçanta shpesh në përditshmërinë e tyre mund të përballen me procedura jo dhe aq të këndshme terapie, pritshmëri të larta lidhur me shkolla, ngacmime në shkollë etj. Ndaj aktivitetet në natyrë duhet të jenë të këndshme për ta. Për të realizuar këtë duhet të përzgjidhen programe me rregulla të thjeshta dhe me pak konkurrencë duke shmangur në parim, për shembull, sportet sfiduese në ekip që kërkojnë nivele optimale të aftësive fizike, sociale, motorike dhe njohëse.

Ndaj në përzgjedhjen e aktiviteteve ku ata do të marrin pjesë, duhet mbajtur parasysh përzgjedhja e një aktiviteti që ai mund të realizojë dhe, gjithashtu, t'i sjellë kënaqësi realizimii tij, duke u shndërruar në këtë mënyrë në një aktivitet të këndshëm ku shkarkohen edhe emocionet negative.

Ndihma e fëmijës për aq kohë sa atij i duhet: Në shumë raste, fëmijët me nevoja të veçanta kanë nevojë për ndihmë kur fillojnë të bëjnë diçka. Prania e një mësuesi ndihmës mbështet fëmijën duke mundësuar që ai ta kuptojë dhe realizojë më lehtë aktivitetin dhe gjithashtu mësuesi ndihmës siguron mirëqenien psiko-fizike të fëmijës duke ndërhyrë nëse lind një problem. Kjo do të reduktojë ankthin e përshtatjes, realizimin e punës dhe lejon fëmijën të bashkëveprojë në grup njësoj si fëmijët e tjerë.

Përfshirja e fëmijëve në vendim, por duke qenë realist: Përfshirja e fëmijëve në vendimin se cilin lloj aktiviteti do të kryejë, është aspekt pozitiv, lidhur me faktin se si do ta ndiejnë veten e tyre, në lidhje me rëndësinë e mendimit dhe të marrjes së vendimeve për vete. Megjithatë gjithnjë këtu duhet pasur parasysh ndarja e dëshirës me mundësitë reale të vetë fëmijës, zgjidhja optimale është të zgjidhet një aktivitet brenda dëshirës së fëmijës, por që realizohet në formën që fëmija mund ta kryejë.

Bashkëpunimi prind-mësues: Për mirëqenien sa më të lartë të fëmijës në aspektin fizik, motorik, konjuktiv, psikologjik, emocional dhe psiko-social, binomi i bashkëpunimit prind - mësues duhet të jetë i pandashëm, njësoj si gjatë zhvillimit të mësimit në klasë. Prindi është ai që njeh fëmijën e vet më së miri, ndërkohë mësuesi ka aftësitë profesionale për të ndihmuar në përparimin e zhvillimit të aftësive të fëmijës me nevoja të veçanta. Njësoj dhe në rastin e pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitete jashtëshkollore, bashkëpunimi duhet të jetë i vazhdueshëm nisur që nga përzgjedhja e aktivitetit, njoftimi për kohën dhe vendin ku do të zhvillohet, mjetet që duhet të sigurohen për realizimin e tij, mbarëvajtjen gjatë realizimit dhe, së fundmi, realizimin e një analize objektive për atë çka sjellë të mirë për fëmijën.

1. Metodat dhe qasjet për mësimdhënie të suksesshme në këtë fushë

David Sobel ekspert në fushën e edukimit mjedisor, njhet për teoritë dhe praktikat inovative që lidhen me bashkimin e fëmijës me natyrën. Studimet e tij kanë ndihmuar në mënyrën sesi nxënësit mësojnë dhë zhvillojnë lidhje me natyrën nëpërmjet përvojave të drejtperdrejta, eksplorimit, dhe lojërave në natyrë. David Sobel trajtoi konceptin e "Mësimit bazuar në vendlindje". Ai thekson rëndësinë e edukimit i cili rrënjoset në komunitetin lokal dhe mjedisit rrethues. Femijët mësojnë më mirë, thotë Sobel, kur kanë mundësi të eksplorojnë dhe angazhohen në mjedisin e tyre natyror dhe kulturor. Ai beson se praktika dhe eksperimentet janë thelbësore për edukim mjedisor, sepse fëmijët mësojnë vetëm duke bërë. Në "Seven Design Projects for Children", prezantohen 7 projekte dizajni të cilat shërbejnë për të ndërtuar një lidhje të veçantë mes fëmijës dhe natyrës, mes lojërave dhe aktiviteteve krijuese. Ai kritikon prirjen e shoqërisë sot që, prej frikës, mbajnë fëmijët larg natyrës, argumenton se pranë natyrës fëmijët zhvillojnë shumë aftësi jete dhe ndjeshmëri ndaj mjedisit. Libri " Childhood and Nature: Design Principles for Educators" prezanton teoritë për edukimin mjedisor dhe ofron udhëzime për mësuesit. Ai ndihmon mësuesit se si të qasen ndaj mësimdhënies përmes përvojave natyrore, duke promovuar lidhje të fuqishme të natyrës me fëmijën. Më poshtë po paraqesim shtatë projekte dizajni, sipas Sobel:

1. Krijimi i kopshteve të vogla në natyrë.
2. Ndërtimi i hapësirave ku fëmijët mund të eksplorojnë dhe të luajnë në natyrë.
3. Ndërtimi i shtëpive për kafshë.
4. Krijimi i stacioneve të motit për të monitoruar kushtet atmosferike.
5. Projekte për restaurimin e ekosistemeve lokale.
6. Përdorimi i materialeve natyrore për të krijuar art.
7. Mbajtja e ditarëve të natyrës për të dokumentuar përvojat dhe vëzhgimet.

Ndërsa libri “Place-Based Education; Connecting Classrooms and Communities” i Sobel ofron strategji për të integruar projektet e bazuara në vend në kurrikulën e shkollës.

1. Qasje të bazuara në vendlindje(bashkëpunimi me ekspertë për të ofruar përvoja edukative)
2. Shërbimi komunitar (inkurajimi që të marrin pjesë në projekte në ndihmë të komunitetit)
3. Studimi i historisë së zonës.

Libri “Beyond Ecophobia: Reclaiming the Heart in Nature Education” argumenton rëndësinë e përvojave pozitive në natyrë, jep argumente kundër frikës nga natyra, i jep rëndësi lojërave në natyrë për t’u bërë më të afrueshëm me natyrën, nënvizon rëndësinë e organizimit të udhëtimeve të udhëhequra në natyrë ku fëmijët mësojnë të ndihen të sigurtë.

Richard Louv autor dhe gazetar amerikan, i njohur për kontributin e tij në fushën e edukimit mjedisor dhe për promovimin e lidhjes mes fëmijëve dhe natyrës, e njohim me librin e tij"Last Child in the Ëoods,2005". Ai ka sjellë në vëmendje problemet e shkëputjes së fëmijëve nga natyra dhe ka nënvizuar rëndësinë e lidhjes së tyre me mjedisin natyror. Në të prezanton konceptin e "deficitit të natyrës" (nature-deficit disorder), duke argumentuar se fëmijët e sotëm po kalojnë më pak kohë në natyrë dhe kjo ka pasoja negative për shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Louv argumenton se mungesa e përvojave në natyrë çon në probleme të tilla si obeziteti, çrregullimet e vëmendjes dhe çështjet emocionale. Ai thekson se ndërveprimi me natyrën është thelbësor për zhvillimin e plotë të fëmijëve. Aktivitetet jashtëshkollore dhe eksplorimi i natyrës, thekson Louv, mund të përmirësojnë zhvillimin emocional dhe fizik të fëmijëve.

Duke iu referar autorëve të mësipërm, sugjerojmë se për të zhvilluar një mësimdhënie të suksesshme në fushën e edukimit mjedisor në Parkun Kombëtar Vjosa për fëmijët e arsimit fillor, me fokus fëmijët me nevoja të veçanta mund të përdoren disa metoda dhe qasje.

1. Metoda të ndërveprimit praktik dhe eksperimental.(mbjellja e disa pemëve, analizimi i ujit nga lumi Vjosa).
2. Hulumtimi i natyrës dhe egërsisë së lumit.
3. Eksplorimi i natyrës duke vëzhguar florën dhe faunën.

Qasje për individualizim

1. Adaptimi i materialeve mësimore për t’i përshtatur për nivele të ndryshme të aftësive dhe nevojave të veçanta.
2. Sigurimi i asistencës me profesionistë, mësues ndihmës, prindër mbështetës.

Aktivitete të ndjeshmërisë sensoriale

1. Aktiviteteve që përfshijnë të gjitha shqisat, si p.sh.: prekje e materialeve natyrore, dëgjim i tingujve të natyrës dhe shijim i produkteve natyrore.
2. Krijimi i stacioneve të ndryshme në park ku fëmijët mund të përjetojnë tekstura të ndryshme, aroma dhe tingujt e natyrës.

Mësim përmes lojës dhe bashkëpunimit

1. Krijimi i lojërave edukative që lidhen me mjedisin, si lojra me role ku fëmijët veprojnë si kafshë ose bimë të ndryshme.
2. Inkurajimi i bashkëpunimit përmes projekteve grupore ku fëmijët punojnë së bashku për të zgjidhur probleme mjedisore ose për të realizuar detyra specifike.

Ftesa e ekspertëve dhe komuniteti

1. Organizimi i sesioneve ku ekspertë të mjedisit ndajnë njohuritë dhe përvojat e tyre me fëmijët.
2. Inkurajimi i fëmijëve dhe familjeve të tyre të marrin pjesë në projekte komunitare për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit në Parkun Kombëtar Vjosa.

Këto metoda dhe qasje do të krijojnë një mjedis gjithëpërfshirës dhe efektiv për edukimin mjedisor të nxënësve të arsimit fillor në Parkun Kombëtar Vjosa, duke siguruar që fëmijët me

nevoja të veçanta të kenë mundësinë të mësojnë dhe të shijojnë përvojat mjedisore në mënyrë të barabartë dhe të përshtatur.

Në librin e tij "Building for Life: Designing and Understanding the Human-Nature Connection, 2005" Stephen R. Kellert argumenton se kontaktet me natyrën ofrojnë përfitime të shumta psikologjike dhe emocionale, veçanërisht për fëmijët, përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta. Sipas tij, kontakti i fëmijëve me natyrën redukton stresin, rrit vetëbesimin te fëmijët dhe ul ndjenjën e ankthit dhe depresionit. Fëmijët me çrregullime të vëmendjes përmirësojnë aftësitë e përqendrimit. Këto aktivitete ofrojnë mundësi për ndërveprim shoqëror dhe zhvillim të aftësive komunikuese dhe bashkëpunuese me mësuesit dhe bashkëmoshatarët. Interes shfaq Dizajni Biophilic që nënkupton integrimin e elementeve natyrore me mjediset ndërtimore për të krijuar hapësira stimuluese për të punuar dhe mësuar. Sipas tij, "Njerëzit kanë një prirje të natyrshme për natyrën, një instinkt biofilik që është thelbësor për mirëqenien tonë emocionale, njohëse, madje, edhe fizike. Projektimi i mjediseve që përfshijnë elemente të natyrës mund të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e jetës sonë, të nxisë kreativitetin, të reduktojë stresin dhe promovimin e shëndetit dhe mirëqenies."

2. Qëllimi i studimit

Qëllimi i studimit është të hulumtojë dhe analizojë rolin dhe praktikat e mësueseve të arsimit fillor në ndërtimin e njohurive mjedisore për nxënësit pranë Parkut Kombëtar Vjosa, me një fokus të veçantë në përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta. Studimi synon të identifikojë dhe ofrojë metoda dhe strategji më efektive për të përfshirë të gjithë nxënësit, pavarësisht aftësive të tyre, në aktivitetet mjedisore dhe edukative të zhvilluara në një mjedis natyror. Studimi përmes kombinimit të metodave kualitative dhe sasiore shqyrton mënyrën se si e perceptojnë mësueset praktikat e gjithëpërfshirjes në mësimdhënies mjedisore, si ndërtojnë strategji dhe si përballojnë ato sfidat në përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në kushtet e natyrës, për të organizuar aktiviete edukative efektive në ndërtimin e njohurive mjedisore për pasurimin e përvojave të nxënësve në lidhje me aktivitetet edukative mjedisore në Parkun Kombëtar Vjosa. Studimi ofron kuptim të plotë të praktikave dhe përvojave të mesuesve, mësueseve mbështetëse, prindërve, specialistëve, duke ndihmuar në zhvillimin e srtategjive më efektive për edukimin mjedisor.

Objektivat dhe pyetjet kërkimore të studimit

1. **Identifikimi i praktikave (objektivi i parë)**

- Të identifikojë dhe analizojë praktikat dhe strategjitë edukative që përdorin mësuesit e arsimit fillor në ndërtimin e njohurive mjedisore për nxënësit në Parkun Kombëtar Vjosa.

Pyetja kërkimore

- Si i perceptojnë dhe zbatojnë mësuesit e arsimit fillor strategjinë gjithëpërfshirëse në ndërtimin e njohurive mjedisore për nxënësit e tyre në Parkun Kombëtar Vjosa?

1. Vlerësimi i përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta

- Të vlerësojë mënyrën dhe efektivitetin e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në aktivitetet edukative dhe mjedisore, duke përdorur lojëra edukative sipas nevojave specifike të tyre.

Pyetja kërkimore

Cilat janë sfidat dhe mundësitë që përballen mësuesit në përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në aktivitete edukative dhe mjedisore pranë Parkut Kombëtar Vjosa?

Metoda dhe materiali

Kampioni i marrë në këtë studim janë mësuese të shkollës 9-vjecare "Naim Frashëri"(5 mësuese dhe 1 mësuese ndihmëse), nxënësit e klasës së tretë në të cilën ndodhen fëmijë me nevoja të veçanta. U përdorën metoda kualitative dhe sasiore. Intervistat individuale me 6 mësueset u kryen për të kuptuar praktikat dhe perceptimet e tyre për gjithëpërfshirjen, grupdiskutimet për të analizuar sfidat në përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta, pyetësorët me nxënësit për të marrë një "feedback" mbi përvojën e tyre në mësimin e njohurive mjedisore përmes lojërave edukative dhe aktiviteteve të tjera. Në intervista u përdorën pyetje të hapura për të marrë më shumë informacion në lidhje me sfidat. Këtë grup pyetjesh më parë e pilotuam në 3 mësuese të arsimit fillor të specializuara edhe në arsimin special. Sugjerimet e tyre na ndihmuan për të pasur pyetje të mirëstrukturuara. Plotësimi i tyre kërkoi kohë rrreth 15 minuta. Formën përfundimtare pyetësori e mori me 10 pyetje. Këto pyetje ndihmuan të vlerësojmë sfidat dhe praktikat e mësueseve në punën me fëmijët në natyrë me fokus fëmijët me nevoja të veçanta. Mësueset e intervistuara janë të gjitha femra. Mësuese të arsimit fillor dhe ndihmëse.

Nr. i mësueseve	**Nr. i mësueseve ndihmëse**	**Nr. i nxënësve të klasës**
5	1	14+2

Mësueset treguan perceptimet dhe përvojat që kanë përjetuar në mësimet e edukimit mjedisor dhe mënyrën si i kanë praktikuar ato, sfidat me të cilat janë ndeshur jo vetëm me fëmijët me nevoja të veçanta, sjelljet e fëmijëve, arritjet akademike si i kanë zbatuar në praktikë, si kanë menaxhuar sjelljet e fëmijëve, a kanë marrë me vete në mësimet në natyrë fëmijët me nevoja të veçanta, si kanë organizuar aktivitetet dhe si kanë përcaktuar llojet e tyre me moshën dhe aftësitë e fëmijëve, a janë trajnuar specifikisht për të përfshirë nxënës me nevoja të veçanta në aktivitete jashtë klase, si reagojnë fëmijët me nevoja të veçanta në aktivitetet mjedisore, ç'metoda kanë gjetur më efektive për të ndihmuar nxënësit me nevoja, ç'ndryshime sugjerojnë për të përmirësuar përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në edukimin mjedisor, si bashkëpunojnë me prindërit për të siguruar përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Pas 10 pyetjeve, përgjigjet e mësueseve ishin:

- Asnjë nga mësueset nuk kishte marrë trajnim për mbështetje specifike të fëmijëve me nevoja të veçanta në aktivitete jashtë klase.
- 2 nga mësueset vetëm pranuan se mund të mbështeteshin nga prindërit. Prindërit e mësueseve te tjera nuk pranojnë kufizimin e fëmijës dhe nuk i dërgonin fare fëmijët në të tilla ditë aktivitetesh.
- Për përfshirjen e fëmijëve me nevoja në aktivitete të tilla, ato thanë se marrin me vete topa ose rrathë.
- Të gjitha treguan se nuk kanë mbështetje për të siguruar mjete transporti, veçse nga pagesat e prindërve.
- Si sfidë kryesore mësueset nxorën transportin.
- Mësueset, si metoda pune, pothuaj,të gjitha përdornin ekskursionin dhe lojërat sportive, që stimulojnë bashkëveprimin me fëmijët e tjerë.
- Nuk kishin praktikuar adaptim të materialeve për të përmbushur nevojat individuale.

Disa nga deklaratat e mësueseve:

- Mungojnë mjetet dhe mbështetja financiare.
- Prindërit akoma nuk pranojnë problematikën e fëmijëve. Kjo vështirëson punën, sepse në klasat tona, mungon mësuesja mbështetëse, dhe vështirëson punën me këta fëmijë.
- Ne nuk e kemi kohën të përshtatim kurrikulën për problematikat e fëmijëve me probleme.

- Nxënësi im të vendos para sfidave me sjellen e tij. Ai kërkon strategji specifike, e ka të vështirë të prishë rutinën.
- Nxënësi im sfidat i ka me komunikimin. Ai mund të sjellë probleme në lojërat në grup gjatë marrjes së udhëzimeve.

Rezultatet per objektivin dhe pyetjen e parë kërkimore

Rezultatet nga intervistat me mësueset për objektivin dhe pyetjen e parë kërkimore treguan se ka mungesë të mbështetjes për të siguruar mbështetje efektive të punës së mësueseve në arsimin fillor. Asnjë nga mësueset nuk ka marrë trajnim specifik në mbështetje të nxënësve jashtë klase. Prindërit e kanë të pamundur të pranojnë kufizimin e fëmijës dhe nuk donin që ata të merrnin pjesë në to. Mësueset kanë mungesë të mjeteve dhe mbështetjes financiare për transportin e fëmijëve. Veç përdorimit të ekskursioneve dhe aktiviteteve sportive mungon mundësia e adaptimit të materialeve.

Rezultatet e objektivit dhe pyetjes së dytë kërkimore

Rezultatet tregojnë se ka sfida të mëdha në përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në aktivitetet jashtë klase. Ato fillojnë nga trajnimet specifike për të punuar me këta nxënës, prindërit nuk pranojnë kufizimet, nuk i dërgojnë në këto aktivitete, transporti i përshtatshëm eshte një sfidë tjetër, mungesa e mjeteve dhe financave për të siguruar këto mjete e kufizon dhe bëhet pengesë për realizimin e këtyre aktiviteteve. Por në gjithë këtë problematikë, ekzistojnë disa pika të forta që rritin shpresat, të tilla si përdorimi i lojërave sportive për stimulimin e bashkëpunimit dhe përfshirjes, mbështetja e disa prindërve dhe pagesa nga prindërit në përgjithësi për të organizuar një shëtitje, ekskursionet e organizuara i përfshijnë fëmijët të gjithë. Pra, ekzizistojnë shpresat e përmirësimit.

Përfundime

- *Organizimi i trajnimeve specifike për të mbështetur përfshirjen e nxënësve me nevoja.*
- *Sigurimi i fondeve për transport dhe materiale për të mundësuar pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve.*
- *Përfshirja e prindërve për të kuptuar dhe mbështetur fëmijët në kufizimet e tyre.*
- *Adaptimi i matrialeve dhe aktiviteteve mësimore për të përmbushur nevojat individuale të fëmijëve.*

Aktiviteti me fëmijët

Për të organizuar këtë orë mjedisore në Parkun Kombëtar të Vjosës, duke u mbështetur tek ajo që sugjerojnë teoritë për këtë problem, përpiluam një listë opsionesh që mund t'i mbajmë fëmijët e klasës së tretë dhe ata me nevoja të veçanta jashtë në natyrë të zënë me punë dhe të argëtuar.

1. Fëmija në karrige me rrota, mundi ***të përgatisë varka*** me letër (dhe në pamundësi përgatitjeje), ai vetëm e lëshon atë në lumë. *(Shpjegim):*Eshtë super e thjeshtë dhe mund tëjetë një mundësi shumë e mire për lojën shqisore. Edhe nëse fëmija nuk është në gjendje të ndihmojë në prodhimin e varkave, ata do të kalojnë mirë duke luajtur, duke i lëshuar ato në rrjedhën e ujit.

2. ***Flluska sapuni/Lojë shqisore.*** Me sapun, ngjyrosje ushqimore, ujë dhe një mikser dore, ujë të marrë me një kovë plazhi, krijuan kosh shumëngjyrësh. (*Shpjegim*): Mund të jetë një mundësi e mirë mësimi për fëmijët që kanë probleme të kujtojnë ngjyrat. Gjithashtu, fëmijët do të përziejnë ngjyrat së bashku dhe të shohin se cilat ngjyra të tjera mund të krijojnë. Përmirëson koordinimin motorrik dhe aftësitë sociale duke bërë më shumë kontakt me sy.

3. ***Shëtitjet në natyrë***/ Shëtitja buzë lumit Vjosë në natyrë ofroi ndjesi shumë të mira. (*Shpjegim*): Bëjeni fëmijën të mbledhë gurë, gjethe dhe lule që i pëlqejnë gjatë shëtitjes. Shikoni dhe dëgjoni zogjtë, shikoni kafshët,pilivesat dhe kandrat e tjera. Vetëm sigurohuni që të flisni për peizazhin për të marrë efektin e plotë.

4. ***Kuti gurësh./ Kuti ndijore.*** Një kuti gurësh është si një kosh i madh ndijor. Ata bënë kështjella, forma gjeometrike, rrugë për makina etj. (*Shpjegim*): Integron shqisat e fëmijës, përmirëson vëmendjen. Eshtë një vend i shkëlqyer për të lënë imagjinatën të lirë dhe mund të jetë një mënyrë e shkëlqyer për të dalë jashtë, i përshtatshëm për fëmijët me vonesë në të folur dhe gjuhë, vonesa të tjera zhvillimore.

5. ***Kohë e qetë.*** Krijuam një hapësirë të vogël të qetë jashtë në hije. Morën drurë, degëza të vogla dhe krijuan me të një kasolle. Lexuam disa libra. (*Shpjegim*): Ju, gjithashtu, mund të ngjyrosni ose të bëni, pothuajse, ndonjë aktivitet tjetër të qetë që fëmijët normalisht do ta shijonin brenda kasolles që ndërtuan. I përshtaten femijëve me çrrregullime të spektrit dhe paaftësi në të nxënë. Ndihmon në zhvillimin e motorikës së madhe dhe të vogël, përmirëson aftësitë sociale.

6. ***Eksplorimi***

Natyra e Vjosës ofron përvoja unike shqisore me shikimin, aromën, shijen dhe prekjen. Fëmijët kanë shumë për të mësuar kur i jepet liria për të eksploruar botën përrreth tij, qoftë një shëtitje në natyrë në këtë park. Ecja në sipërfaqe të pabarabarta, si gurë, shtigje apo sipërfaqe të ndryshme, si: rërë, gurë, drunj, etj. ishte sfidë në vetvete, dhe i ndihmoi në ndërtimin e forcës dhe qëndrueshmërisë. Shtrirja në bar, shikimi i gjetheve që shushurijnë në erë, marrja e luleradhiqeve dhe nuhatja e luleve janë të gjitha ndjesi që ata zbuluan. (*Shpjegim*): Mbledhja e gjërave në shëtitje në natyrë është një aktivitet argëtues eksplorues. Inkurajoni nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur, duke eksploruar dhe mbledhur gjëra të tilla si gurët, gjethet ose lulet. Pastaj, organizoni që të gjithë të takohen për të krahasuar atë që kanë mbledhur.

Përfshini lojëra të ndryshme në shëtitjet tuaja, gjithashtu, tregoni histori, këndoni, dëgjoni tingujt e natyrës dhe identifikoni se çfarë kafshe apo objekt po shkakton tingullin. Ndjeni objektet që fëmijët mbledhin, si: gurë, lule ose gjethe ose sillni një xham zmadhues/lupe me vete për të inspektuar gjithçka që gjeni.

7. Pikturë jashtë

Nuk ka vend më të mirë për të bërë rrëmujë sesa jashtë! Vendosëm disa faqe të mëdha pikture në tokë, mbushëm disa kova me bojë me ngjyrë dhe lamë fëmijën të pikturojë aq "shumë" sa ai mundi të imagjinojë. (*Shpjegim*): Të bësh fëmijën të përdorë duart, këmbët dhe trupin e tij ose të saj për të pikturuar inkurajon përdorimin e grupeve kryesore të muskujve.

Piktura në gurë është një tjetër argëtim në natyrë që përdorëm për të kombinuar pikturën me aktivitetet e eksplorimit. Gjetja e gurëve të përshtatshëm për të pikturuar ishte një aventurë në vetvete, me aftësi motorike bruto që zhvillohen gjatë rrugës. (*Shpjegim*):Aspekti i pikturës përfshin aktivitetet e shkëlqyera motorike të punës me një sipërfaqe më të vogël dhe furça më të vogla bojë.

8. Lodra në natyrë

Lodrat në natyrë si litarët e kërcimit dhe rrathët ishin mjete të shkëlqyera për lojë në natyrë, pasi inkurajojnë lëvizje më të mëdha. Shkopinjtë e vallëzimit me fjongo, flluskat dhe shumë lodra të tjera inkurajuan fëmijët të përdornin imagjinatën.(*Shojegim*): Këto lloj lodrash, gjithashtu, kërkojnë që fëmija të qëndrojë në lëvizje të vazhdueshme me krahët dhe trupin e tij ose të saj, duke e bërë këtë një aktivitet stimulues. Përfitimet koordinim motorik, vetëbesim, aftësi shoqërore. Përshtatet për çrregullime të spektrit të autizmit, paralizë cerebrale, paaftësi në të mësuar.

Lojë me ujë

9. Të gjithë fëmijët e duan spërkatjen në ujë kur moti e lejon atë. (*Shpjegim*): Ajo që shumë kujdestarë nuk e dinë është se si aktivitetet kryesore të lojës në ujë janë rritja e aftësive motorike bruto.

Mbushëm kova me ujë në lumë për fëmijët. Shtuam lodra plazhi, lodra shiringa dhe objekte që forcojnë muskujt e duarve, punuam me ujë për forcimin e aftësive motorike.

10. ***Të bëjmë disa punë***! Fëmijët mblodhën degë të thyera, grumbulluan gjethe. Kjo mënyrë e ndihmon fëmijën të forcojë muskujt e krahut dhe këmbës, të punojë për ekuilibër dhe qëndrueshmëri.

11. ***Ecja në një trung të rrëzuar.*** Ishtë një mënyrë e mirë për të punuar me ndërgjegjësimin hapësinor, ekulibrin. (*Shpjegim*): Këto terrene përfshijnë aftësi motorike bruto dhe një vend ku spikatin aftësitë shoqërore me fëmijët e tjerë.

12. ***Vëzhgimi i natyrës***. Kërkuan një zgavër, ku hodhën disa farëra në një platformë. Një formë për të ndihmuar të ushqehen kafshët rreth lumit.

13. ***Mbledhja e gjetheve dhe degëzave. (****Shpjegim****):***Krijimi i aplikacioneve të përbshkëta rrit kreativitetin dhe aftësitë e shkëlqyera vizuale motorike, përmirëson aftësitë ndërvepruese. E përshtatshme për fëmijët me çrregullime të spektrit të autizmit, paaftësi në të mësuar, sindromën "dëun".

14. ***Të vallëzosh*** në brigjet e Vjosës, nën gurgullimën e rrjedhës, ishte një eksperiencë e paharrueshme.(*Shpjegim*): Ndihmon në rritjen e fleksibilitetit, rrit hormonet e ndjenjës së mirë që do të relaksojnë, përmirësojnë aftësitë sociale, i përshtatshëm për paaftësi fizike, sindromën "doën", paaftësi në të mësuar, spektri i autizmit.

15. ***Të qëndisësh gjethe dhe të krijosh herbarium ose ditarë të bimëve të mbledhura***. Fëmijët përfituan aftësi të koordinimit, përmirësim të motorikës së vogël, u përpoqën të arrijnë të zgjidhin problema të thjeshta praktike.

16. ***Përqafuan pem****ë* ***dhe u shtrin****ë* ***në bar***. (*Shpjegim*): Kalimi i kohës pranë ose nën hijen e një peme ul presionin e gjakut, lehtësojnë stresin, jep ndjenjë të ngrohtë dhe të paqtë. Shtrirja në bar dhe të kërkuarit e formave në re rrit imagjinatën te fëmijët. Ata tergojnë çdo formë që shohin. Kjo ndikon në përmirësimin e aftësive gjuhësore dhe komunikuese, përmirësimin shqisor. Në të angazhohen fëmijë më dispraksi, paraliza cerebrale të cilët e kanë të pamundur lëvizjen.

17. ***Kap një gabim***. Duke eksploruar fëmijët ndeshën krimba, milingona, insekte të ndryshme. Kjo i ndihmoi ata të largojnë frikën.

18. **Imitimi i kafshëve** si peshku, kërcimi si bretkosë, të lëvizin krahët si zogjtë rriti aftësitë e tyre lëvizore.

19. **Mbledhja e qeseve dhe plastikave** që kanë rënëbrigjeve të Vjosës i ndihmoi të mësojnë rëndësinë e kujdesit për një qenie tjetër dhe natyrën.

20. **Shtypja e luleve dhe gjetheve**. (*Shpjegim*): Prej saj mësojnë vlerën e saktësisë, kalitin durimin dhe mësojnë si të presin, rritin këmbënguljen dhe vlerën e suksesit afatgjatë, marrin interes për botanikën, vlerësojnë botën natyrore.

21. **Luaj duke lënë mënjanë gurët.** Aty ku Vjosa ka lënë disa pellgje të vogla, fëmijët përdorën gurë për të kaluar pellgun. Kjo i ndihmoi të bëhen zgjidhës të problemeve. Është një objektiv aftagjatë që i ndihmon në jetën reale.

Në një mjedis si Vjosa ka kaq shumë për të eksploruar. Eksplorimi ishte një mënyrë e shkëlqyeshme për të pasur ndërveprime të reja shoqërore, gjë që ndihmoi në ndërtimin e aftësive shoqërore-emocionale. Fëmijët punuan së bashku në një gjueti ose në vëzhgimin e kafshëve dhe insekteve me fëmijët e tjerë. Kur eksplorimi bëhet me bashkëmoshatarët, krijon mundësi për përvoja dhe miqësi të reja.Natyra promovoi përdorimin e aftësive të funksionit ekzekutiv.Aftësitë e funksionit ekzekutiv dhe aftësitë e jetës që u përdorën i ndihmuan të qëndrojnë të organizuar dhe të pavarur. Me lojën e pastrukturuar në natyrë, fëmijët përdorën kreativitetin për të zgjidhur problemet dhe kujtesën e punës për të krijuar histori. Ata përdorën aftësitë e tyre fleksibël të të menduarit duke testuar kufijtë dhe duke mësuar se si të qëndrojnë të sigurt gjatë eksplorimit, krijimit dhe argëtimit. Ata forcuan dhe sfiduan aftësitë e tyre të jetës vetëm duke luajtur.Fëmijët krijuan përvoja të reja shqisore në natyrë.Tingujt e zogjve, aroma e barit të freskët të prerë, ndjenja e diellit të ngrohtë gjithçka e re ndihmoi të mësojnë. Fëmijët

mund të marrin kaq shumë pamje, tinguj dhe aroma të reja nga mësimi mjedisor në Vjosë. Çdo aktivitet u shoqërua me foto. Pas përfundimit të aktivitetit, u organizua në grupin e fëmjëve një diskutim.

- Ç'ngjyra pe kur lëshove varkat në lumë?(përfitojnë nga loja shqisore)
- Ç'zogj, insekte vure re gjatë shëtitjes? A mund të përgatitësh një histori rrethtyre?(inkurajim për vëzhgim dhe treguar histori)
- Cilat forma gjeometrike mund të krijoje me gurët në kuti?(zhvillimi i aftësive matematikore dhe mendimin kritik)
- Cilat ngjyra krijohen në flluskat e sapunit?(eksperimentimi me ngjyrat)
- Si ndihesh kur kërcen si bretkosë apo fluturon si zog?(inkurajimi i lëvizjeve fizike dhe përmirësimi i aftësive motorike)

Referenca

Carson, R. (1962). "*Silent Spring*". Houghton Mifflin. p. 3-4

Orr, D. W. (1992). "*Ecological Literacy: Education and the Transition to a Postmodern World*". State University of New York Press. p. 27-32

Palmer, J. A. (1998). "*Environmental Education in the 21st Century: Theory, Practice, Progress and Promise*". Routledge. p. 12

IUCN. (2019). "*Protected Areas and Climate Change in Europe*". International Union for Conservation of Nature. p. 3

WWF. (2020). "*Living Planet Report 2020: Bending the Curve of Biodiversity Loss"* World Wide Fund for Nature. p. 7-8

UNESCO. (2020). "*Education for Sustainable Development*" UNESCO. p. 2

EPA. (2021). "*Environmental Education (EE)".* EPA p.4-5

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Shqipëri. (2021). "*Strategjia Kombëtare për Mjedisin*". p.46-52.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Shqipëri. (2021). "*Raporti Vjetor i Parkut Kombëtar* Vjosa". p.1-3.

National Wildlife Federation. (2018). "*Eco-Schools USA Handbook*" .[NWF website](https://www.nwf.org/Eco-Schools-USA/Resources/Handbook). p. 14

Anonim (n.d) "*Connecting Children of All Abilities to Nature Play & Therapeutic Gardens*" Research Gate. p. 11-14

Kormanik A. (2024) "*Harnessing the Power of Nature: Outdoor Sensory Activities for Autistic Children*". Autism Spectrum News. p. 12

Rudy. L.J (2022) "*Extracurricular Activities for Disabled Kids".* Very well family. p. 7-9

Anonim (2023). "*Outdoor Learning and Nature-Based Activities: Connecting Children with the Environment"*. Montgomery Child Care Association. p. 3-4

Rudy. L.J (2022) "*Extracurricular Activities for Disabled Kids".* Very well family. p. 18

Kentiba. E (2015) "*Challenges and problems affecting the participation of disabled children in physical education and extracurricular activities".* Research Gate. p. 15

Anonym (n.d) *"Working with children with special needs".* Sage Publications Inc. p. 3

Anonym (n.d) "*Extracurricular activities and students ëith disabilities".* Pacer Center. p. 15

"Building for Life: Designing and Understanding the Human-Nature Connection" nga Stephen R. Kellert. p. 34-42

Jean Piaget: "The Origins of Intelligence in Children","The Construction of Reality in the Child" (1954) p. 84-92

Lev Vygotsky:"Mind in Society The Development of Higher Psychological Processes" (1978) p. 32-48

David Kolb"*Experiential Learning: Experience as the Source of Learning and Development*" (1984) p.38-46

Anonim (2016) "*Outdoor Activities for Children with Special Needs*". CerebralPalsy. p. 3-5

Anonim (2019). "10 outdoors spring activities to do with kids with developmental disabilities". Integrity.inc. p. 7

Anonim (n.d) "Connecting Children of All Abilities to Nature Play & Therapeutic Gardens". p. 3-4

David Sobel: (Place-Based Education; Connecting Classrooms and Communities),(Seven Design Projects for Children, Childhood and Nature):(Design Principles for Educators)(Beyond Ecophobia: Reclaiming the Heart in Nature Education) p. 39-63

Richard Louv "Last Child in the Woods",2005 p. 16-17

Anonim (2016) "*Outdoor Activities for Children with Special Needs*". CerebralPalsy.org. p. 18

Anonim (2023). "*Outdoor Learning and Nature-Based Activities: Connecting Children with the Environment"*. Montgomery Child Care Association. p. 2

SI NDIKON EKSPOZIMI NË NATYRË TE FËMIJËT ME AFTËSI NDRYSHE?

[1]Dr. Brunilda Laboviti, [2]Dr. Elisabeta Kafia, [3]Dr. Loreta Mamani
[1,2]Department of General Psychology, Faculty of Social Sciences, Albanian University, Tiranë, Shqipëri,klinikalaboviti@gmail.com
[3]Department of Education and Teaching Methodology, Faculty of Education and Social Sciences,"Eqrem Çabej"University Gjirokastër, Shqipëri,lmamani@uogj.edu.al

Abstrakt

Ekspozimi ndaj mjediseve natyrore është treguar se redukton ndjeshëm nivelet e stresit dhe përmirëson mirëqenien mendore te fëmijët me aftësi ndryshe. Efekti qetësues i natyrës mund të ndihmojë në menaxhimin e simptomave të ankthit, ADHD dhe autizmit. Hapësirat e gjelbra, zhurma e gjetheve që shushurijnë dhe pamja e ujit që rrjedh mund të krijojnë një mjedis të qetë që qetëson mendjen. Fëmijët me aftësi ndryshe shpesh përballen me sfida në rregullimin emocional. Natyra ofron një mjedis paqësor që mund t'i ndihmojë këta fëmijë të zhvillojnë kontroll më të mirë emocional. Natyra e paparashikueshme e natyrës i inkurajon fëmijët të zhvillojnë aftësitë e zgjidhjes së problemeve. Eksplorimi i natyrës u mundëson fëmijëve me aftësi ndryshe të praktikojnë dhe të fitojnë besim në aftësitë e tyre të pavarura. Detyra të tilla si ecja, ngritja e një pikniku ose identifikimi i llojeve të ndryshme të bimëve mund t'i fuqizojnë ata të marrin iniciativën dhe të ndjejnë një ndjenjë arritjeje. Mjediset natyrore ofrojnë përvoja të pasura shqisore që mund të jenë tepër të dobishme për fëmijët me çrregullime të përpunimit shqisor. Natyra ofron një mjedis më pak të strukturuar dhe më të relaksuar për fëmijët për të bashkëvepruar, duke nxitur punën ekipore, komunikimin dhe lidhjet sociale. Shumë mjedise natyrore dhe aktivitete në natyrë mund të përshtaten për të qenë gjithëpërfshirës, duke i lejuar fëmijët me aftësi ndryshe të marrin pjesë së bashku me bashkëmoshatarët e tyre. Terapitë e bazuara në natyrë, të tilla si terapia e kopshtarisë ose terapia me ndihmën e kafshëve, mund të ofrojnë mbështetje shtesë për fëmijët me aftësi ndryshe. Këto terapi përdorin elementë natyrorë për të krijuar përvoja terapeutike që mund të përmirësojnë mirëqenien fizike, emocionale dhe sociale.

Fjalët kyçe: *fëmijët me aftësi ndryshe,mjedis , mirëqënie mendore, terapitë, natyrë*

Abstract

Exposure to natural environments has been shown to significantly reduce stress levels and improve mental well-being in differently abled children. The calming effect of nature can help manage symptoms of anxiety, ADHD and autism. Green spaces, the sound of rustling leaves and the sight of flowing water can create a peaceful environment that soothes the mind. Children with disabilities often face challenges in emotional regulation. Nature provides a peaceful environment that can help these children develop better emotional control. The unpredictable nature of nature encourages children to develop problem-solving skills. Exploring nature allows differently-abled children to practice and gain confidence in their independent skills. Tasks such as walking, setting up a picnic, or identifying different types of plants can empower them to take initiative and feel a sense of accomplishment. Natural environments provide rich sensory experiences that can be incredibly beneficial for children with sensory processing disorders. Nature provides a less structured and more relaxed environment for children to interact, fostering teamwork, communication and social bonding. Many natural settings and outdoor activities can be adapted to be inclusive, allowing differently-abled children to participate alongside their peers. Nature-based therapies, such as horticultural therapy or animal-assisted therapy, can provide additional support for differently abled children. These therapies use natural elements to create therapeutic experiences that can improve physical, emotional and social well-being.

Keywords: *children with different abilities, environment, mental well-being, therapies, nature*

Hyrja

Ndërsa shqetësimet në lidhje me shëndetin mendor dhe zhvillimin e fëmijëve vazhdojnë të rriten, studiuesit dhe specialistët po e drejtojnë gjithnjë e më shumë vëmendjen e tyre ndaj ndikimit të natyrës në mirëqenien e fëmijëve me probleme neurozhvillimore. Ky metastudim, i cili përmbledh dhe analizon rezultatet e studimeve të ndryshme të kryera në mbarë botën, sugjeron se ekspozimi ndaj mjediseve natyrore mund të ketë përfitime të konsiderueshme për këta fëmijë. Ky artikull shqyrton se si natyra ndikon pozitivisht te fëmijët me çrregullime të spektrit të autizmit, ADHD dhe çështje të tjera neurozhvillimore dhe se si këto praktika mund të zbatohen në Shqipëri për të rritur mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve tanë.

Studimi, i cili përfshin analiza të thelluara të kërkimeve nga vende të ndryshme, tregon se ndërveprimi me natyrën – përmes aktiviteteve të tilla si shëtitjet në pyll, loja në parqe dhe ndërveprimet me kafshët – mund të përmirësojë aftësitë sociale, të ulë nivelin e stresit dhe të rritë fokusin te fëmijët me probleme neurozhvillimore. Për shembull, në disa vende, është vërejtur se fëmijët që kalojnë kohë në mjedise natyrore shfaqin sjellje më pak agresive dhe përqendrim më të mirë në detyrat e përditshme.

Përfitimet e ekspozimit në natyrë shtrihen përtej përmirësimeve të sjelljes. Metastudimi thekson se kontakti i rregullt me mjediset natyrore, gjithashtu, mund të përmirësojë funksionet njohëse, të rritë disponimin dhe të promovojë shëndetin fizik. Fëmijët me probleme neurozhvillimore shpesh përballen me sfida të përpunimit shqisor dhe mjediset natyrore mund të ofrojnë një përvojë të pasur shqisore që është edhe qetësuese dhe stimuluese. Tingujt natyrorë, teksturat dhe stimujt vizualë mund të ndihmojnë në rregullimin e inputeve shqisore dhe ofrojnë një efekt qetësues që mund t'i mungojë mjediseve të brendshme.

Për më tepër, ndërhyrjet e bazuara në natyrë mund të nxitin një ndjenjë pavarësie dhe vetë-efikasiteti te fëmijët. Angazhimi në aktivitete në natyrë, të tilla si kopshtari, shëtitje ose zanate në natyrë, inkurajon aftësitë për zgjidhjen e problemeve, kreativitetin dhe elasticitetin. Këto aktivitete ofrojnë, gjithashtu, mundësi për ndërveprim social dhe punë ekipore, të cilat janë vendimtare për zhvillimin e kompetencave sociale dhe inteligjencës emocionale.

Në Shqipëri, ku aksesi në natyrë është lehtësisht i disponueshëm në shumë pjesë të vendit, zbatimi i këtyre gjetjeve mund të ofrojë një qasje të re dhe efektive për trajtimin dhe mbështetjen e fëmijëve me çrregullime neurozhvillimore. Shkollat, qendrat e terapisë dhe programet e komunitetit mund të integrojnë aktivitete të bazuara në natyrë në kurrikulat e tyre dhe praktikat terapeutike. Për më tepër, fushatat e ndërgjegjësimit publik mund të edukojnë prindërit dhe kujdestarët për rëndësinë e ekspozimit ndaj natyrës për zhvillimin e fëmijëve të tyre.

Ky metastudim na ofron një mundësi të vlefshme për të adoptuar dhe zbatuar praktikat më të mira ndërkombëtare, duke rritur cilësinë e jetës dhe mundësitë e zhvillimit për fëmijët tanë. Duke përqafuar potencialin terapeutik të natyrës, ne mund të krijojmë mjedise më gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse që plotësojnë nevojat unike të fëmijëve me probleme neurozhvillimore, duke nxitur rritjen e tyre dhe duke u mundësuar atyre të lulëzojnë.

Mjetet dhe metodologjia

Metodologjia e zgjedhur për të realizuar këtë punim shkencor është metastudimi, e cila është përzgjedhur sepse është një metodologji efektive dhe e fuqishme që mund të ofrojë një analizë të thelluar dhe të besueshme mbi një temë shkencore, duke shfrytëzuar në mënyrë optimale të dhënat dherezultatet e studimeve të mëparshme. Duke kombinuar të dhënat nga shumë studime, metastudimi rrit fuqinë statistikore të analizës. Kjo metodë dihmon në përgjithësimin e rezultateve dhe rritjen e aplikueshmërisë së tyre për një popullatë më të gjerë. Për shkak se përfshin studime të ndryshme, përfundimet e arritura janë më të besueshme dhe të aplikueshme në kontekste të ndryshme. Duke përfshirë shumë studime, metastudimi mund të zvogëlojë ndikimin e gabimeve rastësore apo të studimeve individuale që mund të jenë të paragjykuara ose

me metodologji të dobët. Një arsye tjetër e përzgjedhjes së kësaj metodologjie është sepse metastudimi përdor të dhënat ekzistuese, duke kursyer kohë dhe burime. Kjo është veçanërisht e dobishme kur kohëzgjatja dhe burimet janë të kufizuara. Le të ndalemi specifikisht në studimet e shqyrtuara në këtë metastudim.

